



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE DHE INVESTIMEVE TË HUAJA  
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK

“PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E VITIT 2022

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK ME  
OBJEKT  
“PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË  
AUDITIMET E VITIT 2022”**

**DHJETOR 2023**

## PËRMBAJTJA

Përmbledhje Ekzekutive .....	4
1.1 Hyrje .....	6
1.2 Objektivat .....	6
1.3 Qëllimi.....	7
1.4 Metodologjia .....	7
1.5 Konkluzione .....	7
2.Opinion I Përgjithshëm Mbi Zbatimin E Rekomandimeve.....	7
3.1. Ujësjetllës Kanalizime Sha, Fier .....	8
3.2 Ujësjetllës Kanalizime Elbasan Sh.A. ....	52
3.3 Agjencinë Kombëtare Të Mbrojtjes Civile .....	74
3.4 Albgazi .....	102
3.5. Ministria E Infrastrukturës Dhe Energjisë, Projekti “Ndërtimi, Operimi Dhe Transferimi (Bot) Hec Mbi Lumin Devoll, Rimbursimi I Ndërtimit Të Rrugëve Zëvendësuese” .....	130
3.6. . Spitali Bashkiak Sarandë.....	150
3.7. S.U.O.Gj. “Mbretëresha Geraldinë” .....	167
3.8. Ujësjetllës Kanalizime Sarandë Sh.A.....	181
3.9.Ujësjetllës Kanalizime Shkodër .....	203
3.10. Ujësjetllës Kanalizime Vlorë .....	231
3.11. Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastrë .....	265
3.12. Agjencia Kombëtare E Ujësjetllës Kanalizimeve Dhe Infrastrukturës Së Mbetjeve .....	305
3.13. Autoriteti Rrugor Shqiptar Projekti Ndërtimi I By-Pass-Eve Fier & Vlorë .....	341
3.14. Autoriteti Rrugor Shqiptar Projekti Ndërtimi I Rrugës Qukës-Qafë Pllaçë.....	361
3.15.. Fondi Shqiptar I Zhvillimit Projekti Ndërtimi I Rrugës Së Lumit Të Vlorës .....	382
3.16. Fondi Shqiptar I Zhvillimit Projekti Rikonstruksioni I Rrugës Ujë I Ftohtë – Oriku Dhe Ndërtimi I Dy By – Pass-Eve.....	402
3.17. Performanca E Shoqërive Publike Të Sektorit Energjitik Në Administrimin E Rezervës Hidrike Në Kaskadën E Lumit Drin, Prodhimit, Transmetimit Dhe Shpërndarjes Së Energjisë Elektrike Për Vitin 2021-2022.....	410
Anekse .....	427



## **Përmbledhje ekzekutive**

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, gjatë auditimeve të evaduara në vitin 2022 sipas programeve të auditimit në zbatim të Programit të Auditimit nr.702/1, datë 04.08.2023 “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet për periudhën “01/01/2022 deri më 30/06/2023”, në subjektet:

1. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, projekti “Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi (BOT) HEC mbi lumin Devoll, rimbursimi i ndërtimit të rrugëve zëvendësuese”
2. KESH, OSHEE, OST dhe ERE “Performanca e shoqërive publike të sektorit energjitik në administrimin e rezervës hidrike në kaskadën e lumit Drin, prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”
3. Fondi Shqiptar I Zhvillimit, projekti “Konektiviteti i rrugëve rajonale dhe lokale, investimi “Rikonstruksioni i rrugës Ujë i Ftohtë – Orikum dhe ndërtimi i dy By – Pass-eve”
4. Fondi Shqiptar I Zhvillimit, projekti “Ndërtimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”
5. Autoriteti Rrugor Shqiptar, projekti “Ndërtimi i by-pass-eve Fier & Vlorë”
6. Autoriteti Rrugor Shqiptar, projekti “Ndërtimi i Rrugës Qukës-Qafë Pllaçë”
7. Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve dhe infrastrukturës së Mbetjeve
8. Agjencinë Kombëtare Të Mbrojtjes Civile
9. ALBGAZ Sh.a.
10. Ujësjetës Kanalizime Sha. Vlorë
11. Ujësjetës Kanalizime Sha. Elbasan
12. Ujësjetës Kanalizime Sha. Gjirokastër
13. Ujësjetës Kanalizime Sha. Fier
14. Ujësjetës Kanalizime Sha. Shkodër
15. Ujësjetës Kanalizime Sha. Sarandë
16. Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik Mbretëresha Geraldinë
17. Spitali Bashkiak Sarandë

Nga auditimi tematik për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimit e realizuar nga departamenti i auditimit të shoqërive publike dhe investimeve të huaja, për periudhën 01.01.2022 deri më datë 30.06.2023, ka rezultuar si në vijim:

Janë rekomanduar gjithsej 481 masa, nga të cilat janë pranuar 473 masa ose 98.3 %, si dhe nuk janë pranuar 8 masa ose 1.7%.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar rezulton:

Zbatuar plotësisht 148 masa ose 31.3%; zbatuar pjesërisht 15 masa ose 3.2%; janë në proces zbatimi 241 masa ose 51 % dhe 69 masa të pa zbatuara ose 14.5 %

Konstatohet se nga 17 auditimet e kryera:

**10 subjekte** (Agjencinë Kombëtare Të Mbrojtjes Civile, Ujësjetës Kanalizime Sha. Shkodër, Ujësjetës Kanalizime Sha. Sarandë, Spitali Bashkiak Sarandë, Ujësjetës Kanalizime Sha. Vlorë, Ujësjetës Kanalizime Sha. Fier, Ujësjetës Kanalizime Sha. Gjirokastër, Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve dhe infrastrukturës së Mbetjeve, Fondi Shqiptar I Zhvillimit, projekti “Ndërtimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”, Fondi Shqiptar i Zhvillimit “Projekti Rikonstruksioni i rrugës Ujë i Ftohtë – Orikum dhe ndërtimi i dy By – Pass-eve”) kanë hartuar programin (Plan veprimin) dhe kanë respektuar afatin prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e

rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

**7 subjekte** (Ujësjetllës Kanalizime Sha. Elbasan, ALBGAZ Sh.a “KESH, OSHEE, OST dhe ERE”, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik Mbretëresha Geraldinë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, projekti “Ndërtimi i by-pass-eve Fier & Vlorë”, Autoriteti Rrugor Shqiptar, projekti “Ndërtimi i Rrugës Qukës-Qafë Plloçë”) nuk kanë hartuar programin (Plan veprimin) dhe nuk kanë respektuar afatin prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, duke vepruar jo në përputhje me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”

**4 subjekte** (Agjencinë Kombëtare Të Mbrojtjes Civile, Ujësjetllës Kanalizime Sha. Sarandë, Ujësjetllës Kanalizime Sha. Shkodër, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, projekti “Ndërtimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”) kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor në zbatim të pikës 2, nenit 30 i Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

**13 subjekte** (Ujësjetllës Kanalizime Sha. Elbasan, ALBGAZ Sh.a, “KESH, OSHEE, OST dhe ERE”, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Spitali Bashkiak Sarandë, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik Mbretëresha Geraldinë, Ujësjetllës Kanalizime Sha. Vlorë, Ujësjetllës Kanalizime Sha. Fier, Ujësjetllës Kanalizime Sha. Gjirokastër, Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe infrastrukturës së Mbetjeve, Autoriteti Rrugor Shqiptar, projekti “Ndërtimi i by-pass-eve Fier & Vlorë”, Autoriteti Rrugor Shqiptar, projekti “Ndërtimi i Rrugës Qukës-Qafë Plloçë”, Fondi Shqiptar i Zhvillimit “Projekti Rikonstruksioni i rrugës Ujë i Ftohtë – Orikum dhe ndërtimi i dy By – Pass-eve) nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, duke vepruar jo në përputhje me pikën 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Niveli i realizimit të masave sipas llojit të tyre, paraqitet si më poshtë:

**-Masa organizative:**

Nga 314 masa të rekomanduara, janë pranuar 310 ose 98.7% dhe 4 masa nuk janë pranuar ose 1.23%. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 87 masa ose 28.06%; pjesërisht 11 masa ose 3.55%, janë në proces zbatimi 169 masa ose 54.52% si dhe 43 masa rezultojnë të pa zbatuara ose 13.87%.

**-Masa me efekt negativ financiar (3E) “Të ardhura të munguara”:**

Nga 49 masa të rekomanduara me vlerë 64,089,401,053 lekë rezultojnë 48 masa ose 97.95% në vlerën 64,079,552,453 lekë të pranuar dhe 1 masë ose 2.05% në vlerën 9,848,600 lekë të papranuara. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 9 masa ose 18.75% e tyre në vlerën 164,572,920 lekë, janë zbatuar pjesërisht 3 masa ose 6.25% e tyre në vlerën 1,286,806,723 lekë, janë në proces zbatimi 28 masa ose 58.33% e tyre në vlerën 62,289,331,698 lekë dhe rezultojnë të pa zbatuara 8 masa ose 16.67 % e tyre në vlerën 338,841,111 lekë.

**-Masa shpërblim dëmi:**

Nga 44 masa të rekomanduara me vlerë 251,929,506 lekë rezultojnë 42 masa ose 94.45% në vlerën 247,463,500 lekë të pranuar dhe 2 masa ose 5.55% në vlerën 4,466,006 lekë të papranuara.

Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 7 masa ose 16.67% e tyre në vlerën 22,778,524 lekë, është zbatuar pjesërisht 1 masë ose 2.38% e tyre në vlerën 695,700 lekë, janë në proces zbatimi 29 masa ose 69.05% e tyre në vlerën 179,187,617 lekë dhe rezultojnë të pa zbatuara 5 masa ose 11.9 % e tyre në vlerën 44,801,659 lekë.

**-Masa disiplinore:** Nga 66 masa të rekomanduara, janë pranuar 65 masa ose 98.5% dhe 1 masë nuk është pranuar ose 1.5%.

Nga masat e pranuar, 42 masa ose 64.62% e tyre janë zbatuar plotësisht, 15 masa ose 23.08% e tyre janë në proces zbatimi dhe 8 masa ose 12.31% e tyre rezultojnë të pa zbatuara.

**-Masa administrative:**

Nga 6 masa të rekomanduara, janë pranuar 6 masa ose 100%. nga masat e pranuar, 3 masa ose 50% e tyre janë zbatuar plotësisht dhe 3 masa ose 50% e tyre nuk janë zbatuar.

**-Mosrespektimi i kushteve të kontratës të shitblerjes midis palëve:**

Moszbatim të kushteve të kontratës së shitblerjes të KESH për FSHU është rekomanduar 1 masë në vlerën 6,188,316,173 lekë dhe është pranuar plotësisht, kjo masë është e pazbatuar.

Moszbatim të kontratës së shkëmbimit midis KESH dhe NOA Energy të shkëmbimit të sasisë së energjisë elektrike është rekomanduar 1 masë për sasinë kthimin e energjisë elektrike nga NOA Energy për KESH në sasinë 17,515 MWH, e cila është pranuar plotësisht por nuk është zbatuar nga palët e kontraktuara.

## 1.1 Hyrje

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme në subjektet e lartpërmendur mbështetur në programin e auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 702/1 prot. datë 04.08.2023, me objekt: “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimet e vitit 2022”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të lartë të shtetit” dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrisë elektronik institucionale. Auditimi u krye nga:

A.L, përgjegjës grupi

J.H, anëtar

K.SH, anëtar

K.G, anëtar

B.SH, anëtar

K.H, anëtar

E.K, anëtar

J.M, anëtar

Auditimi filloi më datë 07.08.2023 dhe përfundoi më datë 08.09.2023.

## 1.2 Objektivat

1. Hartimi i programit (Planit të veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”

2. Zbatim i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi.

3. Zbatim i rekomandimeve për masat me karakter organizativ.

4. Zbatim i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik.

5. Zbatim i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet.

6. Zbatim i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative.

7. Te tjera që rezultojnë gjatë auditimit

### **1.3 Qëllimi**

Vlerësimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna, nga auditimet e mëparshme, koherencës së tyre dhe përgjegjshmërisë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

### **1.4 Metodologjia**

Duke pasur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit dhe dhënien e një vlerësimi sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, u auditua niveli zbatimit të secilit rekomandim në subjektet e përzgjedhura, vlerësuar sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion gjatë fazës së kryerjes së auditimit në terren.

### **1.5 Konkluzione**

Për çështjet e shqyrtuara janë zhvilluar ballafaqime gjatë fazës së auditimit në terren dhe në përfundim të tij janë mbajtur akt verifikime për çdo subjekt të audituar, mbi rezultatet e të cilit është përgatitur ky Raport Përfundimtar Auditimi.

### **2.Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve**

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se shkalla e pranueshmërisë së rekomandimeve kundrejt atyre të pa pranuar rezulton në nivel të konsiderueshëm, konkretisht nga 481 masa të rekomanduara gjithsej, janë pranuar 473 masa ose 98,3 %, si dhe nuk janë pranuar 8 masa ose 1.7 %. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar rezulton: zbatuar plotësisht 148 masa ose 31.3 %, zbatuar pjesërisht 15 masa ose 3,2 %, janë në proces zbatimi 241 masa ose 51 % si dhe rezultojnë 69 masa të pa zbatuara ose 14.5 %.

### 3.1. Ujësjetllës Kanalizime SHA, Fier

#### PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në **Ujësjetllës Kanalizime SHA, Fier** mbi “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022” për auditimin e kryer në vitin 2022, për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2021 paraqitur me shkresën e administruar në KLSH me nr. 248/9 prot., datë 05.09.2022 (*administruar në subjekt me nr. 1184 prot., datë 09.08.2022*), duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH<sup>së</sup> të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2022, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;

b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;

c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, eficiency dhe ekonomicitet të fondeve;

ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në subjekt u mbajt Akt Verifikimi nr. 1, datë 07.09.2023, administruar në Zyrën e UKF me nr. 2139 prot, datë 07.09.2023, për të cilin nuk është paraqitur observacion nga ana e subjektit. Pas dërgimit të Projektraportit të Auditimit, nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observacione.

**Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:**

#### **I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.**

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, UKF *ka respektuar* këtë afat duke kthyer përgjigje sipas shkresës së administruar në institucion me nr. 1240 prot., datë 23.08.2022. Referuar sipas kësaj shkrese rezulton se me Urdhër të Titullarit nr. 1213 prot., datë 12.08.2022 është ngritur Grupi i Punës për zbatimin e masave e rekomandimeve të lëna.

#### **II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.**

-Nga ana e subjektit të audituar *nuk janë marrë masa* për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas parashikimeve në Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

#### **III. Rekomandimet e KLSH**

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 248/9 prot., datë 05.09.2022, administruar në UKF SHA me nr. 1184 prot., datë 09.08.2022, janë rekomanduar gjithsej:

a. Janë rekomanduar **40 masa organizative**;

b. Janë rekomanduar **3 masa për shpërblim dëmi në vlerën 21,140,484 lekë**;



c. Janë rekomanduar 7 masa për përdorimin me shpenzime jo në përpunje me parimet e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit në shumën 65,886,776 lekë;

d. Janë rekomanduar 6 masa disiplinore.

d. Janë rekomanduar 3 masa administrative.

#### **IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH**

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 248/9 prot., datë 05.09.2022, administruar në UKF SHA me nr. 1184 prot., datë 09.08.2022, statusi i praneshmërisë së rekomandimeve është si me poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Organizative	40 masa	40	-
2	Shpërblim dëmi	3 masa 21,140,484 lekë	3 masa 21,140,484 lekë	-
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	7 masa 287,548,076 lekë	7 masa 287,548,076 lekë	-
4	Masa Disiplinore	6	6	-
5	Masa Administrative	3	3	-

#### **V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit**

Në mënyrë të përmblodhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	40 masa	14	-	23	3
2	Shpërblim dëmi	3 masa 21,140,484 lekë	-	-	3 masa 21,140,484 lekë	-
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	7 masa 287,548,076 lekë	2 masë 2,189,578 lekë	1 masë 1,349,984 lekë	2 masa 2,226,890 lekë	1 masë 281,781,624 lekë
4	Masa Disiplinore	6	6	-	-	-
5	Masa Administrative	3	3	-	-	-

#### **I/1 HYRJA**

Auditimi është kryer në përpunje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 702/1, prot., datë 04.08.2023, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. A.L, (Përgjegjës grupi)
2. J.H.

## I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 248/9 prot., datë 05.09.2022, administruar në UKF SHA me nr. 1184 prot., datë 09.08.2022, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

## I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

## I/4. Metodologjia E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

## I/5. Konkluzioni:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Ujësjiellës Kanalizime SHA, Fier, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 248/9 prot., datë 05.09.2022, administruar në UKF SHA me nr. 1184 prot., datë 09.08.2022, rezulton se nga **59** masa të rekomanduara (*organizative, shpërblim dëmi dhe 3-E, Disiplinore*), janë pranuar nga subjekti **59** masa ose 100 %. **Nga të pranuarat (59)**: janë zbatuar plotësisht **25**, ose 42.4 % e tyre, është zbatuar pjesërisht **1** masë ose 1.7 %, janë në proces zbatimi **28** masa ose 47.5 % dhe nuk janë zbatuar **5** masa ose 8.4 %.

Nga sa shikohet niveli i realizimit është në masën 42.4 %, gjë e cila tregon se Ujësjiellës Kanalizime SHA, Fier e ka vlerësuar procesin e zbatimit të rekomandimeve.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	40 masa	14	-	23	3
2	Shpërblim dëmi	3 masa 21,140,484 lekë	-	-	3 masa 21,140,484 lekë	-
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	7 masa 287,548,076 lekë	2 masë 2,189,578 lekë	1 masë 1,349,984 lekë	2 masa 2,226,890 lekë	2 masa 281,781,624 lekë
4	Masa Disiplinore	6	6	-	-	-
5	Masa Administrative	3	3	-	-	-
<b>SHUMA</b>		<b>59</b>	<b>25</b>	<b>1</b>	<b>28</b>	<b>5</b>

## II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 42.4 % kurse ai i atyre në proces ose të zbatuara pjesërisht është 49.1 %, nivele këto të cila tregojnë vlerësimin pjesërisht të këtij procesi si dhe domosdoshmërinë që ka ndjekja e procedurave të duhura për zbatimin e rekomandimeve të zbatuara pjesërisht, përfundimi i atyre në proces si dhe nisja e hapave të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve të pazbatuara.

### **III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM**

**III/1-**Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.  
-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, UKF SHA, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 1240 prot., datë 23.08.2022.

**III/2-**Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”).

-Nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*”.

**III/3.** Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën me objekt “Blerje materiale hidraulike” rezulton se në përbërje të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të ngritur nga ana e ish – Titullarit të AK z. P.N është caktuar në këtë komision edhe anëtari i NJP i cili ka qenë pjesë e Grupit të Punës për hartimin e specifikimeve teknike (pavarësisht Urdhrit nuk ka firmosur) si dhe njëkohësisht ka qenë anëtar i NJP, i cili ka miratuar kriteret e hartuara më parë. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Kreu VII “Procedurat E Ankimit Administrativ”, neni 63, “Të drejtat e personit të interesuar”, pika 1.1, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu X “Shqyrtimi i Ankesave”, neni 78 “Ankesat në autoritetin kontraktor”, pika 6. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe nr. 42 të Raportit të Auditimit*).

**1.1 Rekomandimi:** Nga ana e UK Fier SHA të merren masa për vendosjen në komisionet e shqyrtimit të ankesave, personave të cilët nuk kanë marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes për çështjet për të cilat janë paraqitur ankesat.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: I pranuar

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKF SHA janë marrë masat e nevojshme për vendosjen në komisionet e shqyrtimit të ankesave të personave të cilët nuk kanë marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes për çështjet për të cilat janë paraqitur ankesat.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet si *I pranuar* dhe *I zbatuar*. Verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**2. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës me objekt “Blerje materiale hidraulike”, rezulton se me urdhër nr. 268, datë 18.03.2019 të Titullarit të UK Fier SHA është ngritur grupi i punës i përbërë nga z. V.M, z. E.E, z. DH.S dhe z. K.M për hartimin e specifikimeve teknike. Në fakt specifikimet teknike janë miratuar vetëm nga ana e z. V.M dhe jo nga anëtarët e tjerë, veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2 si dhe me Urdhrin e Titullarit nr. 268 prot., datë 18.03.2019. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 42 të Raportit të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** Nga ana e Shoqërisë Aksionare Ujësjiellës Kanalizime Fier të merren masa për verifikimin e zbatimit të urdhrave të lëshuar dhe të mos miratohen specifikimet teknike në mungesë të nënshkrimit të të gjithë anëtarëve të komisionit.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKF SHA janë marrë masat e nevojshme për verifikimin e zbatimit të urdhrave të lëshuar dhe mos miratimin e specifikimeve teknike në mungesë të nënshkrimit nga të gjithë anëtarët e komisionit.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet si *I pranuar* dhe *I zbatuar*. Verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**3. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën me objekt “Shpim pusi dublant nr. 3 B Kafaraj”, janë vendosur kriteret e paargumentuara teknikisht dhe ligjërish. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, Neni 2, “Parimet e përzgjedhjes”, Neni 20, “Mos diskriminim”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, Neni 27, “Kontratat e mallrave”, Neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” si dhe Rregulloren e UK Fier SHA. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 42 të Raportit të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:** Nga ana e UK Fier SHA të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kriterëve në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencës dhe ekonomikitet.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKF SHA janë marrë masat e nevojshme për vendosjen në procedurat e prokurimit të kriterëve në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencës dhe ekonomikitet.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*. Verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**4. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën me objekt “Shpim pusi dublant nr. 3 B Kafaraj”, rezulton se gjatë vlerësimit të ofertave është kualifikuar OE A.K.M edhe pse nuk përmbushen dy prej kriterëve. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, Neni 46, “Kualifikimi i Ofertuesve”, Neni 53, “Shqyrtimi i Ofertave”, Pika

3 Pika 5, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, Neni 66, “Kualifikimi i ofertuesve” si dhe Rregulloren e UKF SHA. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 42 të Raportit të Auditimit).

**4.1 Rekomandimi:** Nga ana e UK Fier SHA të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencës dhe ekonomicitet.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKF SHA janë marrë masat e nevojshme për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencës dhe ekonomicitet.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*. Verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**5. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje karburant Gazoil D1 dhe Benzinë”, në vitin 2020 u konstatua se në hartimin e specifikimeve teknike të përcaktuara në DST, vendosja e tyre nuk ishte bazuar në kuadrin ligjor përkatës. Pika 2.3.2, e specifikimeve teknike, për licencat që duhet të disponojë OE si vijon: “*Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje tregtimi ose licencë tregtimi me shumice të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj ose autorizim për tregtim karburantesh të llojit III/A (Gazoil, Diesel 10ppm) dhe II/A (Benzine 95 Oktan) në përputhje me Ligjin Nr. 8450 dt. 24.02.1999 « Për përpunimin, transportin dhe tregtimin të gazoil D1, benzinës, gazit dhe nënprodukteve të tyre » (me ndryshimet përkatëse) sipas standardeve të miratuara konform ligjit.*”, nuk pasqyron ligjin e sipërcituar dhe VKM-në përkatëse.

-Kjo kërkesë është e pasaktë pasi, nuk shpjegon qartë se cilën leje ose licencë duhet të paraqitet nga OE pjesëmarrës, duke sjellë konfuzion dhe paqartësi dhe në procesin e vlerësimit nga KVO. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, i ndryshuar me ligjin nr. 9218, datë 08.04.2004, ligjin nr. 9574, datë 03.07.2006, ligjin nr. 9595, datë 27.07.2006, ligjin nr. 83/2013, ligjin nr. 10137, datë 11.05.2009, ligjin nr. 12/2013, ligjin nr. 71/2014, Kreu III, leja e koncesionit, licenca e tregtimit, licenca dhe procedura e dhënies së tyre, Neni 20, Licencat. Në Vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pjesa II, sqarohet: “*Procedura për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë. Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për prokurimin publik”.*”

-Në procesin e prokurimit ka marrë pjesë vetëm një operator ekonomik, G.C GKG SHPK. Nga shqyrtimi i dokumenteve të dorëzuara në sistemin e prokurimit publik, rezultoi se OE nuk ka paraqitur Licencën “Për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrat lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë”. Nga verifikimet e kryera në QKB, për licencat përkatëse, OE zotëron për rrethin e Shkodrës, licencën e lëshuar nga Bashkia Shkodër, për tregtimin për përdorim nga konsumatorët fundorë.

Në nenin nr. 46, të ligjit të LPP, kërkohet për kualifikimin që OE të zotërojë licencat profesionale, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, si dhe aftësitë teknike duke pasur pajisjet dhe asetet fizike për veprimtaritë e kërkuara për të cilat do të lidhet kontrata.

Më datë 09.06.2020, përfaqësuesi i OE, ka deklaruar se i përmbush të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe se e vërtetojnë këtë me certifikata e dokumente, të dorëzuar bashkë me deklaratën.

Komisioni i vlerësimit të ofertave jo vetëm nuk duhet ta kualifikonte si fitues, por të kërkonte në Agjencinë e Prokurimit Publik për përjashtimin e kontraktorit nga pjesëmarrja në prokurimet publike, në mbështetje të nenit 13, pika 3/a të LPP-së. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 53, pika 3 i LPP. Gjithashtu, në kërkesat për kualifikim parashikohet se, mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri për kualifikim, rasti i mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s'kualifikim. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet 42 të Raportit të Auditimit).*

**5.1 Rekomandimi:**-Nga ana e UKF SHA të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kriterëve në raport me nevojat e investimit si dhe për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencës dhe ekonomikitet.

-Autoriteti Kontraktor të marrë masa për të kërkuar në Agjencinë e Prokurimit Publik për përjashtimin e OE G.C GKG SHPK, nga pjesëmarrja në prokurimet publike, në mbështetje të nenit 13, pika 3/a të LPP-së.

*Në vijimësi*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKF SHA janë marrë masat e nevojshme për vendosjen në procedurat e prokurimit të kriterëve në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencës dhe ekonomikitet. Nga ana e UKF SHA janë marrë masat e nevojshme për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencës dhe ekonomikitet. Nga ana e Titullarit të AK janë marrë masat për ti kërkuar APP dhënien e masave administrative 3 OE sipas atyre të rekomanduara.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht shkresës me nr. 1534 prot., datë 24.10.2022 UKF SHA ka bërë kërkesë në APP për përjashtimin e OE G.C GKG, me shkresën me nr. 1535 prot., datë 24.10.2022 UKF SHA ka bërë kërkesë në APP për përjashtimin e OE F.G dhe me shkresën me nr. 1536 prot., datë 24.10.2022 UKF SHA ka bërë kërkesë në APP për përjashtimin e OE A.C. Nga ana e APP është kthyer përgjigje përkatësisht për cdo rast si më sipër sipas shkresave të administruara në UKF SHA me nr. 544 prot., datë 26.01.2023 (OE G.C GKG), shkresa me nr. 634 prot.. datë 06.02.2023 (A.C) dhe shkresa me nr. 635 prot., datë 06.02.2023 (OE F.G), sipas të cilës nuk është disponuar dokumentacion i mjaftueshëm provues për nisjen e procedimit administrativ. Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *I pranuar dhe I zbatuar.*

**6. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën me objekt *“Shërbim printim faturash”* 2021, nga auditimi i DST u konstatua se janë vendosur kriteret të paargumentuara teknikisht dhe ligjërisht. Konkretisht është kërkuar Certifikata ISO 27001: 2013“Për Sigurinë e Informacionit”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar në Republikën e Shqipërisë për këtë qëllim, si dhe Certifikata 9001:2015 “Për Menaxhimin e Cilësisë”.

Kriteret e mëposhtme janë jo të justifikuar dhe të argumentuara pasi ruajtja e mbrojtja e të dhënave përfshihet në certifikatën ISO 27001:2013, “Për sigurinë e informacionit”.

Në pikat si vijon kërkohet: 2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë të gjitha masat mbrojtëse për mbrojtjen e fileve nga humbja, vjedhja apo aksesit i paautorizuar. Për këtë duhet të dorëzojë një dokument mbështetës (me fatura blerje, nr. serial përkatës ose deklarata zhdoganimit) i cili vërteton disponueshmërinë e mjeteve të mësipërme. (Ky kriter kupton transferim e fileve nga vendi i prodhimit pranë AK me sukses që do të thotë: shmangien e humbjes, vjedhjes apo aksesit të paautorizuar (bakërimi)). Operatorët ekonomik për të vërtetuar se disponojnë masa mbrojtëse për të mbrojtur të dhënat nga bakërimi duhet të disponojnë të paktën një nga programet e mëposhtme: 1. Antivirus; 2. Firewall; 3. Detektor Lëvizje; 4. Enkriptim file. Disponimi nga ana e operatorit ekonomik i të paktën një prej programeve të mësipërme duhet të vërtetohet me fatura blerje, nr. serial përkatës ose deklarata zhdoganimit. Operatori ekonomik duhet të ketë sistem softuer (sisteme operative dhe aplikacione) + hardware për përpunimin e të dhënave dhe krijimin e fileve për print. Të gjitha këto vërtetuar me fatura blerje ose deklarata zhdoganimit (operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin për të vërtetuar ambientin ku do të mbahen pajisjet që do të bëjnë përpunimin e të dhënave nëpërmjet sistemeve softuer dhe harduer si dhe ky ambient të jetë i survejuar me kamera 24 h/24h, dhe të vendosen në dispozicion fotografi të ambientit ku do të kryhet procesi i punës.)

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 1, "Objekti dhe qëllimi", Neni 2, "Parimet e përzgjedhjes", Neni 20, "Mos diskriminim", VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ndryshuar, Neni 27, "Kontratat e mallrave", Neni 61, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" si dhe Rregulloren e UKF SHA. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 42 të Raportit të Auditimit).

**6.1 Rekomandimi:** Nga ana e UK Fier SHA të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e shërbimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencës dhe ekonomikitet.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: I pranuar

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKF SHA janë marrë masat e nevojshme për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencës dhe ekonomikitet.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*. Verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**7. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën me objekt "Blerje elektropompa, panele elektrike, aksesore", 2020, nga auditimi i procesit të vlerësimit të ofertave u konstatua se KVO, ka s'kualifikuar OE K.C SHPK, me ofertë 3,720,000 lekë e cila ishte oferta më e ulët ekonomike dhe ka shpallur fitues OE V. SHPK me ofertë 3,795,450 lekë. OE i s'kualifikuar ka ankimuar vendimin e KVO dhe Komisioni i Prokurimit Publik, me Vendimin 304/2020, datë 23.07.2020, e ka anuluar vendimin e KVO-së dhe ka pranuar ankesën e OE. Me shkresën nr. 647 Prot., datë 27.08.2020, KVO i ka kërkuar OE K.C SHPK, shpjegime pasi oferta ekonomike ishte anomalisht e ulët. Në përgjigjen e dhënë nga OE, është dokumentuar se përpara se të jepet oferta, çmimet janë ofertuar tek prodhuesit apo tek distributorët e shumicës, duke pasur shpenzime për procedurën 2,914,431 lekë dhe normë fitimi prej 27,6 %, bashkëlidhur me ofertat e prodhuesit, si dhe fletë dogane të importeve të mëparshme për artikuj të njëjtë. KVO pas shqyrtimit të ankesës së dokumentacionit të sjellë nga OE K.C, datë 28.08.2020,

mbi ofertën ekonomike anomalisht të ulët, e konsideroi se nuk justifikon uljen e çmimeve dhe në veçanti për produktin Rregullator tensioni, duke cenuar cilësinë. Për këto arsye vendosi të s'kualifikojë OE K.C SHPK dhe me vendimin nr. 791/2 Prot., datë 04.09.2020, të shpallë fitues OE V. SHPK. OE K.C SHPK, ka ankimuar vendimin e KVO me shkresën nr. 692 09.09.2020, Me urdhrin nr. 807/1 Prot., datë 11.09.2020, titullari i AK, ka ngritur Komisionin Shqyrtimit të Ankesës, i cili e ka skualifikuar përsëri. Në mbledhjen e datës 23.10.2020, Komisioni i Prokurimit Publik, ka shqyrtuar ankesën e bërë rishtazi nga OE K.C SHPK, dhe me Vendimin nr. 475/2020, ka vendosur kualifikimin e këtij operatori ekonomik. Më datë 29.10.2020, me Urdhrin nr. 990/1, titullari i AK, ka urdhëruar heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit dhe kualifikimin e OE K.C SHPK.

-Siç vërehet nga zhvillimi i procedurës, përfundimi i saj është zgjatur deri në fund të vitit, duke rënduar në përmirësimin e situatës teknike të UK Fier SHA. Një ndër arsyet kryesore të zgjatjes ka qenë dhe paraqitja e ofertës ekonomike të një OE si anomalisht e ulët.

Duke shqyrtuar procesin e përcaktimit të fondit limit, dhe zgjedhjen me testimin e tregut, nga njësia e prokurimit, konstatohet se ky proces paraqet problematikat si mos paraqitje reale e çmimeve të tregut, ulje ose ngritje të çmimeve të produkteve që nuk janë të besueshme pasi lëvizin nga 3-20 herë më shumë, dhe që reflektohet në vlerësimin e ofertave kur një ofertë reale e tregut, e vërtetë trajtohet si anomalisht e ulët, duke vonuar përfundimin e procedurës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 42 të Raportit të Auditimit).*

**7.1 Rekomandimi:** Nga ana e UK Fier SHA të merren masa për kryerjen e procesit të testimit të tregut, me përgjegjshmëri dhe objektivitet, duke përdorur të gjitha alternativat e mundshme me qëllim përlllogaritjen e fondit limit në mënyrë reale e të saktë duke mundësuar përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencës dhe ekonomikitet.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e grupeve të punës janë marrë masa për të kryer teste të cmimeve referuar INSTAT OE që operojnë në tregun përkatës.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*. Verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**8. Gjetje nga auditimi:** UKF SHA ushtron aktivitetin në njësitë administrative: Qendër, Cakran, Dermenas, Levan, Mbrostar, Libofshë, Portëz, Frakull, Topojë si dhe në qytetin e Fierit. Shoqëria për ofrimin e shërbimeve në qytet apo në njësitë administrative ka në dispozicion 23 mjete në total të tipeve autovetura, skrepa, bote uji dhe kamionçina. Shpërndarja e karburantit për mjetet e Shoqërisë, kryhet ditore bazuar në kërkesat e përgjegjësve të sektorëve të cilat miratohen nga përgjegjësi i ofiçinës. Tërheqja e karburantit kryhet nëpërmjet kartave elektronike së bashku me fletë-daljen përkatëse nga magazina. Normativat për konsumin e karburantit për mjetet e Shoqërisë të cilat janë aplikuar për vitet 2019-2021, janë të miratuara nga Administratorit të Shoqërisë me shkresën nr. 98 prot., datë 30.01.2019, dhe shkresën nr. 191/1 prot., datë 28.02.2020.

-Janë audituar me zgjedhje shpenzimet mbi konsumin e karburantit për 8 automjete ku konstatohet se: Për këto mjete nuk janë mbajtur kartelat përkatëse në të cilat të regjistrohen të gjitha të dhënat e automjetit si dhe shpenzimet që do të kryhen për to gjithashtu duhet të jetë e evidentuar kilometrazhi i tyre në fillim të vitit dhe fund vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra, karburant, riparime etj. Këto shpenzime nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, për mirëmbajtje dhe shfrytëzimin e tyre.



Shpenzimet për konsumin e karburantit mbahen në dosjen e mjetit nga drejtuesi i automjetit ku pjesë përbërëse e dosjes janë edhe urdhri për përdorimin e mjetit, siguracioni vjetor, leje qarkullimi, kolaudimi kontrolli teknik (për të mjetet ndodhet kolaudimi i vitit 2021), kërkesa dhe autorizimi për lëvizjen e mjetit, fletë-dalja nga magazina e karburantit, fletë-udhëtimet.

Nisja e procesit të tërheqjes së karburantit fillon me kërkesës ditore e cila vjen nga sektorët përkatës për lëvizjen e mjetit. Kjo kërkesë miratohet nga përgjegjësi i ofiçinës. Më pas me fletë-daljen respektive bëhet dalja nga magazina. Si dokumentacion justifikues në dosjen e cila mbahet nga drejtuesi i mjetit ndodhet edhe fletë-udhëtimi nënshkruar nga drejtuesi i mjetit i cili konfirmon lëvizjen e mjetit e nënshkruar nga përgjegjësi i ofiçinës. Gjithashtu në fletët e udhëtimit janë vendosur në total kilometrat e përshkruara dhe jo sa ka qenë kilometrazhi në fillim të lëvizjes dhe sa ka qenë në fund të lëvizjes për secilën urdhër shërbimi. Gjithashtu nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, për 4 automjete kilometrazhi i tyre nuk është në gjendje pune, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 07.08.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 19. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 29, të Raportit të Auditimit*).

**8.1. Rekomandimi:** Nga Drejtoria Tregtare dhe Dega Teknikë të hartohen kartelat përkatëse të automjeteve, ku të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet e automjeteve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e Drejtorisë Tregtare dhe Degës Teknikë janë marrë masat për hartimin e kartelave me të dhënat e nevojshme sipas rekomandimit.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se UKF SHA, Drejtoria Tregtare dhe Dega Teknikë kanë hapur libër shërbimesh dhe kartelën përkatëse (AA...G). Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet si *I pranuar* dhe *I zbatuar*. Verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**8.2. Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë dhe Dega Teknikë të merren masa që të kryhet riparimi i automjeteve në të cilat janë konstatuar defekte në aparatën e kilometrazhit, me qëllim kryerjen e rakordimeve ndërmjet kilometrave të paraqitura në fletët e udhëtimeve dhe lëvizjes faktike që kanë kryer mjetet.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:**

**Komenti i audituesve:** Në lidhje me këtë rekomandim nuk u vu në dispozicion asnjë dokumentacion. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* por *I pazbatuar*.

**9. Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2019, për 18 objekte prokurimi me fond limit në shumën 11,620,000 lekë pa TVSH janë realizuar 27 procedura prokurimi me vlera të vogla në shumën 8,779,369 lekë pa TVSH. Janë audituar me zgjedhje 10 procedura prokurimi me vlera të vogla në shumën 4,017,534 lekë pa TVSH ose në masën 45.7%.

Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të procedurave të prokurimit me vlera të vogla konstatohet se:

-Janë kryer 7 procedura prokurimi me vlera të vogla duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat normale të prokurimit në shumën totale të fondit limit 3,960,000 lekë pa TVSH, pra këto procedura duhet të kryheshin me tenderin konkretisht:

a) Procedura me objekt *materiale kancelari* e zhvilluar duke e ndarë në dy procedura të tjera me të njëjtin objekt prokurimi konkretisht, “Blerje bojëra printeri për faturim (fillim viti)” me fond limit në shumën 500,000 lekë pa TVSH, dhe “Blerje tonera, kancelari dhe letër” me fond limit në shumën 800,000 lekë pa TVSH ku fondi limit total shkon në shumën 1,300,000 lekë pa TVSH.

b) Procedura me objekt *pajisje për analizat e ujit* e zhvilluar duke e ndarë në dy procedura të tjera me të njëjtin objekt prokurimi konkretisht, “Blerje laborator analizash uji” (*e cila përmban si objekt në mënyrë të detajuar pajisje laboratorike, optike dhe precizoni përjashtuar syzet*) me fond limit në shumën 800,000 lekë pa TVSH, dhe “Blerje reagente dhe materiale për analizat e ujit” me fond limit në shumën 140,000 lekë pa TVSH ku fondi limit total shkon në shumën 940,000 lekë pa TVSH.

c) Procedura me objekt *pjesë këmbimi për autoveturat* e zhvilluar duke e ndarë në tre procedura të tjera me të njëjtin objekt prokurimi konkretisht, “Blerje pjesë këmbimi për autovetura të ndryshme” me fond limit në shumën 800,000 lekë pa TVSH, “Blerje shërbimi riparim gomash dhe balancim disqesh” me fond limit në shumën 120,000 lekë pa TVSH dhe “Shërbime për makineri të rënda” (*e cila përmban si objekt shërbime riparimi për kamionë, shërbime riparimi dhe mirëmbajtje e vinçave*) me fond limit në shumën 800,000 lekë pa TVSH ku fondi limit total shkon në shumën 1,720,000 lekë pa TVSH;

-Në 3 raste nga anëtarët e komisionit për procedurat me vlera të vogla nuk është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit;

-Në 10 raste fatura tatimore nuk është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit;

-Në 1 rast likuidimi i faturës tatimore nuk është kryer brenda afateve të parashikuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, germa “c” dhe “i”;

-Në 1 rast nuk është argumentuar dhe dokumentuar përllogaritja e fondit limit;

-Në 6 raste dosja e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël nuk është e inventarizuar dhe arkivuar;

-Në 6 raste në kontratat e nënshkruara midis UKF SHA dhe Operatorëve Ekonomikë, nuk janë parashikuar penaltetet në rast se nga OE nuk dorëzohet mallrat ose shërbimi brenda afateve të përcaktuara në këto kontrata, veprime këto në kundërshtim me Norma Teknike Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 3 dhe neni 9, të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 40, pika 1, 3 dhe 8, neni 59, neni 64, pika 2, dhe Udhëzimi nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” i ndryshuar, pika 19. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 42, të Raportit të Auditimit*).

**9.1 Rekomandimi:** Nga Administratori, Zyra Juridike dhe Drejtoria Tregtare të marren masa që:

-Në hartimin e regjistrave të parashikimeve të prokurimeve, shmangien e copëzimit të fondeve, për të njëjtin grup mallrash apo shërbimesh.

-Për çdo procedurë të hartohen deklaratat e konfliktit të interesit si dhe të argumentohet përllogaritja e fondit limit.

-Për çdo rast faturat tatimore të nënshkruhen sipas përcaktimeve ligjore, gjithashtu likuidimi i faturave tatimore për procedurat me vlera të vogla të kryhen brenda afateve të parashikuara në dispozitat ligjore duke shmangur krijimin e detyrimeve kontraktuale.

-Në çdo kontratë të cilat lidhen referuar procedurave me vlera të vogla, të parashikohet edhe klauzolat e penalteteve si dhe të gjitha aktet e hartuara në lidhje me procedurat e prokurimit, të kalojnë përmes arkivës së institucionit, me qëllim evidentimin e rrjedhshmërisë së veprimeve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKF SHA janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*. Verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**10. Gjetje nga auditimi:** Niveli i pagave i aplikuar për vitet 2019-2021 nga UKF SHA nuk është miratuar specifikisht nga Asambleja Aksionare (Bashkia Fier) por vetëm me Vendimin nr. 20, datë 03.10.2016, të Këshillit të Administrimit protokolluar në UKF SHA me nr. 946/1 prot., datë 05.10.2016. Organet drejtuese të Shoqërisë, Këshilli i Administrimit dhe Administratori e kanë quajtur të ezauruar miratimin e nivelit të pagave vetëm me miratimin e programit ekonomik ku pjesë e tij është edhe fondi i pagave. Në opinionin e grupit të auditimit ka keq interpretim nga organet drejtuese të Shoqërisë të Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve” i ndryshuar, neni 6, pika 1. Gjithashtu duke u bazuar nivelit të pagave të aplikuara për vitet 2019-2021 konstatohet se, për të njëjtin pozicion pune punonjësit nuk janë trajtuar me të njëjtin nivel page konkretisht, për kategorinë Specialist të Drejtorive apo Zyrave trajtohen me nivele të ndryshme pagash ku variojnë nga 34,000 lekë deri në 50,000 lekë për pagë bazë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 22, të Raportit të Auditimit)*.

**10.1 Rekomandimi:** Nga Administratori dhe Këshilli i Administrimit në të ardhmen të merren masat e duhura për miratimin e nivelit të pagave nga Asambleja Aksionare (Bashkia Fier), duke zbatuar në këtë mënyrë detyrimet ligjore dhe statusore në mirë-organizimin dhe mirëfunksionimin e Shoqërisë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKF SHA janë marrë masat e nevojshme për miratimin e pagave në mënyrë specifike nga KA dhe Aksionari.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht Vendimit të KA me nr. 3/4 datë 15.12.2022 është bërë miratimi i nivelit të pagave. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *I zbatuar*.

**10.2 Rekomandimi:** Nga Administratori dhe Këshilli Administrimit të merren masat për të hartuar dhe miratuar sipas kompetencave statusore një rregullore, ku të parashikohen kriteret e caktimit të pagës brenda limit të miratuar për pozicionet e punës për kategorinë specialist të drejtorive dhe zyrave të Shoqërisë.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Rregullore e re e UKF SHA është miratuar vetëm me Vendim të KA.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht Vendimit të KA me nr. 3/4 datë 15.12.2022 është bërë miratimi i nivelit të pagave por ky Vendim nuk është miratuar nga AP. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *I pazbatuar*.

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, u konstatuan mangësi dhe parregullsi jo thelbësore në procedurat e përzgjedhura.

-Parregullsitë e konstatuara janë si më poshtë: Në 2 raste nga anëtarët e komisionit për procedurat me vlera të vogla nuk është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 64, pika 2, ku shprehet se: Në momentin e hapjes së ofertave, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave nënshkruajnë një deklaratë përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës.

-Në 6 fatura tatimore nuk është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” i ndryshuar, pika 19, ku shprehet se: Pagesa për prokurimet me vlerë të vogël bëhet sipas legjislacionit tatimor në fuqi. Në çdo rast, faturat e mallrave apo të shërbimeve duhet të jenë të rregullta sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të nënshkruhen nga anëtarët e komisionit. Faturat e lëshuara kanë vlerën e kontratës së lidhur, kur palët nuk kanë nënshkruar një të tillë. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 18, të Raportit të Auditimit*).

**11.1 Rekomandimi:** Nga Administratori dhe Këshilli Administrimit të merren masat për të trajnuar personelin e ngarkuar për procedurat e prokurimit, që të kryejë detyrat e ngarkuara me profesionalizëm dhe përgjegjshmëri.

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKF SHA janë marrë masat e nevojshme për trajnimin e personelit.

**Komenti i audituesve:** Sipas deklaratave të bëra nga ana e stafit të UKF SHA janë bërë trajnime online me qëllim rritjen e profesionalizmit në drejtim të realizimit të procedurave të PP. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*. Verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga krahasimi i shpenzimeve të personelit të planifikuara dhe të realizuara për vitet 2019-2021 rezulton se:

**Për vitin 2019:** Në programin ekonomik me ndryshime për llogarinë 600 “Paga personeli” është planifikuar në shumën 176,480,000 lekë dhe realizuar në shumën 159,108,856 lekë me një diferencë mosrealizimi në shumën 17,371,144 lekë ose realizuar në masën 90.1%. Ndërsa për llogarinë 601 “Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore” është planifikuar në shumën 29,472,000 lekë dhe realizuar në shumën 23,898,694 lekë me një diferencë mosrealizimi në shumën 5,573,306 lekë ose realizuar në masën 81%.

**Për vitin 2020:** Në programin ekonomik me ndryshime për llogarinë 600 “Paga personeli” është planifikuar në shumën 167,000,000 lekë dhe realizuar në shumën 154,171,247 lekë me një diferencë mosrealizimi në shumën 12,828,753 lekë ose realizuar në masën 92.3%. Ndërsa për llogarinë 601 “Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore” është planifikuar në shumën 26,640,000 lekë dhe realizuar në shumën 23,139,074 lekë me një diferencë mosrealizimi në shumën 3,500,926 lekë ose realizuar në masën 86.8%.

**Për vitin 2021:** Në programin ekonomik me ndryshime për llogarinë 600 “Paga personeli” është planifikuar në shumën 175,310,000 lekë dhe realizuar në shumën 151,509,871 lekë me një diferencë mosrealizimi në shumën 23,800,129 lekë ose realizuar në masën 86.4%. Ndërsa për llogarinë 601 “Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore” është planifikuar në shumën

29,380,000 lekë dhe realizuar në shumën 22,753,544 lekë me një diferencë mosrealizimi në shumën 6,626,456 lekë ose realizuar në masën 77.4%.

Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura më sipër edhe pse numri i punonjësve nga viti në vit thuhet nuk ndryshon në total, për vitet 2019-2021 për llogarinë 600 “Paga personeli” dhe 601 “Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore” në programet ekonomike të ri-alokuara është miratuar shuma 604,282,000 lekë dhe realizuar në shumën 534,581,286 lekë me një diferencë mosrealizimi në shumën 69,700,714 lekë ose realizuar në masën 88.4%. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 22, të Raportit të Auditimit).*

**12.1 Rekomandimi:** Drejtoria Tregtare dhe Zyra e Burimeve Njerëzore të marrë masa që në të ardhmen gjatë hartimit të programit ekonomik vjetor, llogaritja e shpenzimeve për personelin t’i referohet të dhënave faktike të Shoqërisë për numrin dhe shpenzimet konkrete të personelit.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga muaji Dhjetor 2022 deri aktualisht, UKF SHA ka qenë me më pak të punësuar se sa ka parashikuar struktura përkatëse e miratuar.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht bordrove dhe strukturave të miratuara për dhjetor 2022 dhe gusht 2023, rezulton se numri i punonjësve (314, 593) është më i ulët nga numri i parashikuar në strukturë (328, 643). Nisur nga sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*. Verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**13. Gjetje nga auditimi:** Në strukturat organizative të UKF SHA të aplikuara për vitet 2019-2021 të miratuar respektivisht me Vendimin nr. 5, datë 03.10.2016, me numër 390 punonjës, me Vendimin nr. 5, datë 03.10.2019, me numër 360 punonjës dhe me shkresën nr. 1053/3 prot., datë 07.05.2021, me numër 329 punonjës nga Asambleja Aksionare nuk është e përfshirë Njësia e Auditimit të Brendshëm, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 3, germa “a” dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 1, germa “b”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 22, të Raportit të Auditimit).*

**13.1 Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë dhe Këshilli i Administrimit të merren masa për përfshirjen e Njesisë së Auditimit të Brendshëm brenda strukturës organizative të Shoqërisë.

*Menjherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga muaji Janar 2023 deri aktualisht, UKF SHA ka në strukturën e re Njësinë e Auditit të Brendshëm.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht bordrove dhe strukturave të miratuara për gusht 2023, rezulton se në pagesat e kryera janë edhe strukturën përkatëse janë përfshirë edhe punonjësit e Njesisë së AB. Nisur nga sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *I zbatuar*.

**14. Gjetje nga auditimi:** Me shkresën nr. 966 prot., datë 10.10.2019, të Administratorit të Shoqërisë P.N është ngritur komisioni për ristrukturimin e UKF SHA i përbërë nga P.H, E.S, L.R, E.Gj dhe A.Gj. Ristrukturimi ka të bëjë me pozicionet e punës inspektor Task Forcë dhe Arkëtarë në pikat e arkëtimit në qytet. Me shkresën nr. 643 prot., datë 14.10.2019, të Administratorit të Shoqërisë P.N është bërë ftesë për bashkëpunim drejtuar Sindikatës së Ndërtimit Drurit dhe Shërbimeve Publike dhe për dijëni të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Me shkresën

nr. 984 prot., datë 15.10.2019, është mbajtur procesverbali mbi diskutimin e pushimit kolektiv ndërmjet komisionit, administratorit dhe përfaqësuesit të Sindikatës. Me shkresën nr. 988 prot., datë 16.10.2019, të Komisionit të Ristrukturimit është kryer njoftimi për pushimin kolektiv dhe njoftimin e ndërprerjen e marrëdhënieve të punës si pasojë e ristrukturimit të UKF SHA për 28 punonjës. Me shkresën nr. 650 prot., datë 17.10.2019, Administratori i Shoqërisë i ka dhënë informacion mbi këtë situatë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Me shkresën nr. 4928/2 prot., datë 20.11.2019, të MSHBS protokolluar në UKF SHA me nr. 728 prot., datë 21.11.2019, ku në të citohet se: “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka në fushën e saj të përgjegjësisë bashkëbisedimet për procedurat e pushimit kolektiv nga puna”. Me shkresën 1018 prot., datë 21.10.2019, të Administratorit të Shoqërisë P.N është kryer njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të ristrukturimit të Shoqërisë për 28 punonjës. Gjithashtu janë për këta punonjës është kryer njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të ristrukturimit të Shoqërisë. Me shkresën nr. 30 prot., datë 26.11.2019, protokolluar në UKF SHA me nr. 738/2 prot., datë 26.11.2019, dhe vendimin e Këshillit të Administrimit të nënshkruar nga F.M Kryetar dhe E.P, P.N anëtarë janë përcaktuar kriteret për marrjen në punë për Specialistët e Task Forcës në UKF SHA. Pas përfundimit të procedurës së pushimit kolektiv komisioni i ristrukturimit ka nisur procedurën e rekrutimit për punonjësit e Sektorit të Task Forcës si dhe të arkëtarëve të pikave të arkëtimit në qytet. Për rekrutimin e punonjësve të Sektorit të Task Forcës janë aplikuar kriteret e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Administrimit sipas shkresës nr. 30 prot., datë 26.11.2019. Në përfundim të vlerësimit nga Komisioni i Ristrukturimit 12 punonjës u rimorën në punë pasi plotësonin kriteret e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Administrimit. Ndërsa 9 punonjës për arsye të kriterit moshë (Moshë ≤ 50 vjeç) nuk janë përzgjedhur pjesë e strukturës së re. Mos rekrutimi i punonjësve si pasojë e pushimit kolektiv bazuar në kriterin moshë (Moshë ≤ 50 vjeç) konsiderohet nga grupi i auditimit si diskriminues dhe jo një veprim i barabartë i cili bie ndesh me Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Nga 9 punonjësit e larguar 1 punonjës u rimor në punë në një pozicion tjetër ndërsa 3 punonjës kanë hapur proces gjyqësor. Për pozicionin e arkëtarëve 6 pozicione, numri në strukturën e re u reduktua në 4 pozicione por duke qenë se brenda strukturës së re kishte vende vakante pune në pozicione të ngjashme u rimorën të 6 punonjësit në punë, veprime këto në kundërshtim Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, kontrata kolektive dhe kontrata individuale e punës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 22, të Raportit të Auditimit).

**14.1 Rekomandimi:** Nga Administratori dhe Këshilli i Administrimit në të ardhmen në rast se do të ketë pushime kolektive si pasojë e ristrukturimit të Shoqërisë, të vendosë kritere duke u bazuar në dispozitat ligjore përkatëse për emërimet apo për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj në lidhje me këtë proces me qëllim shmangien e hapjes së proceseve gjyqësore të cilat mund të sjellin pasojë financiare me ndikim negativ për buxhetin e vetë institucionit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Me reformimin e shoqërisë UKF nuk ka patur pushime kolektive.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**15. Gjetje nga auditimi:** Për vitet 2019-2021 konstatohet se, mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të rregullave të parashikuara në Statut ose Rregullore të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, “Politikat dhe Praktikrat që lidhen me Burimet Njerëzore, Kapitulli II. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 22, të Raportit të Auditimit).

**15.1 Rekomandimi:** Nga organet drejtuese të Shoqërisë të hartohen rregulla të shkruara lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja si dhe për transferimet dhe ngritjen në detyrë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Me reformimin e shoqërisë UKF ka miratuar në Këshilli i Administrimit ka miratuar Rregulloren e Përcaktimit të Kritereve të punësimit në Shoqëri Rajonale UKF SHA.

**Komenti i audituesve:** Refruar dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht shkresës me nr. 729/3 prot., datë 24.02.2023 Këshilli i Administrimit ka miratuar Rregulloren e Përcaktimit të Kritereve të punësimit në Shoqëri Rajonale UKF SHA. Nisur nga sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar dhe I zbatuar*.

**16. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi konstatohet se, kanë dalë në pension pleqërie 38 punonjës nga të cilët 1 prej tyre është shpërblyer me një pagë bruto në shumën 44,000 lekë dhe 7 punonjës janë shpërblyer me një pagë bruto në shumën 33,000 lekë secili ndërsa 30 punonjës nuk e kanë përfituar këtë shpërblyer, veprime këto në kundërshtim VKM nr. 838, datë 21.10.2010, “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” i ndryshuar, neni 7. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 22, të Raportit të Auditimit).

**16.1 Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë, Drejtoria Tregtare dhe Zyra e Burimeve Njerëzore të merren masa në të ardhmen për çdo punonjës i cili del në pension pleqërie të shpërblehet në masën e një page mujore referuar dispozitave ligjore përkatëse.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Për vitin 2022 nuk janë dhënë shpërblime për dalje në pension për shkak të daljes me humbje të bilancit financiar. Për vitin 2023 janë dhënë në total 4 shpërbime me një kuotë fikse prej 30,000 lekë.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar dhe I zbatuar*.

**17. Gjetje nga auditimi:** Duke u bazuar në rregulloret e brendshme e aplikuar për vitet 2019-2021, të miratuara respektivisht me shkresën nr. 189/1 prot., datë 01.03.2017, me shkresën nr. 28 prot., datë 11.10.2019, dhe nr. 1053/3 prot., datë 07.05.2021, të Këshillit të Administrimit konstatohet se, mbajtja e listë prezencës si detyrë nuk është e parashikuar në këto rregullore por ky proces ndiqet/zhvillohet nga Drejtoria Tregtare. Ndërkohë që referuar Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 69, ky proces duhet të kryhet nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe jo nga Drejtoria Tregtare. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 22, të Raportit të Auditimit).

**17.1 Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për adresimin konkret si detyrë në rregulloren e brendshme procesin e mbajtjes së listë prezencës së punonjësve nga Zyra e Burimeve Njerëzore.

*Menjëherë*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Sipas shkresës me nr. 1283/2 prot., datë 23.09.2022 me Vendim të KA është bërë ndryshimi sipas rekomandimit të KLSH. Gjithashtu, në Rregulloren e re të miratuar pas reformimit të insitucionit, kjo përgjegjësi i ka kaluar DBN.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *I zbatuar*.

**18. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi konstatohet se janë punësuar 67 punonjës edhe para periudhës objekt auditimi me profesion pompist, elektropompist pa dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike” i ndryshuar, neni 9, pika 1, gërma “a”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 22, të Raportit të Auditimit).

**18.1 Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë dhe Dega Teknike të merren masa për pajisjen e punonjësve që punojnë në pozicionet e punës elektrikist me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik, për të parandaluar çdo ngjarje në dëm të shëndetit dhe jetës së tyre.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Në lidhje me këtë rekomandim UKF SHA ka marrë masat e nevojshme për certifikimin e stafit. Konkretisht rezulton se institucioni ka certifikuar punonjësit me pozicion elektrikist me dëshmitë përkatëse.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër si dhe referuar dokumentacionit të zhvilluar për procedurën përkatëse të blerjes, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *I zbatuar*.

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të personelit 50 të tilla konstatohet se, në të gjitha rastet dosjet e personelit nuk janë të inventarizuara, në të gjitha rastet nuk është kryer vlerësimi 6 mujor i punonjësve, në 7 raste diplomat e bachelor ose diplomën e nivelit të dytë nuk janë të noterizuara, në 3 raste mungon vërtetimi i banimit, në 4 raste mungon certifikata e aftësisë shëndetësore, në 5 raste mungon certifikata familjare. Gjithashtu u konstatua se në 20 raste në dosjet e personelit mungon dëshmia e penalitetit, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 117, datë 05.03.2014, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 22, të Raportit të Auditimit).

**19.1 Rekomandimi:** Nga Zyra e Burimeve Njerëzore të merren masat për kryerjen e vlerësimit gjashtë mujor për secilin punonjës të shoqërisë, noterizimin e diplomave të nivelit të parë dhe të dytë të cilat janë të pa noterizuara, plotësimin e dosjeve të cilat janë konstatuar mangësi me dokumentacionin si vërtetim banimi, certifikata të aftësisë shëndetësore, certifikata familjare si dhe inventarizimin e secilës dosje të personelit në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKF SHA janë marrë masat e nevojshme për azhurnimin dhe plotësimin e të dhënave të konstatuara me mangësi nga ana e KLSH.



**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër dhe nga natyra e tij, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*. Verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**19.2 Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë dhe Zyra e Burimeve Njerëzore të verifikohet dëshmia e penalitetit për punonjësit e rezultuar pa këtë dëshmi, dhe në rast se nuk paraqitet dëshmia e penalitetit prej tyre, të zbatohen procedurat administrative dhe ligjore për zgjidhjen e kontratës së punësimit.

*Menjëherë*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKF SHA janë marrë masat e nevojshme për azhurnimin dhe plotësimin e të dhënave të konstatuara me mangësi nga ana e KLSH.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër dhe nga natyra e tij, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*. Verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**20. Gjetje nga auditimi:** Për vitet 2019-2021, në projekt programet ekonomike nuk ka një relacion ku të jetë pasqyruar një analizë e detajuar për çdo llogari. Për hartimin e tyre Drejtoria Tregtare i referohet vetëm disa kërkesave të drejtuara nga drejtoritë apo zyrat e Shoqërisë. Në këto kërkesa nuk ka një relacion shpjegues dhe argumentues mbi sasinë e mallrave apo shpenzimeve. Gjithashtu programet ekonomiko-financiare janë hartuar në mënyrë që UKF SHA në fund të vitit ushtrimor do të jetë me fitim por duke u bazuar në realizimin e programeve konstatohet se Shoqëria ka dalë me humbje konkretisht për vitet 2019, 2020 dhe 2021, realizimi është me humbje respektivisht në vlerën 10,698 mijë lekë, në vlerën 7,583 mijë lekë dhe në vlerën 28,311 mijë lekë si më poshtë:

- Për vitin 2019, nga të ardhurat janë programuar në vlerën 1,256 mijë lekë ndërsa humbja është në shumën 10,698 mijë lekë me një diferencë nga planifikim në shumën 11,954 mijë lekë.

- Për vitin 2020, nga të ardhurat janë programuar në vlerën 1,052 mijë lekë ndërsa humbja është në shumën 7,583 mijë lekë me një diferencë nga planifikim në shumën 8,635 mijë lekë.

- Për vitin 2021, nga të ardhurat janë programuar në vlerën 723 mijë lekë ndërsa humbja është në shumën 28,312 mijë lekë me një diferencë nga planifikim në shumën 29,035 mijë lekë. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 19, të Raportit të Auditimit*).

**20.1 Rekomandimi:** Nga Drejtoria Tregtare të merren masa që, projekt programi ekonomik të bëhet referuar një analize sipas relacioneve shpjeguese dhe argumentuese, bazuar në nevojat reale të vitit të pritshëm ushtrimor dhe shmangien programimeve duke rritur bazën në një përqindje të caktuar. Gjatë vitit të angazhohen vetëm ato shpenzime të cilat janë planifikuar sipas llojit dhe të mos ndryshohet destinacioni i përdorimit të këtyre fondeve brenda artikujve të tjerë të programit.

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Pas reformimit të institucionit, Projekt Programi Ekonomik 5 vjeçar i UKF SHA është hartuar nga ana e AKUM dhe me asistencën e KfW i cili është miratuar më pas me Vendimin e Aksionarit MIE.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *I zbatuar*.

**20.2 Rekomandimi:** Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli Administrativ, të analizojnë shkaqet dhe faktorët që ndikojnë në humbjet e kësaj shoqërie, si dhe të marrin masat e nevojshme për të mundësuar drejtimin e shoqërisë, drejt rezultateve pozitive.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Pas reformimit të institucionit, Projekt Programi Ekonomik 5 vjeçar i UKF SHA është hartuar nga ana e AKUM dhe me asistencën e KfW i cili është miratuar më pas me Vendimin e Aksionarit MIE. Palët e mësipërme kanë kryer analizat e veta e në kushte të tilla mendojmë se ka qenë e panevojshme të kryhej një veprim i tillë nga KA dhe ish AP.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *I zbatuar*.

**21. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi UKF SHA nuk ka hartuar programe afatmesme dhe afatgjata, në përputhje me objektivat e caktuar nga organet drejtuese të saj. Shoqëria nuk ka hartuar plan 5-vjeçar për përmirësimin e performancës dhe plan të biznesit, në kuadër të Reformës Kombëtare të Sektorit Ujësjellës-Kanalizime përcaktuar në Udhëzuesin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, ku të përcaktohen: Deklarata e vizionit dhe misionit, përmbledhje për drejtuesit e lartë, qëllimet strategjike, analiza dhe parashikimi për menaxhimin e kërkesës për ujë, struktura organizative dhe personeli, programi për përmirësimin e performancës, programi pesëvjeçar për investimet kapitale, buxheti 5-vjeçar për operacionet mirëmbajtjen, nevoja për të ardhura dhe analiza e tarifave/strategjitë e çmimeve. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 19, të Raportit të Auditimit*).

**21.1 Rekomandimi:** Administratori i Shoqërisë të marrë masa për hartimin dhe miratimin e planit 5-vjeçar për përmirësimin e performancës dhe planit të biznesit, në kuadër të Reformës Kombëtare të Sektorit Ujësjellës-Kanalizime.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Pas reformimit të institucionit, Projekt Programi Ekonomik 5 vjeçar i UKF SHA është hartuar nga ana e AKUM dhe me asistencën e KfW i cili është miratuar më pas me Vendimin e Aksionarit MIE.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *I zbatuar*.

**22. Gjetje nga auditimi:** Në zbatim të VKM nr. 63, datë 27.01.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, Kreu I, pika 8, UKF SHA ka bërë raportim çdo tre muaj në lidhje me realizimin e programeve dhe treguesit e performancës mbi prodhimin dhe përqindjen e humbjes së ujit. Gjithashtu UKF SHA nuk ka zbatuar detyrimin e raportimit pranë Prefektit të Qarkut si dhe nuk ka zbatuar detyrimin për të raportuar për pjesën e saj të dhënave që duhet të hidhen në Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 19, të Raportit të Auditimit*).

**22.1 Rekomandimi:** Administratori i Shoqërisë të marrë masa për të raportuar çdo muaj për ecurinë e shoqërisë në lidhje me realizimin e programeve dhe treguesit e performancës mbi prodhimin dhe humbjen e ujit pranë Këshillit të Administrimit dhe çdo vit përpara Asamblesë së Përgjithshme, si dhe të raportojë pranë Prefektit të Qarkut dhe Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKF SHA janë marrë masat për të kryer raportimet përkatëse sipas rekomandimit të lënë nga KLSH.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e rradhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*. Verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e rradhës në këtë institucion.

**23. Gjetje nga auditimi:** UKF SHA nuk ka bërë bilancin e ujit (analiza e humbjeve teknike dhe ekonomike menaxheriale), nuk ka bërë një plan të detajuar për numrin e konsumatorëve që nuk janë të pajisur me matës, nuk ka bërë plotësisht evidentimin, klasifikimin dhe ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme të debitorëve dhe nga auditimi rezulton se shoqëria merr më shumë para nga konsumatorët sesa uji, që këta të fundit kanë konsumuar, pasi mesatarisht për tre vitet (2019, 2020 dhe 2021), 32.2 % e konsumatorëve nuk janë të pajisur me matës duke bërë që shitja e furnizimit me ujë të mos llogaritet në bazë të konsumit real vlerësuar nëpërmjet aparateve matëse. Shoqëria nuk ka bërë një plan të detajuar për numrin e konsumatorëve që nuk janë të pajisur me matës, duke përcaktuar afatin konkret të pajisjes së tyre 100 % me matës.

UKF SHA nuk ka kryer evidentimin, klasifikimin dhe ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme të debitorëve duke mos pasur dhe koordinim me sektorët përkatës.

Referuar të dhënave të Drejtorisë Tregtare, Drejtorisë Teknike të Shoqërisë UKF SHA merr më shumë para nga konsumatorët sesa uji, që këta të fundit kanë konsumuar, pasi të dhënat lidhur me prodhimin, faturimin dhe arkëtimin e ujit ndryshojnë në sasi dhe në vlerë:

-Për vitin 2019, nga 37,666 lidhje të ujit gjithsej, vetëm 24,326 janë të pajisur me ujëmatës, pra 35.4% e klientëve nuk janë të pajisur me ujëmatës dhe faturohen afrofe. Uji i faturuar në sistem është 11,911,506 m<sup>3</sup> ndërsa humbja është masën 6,402,306 m<sup>3</sup>.

-Për vitin 2020, nga 37,863 lidhje të ujit gjithsej, vetëm 25,231 janë të pajisur me ujëmatës, pra 33.4% e klientëve nuk janë të pajisur me ujëmatës dhe faturohen afrofe. Uji i faturuar në sistem është 14,033,180 m<sup>3</sup> ndërsa humbja është masën 6,402,306 m<sup>3</sup>.

-Për vitin 2021, nga 38,592 lidhje të ujit gjithsej, vetëm 27,829 janë të pajisur me ujëmatës, pra 27.9% e klientëve nuk janë të pajisur me ujë matës dhe faturohen afrofe. Uji i faturuar në sistem është 14,005,500 m<sup>3</sup> ndërsa humbja është masën 9,360,500 m<sup>3</sup>. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 19, të Raportit të Auditimit*).

**23.1 Rekomandimi:** Nga UK Fier SHA për vitin 2022, të bëhet bilanci i ujit, analiza e humbjeve teknike dhe ekonomike (menaxheriale). Në programin ekonomik të vitit pasardhës, humbjet të parashikohen të detajuara në humbje teknike dhe ekonomike (menaxheriale). UK Fier SHA të hartojë planin strategjik për zvogëlimin e humbjeve të ujit për periudhën 2022 e në vijimësi. Ky plan të përmbajë objektiva dhe masa konkrete që duhet të ndërmerren nga Shoqëria për eliminimin e humbjeve të ujit.

*Deri më datë 31.12.2022*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Informacioni i sipërcituar është nisur në AKUM me e-mail periodikisht. Pas reformimit të institucionit, Projekt Programi Ekonomik 5 vjeçar i UKF SHA është hartuar nga ana e AKUM dhe me asistencën e KfW i cili është miratuar më pas me Vendimin e Aksionarit MIE.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**23.2 Rekomandimi:** UK Fier SHA të bëjë një plan të detajuar për numrin e konsumatorëve që nuk janë të pajisur me matës, duke synuar që brenda vitit 2023, të bëhet pajisja 100 për qind e tyre.

*Deri më datë 31.12.2023*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Pas reformimit të institucionit, Projekt Programi Ekonomik 5 vjeçar i UKF SHA është hartuar nga ana e AKUM dhe me asistencën e KfW i cili është miratuar më pas me Vendimin e Aksionarit MIE.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar dhe Në proces zbatimi.*

**24. Gjetje nga auditimi:** Me shkresën nr. 12 prot., datë 19.05.2019 është bërë njoftimi i Këshillit të Administrimit për mbledhje mbi *“Diskutimin dhe miratimin e pasqyrave financiare të vitit 2018 të SHA Ujësjetllës Kanalizime Fier sipas raportit të Audituesve Ligjorë K.H dhe P.H”*. Me datë 22.05.2019 është kryer mbledhja nga Këshilli i Administrimit ku ka vendosur me vendimin nr. 13 prot., datë 22.05.2019 *“Të miratohen Pasqyrat Financiare të vitit 2018 të SHA Ujësjetllës Kanalizime Fier sipas Raportit të audituesve Ligjorë K.H dhe P.H”*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi miratimin e Pasqyrave Financiare u konstatua se nga ana e Këshillit të Administrimit nuk janë paraqitur për miratim në Asamblenë e Përgjithshme, veprim në kundërshtim me VKM-në nr. 63, datë 27.01.2016, Neni 7, *Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme*, Pika 1, Germa b, *Miraton pasqyrat financiare dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë.*

-Me shkresën nr. 26 prot., datë 09.10.2019 është bërë njoftimi i Këshillit të Administrimit për mbledhje mbi *“Diskutimin dhe miratimi i pikës së lidhjes së SHA Ujësjetllës Kanalizime Fier sipas propozimit të bërë nga sha Ujësjetllës Kanalizime Fier”*. Me datë 11.10.2019 është kryer mbledhja nga Këshilli i Administrimit ku ka vendosur me Vendimin nr. 27 prot., datë 11.10.2019 *“Miratimin e Tarifave për pikën e lidhjes së SHA Ujësjetllës Kanalizime Fier sipas tabelës bashkangjitur”*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi Miratimin e Tarifave për pikën e lidhjes së SHA Ujësjetllës Kanalizime Fier u konstatua se nuk janë propozuar për miratim në Entin Rregullator të ujit nga ana e Asamblesë së Përgjithshme, veprim në kundërshtim me VKM-në nr. 63, datë 27.01.2016, Neni 7, *Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme*, Pika 1, Germa c, *Miraton projektplanin tarifor që propozohet për miratim në Entin Rregullator të Ujit.*

-Me shkresën nr. 31 prot., datë 18.12.2019 është bërë njoftimi i Këshillit të Administrimit për mbledhje mbi *“Diskutimin dhe miratimi i Plan Zhvillimit sipas propozimit të Administratorit të SHA Ujësjetllës Kanalizime Fier për vitin 2020”*. Me datë 23.12.2019 është kryer mbledhja nga Këshilli i Administrimit ku ka vendosur me Vendimin nr. 32 prot., datë 23.12.2019 *“Të miratohet paraprakisht Plan Zhvillimit të SHA Ujësjetllës Kanalizime Fier dhe ti paraqis për miratim përfundimtar Asamblesë së Përgjithshme”*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi Miratimin e Plan Zhvillimit u konstatua se nuk janë paraqitur për miratim në Asamblenë e Përgjithshme, veprim në kundërshtim me VKM-në nr. 63, datë 27.01.2016, Neni 7, *Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme*, Pika 1, Germa a, *Përcakton politikat tregtare të shoqërisë, si dhe miraton planin e biznesit të hartuar nga Këshilli i Administrimit të shoqërisë, i cili duhet të përputhet me kontratën për menaxhimin e shërbimit të furnizimit me ujë e kanalizimeve dhe treguesit të punës, për të cilët është rënë dakord midis palëve kontraktore.*

Këshilli i Administrimit ka vendosur me Vendimin nr. 1053/4 prot., datë 07.05.2021 *“Të miratohen Pasqyrat Financiare të vitit 2020 të SHA Ujësjetllës Kanalizime Fier sipas Raportit të audituesve Ligjorë K.H dhe P.H”*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi miratimin e Pasqyrave Financiare u konstatua se nga ana e Këshillit të Administrimit nuk janë paraqitur për miratim në Asamblenë e Përgjithshme, veprim në kundërshtim me VKM-në nr. 63, datë 27.01.2016, Neni 7, *Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme*, Pika 1, Germa b, *Miraton pasqyrat financiare dhe*

raportet e ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 18, të Raportit të Auditimit).

**24.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga Ujësjetllës Kanalizime Fier SHA. që në të gjitha rastet e propozimeve për marrje vendimi nga Këshilli Administrimit, projekt vendimet të shoqërohen me dokumentacionin mbështetës për çdo çështje, duke ju paraqitur Asamblesë së Përgjithshme, për aprovimet përkatëse.

-Të merren masa nga Asambleja e Përgjithshme që në çdo rast të ndryshimit të tarifave të ujit të pijshëm të propozohen për miratim në Entin Rregullator të ujit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKF SHA janë marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e plotë të rekomandimit të KLSH si më sipër.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e tij, verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës. Për rrjedhojë, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**25. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Strukturave Drejtuese (Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtoria), vendimet e marra dhe zbatimi i tyre, u konstatua se Administratorët e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Fier janë emëruar dhe janë pjesë përbërëse e Këshillit të Administrimit me të drejtë vote. *Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, me konkretisht në Kreun II, Këshilli i Administrimit, sistemi me një nivel, Neni 155, Numri, Emërimi dhe përbërja e Këshillit të Administrimit, Pika 1, Këshilli i Administrimit përbëhet nga të paktën tre apo një numër më i madh, por jo më shumë se 21 anëtarë. Anëtarët janë individë, shumica e të cilëve duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga Administratorët e shoqërisë. Gjithashtu veprimi i mësipërm bie në kundërshtim edhe me Nenin 156, Zgjedhshmëria e kufizuar, Pika 2, "Një individ nuk mund të zgjidhet si anëtar i Këshillit të Administrimit, nëse ai, njëkohësisht, është", Germa b, "është administrator i një shoqërie mëmë ose i një shoqërie të kontrolluar të shoqërisë". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 18, të Raportit të Auditimit).*

**25.1 Rekomandimi:** Asambleja e Përgjithshme dhe Ujësjetllës Kanalizime Fier të marrin masa për të sqaruar bazueshmërinë ligjore për përfshirjen e Administratorit të shoqërisë në Këshillin e Administrimit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Aktualisht, me Rregulloren e re pas reformimit të Institucionit Administratori nuk është pjesë e KA.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *I zbatuar*.

**26. Gjetje nga auditimi:** Gjatë procesit të hartimit të pasqyrave financiare UK Fier SHA, është mbështetur në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, duke mos zbatuar SNRF-të. Kjo është në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, në nenin 3 dhe 5 si dhe gjithashtu në nenin 26 Inventari, llogaritë vjetore, të Vendimit nr. 63, datë 27.1.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin,

largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, duke pasur si efekt mos paraqitjen e qartë e situatës financiare të shoqërisë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet 36, të Raportit të Auditimit).

**26.1 Rekomandimi:** Administratori dhe Drejtori Tregtar të marrin masa për hartimin e pasqyrave financiare duke zbatuar Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, duke pasqyruar me besueshmëri situatën financiare të shoqërisë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKF SHA janë marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e plotë të rekomandimit të KLSH si më sipër. Në përfundim PF janë certifikuar nga ekspertët kontabël.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e tij, verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës. Për rrjedhojë, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**27. Gjetje nga auditimi:** -UK Fier nuk ka kryer zhvlerësimin e aktiveve financiare të shoqërisë. Në zërin kërkesa të arkëtueshme klientë, përveç detyrimeve të cilat po ndiqen me veprime administrative dhe ligjore, ka dhe zëra debitorë të tjerë për të cilët nuk disponohen dokumente të mjaftueshëm justifikues për ndjekje ligjore. Gjithashtu në këtë zë ka dhe vlera materialisht të vogla për të cilat nuk është efektive për ndjekje në organet gjyqësore.

Këto veprime janë bërë në kundërshtim me SKK3, “Instrumentet Financiare”, pika 22. Mos kryerja e zhvlerësime të aktiveve financiare sjell mos paraqitje të besueshme të situatës ekonomike të institucionit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 36, të Raportit të Auditimit).

**27.1 Rekomandimi:** Këshilli i Administrimit të marrë masa që sektori i financës gjatë hartimit të pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore, të vlerësojë nëse ka evidenca të mjaftueshme objektive të zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe njohjet respektive në rezultatin ushtrimor.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKF SHA janë marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e plotë të rekomandimit të KLSH si më sipër. Në përfundim PF janë certifikuar nga ekspertët kontabël.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e tij, verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës. Për rrjedhojë, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**28. Gjetje nga auditimi:** Në hartimin e pasqyrave financiare shoqëria ka përllogaritur shpenzimet e amortizimit. Në shënimet shpjeguese nga drejtimi i UK Fier SHA nuk janë paraqitur informacione sqaruese lidhur me vlerësimet dhe arsyet e përcaktimit të jetës së dobishme së AAM-ve, pra për normat e amortizimit të aplikuar në pasqyrat financiare të periudhës ushtrimore. Duke mos përdorur norma menaxheriale të mirë-argumentuara nga specialistët përkatës dhe duke mos e përcaktuar me fleksibilitet jetëgjatësinë e aktiveve, duke vlerësuar dhe zhvillimin e teknologjisë, UK Fier rrezikon të mos kryej me sukses planifikimin në avancë për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 23, shkronja d, e Udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, dhe sjellin mos paraqitje e saktë e pasqyrave financiare dhe mos planifikim i zëvendësimit të aktiveve afatgjata. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 36, të Raportit të Auditimit).

**28.1 Rekomandimi:** Nga Këshilli i Administrimit të merren masa që në të ardhmen, hartimi i pasqyrave financiare të kryhet me përgjegjshmëri dhe besueshmëri. Drejtimi i shoqërisë të marrë masa në të ardhmen, për përcaktimin e sistemeve dhe procedurave për zëvendësimin/shtimin e aktiveve afatgjata. Jetëgjatësia e aktiveve të përcaktohet mbështetur në manualët përkatëse, ekspertiza të specialistëve të fushës, me përgjegjshmëri dhe besueshmëri dhe bazuar në aktivet që disponon shoqëria.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKF SHA janë marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e plotë të rekomandimit të KLSH si më sipër. Në përfundim PF janë certifikuar nga ekspertët kontabël.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e tij, verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës. Për rrjedhojë, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**29. Gjetje nga auditimi:** UK Fier, nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat që duhet të përmbajë ky regjistër. Për periudhën objekt auditimi, u konstatua se institucioni nuk ka mbajtur regjistrin e aktiveve në përputhje me pikën 30 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 30.

Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj. Mos plotësimi i regjistrit të aktiveve sjell risk i lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së shoqërisë, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 36 të Raportit të Auditimit*).

**29.1 Rekomandimi:** Administratori i shoqërisë dhe nëpunësi zbatues duhet të marrin masa për plotësimin e regjistrit të aktiveve që zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKF SHA janë marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e plotë të rekomandimit të KLSH si më sipër. Në përfundim PF janë certifikuar nga ekspertët kontabël.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e tij, verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës. Për rrjedhojë, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**30. Gjetje nga auditimi:** UK Fier nuk ka kryer inventarizimin e plotë të aktiveve afatgjata dhe detyrimeve për periudhat 2019,2020 duke mos kryer verifikimin e ekzistencës fizike si dhe vlerësimin e gjendjes së tyre, të detyrimeve, të drejtave dhe dokumentacionit mbështetës përkatës. Këto veprime janë bërë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, i ndryshuar, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15, dhe pika 74 e Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 36, të Raportit të Auditimit).*

**30.1 Rekomandimi:** Këshilli i Administrimit duhet të marrin masa për kryerjen e inventarizimeve vjetore të aktiveve fizike të shoqërisë, si dhe detyrimeve e të drejtave për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKF SHA janë marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e plotë të rekomandimit të KLSH si më sipër. Në përfundim PF janë certifikuar nga ekspertët kontabël. Inventarizimi i aktiveve fizike të shoqërisë është një proces i cili kryhet çdo vit.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e tij, verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës. Për rrjedhojë, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**31. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i raportit përkatës dhe proces verbaleve të mbajtura nga komisioni u konstatua se: Proces verbalët e vlerësimit nuk janë hartuar duke argumentuar arsyet nëse është i nevojshëm ose jo për njësinë, si dhe nëse duhet të nxirret jashtë përdorimit nëpërmjet shitjes si material mbeturinë apo asgjësimit përfundimtar. Në raportin e hartuar nga komisioni, nuk janë shpjeguar arsyet e zgjedhjes së procedurave të ndjekura, të kriterëve të vlerësimit, si dhe mungojnë efektet ekonomike të masave për ri-aftësimet e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me nenet 104 e 106 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Mos përcaktimi i saktë i arsyeve të nxjerrjes jashtë përdorimit rrit riskun për shpërdorimet e aktiveve të institucionit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 36, të Raportit të Auditimit).*

**31.1 Rekomandimi:** Nga drejtimi i shoqërisë të merren masa që procesi i vlerësimit të aktiveve për tu nxjerrë jashtë përdorimit të kryhet me përgjegjshmëri, duke kryer analizat dhe argumentimet e bazuara në kriteret përkatëse dhe me relacionet shoqëruese.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKF SHA janë marrë masat e nevojshme për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit sipas parashikimeve të kuadrit përkatës ligjor e rregullator.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e tij, verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës. Për rrjedhojë, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**32. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i proces verbaleve të komisionit u konstatua se nuk ishte dokumentuar asgjësimi i aktiveve, duke mos përshkruar procedurën e ndjekur sipas rastit për çdo aktiv lidhur me dhënien në përdorim ose tjetërsimin e tyre, ose nxjerrjen jashtë përdorimit dhe destinacionin përfundimtar të aktiveve. Ky veprim është në kundërshtim me pikën 110 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Mos dokumentimi i asgjësimit të aktiveve rrit riskun për keq-menaxhimin e tyre. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 36, të Raportit të Auditimit).*

**32.1 Rekomandimi:** Nga drejtimi i shoqërisë të merren masa që procesi i asgjësimit të aktiveve të kryhet me përgjegjshmëri, duke kryer relacionet shoqëruese përkatëse.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*



**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKF SHA janë marrë masat e nevojshme për asgjësimin e aktiveve sipas parashikimeve të kuadrit përkatës ligjor e rregullator.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e tij, verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës. Për rrjedhojë, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**33. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i pagesave të furnitorëve u konstatua se nga Departamenti Ekonomik dhe i Financës nuk është ngritur dhe miratuar procedura e monitorimit të afateve të pagesave të detyrimeve, për të garantuar likuidimin e të gjithë kreditorëve në kohë si dhe për të dokumentuar që pagesat kryhen sipas afateve përkatëse kronologjike. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 1, si dhe me nenin 12 dhe nenin 16, pika 2, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Pajisja me sistem të monitorimit të skandencave të detyrimeve të pagueshme, ul riskun e shoqërisë për krijimin e penaliteteve për mos pagesa në afat. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 36, të Raportit të Auditimit*).

**33.1 Rekomandimi:** Nga administratori i shoqërisë të merren masa për të ngritur dhe miratuar procedura të monitorimit të afateve të pagesave të detyrimeve kontraktore, për të garantuar pagesën e të gjithë kreditorëve sipas kontratave përkatëse. Ky sistem do të shërbej për uljen e riskut të shoqërisë për krijimin e penaliteteve për mos pagesa në afat dhe vlerësimin e gjurmës së auditimit për korrektësinë e veprimeve të Nëpunësit Zbatues.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Në lidhje me këtë rekomandim UKF SHA ka hartuar një plan pagesash nisur nga historiku i detyrimit ndaj furnitorëve.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e tij, verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës. Për rrjedhojë, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**34. Gjetje nga auditimi:** Shoqëria UK Fier ka në zotërim objekte, troje, ndërtesa, depo uji, ujësjellës etj, për të cilat nuk disponon certifikatat e pronësisë. Drejtuesit dhe personat përgjegjës për certifikimin e pasurive të Shoqërisë UK Fier duket se kanë vepruar në mënyrë formale dhe janë mjaftuar vetëm me përgatitje shkresash apo aplikime në ZVRPP-të përkatëse dhe nuk e kanë ndjekur këtë çështje të rëndësishme në mënyrë këmbëngulëse. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Nenin 158/dh i Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar. Veprimet dhe mosveprimet në përputhje me ligjin rrisin riskun për humbjet në aktivet e shoqërisë. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 36, të Raportit të Auditimit*).

**34.1 Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë të ndërmerren hapa konkretë për këtë problematikë pasi numri i aseteve të Shoqërisë të pa regjistruara është relativisht i lartë. Regjistrimi dhe certifikimi i tyre sa më shpejtë ndikon në mënyrë direkte në uljen e riskut të humbjeve në aktivet e shoqërisë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Pronat e cituara nga ana e KLSH nuk janë në pronësi të UKF SHA pasi disa prej tyre janë në pronësi të Bashkisë Fier apo të të tretëve. Procedurat e regjistrimit për pronat e UKF SHA janë ende në proces.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *I pazbatuar*.

**35. Gjetje nga auditimit:** Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga UK Fier, konstatohet se situata e detyrimeve të pagueshme, furnitorë është në vlerën 909,379,643 lekë më 31.12.2020, dhe në këtë vlerë 7,434,383 lekë janë të pagueshme deri më 12 muaj, dhe vlera 894,996,190 lekë janë detyrime të lindura në më shumë se 12 muaj. Vlerën më të madhe e kanë detyrimet ndaj OSHEE, me principal 630,242,942 lekë dhe interesa në vlerën 38,985,225 lekë, detyrime ndaj KESH në vlerën 15,132,069 lekë etj. Në zërin e kërkesave të arkëtueshme në vlerën prej 1,236,776,831 lekë deri në datën 10.04.2022, vetëm 85,554,802 lekë janë të kërkueshme për 1-12 muaj. Vlera 79,937,450 lekë ka mbi 12-24 muaj, dhe vlera 1,071,284,571 lekë ka mbi 24 muaj. Nga totali 1,236,776,831 lekë, 735,905,607 lekë janë abonentë familjarë, ku vetëm 78,029,625 lekë janë detyrime nga 1-12 muaj, dhe pjesa tjetër janë mbi 12 muaj. Detyrimi i institucioneve publike është në vlerën 13,578,281 lekë dhe detyrimet e abonentëve biznes janë në vlerën 486,437,000 lekë. Gjithashtu dhe në këtë detyrim vlera më e madhe përbëhet nga detyrime që janë mbi 12 muaj, dhe debitorët kryesorë janë TECI, Reparti zjarrfikës dhe Uzina e Përpunimit të Naftës. Situata ekonomiko financiare e shoqërisë nuk është e mirë. Nëse në detyrimet e pagueshme ku pjesën më të madhe e ka OSHEE, i është kërkuar nga përmbaruesit privatë për pagimin e detyrimeve në pjesën e klientëve ka llogari të cilat kanë probabilitet të ulët për tu arkëtuar, situatë kjo e mbartur në vite. Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me nenin 12, pika 3, të Ligjit Nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Mos arkëtimi i detyrimeve të arkëtueshme zvogëlon fluksin e likuiditeteve të nevojshme për funksionimin e shoqërisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 36, të Raportit të Auditimit).*

**35.1 Rekomandimi:** Këshilli i Administrimit të UK Fier SHA, të vlerësojë me prioritet situatën e llogarive të arkëtueshme të shoqërisë, të kryejë një analizë objektive të të gjithë abonentëve debitorë, të ri-konfirmojë ekzistencën e tyre, të specifikohen grupet kryesore dhe të ndërmarrë të gjitha masat administrative dhe ligjore për arkëtimin e tyre.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Çdo muaj UKF SHA ka raportuar në AKUM mbi ecurinë e debitorëve, vlerën e arkëtuar të debisë ku mbi këtë kuadër është ndërmarrë edhe aksioni nga AKUM për mbledhjen e detyrimeve të pashlyera nga debitorë duke marrë masa më të forta si ndërprerje e ujit, gjobitja etj.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga deklaratimet e mësipërme dhe nga natyra e rekomandimit, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për rrjedhojë, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

## **MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt “*Blerje materiale hidraulike*” rezulton se furnizimi me mallrat objekt prokurimi është kryer brenda afatit 12 mujor të parashikuar në kontratën e furnizimit. Për marrjen në dorëzim të mallrave, sipas Urdhrit të Brendshëm nr. 353/12 prot., datë 10.06.2019 është caktuar nga ana e ish – Titullarit z. P.N grupi përkatës me përbërje z. V.M, z. E.Gj dhe z. E.E. Me shkresat me nr. 353/13 prot., datë 01.07.2019, 353/14 prot., datë 10.09.2019, nr. 89 prot., datë 30.01.2020, nr. 89/1 prot., datë 06.02.2020, nr. 89/2 prot., datë 07.04.2020 nga ana e këtij grupi janë marrë në dorëzim mallrat objekt kontrate i cili ka konkluduar se mallrat janë konform DST. Në fakt nga auditimi i zbatimit

të kontratës nga OE F.G u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së mallrave, nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht mallrat nuk janë të shoqëruara me test raport fabrike, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e mallrave. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto mallra janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën OE F.G ka fituar tenderin dhe është likuiduar. Në këto kushte vlera **9,303,204 lekë** përbën **dëm ekonomik** për UK Fier dhe Buxhetin e Shtetit dhe si e tillë duhet të dëmshpërblehet nga OE F.G. Sa më sipër është në kundërshtim me kontratën me nr. 382/16 prot., datë 06.06.2019, neni 8 *Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet*, neni 9 *Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike* dhe neni 12 *Testimet dhe Inspektimet* tek Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 42 të Raportit të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Nga ana e UK Fier SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **9,303,204 lekë** ndaj sipërmarrësit OE F.G për furnizime të kryera jo në përputhje me kërkesat e AK por të likuiduara, në kontratën e furnizimit të lidhur sipas aktit me nr. 382/16 prot., datë 06.06.2019 me objekt *'Blerje materiale hidraulike'*.

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKF SHA është paditur shoqëria F.G sipas shkresës nr. 1522 prot., datë 21.10.2022 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe çështja është akoma në proces gjykimi.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*. Verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**2. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt *"Shpim pusi dublant nr. 3 B Kafaraj"* rezulton se furnizimi me mallrat objekt prokurimi është kryer brenda afatit 45 ditore të parashikuar në kontratën e furnizimit por konstatohet se ndër të tjera i janë likuiduar furnitorit edhe zëri *Pompim dhe testim pusi*, ose vlera 561,600 lekë me TVSH. Në fakt vlera e mësipërme përbën dëm ekonomik dhe si e tillë duhet të paguhet nga ana e furnitorit, kjo pasi referuar kontratës së furnizimit (DST), kostot e testeve janë në ngarkim të kontraktorit dhe jo të AK. Sa më sipër është në kundërshtim me kontratën me nr. 439 prot., datë 09.07.2019, neni 26, pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 42 të Raportit të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** Nga ana e UK Fier SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **561,600 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit OE A.K.M për punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 439 prot., datë 09.07.2019 me objekt *'Shpim pusi dublant nr. 3 B Kafaraj'*.

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKF SHA është paditur shoqëria A.K.M sipas shkresës nr. 1521 prot., datë 20.10.2022 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe çështja është akoma në proces gjykimi.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*. Verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**3. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt *“Blerje materiale hidraulike”* rezulton se për marrjen në dorëzim të mallrave, sipas Urdhrit të Brendshëm nr. 1069 prot., datë 09.12.2020 është caktuar nga ana e ish – Titullarit z. P.N grupi përkatës me përbërje z. E.C, znj. E.S dhe z. Dh.S (ndërruar jetë). Me shkresat me nr. 1069/1 prot., datë 15.12.2020, nr. 1425/1 prot., datë 21.05.2021, nr. 1425/2 prot., datë 30.06.2021, nr. 2378 prot., datë 24.09.2021 dhe 2378/1 prot., datë 22.11.2021 nga ana e këtij grupi janë marrë në dorëzim mallrat objekt kontrate i cili ka konkluduar se mallrat janë konfort DST. Në fakt nga auditimi i zbatimit të kontratës nga OE A.C u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së mallrave, nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht mallrat nuk janë të shoqëruara me test raport fabrike, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e mallrave. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto mallra janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën OE A.C ka fituar tenderin dhe është likuiduar. Në këto kushte vlera **11,275,680 lekë** përbën **dëm ekonomik** për UK Fier dhe Buxhetin e Shtetit dhe si e tillë duhet të dëmshpërblehet nga OE A.C. Sa më sipër është në kundërshtim me kontratën me nr. 902 prot., datë 04.12.2020, neni 8 *Qëllimi i Furnizimit dhe Përshatshmëria e Mallrave me Specifikimet*, neni 9 *Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike* dhe neni 12 *Testimet dhe Inspektimet* tek Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

**3.1 Rekomandimi:** Nga ana e UK Fier SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **11,275,680 lekë** ndaj sipërmarrësit OE A.C për furnizime të kryera jo në përputhje me kërkesat e AK por të likuiduara, në kontratën e furnizimit të lidhur sipas aktit me nr. 902 prot., datë 04.12.2020 me objekt *‘Blerje materiale hidraulike’*.

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKF SHA është paditur shoqëria A.C sipas shkresës nr. 1523 prot., datë 21.10.2022 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe çështja është është fituar në këtë fazë nga OE, kjo sipas vendimit me nr. 84-2023-631 (326). Pas kësaj UKF SHA ka apeluar këtë vendim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë sipas shkresës me nr. 1859 prot., datë 01.08.2023.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*. Verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

## **MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Shoqëria “Ujësjellës Kanalizime” SHA. Fier, përfaqësuar nga ish administratori i shoqërisë A.P., autorizuar me vendimin nr.1 të asamblesë së përgjithshme të datës 14.07.2010, ka lidhur aktmarrëveshjen për “ Furnizimi, instalimi dhe financimi i një sistemi

elektronik të matjes së ujit” mes shoqërisë “T” S.A., me seli në Athinë, Greqi e përfaqësuar nga C.A administrator i Shoqërisë dhe shoqërisë “T” S.A. Marrëveshja është lidhur dhe zbatuar në kundërshtim me dispozita ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë në fushën e prokurimit, financiare, të ndërtimit, si dhe në kushte ekonomik-financiare të disfavorshme për shoqërinë. Aktmarrëveshja e lidhur nga shoqëria “Ujës-jellës Kanalizime” SHA. Fier, kishte si subjekt blerjen, instalimin, testimin dhe shpërndarjen e 37,224 aparate matës të ujit EËMS, (Furnizim dhe instalim i një sistemi elektronik i matjes së ujit), dhe njësitë e mbledhjes së të dhënave, qendrës së menaxhimit të tyre dhe sistemit të faturimit. Vlera e kontratës ishte në shumën 5,314,830 Euro, pa TVSH. Në pikën 12, të kontratës është përcaktuar se një degë e kompanie Teoalb SHA., do të krijohet pas nënshkrimit të kontratës për zbatimin e saj. Në Shtojcën 3, të kontratës janë përcaktuar termet e Pagesës së Projektit. Nga ana tjetër, midis Ujës-jellës Kanalizime Fier SHA (P1) dhe T S.A. në këtë kontratë palët kanë parashikuar në nenin 1 se: ,1.1 Barrëdhënësi në këtë marrëveshje vendos në favor të Barrmarrësit një barrë siguruese mbi: (i) Të gjitha të ardhurat që rrjedhin nga: a- Kontrata datë 30.07.2010, lidhur ndërmjet, T" SHA, S. INC dhe Shoqërisë Ujës-jellës Kanalizime Fier SHA, ndryshuar. (i) çdo të ardhur shtesë, interesa dhe në përgjithësi çdo kredi që rrjedhin nga këta kontrata. Më datë 12.11.2010, midis palëve kontraktore UK Fier SHA., dhe T SA, dhe S. Inc është vendosur që T SA ia transferon të gjitha të drejtat dhe detyrimet shoqërisë T. SHPK me T SA si aksionar i vetëm. Me shkresën nr. 302/2, datë 13.06.2010, administratori i shoqërisë A.P., ka njoftuar anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës për tematikat e mbledhjes së radhës, ku përfshihet dhe miratimi i vendimit për Drejtorin e Përgjithshëm për të vepruar në emër të UK Fier SHA., për financimin dhe instalimin përfundimtar të matësve dhe sistemit të transmetimit wireless në zonën e shërbimit. Me vendimin nr. 544 Prot., datë 21.10.2010, asambleja e aksionarëve e përfaqësuar nga M.F, ka marrë vendimin për marrjen e garancisë bankare pranë T.B. për investimin e matësve elektronikë të ujit ku autorizon ish administratorin A.P., të përfaqësoj Aksionarët e UK Fier Sha, në kryerjen e veprimeve, si kontrata e garancisë bankare, kontratat e hipotekimit në favor të T.B, për pronat (ndërtesat administrative, zyrat e sektorit, zyrat e arkave etj) në pronësi të UK Fier. UK Fier do të vendosë si garanci të gjithë të ardhurat që ka nga biznesi, këto të ardhura 100 %, do të bëhet vetëm nga llogaria e T.B, për sa kohë vazhdon afati i garancisë, dhe llogaria do të administrohet nga T.B, duke i kryer pagesat fillimisht vetëm për tatime, sigurime shoqërore, paga dhe të gjitha pagesat e tjera vetëm nëse ishte paguar T. SHPK. Me shkresën nr. 770/1 Prot., datë 12.01.2011, administratori që zëvendësoi z. A.P., ka njoftuar T. SHPK, për ndërprerjen e punimeve, ku e njofton se stafi i UK Fier nuk ka informacionin tekniko-financiar dhe ligjor për projektin, nuk ka asnjë projekt preventiv të miratuar apo kryer oponencë nga organet përkatëse si dhe leje ndërtimi sipas ligjit të urbanistikës. Gjithashtu është kërkuar ndërprerja e zëvendësimit të matësve të ujit në dy lagje, pasi janë vendosur në vitin 2007 nga kredia e Bankës Botërore e cila është akoma në shlyerje dhe janë asetet e UK Fier. Me vendimin nr. 544, datë 21.10.2010, Asambleja e Aksionerëve të UK Fier, përfaqësuar nga znj. M.F, ka vendosur të aplikohet për dhënien e garancisë bankare duke autorizuar administratorin për lidhjen e kontratës me T.B. Më datë 12.11.2010 mes palëve UK Fier dhe T dhe S. Inc është bërë amendimi i kontratës duke shtuar faktin se pala T dhe S. Inc merr përsipër kryerjen e shërbimit të billingut në favor të UK Fier për një afat 5 vjeçar, përkundrejt pagimit të një vlere prej 500 euro në muaj. Më datë 22.11.2010 mes palëve D.C.I.A dhe UK Fier është lidhur kontrata e mbikëqyrjes së punimeve të furnizimit, instalimit të sistemit të ri të matësve elektronikë me vlerë 45,000 euro, me afat 18 muaj. Me shkresën nr. 953 Prot., datë 06.04.2011, administratori i ka dërguar T.B, vendimin e asamblesë së ortakëve nr. 06 Prot., datë 30.03.2011 për pezullimin e kontratës “Furnizimi, instalimi dhe financimi i një sistemi elektronik për matjen

e ujit”, si dhe pezullimin e kontratës së fillestare të lidhur me T SA dhe S. Inc, për arsye se nuk janë zbatuar procedurat e prokurimit publik, si dhe për kontratën për dhënie garancie nuk janë zbatuar dispozitat e ligjit nr. 9869 datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar. Kërkesat e administratorit nuk janë marrë në konsideratë nga T.B, në përgjigjen nr. 8062 Prot., datë 21.04.2011.

Më datë 15.05.2011 është ndryshuar kontrata midis shoqërive me shkakun se të dyja palët shohin mundësinë e riorganizimit të kushteve të pagesës, zgjerimit të financimit dhe ndihmës për organizimin e instalimit të pajisjeve në varësi të kontratës së CEZ.

Shoqëria T. SHPK ka lidhur Kontratë me T.B, për Kredi Afatmesme Nr. Co. 466/03.11.2010 ndryshuar me Shtojcë Kontratë për Kontratë për Kredi Afatmesme nr. Co. 466/6.09.2012 për një kredi në shumën Euro 2,188,986.89, me T.B, si dhe siguron pagimin e çdo shume që Barrëdhënësi, i detyrohet Barrëmarrësit në bazë të kontratave të sipërpërmendura. Për periudhën 2010, T. i ka faturuar UK Fier vlerën 539,719 Euro, për “Software and control room” situacion, me faturën tatimore nr. 1, datë 21.12.2010, pranuar nga ish administratori A.P. Më datë 12.01.2011, DIËI Tirana, i ka dërguar UK Fier, shkresën për pagesën e faturës nr. 2, për dhomën e kontrollit dhe për 620 matësa të montuar në terren, duke certifikuar punimet, për vlerën 392,721 Euro. T. SHPK, me shkresën nr. 1327 Prot., datë 27.09.2011, i drejtohet administratorit të ri S. T., për pranimin e faturave tatimore të mësipërme, të refuzuara nga administratori i mëparshëm, veprim sipas tij i paligjshëm dhe nga Zyra e Tatim Taksave, e cila pas kontrollit të kryer, bëri kallzim penal në Prokurorinë e Rrethit Fier, ndaj UK Fier për mos deklarim faturash. Më datë 25.11.2011, Këshilli Mbikëqyrës i përbërë nga A.M kryetar, Q.H, S.Gj, I.Gj dhe K.S anëtarë, kanë miratuar projektet e ndryshme të Drejtorisë Teknike, për vendosjen e matësve të rinj, si përcaktimin e preventiveve dhe vlerave finale që duhet të pagojnë klientët për instalimin dhe përfitimin e shërbimit. Ka ngarkuar administratorin për zbatimin e situacioneve 1 dhe 2, dhe zbatimin e vendimit. Më datë 18.01.2012, Këshilli Mbikëqyrës ka ngarkuar administratorin për marrjen në dorëzim të 1300 matësve të instaluar nga T.. Më datë 01.03.2014, shoqëria T., me shkresën nr. 16 Prot., ka njoftuar UK Fier se do ndërpresë kontratën për moszbatim të kushteve dhe se do ta dërgojë në Gjykatën e Arbitrazhit duke kërkuar minimalisht 4,460,000 Euro dëmshpërblim. Këshilli Mbikëqyrës dhe Asambleja e Ortakëve kanë autorizuar administratorin për pajtimin e një studio ligjore. Pas vlerësimit të ofertave, UK Fier ka lidhur kontratë për konsulencë ligjore me studion “H. & H.”. Më 26.06.2014, administratori S.T ka nënshkruar një aneks kontrate me T., ku pranon detyrimin e faturuar në vlerën 2,115,342 Euro dhe përveç kësaj vlere dhe vlerën 316,025 Euro për 3500 matësa të montuar por të pafaturuar. Gjithashtu pranon se si rezultat i paaftësisë së UK Fier për përmbushjen e pagesave kontraktore dhe sigurimit ndaj T. të një garancie bankare, kjo e fundit ka mundur të instalojë gjatë 4 viteve vetëm 17,600 matësa. Me nënshkrimin e kësaj aneks kontrate T. është dakord të ndërpresë procedurat për ndërprerjen e kontratës dhe ndjekjen në Gjykatën e Arbitrazhit.

Në mënyrë që UK Fier ti paguajë detyrimin prej 2,115,342 euro, do të transferojë në favor të T. të gjitha aktivitetet e departamentit të shitjes, duke përfshirë dhe aktivitetin e faturimit për një periudhë jo më shumë se 5 vjet. UK Fier i ka kaluar T. të drejtën për të gjithë llogarinë e klientëve në shumën 592,000,000 lekë, duke i dhënë të drejta për lidhje marrëveshje, ndërprerje të furnizimit me ujë, mbledhjen e të ardhurave nga lidhjet e reja, Gjithashtu 25 punonjës të UK Fier, faturistë do të kalojnë në T., dhe UK Fier do të paguar një kosto 5000 euro për shërbimin. UK Fier do ti sigurojë T. akses të plotë për të dhënat e numrit të përdoruesve, llogaritë bankare, numrin e punonjësve etj. Kohëzgjatja e kontratës është pesë vjet. Asambleja e Aksionerëve me vendimin nr. 81 Prot., datë 31.03.2015, ka miratuar kalimin e detyrimeve të arkëtueshme nga shoqëria A te T..

Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar largimin e administratorit S.T dhe emërimin e P.N, më datë 05.09.2016.

Më datë 23.09.2016, T., përfaqësuar nga C.A, i ka dërguar UK Fier, lajmërim për ndërprerje kontrate, si rezultat i mos pagesave duke kërkuar pagesën e detyrimit të mbetur prej 1,800,000 euro dhe vlerën minimale prej 2,200,000 euro si kompensim për fitimin e munguar dhe dëme. Nëse nuk paguhen ose nuk lidhet kontratë tjetër, T. do ta dërgojë çështjen për zgjidhje në Gjykatën e Arbitrazhit.

Më datë 09.01.2017, me shkresën nr. 3 Prot., administratori P.N, i është përgjigjur njoftimit të T., se zbatimi i kontratës mes palëve ka pasur probleme teknike si mos funksionimi i matësve, nuk kanë mundur të lexohen on-line, nuk ka pasur rritje të arkëtimeve, kanë faturuar për menaxhimin e shitjeve në total vlerën 469,200 Euro, kur stafi i drejtorisë së shitjes është paguar nga UK Fier, matësit e instaluar në vitin 2008 nga financimi i Bankës Botërore në vlerën 113,000,000 lekë, nuk janë dorëzuar në UK Fier. Gjithashtu UK Fier nuk ka konfirmuar asnjëherë marrjen në dorëzim të matësve të instaluar.

Më datë 10.01.2017, me shkresën nr. 12/1 prot., administratori i UK Fier i ka kthyer faturën e T., duke mos e pranuar.

Për periudhën 2010 deri ne 31.08.2016 nga zbatimi i kontratës me shoqërinë T. me objekt “Për furnizimin dhe instalimin e një sistemi elektronik te matjes se ujit” rezultojnë të kryera pagesa në vlerën 280,019,352 lekë.

Më datë 23.01.2017, B.A ka filluar procedurat gjyqësore për marrjen e detyrimit prej 2,456,000 euro që ka akumuluar shoqëria T. ndaj bankës, duke u mbështetur në marrëveshjen siguroese të lidhur në vitin 2010, ku ishte palë dhe UK Fier sha.

Me vendimin nr. 62 , datë 08.02.2022, Gjykata e Rrethit Fier, ka vlerësuar si të pabazuara në ligj kërkesat e T.B.

Aktmarrëveshja e lidhur ndërmjet shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” SHA. Fier, dhe shoqërisë **është kryer pa zbatuar procedurat e prokurimit**, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, çka ngarkon me përgjegjësi Administratorin e Shoqërisë, Këshillin Mbikëqyrës dhe Këshillin Bashkiak.

Lidhja e kësaj marrëveshje është kryer, pa hartuar plan biznesin përkatës për shlyerjen e kësaj kredie, efektivitetin e saj, dhe në një kohë kur Shoqëria Ujësjetllës Sha, Fier, nuk kishte aftësi paguese për shlyer këtë kredi.

Në kundërshtim me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009, “Për miratimin e modelit të rregullores për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjetllës kanalizimeve SHA”, pika 2.7, Ujëmatësit, vlera e matësve nuk i’u është faturuar konsumatorëve por është mbajtur si kosto e shoqërisë.

### **Vlera 280,019,352 lekë përbën efekt ekonomik negativ për UK Fier.**

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi administratorin e shoqërisë, Këshillin mbikëqyrës dhe Këshillin bashkiak, të cilët kanë aprovuar dhe kryer vendimet për lidhjen e kontratës, vënien e garancive si dhe mos marrjen e masave gjatë zbatimit të kontratës, veprime këto në kundërshtim me nenin Neni 16 “Abuzimi me detyrën dhe formën e shoqërisë”, i Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, ligjin nr. 10,081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet

në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 956, datë 09.05.2012 “Për një ndryshim në VKM nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat”, Udhëzimi i METE nr. 315, datë 08.04.2009 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, i ndryshuar udhëzimin e MZHETS nr. 394, datë 21.08.2-14 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjetllës Kanalizimeve SHA. (Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 77, të Raportit të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Këshilli i Administrimit të shoqërisë UK Fier SHA., të analizojë me përgjegjshmëri dhe prioritet situatën e krijuar me kontratën për montimin e matësve elektronik, duke kërkuar ekspertizë tekniko/ligjore nga ekspertët përkatës për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Këshilli i Administrimit të shoqërisë të shqyrtojë procedurat e lidhjes dhe zbatimit të kontratës, duke dokumentuar shkeljet, mos zbatimet me qëllim përdorimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Këshilli Administrimit ka funksionuar deri në datë 31.12.2022 dhe pas kësaj vendimmarrje pas kësaj date pasi edhe vet shoqëria është reformuar.

**Komenti i audituesve:** Në lidhje me këtë rekomandim nuk u vu në dispozicion ndonjë dokumentacion konkret për zbatimin e tij. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* por *I pazbatuar*.

**2. Gjetje nga auditimi:** Për vitet 2019-2021, janë ekzekutuar në total 6 vendime gjyqësore lidhur pavlefshmërinë dhe kundërshtimin e futurave të ujit të pijshëm dhe gjoba nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit. Në total është ekzekutuar detyrimi në shumën 1,004,500 lekë konkretisht për periudhën nga data 01.01.2019, deri më 31.12.2021, (nga të cilat për vitin 2019 në shumën 153,100 lekë procesi gjyqësor si dhe shpenzime përmbartimore në shumën 241,200 lekë; për vitin 2020 në shumën 51,200 lekë procesi gjyqësor si dhe shpenzime përmbartimore në shumën 23,000 lekë dhe për vitin 2021 në shumën 500,000 lekë procesi gjyqësor si dhe shpenzime përmbartimore në shumën 36,000 lekë). **Shuma 1,004,500 lekë përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime SHA Fier.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faq. 29, të Raportit të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** Nga UKF SHA të merren masa për të ndjekur me përgjegjësi të gjitha procedurat gjyqësore dhe në veçanti ato çështje që kanë të bëjnë me pavlefshmërinë dhe kundërshtimin e faturave të ujit të pijshëm dhe gjobave, me përfaqësim tekniko-juridik me profesionist me eksperiencë për minimizuar dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i vendimeve në disfavor të Shoqërisë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** UKF SHA ka ndjekur me përgjegjësi të gjitha procedurat gjyqësore sipas rekomandimit të mësipërm.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga deklarata e subjektit si më sipër dhe nga vet natyra e tij, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*. Verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i zbatimit të strukturës organizative të UKF SHA konstatohet se, është tejkaluar numri i fuqisë punëtore në total me 38 punonjës për muajt qershor-



shtator të vitit 2021 si pasojë e ristrukturimit të Shoqërisë sipas shkresës me nr. 1053/3 prot., datë 07.05.2021, të Këshillit të Administrimit ku mbi këtë shkresë është miratuar dhe nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Fier e cila shkon nga 360 punonjës në 329 punonjës konkretisht, për muajin qershor 9 punonjës, për muajin korrik 10 punonjës, për muajin gusht 10 punonjës dhe për muajin shtator 9 punonjës. Referuar nivelit të pagave të miratuar me Vendimin nr. 20, datë 03.10.2016, të Këshillit të Administrimit e cila është aplikuar edhe për 2021, në total për punonjësit mbi strukturë është likuiduar **shuma 1,222,390 lekë përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime SHA Fier**. Ky efekt ka ardhur si pasojë e suprimimit të vendit të punës për disa pozicione pune referuar ndryshimeve që ka pësuar struktura organizative duke bërë që për një pozicion pune të jenë të punësuar dy punonjës. Gjithashtu nga UKF SHA këta punonjës që kanë qenë mbi strukturë janë mbajtur në marrëdhënie pune si pasojë e ndjekjes së procedurave ligjore të parashikuara në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, konkretisht nga njoftimi i punonjësve deri në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës proces i cili ka zgjatuar për një periudhë tre mujore. Më pas nga muaji tetor 2021 e në vazhdim numri i punonjësve është brenda strukturës organizative të miratuar, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8 dhe neni 11, dhe struktura e miratuar dhe aplikuar për vitin 2021, me shkresën nr. 1053/3 prot., datë 07.05.2021, të Këshillit të Administrimit ku mbi këtë shkresë është miratuar dhe nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Fier. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 22, të Raportit të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë, Drejtoria Tregtare dhe Zyra e Burimeve Njerëzore të merren masat e duhura që, në të ardhmen të respektohet numri i fuqisë punëtore në punë në përputhje me strukturën e miratuar dhe legjislacionin në fuqi, me qëllim përdorimin e fondeve publike me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga muaji Dhjetor 2022 deri aktualisht, UKF SHA ka qenë me më pak të punësuar se sa ka parashikuar struktura përkatëse e miratuar.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht borderove dhe strukturave të miratuara për dhjetor 2022 dhe gusht 2023, rezulton se numri i punonjësve (314, 593) është më i ulët nga numri i parashikuar në strukturë (328, 643). Nisur nga sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*. Verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**4. Gjetje nga auditimi:** Për vitet 2019-2021 auditimi janë ekzekutuar në total 3 vendime gjyqësore lidhur me humbjen e proceseve gjyqësore në të cilat ka qenë e paditur Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime SHA Fier nga ish-punonjësit e saj mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Në total është ekzekutuar detyrimi në shumën 1,349,984 lekë konkretisht për periudhën nga data 01.01.2019, deri më 15.04.2022, (nga të cilat për vitin 2020 në shumën 326,266 lekë ndërsa për vitin 2022 nga data 01.01.2022, deri më 15.04.2022, në shumën totale 1,023,718 lekë nga të cilat 110,038 lekë tarifë përmbartimore si dhe 913,680 lekë procesi gjyqësor). **Shuma 1,349,984 lekë përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime SHA Fier**. Gjithashtu janë duke u gjykuar edhe 7 procese gjyqësore në Gjykatën e Apelit të Vlorës, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kontratat kolektive dhe kontratat individuale të punës dhe rregulloret e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Shoqërisë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 22, të Raportit të Auditimit).

**4.1 Rekomandimi:** Nga Shoqëria të analizohen në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përmbare, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë duke evidentuar përgjegjësitë individuale, si dhe në të ardhmen të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ardhja e Raportit përfundimtar të Auditimit nuk ka patur më padi për largime të padrejta nga puna. Në lidhje me 7 procedura gjyqësore në Gjykatën e Apelin në Vlorë janë në proces.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër rekomandimi quhet *I pranuar* por *I zbatuar pjesërisht* pasi UKF SHA nuk ka analizuar në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna me pasojë krijimin e detyrimeve të shtuara përmbare.

**5. Gjetje nga auditimi:** Me Vendimin e Këshillit të Administrimit sipas shkresës nr. 21 prot., datë 16.12.2020, janë shpërblyer të gjithë punonjësit e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime SHA konkretisht 346 punonjës në vlerën 6,000 lekë secili. Ndërkohë që Shoqëria është me humbje respektivisht konkretisht për vitin 2019 në shumën 10,698,510 lekë, për vitin 2020 në shumën 7,583,406 lekë dhe për vitin 2021 në shumën 28,311,648 lekë. Gjithashtu vendimi i Këshillit të Administrimit është në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve” i ndryshuar, neni 6, pika 1, germa “b” për arsye se shpërblimi është përfituar para daljes së rezultatit financiar por edhe se Shoqëria është me humbje sipas periudhave të sipërpërmendura dhe për rrjedhojë nuk mund të akordojë shpërblim për punonjësit. Në total shpërblimi në **shumën 2,076,000 lekë përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime SHA Fier.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 22, të Raportit të Auditimit).

**5.1 Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë dhe Këshilli i Administrimit të marren masa në të ardhmen që, dhënia e shpërblimeve për punonjësit e saj të kryhet në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse si dhe duke marrë në konsideratë e faktin e situatës së financiare të institucionit me qëllim përdorimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKF SHA nuk janë dhënë më shpërblime nga data e ardhjes së Raportit Përfundimtar të Auditimit deri aktualisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *I zbatuar*. Verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**6. Gjetje nga auditimi:** Me Vendimin e Këshillit të Administrimit protokolluar në UKF SHA me shkresën nr. 1053/2 prot., datë 07.05.2021, në pikën nr. 2 dhe 3 përcaktohet që: “Për çdo muaj mbështetur në arkëtimet e detyrimeve të prapambetura të çdo grupi, punonjësit përkatës do të përfitojnë shtesë në pagë prej 1% të shumës së detyrimit të prapambetur të arkëtuar si dhe evidentimi i detyrimeve të prapambetura të arkëtuar do të bëhet nga Drejtoria e Shitjes për çdo muaj, e cila do të dorëzojë pranë Drejtorisë së Financës zyrtarisht, shumën e detyrimit të prapambetur të arkëtuar nga çdo grup i Taskë-Forcës”. Për dhënien e këtij shpërblimi Këshilli i Administrimit është bazuar në Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat në përcaktimin

e pagave dhe shpërblimeve” i ndryshuar, ndërkohë që në nenin 6, germa “b”, të këtij ligji përcaktohet që: “masën e shpërblimit të punës por jo më shumë se një pagë mujore në vit pas daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga ministri përkatës”. Kjo bazë ligjore i referohet një shpërblimi vjetor pas daljes së rezultatit financiar dhe jo një shpërblimi në përqindje mbi detyrimet e prapambetura të arkëtuara. Gjithashtu kjo është një detyrë funksionale e Repartit të Taskë-Forcës bazuar edhe në rregulloren e brendshme të funksionimit dhe organizimit të Shoqërisë. Me këtë shpërblim për vitin 2021, për Reparti i Taskë-Forcës janë trajtuar në total 56 punonjës në shumën 113,578 lekë konkretisht, janë trajtuar 13 punonjës në shumën 20,683 lekë për muajin maj, 14 punonjës në shumën 26,200 lekë për muajin qershor, 15 punonjës në shumën 34,580 lekë për muajt korrik-gusht dhe 14 punonjës në shumën 32,115 lekë për muajin tetor. Kjo situatë ka vazhduar deri në muajin tetor të vitit 2021, pasi ky shpërblim është ndërprerë për punonjësit e këtij sektori. Për sa trajtuar më sipër **shuma 113,578 lekë përbën efekt negativ financiar për Buxhetin e Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime SHA Fier.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 22, të Raportit të Auditimit).

**6.1 Rekomandimi:** Nga Administratori dhe Këshilli i Administrimit në të ardhmen të merren masa që kur të ketë shtesë page në formën e përqindjeve mbi arkëtimin e detyrimeve apo dhënie shpërblimesh për punonjësit e saj, të kryhen duke u bazuar në dispozitat ligjore përkatëse me qëllim përdorimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKF SHA nuk janë dhënë më shtesa page në formën e përqindjeve nga data e ardhjes së Raportit Përfundimtar të Auditimit deri aktualisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *i Zbatuar*. Verifikimi i plotë i këtij rekomandimi do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i gjendjes debitore në sistemin tatimor u konstatua se shoqëria ka detyrime të cilat janë ngarkuar në sistemin tatimor nga aktet e kontrollit të inspektorëve tatimorë për periudhën 2013-2014, në vlerën 1,762,272 lekë, nga të cilat 1,318,910 lekë janë gjoba të regjistruara dhe 443,362 lekë janë interesa të maturuara. Në principalin prej 1,318,910 lekë, 110,000 lekë janë gjoba mbi fitimin, 7,641 lekë për tatimin e mbajtur në burim, 91,114 lekë për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, 546,357 lekë dhe interes i maturuar në vlerën 419,983 lekë për kontributet shoqërore, si dhe 563,798 lekë gjoba për mos mbajtje të saktë të librave, regjistrave dhe dokumentacionit. Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Vlera **1,762,272 lekë përbën efekt financiar negativ** për shoqërinë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet 36, të Raportit të Auditimit).

**7.1 Rekomandimi:** Këshilli i Administrimit të marrë masa për vlerësimin e gjobave të vendosura nga organet tatimore, duke gjykuar nëse vlerësimet e lëna nga inspektorët janë të drejta apo të apelueshme, nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse, pagesat e detyrueshme nga organeve tatimore. Këshilli i Administrimit të marrë masa për trajnime dhe përditësime të personelit lidhur me detyrimet e institucionit për zbatimin e procedurave tatimore e fiskale.

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Në lidhje me këtë rekomandim UKF SHA ka vlerësuar gjobat e vendosura por duhet theksuar fakti se nxjerrja e përgjegjësisë ka qenë një proces jo praktikisht i lehtë pasi këto gjoba datojnë që prej vitit 2012 dhe stafi ka lëvizur vazhdimisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet si *I pranuar* por *I pazbatuar*.

### **D/1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe përgjegjësitë të evidentuara dhe pasqyruara në pikën 7 faqe 42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, mbështetur në nenin 15 shkronja (c, ç) dhe 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë Administratorit të Ujësjetës Kanalizime Fier SHA, që në zbatim të nenit 78, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ti kërkojë Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe vendosjen e masave administrative dhe/ose disiplinore në raport me shkeljet e konstatuara për 2OE e mëposhtëm:

#### **1. OE F.G**

a. Në shkeljet e konstatuara në 1 rast në procedurën e prokurimit me objekt ‘Blerje materiale hidraulike’, viti 2020, ku u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së mallrave, nuk rezultoi i plotë dhe i saktë. Konkretisht mallrat nuk rezultuan të shoqëruara me test raport fabrike, për pasojë nuk mund të konfirmohet saktësia dhe vërtetësinë e mallrave. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto mallra janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën OE A.C ka fituar tenderin dhe është likuiduar. Në këto kushte vlera **11,275,680 lekë** përbën **dëm ekonomik** për UK Fier dhe Buxhetin e Shtetit.

#### **2. OE A.C**

a. Në shkeljet e konstatuara në 1 rast në procedurën e prokurimit me objekt ‘Blerje materiale hidraulike’, viti 2020, ku u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së mallrave, nuk rezultoi i plotë dhe i saktë. Konkretisht mallrat nuk rezultuan të shoqëruara me test raport fabrike, për pasojë nuk mund të konfirmohet saktësia dhe vërtetësinë e mallrave. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto mallra janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën OE A.C ka fituar tenderin dhe është likuiduar. Në këto kushte vlera **11,275,680 lekë** përbën **dëm ekonomik** për UK Fier dhe Buxhetin e Shtetit.

#### **3. G.C GKG**

-Në procesin e prokurimit me objekt: **“Blerje karburant Gazoil D1 dhe Benzinë”2020** ka marrë pjesë vetëm një operator ekonomik, G.C GKG SHPK. Nga shqyrtimi i dokumenteve të dorëzuara në sistemin e prokurimit publik, rezultoi se OE nuk ka paraqitur Licencën “Për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrat lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë”. Nga verifikimet e kryera në QKB, për licencat përkatëse OE, zotëron për rrethin e Shkodrës, licencën e lëshuar nga Bashkia Shkodër, për tregtimin për përdorim nga konsumatorët fundorë.

Në nenin nr. 46, të ligjit të LPP, kërkohet për kualifikimin që OE të zotërojë licencat profesionale, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, si dhe aftësitë teknike duke pasur pajisjet dhe asetet fizike për veprimtaritë e kërkuara për të cilat do të lidhet kontrata.

Më datë 09.06.2020, përfaqësuesi i OE, ka deklaruar se i përmbush të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe se e vërtetojnë këtë me certifikata e dokumente, të dorëzuar bashkë me deklaratën. Komisioni i vlerësimit të ofertave jo vetëm nuk duhet ta kualifikonte si fitues, por të kërkonte në Agjencinë e Prokurimit Publik për përjashtimin e kontraktorit nga pjesëmarrja në prokurimet publike, në mbështetje të nenit 13, pika 3/a të LPP-së. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 53, pika 3 i LPP. Gjithashtu, në kërkesat për kualifikim parashikohet se, mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri për kualifikim, rasti i mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s'kualifikim.

**Komenti i subjektit:** Nga ana e Titullarit të AK janë marrë masat për ti kërkuar APP dhënien e masave administrative 3 OE sipas atyre të rekomanduara.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht shkresës me nr. 1534 prot., datë 24.10.2022 UKF SHA ka bërë kërkesë në APP për përjashtimin e OE G.C GKG, me shkresën me nr. 1535 prot., datë 24.10.2022 UKF SHA ka bërë kërkesë në APP për përjashtimin e OE F.G dhe me shkresën me nr. 1536 prot., datë 24.10.2022 UKF SHA ka bërë kërkesë në APP për përjashtimin e OE A.C. Nga ana e APP është kthyer përgjigje përkatësisht për çdo rast si më sipër sipas shkresave të administruara në UKF SHA me nr. 544 prot., datë 26.01.2023 (OE G.C GKG), shkresa me nr. 634 prot.. datë 06.02.2023 (A.C) dhe shkresa me nr. 635 prot., datë 06.02.2023 (OE F.G), sipas të cilës nuk është disponuar dokumentacion i mjaftueshëm provues për nisjen e procedimit administrativ. Nisur nga sa më sipër rekomandimi konsiderohet *I pranuar* dhe *I zbatuar*.

## **MASA DISIPLINORE**

### **E.1. PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE**

*Mbështetur në nenet 37, 141 e 153, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, kontratave individuale të punës si dhe rregullores së brendshme të institucionit, i rekomandojmë Administratorit të UKF SHA, të marrë masat disiplinore si më poshtë:*

**“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”**, për punonjësin e mëposhtëm:

Z. E.E

- Për mangësitë e konstatuara gjatë auditimit të procedurave të prokurimit me objekt *‘Blerje materiale hidraulike, viti 2019’* dhe *‘Shpim pusi dublant nr. 3 B Kafaraj’* në cilësinë e punonjësit të angazhuar si anëtar i NJP, hartuesi të specifikimeve teknike si dhe të në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim në një rast me pasojë dëm ekonomik në shumën **9,671,436 lekë me TVSH;**

Z. E.C

Z. E.S

- Për mangësitë e konstatuara gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt *‘Blerje materiale hidraulike, viti 2019’* në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim me pasojë dëm ekonomik në shumën **11,275,680 lekë me TVSH;**

**“Vërejtje”**, për punonjësit e mëposhtëm:

Z. V.M

- Për mangësitë e konstatuara gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt *‘Blerje materiale hidraulike, viti 2019’* në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim me pasojë dëm ekonomik në shumën **9,671,436 lekë me TVSH;**

Znj. E.B

## Znj. S.C

- Për mangësitë e konstatuara gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt 'Shpim pusi dublant nr. 3 B Kafaraj' në cilësinë e personave të angazhuar si anëtare të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Pranueshmëria e rekomandimit: I pranuar

**Komenti i subjektit:** Nga ana e Titullarit të AK janë marrë masat për dhënien e masave disiplinore sipas atyre të rekomanduara.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht shkresave me nr. 1199 prot., datë 11.08.2022, nr. 200 prot., datë 11.08.2022, nr. 201 prot., datë 11.08.2022, nr. 203 prot., 11.08.2022, nr. 204 prot., datë 11.08.2022 dhe nr. 205 prot., datë 11.08.2022 janë zbatuar të gjitha rekomandimet në lidhje me dhënien e masave disiplinore. Për sa më sipër rekomandimet konsiderohen *Të pranuar* dhe *Të zbatuara*.

## **IV KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

Në përfundim të procesit të auditimit, nga Ujësjetës Kanalizime SHA Fier për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën nr. 248/9 prot., datë 05.09.2022 (*administruar në subjekt me nr. 1184 prot., datë 09.08.2022*), konstatohet se 42.4 % e rekomandimeve janë zbatuar dhe nga ana e subjektit janë zbatuar pjesërisht dhe janë në proces zbatimi rekomandimet në lidhje me arkëtimin e dëmeve si dhe ato për përdorimin e fondeve me efektivitet, efizienz dhe ekonomikitet. Duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore, si më poshtë:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** (*Gjetja nr. 8 e Masave Organizative të Raportit Përfundimtar të Auditimit*) UKF SHA ushtron aktivitetin në njësitë administrative: Qendër, Cakran, Dermenas, Levan, Mbrostar, Libofshë, Portëz, Frakull, Topojë si dhe në qytetin e Fierit. Shoqëria për ofrimin e shërbimeve në qytet apo në njësitë administrative ka në dispozicion 23 mjete në total të tipeve autovetura, skrepa, bote uji dhe kamionçina. Shpërndarja e karburantit për mjetet e Shoqërisë, kryhet ditore bazuar në kërkesat e përgjegjësve të sektorëve të cilat miratohen nga përgjegjësi i ofiçinës. Tërheqja e karburantit kryhet nëpërmjet kartave elektronike së bashku me fletë-daljen përkatëse nga magazina. Normativat për konsumin e karburantit për mjetet e Shoqërisë të cilat janë aplikuar për vitet 2019-2021, janë të miratuara nga Administratorit të Shoqërisë me shkresën nr. 98 prot., datë 30.01.2019, dhe shkresën nr. 191/1 prot., datë 28.02.2020.

-Janë audituar me zgjedhje shpenzimet mbi konsumin e karburantit për 8 automjete ku konstatohet se: Për këto mjete nuk janë mbajtur kartelat përkatëse në të cilat të regjistrohen të gjitha të dhënat e automjetit si dhe shpenzimet që do të kryhen për to gjithashtu duhet të jetë e evidentuar kilometrazhi i tyre në fillim të vitit dhe fund vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra, karburant, riparime etj. Këto shpenzime nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, për mirëmbajtje dhe shfrytëzimin e tyre.

Shpenzimet për konsumin e karburantit mbahen në dosjen e mjetit nga drejtuesi i automjetit ku pjesë përbërëse e dosjes janë edhe urdhri për përdorimin e mjetit, siguracioni vjetor, leje qarkullimi, kolaudimi kontrolli teknik (për të mjetet ndodhet kolaudimi i vitit 2021), kërkesa dhe autorizimi për lëvizjen e mjetit, fletë-dalja nga magazina e karburantit, fletë-udhëtimet.

Nisja e procesit të tërheqjes së karburantit fillon me kërkesës ditore e cila vjen nga sektorët përkatës për lëvizjen e mjetit. Kjo kërkesë miratohet nga përgjegjësi i ofiçinës. Më pas me fletë-daljen

respektive bëhet dalja nga magazina. Si dokumentacion justifikues në dosjen e cila mbahet nga drejtuesi i mjetit ndodhet edhe fletë-udhëtimi nënshkruar nga drejtuesi i mjetit i cili konfirmon lëvizjen e mjetit e nënshkruar nga përgjegjësi i ofiçinës. Gjithashtu në fletët e udhëtimit janë vendosur në total kilometrat e përshkruara dhe jo sa ka qenë kilometrazhi në fillim të lëvizjes dhe sa ka qenë në fund të lëvizjes për secilën urdhër shërbimi. Gjithashtu nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, për 4 automjete kilometrazhi i tyre nuk është në gjendje pune, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 07.08.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 19.

**1.1 Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë dhe Dega Teknike të merren masa që të kryhet riparimi i automjeteve në të cilat janë konstatuar defekte në aparatin e kilometrazhit, me qëllim kryerjen e rakordimeve ndërmjet kilometrave të paraqitura në fletët e udhëtimeve dhe lëvizjes faktike që kanë kryer mjetet.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** (Gjetja nr. 10 e Masave Organizative të Raportit Përfundimtar të Auditimit) Niveli i pagave i aplikuar për vitet 2019-2021 nga UKF SHA nuk është miratuar specifikisht nga Asambleja Aksionare (Bashkia Fier) por vetëm me Vendimin nr. 20, datë 03.10.2016, të Këshillit të Administrimit protokolluar në UKF SHA me nr. 946/1 prot., datë 05.10.2016. Organet drejtuese të Shoqërisë, Këshilli i Administrimit dhe Administratori e kanë quajtur të ezauruar miratimin e nivelit të pagave vetëm me miratimin e programit ekonomik ku pjesë e tij është edhe fondi i pagave. Në opinionin e grupit të auditimit ka keq interpretim nga organet drejtuese të Shoqërisë të Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve” i ndryshuar, neni 6, pika 1. Gjithashtu duke u bazuar nivelit të pagave të aplikuar për vitet 2019-2021 konstatohet se, për të njëjtin pozicion pune punonjësit nuk janë trajtuar me të njëjtin nivel page konkretisht, për kategorinë Specialist të Drejtorive apo Zyrave trajtohen me nivele të ndryshme pagash ku variojnë nga 34,000 lekë deri në 50,000 lekë për pagë bazë.

**2.1 Rekomandimi:** Nga Administratori dhe Këshilli Administrimit të merren masat për të hartuar dhe miratuar sipas kompetencave statusore një rregullore, ku të parashikohen kriteret e caktimit të pagës brenda limit të miratuar për pozicionet e punës për kategorinë specialist të drejtorive dhe zyrave të Shoqërisë.

*Në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** (Gjetja nr. 34 e Masave Organizative të Raportit Përfundimtar të Auditimit) Shoqëria UK Fier ka në zotërim objekte, troje, ndërtesa, depo uji, ujësjellës etj., për të cilat nuk disponon certifikatat e pronësisë. Drejtuesit dhe personat përgjegjës për certifikimin e pasurive të Shoqërisë UK Fier duket se kanë vepruar në mënyrë formale dhe janë mjaftuar vetëm me përgatitje shkresash apo aplikime në ZVRPP-të përkatëse dhe nuk e kanë ndjekur këtë çështje të rëndësishme në mënyrë këmbëngulëse. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Nenin 158/dh i Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar. Veprimet dhe mosveprimet në përputhje me ligjin rrisin riskun për humbjet në aktivet e shoqërisë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 36, të Raportit të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë të ndërmerren hapa konkretë për këtë problematikë pasi numri i aseteve të Shoqërisë të pa regjistruara është relativisht i lartë. Regjistrimi dhe certifikimi i tyre sa më shpejtë ndikon në mënyrë direkte në uljen e riskut të humbjeve në aktivet e shoqërisë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1. Gjetje nga auditimi:** (Gjetja nr. 1 e Masave për Eliminimin e Efekteve Negative të Konstatuara në Administrimin e Fondeve Publike dhe për Menaxhimin me Ekonomicitet, Eficiencë dhe Efektivitet të Fondeve Publike të Raportit Përfundimtar të Auditimit) Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime” SHA. Fier, përfaqësuar nga ish administratori i shoqërisë A.P., autorizuar me vendimin nr.1 të asamblesë së përgjithshme të datës 14.07.2010, ka lidhur aktmarrëveshjen për “Furnizimi, instalimi dhe financimi i një sistemi elektronik të matjes së ujit” mes shoqërisë “T” S.A., me seli në Athinë, Greqi e përfaqësuar nga Constantin Aloupis administrator i Shoqërisë dhe shoqërisë “T” S.A. Marrëveshja është lidhur dhe zbatuar në kundërshtim me dispozita ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë në fushën e prokurimit, financiare, të ndërtimit, si dhe në kushte ekonomiko financiare të disfavorshme për shoqërinë. Aktmarrëveshja e lidhur nga shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime” SHA. Fier, kishte si subjekt blerjen, instalimin, testimin dhe shpërndarjen e 37,224 aparate matës të ujit EËMS, (Furnizim dhe instalim i një sistemi elektronik i matjes së ujit), dhe njësitë e mbledhjes së të dhënave, qendrës së menaxhimit të tyre dhe sistemit të faturimit. Vlera e kontratës ishte në shumën 5,314,830 Euro, pa TVSH. Në pikën 12, të kontratës është përcaktuar se një degë e kompanie T. SHA., do të krijohet pas nënshkrimit të kontratës për zbatimin e saj. Në Shtojcën 3, të kontratës janë përcaktuar termat e Pagesës së Projektit. Nga ana tjetër, midis Ujësjiellës Kanalizime Fier SHA (P1) dhe T S.A. në këtë kontratë palët kanë parashikuar në nenin 1 se: ,1.1 Barrëdhënësi në këtë marrëveshje vendos në favor të Barrmarrësit një barrë siguroese mbi: (i) Të gjitha të ardhurat që rrjedhin nga: a- Kontrata datë 30.07.2010, lidhur ndërmjet, T” SHA, S. INC dhe Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Fier SHA, ndryshuar. (i) çdo të ardhur shtesë, interesa dhe në përgjithësi çdo kredi që rrjedhin nga këta kontrata. Më datë 12.11.2010, midis palëve kontraktore UK Fier SHA., dhe T SA, dhe S. Inc është vendosur që T SA ia transferon të gjitha të drejtat dhe detyrimet shoqërisë T. SHPK me T SA si aksionar i vetëm. Me shkresën nr. 302/2, datë 13.06.2010, administratori i shoqërisë A.P., ka njoftuar anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës për tematikat e mbledhjes së radhës, ku përfshihet dhe miratimi i vendimit për Drejtorin e Përgjithshëm për të vepruar në emër të UK Fier SHA., për financimin dhe instalimin përfundimtar të matësve dhe sistemit të transmetimit Wireless në zonën e shërbimit. Me vendimin nr. 544 Prot., datë 21.10.2010, asambleja e aksionarëve e përfaqësuar nga M.F, ka marrë vendimin për marrjen e garancisë bankare pranë T.B për investimin e matësve elektronikë të ujit ku autorizon ish administratorin A.P., të përfaqësoj Aksionarët e UK Fier Sha, në kryerjen e veprimeve, si kontrata e garancisë bankare, kontratat e hipotekimit në favor të T.B, për pronat (ndërtesat administrative, zyrat e sektorit, zyrat e arkave etj.) në pronësi të UK Fier. UK Fier do të vendosë si garanci të gjithë të ardhurat që ka nga biznesi, këto të ardhura 100 %, do të bëhet vetëm nga llogaria e T.B, për sa kohë vazhdon afati i garancisë, dhe llogaria do të administrohet nga T.B, duke i kryer pagesat fillimisht vetëm për tatime, sigurime shoqërore, paga dhe të gjitha pagesat e tjera vetëm nëse ishte paguar T. SHPK.

Me shkresën nr. 770/1 Prot., datë 12.01.2011, administratori që zëvendësoi z. A.P., ka njoftuar T. SHPK, për ndërprerjen e punimeve, ku e njofton se stafi i UK Fier nuk ka informacionin tekniko-financiar dhe ligjor për projektin, nuk ka asnjë projekt preventiv të miratuar apo kryer oponentë nga organet përkatëse si dhe leje ndërtimi sipas ligjit të urbanistikës. Gjithashtu është kërkuar ndërprerja e zëvendësimit të matësve të ujit në dy lagje, pasi janë vendosur në vitin 2007 nga kredia e Bankës Botërore e cila është akoma në shlyerje dhe janë asetet e UK Fier. Me vendimin nr. 544,



datë 21.10.2010, Asambleja e Aksionerëve të UK Fier, përfaqësuar nga znj. M.F, ka vendosur të aplikohet për dhënien e garancisë bankare duke autorizuar administratorin për lidhjen e kontratës me T.B. Më datë 12.11.2010 mes palëve UK Fier dhe T dhe S. Inc është bërë amendimi i kontratës duke shtuar faktin se pala T dhe S. Inc merr përsipër kryerjen e shërbimit të billingut në favor të UK Fier për një afat 5 vjeçar, përkundrajt pagimit të një vlere prej 500 euro në muaj. Më datë 22.11.2010 mes palëve D.C.I.A dhe UK Fier është lidhur kontrata e mbikëqyrjes së punimeve të furnizimit, instalimit të sistemit të ri të matësve elektronikë me vlerë 45,000 euro, me afat 18 muaj. Me shkresën nr. 953 Prot., datë 06.04.2011, administratori i ka dërguar T.B, vendimin e asamblesë së ortakëve nr. 06 Prot., datë 30.03.2011 për pezullimin e kontratës “Furnizimi, instalimi dhe financimi i një sistemi elektronik për matjen e ujit”, si dhe pezullimin e kontratës së fillestare të lidhur me T SA dhe S. Inc, për arsye se nuk janë zbatuar procedurat e prokurimit publik, si dhe për kontratën për dhënie garancie nuk janë zbatuar dispozitat e ligjit nr. 9869 datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar. Kërkesat e administratorit nuk janë marrë në konsideratë nga T.B, në përgjigjen nr. 8062 Prot., datë 21.04.2011. Më datë 15.05.2011 është ndryshuar kontrata midis shoqërive me shkakun se të dyja palët shohin mundësinë e riorgazimit të kushteve të pagesës, zgjerimit të financimit dhe ndihmës për organizimin e instalimit të pajisjeve në varësi të kontratës së CEZ. Shoqëria T. SHPK ka lidhur Kontratë me T.B, për Kredi Afatmesme Nr. Co. 466/03.11.2010 ndryshuar me Shtojcë Kontratë për Kontratë për Kredi Afatmesme nr. Co. 466/6.09.2012 për një kredi në shumën Euro 2,188,986.89, me T.B, si dhe siguron pagimin e çdo shume që Barrëdhënësi, i detyrohet Barrëmarrësit në bazë të kontratave të sipërpërmendura. Për periudhën 2010, T. i ka faturuar UK Fier vlerën 539,719 Euro, për “Software and control room” situacion, me faturën tatimore nr. 1, datë 21.12.2010, pranuar nga ish administratori A.P. Më datë 12.01.2011, D.T, i ka dërguar UK Fier, shkresën për pagesën e faturës nr. 2, për dhomën e kontrollit dhe për 620 matësa të montuar në terren, duke certifikuar punimet, për vlerën 392,721 Euro. T. SHPK, me shkresën n.r 1327 Prot., datë 27.09.2011, i drejtohet administratorit të ri S.T, për pranimin e faturave tatimore të mësipërme, të refuzuara nga administratori i mëparshëm, veprim sipas tij i paligjshëm dhe nga Zyra e Tatim Taksave, e cila pas kontrollit të kryer, bëri kallzim penal në Prokurorinë e Rrethit Fier, ndaj UK Fier për mos deklarim faturash. Më datë 25.11.2011, Këshilli Mbikëqyrës i përbërë nga A.M kryetar, Q.H, S.Gj, I.Gj dhe K.S anëtarë, kanë miratuar projektet e ndryshme të Drejtorisë Teknike, për vendosjen e matësve të rinj, si përcaktimin e preventiveve dhe vlerave finale që duhet të pagojnë klientët për instalimin dhe përfitimin e shërbimit. Ka ngarkuar administratorin për zbatimin e situacioneve 1 dhe 2, dhe zbatimin e vendimit. Më datë 18.01.2012, Këshilli Mbikëqyrës ka ngarkuar administratorin për marrjen në dorëzim të 1300 matësve të instaluar nga T.. Më datë 01.03.2014, shoqëria T., me shkresën nr. 16 Prot., ka njoftuar UK Fier se do ndërpresë kontratën për moszbatim të kushteve dhe se do ta dërgojë në Gjykatën e Arbitrazhit duke kërkuar minimalisht 4,460,000 Euro dëmshpërblim. Këshilli Mbikëqyrës dhe Asambleja e Ortakëve kanë autorizuar administratorin për pajtimin e një studio ligjore. Pas vlerësimit të ofertave, UK Fier ka lidhur kontratë për konsulencë ligjore me studion “H. & H.”. Më 26.06.2014, administratori S.T ka nënshkruar një aneks kontrate me T., ku pranon detyrimin e faturuar në vlerën 2,115,342 Euro dhe përveç kësaj vlere dhe vlerën 316,025 Euro për 3500 matësa të montuar por të pafaturuar. Gjithashtu pranon se si rezultat i paafetësisë së UK Fier për përmbushjen e pagesave kontraktore dhe sigurimit ndaj T. të një garancie bankare, kjo e fundit ka mundur të instalojë gjatë 4 viteve vetëm 17,600 matësa. Me nënshkrimin e kësaj aneks kontrate T. është dakord të ndërpresë procedurat për ndërprerjen e kontratës dhe ndjekjen ne Gjykatën e Arbitrazhit. Në mënyrë që UK Fier ti paguajë detyrimin prej 2,115,342 euro, do të transferojë në favor të T. të gjitha aktivitetet e departamentit të shitjes, duke

përfshirë dhe aktivitetin e faturimit për një periudhë jo më shumë se 5 vjet. UK Fier i ka kaluar T. të drejtën për të gjithë llogarinë e klientëve në shumën 592,000,000 lekë, duke i dhënë të drejta për lidhje marrëveshje, ndërprerje të furnizimit me ujë, mbledhjen e të ardhurave nga lidhjet e reja, Gjithashtu 25 punonjës të UK Fier, faturistë do të kalojnë në T., dhe UK Fier do të paguar një kosto 5000 euro për shërbimin. UK Fier do ti sigurojë T. akses të plotë për të dhënat e numrit të përdoruesve, llogaritë bankare, numrin e punonjësve etj. Kohëzgjatja e kontratës është pesë vjet. Asambleja e Aksionerëve me vendimin nr. 81 Prot., datë 31.03.2015, ka miratuar kalimin e detyrimeve të arkëtueshme nga shoqëria A te T.. Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar largimin e administratorit S.T dhe emërimin e P.N, më datë 05.09.2016. Më datë 23.09.2016, T., përfaqësuar nga C.A, i ka dërguar UK Fier, lajmërim për ndërprerje kontrate, si rezultat i mospagesave duke kërkuar pagesën e detyrimit të mbetur prej 1,800,000 euro dhe vlerën minimale prej 2,200,000 euro si kompensim për fitimin e munguar dhe dëme. Nëse nuk paguhen ose nuk lidhet kontratë tjetër, T. do ta dërgojë çështjen për zgjidhje në Gjykatën e Arbitrazhit. Më datë 09.01.2017, me shkresën nr. 3 Prot., administratori P.N, i është përgjigjur njoftimit të T., se zbatimi i kontratës mes palëve ka pasur probleme teknike si mos funksionimi i matësve, nuk kanë mundur të lexohen on-line, nuk ka pasur rritje të arkëttimeve, kanë faturuar për menaxhimin e shitjeve në total vlerën 469,200 Euro, kur stafi i drejtorisë së shitjes është paguar nga UK Fier, matësit e instaluar në vitin 2008 nga financimi i Bankës Botërore në vlerën 113,000,000 lekë, nuk janë dorëzuar në UK Fier. Gjithashtu UK Fier nuk ka konfirmuar asnjëherë marrjen në dorëzim të matësve të instaluar. Më datë 10.01.2017, me shkresën nr. 12/1 Prot..administratori i UK Fier i ka kthyer faturën e T., duke mos e pranuar. Për periudhën 2010 deri ne 31.08.2016 nga zbatimi i kontratës me shoqërinë T.-A. me objekt “Për furnizimin dhe instalimin e një sistemi elektronik te matjes se ujit” rezultojnë të kryera pagesa në vlerën 280,019,352 lekë. Më datë 23.01.2017, Banka Tirana ka filluar procedurat gjyqësore për marrjen e detyrimit prej 2,456,000 euro që ka akumuluar shoqëria T. ndaj bankës, duke u mbështetur në marrëveshjen sigurorese të lidhur në vitin 2010, ku ishte palë dhe UK Fier sha. Me vendimin nr. 62 , datë 08.02.2022, Gjykata e Rrethit Fier, ka vlerësuar si të pabazuara në ligj kërkesat e T.B. Aktmarrëveshja e lidhur ndërmjet shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” SHA. Fier, dhe shoqërisë **është kryer pa zbatuar procedurat e prokurimit**, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, çka ngarkon me përgjegjësi Administratorin e Shoqërisë, Këshillin Mbikëqyrës dhe Këshillin Bashkiak. Lidhja e kësaj marrëveshje është kryer, pa hartuar plan biznesin përkatës për shlyerjen e kësaj kredie, efektivitetin e saj, dhe në një kohë kur Shoqëria Ujësjetllës Sha, Fier, nuk kishte aftësi paguese për shlyer këtë kredi. Në kundërshtim me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009, “Për miratimin e modelit të rregullores për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjetllës kanalizimeve SHA”, pika 2.7, Ujëmatësit, vlera e matësve nuk i’u është faturuar konsumatorëve por është mbajtur si kosto e shoqërisë.

#### **Vlera 280,019,352 lekë përbën efekt ekonomik negativ për UK Fier.**

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi administratorin e shoqërisë, Këshillin mbikëqyrës dhe Këshillin bashkiak, të cilët kanë aprovuar dhe kryer vendimet për lidhjen e kontratës, vënien e garancive si dhe mos marrjen e masave gjatë zbatimit të kontratës, veprime këto në kundërshtim me nenin Neni 16 “Abuzimi me detyrën dhe formën e shoqërisë”, i Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, ligjin nr. 10,081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet

në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 956, datë 09.05.2012 “Për një ndryshim në VKM nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat”, Udhëzimi i METE nr. 315, datë 08.04.2009 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, i ndryshuar udhëzimin e MZHETS nr. 394, datë 21.08.2-14 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësijellës Kanalizimeve SHA.

**1.1 Rekomandimi:** Këshilli i Administrimit të shoqërisë UK Fier SHA., të analizojë me përgjegjshmëri dhe prioritet situatën e krijuar me kontratën për montimin e matësve elektronik, duke kërkuar ekspertizë tekniko/ligjore nga ekspertët përkatës për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Këshilli i Administrimit të shoqërisë të shqyrtojë procedurat e lidhjes dhe zbatimit të kontratës, duke dokumentuar shkeljet, mos zbatimet me qëllim përdorimin e fondeve publike me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

**2. Gjetje nga auditimi:** *(Gjetja nr. 4 e Masave për Eliminimin e Efekteve Negative të Konstatuara në Administrimin e Fondeve Publike dhe për Menaxhimin me Ekonomicitet, Eficiencë dhe Efektivitet të Fondeve Publike të Raportit Përfundimtar të Auditimit)* Për vitet 2019-2021 auditimi janë ekzekutuar në total 3 vendime gjyqësore lidhur me humbjen e proceseve gjyqësore në të cilat ka qenë e paditur Shoqëria Ujësijellës Kanalizime SHA Fier nga ish-punonjësit e saj mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Në total është ekzekutuar detyrimi në shumën 1,349,984 lekë konkretisht për periudhën nga data 01.01.2019, deri më 15.04.2022, (nga të cilat për vitin 2020 në shumën 326,266 lekë ndërsa për vitin 2022 nga data 01.01.2022, deri më 15.04.2022, në shumën totale 1,023,718 lekë nga të cilat 110,038 lekë tarifë përmbartimore si dhe 913,680 lekë procesi gjyqësor). **Shuma 1,349,984 lekë përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Shoqërisë Ujësijellës Kanalizime SHA Fier.** Gjithashtu janë duke u gjykuar edhe 7 procese gjyqësore në Gjykatën e Apelit të Vlorës, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kontratat kolektive dhe kontratat individuale të punës dhe rregulloret e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Shoqërisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 22, të Raportit të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** Nga Shoqëria të analizohen në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përmbartimore, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë duke evidentuar përgjegjësitë individuale, si dhe në të ardhmen të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** *(Gjetja nr. 7 e Masave për Eliminimin e Efekteve Negative të Konstatuara në Administrimin e Fondeve Publike dhe për Menaxhimin me Ekonomicitet, Eficiencë dhe Efektivitet të Fondeve Publike të Raportit Përfundimtar të Auditimit)* Nga verifikimi i gjendjes debitore në sistemin tatimor u konstatua se shoqëria ka detyrime të cilat janë ngarkuar në sistemin tatimor nga aktet e kontrollit të inspektorëve tatimorë për periudhën 2013-2014, në vlerën 1,762,272 lekë, nga të cilat 1,318,910 lekë janë gjoba të regjistruara dhe 443,362 lekë janë interesa të maturuara. Në principalin prej 1,318,910 lekë, 110,000 lekë janë gjoba mbi fitimin, 7,641 lekë për tatimin e mbajtur në burim, 91,114 lekë për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, 546,357 lekë dhe interes i maturuar në vlerën 419,983 lekë për kontributet shoqërore, si dhe 563,798 lekë gjoba për mos mbajtje të saktë të librave, regjistrave dhe dokumentacionit. Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në

Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Vlera **1,762,272 lekë përbën efekt financiar negativ** për shoqërinë.

**3.1 Rekomandimi:** Këshilli i Administrimit të marrë masa për vlerësimin e gjobave të vendosura nga organet tatimore, duke gjykuar nëse vlerësimet e lëna nga inspektorët janë të drejta apo të apelueshme, nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse, pagesat e detyrueshme nga organeve tatimore. Këshilli i Administrimit të marrë masa për trajnime dhe përditësime të personelit lidhur me detyrimet e institucionit për zbatimin e procedurave tatimore e fiskale.

*Menjëherë*

*Në lidhje me masat e konstatuara në proces zbatimi, nga ana e subjektit të audituar Ujësjetllës Kanalizime SHA, Fier të vijojnë përpjekjet duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore deri në zbatimin e plotë të tyre.*

### **3.2 UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN SH.A.**

#### **PËRMBLEDHJE**

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të lartë të shtetit ” dhe të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH, Nr. 1, datë 04.11.2016, “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacion që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit rekomandimeve të KLSH ”.

Duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- a. Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së, të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2022, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjektet e audituara, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- b. Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike, të akteve administrative të nevojshme, si vendime e urdhra për zbatimin e masave organizative;
- c. Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

**Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:**

#### **I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.**

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a., nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, duke mos respektuar kështu afatin 20 ditor të dërgimit.

#### **II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.**

-Në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a., nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, duke mos respektuar kështu afatin 6 mujor të dërgimit.

### **III. Rekomandimet e KLSH**

Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a, i ka trajtuar rekomandimet e lëna nga auditimi i KLSH dhe në lidhje me to i ka zbatuar si më poshtë vijon:

- Nga 26 masa organizative të rekomanduara gjithsej për 24 gjetje, 4 janë zbatuar plotësisht , 2 janë zbatuar pjesërisht, 3 janë në proces zbatimi dhe nuk janë zbatuar 17, nuk janë pranuar 0 .

-Nga 1 masë për shpërblim dëmi të rekomanduar gjithsej për 1 gjetje dhe në vlerë totale 40,771,612 mijë lekë, nuk është zbatuar 1, nuk është pranuar 0.

-Nga 1 masë disiplinore të rekomanduar gjithsej, 1 është zbatuar .

### **IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH**

<b>Nr.</b>	<b>Lloji i rekomandimit</b>	<b>Rekomanduar</b>	<b>Pranuar Plotësisht</b>	<b>Pa pranuar</b>
1	Organizative	26 masa	26 masa	0
2	Për shpërblim dëmi ekonomik	1 masë	1 masë	0
3	Disiplinore	1 masë	1 masë	0

### **V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit**

<b>Nr.</b>	<b>Lloji i rekomandimit</b>	<b>Pranuar</b>	<b>Statusi i zbatimit</b>			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	26 masa	4 masa	2 masa	3 masa	17 masa
2	Për shpërblim dëmi ekonomik	1 masë	0	0	0	1 masë
3	Disiplinore	1 masë	1 masë	0	0	0

#### **I/1. HYRJA**

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 702/1 Prot, datë 04.08.2023, me objekt: “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022”.

Auditimi është kryer nga:

B.SH, *anëtar*

K.H, *anëtar*

Periudha e auditimit: 01.01.2022 – 30.06.2022

Afati i auditimit: 07.08.2023 - 08.09.2023

#### **I/2 OBJEKTI AUDITIMIT**

Zbatimi i masave të rekomanduara të dërguara me shkresën e KLSH me shkresat e cituara në pikën I/4 të këtij Raporti, për auditimin e ushtruar në Ujësjetllës Kanalizime Elbasan Sh.A.

#### **I/3 QËLLIMI AUDITIMIT:**

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tre-mujorit

të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3, të nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

#### **I/4 METODOLOGJIA E AUDITIMIT**

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që lidhet me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen të subjekteve të audituara.

#### **I/5 KONKLUZIONI**

Në Ujësjellës Kanalizime Elbasan SHA, në mospërputhje me nenin 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", nuk janë marrë masa për respektimin e afatit ligjor prej 20 ditësh për të informuar KLSH-në mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Gjithashtu, në Ujësjellës Kanalizime Elbasan SHA, në mospërputhje me nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", nuk janë marrë masa për dërgimin e informacioneve në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit 6 mujor.

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga Ujësjellës Kanalizime Elbasan SHA, me shkresat e cituara në pikën I/4 të këtij Raporti, rezulton se:

-Nga 28 masat e rekomanduara, nga subjekti janë pranuar 28 masa ose në masën 100 %. Nga 28 masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 5 masa ose 17 % e tyre, janë zbatuar pjesërisht 2 masa ose 7 %, janë në proces zbatimi 3 masa ose 10 % dhe janë pa zbatuar 18 masa ose 66 %.

Në numër dhe në % statusi i masave organizative paraqitet:

<b>Nr.</b>	<b>Statusi i masave të marra nga KLSH</b>	<b>Në numër</b>	<b>Në %</b>
1	Totali	28	
2	Pa pranuar	0	0%
3	Pranuar	28	100%
	<b>Nga të pranuarat:</b>		<b>Në % ndaj të pranuarave</b>
1	Zbatuar plotësisht	5	17%
2	Zbatuar pjesërisht	2	7%
3	Pa zbatuar	18	66%
4	Në proces	3	10%

#### **II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE**

Zbatimi i plotë i rekomandimeve është në nivelin 17 %, së bashku me rekomandimet që janë në proces zbatimi në nivelin 10 %, shkon në total në nivelin 27 %. Pavarësisht përpjekjeve të subjekteve për marrjen e masave për zbatimin e tyre, përsëri rekomandimet e pazbatuara mbeten në nivel relativisht të lartë në masën 66 %.

#### **III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM**

III/1-Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".

Në Ujësjellës Kanalizime Elbasan SHA, në mospërputhje me nenin 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", nuk janë marrë masa për respektimin e afatit ligjor prej 20 ditësh për të informuar KLSH-në mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

*III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

Në Ujësjellës Kanalizime Elbasan SHA, në mospërputhje me nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", nuk janë marrë masa për dërgimin e informacioneve në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit 6 mujor.

*III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:*

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në 7 raste për vlerën 9,307 mijë lekë me TVSH janë kryer shpenzime për blerje Hipoklorit Natriumi pa dokumentacion të plotë vërtetues. Konkretisht certifikatat e origjinës janë me logo nga Shoqëria "2.CH" shpk të firmosura nga Administratori i Shoqërisë N.Sh. Specifikat (raport analize dhe skedë sigurie) për furnizimin, janë me logo "2.CH" shpk Korçë të firmosura nga Administratori N.Sh, të pa firmosura në 2 raste nga kimisti/kimistja që ka bërë analizën. Faturat nuk shoqërohen me certifikatën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik, ose dëshmi të lëshuara nga autoritete/institucione/ente të autorizuar për lëshimin e tyre, për analizë toksikologjike për NaOCl (hipoklorit natriumi) të marrë brenda tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, referuar kërkesave për kualifikim pikës 2.3.3 të kapacitetit teknik (shtojcë datë 06.02.2020), për pasojë nuk mund të verifikohet zbatimi/ose jo i specifikimeve (shtojca 10 e dokumenteve të tenderit) Shtojca 6 "Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik" dhe neni 9/1 i kontratës "Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Për pasojë raporti i analizës specifikat (raport analize dhe skedë sigurie) nga laborator "2.CH" shpk Korçë, është dokument i pavlefshëm, pasi ky laborator nuk është i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme Kalibrimi.

Për posë sa mësipër, nuk ka gjurmë (dokumentacion) të kthimit nga litra në kg, referuar nivelit të depozitës së klorinit para furnizimit, mbas furnizimit dhe koficientët e përdorur për kthimin nga litra në kg.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 116/2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 5, pika 1 dhe 4, Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nr. 145 prot, datë 16.03.2018, Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me ndryshimet vijuese të

tij, neni 7, Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 35 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 43-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

**1.1. Rekomandimi:** Administratori i Shoqërisë të sigurojë marrjen e veprimeve korigjuese në mënyrë që të gjitha shpenzimet për blerjen e Hipoklorit të Natriumi të bëhen në përputhje me Standardet Teknike të parashikuara në specifikimet teknike.

**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Lidhur me këtë rekomandim financa ka raportuar se çdo shpenzim për blerjen e Hipoklorit Natriumi është bërë duke plotësuar dokumentacionin përkatës, përfshirë edhe analizat e bëra nga ISKSH.

**Zbatuar**

**2. Gjetje nga auditimi:** Në 8 raste për vlerën 5,187 mijë lekë me TVSH janë kryer shpenzime për blerje karburant (dizel dhe benzinë) pa dokumentacion të plotë vërtetues.

Faturat nuk shoqërohen me raport analizë para zhdoganimit, të lëshuar nga Laboratori i Kontrollit të Naftës dhe Gazit, (Drejtoria e Laboratorit Qendror të Kontrollit, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial), për pasojë nuk mund të verifikohet zbatimi/ose jo i specifikimeve teknike (shtojca 9 e dokumenteve të tenderit) Shtojca 6 “Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik” dhe neni 9/1 i kontratës “Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor”. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 60, pika 1, Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 35 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 43-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

**2.1. Rekomandimi:** Administratori i Shoqërisë të sigurojë marrjen e veprimeve korigjuese në mënyrë që të gjitha shpenzimet për blerjen e karburant (dizel dhe benzinë) të bëhen në përputhje me Standardet Teknike të parashikuara në specifikimet teknike.

**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Lidhur me këtë rekomandim financa ka raportuar se janë marrë masa korigjuese dhe të gjitha shpenzimet për blerjen e karburant (dizel dhe benzinë) janë bërë me dokumentacionin përkatës bashkangjitur.

**Zbatuar**

**3. Gjetje nga auditimi:** Në 13 raste për vlerën 69,210 mijë lekë me TVSH janë kryer shpenzime për blerje materiale hidraulike. Proces verbalet e marrjes në dorëzim janë të firmosura nga grupet e marrjes në dorëzim, duke mos cilësuar zbatimin ose jo të specifikimeve teknike (shtojca 9 e dokumenteve të tenderit) Shtojca 6 “Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik” dhe neni 9/1 i kontratës “Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë



konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 60, pika 1, Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 35 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 43-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

**3.1. Rekomandimi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor duhet të nxjerri urdhër/urdhra me qëllim ndjekjen me përpikmëri të zbatimit të kontratave, duke përfshirë dhe marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara, për sasinë, cilësinë, llojin si dhe dokumentacionin shoqërues të tyre.

Statusi i pranimit: **Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Lidhur me këtë rekomandim financa ka raportuar se bashkëlidhur marrjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara, është dhe dokumentacioni shoqërues i tyre.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se pavarësisht se përcaktohet sasia, lloji dhe çmimi nuk është përcaktuar nëse janë konform specifikimeve teknike ose jo.

**Pa zbatuar**

**4. Gjetje nga auditimi:** Në 8 raste për vlerën 6,000 mijë lekë me TVSH janë kryer shpenzime, me dokumenti justifikues (faturë) të firmosur dhe vulosur vetëm nga furnitorët. Faturat nuk janë firmosur nga blerësi dhe transportuesit. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Ligjin nr. 83/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 2, 6, dhe 7, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 43-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

**4.1. Rekomandimi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor duhet të nxjerri urdhër/urdhra me qëllim ndjekjen me përpikmëri të kryerjes së shpenzimeve me dokumentacion të plotë dhe të saktë vërtetues.

Statusi i pranimit: **Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Faturat në vazhdimësi janë të gjitha të fiskalizuara në sistemin online.

**Pa zbatuar**

**5. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër transfertë datë 27.07.2020 nëpërmjet B. Bankë është likuiduar personi fizik K.S për vlerën 703,096 lekë. Dokumenti justifikues faturë tatimore shitje me numër 143, datë 29.04.2020, e cila cilëson dizifektive Covi-19. Nuk ka asnjë dokument tjetër, nuk cilëson dezinfektim i brendshëm ose i jashtëm. Nuk ka të përcaktuar produktet biocide që do përdoren për dizifektim, të cilat duhet të jenë në listën e miratuar nga Ministri i Shëndetësisë, të kenë veprim baktericid, fungicid dhe virusicid, nuk duhet të shkaktojnë efekte anësore që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, si dhe nuk duhet të kenë ndikim negativ në mjedisë.

Nuk është përcaktuar sasia dhe grafiku, mënyra e dezinfektimit me spërkatje mjegullës në të ftohtë, mjetet e përdorura (pompa /cantë shpine me presion etj. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin e përbashkët të Agjencisë së Prokurimit Publik me nr. 2857 prot, datë 06.05.2020 dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 2163 prot, datë 06.05.2020 “Për përcaktimin e listës së mallrave dhe shërbime për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia Covid-19 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 43-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1. Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa për të korrigjuar praktikën e dezinfektit të brendshëm ose të jashtëm ambienteve të punës, me qëllim jo vetëm kryerja e tyre të bëhet me produktet biocide të cilat nuk duhet të shkaktojnë efekte anësore që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, si dhe nuk duhet të kenë ndikim negativ në mjedis.

**Statusi i pranimit: Pranu**

**Përgjigje nga subjekti:**

Nga verifikimi i akt-konstatimeve dhe observacioneve të derguara pranë KLSH është argumentuar se praktika e dezinfektit të brendshëm ose të jashtëm ambienteve të punës, kryerja e tyre është bërë me produktet biocide të cilat nuk duhet të shkaktojnë efekte anësore që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, si dhe nuk duhet të kenë ndikim negativ në mjedis. Nuk është kryer asnjë praktike tjetër lidhur me dezinfektit të brendshëm ose të jashtëm ambienteve të punës.

**Pa zbatuar**

**6. Gjetje nga auditimi:** Në 7 raste në vlerën 348,655 mijë lekë kriteret e veçanta për kualifikimit nuk janë vendosur plotësisht konformë akteve ligjore dhe rregullatore për prokurimet publike. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2009, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 5, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, kreu III, pika 1/a, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 09.02.2011, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, i ndryshuar, shkresën e Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 72-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1. Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor, në vijimësi duhet të hartojë kërkesat e veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë.

**Statusi i pranimit: Pranu**

**Përgjigje nga subjekti:**

Në kuader të riorganizimit të shoqërive UK mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe pëpunimit të ujërave të ndotura”, marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës- Kanalizime Elbasan Sh.a datë 22.07.2022 lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkive Elbasan, Librazhd, Peqin, Cërrik, Belsh, Gramsh është krijuar shoqëria e re aksionare “**Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a**” me numër nipti **M23322201V**, dhe si rezultat i saj shoqëria UK filluan procesin e riorganizimit dhe nuk është zbatuar si rekomandim nga UK Elbasan sepse shoqëria nisi procedurat për agregim.

**Pa zbatuar**

**7. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit me objekt “Hipoklorit natriumi, viti 2020-2021, në vlerën 14,248 mijë lekë, “Blerje materiale hidraulike, viti 2021 në vlerën 35,000 mijë lekë, “Blerje matësa uji individuale ½, ¾ dhe 1, viti 2019”, në vlerën 10,668 mijë lekë, përlllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, etj). Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 72-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**7.1. Rekomandimi:** Nga Autoriteti Kontraktor të merren masa që përlllogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit publik, të vlerësohet si procedurë e rëndësishme, pasi nga zbatimi i procedurave të përzgjedhjes të prokurimit publik, varet saktësia e kësaj vlere, por dhe efektiviteti maksimal i shpenzimeve publike.

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Është mbajtur në konsideratë në procedurat e prokurimit të zhvilluara.

**Proces zbatimi**

**8. Gjetje nga auditimi:** Në 5 procedura prokurimi për vlerën 244,882 mijë lekë, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46, neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, neni 66 pika 3, Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” nenet 108-118 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 62-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**8.1. Rekomandimi:** Nga Shoqëria t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi procesi i shqyrtimit, kualifikimit dhe shpallja fitues të operatorëve është me rëndësi kapitale.

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Është mbajtur në konsideratë në procedurat e prokurimit të zhvilluara.

**Proces zbatimi**

**9. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit me objekt “Instalimi i teknologjive të reja në stacionet e pompimit në sistemin Mengël-Samurr-Godolesh,(për zëvendësimin e pompave dhe pajisjeve viti 2019, në vlerën 56,418 mijë lekë dhe procedurën e prokurimit “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm ekzistues të linjave në Rrugët “11 Nëntori”, Rruga “Ali Çausi”, Rruga “Faik Neziri”, Rruga “Veli Stafa”, një pjesë të Lagjes “Çlirimi” dhe “11 Nëntori” të Bashkisë Elbasan, viti 2019 në vlerën 23,002 mijë lekë, nuk është siguruar kontrata për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve, humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta, si dhe deri në datën e hartimit të këtij konstatimi Autoriteti Kontraktor, nuk ka zgjatur periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose nuk ka bërë vet siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit. Veprim në

kundërshtim me neni 25 të kontratës së lidhur, pika 1 dhe 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 72-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**9.1. Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë në sigurimin e kontratave, me qëllim jo vetëm lidhja tyre të shoqërohet me polica e sigurimi, por edhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Statusi i pranimit: **Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Procedura e prokurimit me objekt “Instalimi i teknologjive të reja në stacionet e pompimit në sistemin Mengël-Samurr-Godolesh si dhe procedura “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm ekzistues të linjave në Rrugët “11 Nëntori”, Rruga “Ali Çaushti”, Rruga “Faik Neziri”, Rruga “Veli Stafa”, një pjesë të Lagjes “Çlirimi” dhe “11 Nëntori” të Bashkisë Elbasan ka përfunduar si projekt nga ku për shkak të përfundimit të projektit, nuk ka patur nevoja për policë sigurimi.

**Pa zbatuar**

**10. Gjetje nga auditimi:** Anëtarët e Këshillit të Administrimit të Shoqërisë, nuk kanë lidhur kontratë me shoqërinë, kontratë e cila duhet të lidhej që në momentin e emërimit të tyre, ku të jetë parashikuar, ndër të tjera, kritere të qarta performance që pritej t’i arrihen në terma vjetorë. Objektivat për performancën (indiktorët) e vendosur në kontratë, duhet të miratohen edhe nga ministria e linjës dhe duhet të jenë të matshme në përputhje me biznes planet e shoqërisë. Veprim në kundërshtim me nenin 12 pika 3 e Statutit të Ujësjetës Kanalizime Elbasan SHA, të miratuar me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr. 516, datë 31.03.2016, VKM nr. 63 i datës 20.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 14-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**10.1. Rekomandimi:** Nga kryetari i Bashkisë Elbasan në cilësinë e përfaqësuesit të Asamblesë së Përgjithshme të lidhen kontratat me anëtarët e Këshillit të Administrimit, në të cilat të parashikohen kritere të qarta performance/objektiva që priten të arrihen në terma vjetorë. Objektivat për performancën (indiktorët) e vendosur në kontratë duhet të miratohen edhe nga ministria e linjës dhe duhet të jenë të matshme në përputhje me biznes planet e Shoqërisë.

Statusi i pranimit: **Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Në kuader të riorganizimit të shoqërive UK mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe pëpunimit të ujërave të ndotura”, marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetës- Kanalizime Elbasan Sh.a datë 22.07.2022 lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkive Elbasan, Librazhd, Peqin, Cërrik, Belsh, Gramsh është krijuar shoqëria e re aksionare “**Shoqëria Rajonale Ujësjetës Kanalizime Elbasan sh.a**” me numër nipti **M23322201V**, dhe si rezultat i saj shoqëria UK filluan procesin e riorganizimit dhe nuk është zbatuar si rekomandim nga UK Elbasan sepse shoqëria nisi procedurat për agregim.

**Pa zbatuar**

**11. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi, me Administratorin e Shoqërisë nuk është lidhur kontratë, pavarësisht se emërohet për një periudhë kohe prej tre vitesh, dhe qëndrimi i tij në detyrë gjatë periudhës tre vjeçare bëhet në bazë kontratash të rinovueshme vjetore ndërmjet tij dhe

Asamblesë së Përgjithshme, bazuar në vlerësimet pozitive të performancës së punës së tij. Veprim në kundërshtim me nenin 18, pika 5 e VKM nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, si dhe pika 5 e nenit 18 të Statutit të UK Elbasan SHA (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 14-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**11.1. Rekomandimi:** Në zbatim të Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 11, datë 02.02.2021 të lidhet kontratë me Administratorin, në të cilën të parashikohen kritere të qarta performance/objektiva që priten të arrihen në terma vjetorë, si dhe të bëhen vlerësime vjetore të performancës së punës, bazuar në objektivat/kriteret e performancës të parashikuar në kontratë.

Statusi i pranimit: **Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Në kuader të riorganizimit të shoqërive UK mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe pëpunimit të ujërave të ndotura”, marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetllës- Kanalizime Elbasan Sh.a datë 22.07.2022 lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkive Elbasan, Librazhd, Peqin, Cërrik, Belsh, Gramsh është krijuar shoqëria e re aksionare “**Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a**” me numër nipti **M23322201V**, dhe si rezultat i saj shoqëritë UK filluan procesin e riorganizimit dhe nuk është zbatuar si rekomandim nga UK Elbasan sepse shoqëria nisi procedurat për agregim.

**Pa zbatuar**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nuk është publikuar në faqen e internetit të Shoqërisë, dokumentacioni i detyrueshëm për t’u publikuar, lidhur me procesverbalet e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme të cilat duhet të jenë të publikuara në faqen zyrtare të internetit jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes për të cilën janë mbajtur. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 90, pika 5 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 14-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**12.1 Rekomandimi:** Nga Asambleja së Përgjithshme dhe Administratori i Shoqërisë të merren masa për publikimin në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë të dhënat/dokumentet e detyrueshme për tu publikuar.

Statusi i pranimit: **Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Në kuader të riorganizimit të shoqërive UK mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe pëpunimit të ujërave të ndotura”, marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetllës- Kanalizime Elbasan Sh.a datë 22.07.2022 lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkive Elbasan, Librazhd, Peqin, Cërrik, Belsh, Gramsh është krijuar shoqëria e re aksionare “**Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a**” me numër nipti **M23322201V**, dhe si rezultat i saj shoqëritë UK filluan procesin e riorganizimit dhe nuk është zbatuar si rekomandim nga UK Elbasan sepse shoqëria nisi procedurat për agregim.

**Pa zbatuar**

**13. Gjetje nga auditimi:** Këshilli i Administrimit nuk është mbledhur përherë çdo muaj të vitit kalendarik. Konkretisht për vitin 2019 nuk është mbledhur në muajt Janar, Prill, Maj, Qershor, Korrik, Nëntor, Dhjetor. Për vitin 2020 nuk është mbledhur në muajt Janar, Gusht, Nëntor dhe për vitin 2021 nuk është mbledhur në muajin Janar. Veprim në kundërshtim me nenin 14 pika 1 e Statutit, të miratuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr. 516, datë 31.03.2016, si dhe VKM nr. 63 i datës 20.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 14-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**13.1 Rekomandimi:** Nga organet drejtuese, të merren masa për thirrjen e mbledhjeve të Këshillit të Administrimit jo më pak se një herë në muaj, me qëllim analizimin e vijueshëm të performancës së shoqërisë dhe marrjen e vendimeve koherente në bazë të problematikave që rezultojnë nga aktiviteti i përditshëm i shoqërisë.

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se thirrjet për mbledhjet e Këshillit të Administrimit janë kryer sipas rekomandimit.

**Zbatuar**

**14. Gjetje nga auditimi:** Në 5 raste Këshilli i Administrimit është mbledhur më vonë nga afati i përcaktuar në njoftim, përkatësisht në rastet si më poshtë:

Njoftimi nr. 176 prot., datë 07.02.2020 – vendimi nr. 1 prot., datë 13.02.2020.

Njoftimi nr. 2531 prot., datë 01.12.2020 – vendimi nr. 2531/1 prot., datë 09.12.2020.

Njoftimi nr. 671 prot., datë 05.04.2021 – vendimi nr. 687 prot., datë 12.04.2021.

Njoftimi nr. 1326 prot., datë 01.06.2021 - vendimi nr. 1362 prot., datë 07.06.2021.

Njoftimi nr. 2801 prot., datë 17.09.2021 - vendimi nr. 2913 prot., datë 24.09.2021.

Veprim në kundërshtim me nenin 14 pika 4 e Statutit, VKM nr. 63 i datës 20.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 14-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**14.1 Rekomandimi:** Këshilli i Administrimit të sigurojë marrjen e veprimeve korrigjuese në mënyrë që mbledhjet e tij të bëhen duke respektuar njoftimet e bëra.

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Lidhur me këtë rekomandim per vitin 2022:

Shkresat nr 2645 Prot date 03/06/2022 Thirrje mbledhjeje dhe vendim Nr 2710 Prot date 08/06/2022

Shkresat nr 3961 Prot date 19/07/2022 Thirrje mbledhjeje dhe vendim Nr 4056 Prot date 22/07/2022

Shkresat nr 4631 Prot date 19/08/2022 Thirrje mbledhjeje dhe vendim Nr 4718 Prot date 24/08/2022

Shkresat nr 5035 Prot date 15/09/2022 Thirrje mbledhjeje dhe vendim Nr 5088 Prot date 20/09/2022

Shkresat nr 5622 Prot date 13/10/2022 Thirrje mbledhjeje dhe vendim Nr 5627 Prot date 14/10/2022

Shkresat nr 5736 Prot date 24/10/2022 Thirrje mbledhjeje dhe vendim Nr 6061 Prot date 28/10/2022

**15. Gjetje nga auditimi:** Programet ekonomik-financiar (buxhetet vjetor) janë hartuar dhe realizuar në pamjaftueshmëri financiare, pasi aktiviteti i shoqërisë nuk është i mbuluar plotësisht me buxhet. Konkretisht është programuar dhe realizuar me humbje për vitin 2020 dhe 2021. Në mënyrë të detajuar për vitin 2020, humbja është planifikuar në vlerën -42,749,527 lekë. Të ardhurat janë realizuar në vlerën 340,145,524 lekë, ndërsa shpenzimet janë realizuar në vlerën 385,924,232 lekë, me një humbje në vlerën 45,778,708 lekë.

Për vitin 2021 humbja është planifikuar në vlerën -8,500,000 lekë. Të ardhurat janë realizuar në vlerën 384,633,550 lekë, ndërsa shpenzimet janë realizuar në vlerën 469,435,236 lekë, me një humbje në vlerën 84,801,686 lekë.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, me ndryshimet vijuese të tij neni 37 dhe 82 dhe Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë nr. 15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 23-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**15.1. Rekomandimi:** Organet drejtuese të shoqërisë duhet analizojnë dhe të vlerësojnë arsyet e produktivitetit të ulët të veprimtarisë ekonomik-financiare, efektin e çdo risku të identifikuar, përfshirë një analizë të detajuar të detyrimeve ndaj të tretëve dhe në veçanti kreditë afatshkurtra e afatgjata, si dhe të merren masat e nevojshme për daljen nga kjo situatë që të çon drejt falimentimit.  
**Statusi i pranimit: Pranuar**

#### **Përgjigje nga subjekti:**

Në kuader të riorganizimit të shoqërive UK mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe pëpunimit të ujërave të ndotura”, marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës- Kanalizime Elbasan Sh.a datë 22.07.2022 lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkive Elbasan, Librazhd, Peqin, Cërrik, Belsh, Gramsh është krijuar shoqëria e re aksionare “**Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a**” me numër nipti **M23322201V**, dhe si rezultat i saj shoqërite UK filluan procesin e riorganizimit dhe nuk është zbatuar si rekomandim nga UK Elbasan sepse shoqëria nisi procedurat për agretim.

Shkresa nr. 9463 Prot. datë 05/10/2022 Lënda “Vendim nr 10475 date 03/10/2022 për autorizimin e administratorit të shoqërisë UK Elbasan sha për nënshkrimin e marrëveshjes së transferim veprimtarie dhe cdo akti të nevojshëm kontraktor me qëllim transferim veprimtarie.

Shkresa nr 5464 Prot. datë. 06/10/2022 Lënda “Kërkesë për transferim liçense”

Aktmarrëveshje (kontratë bashkëpunimi) datë 11/10/2022 Nr repertori 4272, nr koleksioni 2315

Shkresa nr 6697 Prot datë 11/11/2022 Lënda “Urdher nr 267, date 11/11/2022 Për njoftim të punonjësve të UKE. dhe Njoftim transferim të aktivitetit të Shoqërisë dhe punonjësve.

**Pa zbatuar**

**16. Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2019, 2020 dhe 2021 nuk janë respektuar afatet kohore për dërgimin e projekt programit ekonomik në Këshillin e Administrimit dhe në Asambleenë e Përgjithshme. Konkretisht për vitin 2019 programi ekonomik është miratuar me Vendim të Këshillit të Administrimit nr. 22, datë 31.12.2018, ndërsa miratimi përfundimtar i programit

ekonomik është realizuar me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr. 8, datë 07.01.2019 të dhe protokolluar në UKE me nr. 123 prot., datë 10.01.2019. Për vitin 2020 programi ekonomik është miratuar me Vendim të Këshillit të Administrimit nr.177, datë 30.12.2019,. ndërsa miratimi përfundimtar i programit ekonomik është realizuar me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë nr. 178, datë 30.12.2019. Për vitin 2021 programi ekonomik është miratuar me Vendim të Këshillit të Administrimit nr.182, datë 28.12.2020, ndërsa miratimi përfundimtar i programit ekonomik është realizuar me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë nr. 183, datë 30.12.2020. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë nr. 15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror” III, pika 2 ( programi ekonomik duhet miratuar brenda datës 01 dhjetor) (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 23-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**16.1. Rekomandimi:** Organet Drejtuese Shoqërisë të miratojnë kohë programin ekonomiko-financiar (buxhetin vjetor) dhe ndryshimet e tij gjatë vitit, si dhe të marrin masa për zbatimin rigoroz të zërave të buxhetit, si për të ardhurat dhe shpenzimet, duke bërë analiza periodike dhe nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për devijimet nga programi i miratuar.

Statusi i pranimit: **Pranuar**

#### **Përgjigje nga subjekti:**

Në kuader të riorganizimit të shoqërive UK mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe pëpunimit të ujërave të ndotura”, marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës- Kanalizime Elbasan Sh.a datë 22.07.2022 lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkive Elbasan, Librazhd, Peqin, Cërrik, Belsh, Gramsh është krijuar shoqëria e re aksionare “**Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a**” me numër nipti **M23322201V**, dhe si rezultat i saj shoqërite UK filluan procesin e riorganizimit dhe nuk është zbatuar si rekomandim nga UK Elbasan sepse shoqëria nisi procedurat për agregim.

Shkresa nr. 9463 Prot. datë 05/10/2022 Lënda “Vendim nr 10475 date 03/10/2022 për autorizimin e administratorit të shoqërisë UK Elbasan sha për nënshkrimin e marrëveshjes së transferim veprimtarie dhe cdo akti të nevojshëm kontraktor me qëllim transferim veprimtarie.

Shkresa nr 5464 Prot. datë. 06/10/2022 Lënda “Kërkesë për transferim liçense”

Aktmarrëveshje (kontratë bashkëpunimi) datë 11/10/2022 Nr repertori 4272, nr koleksioni 2315

Shkresa nr 6697 Prot datë 11/11/2022 Lenda “Urdher nr 267, date 11/11/2022 Për njoftim të punonjësve të UKE. dhe Njoftim transferim të aktivitetit të Shoqërisë dhe punonjësve.

**Pa zbatuar**

**17. Gjetje nga auditimi:** Shoqëria “Ujësjellës Kanalizime” Elbasan SHA, nuk ka hartuar programe afatmesme dhe afatgjata, veprim në kundërshtim me Statutin, neni 7 “Kompetencat” e Asamblesë së Përgjithshme”, Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë nr. 15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, pika I/2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 23-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**17.1. Rekomandimi:** Organet Drejtuese të Shoqërisë të marrin masa për hartimin dhe miratimin e programe afatmesme dhe afatgjata për përmirësimin e performancës, në kuadër të Reformës Kombëtare të Sektorit Ujësjellës-Kanalizime.

Statusi i pranimit: **Pranuar**

#### **Përgjigje nga subjekti:**



Në kuader të riorganizimit të shoqërive UK mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe pëpunimit të ujërave të ndotura”, marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjiellës- Kanalizime Elbasan Sh.a datë 22.07.2022 lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkive Elbasan, Librazhd, Peqin, Cërrik, Belsh, Gramsh është krijuar shoqëria e re aksionare “**Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a**” me numër nipti **M23322201V**, dhe si rezultat i saj shoqërite UK filluan procesin e riorganizimit dhe nuk është zbatuar si rekomandim nga UK Elbasan sepse shoqëria nisi procedurat për agregim.

### **Pa zbatuar**

**18. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën e auditimit, përqindjet e arkëtimit vjetor total krahasuar me faturimin vjetor, janë në rritje nga viti në vit. Megjithatë arkëtimi korent është ai që tregon arkëtimin e faturimit të viteve përkatëse, dhe në fakt pavarësisht rritjes progresive është nën normat e konsideruara të pranueshme nga ERRU etj. Përsa i përket arkëtimit të debive të vjetra shoqëria ka akoma një vlerë të konsiderueshme të debisë për të mbledhur, pavarësisht përpjekjeve të saj për lidhjen e aktmarrëveshjeve me debitorët apo dërgim në përmbarim. Konkretisht në vitin 2019, arkëtimet totale janë në vlerën 323,162,000 lekë, ku arkëtimet korente janë në vlerën 211,683,000 lekë ose 65.5 % dhe arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 111,509,000 lekë ose 34.51 %. Në vitin 2020, arkëtimet totale janë në vlerën 322,594,000 lekë, ku arkëtime korente janë në vlerën 138,070,230 lekë ose 57.2 %, ndërsa arkëtimet e prapambetura në vlerën 138,070,230 lekë ose 42.8 % Në vitin 2021, arkëtimet totale janë në vlerën 368,813,000 lekë, ku arkëtime korente janë në vlerën 252,715,000 lekë ose 68.52 %, ndërsa arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 116,098,000 lekë ose 31.48 %.

Veprim në kundërshtim me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e rregullores për furnizimin me ujë të pijshëm dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të UK”, pjesa II pika 4, VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjar”, i ndryshuar, neni 1; Udhëzimin nr. 3, datë 28.7.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”, i ndryshuar, pika 6 dhe kontratën e shërbimit të miratuar me vendim të ERRU nr. 8, datë 4.02.2011 “Për miratimin e modelit të kontratës tip”, neni 9, pika 1 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 23-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**18.1. Rekomandimi:** Organet Drejtuese të Shoqërisë të marrin masa për rritjen e arkëtimit duke reduktuar humbjet menaxheriale të shoqërisë.

**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:** Në kuader të riorganizimit të shoqërive UK mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe pëpunimit të ujërave të ndotura”, marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjiellës- Kanalizime Elbasan Sh.a datë 22.07.2022 lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkive Elbasan, Librazhd, Peqin, Cërrik, Belsh, Gramsh është krijuar shoqëria e re aksionare “**Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a**” me numër nipti **M23322201V**, dhe si rezultat i saj shoqërite UK filluan procesin e riorganizimit dhe nuk është zbatuar si rekomandim nga UK Elbasan sepse shoqëria nisi procedurat për agregim.

Shkresa nr. 9463 Prot. datë 05/10/2022 Lënda “Vendim nr 10475 date 03/10/2022 për autorizimin e administratorit të shoqërisë UK Elbasan sha për nënshkrimin e marrëveshjes së transferim veprimtarie dhe cdo akti të nevojshëm kontraktor me qëllim transferim veprimtarie.

Shkresa nr 5464 Prot. datë. 06/10/2022 Lënda “Kërkesë për transferim liçense”  
Aktmarrëveshje (kontratë bashkëpunimi) datë 11/10/2022 Nr repertori 4272, nr koleksioni 2315  
Shkresa nr 6697 Prot datë 11/11/2022 Lenda “Urdher nr 267, date 11/11/2022 Për njoftim të punonjësve të UKE. dhe Njoftim transferim të aktivitetit të Shoqërisë dhe punonjësve.

**Pa zbatuar**

**19. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi u konstatua se mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të rregullave të parashikuara në Statut ose Rregullore të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. Në të gjithë deklaratimet për vende të lira pune për periudhën objekt auditimi nuk deklarohet afati brenda të cilit individët mund të paraqesin aplikimet e tyre. Për më tepër, në shumë raste evidentohet kohë shumë e shkurtër nga momenti i deklaratimit të pozicionit të lirë të punës deri në momentin e emërimit në punë të fituesit. Në disa raste mungesa e deklaratimeve për vende të lira pune në Zyrën e Punësimit Elbasan, kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira, si dhe për të njëjtin pozicion pune nuk janë të njëjësuar kriteret e nevojshme për punësim.

Veprim në kundërshtim me nenin 18 pika 7/l e VKM nr.63 datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 38-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**19.1. Rekomandimi:** Nga organet drejtuese të bëhen parashikime të detajuara statutores dhe rregullatore lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë.

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Në kuader të riorganizimit të shoqërive UK mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe pëpunimit të ujërave të ndotura”, marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetillës- Kanalizime Elbasan Sh.a datë 22.07.2022 lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkive Elbasan, Librazhd, Peqin, Cërrik, Belsh, Gramsh është krijuar shoqëria e re aksionare “**Shoqëria Rajonale Ujësjetillës Kanalizime Elbasan sh.a**” me numër nipti **M23322201V**, dhe si rezultat i saj shoqëritë UK filluan procesin e riorganizimit dhe nuk është zbatuar si rekomandim nga UK Elbasan sepse shoqëria nisi procedurat për agregim.

**Pa zbatuar**

**19.2. Rekomandimi:** Nga organet drejtuese të bëhet adresim korrekt në rregullore të përgjegjësisë të punonjësve bazuar në lidhjen shkakësore të veprimeve të tyre me pasojat e kundërta ligjshme që mund të shkaktohen.

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Në kuader të riorganizimit të shoqërive UK mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe pëpunimit të ujërave të ndotura”, marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetillës- Kanalizime Elbasan Sh.a datë 22.07.2022 lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkive Elbasan, Librazhd, Peqin, Cërrik, Belsh, Gramsh është krijuar shoqëria e re aksionare “**Shoqëria Rajonale Ujësjetillës**

**Kanalizime Elbasan sh.a**” me numër nipti **M23322201V**, dhe si rezultat i saj shoqërite UK filluan procesin e riorganizimit dhe nuk është zbatuar si rekomandim nga UK Elbasan sepse shoqëria nisi procedurat për agregim.

**Pa zbatuar**

**19.3. Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë të përcaktohet në deklaratimet për pozicione të lira pune, edhe afati brenda të cilit të interesuarit për pozicionin e punës duhet të shprehin interesin dhe paraqesin dokumentacionin e nevojshëm provues.

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Në kuader të riorganizimit të shoqërive UK mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe pëpunimit të ujërave të ndotura”, marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjiellës- Kanalizime Elbasan Sh.a datë 22.07.2022 lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkive Elbasan, Librazhd, Peqin, Cërrik, Belsh, Gramsh është krijuar shoqëria e re aksionare “**Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a**” me numër nipti **M23322201V**, dhe si rezultat i saj shoqërite UK filluan procesin e riorganizimit dhe nuk është zbatuar si rekomandim nga UK Elbasan sepse shoqëria nisi procedurat për agregim.

**Pa zbatuar**

**20. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi nuk është kryer inventari fizik i aktiveve, por vetëm inventari i imët, pajisje zyre dhe ai ekonomik, si dhe nuk është mbajtur regjistri i aktiveve

-Gjatë investimeve të ndryshme në linja e kanalizime të reja, dhe impiante, nga shoqëria nuk janë evidentuar aktivet e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kontabilizuar si shpenzimin për vlerën kontabël të mbetur.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15, pika 1 dhe 2 dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, KREU III, pika 30 dhe 85/c (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 65-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**20.1. Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë dhe Drejtoria Tregtare të merren masa për të kryer inventarin fizik të aktiveve të shoqërisë, të evidentohen aktivet e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit, si dhe të mbahet regjistri i aktiveve.

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Në lidhje me rekomandimin e mësipërm, është mbajtur:

Shkresa nr. 5848 Prot. datë 25.10.2022 Urdhër nr. 245 lënda : “Për kryerjen e inventarit fizik dhe kontabël të pasurisë së shoqërisë për vitin 2022.”

Shkresa nr. 5848/1 Prot. datë 30.12.2022 “ Procesverbal mbi përfundimin e inventarizimit fizik të aseteve në pronësi të Ujësjiellës Kanalizime Elbasan Sh.A”

Shkresa nr. 5848/2 Prot. datë 30.12.2022 “Relacion mbi përfundimin e inventarizimit fizik dhe kontabël të magazinës së UKE sh.a”

Dokumentacion i cili vërteton kryerjen e inventarizimit fizik të aktivëve, por nuk rezulton të jetë mbajtur një regjistër i aktiveve.

**Zbatuar pjesërisht**

**21. Gjetje nga auditimi:** Në faqen zyrtare të Ujësjellës Kanalizime Elbasan SHA nuk është bërë publikimi i pasqyrave financiare vjetore, raporti i ecurisë së veprimtarisë, raporti i auditimit, në rastet kur përgatitja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme. Kjo situatë ka ardhur dhe si pasojë e një rregulloreje jo shumë të plotë për funksionimin e shoqërisë. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 22 pika 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 65-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**21.1. Rekomandimi:** Nga organet drejtuese të shoqërisë të merren masa për të publikuar në faqen zyrtare të Shoqërisë të pasqyrave financiare vjetore, raporti i ecurisë së veprimtarisë, si dhe raporti i auditimit.

**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Në kuader të riorganizimit të shoqërive UK mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe pëpunimit të ujërave të ndotura”, marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës- Kanalizime Elbasan Sh.a datë 22.07.2022 lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkive Elbasan, Librazhd, Peqin, Cërrik, Belsh, Gramsh është krijuar shoqëria e re aksionare “**Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a**” me numër nipti **M23322201V**, dhe si rezultat i saj shoqëritë UK filluan procesin e riorganizimit dhe nuk është zbatuar si rekomandim nga UK Elbasan sepse shoqëria nisi procedurat për agregim.

**Pa zbatuar**

**22. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nga Shoqëria “Ujësjellës Kanalizime Elbasan” SHA, asetet nuk janë regjistruar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, veprim në kundërshtim Ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, i ndryshuar neni 3, pika 5 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 65-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**22.1. Rekomandimi:** Nga Shoqëria “Ujësjellës Kanalizime Elbasan” SHA të zbatohen procedurat ligjore, për të regjistruar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet.

**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Në kuader të riorganizimit të shoqërive UK mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe pëpunimit të ujërave të ndotura”, marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës- Kanalizime Elbasan Sh.a datë 22.07.2022 lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkive Elbasan, Librazhd, Peqin, Cërrik, Belsh, Gramsh është krijuar shoqëria e re aksionare “**Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a**” me numër nipti **M23322201V**, dhe si rezultat i saj shoqëritë UK filluan procesin e riorganizimit dhe nuk është zbatuar si rekomandim nga UK Elbasan sepse shoqëria nisi procedurat për agregim.

**Pa zbatuar**

**23. Gjetje nga auditimi:** Në pasqyrat financiare të vitit 2020 në llogarinë 21271 “Rrjeti i shpërndarjes së ujit ndërtim” paraqitet në vlerën 50,492,139 lekë, dhe llogaria 2181 “Mobilje dhe pajisje zyre”, paraqitet në vlerën 16,122,898 lekë, që kanë të bëjnë me kontratën “Financim,

instalim dhe realizim punimesh civile, sistemi, matje Wireless”. Llogaria 2317 “AQT në proces Rrjeti i shpërndarjes” është në vlerën 68,770,000 lekë pa TVSH. Kontabilizimet e mësipërme janë kryer në vlerë totale dhe nuk janë zë për zë referuar situacioneve respektive. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 3, pika 14, neni 7 pika 2, neni 25, pika 1 dhe 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 65-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**23.1. Rekomandimi:** Nga Administratori i shoqërisë të merren masa për të kryer inventarizimin fizik, rivlerësimin, klasifikimin (inventar ekonomik apo aktive) dhe kontabilizimin zë për zë.

**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Në lidhje me rekomandimin e mësipërm, është mbajtur:

Shkresa nr. 5848 Prot. datë 25.10.2022 Urdhër nr. 245 lënda : “Për kryerjen e inventarit fizik dhe kontabël të pasurisë së shoqërisë për vitin 2022.”

Shkresa nr. 5848/1 Prot. datë 30.12.2022 “ Procesverbal mbi përfundimin e inventarizimit fizik të aseteve në pronësi të Ujësjetës Kanalizime Elbasan Sh.A”

Shkresa nr. 5848/2 Prot. datë 30.12.2022 “Relacion mbi përfundimin e inventarizimit fizik dhe kontabël të magazinës së UKE sh.a”

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se është kryer vetëm inventarizimi fizik i aktivëve dhe jo kontabilizimi zë për zë.

**Zbatuar pjesërisht**

**24. Gjetje nga auditimi:** Në certifikimin e pasqyrave financiare të vitit 2019 dhe 2020, nga ekspertët kontabël të kontraktuar:

a. Nuk ka zbatim të SNK 250, i rishikuar “Mbajtja parasysh e ligjeve dhe rregullave në një auditim të pasqyrave financiare” për auditim ligjshmërie dhe përputhshmërie nga ekspertët kontabël.

b. Nuk ka dokumentacion përkatës që vërteton punën e kryer të ekspertëve, psh krahasimi i programit me faktin e realizuar dhe kush e ka konfirmuar situacionin e punës së kryer prej tyre (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 65-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**24.1. Rekomandimi:** Nga Organet e Shoqërisë t’i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të emërimit dhe kontraktimit të ekspertëve kontabël.

**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2022, është kontraktuar F.A, me ekspert kontabël E.A. Është mbajtur një tabelë për orët e punës të kryera në total nga ekspertët kontabël. Për vitin 2023 do ketë një format tjetër ku të zbatohen sipas rekomandimit të KLSH.

**Proces zbatimi**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI EKONOMIK**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga Shoqëria “A.S.G” shpk, me objekt “Materialet hidraulike, në vlerën 40,771,612 lekë, viti 2021, u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së materialeve, nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht pajisjet nuk janë të shoqëruara me test raport fabrike, si dhe Operatori ka paraqitur çertifikatën ISO 9001:2015 të lëshuar nga kompania Q C, për Shoqërinë “A.S.G” shpk, e përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, çertifikuar më datë 01.07.2018 dhe datë skadence 30.06.2021.

Nga verifikimi, referuar Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3330 prot., datë 20.03.2018 dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nr. 145 prot., datë 16.03.2018, u konstatua

se kompania Q C në Angli është e akredituar ndërkombëtarisht, por kjo çertifikatë me numër seri QEC 30675457/72/Q Rev:001, nuk është publikuar në faqen e kësaj kompanie, për pasojë është dokument i pabesueshëm për tu marrë në konsiderate referuar rekomandimit të sipërpërmendur. Për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e materialet hidraulike. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “A.S.G” shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar. Në këto kushte grupi i auditimit nuk mund të japë opinionin e tij, për zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmojë që këto pajisje janë njëjta me ato të prokuruar. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 60, pika 1, Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690, Ligjin nr. 10,489 datë 15.12.2011 “Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8 , neni 9 dhe neni 10, Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 35 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 62-96 të Projekt Raportit të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshijë ata që kanë qenë pjesë e procesit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e materialeve hidraulike.

Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga Shoqëria “A.S.G” Sh.p.k, nuk garantojnë zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar, konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës 40,771,612 lekë nga Shoqëria “A.S.G” Sh.p.k.

**Statusi i pranimit:** **Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Ne lidhje me këtë rekomandim rezulton që nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit.

Nga ana e Ujësjetës Kanalizime Sh.a. deri në fazën e Raportit Përfundimtar të Auditimit të paraqiten dokumentacione justifikuese ligjore.

**Pa zbatuar**

**C. MASA DISIPLINORE:**

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, kontratave individuale të punës neni 16, i kërkojmë Administratorit të Shoqërisë, marrjen/ose jo të masave disiplinore ndaj personelit që është angazhuar në procedurat e prokurimit në cilësinë anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, njësisë së prokurimit, përcaktimit të specifikimeve teknike, kërkesave për kualifikim dhe përllogaritjen e vlerave të kontratave, si dhe marrjes në dorëzim të pajisjeve (mallrave), duke marrë në konsideratë shkeljet ligjore dhe përgjegjësiive respektive të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe të performancës së punës së tyre.

**Statusi i pranimit:** **Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Lidhur me këtë rekomandim janë lëshuar Urdhrat e brendshëm me Nr. Prot 3441 – 3450 dhe 3452-3456 me objekt “Vërejtje me paralajmërim me përjashtim”. Përkatësisht:

Urdhëri i brendshëm Nr.3441 Prot. Datë 29.06.2022, masë disiplinore vërejtje për znj. P.A me detyrë, Drejtoreshë e Burimeve Njerëzore.

Urdhëri i brendshëm Nr.3442 Prot. Datë 29.06.2022, masë disiplinore vërejtje për znj. I.S me detyrë, Drejtoreshë Juridike.

Urdhëri i brendshëm Nr.3443 Prot. Datë 29.06.2022, masë disiplinore vërejtje për znj. R.H me detyrë, Përgjegjëse statistike dhe Koordinim Projektesh.

Urdhëri i brendshëm Nr.3444 Prot. Datë 29.06.2022, masë disiplinore vërejtje për znj. L.D.me detyrë, Drejtoreshë Teknike.

Urdhëri i brendshëm Nr.3445 Prot. Datë 29.06.2022, masë disiplinore vërejtje për z.Ç.L me detyrë, Drejtor i Shërbimeve të Përgjithshme.

Urdhëri i brendshëm Nr.3446 Prot. Datë 29.06.2022, masë disiplinore vërejtje për z. J.D me detyrë, zv.Administrator.

Urdhëri i brendshëm Nr.3447 Prot. Datë 29.06.2022, masë disiplinore vërejtje për z. A.T me detyrë, Inxhinier.

Urdhëri i brendshëm Nr.3448 Prot. Datë 29.06.2022, masë disiplinore vërejtje për z. A.N me detyrë, specialist.

Urdhëri i brendshëm Nr.3449 Prot. Datë 29.06.2022, masë disiplinore vërejtje për z. A.K me detyrë, specialist.

Urdhëri i brendshëm Nr.3450 Prot. Datë 29.06.2022, masë disiplinore vërejtje për z. K.M me detyrë, Përgjegjës Mirëmbajtje Rrjeti.

Urdhëri i brendshëm Nr.3452 Prot. Datë 29.06.2022, masë disiplinore vërejtje për znj. M.T me detyrë, specialiste.

Urdhëri i brendshëm Nr.3453 Prot. Datë 29.06.2022, masë disiplinore vërejtje për znj. L.H.

Urdhëri i brendshëm Nr.3454 Prot. Datë 29.06.2022, masë disiplinore vërejtje për znj. K.C.

Urdhëri i brendshëm Nr.3455 Prot. Datë 29.06.2022, masë disiplinore vërejtje për z. A.S me detyrë, specialist.

Urdhëri i brendshëm Nr.3456 Prot. Datë 29.06.2022, masë disiplinore vërejtje për z. Y. A me detyrë, dispeçer.

**Zbatuar**

#### **IV- KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME:**

##### **MASA ORGANIZATIVE**

**1.Rekomandimi 3.1:** Titullari i Autoritetit Kontraktor duhet të nxjerri urdhër/urdhra me qëllim ndjekjen me përpikmëri të zbatimit të kontratave, duke përfshirë dhe marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara, për sasinë, cilësinë, llojin si dhe dokumentacionin shoqërues të tyre.

*Menjëherë*

**2.Rekomandimi 4.1:** Titullari i Autoritetit Kontraktor duhet të nxjerri urdhër/urdhra me qëllim ndjekjen me përpikmëri të kryerjes së shpenzimeve me dokumentacion të plotë dhe të saktë vërtetues.

*Menjëherë*

**3.Rekomandimi 5.1:** Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa për të korrigjuar praktikën e dezinfektit të brendshëm ose të jashtëm ambienteve të punës, me qëllim jo vetëm kryerja e tyre të bëhet me produktet biocide të cilat nuk duhet të shkaktojnë efekte anësore që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, si dhe nuk duhet të kenë ndikim negativ në mjedis.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**4.Rekomandimi 6.1:** Autoriteti Kontraktor, në vijimësi duhet të hartojë kërkesat e veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**5.Rekomandimi 7.1:** Nga Autoriteti Kontraktor të merren masa që përlllogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit publik, të vlerësohet si procedurë e rëndësishme, pasi nga zbatimi i procedurave të përzgjedhjes të prokurimit publik, varet saktësia e kësaj vlere, por dhe efektiviteti maksimal i shpenzimeve publike.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**6.Rekomandimi 8.1:** Nga Shoqëria t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi procesi i shqyrtimit, kualifikimit dhe shpallja fitues të operatorëve është me rëndësi kapitale.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**7.Rekomandimi 9.1:** Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë në sigurimin e kontratave, me qëllim jo vetëm lidhja tyre të shoqërohet me polica e sigurimi, por edhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**8.Rekomandimi 10.1:** Nga kryetari i Bashkisë Elbasan në cilësinë e përfaqësuesit të Asamblesë së Përgjithshme të lidhen kontratat me anëtarët e Këshillit të Administrimit, në të cilat të parashikohen kritere të qarta performance/objektiva që priten të arrihen në terma vjetorë. Objektivat për performancën (indiktorët) e vendosur në kontratë duhet të miratohen edhe nga ministria e linjës dhe duhet jenë të matshme në përputhje me biznes planet e Shoqërisë.

*Menjëherë*

**9.Rekomandimi 11.1:** Në zbatim të Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 11, datë 02.02.2021 të lidhet kontratë me Administratorin, në të cilën të parashikohen kritere të qarta performance/objektiva që priten të arrihen në terma vjetorë, si dhe të bëhen vlerësime vjetore të performancës së punës, bazuar në objektivat/kriteret e performancës të parashikuar në kontratë.

*Menjëherë*

**10.Rekomandimi 12.1:** Nga Asambleja së Përgjithshme dhe Administratori i Shoqërisë të merren masa për publikimin në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë të dhënat/dokumentet e detyrueshme për tu publikuar.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**11.Rekomandimi 15.1:** Organet drejtuese të shoqërisë duhet analizojnë dhe të vlerësojnë arsyet e produktivitetit të ulët të veprimtarisë ekonomiko-financiare, efektin e çdo risku të identifikuar, përfshirë një analizë të detajuar të detyrimeve ndaj të tretëve dhe në veçanti kreditë afatshkurtra e afatgjata, si dhe të merren masat e nevojshme për daljen nga kjo situatë që të çon drejt falimentimit.

*Menjëherë*



**12.Rekomandimi 16.1:** Organet Drejtuese Shoqërisë të miratojnë kohë programin ekonomiko-financiar (buxhetin vjetor) dhe ndryshimet e tij gjatë vitit, si dhe të marrin masa për zbatimin rigoroz të zërave të buxhetit, si për të ardhurat dhe shpenzimet, duke bërë analiza periodike dhe nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për devijimet nga programi i miratuar.

*Në vijimësi*

**13.Rekomandimi 17.1:** Organet Drejtuese të Shoqërisë të marrin masa për hartimin dhe miratimin e programe afatmesme dhe afatgjata për përmirësimin e performancës, në kuadër të Reformës Kombëtare të Sektorit Ujësjellës-Kanalizime.

*Menjëherë*

**14.Rekomandimi 18.1:** Organet Drejtuese të Shoqërisë të marrin masa për rritjen e arkëtimeve duke reduktuar humbjet menaxheriale të shoqërisë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**15.Rekomandimi 19.1:** Nga organet drejtuese të bëhen parashikime të detajuara statutore dhe rregullatore lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë.

*Menjëherë*

**16.Rekomandimi 19.2:** Nga organet drejtuese të bëhet adresim korrekt në rregullore i përgjegjësive të punonjësve bazuar në lidhjen shkakësore të veprimeve të tyre me pasojat e kundra ligjshme që mund të shkaktohen.

*Menjëherë*

**17.Rekomandimi 19.3:** Nga Administratori i Shoqërisë të përcaktohet në deklaratimet për pozicione të lira pune, edhe afati brenda të cilit të interesuarit për pozicionin e punës duhet të shprehin interesin dhe paraqesin dokumentacionin e nevojshëm provues.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**18.Rekomandimi 20.1:** Nga Administratori i Shoqërisë dhe Drejtoria Tregtare të merren masa për të kryer inventarin fizik të aktiveve të shoqërisë, të evidentohen aktivet e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit, si dhe të mbahet regjistri i aktiveve.

*Menjëherë*

**19.Rekomandimi 21.1:** Nga organet drejtuese të shoqërisë të merren masa për të publikuar në faqen zyrtare të Shoqërisë të pasqyrave financiare vjetore, raporti i ecurisë së veprimtarisë, si dhe raporti i auditimit.

*Në vijimësi*

**20.Rekomandimi 22.1:** Nga Shoqëria “Ujësjellës Kanalizime Elbasan” SHA të zbatohen procedurat ligjore, për të regjistruar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet.

*Menjëherë*

**21.Rekomandimi 23.1:** Nga Administratori i shoqërisë të merren masa për të kryer inventarizimin fizik, rivlerësimin, klasifikimin (inventar ekonomik apo aktive) dhe kontabilizimin zë për zë.

*Menjëherë*

**2.Rekomandimi 24.1:** Nga Organet e Shoqërisë t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të emërimit dhe kontraktimit të ekspertëve kontabël.

*Në vijimësi*

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI EKONOMIK**

**1.Rekomandimi 1.1.** Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshijë ata që kanë qenë pjesë e procesit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e materialeve hidraulike. Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga Shoqëria "A.S.G" Sh.p.k, nuk garantojnë zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar, konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i **vlerës 40,771,612 lekë** nga Shoqëria "A.S.G" Sh.p.k.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **3.3 AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE**

### **PËRMBLEDHJE**

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), bazuar në programin e auditimit nr. 702/1 prot., datë 04.08.2023, "Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022", ushtroi auditim në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, për zbatimin e rekomandimeve të lëna, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, të përcjellë:

- Në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me shkresën nr. 695 prot., datë 20.04.2022.

Duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- a.** Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së, të lëna nga auditimi i vitit 2022, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjektet e audituara, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- b.** Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike, të akteve administrative të nevojshme, si vendime e urdhra për zbatimin e masave organizative;
- c.** Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

**Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:**

### **I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.**

- Në zbatim të nenin 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 783/1 prot., datë 09.05.2022, duke respektuar kështu afatin 20 ditor të dërgimit.

### **II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.**

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 1894/1 prot., datë 24.11.2022, duke respektuar afatin 6 mujor.

### **III. Rekomandimet e KLSH**

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 695 prot., datë 20.04.2022, janë rekomanduar gjithsej:

a) 19 masa organizative,

b) 1 masë për shpërblim dëmi në vlerën 4,669,650 lekë,

c) 1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike” në vlerën 78,044 lekë,

d) 5 masa disiplinore.

### **IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH**

Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si më poshtë:

<b>Nr.</b>	<b>Lloji i rekomandimit</b>	<b>Rekomanduar</b>	<b>Pranuar Plotësisht</b>	<b>Pa pranuar</b>
1	Organizative	19 masa	19 masa	0
2	Shpërblim dëmi	1 masë	1 masë	0
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	1 masë	1 masë	0
4	Disiplinore	5 masa	5 masa	0

### **V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit**

Në mënyrë të përmblëdhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

<b>Nr.</b>	<b>Lloji i rekomandimit</b>	<b>Pranuar</b>	<b>Statusi i zbatimit</b>			
			<b>Zbatuar plotësisht</b>	<b>Zbatuar pjesërisht</b>	<b>Në proces zbatimi</b>	<b>Pa zbatuar</b>
1	Organizative	19 masa	0	2 masë	17 masa	0
2	Shpërblim dëmi	1 masë	0	0	1 masë	0
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	1 masë	0	0	1 masë	0
4	Disiplinore	5 masa	0	0	0	5 masa

#### **I/1. HYRJA**

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" si dhe manualit "Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve".

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 702/1 prot., datë 04.08.2023, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, është kryer nga audituesit shtetërorë të KLSH-së:

1. K.SH, Anëtar.
2. J.M, Anëtar.

#### **I/2 OBJEKTI AUDITIMIT**

Zbatimi i masave të rekomanduara të dërguara me shkresën e KLSH me shkresat e cituara në pikën I/4 të këtij Projekt Raporti, për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

#### **I/3 QËLLIMI AUDITIMIT:**

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tre-mujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3, të nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

#### **I/4 METODOLOGJIA E AUDITIMIT**

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që lidhet me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen të subjekteve të audituara.

#### **I/5 KONKLUZIONI**

Në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile janë marrë masa për respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, në zbatim të nenin 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për të informuar KLSH-në mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Gjithashtu, në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, janë marrë masa edhe për dërgimin e informacioneve në KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit 6 mujor. Afat ky i përcaktuar në nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, me shkresat e cituara në pikën I/4 të këtij Projekt Raporti, rezulton se:

Nga 26 masa e rekomanduara, nga subjektet janë pranuar 26 masa ose në masën 100 %. Nga 26 masat e pranuar janë zbatuar pjesërisht 2 masa ose 8 %, janë zbatuar plotësisht 0 masa ose 0 % tyre, janë në proces zbatimi 19 masa ose 73 % dhe janë pa zbatuar 5 masa ose 19 %.

Në numër dhe në % statusi i masave organizative paraqitet:

<b>Nr.</b>	<b>Statusi i masave të marra nga KLSH</b>	<b>Në numër</b>	<b>Në %</b>
1	Totali	26	100 %
2	Pa pranuar	0	0%
3	Pranuar	26	100%
	<b>Nga të pranuarat:</b>		<b>Në % ndaj të pranuarave</b>
1	Zbatuar plotësisht	0	0%
2	Zbatuar pjesërisht	2	8%

3	Pa zbatuar	5	19%
4	Në proces	19	73%

## II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Rekomandimet që janë në proces zbatimi janë në nivelin 73 %, ndërsa rekomandimet që janë pa zbatuar janë në nivel 19 %. Pavarësisht përpjekjeve të subjekteve për marrjen e masave për zbatimin e tyre, përsëri rekomandimet e pazbatuara apo në proces zbatimi mbeten në nivel relativisht të lartë në masën 92 %.

## III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

- Në zbatim të nenin 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 783/1 prot., datë 09.05.2022, duke respektuar kështu afatin 20 ditor të dërgimit.

III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 1894/1 prot., datë 24.11.2022, duke respektuar afatin 6 mujor.

III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Plani Kombëtar për Emergjencat Civile është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave VKM nr. 385, date 03.12.2004.

Institucionet e ngarkuara me ligj për emergjencat civile për 17 vite, periudha viti 2004 deri më datë 10.12.2021 që përfundoi auditimi, nuk kanë arritur të përditësojnë dokumentet strategjike për reagim dhe menaxhim të situatave emergjente. Këto dokumente nuk janë përditësuar që nga viti 2004 dhe të njëjtat vazhdojnë të përdoren edhe sot. Dokumenti Strategjik i Emergjencave Civile të Shqipërisë deri në miratimin e dokumentit të ri mbetet me dokumentin e vitit 2004, i cili nuk pasqyron rrethana të reja në fushën menaxhimit të emergjencave, përpos kësaj divergon dhe me Ligjin nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, në rastet si më poshtë:

Kreu 1. (1.2) Baza ligjore.

Kreu 2. Organizimi i Sistemit të Menaxhimit të Emergjencave Civile në Shqipëri.

Kreu 3.(3.3). Përgjegjësitë për bashkërendimin e emergjencave civile.

Kreu 4.(4.3) Masat e përgjithshme për Parandalimin dhe Lehtësimin.

Kreu 5.(4.3) Rolet dhe Përgjegjësitë.

Kreu 6 Përgjigja.

Shtojca B: Baza ligjore, funksionet dhe detyrat e institucioneve etj, të cilat nuk gjejnë mishërim të plani kombëtar i vitit 2004 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2. Gjetje nga auditimi:** Nuk kanë dalë të gjitha aktet nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”. Në veçanti për sigurimin e pronës bujqësore, kullimore nga shoqëritë e sigurimit. Konkretisht janë në proces miratimi:

- Projekt-vendim për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të akordimit të fondeve të agjencisë kombëtare të mbrojtjes civile, për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si dhe veprimtarive të tjera në fushën e mbrojtjes civile.

-Projekt-vendim për ngritjen dhe funksionimin e numrit të unifikuar të thirrjeve emergjente 112.

-Projekt-vendim për miratimin e llojeve të sinjaleve të alarmit, numrit dhe mënyrës së përdorimit të tyre, në rastet e fatkeqësive.

Nuk ka, dhe as në proces akt rregullator, për sigurimin nga zjarri në shoqëritë e sigurimit, për dëm shpërblimin në rast të rënies të zjarrit. Ashtu siç është vepruar me ndërtesat nga tërmeti etj.

-Bashkitë dhe Prefekturat përpos njësive të reaguesve të parë, nuk kanë në dispozicion edhe kompani të specializuara për mbrojtjen nga zjarri kontraktuara të cilat asistojnë në aspektin teknik sa herë që kërkohet nga Bashkitë dhe Prefekturat, edhe pse me Ligjin 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, neni 30, pikat e dhe j, neni 58, pika ç; neni 61, pika ë mundësohet angazhimi i subjekteve private (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën 2004 deri më datë 10.12.2021 që përfundoi auditimi, Republika e Shqipërisë nuk ka Strategji Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, dhe vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror. Mos disponimi i këtij dokumenti ka bërë të pamundur parashikimin e fatkeqësive dhe pasojave të mundshme nga fatkeqësitë, duke pamundësuar të bëhet vlerësimi i duhur i mbrojtjes nga rreziqet përkatëse dhe masat parandaluese për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë. Pas një viti e gjysmës, me urdhër të Kryeministrit nr. 57, datë 29.06.2021, është ngritur grupi ndërinstytucional dhe grupi teknik ndërinstytucional i punës për përgatitjen Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë. Ky dokument është në proces, pra nuk ka përfunduar. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, neni 10 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 5-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4. Gjetje nga auditimi:** Nuk ka funksionuar Komisioni Teknik Këshillimor i emëruar në zbatim të VKM nr. 1020, datë 16.12.2020, “Për përbërjen, funksionimin dhe detyrat e komisionit teknik këshillimor për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive”. Nën drejtimin AKMC në Ministrinë e Mbrojtjes krijohet dhe funksionon Komisioni Teknik Këshillimor (në vijim KTK), i cili këshillon për çështje të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë për mbrojtjen civile. KTK-ja kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm i AKMC dhe ka në përbërje përfaqësues të Ministrive, të strukturave në vartësi të tyre dhe të institucioneve. Nuk është mbledhur për periudhën janar-gushtë 2021. Veprim në kundërshtim me VKM nr. 1020, datë 16.12.2020, “Për përbërjen, funksionimin dhe detyrat e komisionit teknik këshillimor për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive”, pika 1,3,4 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### **4.1. Rekomandimi:**

Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për funksionimin e Komisionit Teknik Këshillimor, që në të ardhmen vendimmarrjet për çështje të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë për mbrojtjen civile të jenë sa më të dobishme.

**4.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Komisioni Teknik Këshillimor është mbledhur 2 herë në vit, në Qershor dhe në Dhjetor ose në varësi të kalendarit të aktiviteteve të AKMC. Në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 186, Prot. 1397/1, datë 24.08.2022 është ngritur Sekretaria teknike e KTK, e cila administron procesin e takimeve. Takimi i parë për vitin 2022 është zhvilluar në datën 15.06.2022 (procesverbali me nr. 1003/6 prot., datë 23.06.2022), ndërsa takimi dytë është zhvilluar në datën 13.12.2022 (procesverbali me nr. 1397/8 prot., datë 20.12.2022). Takimi i parë për këtë vit, është zhvilluar në datën 24 Korrik 2023 (procesverbali me nr. 1369/1 prot., datë 28.07.2023) dhe tjetri është parashikuar në periudhën Nëntor - Dhjetor. Drejtoria e Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive dhe Parandalimit në përmbushje të detyrave funksionale, planifikon, administron procesin, si dhe mban procesverbalet e çdo takimi, materialet mbështetëse etj. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Niveli qendror dhe lokal nuk ka burimet njerëzore dhe teknike të mjaftueshme për reagim ndaj situatave emergjente/zjarret.

-Nga 61 Bashki në shkallë Republike, janë marrë të dhëna në 55 prej tyre, në të cilat raportohen 152 zjarrfikëse. Nga këto 131 në gjendje pune, 8 me defekte të vogla, 3 me defekte të konsiderueshme, 10 jashtë përdorimit dhe 36 të pa targuara (pa dokumentacion). Shumë nga zjarrfikëset në dispozicion janë të vjetruara (disa që datojnë nga vitet gjashtëdhjetë), janë në gjendje të keqe dhe nuk janë të ndërveprueshme sepse janë dhuruar nga vende të ndryshme.

- Bashkive dhe njërive administrative u mungojnë pajisjet mbrojtëse personale dhe pajisje të jashtme për shuarjen e zjarreve, si: Kostume anti zjarr, kundragaz, çizme kundra zjarrit, doreza kundra zjarrit etj. Nga bashkitë janë raportuar: Pompa shpine gjithsej 243, nga këto profesionale 221, të zakonshme 22, fikse me pluhur 568, me CO2 92, pompa thithëse 23 dhe pompa të ndryshme 55.

Në zbatim të Ligjit Nr. 152/2015, "Për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shërbimin e Shpëtimit", shumica e kompetencave të shuarjes së zjarrit u transferuan nga prefekturat tek bashkitë, duke lënë në nivel qendror vetëm legjislacionin, trajnimin dhe bashkëpunimin mes strukturave të shuarjes së zjarrit. Po në zbatim të këtij ligji, Bashkitë janë të detyruara të investojnë në ngritjen e kapaciteteve vullnetare të shuarjes së zjarreve, përveç shërbimit profesional. Por kufizimet buxhetore pengojnë shumë bashki të zhvillojnë programe për shuarjen e zjarrit me vullnetarizëm (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1. Rekomandimi:** Nga Drejtori i Përgjithshëm ti bëhet prezent Instancave më të Larta Shtetërore, pamjaftueshmëria e burimeve njerëzore dhe teknike për menaxhimin efektiv dhe reagimin ndaj situatave emergjente(zjarret).

**5.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Nga ana e Drejtorisë së Zvogëlimit të Riskut Fatkeqësive Parandalimit (DZRFP) janë realizuar takime periodike me strukturat qendrore dhe lokale në kuadër të hartimit të dokumenteve strategjike, ku fokus të veçantë kanë marrë institucionet përgjegjëse për menaxhimin e riskut të zjarreve si Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Zjarrfikës në Ministrinë e Brendshme, ndërsa në nivel lokal janë realizuar takime në Prefekturat me ekspozim më të lartë ndaj zjarreve dhe strukturat e bashkive respektive. Konkretisht: (I) Prefektura Vlorë (datë 17 mars 2022), (II) Prefektura Kukës (datë 10 maj 2022), (III) Prefektura Shkodër (datë 19 maj 2022). Gjithashtu DZRFP përmes shkresës nr. 692/1, datë 19.04.2022 i është drejtuar 12 Prefekturave mbi marrjen e masave parandaluese dhe menaxhimin e zjarreve, ku u kërkohet raportimi i aktiviteteve të planifikuara në këtë kuadër, sikurse edhe respektimi i planifikimit të buxhetit në masën 4% për mbrojtjen civile. Asistencë e vazhdueshme iu është dhënë bashkive për

përdorimin e transfertës së kushtëzuar në zbatim të VKM nr. 414, date 08.07.2021. Lidhur me pamjaftueshmërinë në kapaciteteve njerëzore dhe financiare (për makineri, pajisje për reagim emergjent) janë evidentuar dhe reflektuar në prioritetet strategjike në dokumentin e Vlerësimit të Riskut qendror dhe Strategjise Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë. Rekomandimi është në proces zbatimi, por nuk është respektuar afati i përcaktuar nga grupi i auditimit. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga AKMC, nuk ka janë përdorur Kapacitetet e Paralajmërimit të hershëm.

Deri më datë 10.12.2021 që përfundoi auditimi, nuk është realizuar (është në proces) rehabilitimi i stacioneve hidrometeorologjike të cilat janë në pronësi të AKMC-së, që do të përdoren për detyra operacionale nga IGJEUM. Njëkohësisht numri i vrojtuesve dhe sinjalizuesve të kontraktura nga njësitë vendore është në nivel të kufizuar. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, neni 8 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1. Rekomandimi:** Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për rehabilitimin e stacioneve hidrometeorologjike, për të siguruar menaxhimin efektiv për parandalimin dhe reagimin ndaj situatave emergjente me fokus zjarret.

**6.2 Nga verifikimi rezultoi se:** AKMC ka marrë në dorëzim 24 stacionet hidrometeorologjike dhe kanë lidhur kontratën nr. 2410/6, datë 10.10.2022 me shoqërinë e mirëmbajtjes T në bazë të marrëveshjes kuadër nr. 2410, datë 01.12.2021, “Shërbim për mirëmbajtjen për stacionet hidrometeorologjike”. Me mbështetjen USAID, AKMC-së do ti dhurohet akses në platformën “DisasterAëare” e cila është platformë “Sistem i Paralajmërimit të Hershëm”. Rekomandimi është në proces zbatimi, por nuk është respektuar afati i përcaktuar nga grupi i auditimit. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e mangët operacionale e helikopterëve të Forcave të Armatosura të destinuar për emergjencat civile (zjarret), ka krijuar boshllëk në kryerjen e operacioneve të shuarjes së zjarreve të rëna në vendin tonë. Konkretisht Ministria e Mbrojtjes nga 4 helikopter gjithsej që ka për emergjencat civile (zjarret), ka në gjendje operacionale vetëm një helikopter të gatshëm, helikopter i cili është përdorur gjatë operacioneve të shuarjes së zjarreve të rëna në vendin tonë gjatë vërës së këtij viti.

Në këtë kontekst, shpenzimi prej 36,069,300 lekë për blerjen e shërbimit me dy helikopter nga Shoqëria “V H” nga AKMC, nuk do të ishte kryer në qoftë se Ministria e Mbrojtjes do të kishte përdorur kapacitetet e veta operacionale, si dhe AKMC nuk do të ishte drejtuar Mekanizimit Evropian të Mbrojtjes Civile ERCC, për ndihmë ndërkombëtare, ndihmë e cila ka ardhur nga Shteti Hollandez me 3 mjete Helikopter dhe 76 veta personel, Republika Ceke me 2 mjete Helikopter me 7 veta personel. Gjithashtu USAID ka ofruar asistencë teknike mbi metodat e shuarjes së zjarreve në pyje me 4 veta personel, të cilët lehtësuan procesin e shuarjes së zjarreve në vatrat më kritike të vendit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**8. Gjetje nga auditimi:** Nuk është krijuar fondi i solidaritetit për mbrojtjen civile (zjarret), veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civil”, neni 66 “Fondi i solidaritetit”, pikat 1,2,3 ku është shprehur respektivisht.



“Pika 1. AKMC-ja, nëpërmjet një llogarie në një bankë të nivelit të dytë, krijon një fond solidariteti, për mbrojtjen civile, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Pika 2. Ky fond përdoret për përballimin e situatave emergjente, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të prokurimit publik.

Pika 3. Fondi i krijuar sipas pikës 1, të këtij neni, mund t’u transferohet njësive të vetëqeverisjes vendore, me kërkesën e tyre, sipas legjislacionit në fuqi” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**8.1. Rekomandimi:** Nga AKMC-ja, të merren masa për të krijuar fondin e solidaritetit nëpërmjet një llogarie në një bankë të nivelit të dytë, për përballimin e situatave emergjente, si dhe të bëhen transparente të gjitha proceset e krijimit të këtij fondi.

**8.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Nga ana e AKMC është çelur llogaria për krijimin e Fondit të Solidaritetit, në bankën e Nivelit të dytë (Banka C) dhe është publikuar në website: [www.akmc.gov.al](http://www.akmc.gov.al). Numri i llogarisë së solidaritetit (në euro dhe në lekë) është: EURO xxxxxxxxxxxx IBAN ALxx xxxx xxxx xxxx xxxx xxx xxxx dhe: ALL xxxxxxxxxxxx IBAN ALxx xxxx xxxx xxxx xxxx xxxx xxx. Për të siguruar transparencën, Fondi i Solidaritetit do të publikohet në faqen zyrtare të AKMC. Rekomandimi është në proces zbatimi, por nuk është respektuar afati i përcaktuar nga grupi i auditimit. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**9. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi nga AKMC, nuk janë kryer inspektime për gatishmërinë e strukturave të Mbrojtjes Civile për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri. Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm është miratuar Plan kontrolli nr. 1390/1 prot., datë 25.06.2021 “Për masat e marra nga Prefektura Fier dhe bashkitë e këtij Qarku, për gatishmërinë e strukturave të Mbrojtjes Civile për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri”, me objekt: zbatimi i masave të marra dhe planet e përgatitura për përballimin e situatave të zjarreve që mund të ndodhin gjatë sezonit të verës, ngritja dhe forcimi i kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes civile, si dhe përmirësimin e infrastrukturës për parandalimin e fatkeqësive natyrore të shkaktuara nga zjarret”. Sipas këtij Programi është kërkuar që:

“Në përfundim të planit të kontrollit të përgatitet informacion me përfundime dhe rekomandime për eliminimin e mangësive të konstatuara. Për masat të cilat kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme, ekipi AKMC-së, të vërë detyra konkret”. Në fakt, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se nuk është përgatitur informacion me përfundime dhe rekomandime për eliminimin e mangësive të konstatuara (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**9.1. Rekomandimi:** Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për të kryer inspektime në strukturat qendrore dhe vendore për marrjen e masave, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre shtetërore për gatishmërinë e strukturave të Mbrojtjes Civile për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri.

**9.2 Nga verifikimi rezultoi se:** AKMC ka bashkëpunuar me DAP dhe është shpallur konkurrimi për pozicionin Përgjegjësi i Sektorit të Inspektimit në AKMC. Më pas me aktin Nr.3930, datë 21.06.2022 të DAP është emëruar Përgjegjësi i Sektorit të Inspektimit në AKMC. Aktualisht, Struktura e Sektorit të Inspektimit është e plotësuar me 2 specialistë dhe 1 përgjegjës sektori, ku po vijon puna për zbatimin e rekomandimit. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**10. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi, në strukturat qendrore dhe vendore për marrjen e masave, sipas fushës së përgjegjësive të tyre shtetërore për gatishmërinë e strukturave të Mbrojtjes Civile për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, nuk është aplikuar asnjë kundërvajtje administrative (gjobë) ndaj strukturave që kanë shkelur ligjin për situatën e zjarreve korrik-gusht 2021, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civil”, neni 68 “Kundërvajtjet administrative”, pikat 1 dhe 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**10.1. Rekomandimi:** Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa për ushtrim të plotë të përgjegjësive të Tij, funksionale ndaj strukturave qendrore dhe vendore për mos marrjen e masave, sipas fushës së përgjegjësive të tyre shtetërore për gatishmërinë për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri.

**10.2 Nga verifikimi rezultoi se:** AKMC ka bashkëpunuar me DAP dhe është shpallur konkurrimi për pozicionin Përgjegjësi i Sektorit të Inspektimit në AKMC. Më pas me aktin Nr.3930, datë 21.06.2022 të DAP është emëruar Përgjegjësi i Sektorit të Inspektimit në AKMC. Aktualisht, Struktura e Sektorit të Inspektimit është e plotësuar me 2 specialistë dhe 1 përgjegjës sektori, ku po vijon puna për zbatimin e rekomandimit. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**11. Gjetje nga auditimi:** AKMC, në ndërhyrjen për fikjen e zjarreve nga ajri në muajin gusht 2021, ka kryer procedurë prokurimi për sigurimin e dy mjeteve ajrore, pa kompetencë (tagër ligjor) të deleguar nga Ministri i Mbrojtjes. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Ministrisë së Mbrojtjes nr. 3, datë 13.02.2015, “Për prokurimin Publik në Ministrinë e Mbrojtjes, Strukturave të vartësisë dhe në Forcat e Armatosura”, KREU III, pika 3, KREU IV, pik 11, nenet 28 e 29, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 21, pika 5, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, dhe të nenit 73, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 53-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**11.1. Rekomandimi:** Nga Drejtori Ekzekutiv të kushtohet vëmendje e duhur institucionale mos përsëritja e rasteve të tilla në të ardhmen.

**11.2 Nga verifikimi rezultoi se:** AKMC ka bashkëpunuar me DAP dhe është shpallur konkurrimi për pozicionin Përgjegjës i Sektorit për çështjet Ligjore në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në AKMC. Më pas me aktin nr.3732, datë 10.06.2022 të DAP është emëruar Përgjegjësi i Sektorit për çështjet Ligjore në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në AKMC, ku po vijohet puna për realizimin e rekomandimit. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**12. Gjetje nga auditimi:** AKMC në shpenzimin në vlerën 36,069,300 lekë për ndërhyrjen e fikjes së zjarreve nga ajri në muajin gusht 2021, nuk ka përcaktuar llojin e procedurës (pra nuk ka një procedurë të mirëfilltë) në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 41 dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 46.

Procedura e prokurimit ka filluar pa pasur fondin në dispozicion. Konkretisht fondi është çelur nga Ministria e Mbrojtjes me shkresën nr. 4195/4 Prot., datë 29.08.2021 dhe nr. 4404/2 Prot., datë 01.10.2021 po për këtë vlerë, dhe jo më datë 03.08.2021, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 40 dhe neni 50.

Për këtë procedurë prokurimi nuk është marrë autorizimi i urdhër prokurimit nga Dega e Thesarit Tiranë, përpara se të fillojë procesi i prokurimit. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9/1 dt. 20.03.2018, pjesa III, Procedurat për kryerjen e shpenzimeve, dhe pika 15.1 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 53-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**12.1. Rekomandimi:** Për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura në lidhje me procedurën për ndërhyrjen e fikjes së zjarreve nga ajri në muajin gusht 2021, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktikë, por edhe për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla, me qëllim uljen e kostove të blerjes së shërbimeve.

**12.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Sektori i Prokurimit për zbatimin korrekt të legjislacionit në fushën e prokurimit si dhe për rritjen profesionale ka ndjekur trajnime në mënyrë të vazhdueshme dhe po vijon punën për zbatimin e rekomandimit. Rekomandimi është zbatuar pjesërisht, pasi është rekomanduare domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktikë, por edhe për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla, me qëllim uljen e kostove të blerjes së shërbimeve dhe konkretisht kjo nuk mund të zgjidhet vetëm me anë të trajnimeve. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe zbatuar pjesërisht.

*Zbatuar pjesërisht*

**13. Gjetje nga auditimi:** Referuar faktit që Shqipëria është një nga vendet mesdhetare që preket më shumë nga zjarret, planifikimi apo programet e kontrollit të situatave emergjente nuk mund të lihen deri në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë. AKMC në shpenzimin në vlerën 36,069,300 lekë për ndërhyrjen e fikjes së zjarreve nga ajri në muajin gusht 2021, duhet të kishte vlerësuar dhe zhvilluar procedurën e prokurimit “Marrëveshje kuadër”, mbështetur në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” 52 dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 60, 61 dhe 62, për të siguruar mirë përdorimin të fondeve publike (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 53-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**13.1. Rekomandimi:** Nga Drejtori Ekzekutiv t’i kushtohet vëmendje e duhur institucionale menaxhimit të emergjencave (zjarreve në fondin pyjor/kullosor etj.) duke marrë masa për një organizim më të mirë institucional në aspektin e gatishmërisë për parandalimin apo reagimin ndaj situatave të jashtëzakonshme, në këtë kontekst vlerësimin dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit “Marrëveshje kuadër”.

**13.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Nga AKMC është lidhur marrëveshja kuadër nr. 2410, datë 01.12.2021 “Shërbim për mirëmbajtjen për stacionet hidrometeorologjike” dhe po vijohet më tej për realizimin e rekomandimit të lënë nga grupi i auditimit. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**14. Gjetje nga auditimi:** Kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik “V H” nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” nenet 77,87,89,90,92 dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82. Konkretisht:

-Operatori ekonomik "V H" shpk nuk disponon asnjë mjet të fluturimit ajror, por ka aktmarrëveshjen e datës 07.06.2020 ndërmjet Operatorit ekonomik "V H" shpk, dhe Kompanisë A I G & C Gjermani, dokument i pavlefshëm për tu marr në konsideratë pasi:

-Marrëveshja nuk ka të përcaktuar vlerën e qirasë.

-Konfirmimin që qiraja është miratuar nga autoritetet aeronautike të qiramarrësit.

-Konfirmimi i operacioneve të linjave ajrore dhe manualeve të fluturimit.

-Dy kopje të manifestit të ngarkesës (depozitës së ujit).

-Licencën Operative, në përputhje me kapitullin 2 të Rregullores së (KE) nr. 1008/2008, të lëshuar nga autoriteti aeronautikë i vendit të regjistrimit.

Veprim në kundërshtim me Rregulloren e (KE) nr. 1008/2008 udhëzim nr.14, datë 9.9.2011, "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e ministrit nr.17, datë 2.9.2010 "Mbi rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajrore", pika 1 dhe 2.

-Nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar si: Kontrata për shërbime të ngjashme dhe vet deklarimi që mjetet janë në gjendje të mirë teknike dhe operatori zotëron të gjitha kapacitetet ligjore dhe teknike për ushtrimin e aktivitetit, si dhe në ofertën ekonomike nuk jepen të dhëna të sakta për numrin e mjeteve ajrore të angazhuara dhe ofertë e detajuar për çdo mjetë ajror, nëse është rasti, provon faktin se Operatori ekonomik "V H", nuk duhet të ishte jo vetëm përzgjedhur, dhe aq më tepër kontraktuar.

Në planin operacional, në marrëveshje, në kontratë dhe në fakt nuk ka të dokumentuar nëpërmjet një proces verbali apo akt inspektimi, kryerjen e inspektimit në Qendrën e helikopterëve Heliport të "V H" shpk Baldushk-Tiranë, para lidhjes së kontratës, si dhe gjatë kryerjes së shërbimit, për disponibilitetin e mjeteve ajrore të kërkuar dhe kryerjen e shërbimit sipas marrëveshjes.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 53-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1. Rekomandimi:** Nga Institucioni t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi rëndësia e procesit të shqyrtimit, kualifikimit dhe shpallja fitues të operatorëve është me rëndësi kapitale.

**14.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Sektori i Prokurimit për zbatimin korrekt të legjislacionit në fushën e prokurimit si dhe për rritjen profesionale ka ndjekur trajnime në mënyrë të vazhdueshme dhe po vijon punën për zbatimin e rekomandimit. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**15. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 53, datë 11.12.2020 për vlerën 120,000 lekë nëpërmjet B., është likuiduar Shoqëria "D.A" Sh.a. Ky shpenzim ka të bëjë me shërbim makine (pjesë këmbimi dhe bateri). Ky shpenzim është klasifikuar në strukturën e llogarisë (artikullin) 6023200, duke u konsideruar blerje me vlerë të vogël "Rast emergjent", formulari nr.4.

Në fakt ky shpenzim nuk është rast emergjent, por një shërbim i rregullt, dhe duhet të ishte zbatuar procedurë prokurimi për përzgjedhjen e operatorit ekonomik.

-Për këtë shpenzim nga Shoqëria "D.A" sh.a është lëshuar fatura tatimore shitje 321561013, datë 03.12.2020, firmosur nga F.B, R.B dhe F.K. Në fakt duhej firmosur nga personat e ndodhur në udhëtim K.N dhe J.H.

Urdhër shpenzimi, nuk ka bashkëlidhur dokumentacionin vërtetues të kryerjes së këtij shpenzimi:

-Kontratën me karrotecin dhe sa është likuiduar për ta çuar makinën tek vendi i shërbimit, ose mjeti që e ka tërhequr.

-Fletëdaljen e pjesëve të këmbimit (fakt që nuk ka fletëdalje, çka presupozon që pjesët duhet të jenë në magazinë).

-Situacionin e shërbimit të lëshuar nga operatori ekonomik Shoqëria "D.A"Sh.a.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr. 3, datë 8.01.2018, "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", pika 18, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik", me ndryshimet vijuese të tij, pika 35.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 53-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1. Rekomandimi:** Nga Drejtori Ekzekutiv t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale mos përsëritja e rasteve të tilla në të ardhmen.

**15.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Sektori i Prokurimit për zbatimin korrekt të legjislacionit në fushën e prokurimit si dhe për rritjen profesionale ka ndjekur trajnime në mënyrë të vazhdueshme dhe po vijon punën për zbatimin e rekomandimit. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**16. Gjetje nga auditimi:** Departamenti i Administratës Publike në tre rast ka kryer emërimë në kundërshtim me kriteret e posaçme të pozicioneve të punës të miratuara nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe të depozituara në DAP *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 33-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**16.1. Rekomandimi:** Drejtori i Përgjithshëm të depozitojë në DAP, kriteret e posaçme të pozicioneve të punës të miratuara nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe të kërkojë që emërimet e nëpunësve civil të kryhen në zbatim të këtyre kriterëve, duke synuar mos përsëritjen e rasteve të tilla në të ardhmen.

**16.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Në periudhën në vazhdim, AKMC ka dërguar rregullisht në DAP kopje të kriterëve të posaçme për çdo pozicion pune vakant. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**17. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi, AKMC ushtron aktivitetin e saj me strukturë organizative të pa plotësuar. Konkretisht nga 106 pozicione të miratuara, në fakt janë punësuar 58 punonjës me një diferencë prej 48 punonjësish *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 33-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**17.1. Rekomandimi:** Drejtori i Përgjithshëm ti kërkojë DAP nisjeve procesit të rekrutimit, pra shpalljen e vendeve vakante dhe administrimin e procedurave të seleksionimit për çdo kategori për të plotësuar strukturë organizative të AKMC.

**17.2 Nga verifikimi rezultoi se:** AKMC në bashkëpunim me DAP është duke vijuar punën për plotësimin e strukturës organizative. Struktura organizative e plotësuar është aktualisht 73 punonjës dhe janë në proces konkurrimi 6 pozicione. AKMC ka dërguar në DAP me shkresën nr.1230, datë 07.07.2023, për kërkesën për vijimin e shpalljeve dhe procedurën e rekrutimit për të gjitha vendet e lira. Procesi i rekrutimeve nga DAP ka patur vonesa. Shumë pozicione vakante në kategorinë ekzekutive janë shpallur disa herë dhe janë mbyllur pa kandidatë fitues. Rekomandimi është zbatuar pjesërisht, por nuk është respektuar afati i përcaktuar nga grupi i auditimit.

Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe zbatuar pjesërisht.

### *Zbatuar pjesërisht*

**18. Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2020, AKMC ka vlerësuar dhe argumentuar dhënien e ndihmës financiare për familjet e dëmtuar nga fatkeqësi natyrore (tërmeti, zjarri, përmbytjet, rrëshqitje tokash ose dherash) në vlerën **129,500,000 lekë** në zbatim të Ligjit nr.45/2019, datë 18.07.2019, “Për mbrojtjen Civile” dhe VKM nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

Kontabilizimi nuk është kryer në momentin e ndodhjes së tyre, pasi i gjithë dokumentacioni që vërteton kërkesat e bashkive (*për banesat e dëmtuara nga tërmeti, zjarri, përmbytjet, rrëshqitje tokash ose dherash*) për dhënien e fondeve emergjente, depozitohet dhe verifikohet nga Drejtoria e Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë, (*Spektori i Investimeve Infrastrukturore dhe Kompensimit të Qytetarëve*), për këtë arsye kontabilizimi është bërë në fund të vitit, pra mbas ndodhjes së veprimit në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, “Për Procedurat e Përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme”, pika 3.1, “Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, nën-pika pika 32, paragrafi 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 42-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**18.1. Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë, të depozitohet në kohë në Drejtorinë e Financës dhe e Shërbimeve Mbështetëse i gjithë dokumentacioni që ka vlerësuar dhe argumentuar dhënien e ndihmës financiare për familjet e dëmtuar nga fatkeqësi natyrore për banesat e dëmtuara nga tërmeti, zjarri, përmbytjet, dhe nga fatkeqësi të tjera, që detyrimet të evidentohen në pasqyrat financiare duke mbajtur parasysh njohjen në çastin e ndodhjes si shpenzime, pavarësisht nga data e pagesës së tyre nga llogarit financiare.

**18.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Drejtoria e Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë, në funksion të evidentimit në pasqyrat financiare për detyrimet, raporton çdo 4 muaj në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, lidhur me likuidimet të ndara në blloqet përkatëse financiare të shoqëruar me relacion, si dhe shtesën e detyrimeve. Në rastet e akordimit të fondeve financiare dhe hartimit të praktikës për këtë qëllim DFSHM informohet në lidhje me listën totale të shtetasve dhe vlerat përkatëse. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

### *Në proces zbatimi*

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i disa praktikave në administrim të AKMC-së “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore dhe financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, u konstatua se në asnjë prej këtyre praktikave nuk ndodhet relacioni drejtuar Titullarit të njësisë publike për mënyrën e përlllogaritjes së vlerës së ndihmës ekonomike. Përlllogaritja e vlerës së ndihmës ekonomike nga AKMC, nuk ka ndjekur një rrugë shkresore zyrtare por pas kalkulimeve dhe disa shënimeve, është proceduar me hartimin e relacionit për propozimin e akordimit të fondit financiar drejtuar Titullarit të AKMC-së. Nga auditimi i disa prej praktikave “Për akordimin e ndihmës financiare për të dëmtuarit nga tërmeti në fshatin Kuç të Himarës në muajin Janar 2019, rezultoi se mungonte gjurma e auditimit. Konkretisht, nuk evidentohet nëse kërkuesi e disponon

pronën pra nuk ka në dosje një dokument hipotekor ku të vërtetohet posedimi i pronës nga kërkuesi. Nuk gjendet bashkangjitur preventivave asnjë skicë apo planimetri ose të paktën koordinata të pozicionit gjeografik të pronës për të bërë të mundur të paktën evidentimin e pronës dhe kryerjen e matjeve online nga [www.google.com/maps](http://www.google.com/maps). Nuk ka asnjë fotografi ose regjistrim të dëmeve të shkaktuara. Procesverbalet e mbajtura nga grupet e inspektimit të dëmeve në terren të autorizuar nga Titullarët e institucioneve të vetëqeverisjes vendore, nuk janë protokolluar pranë këtyre institucioneve. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, në nivel Qendror dhe Vendor, miratuar me Urdhrin nr. 881, datë 25.06.2021 të Ministrit të Mbrojtjes, përcakton qartë tek neni 15 i saj, detyrat e Drejtorisë së Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë dhe të Sektorit të Investimeve Infrastrukturore dhe Kompensimit të Qytetarëve (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 71-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**19.1. Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë, të marrë masat që në të ardhmen të koordinohet procesi i monitorimit të institucioneve vendore dhe qendrore, për rehabilitimin dhe rimëkëmbjen e të dëmtuarve nga dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë duke dokumentuar të gjitha veprimet, proceset dhe transaksionet, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin e akordimit të shumave financiare rast pas rasti të të dëmtuarve, me qëllim krijimin dhe miradministrimin e një baze të dhënash kombëtare të dëmtimeve dhe humbjeve nga fatkeqësitë.

**19.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Është realizuar praktika për akordimin e fondeve financiare në dispozicion, e cila është shoqëruar me relacione mbi mënyrën e vlerësimit të dokumentacioneve tekniko-ligjore drejtuar titullarit të institucionit. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga Drejtori i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente nuk është përgatitur Formulari i Propozimit të Projektit të Investimit (FPPI) (projektet, preventivat dhe dokumentacioni ligjor) për projektet prioritare të investimit për vitin 2021 dhe 2022).

Për projektin kryesor të investimit “Fatkeqësi natyrore të menaxhuara” me vlerë 280,073 mijë lekë për vitin 2021.

Drejtoria e sipër cituar është dërguar 1 vit vonesë, konkretisht me shkresën nr. 1892/1, datë 30.08.2021 në Ministrinë e Mbrojtjes me subjekt “Mbi nevojën e prokurimit të projekteve prioritare të ndërhyrjeve në objektet e mbrojtjes nga përmytja” duke e bërë praktikisht të pamundur realizimin e këtij investimi prioritar dhe mos përdorimin e fondit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 30-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**20.1. Rekomandimi:** AKMC, Drejtoria e Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente të marrë masat që në të ardhmen për projektet prioritare të investimeve, të përgatisë dhe dërgojë brenda afateve ligjore formularët e propozimeve të projekteve.

**20.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Për vitin 2023 fishat për projektet e shpallura fituese janë plotësuar nga AKMC, ndërsa në çdo rast tjetër do të kërkohen të plotësuara nga subjektet aplikuese. Pritet që fishat për vitet pasardhëse të përcillen nga subjektet aplikuese. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**21. Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2020 janë kryer 2 shtesa/pakësime në vlerën 35,000 mijë lekë, për vitin 2021 janë kryer 6 shtesa/pakësime në vlerën 300,250 mijë lekë, tregojnë qartë për planifikime optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv. Mosrealizimet dhe ndryshimet e mëdha dhe të shpeshta në programet kryesore të veprimtarisë së AKMC tregojnë se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 30-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**21.1. Rekomandimi:** Nga ana e AKMC të bëhet programimi i buxhetit duke pasur parasysh nevojat reale gjatë vitit të pritshëm buxhetor dhe të shmangen programimet duke rritur bazën në një përqindje të caktuar. Gjatë vitit të angazhohen vetëm ato shpenzime të cilat janë planifikuar sipas llojit dhe të mos ndryshohet destinacioni i përdorimit të këtyre fondeve brenda artikujve buxhetorë.

**21.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Nga AKMC është parashikuar programi buxhetor afatmesëm (PBA) për vitet 2024-2026 (faza e dytë). Gjithashtu, janë vendosur prioritetet në bazë të nevojave dhe kërkesave reale të paraqitura nga drejtoritë përkatëse. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**22. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimit nr. 135, datë 15.09.2021 për vlerën 36,069,300 lekë nëpërmjet O. Bankë, është likuiduar Shoqëria “V. H.” me nipt M01624004A. Kryerja e këtij shpenzim nuk provohet me dokumentacionin e përcaktuar në marrëveshje dhe kontratë. Konkretisht:

Dokument vërtetues i urdhër shpenzimit nr. 135, datë 15.09.2021, është urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm nr. 129, datë 15.09.2021 për likuidimin e Shoqërisë “V H”, Marrëveshja ndërmjet dy palëve me nr. 1704/7 prot., i AKMC, datë 03.08.2012 dhe nr. 101 prot., i Operatorit Ekonomik “V. H.” datë 03.08.2021, kontrata me nr. 1789 prot., i AKMC, datë 16.08.2021 dhe nr. 188 prot., i Operatorit ekonomik “V. H.” datë 16.08.2021, fatura elektronike nr. 4/2021, datë 17.08.2021 në të cilën përcaktohet 89.06 orë për vlerën 36,069,300 lekë. Fatura nuk shoqërohet nga asnjë dokument tjetër për kohën operacionale të kryer në fakt referuar:

Pikës 2.5 të aktmarrëveshjes në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite se “Ministria e Mbrojtjes, AKMC kryen pagesën për shërbimet e realizuara nga Operatori Ekonomik “V. H.” dhe të monitoruara sipas pikës 2.4 të kësaj marrëveshje, pikë në të cilën është shprehur se “Ministria e Mbrojtjes, AKMC, nëpërmjet Qendrës Kombëtare Operacionale Civile (QKOEC) monitoron shërbimet e kryera nga Operatori ekonomik “V H”, duke komunikuar me shërbimet vendore të mbrojtjes civile, Mbrojtjes ndaj zjarrit (MNZ) në teren dhe Albkontroll sha”, pikës 2.6 të marrëveshjes në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite se “Njësia mbi të cilën bëhet përlllogaritja e shpenzimeve të kryera, është për orë pune operacionale ku “kohë pune operacionale”, do të konsiderohet koha nga momenti i ngritjes së helikopterëve nga Viva heliport Baldushk-Tiranë deri në kthimin në Baldushk-Tiranë...”.

Nga të dhënat e Albkontrollit, provohet që vetëm një helikopter është futur në datë 03.08.2021 në territorin e Republikës së Shqipërisë, pra nuk provohet të jenë përdor dy helikopter siç paraqitet



Regjistri i orëve operacionale, regjistër i cili nuk përcakton tipin e helikopterit dhe numrin e serisë por vetëm çertifikata e regjistrimit D-HAIQ, D-HAIL.

Si pasojë e çështjeve të trajtuar si më sipër grupi i auditimit refuzon të jap opinion, për saktësinë dhe vërtetësinë e kryerjes së këtij shpenzimi.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligji nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35, Marrëveshja ndërmjet dy palëve me nr. 1704/7 prot., i AKMC, datë 03.08.2012 dhe nr. 101 prot., i Operatorit Ekonomik “V. H.” datë 03.08.2021 kontrata me nr. 1789 prot., i AKMC, datë 16.08.2021 dhe nr. 188 prot., i Operatorit ekonomik “V H” datë 16.08.2021 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 40-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**22.1. Rekomandim:** Për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura në lidhje me shpenzimin në vlerën 36,069,300 lekë për llogari të shoqërisë “V. H.” për shërbimin e fikjes së zjarreve nga ajri në muajin gusht 2021, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktikë, por edhe për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla, me qëllim uljen e kostove të blerjes së shërbimeve.

**22.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Nga AKMC u paraqit padi kundër “V. H.” shpk, në Gjykatën Administrative të shkallës së parë Tiranë. Vendimi i Gjykatës Administrative të shkallës së parë Nr. 798, datë 11.04.2022, vendosi rrëzimin e padisë së AKMC. AKMC ka paraqitur Ankimim nr. 942 prot., datë 18.05.2022. Ankimim ka paraqitur dhe Avokatura e Shtetit me nr. 942/1 prot., datë 01.06.2023. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**23. Gjetje nga auditimi:** Nuk provohet nga ana dokumentare që të jetë kryer Drejtimi i planit operacional të zjarreve me “V. H.” nga Drejtori i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit dhe Përgjigjes së Emergjencave.

Konkretisht në zbatim të planit operacional nga R. H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente, i ngarkuar me drejtimin e planit operacional, nuk është hartuar një Plan Veprimi për monitorimin për marrjen në dorëzim shërbimit të ofruar operatori “V. H.” shpk, nuk është saktësuar dokumentacioni që do të mbahet gjatë monitorimit për marrjen në dorëzim të shërbimit të ofruar nga operatori “V. H.”, shpk si referencat ligjore për kryerjen e pagesës së këtij shërbimi. Konkretisht nuk ka një dokument (aktverifikim, aktkonstatim, procesverbal etj, ku te jenë përcaktuar lëvizjet e helikopterëve sipas plan veprimit, te urdhëruar dhe firmosur nga personat përkatës të përfshirë në operacion si: AKMC, Mbrojtjes ndaj zjarrit (MNZ) në teren, Qendrës Kombëtare Operacionale Civile (QKOE) dhe Operatorit ekonomik “V. H.” etj )

Në planin operacional, në marrëveshje, në kontratë dhe në fakt nuk ka të dokumentuar nëpërmjet një proces verbal apo akt inspektimi, kryerjen e inspektimit në Qendrën e helikopterëve Heliport të “V. H.” shpk Baldushk-Tiranë, para lidhjes së kontratës, si dhe gjatë kryerjes së shërbimit, për disponibilitetin e mjeteve ajrore të kërkuar dhe kryerjen e shërbimit sipas marrëveshjes.

Veprim në kundërshtim me marrëveshjen ndërmjet dy palëve me nr. 1704/7 prot., i AKMC, datë 03.08.2012 dhe nr. 101 prot., i Operatorit Ekonomik “V H” datë 03.08.2021 kontratën me nr. 1789 prot., i AKMC, datë 16.08.2021 dhe nr. 188 prot., i Operatorit ekonomik “V. H.” datë 16.08.2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 53-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

### **23.1. Rekomandimi**

Nga Drejtori Ekzekutiv t`i kushtohet vëmendje e duhur institucionale menaxhimit të emergjencave (zjarreve në fondin pyjor/kullësor etj.) duke marrë masa për të hartuar Plan Veprime për monitorimin dhe marrjen në dorëzim të shërbimit të ofruar operatorët ekonomik, duke saktësuar dokumentacionin që do të mbahet gjatë monitorimit për marrjen në dorëzim të shërbimit të ofruar.

**23.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Është ngritur Centrali i Sallës së Sektorit (Qendra) Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile 08000911. Në të ardhmen ky numër do të zëvendësohet me infrastrukturën e numrit të thirrjeve emergjente 112, bazuar në nenin 47 të Ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen Civile”. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 135, datë 15.09.2021, është likuiduar Shoqëria “V. H.” për vlerën 36,069,300 lekë, për 89.06 orë pune operacionale të helikopterëve të kontraktuar. Regjistri i mbajtur për orët operacionale të helikopterëve më datë 03.08.2021, pasqyron Berlin (Gjermani)-Shqipëri 11,53 orë operacionale x 405,000 lekë/ora = 4,669,650 lekë, veprim në kundërshtim me pikën 2.6 të marrëveshjes në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite se “Njësia mbi të cilën bëhet përlllogaritja e shpenzimeve të kryera, është për orë pune operacionale ku “Kohë pune operacionale”, do të konsiderohet koha nga momenti i ngritjes së helikopterëve nga V Baldushk-Tiranë deri në kthimin në Baldushk-Tiranë....”.

Vlera 4,669,650 lekë përbën dëm ekonomik për AKMC dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga Shoqëria V. H.” shpk (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 53-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandimi:** Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 4,669,650 lekë, nga Shoqëria “V. H.” shpk, për shkeljet konstatuara në kontratën me objekt “Për shërbimet e kryera për shuarjen e zjarreve në zonat e prekura në Gadishullin e Karaburunit, Bashkia Vlorë”, viti 2021, si përfitim i padrejtë i shpenzimeve Berlin(Gjermani)-Shqipëri, duke rënduar padrejtësisht koston e shërbimit në vlerën 4,669,650 lekë, vlerë e cila për AKMC dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik.

**1.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Referuar vendimit të Gjykatës Administrative të shkallës së parë Nr. 798, datë 11.04.2022 rezulton se i ngarkuari nga Drejtori i Përgjithshëm i AKMC për përfaqësim ligjor të AKMC është caktuar juristi Z. A.Z, i cili ka rezultuar në mungesë. Misur nga më sipër, AKMC nuk ka analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë administrative ligjore për shkaqet e mosprezencës të Z. Z në proces si dhe nuk ka një vlerësim të nivelit të mbrojtjes ligjore që përfaqësuesi ka bërë në gjykatë, referuar padisë apo parashtrimeve të paraqitura.

**1.3. Rekomandimi:** Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile të marrë në vlerësim dhe shqyrtim për rastin e mospërfaqësimit të AKMC në procesin gjyqësor duke evidentuar pasojat e ardhura nga mospërfaqësimi, si dhe duke bërë me dije Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi sa konstatuar për vijueshmërinë ligjore në Gjykatën Administrative të Apelit si dhe përgjegjësinë administrative ligjore të Z. Z.

*Në proces zbatimi*

## **C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me zgjedhje i listë pagesave konstatohet se për katër punonjës ish-ushtarak, që kanë përfunduar studimet e universitare në Shkollën e Lartë të Bashkuar Tiranë sistemim tre vjeçar, nga AKMC janë klasifikuar në kategorinë e sistemit katër vjeçar (master shkencor). Duke u bazuar në Urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 2012, datë 11.12.2015, “Miratimin e tabelës së ekuivalentimit të diplomave të lëshuara nga institucionet ushtarake në vite”, tabela 1 dhe 2, këto diploma ekuivalentohen si Bachelor. Në zbatim të VKM nr. 187, datë 08.03.2017, këta punonjës duhen të trajtohen me vlerën 10,000 lekë në muaj dhe jo në vlerën 14,000 lekë në muaj që i ka trajtuar AKMC-ja. Kjo praktikë është korrigjuar nga muaji mars 2021 dhe në vazhdim, ku këta punonjës janë trajtuar me vlerën 10,000 lekë në muaj në përputhje me përcaktimet e Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes. Për muajt gusht 2020 - shkurt 2021 kjo diferencë është në vlerën 78,044 lekë e cila për AKMC dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt negativ në administrimin e fondeve publike për menaxhimin me economicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 33-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandimi:** Nga Drejtori i Përgjithshëm të analizohet vlera 78,044 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me mos përcaktimin e saktë të statusit të klasifikimit dhe ekuivalentimit të diplomave universitare për punonjësit ish-ushtarak dhe ti kushtohet vëmendja e duhur institucionale mos përsëritja e rasteve të tilla në të ardhmen.

**1.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Sektori i Burimeve Njerëzore në AKMC, vijon bashkëpunimin me Ministrinë e Mbrojtjes dhe DAP për të verifikuar ekuivalentimin e diplomave të nëpunësve me arsim të lartë ushtarak. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

## **D. MASA DISIPLINORE:**

**E.1.** Mbështetur në nenet 57, 58 dhe 59 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i ndryshuar, pasi të jenë identifikuar përgjegjësitë në lidhje me shkeljet e konstatuara e të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandohet Titullarit të AKMC, t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, pranë Institucionit Tuaj dhënie e masave disiplinore si më poshtë vijon:

**E.1.a. “Largim nga shërbimi civil”, sipas pikës “ç” e nenit 58,**

**1. R.H,** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente, **për arsye se:**

-Për periudhën objekt auditimi nga AKMC, nuk janë kryer inspektime për gatishmërinë e strukturave të Mbrojtjes Civile për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civil”, neni 67 “Inspektimi”, pikat 1 dhe 2.

Plan kontrolli nr. 1390/1 prot., datë 25.06.2021 i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm “Për masat e marra nga Prefektura Fier dhe bashkitë e këtij Qarku, për gatishmërinë e strukturave të Mbrojtjes Civile për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri”, me objekt: zbatimi masave të marra dhe planet e përgatitura për përballimin e situatave të zjarreve që mund të ndodhin gjatë sezonit të verës, ngritja dhe forcimi i kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes civile, si dhe përmirësimin e infrastrukturës për parandalimin e fatkeqësive natyrore të shkaktuara nga zjarret”.

Ky program në fund ka përcaktuar se “Në përfundim të planit të kontrollit të përgatitet informacion me përfundime dhe rekomandime për eliminimin e mangësive të konstatuara. Për masat të cilat kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme, ekipi AKMC-së, të vërë detyra konkrete. Në fakt nuk është përgatitur informacion me përfundime dhe rekomandime për eliminimin e mangësive të konstatuara.

- Për periudhën objekt auditimi, në strukturat qendrore dhe vendore për marrjen e masave, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre shtetërore për gatishmërinë e strukturave të Mbrojtjes Civile për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, nuk është aplikuar asnjë kundërvajtje administrative (gjobë) ndaj strukturave që kanë shkelur ligjin për situatën e zjarreve korrik-gusht 2021, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civil”, neni 68 “Kundërvajtjet administrative”, pikat 1 dhe 2.

-Për vitin 2020, AKMC ka vlerësuar dhe argumentuar dhënien e ndihmës financiare për familjet e dëmtuar nga fatkeqësi natyrore (*tërmeti, zjarri, përmbytjet, rrëshqitje tokash ose dherash*) në vlerën **129,500,000 lekë** në zbatim të Ligjit nr.45/2019, datë 18.07.2019, “Për mbrojtjen Civile” dhe VKM nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

Kontabilizimi nuk është kryer në momentin e ndodhjes së saj, pasi i gjithë dokumentacioni që vërteton kërkesat e bashkive (*për banesat e dëmtuara nga tërmeti, zjarri, përmbytjet, rrëshqitje tokash ose dherash*) për dhënien e fondeve emergjente, depozitohet dhe verifikohet nga Drejtoria e Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë, (*Spektori i Investimeve Infrastrukturore dhe Kompensimit të Qytetarëve*), për këtë arsye kontabilizimi është bërë në fund të vitit, pra mbas ndodhjes së veprimit në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, “Për Procedurat e Përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme”, pika 3.1, “Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, nënpika pika 32, paragrafi 2

- Nga auditimi i disa praktikave në administrim të AKMC-së “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore dhe financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, u konstatua se në asnjë prej këtyre praktikave nuk ndodhet relacioni drejtuar Titullarit të njësisë publike për mënyrën e përlllogaritjes së vlerës së ndihmës ekonomike. Përlllogaritja e vlerës së ndihmës ekonomike nga AKMC, nuk ka ndjekur një rrugë shkresore zyrtare por pas kalkulimeve dhe disa shënimeve, është proceduar me hartimin e relacionit për propozimin e akordimit të fondit financiar drejtuar Titullarit të AKMC-së. Nga auditimi i disa prej praktikave “Për akordimin e ndihmës financiare për të dëmtuarit nga tërmeti në fshatin Kuç të Himarës në muajin Janar 2019, rezultoi se mungonte gjurma e auditimit. Konkretisht, nuk evidentohet nëse kërkuesi e disponon pronën pra nuk ka në dosje një dokument hipotekor ku të vërtetohet posedimi i pronës nga kërkuesi. Nuk gjendet bashkangjitur preventivave asnjë skicë apo planimetri ose të paktën koordinata të pozicionit gjeografik të pronës për të bërë të mundur të paktën evidentimin e pronës dhe kryerjen e matjeve online nga [www.google.com/maps](http://www.google.com/maps). Nuk ka asnjë fotografi ose regjistrim të dëmeve të shkaktuara. Procesverbalet e mbajtura nga grupet e inspektimit të dëmeve në terren të autorizuara nga Titullarët e institucioneve të vetëqeverisjes vendore, nuk janë protokolluar pranë këtyre institucioneve. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, në nivel Qendror dhe Vendor, miratuar me Urdhrin nr. 881, datë 25.06.2021 të Ministrit të Mbrojtjes, përcakton qartë tek neni 15 i saj, detyrat e Drejtorisë së Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe

Kompensimit nga Fatkeqësitë dhe të Sektorit të Investimeve Infrastrukturore dhe Kompensimit të Qytetarëve.

-Nga Drejtori i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente, nuk është përgatitur Formulari i Propozimit të Projektit të Investimit (FPPI) (projektet, preventivat dhe dokumentacioni ligjor) për projektet prioritare të investimit për vitin 2021 dhe 2022).

Për projektin kryesor të investimit “Fatkeqësi natyrore të menaxhuara” me vlerë 280,073 mijë lekë për vitin 2021, Drejtoria e sipër cituar është dërguar 1 vit vonesë, konkretisht me shkresën nr. 1892/1, datë 30.08.2021 në Ministrinë e Mbrojtjes me subjekt “Mbi nevojën e prokurimit të projekteve prioritare të ndërhyrjeve në objektet e mbrojtjes nga përmytja” duke e bërë praktikisht të pamundur realizimin e këtij investimi prioritar dhe mos përdorimin e fondit.

-Nuk provohet nga ana dokumentare që të jetë kryer drejtimi i planit operacional të zjarreve me “V. H.” nga Drejtori i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit dhe Përgjigjes së Emergjencave. Konkretisht në zbatim të planit operacional nga R.H me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente, i ngarkuar me drejtimin e planit operacional, nuk është hartuar një Plan Veprimi për monitorimin për marrjen në dorëzim shërbimit të ofruar operatori “V. H.” shpk, nuk është saktësuar dokumentacioni që do të mbahet gjatë monitorimit për marrjen në dorëzim të shërbimit të ofruar nga operatori “V. H.”, shpk si referencat ligjore për kryerjen e pagesës së këtij shërbimi. Konkretisht nuk ka një dokument (aktverifikim, aktkonstatim, procesverbal etj, ku të jenë përcaktuar lëvizjet e helikopterëve sipas plan veprimit, të urdhëruar dhe firmosur nga personat përkatës të përfshirë në operacion si: AKMC, Mbrojtjes ndaj zjarrit (MNZ) në terren, Qendrës Kombëtare Operacionale Civile (QKOEK) dhe Operatorit ekonomik “V. H.” etj)

Në planin operacional, në marrëveshje, në kontratë dhe në fakt nuk ka të dokumentuar nëpërmjet një proces verbal apo akt inspektimi, kryerjen e inspektimit në Qendrën e helikopterëve Heliport të “V. H.” shpk Baldushk-Tiranë, para lidhjes së kontratës, si dhe gjatë kryerjes së shërbimit, për disponibilitetin e mjeteve ajrore të kërkuar dhe kryerjen e shërbimit sipas marrëveshjes.

**Nga verifikimi rezultoi se:** *Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AKMC u ngrit Komisioni Disiplinor Nr.115 datë 23.05.2022 i cili me Vendimin Nr. 4 datë 12.07.2022 vendosi masën disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 1 vjeçare” për Z. R.H.Rekomandimi nuk është zbatuar, sepse grupi i auditimit të KLSH ka dhënë masën “Largim nga shërbimi civil”, sipas pikës “ç” e nenit 58, ndërkohë që Komisioni Disiplinor ka dhënë masë më të vogël: “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 1 vjeçare”. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe pazbatuar.*

#### ***Pa zbatuar***

**2. P.K,** me detyrë përgjegjësi i sektorit të buxhetit **për arsye se:**

Me urdhër shpenzimin nr. 135, datë 15.09.2021, është likuiduar Shoqëria “V. H.” për vlerën 36,069,300 lekë, për 89.06 orë pune operationale të helikopterëve të kontraktuar. Regjistri i mbajtur për orët operationale të helikopterëve më datë 03.08.2021, pasqyron Berlin ( Gjermani)- Shqipëri 11,53 orë operationale x 405,000 lekë/ora = 4,669,650 lekë, veprim në kundërshtim me pikën 2.6 të marrëveshjes në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite se “Njësia mbi të cilën bëhet përlllogaritja e shpenzimeve të kryera, është për orë pune operationale ku “Kohë pune operationale”, do të konsiderohet koha nga momenti i ngritjes së helikopterëve nga V Baldushk-Tiranë deri në kthimin në Baldushk-Tiranë....”.

Vlera 4,669,650 lekë përbën dëm ekonomik për AKMC dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga Shoqëria V. H.” shpk

- AKMC, në ndërhyrjen për fikjen e zjarreve nga ajri në muajin gusht 2021, ka kryer procedurë prokurimi për sigurimin e dy mjeteve ajrore, pa kompetencë (tagër ligjor) të deleguar nga Ministri i Mbrojtjes. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Ministrisë së Mbrojtjes nr. 3, datë 13.02.2015 “Për prokurimin Publik në Ministrin e Mbrojtjes, Strukturave të vartësisë dhe në Forcat e Armatosura”, KREU III, pika 3, KREU IV, pik 11, nenet 28 e 29, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 21, pika 5, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, dhe të nenit 73, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-AKMC në shpenzimin në vlerën 36,069,300 lekë për ndërhyrjen e fikjes së zjarreve nga ajri në muajin gusht 2021, nuk ka përcaktuar llojin e procedurës (pra nuk ka një procedurë të mirëfilltë) në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 41 dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 46.

-Procedura e prokurimit ka filluar pa pasur fondin në dispozicion. Konkretisht fondi është çelur nga Ministria e Mbrojtjes me shkresën nr. 4195/4 prot., datë 29.08.2021 dhe nr. 4404/2 prot., datë 01.10.2021 po për këtë vlerë, dhe jo më datë 03.08.2021, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 40 dhe neni 50.

Për këtë procedurë prokurimi nuk është marrë autorizimi i urdhër prokurimit nga Dega e Thesarit Tiranë, përpara se të fillojë procesi i prokurimit. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9/1 dt. 20.03.2018, pjesa III, Procedurat për kryerjen e shpenzimeve, dhe pika 15.1

- Me urdhër shpenzimin nr. 135, datë 15.09.2021 për vlerën 36,069,300 lekë nëpërmjet O. Bankë, është likuiduar Shoqëria “V. H.” me nipt M-A. Kryerja e këtij shpenzim nuk provohet me dokumentacionin e përcaktuar në marrëveshje dhe kontratë. Konkretisht:

Dokument vërtetues i urdhër shpenzimit nr. 135, datë 15.09.2021, është urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm nr. 129, datë 15.09.2021 për likuidimin e Shoqërisë “V. H.”, Marrëveshja ndërmjet dy palëve me nr. 1704/7 prot., i AKMC, datë 03.08.2012 dhe nr. 101 prot., i Operatorit Ekonomik “V. H.” datë 03.08.2021, kontrata me nr. 1789 prot., i AKMC, datë 16.08.2021 dhe nr. 188 prot., i Operatorit ekonomik “V. H.” datë 16.08.2021, fatura elektronike nr. 4/2021, datë 17.08.2021 në të cilën përcaktohet 89.06 orë për vlerën 36,069,300 lekë. Fatura nuk shoqërohet nga asnjë dokument tjetër për ***kohën operationale të kryer në fakt referuar:***

Pikës 2.5 të aktmarrëveshjes, në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite se “Ministria e Mbrojtjes, AKMC kryen pagesën për shërbimet e realizuara nga Operatori Ekonomik “V. H.” dhe të monitoruara sipas pikës 2.4 të kësaj marrëveshje, pikë në të cilën është shprehur se “Ministria e Mbrojtjes, AKMC, nëpërmjet Qendrës Kombëtare Operationale Civile (QKOE) monitoron shërbimet e kryera nga Operatori ekonomik “V. H.”, ***duke komunikuar me shërbimet vendore të mbrojtjes civile, Mbrojtjes ndaj zjarrit (MNZ) në teren dhe Albkontroll sha***”, pikës 2.6 të marrëveshjes në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite se “***Njësia mbi të cilën bëhet përlllogaritja e shpenzimeve të kryera, është për orë pune operationale ku “kohë pune operationale”, do të konsiderohet koha nga momenti i ngritjes së helikopterëve nga Viva heliport Baldushk-Tiranë deri në kthimin në Baldushk-Tiranë....***”.

Nga të dhënat e Aktkontrollit, provohet që vetëm një helikopter është futur në datë 03.08.2021 në territorin e Republikës së Shqipërisë, pra nuk provohet të jenë përdor dy helikopter siç paraqitet

regjistri i orëve operacionale, regjistër i cili nuk përcakton tipin e helikopterit dhe numrin e serisë por vetëm certifikata e regjistrimit D-HAIQ, D-HAIL.

Si pasojë e çështjeve të trajtuar si më sipër grupi i auditimit refuzon të jap opinion, për saktësinë dhe vërtetësinë e kryerjes së këtij shpenzimi.

-Në planin operacional, në marrëveshje, në kontratë dhe në fakt nuk ka të dokumentuar nëpërmjet një proces verbali apo akt inspektimi, kryerjen e inspektimit në Qendrën e Helikopterëve Heliport të “V. H.” shpk Baldushk-Tiranë, para lidhjes së kontratës, si dhe gjatë kryerjes së shërbimit, për disponibilitetin e mjeteve ajrore të kërkuar dhe kryerjen e shërbimit sipas marrëveshjes.

**Nga verifikimi rezultoi se:** *Me udhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AKMC u ngrit Komisioni Disiplinor Nr.114 datë 23.05.2022 i cili me Vendimin Nr. 3 datë 12.07.2022 vendosi masën disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 1 vjeçare” për Z. P.K.Rekomandimi nuk është zbatuar, sepse grupi i auditimit të KLSH ka dhënë masën “Largim nga shërbimi civil”, sipas pikës “ç” e nenit 58, ndërkohë që Komisioni Disiplinor ka dhënë masë më të vogël: “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 1 vjeçare”. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe pazbatuar.*

***Pa zbatuar***

**3. K.N,** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Projekteve, **për arsye se:**

Kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik “V. H.” nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” nenet 77,87,89,90,92 dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82. Konkretisht:

-Operatori ekonomik “V. H.”shpk nuk disponon asnjë mjet të fluturimit ajror, por ka aktmarrëveshjen e datës 07.06.2020 ndërmjet Operatorit ekonomik “V. H.”shpk, dhe Kompanisë A I G & C Gjermani, dokument i pavlefshëm për tu marr në konsideratë pasi:

-Marrëveshja nuk ka të përcaktuar vlerën e qirasë.

-Konfirmimin që qiraja është miratuar nga autoritetet aeronautike të qiramarrësit.

-Konfirmimi i operacioneve të linjave ajrore dhe manualeve të fluturimit.

-Dy kopje të manifestit të ngarkesës (depozitës së ujit).

-Licencën Operative , në përputhje me kapitullin 2 të Rregullores së (KE) nr. 1008/2008, të lëshuar nga autoriteti aeronautikë i vendit të regjistrimit

Veprim në kundërshtim me Rregulloren e (KE) nr. 1008/2008 udhëzim nr.14, datë 9.9.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e ministrit nr.17, datë 2.9.2010 "mbi rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajrore", pika 1 dhe 2.

-Nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar si: Kontrata për shërbime të ngjashme dhe vet deklarimi që mjetet janë në gjendje të mirë teknike dhe operatori zotëron të gjitha kapacitetet ligjore dhe teknike për ushtrimin e aktivitetit, si dhe në ofertën ekonomike nuk jepen të dhëna të sakta për numrin e mjeteve ajrore të angazhuara dhe ofertë e detajuar për çdo mjetë ajror, nëse është rasti, provon faktin se Operatori ekonomik “V. H.”, nuk duhet të ishte jo vetëm përzgjedhur, dhe aq më tepër kontraktuar.

Në planin operacional, në marrëveshje, në kontratë dhe në fakt nuk ka të dokumentuar nëpërmjet një proces verbali apo akt inspektimi, kryerjen e inspektimit në Qendrën e helikopterëve Heliport të “V. H.” shpk Baldushk-Tiranë, para lidhjes së kontratës, si dhe gjatë kryerjes së shërbimit, për disponibilitetin e mjeteve ajrore të kërkuar dhe kryerjen e shërbimit sipas marrëveshjes.

**Nga verifikimi rezultoi se:** Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AKMC u ngrit Komisioni Disiplinor Nr.113 datë 23.05.2022 i cili me Vendimin Nr. 5 datë 12.07.2022 vendosi masën disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 1 vjeçare” për Z. K.N.Rekomandimi nuk është zbatuar, sepse grupi i auditimit të KLSH ka dhënë masën “Largim nga shërbimi civil”, sipas pikës “ç” e nenit 58, ndërkohë që Komisioni Disiplinor ka dhënë masë më të vogël: “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 1 vjeçare”. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe pazbatuar.

*Pa zbatuar*

**E.1.b. “Vërejtje” e parashikuar nga neni 58, shkronja (a), për:**

**1. F.B,** me detyrë specialiste, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Buxhetit dhe Financës.

**Nga verifikimi rezultoi se:** Nga AKMC nuk janë marrë masa për realizimin e rekomandimit. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe pazbatuar.

*Pa zbatuar*

**2. R.B,** me detyrë specialist, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Prokurimit dhe Marrëdhënieve Kontraktuale .

**Për arsye se:**

Me urdhër shpenzimin nr. 53, datë 11.12.2020 për vlerën 120,000 lekë nëpërmjet B., është likuiduar Shoqëria “D.A”Sh.a. Ky shpenzim ka të bëjë me shërbim makine (pjesë këmbimi dhe bateri). Ky shpenzim është klasifikuar në strukturën e llogarisë (artikullin) 6023200, duke u konsideruar blerje me vlerë të vogël “Rast emergjent”, formulari nr.4.

Në fakt ky shpenzim nuk është rast emergjent, por një shërbim i rregullt, dhe duhet të ishte zbatuar procedurë prokurimi për përzgjedhjen e operatorit ekonomik.

-Për këtë shpenzim nga Shoqëria “D.A” sh.a është lëshuar fatura tatimore shitje 321561013, datë 03.12.2020, firmosur nga F.B, R.B dhe F.K. Në fakt duhej firmosur nga personat e ndodhur në udhëtim K.N dhe J.H.

Urdhër shpenzimi, nuk ka bashkëlidhur dokumentacionin vërtetues të kryerjes së këtij shpenzimi:

-Kontratën me karrotecin dhe sa është likuiduar për ta çuar makinën tek vendi i shërbimit, ose mjeti që e ka tërhequr.

-Fletëdaljen e pjesëve të këmbimit (fakt që nuk ka fletëdalje, çka presupozon që pjesët duhet të jenë në magazinë).

-Situacionin e shërbimit të lëshuar nga operatori ekonomik Shoqëria “D.A”Sh.a.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr. 3, datë 8.01.20181 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 18, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35.

**E.2.** Mbështetur në nenet 57, 58 dhe 59 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i ndryshuar, pasi të jenë identifikuar përgjegjësitë në lidhje me shkeljet e konstatuara e të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandohet Titullarit të AKMC, marrjen/ose jo të masave disiplinore ndaj personelit që nuk përfshirë në pikën **D.1**, duke marrë në konsideratë shkeljet



ligjore dhe përgjegjësi respektive të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të performancës së punës së tyre, si dhe të masave disiplinore të dhëna më parë.

**E.3.** Për punonjësit e identifikuar me përgjegjësi për shkeljet e konstatuara, Titullari i AKMC, pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

**Nga verifikimi rezultoi se:** Nga AKMC nuk janë marrë masa për realizimin e rekomandimit. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe pazbatuar.

*Pa zbatuar*

#### **IV- KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME:**

Në përfundim të procesit të auditimit, në Bashkinë Malësi e Madhe për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, të pazbatuara ose të zbatuara pjesërisht, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore deri në mbylljen e plotë të tyre, si më poshtë:

#### **D. MASA DISIPLINORE:**

**D.1.** Mbështetur në nenet 57, 58 dhe 59 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", i ndryshuar, pasi të jenë identifikuar përgjegjësitë në lidhje me shkeljet e konstatuara e të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandohet Titullarit të AKMC, t'i kërkojë Komisionit Disiplinor, pranë Institucionit Tuaj dhënie e masave disiplinore si më poshtë vijon:

**D.1.a. "Largim nga shërbimi civil", sipas pikës "ç" e nenit 58,**

**1. R.H,** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente, **për arsye se:**

-Për periudhën objekt auditimi nga AKMC, nuk janë kryer inspektime për gatishmërinë e strukturave të Mbrojtjes Civile për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civil", neni 67 "Inspektimi", pikat 1 dhe 2.

Plan kontrolli nr. 1390/1 prot., datë 25.06.2021 i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm "Për masat e marra nga Prefektura Fier dhe bashkitë e këtij Qarku, për gatishmërinë e strukturave të Mbrojtjes Civile për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri", me objekt: zbatimi masave të marra dhe planet e përgatitura për përballimin e situatave të zjarreve që mund të ndodhin gjatë sezonit të verës, ngritja dhe forcimi i kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes civile, si dhe përmirësimin e infrastrukturës për parandalimin e fatkeqësive natyrore të shkaktuara nga zjarret".

Ky program në fund ka përcaktuar se "Në përfundim të planit të kontrollit të përgatitet informacion me përfundime dhe rekomandime për eliminimin e mangësive të konstatuara. Për masat të cilat kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme, ekipi AKMC-së, të vërë detyra konkrete. Në fakt nuk është përgatitur informacion me përfundime dhe rekomandime për eliminimin e mangësive të konstatuara.

- Për periudhën objekt auditimi, në strukturat qendrore dhe vendore për marrjen e masave, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre shtetërore për gatishmërinë e strukturave të Mbrojtjes Civile për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, nuk është aplikuar asnjë kundërvajtje administrative (gjobë) ndaj strukturave që kanë shkëlur ligjin për situatën e zjarreve korrik-gusht 2021, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civil”, neni 68 “Kundërvajtjet administrative”, pikat 1 dhe 2.

-Për vitin 2020, AKMC ka vlerësuar dhe argumentuar dhënien e ndihmës financiare për familjet e dëmtuar nga fatkeqësi natyrore (*tërmeti, zjarri, përmytjet, rrëshqitje tokash ose dherash*) në vlerën **129,500,000 lekë**në zbatim të Ligjit nr.45/2019, datë 18.07.2019, “Për mbrojtjen Civile” dhe VKM nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

Kontabilizimi nuk është kryer në momentin e ndodhjes së saj, pasi i gjithë dokumentacioni që vërteton kërkesat e bashkive (*për banesat e dëmtuara nga tërmeti, zjarri, përmytjet, rrëshqitje tokash ose dherash*) për dhënien e fondeve emergjente, depozitohet dhe verifikohet nga Drejtoria e Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë, (*Spektori i Investimeve Infrastrukturore dhe Kompensimit të Qytetarëve*), për këtë arsye kontabilizimi është bërë në fund të vitit, pra mbas ndodhjes së veprimit në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, “Për Procedurat e Përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme”, pika 3.1, “Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, nënpika pika 32, paragrafi 2

- Nga auditimi i disa praktikave në administrim të AKMC-së “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore dhe financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, u konstatua se në asnjë prej këtyre praktikave nuk ndodhet relacioni drejtuar Titullarit të njësisë publike për mënyrën e përlllogaritjes së vlerës së ndihmës ekonomike. Përlllogaritja e vlerës së ndihmës ekonomike nga AKMC, nuk ka ndjekur një rrugë shkresore zyrtare por pas kalkulimeve dhe disa shënimeve, është proceduar me hartimin e relacionit për propozimin e akordimit të fondit financiar drejtuar Titullarit të AKMC-së. Nga auditimi i disa prej praktikave “Për akordimin e ndihmës financiare për të dëmtuarit nga tërmeti në fshatin Kuç të Himarës në muajin Janar 2019, rezultoi se mungonte gjurma e auditimit. Konkretisht, nuk evidentohet nëse kërkuesi e disponon pronën pra nuk ka në dosje një dokument hipotekor ku të vërtetohet posedimi i pronës nga kërkuesi. Nuk gjendet bashkangjitur preventivave asnjë skicë apo planimetri ose të paktën koordinata të pozicionit gjeografik të pronës për të bërë të mundur të paktën evidentimin e pronës dhe kryerjen e matjeve online nga [www.google.com/maps](http://www.google.com/maps). Nuk ka asnjë fotografi ose regjistrim të dëmeve të shkaktuara. Procesverbalet e mbajtura nga grupet e inspektimit të dëmeve në terren të autorizuara nga Titullarët e institucioneve të vetëqeverisjes vendore, nuk janë protokolluar pranë këtyre institucioneve. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, në nivel Qendror dhe Vendor, miratuar me Urdhrin nr. 881, datë 25.06.2021 të Ministrisë së Mbrojtjes, përcakton qartë tek neni 15 i saj, detyrat e Drejtorisë së Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë dhe të Sektorit të Investimeve Infrastrukturore dhe Kompensimit të Qytetarëve.

-Nga Drejtoria e Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente, nuk është përgatitur Formulari i Propozimit të Projektit të Investimit (FPPI) (projektet, preventivat dhe dokumentacioni ligjor) për projektet prioritare të investimit për vitin 2021 dhe 2022).

Për projektin kryesor të investimit “Fatkeqësi natyrore të menaxhuara” me vlerë 280,073 mijë lekë për vitin 2021, Drejtoria e sipër cituar është dërguar 1 vit vonesë, konkretisht me shkresën nr. 1892/1, datë 30.08.2021 në Ministrinë e Mbrojtjes me subjekt “Mbi nevojën e prokurimit të projekteve prioritare të ndërhyrjeve në objektet e mbrojtjes nga përmytja” duke e bërë praktikisht të pamundur realizimin e këtij investimi prioritar dhe mos përdorimin e fondit

-Nuk provohet nga ana dokumentare që të jetë kryer drejtimi i planit operacional të zjarreve me “V. H.” nga Drejtori i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit dhe Përgjigjes së Emergjencave. Konkretisht në zbatim të planit operacional nga R.H me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente, i ngarkuar me drejtimin e planit operacional, nuk është hartuar një Plan Veprimi për monitorimin për marrjen në dorëzim shërbimit të ofruar operatori “V. H.” shpk, nuk është saktësuar dokumentacioni që do të mbahet gjatë monitorimit për marrjen në dorëzim të shërbimit të ofruar nga operatori “V. H.”, shpk si referencat ligjore për kryerjen e pagesës së këtij shërbimi. Konkretisht nuk ka një dokument (aktverifikim, aktkonstatim, procesverbal etj, ku të jenë përcaktuar lëvizjet e helikopterëve sipas plan veprimit, të urdhëruar dhe firmosur nga personat përkatës të përfshirë në operacion si: AKMC, Mbrojtjes ndaj zjarrit (MNZ) në terren, Qendrës Kombëtare Operacionale Civile (QKOC) dhe Operatorit ekonomik “V. H.” etj )

Në planin operacional, në marrëveshje, në kontratë dhe në fakt nuk ka të dokumentuar nëpërmjet një proces verbal apo akt inspektimi, kryerjen e inspektimit në Qendrën e helikopterëve Heliport të “V. H.” shpk Baldushk-Tiranë, para lidhjes së kontratës, si dhe gjatë kryerjes së shërbimit, për disponibilitetin e mjeteve ajrore të kërkuar dhe kryerjen e shërbimit sipas marrëveshjes.

*Menjëherë*

## **2. P.K, me detyrë përgjegjësi i sektorit të buxhetit për arsye se:**

Me urdhër shpenzimin nr. 135, datë 15.09.2021, është likuiduar Shoqëria “V. H.” për vlerën 36,069,300 lekë, për 89.06 orë pune operationale të helikopterëve të kontraktuar. Regjistri i mbajtur për orët operationale të helikopterëve më datë 03.08.2021, pasqyron Berlin ( Gjermani)-Shqipëri 11,53 orë operationale x 405,000 lekë/ora = 4,669,650 lekë, veprim në kundërshtim me pikën 2.6 të marrëveshjes në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite se “Njësia mbi të cilën bëhet përlllogaritja e shpenzimeve të kryera, është për orë pune operationale ku “Kohë pune operationale”, do të konsiderohet koha nga momenti i ngritjes së helikopterëve nga V Baldushk-Tiranë deri në kthimin në Baldushk-Tiranë....”.

Vlera 4,669,650 lekë përbën dëm ekonomik për AKMC dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga Shoqëria V. H.” shpk

- AKMC, në ndërhyrjen për fikjen e zjarreve nga ajri në muajin gusht 2021, ka kryer procedurëprokurimi për sigurimin e dy mjeteve ajrore, pa kompetencë (tagër ligjor) të deleguar nga Ministri i Mbrojtjes. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Mbrojtjes nr. 3, datë 13.02.2015 “Për prokurimin Publik në Ministrinë e Mbrojtjes, Strukturave të vartësisë dhe në Forcat e Armatosura”, KREU III, pika 3, KREU IV, pik 11, nenet 28 e 29, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 21, pika 5, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, dhe të nenit 73, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-AKMC në shpenzimin në vlerën 36,069,300 lekë për ndërhyrjen e fikjes së zjarreve nga ajri në muajin gusht 2021, nuk ka përcaktuar llojin e procedurës (pra nuk ka një procedurë të mirëfilltë) në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 41 dhe me

Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 46.

-Procedura e prokurimit ka filluar pa pasur fondin në dispozicion. Konkretisht fondi është çelur nga Ministria e Mbrojtjes me shkresën nr. 4195/4 prot., datë 29.08.2021 dhe nr. 4404/2 prot., datë 01.10.2021 po për këtë vlerë, dhe jo më datë 03.08.2021, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 40 dhe neni 50.

Për këtë procedurë prokurimi nuk është marrë autorizimi i urdhër prokurimit nga Dega e Thesarit Tiranë, përpara se të fillojë procesi i prokurimit. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9/1 dt. 20.03.2018, pjesa III, Procedurat për kryerjen e shpenzimeve, dhe pika 15.1

- Me urdhër shpenzimit nr. 135, datë 15.09.2021 për vlerën 36,069,300 lekë nëpërmjet O. Bankë, është likuiduar Shoqëria “V. H.” me nipt M01624004A. Kryerja e këtij shpenzim nuk provohet me dokumentacionin e përcaktuar në marrëveshje dhe kontratë. Konkretisht:

Dokument vërtetues i urdhër shpenzimit nr. 135, datë 15.09.2021, është urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm nr. 129, datë 15.09.2021 për likuidimin e Shoqërisë “V. H.”, Marrëveshja ndërmjet dy palëve me nr. 1704/7 prot., i AKMC, datë 03.08.2012 dhe nr. 101 prot., i Operatorit Ekonomik “V. H.” datë 03.08.2021, kontrata me nr. 1789 prot., i AKMC, datë 16.08.2021 dhe nr. 188 prot., i Operatorit ekonomik “V. H.” datë 16.08.2021, fatura elektronike nr. 4/2021, datë 17.08.2021 në të cilën përcaktohet 89.06 orë për vlerën 36,069,300 lekë. Fatura nuk shoqërohet nga asnjë dokument tjetër për ***kohën operationale të kryer në fakt referuar:***

Pikës 2.5 të aktmarrëveshjes, në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite se “Ministria e Mbrojtjes, AKMC kryen pagesën për shërbimet e realizuara nga Operatori Ekonomik “V. H.” dhe të monitoruara sipas pikës 2.4 të kësaj marrëveshje, pikë në të cilën është shprehur se “Ministria e Mbrojtjes, AKMC, nëpërmjet Qendrës Kombëtare Operationale Civile (QKOE) monitoron shërbimet e kryera nga Operatori ekonomik “V. H.”, ***duke komunikuar me shërbimet vendore të mbrojtjes civile, Mbrojtjes ndaj zjarrit (MNZ) në teren dhe Albkontroll sha***”, pikës 2.6 të marrëveshjes në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite se “***Njësia mbi të cilën bëhet përlllogaritja e shpenzimeve të kryera, është për orë pune operationale ku “kohë pune operationale”, do të konsiderohet koha nga momenti i ngritjes së helikopterëve nga Viva heliport Baldushk-Tiranë deri në kthimin në Baldushk-Tiranë... ”.***

Nga të dhënat e Aktkontrollit, provohet që vetëm një helikopter është futur në datë 03.08.2021 në territorin e Republikës së Shqipërisë, pra nuk provohet të jenë përdor dy helikopter siç paraqitet regjistri i orëve operationale, regjistër i cili nuk përcakton tipin e helikopterit dhe numrin e serisë por vetëm çertifikata e regjistrimit D-HAIQ, D-HAIL.

Si pasojë e çështjeve të trajtuar si më sipër grupi i auditimit refuzon të jap opinion, për saktësinë dhe vërtetësinë e kryerjes së këtij shpenzimi.

-Në planin operational, në marrëveshje, në kontratë dhe në fakt nuk ka të dokumentuar nëpërmjet një proces verbal apo akt inspektimi, kryerjen e inspektimit në Qendrën e Helikopterëve Heliport të “V. H.” shpk Baldushk-Tiranë, para lidhjes së kontratës, si dhe gjatë kryerjes së shërbimit, për disponibilitetin e mjeteve ajrore të kërkuar dhe kryerjen e shërbimit sipas marrëveshjes.

***Menjëherë***

**3. K.N**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Projekteve, **për arsye se:**

Kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik “V. H.” nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për

prokurimin publik” nenet 77,87,89,90,92 dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82. Konkretisht:

-Operatori ekonomik “V. H.”shpk nuk disponon asnjë mjet të fluturimit ajror, por ka aktmarrëveshjen e datës 07.06.2020 ndërmjet Operatorit ekonomik “V. H.”shpk, dhe Kompanisë A I G & CGjermani, dokument i pavlefshëm për tu marr në konsideratë pasi:

-Marrëveshja nuk ka të përcaktuar vlerën e qirasë.

-Konfirmimin që qiraja është miratuar nga autoritetet aeronautike të qiramarrësit.

-Konfirmimi i operacioneve të linjave ajrore dhe manualeve të fluturimit.

-Dy kopje të manifestit të ngarkesës (depozitës së ujit).

-Licencën Operative , në përputhje me kapitullin 2 të Rregullores së (KE) nr. 1008/2008, të lëshuar nga autoriteti aeronautikë i vendit të regjistrimit

Veprim në kundërshtim me Rregulloren e (KE) nr. 1008/2008 udhëzim nr.14, datë 9.9.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e ministrit nr.17, datë 2.9.2010 "mbi rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajrore", pika 1 dhe 2.

-Nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar si: Kontrata për shërbime të ngjashme dhe vet deklarimi që mjetet janë në gjendje të mirë teknike dhe operatori zotëron të gjitha kapacitetet ligjore dhe teknike për ushtrimin e aktivitetit, si dhe në ofertën ekonomike nuk jepen të dhëna të sakta për numrin e mjeteve ajrore të angazhuara dhe ofertë e detajuar për çdo mjetë ajror, nëse është rasti, provon faktin se Operatori ekonomik “V. H.”, nuk duhet të ishte jo vetëm përzgjedhur, dhe aq më tepër kontraktuar.

Në planin operacional, në marrëveshje, në kontratë dhe në fakt nuk ka të dokumentuar nëpërmjet një proces verbal apo akt inspektimi, kryerjen e inspektimit në Qendrën e helikopterëve Heliport të “V. H.” shpk Baldushk-Tiranë, para lidhjes së kontratës, si dhe gjatë kryerjes së shërbimit, për disponibilitetin e mjeteve ajrore të kërkuar dhe kryerjen e shërbimit sipas marrëveshjes.

*Menjëherë*

#### **D.1.b. “Vërejtje” e parashikuar nga neni 58, shkronja (a), për:**

**1. F.B.**, me detyrë specialiste, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Buxhetit dhe Financës.

*Menjëherë*

**2. R.B.**, me detyrë specialist, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Prokurimit dhe Marrëdhënieve Kontraktuale .

#### **Për arsye se:**

Me urdhër shpenzimin nr. 53, datë 11.12.2020 për vlerën 120,000 lekë nëpërmjet B., është likuiduar Shoqëria “D.A”Sh.a. Ky shpenzim ka të bëjë me shërbim makine (pjesë këmbimi dhe bateri). Ky shpenzim është klasifikuar në strukturën e llogarisë (artikullin) 6023200, duke u konsideruar blerje me vlerë të vogël “Rast emergjent”, formulari nr.4.

Në fakt ky shpenzim nuk është rast emergjent, por një shërbim i rregullt, dhe duhet të ishte zbatuar procedurë prokurimi për përzgjedhjen e operatorit ekonomik.

-Për këtë shpenzim nga Shoqëria “D.A” sh.a është lëshuar fatura tatimore shitje 321561013, datë 03.12.2020, firmosur nga F.B, R.B dhe F.K. Në fakt duhej firmosur nga personat e ndodhur në udhëtim K.N dhe J.H.

Urdhër shpenzimi, nuk ka bashkëlidhur dokumentacionin vërtetues të kryerjes së këtij shpenzimi:

-Kontratën me karrotecin dhe sa është likuiduar për ta çuar makinën tek vendi i shërbimit, ose mjeti që e ka tërhequr.

-Fletëdaljen e pjesëve të këmbimit (fakt që nuk ka fletëdalje, çka presupozon që pjesët duhet të jenë në magazinë).

-Situacionin e shërbimit të lëshuar nga operatori ekonomik Shoqëria "D.A"Sh.a.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr. 3, datë 8.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", pika 18, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik", me ndryshimet vijuese të tij, pika 35.

**D.2.** Mbështetur në nenet 57, 58 dhe 59 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", i ndryshuar, pasi të jenë identifikuar përgjegjësitë në lidhje me shkeljet e konstatuara e të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandohet Titullarit të AKMC, marrjen/ose jo të masave disiplinore ndaj personelit që nuk përfshirë në pikën **D.1**, duke marrë në konsideratë shkeljet ligjore dhe përgjegjësiive respektive të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të performancës së punës së tyre, si dhe të masave disiplinore të dhëna më parë.

**D.3.** Për punonjësit e identifikuar me përgjegjësi për shkeljet e konstatuara, Titullari i AKMC, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

*Menjëherë*

*Në lidhje me masat e konstatuara në proces zbatimi ose të zbatuara pjesërisht, nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile të vijojnë përpjekjet duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore deri në zbatimin e plotë të tyre.*

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë Vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja. Ky vendim përcillet në formë rekomandimi në subjektin e auditimit.

### **3.4 ALBGAZI**

#### **PËRMBLEDHJE**

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), bazuar në programin e auditimit nr. 702/1 prot., datë 04.08.2023, "Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022", ushtroi auditim në Albغاز SHA, për zbatimin e rekomandimeve të lëna, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, të përcjellë:

- Në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me shkresën nr. 51/7 prot., datë 23.06.2022.

Duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

**a.** Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së, të lëna nga auditimi i vitit 2022, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjektet e audituara, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

- b. Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike, të akteve administrative të nevojshme, si vendime e urdhra për zbatimin e masave organizative;
- c. Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

**Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:**

**I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.**

- Në zbatim të nenin 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Albgaz Sh.a, ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 9/12 prot., datë 27.07.2023. Rekomandimi është zbatuar, por nuk është respektuar afati 20 ditor, në mospërputhje me Nenin 15, pikën "j" të Ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

**II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.**

- Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna", u konstatua se nga Albgaz Sh.a nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve duke mos respektuar kështu edhe afatin 6 mujor, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30, pika 2.

**III. Rekomandimet e KLSH**

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit me nr. 51/7 prot., datë 23.06.2022, janë rekomanduar gjithsej:

- a. **20 masa organizative;**
- b. **4 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën 18,451,812 lekë;**
- c. **5 masa disiplinore.**

**IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH**

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit me nr. 51/7 prot., datë 23.06.2022, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar Plotësisht	Pa pranuar
1	Organizative	20 masa	20 masa	0
2	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	4 masa	4 masa	0
3	Disiplinore	5 masa	5 masa	0

## V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit

Në mënyrë të përmblëdhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	20 masa	2 masa	1 masë	10 masa	7 masa
2	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	4 masa	0	0	2 masa	2 masa
3	Disiplinore	5 masa	0	0	4 masa	1 masë

### I/1. HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" si dhe manualit "Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve".

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 702/1 prot., datë 04.08.2023, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, është kryer nga audituesit shtetërorë të KLSH-së:

1. K.SH, Anëtar.
2. J.M, Anëtar.

### I/2 OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara të dërguara me shkresën e KLSH me shkresat e cituara në pikën I/4 të këtij Projekt Raporti, për auditimin e ushtruar në Albgaz SHA.

### I/3 QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tre-mujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3, të nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

### I/4 METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që lidhet me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen të subjekteve të audituara.

### I/5 KONKLUZIONI

Në Albgaz SHA, në mospërputhje me nenin 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", nuk janë marrë masa për respektimin e afatit ligjor prej 20 ditësh për të informuar KLSH-në mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Gjithashtu, në Albgaz SHA, në mospërputhje me nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", nuk janë marrë masa për



dërgimin e informacioneve në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit 6 mujor.

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga Albgaz SHA, me shkresat e cituara në pikën I/4 të këtij Projekt Raporti, rezulton se:

-Nga 29 masat e rekomanduara, nga subjektet janë pranuar 29 masa ose në masën 100 %. Nga 29 masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 2 masa ose 7 % e tyre, është zbatuar pjesërisht 1 masë ose 3 %, janë në proces zbatimi 16 masa ose 55 % dhe janë pa zbatuar 10 masa ose 35 %.

Në numër dhe në % statusi i masave organizative paraqitet:

Nr.	Statusi i masave të marra nga KLSH	Në numër	Në %
1	Totali	29	
2	Pa pranuar	0	0%
3	Pranuar	29	100%
	<b>Nga të pranuarat:</b>		<b>Në % ndaj të pranuarave</b>
1	Zbatuar plotësisht	2	7%
2	Zbatuar pjesërisht	1	3%
3	Në proces	16	55%
4	Pa zbatuar	10	35%

## II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Zbatimi i plotë i rekomandimeve është në nivelin 10 %, së bashku me rekomandimet që janë në proces zbatimi në nivelin 80 %, shkon në total në nivelin 90 %. Pavarësisht përpjekjeve të subjekteve për marrjen e masave për zbatimin e tyre, përsëri rekomandimet e pazbatuara mbeten në nivel relativisht të lartë në masën 50 %.

## III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

*III/1-Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.*

- Në zbatim të nenin 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Albgaz Sh.a, ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 9/12 prot., datë 27.07.2023. Rekomandimi është zbatuar, por nuk është respektuar afati 20 ditor, në mospërputhje me Nenin 15, pikën “j” të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

*III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.*

- Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna", u konstatua se nga Albgaz Sh.a nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve duke mos respektuar kështu edhe afatin 6 mujor, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2.

III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Situata ekonomiko-financiare që nga krijimi i kësaj shoqërie (2017-2021), është me humbje, si dhe detyrimet ndaj të tretëve si kredi afatshkurtër e afatgjatë në vlerën 411,656 mijë lekë, detyrime të cilat janë maturuar për pagesë dhe janë kërkuar për likuidim, pasqyron qartazi jo vetëm situatën e vështirë të likuiditetit të Shoqërisë “Albgaz” Sh.a, por po të vazhdohet në këtë pozitë, kjo shoqëri rrezikon të falimentojë. Në opinionin e grupit të auditimit kjo ka ardhur për arsye si më poshtë:

-Shoqëri nuk e ka kryer aktivitetin e saj në përputhje me objektin e veprimtarisë, si operator i kombinuar i gazit natyror, pasi ka kryer veprimtarinë vetëm të operatorit të sistemit të transmetimit dhe jo edhe të operatorit të sistemit të shpërndarjes {për tre vite kjo shoqëri ka marrë gaz natyror nga shoqëria Albpetrol dhe ja ka shitur përsëri shoqërisë (Albpetrol) si klient fundor}.

-Shoqëria nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur investimeve shtetërore në zbatim të parashikimeve të Master Planit të Gazit Natyror, duke mos avancuar në projekte me interes të përbashkët të Komunitetit të Energjisë {JAP ( *Degëzim i TAP AG në drejtim të Kroacisë*), ALKOGAP ( *Degëzim i TAP AG në drejtim të Kosovës, si dhe depozita nëntokësore e gazit natyror në Dumre-Elbasan*)} si e vetmja Shoqëri në Republikën e Shqipërisë me objekt të veprimtarisë, si operator i kombinuar i gazit natyror. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, neni 104 dhe 190, Ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, neni 22, Master Plani i Gazit Natyror, dhjetor 2016.

-Shoqëria është organizuar me një strukturë organizative, të mbingarkuar, e pa strukturuar për të plotësuar objektin e shoqërisë, duke sjellë kosto në rritje në shpenzimet e shoqërisë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 16-19 të Raportit të Auditimit).

**1.1 Rekomandim:** Organet drejtuese të shoqërisë duhet analizojnë dhe të vlerësojnë arsyet e produktivitetit të ulët të veprimtarisë ekonomiko-financiare, efektin e çdo arsyeje të identifikuar, përfshirë një analizë të detajuar të detyrimeve ndaj të tretëve dhe në veçanti kreditë afatshkurtra e afatgjata, si dhe të merren masat e nevojshme për daljen nga kjo situatë që shoqëria mos të falimentojë.

**Nga verifikimi rezultoi se:** Shoqëria Albgaz Sh.a i ka përcjellë Këshillit Mbikqyrës më datë 19.10.2023, raportin dhe rekomandimet e KLSH-së me anë të postës elektronike. MIE, në cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë ka marrë vendimin për zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë Albgaz sh.a në shumën prej 1,200,000,000 lekë (vendimi Nr.9895, datë 22.12.2022). Qëllimi i zmadhimit të kapitalit ka qenë pikërisht rritja produktivitetit të veprimtarisë ekonomiko-financiare. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**1.2 Rekomandim:** Administratori dhe Këshilli Mbikqyrës, ti kërkojnë në rrugë institucionale Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë Asamblesë (pronarit) dhe të monitoruesit dhe hartimit të politikave, që të ndërmarrin veprime ligjore, për korrigjimin e menjëhershëm të veprimtarisë së kësaj shoqërie, dhe konkretisht për investime shtetërore në zbatim të parashikimeve të Master Planit të Gazit Natyror dhjetor 2016, si dhe marrjen e masave për kryerjen

e plotë të aktivitetit të kësaj shoqërie referuar objektit të veprimtarisë, si operator i kombinuar i gazit natyror, duke kryer veprimtarinë e operatorit të sistemit të transmetimit dhe operatorit të sistemit të shpërndarjes.

**Nga verifikimi rezultoi se:** Në përgjigjen e dërguar grupit të auditimit, shoqëria Albgaz Sh.a i ka informuar organet drejtuese. Për sa i përket marrjes së masave: Albgaz është angazhuar për ndërtimin e tubacionit Fier-Vlorë si një detyrim i Master Planit të Gazit Natyror dhe Albgaz nëpërmjet ekspertizës së ofruar për këtë qëllim ka hartuar dhe është në fazën e miratimit të planit 10 vjeçar të rrjetit të transmetimit të gazit natyror dhe planit të investimit, nga organet vendimarrëse të shoqërisë dhe nga ERE, si detyrim rregullator. Albgaz në bashkëpunim të ngushtë edhe me MIE-n, në cilësinë e ministrisë së linjës përgjegjëse për politikën e sektorit, po ndërmerr hapat për përditësimin e këtij Master Plani në përputhje me situatën, e diktuar nga lufta në Ukrainë si dhe në përmbushje të sigurisë energjitike dhe nevojave të tregut. Gjithashtu për plotësimin e këtij masterplani me projekte të një rëndësie rajonale në fushën e gazit të lëngshëm, siç është ai i terminalit të Vlorës si dhe projekti për gazifikimin e qytetit të Korçës si projekti i parë në Shqipëri për furnizimin e një zone rezidenciale. Për realizimin e këtyre investimeve Albgaz synon të përdorë jo vetëm fonde publike por do t'i realizojë ato me bizneset e interesuara, që disponojnë ekspertizën ndërkombëtare sikurse dhe burimet e financimit të nevojshme. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Shoqëria “Albgaz” Sh.a është çertifikuar nga ERE, si operator i kombinuar i gazit natyror, nga ERE me Vendim nr. 179, datë 08.11.2017 në përputhje me nenet 37, 50, 59, 68, dhe 80 të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 73/2009 EC, *çertifikim i cili është kushtëzuar*, si për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit natyror me plotësimin e dokumentacionit që tregon titujt e pronësisë mbi aktivet që ka, për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar, lejet dhe autorizimet mjedisore, certifikatë sigurimi nga shoqëri sigurimi (që operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri). Për plotësimin e këtyre kushteve ERE herë pas here ka vendosur dhe rivendosur afate me Vendimet nr. 188, datë 10.11.2017, nr. 63, datë 23.04.2019, nr. 221, datë 20.12.2019, nr. 37, datë 04.03.2019, nr. 220, datë 20.12.2019, nr. 261, date 19.12.2018, nr. 36, datë 04.03.2019 dhe me Vendim nr. 220, datë 20.12.2019, ka vendosur të shtyjë sërish afatin e depozitimit të dokumentacionit të munguar deri më datë 31.03.2022.

Sikurse me aktivitetin e transmetimit, edhe me shpërndarjen, konstatohet se deri më datë 31.03.2022 datë në të cilën përfundoj auditimi, nuk është plotësuar asnjë nga kushtet e vendosura nga ERE. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” neni 22. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 16-19 të Raportit të Auditimit).*

**2.1 Rekomandim:** Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë të marrin masa për nxjerrjen nga statusi i certifikimit të kushtëzuar të shoqërisë, duke analizuar dhe vlerësuar arsyet e mos plotësimit të kushteve të vendosura nga ERE, duke vendosur një afat prekluziv në lidhje me plotësimin e kushteve të certifikimit.

**2.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Në përgjigjen e dërguar grupit të auditimit, Albgaz SHA është shprehur se vendimi i bordit të ERE nr. 17/2022, ka pranuar argumentat e Albgaz në lidhje me pikën 5.2 të vendimit nr. 179/2017 për shtyrjen e afatit të certifikimit deri më 20.11.2022. Albgaz ka kërkuar zgjatjen e afatit deri më 20.11.2023. Pavarësisht qëndrimit të parashtruar, Albgaz SHA nuk ka vënë në dispozicion asnjë evidencë që dëshmon zbatimin e rekomandimit. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga Shoqëria “Albgaz” Sh.a nuk disponohet pronësia e gjurmës së kalimit të tubacioneve magjistrale të transmetimit të gazit natyror në total. Sipas Master Planit të Gazit Natyror kjo shoqëri disponon 267.4 km, ndërsa sipas inventarit kontabël disponon 264 km, me një diferencë 3.4 km. Tubacionet magjistrale të transmetimit të gazit janë projektuar e ndërtuar rreth viteve 1970-1980.

Gjurma e kalimit të tubacioneve është projektuar e zbatuar duke kaluar edhe përmes tokës arë dhe drufrutor të prodhimit të kulturave bujqësore dhe të plantacioneve të drufrutoreve nën administrim të ish-kooperativave bujqësore dhe të ish-ndërmarrjeve shtetërore.

Tubacionet janë futur në thellësinë 1 metër deri në 1.2 metër nën sipërfaqen e tokës, me qëllim që të mos pengonin punimet për kulturat bujqësore dhe drufrutore. Në zbatim të Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, me ndryshimet vijuese të tij, për pronësinë e gjurmës së kalimit të tubacioneve magjistrale të transmetimit të gazit, nuk është mbajtur asnjë qëndrim për njohjen e autoritetit të pronarit të tubacioneve për gjurmën e kalimit. Pra 264 km tubacion i transmetimit të gazit kalon në tokat në pronësi të të tretëve.

Ky është jo vetë një problem pronësie, por dhe të shfrytëzimit të magjistrave të tubacioneve të transmetimit të gazit, pasi pengon jo vetëm kryerjen e shërbimeve teknike të tubacioneve, por dhe rëndon koston e mirëmbajtjes, pasi shoqëria është e detyruar të zhdëmtojë kulturat bujqësore dhe drufrutore të pronarëve të tokave. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. Ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, neni 12, pika 1 dhe 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 16-19 të Raportit të Auditimit).*

**3.1 Rekomandim:** Nga Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës të merren të gjitha masat tekniko-organizative dhe të ndiqen procedurat ligjore për përcaktimin e distancës së gjurmës së tubacioneve të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, si dhe zbatimin e plotë të dispozitave ligjore për pronësinë dhe pasurinë e nëntokës me të vetmin pronar Shtetin, duke i kërkuar zyrtarisht Zyrrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të bëjnë rregullimin e marrëdhënieve të bashkëpronësisë të tokës arë, drufrutore, pyjore, kullosore dhe truall që disponohet (regjistruar) nga palët e treta me gjurmën e kalimit të tubacioneve të magjistrave të transmetimit të gazit natyror.

**3.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Në përgjigjen e dërguar grupit të auditimit, Albgaz SHA Drejtoria juridike dhe Prokurimeve i është drejtuar Administratorit me Memon nr. 98, datë 25.10.2022, ku ndër të tjera ka evidentuar problematikat në pasuritë e paluajtshme të Albgaz sh.a. Konkretisht: - Stacioni Gazit Cërrik, në bazë të Certifikatës së Pronësisë datë 26.04.2019 rezulton në Përgjegjësi Administrimi të Albgaz Sh.a. Gjendja teknike e godinës rezulton e amortizuar. Godina është zaptuar prej shumë vitesh dhe shërben si strehim për qytetarin R.S. Godina nuk pasqyrohet në dokumentacionin e lëshuar nga Kadastra. -Stacioni Gazit Elbasan, në bazë të Dokumentit Hipotekor date 24.07.2018 rezulton në Përgjegjësi Administrimi të Albgaz Sh.a. Gjendja teknike e godinës rezulton pjesërisht e amortizuar. Ajo është e zaptuar nga qytetari A.A prej shumë vitesh. Ai jo vetëm që ka kryer ndërhyrje ndërtimore në godinën ekzistuese, por edhe ka ndërtuar godinë të re në truallin përreth. -Stacioni Gazit Kuçovë, rezulton pa dokument hipotekor. Për pasurinë nuk ka asnjë të dhënë në listën e pasurive. Transferimi nga Albpetrol në Albgaz është realizuar në kontabilitet për një sipërfaqe 2016 m<sup>2</sup>. Godina është zaptuar nga qytetari Shkëlqim Kurti.-Salla e pompave të ujit Selishte, Gjonçe-Fier. Në bazë të Certifikatës së Pronësisë date 09.11.2017 rezulton në Përgjegjësi Administrimi të Albgaz Sh.a. Lloji i Pasurisë është truall me një sipërfaqe totale prej 4290 m<sup>2</sup>, nga të cilat 376 m<sup>2</sup> janë ndërtesë. Nuk kuptohet se si në kontabilitet është

llogaritur për 10.000 m<sup>2</sup> truall. -Stacioni Gazit Patos, rezulton pa dokument hipotekor. Për pasurinë nuk ka asnjë të dhënë në listën e pasurive. Transferimi nga Albpetrol në Albgas është realizuar në kontabilitet për një sipërfaqe 250 m<sup>2</sup>. Godina është e zaptuar nga një qytetar i pa identifikuar. -Zyra e operatorit stacioni Vlore, rezulton pa dokument hipotekor. Për pasurinë nuk ka asnjë të dhënë në listën e pasurive. Transferimi nga Albpetrol në Albgas është realizuar në kontabilitet për një sipërfaqe 250 m<sup>2</sup>. Në ndjekje të kësaj problematike, e cila është konstatuar edhe në institucione të tjera, Këshilli i Ministrave me VKM-në nr. 28, datë 27.01.2023 vendosi që çdo institucion të krijojë një strukturë të posaçme me qëllim përditësimin e listës së pronave shtetërore. Në zbatim të kësaj VKM-je Administratori i Albgas me Urdhërin Nr. 24 Prot, datë 12.04.2023, krijoi strukturën e posaçme për Albgas SHA. Ky proces po monitorohet nga MIE dhe Këshilli i Ministrave.

Pavarësisht qëndrimit të parashtruar, Albgas SHA nuk ka vënë në dispozicion evidenca që dëshmojnë veprimtarinë institucionale të ndërmarra me qëllim implementimin e këtij rekomandimi. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

*Pa zbatuar*

**4. Gjetje nga auditimi:** Në statutin e Shoqërisë “Albgas” Sh.a, neni 13.3, është përcaktuar kompetenca e Asamblesë së Përgjithshme, vendosja e kufirit për aprovimin e huave në vlerat mbi 10,000,000 euro dhe të drejtën e vendimmarrjes për heqje dorë nga një e drejtë për vetëm mbi 300,000 euro ose 500,000 euro vlera kumulative gjatë një viti, duke i lënë vlerat nën këto tavane, si kompetencë e aprovimit të Këshillit Mbikëqyrës.

Po në këtë status neni 16, pika 16.3/n është përcaktuar kompetenca e Këshillit Mbikëqyrës:

- Të miratojë hyrjen në një marrëveshje huaje apo kredie ose krijime të tjera (apo marrëveshje për krijim) të një borxhi të shoqërisë deri në shumën prej 10,000,000 euro.

-Të japë miratimin paraprak për blerjen e aktiveve të paluajtshme mbi vlerën 100.000 euro.

-Të miratojë paraprakisht shitjen apo çdo formë disponimi të aktiveve të paluajtshme të Shoqërisë me vlerë nga 50.000 deri 100.000 euro, dhe të kërkojë paraprakisht miratimin e Asamblesë për vlera më të mëdha se 100.000 euro.

-Të miratojë paraprakisht shitjen e aktiveve të luajtshme në rast se vlera e një kontrate është nga 50.000 deri 100.000 euro, ose nëse vlera kumulative e këtyre kontratave është nga 250.000 deri 500.000 euro brenda një viti financiar.

-Termi i përdorur sa më sipër (... të miratoj paraprakisht...), nuk është i qartë dhe nuk i jep vlerë përfundimtare kompetencës së çeduar, pra Këshilli Mbikëqyrës, i shqyrton paraprakisht dhe më pas shqyrtohen dhe nga Asambleja e Përgjithshme, apo është organi i vetëm që i shqyrton dhe pas tij vendimet marrin vlerë përfundimtare.

Kompetencat si më sipër të Këshillit Mbikëqyrës, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar, neni 4, neni 10 (Shtuar pas fjalisë së parë me Ligjin nr. 8/2016, datë 11.2.2016).

-Në nenin 17, përbërja e Këshillit Mbikëqyrës, në asnjë nga pikat nuk përcaktohet kriteri i aftësive profesionale, eksperiencia dhe monitorimi i veprimtarisë mbikëqyrëse dhe vendimmarrëse i tyre me performancën e shoqërisë. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 16-19 të Raportit të Auditimit*).

**4.1 Rekomandim:** Asambleja e Përgjithshme brenda kompetencave ligjore, të bëjë parashikime specifike (ç’fuqizojë dhe/ose ndreqje gabimi material) në Statut, në lidhje me vendosjen e kufirit për aprovimin e huave, si dhe përbërjen e Këshillit Mbikëqyrës, ku të përcaktohet specifikisht kriteri i aftësive profesionale, eksperiencia dhe monitorimi i veprimtarisë mbikëqyrëse dhe vendimmarrëse i tyre, në lidhje me performancën e shoqërisë.

**4.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Në përgjigjen e dërguar grupit të auditimit, Albgaz SHA ka informuar Këshillin Mbikqyrës të shoqërisë dhe ka pranuar nevoja për një rishikim tërësor i statutit në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 102/2015 “ Për sektorin e gazit natyror”.

Pavarësisht qëndrimit të parashtruar, Albgaz SHA nuk ka vënë në dispozicion asnjë evidencë që dëshmon veprimtarinë institucionale të ndërmarra me qëllim implementimin e këtij rekomandimi. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

*Pa zbatuar*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga dokumentacioni zyrtar i vënë në dispozicion u konstatua se Shoqëria “Albgaz” Sh.a është palë edhe në marrëveshjet si më poshtë:

-Marrëveshja për fondet e rikonstruksionit të Qendrës Fier (Funding Agreement C32919 between Trans Adriatic Pipeline AG Albanian Branch and Albgaz Sh.a), hartuar dhe nënshkruar më datën 18.09.2017, protokolluar me nr. 141 prot., datë 03.11.2017 në gjuhën Angleze, nuk është hartuar dhe nënshkruar në gjuhën shqiptare.

-EBRD-ECA (Terma Reference: Project është përgatitur me ndihmën e konsulentit ECA , si pjesë e asistencës për ngritjen e kapaciteteve teknike, financuar nga (BERZ) e nënshkruar më datën 04.05.2017, hartuar dhe nënshkruar në gjuhën Angleze, nuk është hartuar dhe nënshkruar në gjuhën shqiptare.

-Marrëveshja trepalëshe të trajnimit të negociuar ndërmjet S S.P.A, Shoqërisë “Albgaz” Sh.a dhe Shoqërisë “A G S C” Sh.a, e nënshkruar më datën 22.01.2020, hartuar dhe nënshkruar në gjuhën Angleze, nuk është hartuar dhe nënshkruar në gjuhën shqiptare.

Marrëveshjet si mësipër të hartuara dhe nënshkruara vetëm në gjuhën angleze, pa u hartuar dhe nënshkruar në gjuhën shqiptare, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8417, date 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 14.

Marrëveshjet e mësipërme, janë hartuar dhe nënshkruar vetëm në gjuhën angleze, pa u hartuar dhe nënshkruar në gjuhën shqiptare gjë që pamundësoi auditimin e tyre nga grupi i auditimit, kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 8417, date 21.10.1998, me ndryshimet vijuese të tij, neni 14. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 16-19 të Raportit të Auditimit).

**5.1 Rekomandim:** Për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura në lidhje me hartimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve me Shoqërinë, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktikë, duke përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar marrëveshjet ekzistuese, por edhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

**5.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Në përgjigjen e dërguar grupit të auditimit, shoqëria Albgaz SHA për realizimin e këtij rekomandimi ka nxjerrë Urdhrin e brendshëm me nr. 41, datë 30.12.2022 “Për përkthimin në gjuhën shqipe të marrëveshjeve me palë Albgaz sh.a”.

Pavarësisht qëndrimit të parashtruar, Albgaz SHA nuk ka vënë në dispozicion asnjë evidencë që dëshmon veprimtarinë institucionale të ndërmarra me qëllim implementimin e këtij rekomandimi. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

*Pa zbatuar*

**6. Gjetje nga auditimi:** Shoqëria “Albgaz” Sh.a në shpenzimet e veprimtarisë operacionale të saj rëndohet padrejtësisht nga vënia në punë dhe mirëmbajtja e stacioneve të kompresorëve B2S Drenovë. Mbajtja e stacionit të kompresorëve B2S DR në punë ka kosto operacionale të lartë (shpenzime për vajra, riparime të defekteve, shpenzime paga fuqie punëtore, energjinë elektrike dhe reaktive etj.). Përveç shpenzimeve të tjera, edhe pse është aktiv afatgjatë material i Shoqërisë “Albgaz” Sh.a, faturimi i energjisë elektrike dhe reaktive i Shoqërisë “Albgaz” Sh.a kryhet nga

Shoqëria “Albpetrol” Sh.a, bile jo nga kjo shoqëri, por nga QFSHEE. Pra matësi i energjisë është i kësaj të fundit (aktivi afatgjat material është i Shoqërisë “Albgaz” Sh.a, matësi është i Shoqërisë “QFSHEE”), dhe me çmim 17.4 lek/këh për energji elektrike dhe 1.65 lekë për këh energji reaktive që i përket çmimit të liberalizuar të konsumatorëve të tregut të lidhur me tensionin e lartë dhe të mesëm.

Për shpenzimet e energjisë elektrike dhe reaktive (jo për shpenzimet e tjera), Shoqëria “Albgaz” Sh.a i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 120 prot., datë 22.10.2018 për rivlerësim e këtij shpenzimi, për një shpërndarje sa më të drejtë mes dy shoqërive. Për vitet 2017-2019 shpenzimet për energjinë elektrike dhe reaktive, lubrifikant, shpenzime avarie, paga etj., kapin vlerën 23,365,578 lekë.

Deri më datën 31.03.2022, datë në të cilën përfundon auditimi nuk është kryer rivlerësim i këtij shpenzimi, për një shpërndarje sa më të drejtë të tij mes dy shoqërive, edhe pse 5 nga 6 antarët e Këshillit Mbikëqyrës (Me përjashtim të N.L që është përfaqësuesi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë) i perkasin Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë edhe të Asamblesë së Aksionarëve, për të cilët Shoqëria “Albgaz” Sh.a për vitet 2017-2019 ka shpenzuar vlerën 2,537,485 lekë për shpërblimin e tyre. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 2, pika 25 dhe 26, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 36 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 në faqet 30-33 të Raportit të Auditimit*).

**6.1 Rekomandim:** Nga Këshilli Mbikëqyrës të ri-njoftohet zyrtarisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e Asamblesë së Aksionarëve (pronarit) dhe të monitoruesit dhe hartimit të politikave të Shoqërisë “Albgaz” Sh.a dhe Shoqërisë “Albpetrol” Sh.a, brenda kompetencave ligjore, statusore, rregullatorë të kryej rivlerësimin e këtij shpenzimi, për një shpërndarje sa më të drejtë të tij mes dy shoqërive. Në rast mos kryerjes së rivlerësimit të këtij shpenzimi nga Asambleja, të ndiqen procedurat gjyqësore.

**6.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Në përgjigjen e dërguar grupit të auditimit, Shoqëria “Albgaz” SHA është shprehur që synon të bashkëpunojë me Albpetrol sh.a për zgjidhjen e kësaj shtate, por procesi është vonuar edhe për shkak të ndryshimit të shpeshtë të administratorëve të kësaj të fundit. Pavarësisht qëndrimit të parashtruar, Albpetrol SHA nuk ka vënë në dispozicion asnjë evidencë që dëshmon veprimtaritë institucionale të ndërmarra me qëllim implementimin e këtij rekomandimi. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

*Pa zbatuar*

**7. Gjetje nga auditimi:** Në një rast investimi është kryer pa leje ndërtimi, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 39, pika 1 dhe 2, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 11, pika a, neni 13, pika c. Leja e ndërtimit për objektin është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me vendim nr. 8, datë 28.02.2020, pasi është ndërtuar objekti, veprim i cili ngarkon me përgjegjësi A.C me detyrë drejtor i drejtorisë së marrëveshjeve dhe projekteve dhe E. Prodani me detyrë shef i sektorit të projekteve.

- Në një rast në preventivin paraprak dhe atë të ndryshuar nuk është përcaktuar fond rezervë, si dhe ndryshimet në preventiv nuk janë shoqëruar me ndryshimet në projekt. Pra projekti është i pa ndryshuar. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 39, pika 1 dhe 2, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 11, pika a,b,c,ç.

-U konstatua lidhje kontrate shtesë me nr. 101/16 prot., datë 18.12.2019, kontratës bazë nr. 3/17 prot., datë 18.03.2019 për ndërtimin e dy magazinave me konstruksion metalik dhe rikonstruksionin e zyrave Fier, viti 2019, pa pasur fond disponibël. Kontrata për ndërtimin e dy magazinave me konstruksion metalik dhe rikonstruksionin e zyrave Fier, është lidhur me nr. 3/17 prot., datë 18.03.2019 ndërmjet Shoqërisë “Albgaz” Sh.a dhe operatorit/e shoqërisë “A” shpk në vlerën 55,109,096 lekë pa TVSh. Për realizimin e këtij objekti është bërë shtesë kontrate me nr. 101/16 prot., datë 18.12.2019 në vlerën 11.016.811,60lekë pa TVSH Për rrjedhojë kjo shtesë kontratenuk duhet të ishte lidhur, pasi lidhja e kësaj kontrate është në kundërshtim me shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe e Verifikimit), nr. 9941 prot., datë 08.11.2018, veprim i cili ngarkon me përgjegjësi, E. K. me detyrë drejtor i drejtorisë juridike dhe prokurimeve.

-Procedura e prokurimit, negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për objektin e prokurimit “Ndërtim magazina dhe rikonstruksion i zyrave në Fier”, me fond limit 11.016.812lekë, e parashikuar në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2019, nuk është në kushtet e rrethanave të veçanta (kushte specifike) të pa parashikuara nga dispozitat ligjore, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 33, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar neni 36, çka ngarkon me përgjegjësi drejtorinë e drejtorisë juridike dhe prokurimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 në faqet 48-67 të Raportit të Auditimit).*

**7.1 Rekomandim:** Për të mbrojtur interesat publike, duke siguruar se fondet publike shpenzohen në mënyrën e duhur, të besueshme dhe efikase, me konkurrencë dhe transparencë në prokurimet publike, si dhe për të siguruar, që të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar në kontratat publike të trajtohen në mënyrë të drejtë:

-Të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë për ndërtimet dhe rikonstruksionet e objekteve, me qëllim jo vetëm kryerja e tyre të bëhet me leje ndërtimi, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen shkeljet e ligjeve.

- Në të ardhmen nga Shoqëria t`i kushtohet vëmendje e duhur institucionale fondeve disponibël, dhe në vartësi të tyre të operohet me procedurat e prokurimit dhe në veçanti lidhjes së kontratave.

- Nga Autoriteti kontraktor del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktikë të paligjshme, me qëllimin e rivënies në vend të integritetit në prokurimin publik, që procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës të kryhen vetëm në rrethanat të veçanta (kushte specifike).

**7.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Shoqëria “Albgaz” sh.a ka synuar që procedurat e prokurimit të mos kryhen pa disponibilitetin e fondeve dhe të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**8. Gjetje nga auditimi:** Për procedurën e prokurimit “Ndërtim magazina dhe rikonstruksion i zyrave në Fier”,për vlerën 60,529mijë lekë, në hartimin e dokumenteve të tenderit, për kriteret e veçanta për kualifikimit, nuk është dhënë asnjë argument për përcaktimin e tyre dhe nuk është dokumentuar me procesverbal ky përcaktim, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

- Për procedurën e prokurimit “Ndërtim magazina dhe rikonstruksion i zyrave në Fier”, për vlerën 60,529mijë lekë, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014



“Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, neni 63 pika 3, neni 67, Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” nenet 108-118, çka ngarkon me përgjegjësi komisionet e vlerësimit të ofertave.

-Në 1 rast për vlerën 325 mijë lekë është anuluar procedura e prokurimit nga autoriteti kontraktor, është kryer pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24 dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, neni 73, pika 2. Në opinionin e grupit të auditimit, arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të pa parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por duke respektuar parimet e barazisë dhe transparencës.

-Për procedurën e prokurimit “*Ndërtimi i qendrës së mirëmbajtjes Korçë*”, për vlerën 98,844,810 lekë, në hartimin e dokumenteve të tenderit, për kriteret e veçanta për kualifikimit, nuk është dhënë asnjë argument për përcaktimin e tyre dhe nuk është dokumentuar me procesverbal ky përcaktim, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

-Për procedurën e prokurimit “*Ndërtimi i qendrës së mirëmbajtjes Korçë*”, për vlerën 98,844,810 lekë, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, neni 63 pika 3, neni 67, Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” nenet 108-118, çka ngarkon me përgjegjësi komisionet e vlerësimit të ofertave. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 në faqet 48-67 të Raportit të Auditimit).*

**8.1 Rekomandim:** Autoriteti kontraktor, në vijim duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë. Kërkesat/specifikimet teknike duhet të jenë të shkruara në mënyrë të tillë që të argumentohet nevoja që dikton vendosjen e këtyre kriterëve, duke parandaluar në këtë mënyrë para përzgjedhjen paraprake të kandidatit fitues, në zbatim me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik.

-Nga Shoqëria t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, duke planifikuar trajnime për rritjen e kapaciteteve të personelit.

-Anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, të kryhet duke analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar. Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të pa parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por duke respektuar parimet e barazisë dhe transparencës.

**8.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Shoqëria “Albgaz” sh.a ka kryer kryesisht procese prokurimi për blerje të vogla, në plotësim të nevojave të veprimtarisë së përditshme operionale dhe është në proces realizimi të rekomandimit. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**9. Gjetje nga auditimi:** -Struktura organizative dhe niveli i pagave të Shoqërisë, nuk është miratuar specifikisht nga Asambleja Aksionare (Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,

Tregtisë dhe Sipërmarrjes, sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë). Konkretisht për vitin 2017 nuk është marrë miratimi për strukturën organizative, për vitet 2018 dhe 2019 nuk është marrë miratimi për strukturën organizative dhe nivelin e pagave dhe për vitin 2020 nuk është marrë miratimi për nivelin e pagave. Organet drejtuese të Shoqërisë (Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori) e kanë quajtur të ezauruar miratimin vetëm me miratimin e programit ekonomik ku pjesë e tij është dhe fondi i pagave. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1.

-Shoqëria “Albgaz” Sh.a marrëdhëniet e punës me punonjësit e saj i ka të rregulluar bazuar në Ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, Kontratës kolektive nr. 261, datë 19.09.2017 dhe kontratave individuale të punës. Pagat janë të grupuar në katër nivele për secilin pozicion pune, konkretisht niveli I, II, III dhe IV dhe secili nivel ka një limit përcaktuar. Për pozicionet punëtor deri në specialist brenda limitit të çdo niveli është përcaktuar paga e secilit punonjës me vendim të Administratorit.

Për pozicionet përgjegjës sektori, shef sektori, asistent ekzekutiv, këshilltar, drejtor drejtorie nuk ka të miratuar sipas kompetencave statusore një rregullore, ku të parashikohen kriteret e caktimit të pagës brenda limit të miratuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 11-21 të Raportit të Auditimit).

**9.1 Rekomandim:** Nga Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës të merren masat për të hartuar dhe miratuar sipas kompetencave staturore një rregullore, ku të parashikohen kriteret e caktimit të pagës brenda limit të miratuar, për pozicionet përgjegjës sektori, shef sektori, asistent ekzekutiv, këshilltar, drejtor drejtorie etj.

**9.2 Rekomandim:** Nga organet drejtuese të shoqërisë të merren masat për miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, duke zbatuar në këtë mënyrë detyrimet ligjore dhe staturore në mirë-organizimin dhe mirëfunksionimin e shoqërisë.

**9.3 Nga verifikimi rezultoi se:** Në përgjigjen e dërguar grupit të auditimit, shoqëria “Albgaz” sh.a, në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës datë 01.02.2023 (referuar Procesverbalit nr. Prot 02, datë 01.02.2023) në rendin e ditës është paraqitur për miratim konkretisht pika 3 dhe 4 miratimi i strukturës dhe miratimin i nivelit të pagave dhe përshkrimet e punës, në përputhje me pozicionet përkatëse në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së. Për këto pika Këshilli Mbikëqyrës vendosi të shtyjë vendimarrjen për një datë tjetër.

Pavarësisht qëndrimit të parashtruar, Albgaz SHA nuk ka vënë në dispozicion asnjë evidencë që dëshmon veprimtaritë institucionale të ndërmarra me qëllim implementimin e këtij rekomandimi. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

*Pa zbatuar*

**10. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi u konstatua se, mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të rregullave të parashikuara në Statut ose Rregullore të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. Në të gjithë deklaratimet për vende të lira pune për periudhën objekt auditimi nuk deklarohet afati brenda të cilit individët mund të paraqesin aplikimet e tyre. Për më tepër, në shumë raste evidentohet kohë shumë e shkurtër nga momenti i deklaratimit të pozicionit të lirë të punës deri në momentin e emërimit në punë të fituesit. Evidentohet në disa raste mungesa e deklaratimeve për vende të lira pune në këtë Shoqëri, si dhe kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira, sa më sipër në kundërshtim me Ligji nr. 9125,

datë 29.07.2003 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, neni 9 pika 1, pika 5, gërma a (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 11-21 të Raportit të Auditimit*).

**10.1 Rekomandim:** Nga organet drejtuese të shoqërisë të merren masat:

-Të bëhen parashikime të detajuara staturore dhe rregullatore lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë.

- Të bëhet adresim korrekt në rregullore i përgjegjësive të punonjësve bazuar në lidhjen shkakësore të veprimeve të tyre me pasojat e kundraligjshme që mund të shkaktohen.

- Të përcaktohet në deklaratimet për pozicione të lira pune, edhe afati brenda të cilit të interesuarit për pozicionin e punës, duhet të shprehin interesin dhe paraqesin dokumentacionin e nevojshëm provues.

**10.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Në përgjigjen e dërguar grupit të auditimit, Albgaz SHA është shprehur se ky rekomandim nuk është zbatuar. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

*Pa zbatuar*

**11. Gjetje nga auditimi:** -Sipas programit ekonomik për vitin 2017, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 116 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2018 është realizuar 115 punonjës, pra 1 punonjës më pak. Fondi i pagave është realizuar 68,790 mijë lekë, pra 2,908 mijë lekë më pak se programi.

-Sipas programit ekonomik për vitin 2018, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 117 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2018 është realizuar 115 punonjës, pra 2 punonjës më pak. Fondi i pagave është realizuar 79,141 mijë lekë, pra 459 mijë lekë më pak se programi.

-Sipas programit ekonomik për vitin 2019, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 117 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve të vitit 2019 është realizuar 116 punonjës, pra 1 punonjës më pak. Fondi i pagave është realizuar 93,330 mijë lekë, pra 3,103 mijë lekë më pak se programi.

-Sipas programit ekonomik për vitin 2020, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 118 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve të vitit 2020 është realizuar 113 punonjës, pra 5 punonjës më pak. Fondi i pagave është realizuar 90,922 mijë lekë, pra 3,618 mijë lekë më pak se programi.

-Sipas programit ekonomik për vitin 2021, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 119 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve të vitit 2021 është realizuar 113 punonjës, pra 6 punonjës më pak. Fondi i pagave është realizuar 97,428 mijë lekë, pra 2,372 mijë lekë më pak se programi.

-Sa më sipër, konstatohet se struktura organizative e shoqërisë Albgaz SHA, është e paargumentuar, jo e mirë menduar dhe duke u bazuar në aktivitetin, të ardhurat e rezultatin financiar negativ të shoqërisë nuk justifikohet numri i punonjësve.

-Sa më sipër nga grupi i auditimit konstatohet se struktura organizative dhe fondi i pagave, çdo vit kanë progresion rritës, i cili në asnjë rast nuk realizohet dhe nuk justifikohet. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 11-21 të Raportit të Auditimit*).

**11.1 Rekomandim:** Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë Albgaz SHA të merren masa për parashikimin e saktë të strukturës numrit të punonjësve, duke ju referuar nevojave specifike të shoqërisë, bazuar në funksionin e saj primar.

**11.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Albgaz Sh.a është në pritje të miratimit nga organet përkatëse sqaruar në pikën 9 më lart. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**12. Gjetje nga auditimi:** Më datë 22.05.2017, administratori i shoqërisë K.G, i përfaqësuar nga A.Gj me autorizimin e posaçëm me nr. 154 prot., datë 22.05.2017, ka lidhur kontratën me shoqërinë V SHA, për përfitimin e shërbimit të telefonisë celulare. Kohëzgjatja e kontratës është 24 muaj dhe vlera totale e shpenzimit që shoqëria Albgaz detyrohet t'i paguajë shoqërisë V është 3,585,600 lekë brenda afatit të kontratës, për një numër 88 përdoruesish, me një vlerë shpenzimi fiks mujor prej 149,400 lekë. Me vendimin të Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 13.04.2017, janë përcaktuar kuotat dhe pozicionet e punës të cilat përfitojnë mbulimin e shpenzimeve të telefonisë celulare, si administratori dhe drejtorët e drejtorive, ndërsa punonjësit e tjerë nuk janë përfitues. Dhënia e garancisë ndaj Shoqërisë V për mbulimin e shpenzimeve për të gjithë numrat e kontraktuar përfshirë dhe pozicionet e tjera jo të aprovuara në këtë vendim, ekspozon shoqërinë për efekte të mundshme ekonomike negative.

-Në librat e blerjeve të deklaruara në sistemin tatimor, në periudhën 2017-2018-2019, vlera e deklaruar e blerjeve të shërbimit të telefonisë janë në shumat e rimbursuara prej shoqërisë për personat e autorizuar dhe jo në vlerën totale të faturës së lëshuar nga V, një veprim i kryer për të justifikuar si shpenzim të zbritshëm për deklaratimet tatimore vetëm vlerat e rimbursuara, por që nuk ka ndikuar në rezultatin e shoqërisë.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 1, pika 2, VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publik”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, seksioni III, mbajtja e kontabilitetit, neni 57, Udhëzimin, nr. 24, datë 02.09.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 42, neni 115, si dhe Udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, pika 3.5 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet 33-43 të Raportit të Auditimit*).

**12.1 Rekomandim:** Nga Administratori i Shoqërisë të merren masat, që shërbimi i telefonisë celulare të prokurohet, me synim e transparencës së garës konkurruese dhe leverdishmërisë ekonomike, si dhe kontrata të përfshijë vetëm personat e pozicioneve që ka përcaktuar Këshilli Mbikëqyrës për tu rimbursuar.

**12.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Shoqëria “Albgaz” Sh.a iu ka ndërprerë shërbimin e telefonsë celulare drejtorëve të drejtorive. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe zbatuar pjesërisht.

*Zbatuar pjesërisht*

**13. Gjetje nga auditimi:** - Për vitin 2017 janë kryer 3 procedura prokurimi me vlera të vogla me objekt “Blerje karburanti Diezel D1 dhe Benzinë” me vlerë totale 1,150,000 lekë pa TVSH. Nga auditimi i këtyre procedurave konstatohet se Autoriteti Kontraktor për vitin 2017 ka copëzuar fondin limit, në kundërshtim me nenin 28.2 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndryshimet vijuese të tij, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në uljen e efikasitetit në përdorimin e këtyre fondeve.

- Në procedurën e iniciuar me kërkesën e Drejtorisë së Projekteve dhe Marrëveshjeve me nr. 237 Prot., datë 05.09.2017, me objekt “Blerje pajisje GPS” për nevoja të Shoqërisë “Albgaz” Sh.a, u

konstatua se parametrat teknik të kërkuar janë me vlera specifike dhe jo me kufij të limituar. Përcaktimi me vlera të pandryshuara të madhësisë së ekranit, pesha, rezolucioni, kohë zgjatja e baterisë ka sjellë paracaktimin e fituesit të procedurës.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 23, pika 3, nenin 23, pika 3 dhe nenin 40 të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet vijuese të tij. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet 33-43 të Raportit të Auditimit).

**13.1 Rekomandim:** Nga Autoriteti kontraktor të merren masa për korrigjimin e praktikave që cenojnë parimet e konkurrencës në çmimin e paguar nga shoqëria për blerjen e një malli, shërbimi apo kryerjen e një pune, të cilat nga ana tjetër kanë efekt të drejtpërdrejtë në shpenzimet e buxhetit të shtetit.

**13.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Shoqëria “Albgaz” Sh.a po merr masa për korrigjimin e praktikave që cenojnë parimet e konkurrencës në çmimin e paguar nga shoqëria për blerjen e një malli, shërbimi apo kryerjen e një pune, të cilat nga ana tjetër kanë efekt të drejtpërdrejtë në shpenzimet e buxhetit të shtetit. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**14. Gjetje nga auditimi:** -Shpenzimet për konsum karburanti për vitin 2017, janë administruar nga Arben Subashi me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve mbështetëse dhe operacionale në cilësinë e personit të autorizuar nga A.Gj me detyrë Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe Operacionale. Ky administrim ka paraqitur risk të lartë shpërdorimi, pasi përcaktimi i normave të konsumit të karburantit, ndjekja, monitorimi, verifikimin dhe marrja në dorëzim e formularëve të plotësuar mbi lëvizjet e kryera të punonjësve, dhe deklaratimet e shpenzimeve të karburantit, janë kryer nga i njëjti person. Për pos sa më sipër u konstatua se mungonin kërkesat për karburant nga përdoruesit, fletët e udhëtimit të aprovuara nga administratori/eprori përkatës, dhe kuponët tatimorë përkatës për karburantin e konsumuar. Veprim në kundërshtim me nenin 22, pika 3, veprimtaritë e kontrollit, shkronja b), të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, pikave 6 dhe 10 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, me ndryshimet vijuese të tij. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet 33-43 të Raportit të Auditimit).

**14.1 Rekomandim:** Nga Administratori i Shoqërisë, të merren masa për hartimin e procedurave të menaxhimit të shpërndarjes së karburantit dhe verifikimit të konsumit të tij, duke reflektuar rritjen e sigurisë që rrisqet për keq menaxhim ose vjedhje të jenë të kufizuar brenda kufijve të pranueshëm.

**14.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Shoqëria “Albgaz” Sh.a po merr masa për hartimin e procedurave të menaxhimit të shpërndarjes së karburantit dhe verifikimit të konsumit të tij. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**15. Gjetje nga auditimi:** -Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se në Shoqërinë Albgaz Sh.a, Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit nuk është implementuar në nivelin e duhur, pasi nga shoqëria për periudhën objekt auditimi:

-Nuk disponon urdhër për emërimin e nëpunësit zbatues.

-Nuk disponohet një procedurë e veçantë për përmbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.

-Nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik i riskut, i cili duhet të kontrollojë si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike, si dhe të përgatisë raporte vjetore mbi problematikat e hasura.

-Nuk është hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollat që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave. Nuk janë përcaktuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin dhe implementimin e kësaj strategjie.

-Nuk janë miratuar, hartuar dhe arkivuar Gjurmët e Auditimit të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlera të vogla, shpenzime për konsumin e karburantit.

-Nuk rezultojnë të jenë përgatitur Hartat e proceseve të punës sipas formatit të përcaktuar nga DH/MFKK si kërkesë e pikës 3.3, të Manualit të MFK.

-Nuk janë plotësuar, hartuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë deklarata dhe raportet vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm si dhe pyetësorin e vetëvlerësimit, në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon menaxhimi financiar dhe kontrolli. Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, nevojiten aktivitete shtesë për të forcuar kontrollat në raportimin menaxherial, llogaridhënie dhe menaxhim të rrezikut.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimi financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, pikat 1, 2 dhe gërma b, neni 11 pika 2 dhe 3, neni 16 pika 2 dhe 3, neni 21 pikat 1, 2 dhe 3, neni 27 pika 2, Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësinë publike”, aneksi nr. 2, si dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, pika 2.5.2, pika 3.1, pika 3.2 dhe kapitulli V, shtojca nr.2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqet 67-78 të Raportit të Auditimit).

**15.1 Rekomandim:** Shoqëria “Albgaz” Sh.a duhet të rrisë performancën e saj në drejtim të përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, të personelit, pasurive dhe buxhetit sipas planeve të biznesit, që menaxhmenti i kësaj shoqërie të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve, por edhe për të siguruar që këto vendime të jenë dobiprurëse. Ajo duhet të marrë masa për hartimin dhe menaxhimin e strategjisë dhe regjistrin të riskut, krijimin e listave të proceseve kryesore dhe gjurmët e auditimit, me qëllim arritjen e mjaftueshme të aktiviteteve të kontrollit për identifikimin, kontrollin dhe reduktimin e risqeve, si edhe përfshirjen efektive të sektorëve të ndryshëm në procese, dokumentacionin përkatës, përgjegjësitë personale, mbështetjen e sistemeve të IT.

**15.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Nga Albgaz sh.a po merren masa për plotësimin e rekomandimit. Albgaz ka hartuar regjistrin e riskut dhe janë në proces për ngritjen e grupit dhe menaxhimin e strategjisë. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**16. Gjetje nga rekomandimi:** Programet ekonomiko-financiar (buxhetet vjetor) janë hartuar dhe realizuar në pamjaftueshmëri financiare, pasi aktiviteti i shoqërisë nuk është i mbuluar në fakt

plotësisht me buxhet, konkretisht është programuar me humbje për periudhën e auditimit. Në mënyrë të detajuar: Për vitin 2017 nga të ardhurat janë realizuar në vlerën 19,557 mijë lekë, ndërsa shpenzimet janë realizuar në vlerën 114,037 mijë lekë, për vitin 2018 të ardhurat janë realizuar në vlerën 11,961 mijë lekë, ndërsa shpenzimet janë realizuar në vlerën 145,032 mijë lekë, për vitin 2019 të ardhurat janë realizuar në vlerën 9,811 mijë lekë, ndërsa shpenzimet janë realizuar në vlerën 335,714 mijë lekë, për vitin 2020 të ardhurat janë realizuar në vlerën 145,044 mijë lekë, ndërsa shpenzimet janë realizuar në vlerën 170,209 mijë lekë, për vitin 2021 të ardhurat janë realizuar në vlerën 162,588 mijë lekë, ndërsa shpenzimet janë realizuar në vlerën 194,710 mijë lekë.

-Për vitin 2017, nuk janë respektuar afatet për dërgimin dhe miratimin e programit ekonomik nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë Asamblesë (pronarit). Kjo situatë ka ndodhur për shkak se Shoqëria e ka filluar ushtrimin e aktivitetit të saj më datë 05.01.2017.

- Për vitet 2018, 2019, 2020 është konstatuar se nuk janë respektuar afatet kohore për dërgimin e projekt programit ekonomik pranë Këshillit Mbikëqyrës, brenda datës një nëntor, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, kapitulli III, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 30-33 të Projekt Raportit të Auditimit).

**16.1 Rekomandim:** Programet ekonomik-financiar (buxhetet vjetor) të hartohen në mjaftueshmëri financiare, duke mbuluar me buxhet të gjithë aktivitetin e shoqërisë. Këshilli Mbikëqyrës të miratojë në kohë programin ekonomik-financiar (buxhetin vjetor) dhe ndryshimet e tij gjatë vitit, si dhe të marrin masa për zbatimin rigoroz të zërave të buxhetit, si për të ardhurat dhe shpenzimet, duke bërë analiza periodike dhe nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për devijimet nga programi i miratuar.

**16.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Nga Albغاز sh.a janë informuar organet vendim-marrëse të shoqërisë (Asambleja dhe Këshilli Mbikëqyrës). Është bërë propozim për marrjen e hapave konkretë. MIE, në cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë ka marrë vendimin për zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë Albغاز sh.a në shumën prej 1.200.00.000 leke (vendimi Nr.9895, datë 22.12.2022).

Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**17. Gjetje nga auditimi:** -Nga departamenti i financës, regjistrimet e veprimeve kontabël, janë kryer në programin Excel dhe jo me “Bartës informatik”, të cilët janë programe informatike të pam manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë, gjë e cila ndikon në pasaktësi gjatë procesit të regjistrimit të dokumenteve financiarë, si dhe gabime gjatë kuadrimin të veprimeve kontabël. Mungesa e programit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, si dhe në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabile dhe të pasqyrave financiare.

-Procesi i marrjes në dorëzim i aktiveve afatgjata materiale në shoqërinë Albغاز SHA, nga shoqëria dhuruese Albpetrol SHA, nuk është kryer sipas Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 42,43, 55,56,57.

-Zëri i AAJM, për periudhën 31.12.2017 Aktivet afatgjata jo-materiale, License programe dhe transmetimi është grand dhe i klasifikuar si AAJM afatgjatë. Ky zë përbëhet nga pajisje kompjuterike të dhëna si grant nga TAP dhe licensa 1 vjecare për programin Office 365 Bussines Premium, në vlerën 1,056,850 lekë. Këto licensa nuk janë të lidhura me pajisjet kompjuterike dhe meqënëse skadonin brenda një periudhe 1 vjecare duhet kontabilizoheshin tek shpenzimet e

periudhës, për vlerën 4 mujore, prej 352,283 lekë që i takonte vitit 2017, dhe pjesa tjetër 704,567 lekë si shpenzim i periudhës 2018. Ky veprim ka dhënë efekte dhe zërin e të ardhurave nga grantet. -Në vlerën e të ardhurave rimarrje Grantesh, nuk është llogaritur pjesa përkatëse e vitit 2017 e licensave të Office 365 që skadonin në vitin 2018, dhe jo duke e amortizuar si një Aktiv Afatgjatë. -Administratori dhe drejtorja ekonomike kanë përdorur norma amortizimi për aktivet afatgjata materiale, për periudhën 2017, të pa miratuara nga këshilli mbikëqyrës.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, normat për llogaritjen e shpenzimeve të amortizimit të aktiveve afatgjata materiale janë të pa vlerësuara dhe aprovuara nga këshilli mbikëqyrës.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin Nr.9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

-Miratimi i pasqyrave financiare të vitit 2017, për Sh.a “Albgaz”, Tiranë, është bërë nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën nr. 7718/1, datë 09.07.2018. Aprovimi është kryer jashtë afatit të përcaktuar në Ligjin nr. 8483 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 33/1.

Veprimet sa më sipër kanë sjellë mos vlerësim të drejtë të situatës së aktiveve të shoqërisë. Mosmbajtja e kontabilitetit me “Bartës informatik”, sjellë risk për mos marrje në kohë të informacionit, duke u reflektuar në vendimmarrjen e drejtimit të shoqërisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqet 26-32 të Raportit të Auditimit).*

**17.1 Rekomandim:** Drejtimi i shoqërisë të marrë masa që në të ardhmen për pajisjen me programe kompjuterike financiare për mbajtjen e kontabilitetit.

**17.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Nga Albgaz sh.a është instaluar programi financiar “Financa 5”. Referuar faturës tatimore elektronike nr.388, datë 14.06.2022 për instalim server dhe dy poste Financa 5, likujduar kundrejt Infosoft në vlerën 248,400 lekë pa tvsh dhe 298,080 lekë me tvsh. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

*Zbatuar*

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatuan deklarime shpenzimesh të njohura fiskale në librin e blerjeve dhjetor 2017, si deklarime të faturave të OSHEE dhe UKT, të cilat ishin faturuar për subjektin e Ministrisë së Ekonomisë. Këto fatura ishin deklaruar për vlera pjesore si dhe në kolonën e blerjeve me Tvsh jo të zbritshëm.

Këto veprime janë bërë në kundërshtim me Udhëzimin Nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar. Mos deklarimi i saktë i blerjeve sjell risk për penalitete për mos zbatim të legjislacionit tatimor si dhe deformon rezultatin financiar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqet 26-32 të Raportit të Auditimit).*

**18.1 Rekomandim:** Drejtimi i shoqërisë të marrë masa që në të ardhmen nga sektori i financës deklarimet e blerjeve të kryehen me saktësi dhe në kohën e përcaktuar.

**18.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Nga Albgaz sh.a janë marrë masa dhe ka nisur kryerja e deklarimeve të blerjeve me saktësi dhe në kohën e përcaktuar. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**19. Gjetje nga auditimi:** -Shoqëria nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat tërësore e të plota që duhet të përmbajë ky regjistër, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 30. Mos plotësimi i saktë i regjistrit sjell risk i lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së shoqërisë, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqet 26-32 të Raportit të Auditimit).*



**19.1 Rekomandim:** Drejtimi i shoqërisë duhet të marrë masa për plotësimin e regjistrit të aktiveve që ka në pronësi, duke plotësuar të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë.

**19.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Nga Albgaz sh.a,regjistri i aktiveve që ka në pronësi është plotësuar dhe protokolluar me shkresën nr.20 prot., datë 16.02.2022. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

*Zbatuar*

**20. Gjetje nga auditimi:** Shoqëria në pasqyrat e vitit 2017 ka një humbje në vlerën 94,459,828 lekë e mbledhur me humbjen e vitit 2018 në vlerën 133,071,313 lekë dhe e redukton kapitalin e shoqërisë në vlerën 169,606,330 lekë. Humbjet e shoqërisë kanë kaluar në më shumë se 50 % të kapitalit të regjistruar. Për periudhat 2019-2020 shoqëria ka paraqitur pasqyrat financiare të konsoliduara të cilat nuk e japin të qartë fenomenin, por problematika kryesore e daljes me humbje është në vazhdimësi. Nga organet drejtuese të shoqërisë nuk janë marrë masat për vlerësimin e situatës, propozimet për zgjidhje dhe njoftimi i ortakut, veprim në kundërshtim me nenin Neni 136 “Mbledhja e asamblesë së përgjithshme”, të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, pika 3 si dhe pika k e nenit 20.2 të statutit të shoqërisë. Mos marrja e masave për rritjen e kapitalit mund të sjellë në një situatë falimentimi për shoqërinë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqet 26-32 të Raportit të Auditimit).*

**20.1 Rekomandim:** Drejtimi i shoqërisë duhet të marrë masa për vlerësimin e situatës së përkeqësuar ekonomike dhe financiare të shoqërisë, të analizojnë humbjet vjetore, të propozojnë për miratim në asamblenë e ortakëve zgjidhje dhe strategji afatgjata të cilat do të përmirësojnë performancën ekonomike e financiare të shoqërisë.

**20.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Albgaz Sh.a ka informuar Asamblenë dhe Këshillin Mbikqyrës për situatën financiare të shoqërisë për çdo vit buxhetor. Janë certifikuar pasqyrat financiare dhe është njohur humbja nga ekspertët ligjorë. Në këto kushte është bërë propozim për marrjen e hapave konkretë. MIE, në cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë ka marrë vendimin për zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë Albgaz sh.a në shumën prej 1,200,000,000 lekë (vendimi Nr. 9895, datë 22.12.2022). Me anë të investimeve të parashikuara për t’u realizuar në përputhje me objektivin strategjik, shoqëria “Albgaz” Sh.a planifikon që në një periudhë afatshkurtër/afatmesëm të jetë plotësisht rentabël ku të gjenerohen të ardhura nga burimet e veta njerëzore dhe materiale Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

## **B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Administrata e Shoqërisë ka përfutuar padrejtësisht: -Për periudhën Mars 2018 deri më Mars 2020, trajtim me dietë ushqimore në **vlerën 4,648,000 lekë**, trajtim i cili referuar pikës 2, germa a, të VKM nr. 68, datë 07.02.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfutuar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, duhet të ishte 300 lekë për ditë pune, ndërsa Administrata e Shoqërisë është trajtuar me 500 lekë për ditë pune. Për periudhën prill të vitit 2020 e në vazhdim ky trajtim është konform VKM të sipërcituar.

-Për periudhën objekt auditimi konstatohet se punonjësit e shoqërisë Albgaz SHA kanë përfituar padrejtësisht bonusin dietë antidodë **në vlerën 3,170,244 lekë**, bonus i cili referuar kontratës kolektive nr. 261, datë 19.09.2017, jepet për punonjësit që ushtrojnë detyrën në terren në kushtet e vështirësive tekniko profesionale, veprim i cili ngarkon me përgjegjësi Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 11-21 të Raportit të Auditimit*).

**1.1 Rekomandim:** Nga organet drejtuese të shoqërisë të analizohet **vlera 7,818,244 lekë**, vlerë e cila ka të bëjë me trajtim me dietë ushqimore dhe dietë antidodë të administratës në zbatim të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 5 datë 12.11.2019 dhe të merren masa për të mos u përsëritur në të ardhmen, pasi kjo vlerë për Shoqërinë “Albgaz” dhe Buxhetin e Shtetit, përbën efekt negativ në menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.

**1.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Albgaz Sh.a nuk ka marrë masa konkrete lidhur me këtë rekomandim brënda afatit të përcaktuar. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

*Pa zbatuar*

**2. Gjetje nga auditimi:** Shpenzime udhëtim dhe dieta për jashtë shtetit në 22 raste në vlerën 1,725,587 lekë, për akomodim në hotele jashtë vendit, të kryera pa dokumentacion të plotë justifikues. Konkretisht faturat janë lëshuar nga agjenci turistike pa u shoqëruar me faturën e hotelit të përdorur nga punonjësit e shoqërisë, duke mos vërtetuar prezencën e tyre në hotelet përkatëse, veprim në kundërshtim me VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit , i ndryshuar, pika 9. Vlera 1,725,587 lekë përbën efekt negativ në menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 11-21 të Raportit të Auditimit*).

**2.1 Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë të shqyrtohet **vlera 1,725,587 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shpenzime udhëtim e dieta për jashtë shtetit të kryera pa dokumentacion të plotë justifikues. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse për të korrigjuar këtë praktikë të paligjshme që të mos përsëritet në të ardhmen.

**2.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Albgaz Sh.a ka marrë masa për realizimin e këtij rekomandimi. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**3. Gjetje nga auditimi:** -Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 7 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **8,491,981 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbareme. Lidhur me këto çështje gjyqësore nga ana e përmbareuesve privatë është vepruar me urdhër sekuestro. Sa më sipër **vlera 8,491,981 lekë** përbën efekt negativ financiar në buxhetin e shoqërisë. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 11-21 të Raportit të Auditimit*).

**3.1 Rekomandim:** Nga Administratori, sektori Juridik dhe Burimet Njerëzore të shoqërisë Albgaz SHA, të merren masa për analizimin e vlerës prej **8,491,981 lekë**, të efektit negativ dhe për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të shkëputjes të marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

**3.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Kjo problematikë është shqyrtuar nga Sektori Juridik dhe ai i Burimeve Njerëzore të shoqërisë Albgaz Sh.a dhe janë marrë masa në zbatim të këtij rekomandimi.

Për periudhën e mëtejshme nuk ka pasur raste të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës në mënyrë të njëanshme. Për këtë qëllim është informuar në vijimësi edhe Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi).

*Në proces zbatimi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Me vendim të ish-Administratorit të Shoqërisë K.G nr. 86, datë 01.03.2017, në pozicionin e specialist në Sektorin e Burimeve Njerëzore është emëruar M.H me pagë 75,000 lekë. Me vendim të Administratorit të Shoqërisë A.A nr. 24, datë 30.01.2019, është bërë ndryshimi i pagës nga 75,000 lekë në 50,000 lekë për këtë ish-punonjëse. Ish-punonjësja në fjalë nuk dispononte diplomën e arsimit të lartë, në kundërshtim me kriteret e aprovuara me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 2/1, datë 26.01.2017. Nga përlllogaritja e pagës si diferencë ndërmjet pozicionit të punës me diplomë të arsimit të lartë dhe jo të lartë, për periudhën mars 2017 deri më dhjetor 2017 rezulton një diferencë në vlerën 416,000 lekë. **Vlera 416,000 lekë për Shoqërinë “Albgaz” Sh.a dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt negativ në menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 11-21 të Raportit të Auditimit).**

**4.1 Rekomandim:** Nga Këshilli Mbikëqyrës të shqyrtohet vlera **416,000 lekë**. Kjo vlerë ka ardhur si pasojë e diferencës së pagës nga mos pasja e diplomës së arsimit të lartë në pozicionin e specialistit në Sektorin e Burimeve Njerëzore të ish-punonjësës M.H. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse.

**4.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Në përgjigjen e dërguar grupit të auditimit, shoqëria “Albgaz” Sh.a është shprehur se momentalisht është e pamundur të njoftohet personi, pasi adresa e deklaruar rezulton e pasaktë. Pavarësisht qëndrimit të parashtruar, Albgaz SHA nuk ka vënë në dispozicion asnjë evidencë që dëshmon veprimtaritë institucionale të ndërmarra me qëllim implementimin e këtij rekomandimi. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

*Pa zbatuar*

## **D. MASA DISIPLINORE**

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenit nr.37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe Kontratës kolektive për punonjësit e shoqërisë Albgaz ShA, **kërkojmë nga Administratori i Shoqërisë** fillimin e procedurave për dhënie masë disiplinore:

**“Vërejtje” për punonjësit:**

**1.-A.Gj** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe Operacionale, për shkeljet e konstatuara në administrimin e shpenzimeve të karburantit.

Ky administrim ka paraqitur risk të lartë shpërdorimi, pasi përcaktimi i normave të konsumit të karburantit, ndjekja, monitorimi, verifikimin dhe marrja në dorëzim e formularëve të plotësuar mbi lëvizjet e kryera të punonjësve, dhe deklarimet e shpenzimeve të karburantit, janë kryer nga i njëjti person.

**2.-E.K** me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike, për shkeljet e konstatuara në procedurat e kryera për punonjësit që janë dërguar jashtë shtetit me shërbime.

Z. K ka konceptuar procedura për përzgjedhjen e hoteleve për qëndrim jashtë shtetit, duke e përcaktuar paraprakisht hotelin dhe më pas duke u kërkuar operatorëve ekonomikë, ofertën më të ulët për qëndrim. Asnjë nga operatorët ekonomikë nuk kishte marrëveshje bashkëpunimi me

hotelet e përcaktuara, pra procedura e marrjes së ofertave ekonomike ishte një procedurë formale dhe jo ekonomike dhe efektive.

**3.-A.C** me detyrë drejtor i drejtorisë së marrëveshjeve dhe projekteve, për një rast investimi, që është kryer pa leje ndërtimi, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 39, pika 1 dhe 2, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 11, pika a, neni 13, pika c. Leja e ndërtimit për objektin është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me vendim nr. 8, datë 28.02.2020.

**4.-E.P** me detyrë shëf i sektorit të projekteve, për një rast investimi, që është kryer pa leje ndërtimi, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 39, pika 1 dhe 2, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 11, pika a, neni 13, pika c. Leja e ndërtimit për objektin është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me vendim nr. 8, datë 28.02.2020.

-Në cilësinë e specialistit të fushës, në njësinë e prokurimit në hartimin e specifikimeve teknike të përcaktuara në DST, në Tenderin me objekt: “Ndërtim dhe rikonstruksion i zyrave Fier” 2018 u konstatuan parregullsitë si vijon: Vendosja e disa specifikimeve teknike nuk ishte argumentuar dhe justifikuar me relacionet përkatëse.

Vendosja e paargumentuar e specifikimeve për aftësinë teknike e profesionale, të Operatorëve Ekonomik ofertues, ka pasur si pasojë që KVO ka skualifikuar një OE i cili kishte ofertë ekonomike më të ulët në vlerën 10,932,511 lekë. Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për prokurimin publik”.

**5.-M.R** me detyrë drejtor i drejtorisë teknike, për parregullsitë në procedurën e prokurimit me objekt: “Ndërtimi i qendrës së mirëmbajtjes Korçë ”2020, në cilësinë e specialistit të fushës në njësinë e prokurimit, ku u konstatuan parregullsitë si vijon:

Vendosja e disa specifikimeve teknike nuk ishte argumentuar dhe justifikuar me relacionet përkatëse, si licencat profesionale, veprime në kundërshtim me nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për prokurimin publik”.

**Nga verifikimi rezultoi se:** Në përgjigjen e dërguar grupit të auditimit, Albgaz SHA ka nxjerrë Vendimin e brendshëm të Administratorit me nr.57, datë 25.07.2022, me nr. 79/2 prot., për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH sipas drejtorive dhe strukturave përkatëse lidhur me masat disiplinore. Konkretisht, Administratori i Albgaz sh.a ka ngarkuar Drejtorin e Shërbimeve Z. A.Gj dhe Shëfien e Sektorit Znj. A.L, për zbatimin e rekomandimeve për punonjësit: A.Gj, E.P, E.K, M.R përmes relacionit me nr. 79 prot., datë 04.07.2022. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi (realizimi) për punonjësit: A.Gj, E.P, E.K, M.R.

*Në proces zbatimi*

**Nga verifikimi rezultoi se:** Për masën disiplinore për punonjësin A.C nuk kemi informacion. Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar për punonjësin A.C.

*Pa zbatuar*

#### **IV- KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME:**

##### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**2. Gjetje nga auditimi:** Shoqëria “Albgaz” Sh.a është çertifikuar nga ERE, si operator i kombinuar i gazit natyror, nga ERE me Vendim nr. 179, datë 08.11.2017 në përputhje me nenet 37, 50, 59, 68, dhe 80 të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 73/2009 EC, *çertifikim i cili është kushtëzuar*, si për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit natyror me plotësimin e dokumentacionit që tregon titujt e pronësisë mbi aktivet që ka, për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar, lejet dhe autorizimet mjedisore, certifikatë sigurimi nga shoqëri sigurimi (që operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri). Për plotësimin e këtyre kushteve ERE herë pas here ka vendosur dhe rivendosur afate me Vendimet nr. 188, datë 10.11.2017, nr. 63, datë 23.04.2019, nr. 221, datë 20.12.2019, nr. 37, datë 04.03.2019, nr. 220, datë 20.12.2019, nr. 261, date 19.12.2018, nr. 36, datë 04.03.2019 dhe me Vendim nr. 220, datë 20.12.2019, ka vendosur të shtyjë sërish afatin e depozitimit të dokumentacionit të munguar deri më datë 31.03.2022.

Sikurse me aktivitetin e transmetimit, edhe me shpërndarjen, konstatohet se deri më datë 31.03.2022 datë në të cilën përfundoj auditimi, nuk është plotësuar asnjë nga kushtet e vendosura nga ERE. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” neni 22. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 16-19 të Raportit të Auditimit).*

**2.1 Rekomandim:** Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë të marrin masa për nxjerrjen nga statusi i certifikimit të kushtëzuar të shoqërisë, duke analizuar dhe vlerësuar arsyet e mos plotësimit të kushteve të vendosura nga ERE, duke vendosur një afat prekluziv në lidhje me plotësimin e kushteve të certifikimit.

##### ***Menjëherë***

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga Shoqëria “Albgaz” Sh.a nuk disponohet pronësia e gjurmës së kalimit të tubacioneve magjistrale të transmetimit të gazit natyror në total. Sipas Master Planit të Gazit Natyror kjo shoqëri disponon 267.4 km, ndërsa sipas inventarit kontabël disponon 264 km, me një diferencë 3.4 km. Tubacionet magjistrale të transmetimit të gazit janë projektuar e ndërtaur rreth viteve 1970-1980.

Gjurma e kalimit të tubacioneve është projektuar e zbatuar duke kaluar edhe përmes tokës arë dhe drufrutor të prodhimit të kulturave bujqësore dhe të plantacioneve të drufrutoreve nën administrim të ish-kooperativave bujqësore dhe të ish-ndërmarrjeve shtetërore.

Tubacionet janë futur në thellësinë 1 metër deri në 1.2 metër nën sipërfaqen e tokës, me qëllim që të mos pengonin punimet për kulturat bujqësore dhe drufrutore. Në zbatim të Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, me ndryshimet vijuese të tij, për pronësinë e gjurmës së kalimit të tubacioneve magjistrale të transmetimit të gazit, nuk është mbajtur asnjë qëndrim për njohjen e autoritetit të pronarit të tubacioneve për gjurmën e kalimit. Pra 264 km tubacion i transmetimit të gazit kalon në tokat në pronësi të të tretëve.

Ky është jo vetë një problem pronësie, por dhe të shfrytëzimit të magjistraleve të tubacioneve të transmetimit të gazit, pasi pengon jo vetëm kryerjen e shërbimeve teknike të tubacioneve, por dhe rëndon koston e mirëmbajtjes, pasi shoqëria është e detyruar të zhdëmtojë kulturat bujqësore dhe drufrutore të pronarëve të tokave. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. Ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, neni 12, pika 1 dhe 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 16-19 të Raportit të Auditimit).*

**3.1 Rekomandim:** Nga Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës të merren të gjitha masat tekniko-organizative dhe të ndiqen procedurat ligjore për përcaktimin e distancës së gjurmës së tubacioneve të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, si dhe zbatimin e plotë të dispozitave

ligjore për pronësinë dhe pasurinë e nëntokës me të vetmin pronar Shtetin, duke i kërkuar zyrtarisht Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të bëjnë rregullimin e marrëdhënieve të bashkëpronësisë të tokës arë, drufrutore, pyjore, kullosore dhe truall që disponohet (regjistruar) nga palët e treta me gjurmën e kalimit të tubacioneve të magjistrale të gazit natyror.

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Në statutin e Shoqërisë “Albgaz” Sh.a, neni 13.3, është përcaktuar kompetenca e Asamblesë së Përgjithshme, vendosja e kufirit për aprovimin e huave në vlerat mbi 10,000,000 euro dhe të drejtën e vendimmarrjes për heqje dorë nga një e drejtë për vetëm mbi 300,000 euro ose 500,000 euro vlera kumulative gjatë një viti, duke i lënë vlerat nën këto tavane, si kompetencë e aprovimit të Këshillit Mbikëqyrës.

Po në këtë status neni 16, pika 16.3/n është përcaktuar kompetenca e Këshilli Mbikëqyrës:

- Të miratojë hyrjen në një marrëveshje huaje apo kredie ose krijime të tjera (apo marrëveshje për krijim) të një borxhi të shoqërisë deri në shumën prej 10,000,000 euro.

-Të japë miratimin paraprak për blerjen e aktiveve të paluajtshme mbi vlerën 100.000 euro.

-Të miratojë paraprakisht shitjen apo çdo formë disponimi të aktiveve të paluajtshme të Shoqërisë me vlerë nga 50.000 deri 100.000 euro, dhe të kërkojë paraprakisht miratimin e Asamblesë për vlera më të mëdha se 100.000 euro.

-Të miratojë paraprakisht shitjen e aktiveve të luajtshme në rast se vlera e një kontrate është nga 50.000 deri 100.000 euro, ose nëse vlera kumulative e këtyre kontratave është nga 250.000 deri 500.000 euro brenda një viti financiar.

-Termi i përdorur sa më sipër (... të miratoj paraprakisht...), nuk është i qartë dhe nuk i jep vlerë përfundimtare kompetencës së çeduar, pra Këshilli Mbikëqyrës, i shqyrton paraprakisht dhe më pas shqyrtohen dhe nga Asambleja e Përgjithshme, apo është organi i vetëm që i shqyrton dhe pas tij vendimet marrin vlerë përfundimtare.

Kompetencat si më sipër të Këshillit Mbikëqyrës, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar, neni 4, neni 10 (Shtuar pas fjalisë së parë me Ligjin nr. 8/2016, datë 11.2.2016).

-Në nenin 17, përbërja e Këshillit Mbikëqyrës, në asnjë nga pikat nuk përcaktohet kriteri i aftësive profesionale, eksperiencia dhe monitorimi i veprimtarisë mbikëqyrëse dhe vendimmarrëse i tyre me performancën e shoqërisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 16-19 të Raportit të Auditimit).*

**4.1 Rekomandim:** Asambleja e Përgjithshme brenda kompetencave ligjore, të bëjë parashikime specifike (ç’fuqizojë dhe/ose ndreqje gabimi material) në Statut, në lidhje me vendosjen e kufirit për aprovimin e huave, si dhe përbërjen e Këshillit Mbikëqyrës, ku të përcaktohet specifikisht kriteri i aftësive profesionale, eksperiencia dhe monitorimi i veprimtarisë mbikëqyrëse dhe vendimmarrëse i tyre, në lidhje me performancën e shoqërisë.

**Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga dokumentacioni zyrtar i vënë në dispozicion u konstatua se Shoqëria “Albgaz” Sh.a është palë edhe në marrëveshjet si më poshtë:

-Marrëveshja për fondet e rikonstruksionit të Qendrës Fier (Funding Agreement C32919 between Trans Adriatic Pipeline AG Albanian Branch and Albgaz Sh.a), hartuar dhe nënshkruar më datën 18.09.2017, protokolluar me nr. 141 prot., datë 03.11.2017 në gjuhën Angleze, nuk është hartuar dhe nënshkruar në gjuhën shqiptare.

-EBRD-ECA (Terma Reference: Project është përgatitur me ndihmën e konsulentit ECA, si pjesë e asistencës për ngritjen e kapaciteteve teknike, financuar nga (BERZ) e nënshkruar më datën

04.05.2017, hartuar dhe nënshkruar në gjuhën Angleze, nuk është hartuar dhe nënshkruar në gjuhën shqiptare.

-Marrëveshja trepalëshe të trajnimit të negociuar ndërmjet S S.P.A, Shoqërisë “Albgaz” Sh.a dhe Shoqërisë “A G S C” Sh.a, e nënshkruar më datën 22.01.2020, hartuar dhe nënshkruar në gjuhën Angleze, nuk është hartuar dhe nënshkruar në gjuhën shqiptare.

Marrëveshjet si mësipër të hartuara dhe nënshkruara vetëm në gjuhën angleze, pa u hartuar dhe nënshkruar në gjuhën shqiptare, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8417, date 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 14. Marrëveshjet e mësipërme, janë hartuar dhe nënshkruar vetëm në gjuhën angleze, pa u hartuar dhe nënshkruar në gjuhën shqiptare gjë që pamundësoi auditimin e tyre nga grupi i auditimit, kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 8417, date 21.10.1998, me ndryshimet vijuese të tij, neni 14. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 16-19 të Raportit të Auditimit).*

**5.1 Rekomandim:** Për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura në lidhje me hartimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve me Shoqërinë, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktikë, duke përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar marrëveshjet ekzistuese, por edhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

*Menjëherë*

**6. Gjetje nga auditimi:** Shoqëria “Albgaz” Sh.a në shpenzimet e veprimtarisë operacionale të saj rëndohet padrejtësisht nga vënia në punë dhe mirëmbajta e stacioneve të kompresorëve B2S Drenovë. Mbajtja e stacionit të kompresorëve B2S DR në punë ka kosto operacionale të lartë (shpenzime për vajra, riparime të defekteve, shpenzime paga fuqie punëtore, energjinë elektrike dhe reaktive etj.). Përveç shpenzimeve të tjera, edhe pse është aktiv afatgjatë material i Shoqërisë “Albgaz” Sh.a, faturimi i energjisë elektrike dhe reaktive i Shoqërisë “Albgaz” Sh.a kryhet nga Shoqëria “Albpetrol” Sh.a, bile jo nga kjo shoqëri, por nga QFSHEE . Pra matësi i energjisë është i kësaj të fundit (aktivi afatgjatë material është i Shoqërisë “Albgaz” Sh.a, matësi është i Shoqërisë “QFSHEE”), dhe me çmim 17.4 lek/këh për energji elektrike dhe 1.65 lekë për këh energji reaktive që i përket çmimit të liberalizuar të konsumatorëve të tregut të lidhur me tensionin e lartë dhe të mesëm.

Për shpenzimet e energjisë elektrike dhe reaktive (jo për shpenzimet e tjera), Shoqëria “Albgaz” Sh.a i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 120 prot., datë 22.10.2018 për rivlerësim e këtij shpenzimi, për një shpërndarje sa më të drejtë mes dy shoqërive. Për vitet 2017-2019 shpenzimet për energjinë elektrike dhe reaktive, lubrifikant, shpenzime avarie, paga etj., kapin vlerën 23,365,578 lekë.

Deri më datën 31.03.2022, datë në të cilën përfundon auditimi nuk është kryer rivlerësim i këtij shpenzimi, për një shpërndarje sa më të drejtë të tij mes dy shoqërive, edhe pse 5 nga 6 antarët e Këshillit Mbikëqyrës (Me përjashtim të N.L që është përfaqësuesi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë) i perkasin Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë edhe të Asamblesë së Aksionarëve, për të cilët Shoqëria “Albgaz” Sh.a për vitet 2017-2019 ka shpenzuar vlerën 2,537,485 lekë për shpërblimin e tyre. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 2, pika 25 dhe 26, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 36 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 në faqet 30-33 të Raportit të Auditimit).*

**6.1 Rekomandim:** Nga Këshilli Mbikëqyrës të ri-njoftohet zyrtarisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e Asamblesë së Aksionarëve (pronarit) dhe të monitoruesit dhe hartimit të politikave të Shoqërisë “Albgaz” Sh.a dhe Shoqërisë “Albpetrol” Sh.a, brenda kompetencave ligjore, statusore, rregullatorë të kryej rivlerësimin e këtij shpenzimi, për një shpërndarje sa më të

drejtë të tij mes dy shoqërive. Në rast mos kryerjes së rivlerësimit të këtij shpenzimi nga Asambleja, të ndiqen procedurat gjyqësore.

*Menjëherë*

**9. Gjetje nga auditimi:** -Struktura organizative dhe niveli i pagave të Shoqërisë, nuk është miratuar specifikisht nga Asambleja Aksionare (Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë). Konkretisht për vitin 2017 nuk është marrë miratimi për strukturën organizative, për vitet 2018 dhe 2019 nuk është marrë miratimi për strukturën organizative dhe nivelin e pagave dhe për vitin 2020 nuk është marrë miratimi për nivelin e pagave. Organet drejtuese të Shoqërisë (Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori) e kanë quajtur të ezauruar miratimin vetëm me miratimin e programit ekonomik ku pjesë e tij është dhe fondi i pagave. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1.

-Shoqëria “Albgaz” Sh.a marrëdhëniet e punës me punonjësit e saj i ka të rregulluar bazuar në Ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, Kontratës kolektive nr. 261, datë 19.09.2017 dhe kontratave individuale të punës. Pagat janë të grupuar në katër nivele për secilin pozicion pune, konkretisht niveli i I, II, III dhe IV dhe secili nivel ka një limit përcaktuar. Për pozicionet punëtor deri në specialist brenda limitit të çdo niveli është përcaktuar paga e secilit punonjës me vendim të Administratorit.

Për pozicionet përgjegjës sektori, shef sektori, asistent ekzekutiv, këshilltar, drejtor drejtorie nuk ka të miratuar sipas kompetencave statusore një rregullore, ku të parashikohen kriteret e caktimit të pagës brenda limit të miratuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 11-21 të Raportit të Auditimit).*

**9.1 Rekomandim:** Nga Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës të merren masat për të hartuar dhe miratuar sipas kompetencave statutore një rregullore, ku të parashikohen kriteret e caktimit të pagës brenda limit të miratuar, për pozicionet përgjegjës sektori, shef sektori, asistent ekzekutiv, këshilltar, drejtor drejtorie etj.

**9.2 Rekomandim:** Nga organet drejtuese të shoqërisë të merren masat për miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, duke zbatuar në këtë mënyrë detyrimet ligjore dhe statutore në mirë-organizimin dhe mirëfunksionimin e shoqërisë.

*Menjëherë*

**10. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi u konstatua se, mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të rregullave të parashikuara në Statut ose Rregullore të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. Në të gjithë deklaratimet për vende të lira pune për periudhën objekt auditimi nuk deklarohet afati brenda të cilit individët mund të paraqesin aplikimet e tyre. Për më tepër, në shumë raste evidentohet kohë shumë e shkurtër nga momenti i deklaratimit të pozicionit të lirë të punës deri në momentin e emërimit në punë të fituesit. Evidentohet në disa raste mungesa e deklaratimeve për vende të lira pune në këtë Shoqëri, si dhe kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira, sa më sipër në kundërshtim me Ligji nr. 9125, datë 29.07.2003 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, neni 9 pika 1, pika 5, gërma a *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 11-21 të Raportit të Auditimit).*

**10.1 Rekomandim:** Nga organet drejtuese të shoqërisë të merren masat:



-Të bëhen parashikime të detajuara staturore dhe rregullatore lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë.

- Të bëhet adresim korrekt në rregullore i përgjegjësive të punonjësve bazuar në lidhjen shkakësore të veprimeve të tyre me pasojat e kundraligjshme që mund të shkaktohen.

- Të përcaktohet në deklaratimet për pozicione të lira pune, edhe afati brenda të cilit të interesuarit për pozicionin e punës, duhet të shprehin interesin dhe paraqesin dokumentacionin e nevojshëm provues.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Administrata e Shoqërisë ka përfituar padrejtësisht: -Për periudhën Mars 2018 deri më Mars 2020, trajtim me dietë ushqimore në *vlerën 4,648,000 lekë*, trajtim i cili referuar pikës 2, germa a, të VKM nr. 68, datë 07.02.2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, duhet të ishte 300 lekë për ditë pune, ndërsa Administrata e Shoqërisë është trajtuar me 500 lekë për ditë pune. Për periudhën prill të vitit 2020 e në vazhdim ky trajtim është konform VKM të sipërcituar.

-Për periudhën objekt auditimi konstatohet se punonjësit e shoqërisë Albgaz SHA kanë përfituar padrejtësisht bonusin dietë antidodë *në vlerën 3,170,244 lekë*, bonus i cili referuar kontratës kolektive nr. 261, datë 19.09.2017, jepet për punonjësit që ushtrojnë detyrën në terren në kushtet e vështirësive tekniko profesionale, veprim i cili ngarkon me përgjegjësi Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 11-21 të Raportit të Auditimit*).

**1.1 Rekomandim:** Nga organet drejtuese të shoqërisë të analizohet *vlera 7,818,244 lekë*, vlerë e cila ka të bëjë me trajtim me dietë ushqimore dhe dietë antidodë të administratës në zbatim të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 5 datë 12.11.2019 dhe të merren masa për të mos u përsëritur në të ardhmen, pasi kjo vlerë për Shoqërinë “Albgaz” dhe Buxhetin e Shtetit, përbën efekt negativ në menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.

*Menjëherë*

**4. Gjetje nga auditimi:** Me vendim të ish-Administratorit të Shoqërisë K.G nr. 86, datë 01.03.2017, në pozicionin e specialist në Sektorin e Burimeve Njerëzore është emëruar M.H me pagë 75,000 lekë. Me vendim të Administratorit të Shoqërisë A.A nr. 24, datë 30.01.2019, është bërë ndryshimi i pagës nga 75,000 lekë në 50,000 lekë për këtë ish-punonjëse. Ish-punonjësja në fjalë nuk dispononte diplomën e arsimit të lartë, në kundërshtim me kriteret e aprovuara me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 2/1, datë 26.01.2017. Nga përlllogaritja e pagës si diferencë ndërmjet pozicionit të punës me diplomë të arsimit të lartë dhe jo të lartë, për periudhën mars 2017 deri më dhjetor 2017 rezulton një diferencë në vlerën 416,000 lekë. *Vlera 416,000 lekë për Shoqërinë “Albgaz” Sh.a dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt negativ në menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 11-21 të Raportit të Auditimit).*

**4.1 Rekomandim:** Nga Këshilli Mbikëqyrës të shqyrtohet vlera *416,000 lekë*. Kjo vlerë ka ardhur si pasojë e diferencës së pagës nga mos pasja e diplomës së arsimit të lartë në pozicionin e

specialistit në Sektorin e Burimeve Njerëzore të ish-punonjësës M.H. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse.

*Menjëherë*

#### **D. MASA DISIPLINORE**

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni nr.37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe Kontratës kolektive për punonjësit e shoqërisë Albgaz ShA, **kërkojmë nga Administratori i Shoqërisë** fillimin e procedurave për dhënie masë disiplinore:

##### **“Vërejtje” për punonjësin:**

**3.A.C** me detyrë drejtor i drejtorisë së marrëveshjeve dhe projekteve, për një rast investimi, që është kryer pa leje ndërtimi, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 39, pika 1 dhe 2, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 11, pika a, neni 13, pika c. Leja e ndërtimit për objektin është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me vendim nr. 8, datë 28.02.2020.

*Menjëherë*

*Në lidhje me masat e konstatuara në proces zbatimi ose të zbatuara pjesërisht, nga ana e subjektit të audituar “Albgaz” SH.A të vijojnë përpjekjet duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore deri në zbatimin e plotë të tyre.*

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë Vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja. Ky vendim përcillet në formë rekomandimi në subjektin e auditimit.

#### **3.5. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, projekti “Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi (BOT) HEC mbi lumin Devoll, rimbursimi i ndërtimit të rrugëve zëvendësuese”**

##### **A. PËRMBLEDHJE**

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 702/1 Prot, datë 04.08.2023, me objekt: “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022”.

Auditimi është kryer nga:

*E.K*

*K.G*

Periudha e auditimit: 01.01.2022 – 31.12.2022

Afati i auditimit: 07.08.2023 - 08.09.2023

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të lartë të shtetit ” dhe të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH, Nr. 1, datë 04.11.2016, “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacion që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit rekomandimeve të KLSH ”.

Duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

a. Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së, të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2022, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjektet e audituara, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

- b. Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike, të akteve administrative të nevojshme, si vendime e urdhra për zbatimin e masave organizative;
- c. Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

## **B. HYRJA**

Përfaqësuesit e autorizuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit, audituesit E.K dhe K.G, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë u informuan mbi ecurinë e zbatimit të tyre nga znj. V.H në cilësinë e Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Objekti i këtij Raporti Përfundimtar është zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në subjektin Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

## **C. REZULTATET E AUDITIMIT**

Nga zbatim të programit të auditimit u verifikua dokumentacioni si më poshtë:

Raporti Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;  
Shkresa përcjellëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, administruar në shoqërinë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;  
Etj.

Nga auditimi rezulton se:

### **I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.**

-Në mospërputhje të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sh.a., nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, duke mos respektuar kështu afatin 20 ditor të dërgimit.

### **II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.**

-Në mospërputhje me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, Ministria ., nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, duke mos respektuar kështu afatin 6 mujor të dërgimit.

### **III. Rekomandimet e KLSH**

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit në Ujësjellës Kanalizime Sarandë sh.a. janë rekomanduar gjithsej:

**a.** Janë rekomanduar 20 **masa organizative**;

**b.** Janë rekomanduar 2 **masa për shpërblim dëmi në vlerën 486,000 lekë**;

**c.** Janë rekomanduar 5 **masa për përdorimin me shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 141,223 euro + 104,890,174lekë**;

### **IV. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH**

Sipas shkresës së administruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si me poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar Plotësisht	Pa pranuar
1	Organizative	8 masa	8 masa	0
2	Shpërblim dëmi	3 masa	3 masa	0
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	3 masa	3 masa	0

#### V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit

Në mënyrë të përmblendhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	8 masa			7	1
2	Shpërblim dëmi	3 masa			3	
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	3 masa			3	

Në mënyrë të analitike statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

#### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e kontratës përfundimtare të koncesionit lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Koncesionarit, të aprovuar me ligjin nr. 7/2015, datë 12.02.2015, dhe me ligjet e mëparshme u konstatua se janë kryer ndryshime të rëndësishme thelbësore nga kushtet e përcaktuara në dokumentet e procedurës së koncesionit për përzgjedhjen e operatorit ekonomik fitues si vijon:

-Në pjesën e kushteve të kontratës, në formularin e deklaratimit të ofertës, ofertuesi konfirmon pajtimin e tij për të firmosur kontratën sipas formularit të Kushteve të Kontratës, nëse shpallet fitues. Në seksionin e Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës Koncesionare përcaktohet se: A. Terma të Përgjithshme të MK, C. Të drejtat dhe detyrimet e palëve, koncesionari duhet të marrë masa të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet, që eventualisht mund t'i shkaktohen palëve të treta. E. 20. Çështjet e panegociueshme, - Akses të plotë të Autoritetit Kontraktues dhe ERE në regjistrat e punës së Koncesionarit. -Detyrimi i Koncesionarit dhe shoqërisë së projektit për të paguar taksat, detyrimet dhe taksat e tjera sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë. –Pagesa e të drejtës koncesionare do të jetë në % fituese kWh, jo më pak se 2% të vleftës absolute të prodhimit të energjisë elektrike. –detyrimi i koncesionarit për të përbushur kërkesat e Autoritetit Kontraktues ose ERE për tu përshtatur me detyrimet e shërbimit publik. F. Zbatimi dhe interpretimi i kësaj kontrate koncesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptar në fuqi dhe çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë kontratë do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Më pas në shtesat e kontratave kushtet fillestare kanë ndryshuar duke e kaluar riskun te Autoriteti Kontraktues.

-Pagesa e detyrimeve fiskale sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, në kontratë është ndryshuar duke e përjashtuar koncesionarin nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH), për mallrat e importit dhe ato brenda vendit si dhe të gjitha ndryshimet në taksa gjatë viteve.

-Gjykimi i mosmarrëveshjeve mes palëve është akorduar për tu zgjidhur në Gjykatën e Arbitrazhit.

Ndryshimi i kushteve thelbësore të kontratës ka sjellë shkeljen e barazisë në procedurën e përzgjedhjes së koncesionarit, veprime në kundërshtim me nenin nr.1., të Ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006, i ndryshuar, “Për koncesionet”, ku citohet: *Qëllimi i këtij ligji është të krijojë kuadrin e nevojshëm për nxitjen dhe lehtësimin e zbatimit të projekteve koncesionare, të financuara nga sektori privat, duke rritur transparencën, barazinë, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë në zhvillimin e projekteve të infrastrukturës dhe të shërbimeve publike. Ai synon zhvillimin e mëtejshëm të parimeve të përgjithshme në lidhjen e kontratave nga autoritetet publike, nëpërmjet përcaktimit të procedurave të veçanta për dhënien e projekteve koncesionar, . dhe me nenin nr. 21., Caktimi i ofertuesit më të mirë dhe negocimet përfundimtar, pika 2, ku citohet: “**Kushtet kontraktuale, të deklaruara të panegociueshme në kërkesën përfundimtare për propozime, nuk do të jenë objekt i negociimeve përfundimtare.**” Trajtuar më hollësisht në Pikën 1, faqe 23 të Projektraportit të Auditimit.*

**1.1.Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në të ardhmen në procesin e finalizimit të kontratave me operatorët fitues, të mos ndryshojë termat e përgjithshme dhe të veçanta të procedurave të përzgjedhjes së ofertuesve pasi sjell shkeljen e barazisë në procedurën e përzgjedhjes së koncesionarit, dhe uljen e transparencës, barazisë, efikasitetit dhe qëndrueshmërinë afatgjatë në zhvillimin e projekteve të infrastrukturës dhe të shërbimeve publike.

*Në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Bazuar në materialin e paraqitur nga auditi i KLSH-së, si dhe në vijim të shkresës suaj lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimev, ju informojmë si vijon:

Lidhur me gjetjen se në auditimin e kontratës përfundimtare të koncesionit lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Koncesionarit, të aprovuar me ligjin nr. 7/2015, datë 12.02.2015, dhe me ligjet e mëparshme u konstatua se janë kryer ndryshime të rëndësishme thelbësore nga kushtet e përcaktuara në dokumentet e procedurës së koncesionit për përzgjedhjen e operatorit ekonomik fitues si dhe në vijim të rekomandimit të KLSH-së, theksojmë se këto ndryshime në kontratë janë vlerësuar të domosdoshme në periudhën e lidhjes së kontratës, megjithatë do të merret në konsideratë dhe do të merren masa që të mos të kenë ndryshime thelbësore në të ardhmen. Si e tillë, rekomandimet e KLSH-së do të shërbejnë për përsosjen dhe përmirësimin cilësor të procedurave të ardhshme që do të shpallen nga ana e MIE-së.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

**2. Gjetje nga auditimi:** Në Masterplanin e vitit 2003-2015, “Për zhvillimin e sektorit të gjenerimit të energjisë elektrike” është përcaktuar se për të përballuar nevojat shtesë Elektroenergjitike dhe për të reduktuar nivelin shumë të lartë të importit, parashikohet të ndërtohen HEC-e, që do të rrisin sigurinë e furnizimit me energji elektrike në të gjithë vendin.

Nga shqyrtimi i kushteve fillestare të procedurës së përzgjedhjes së koncesionarit dhe deri në ndryshimet përfundimtare të kontratës lidhur me operatorin ekonomik fitues u konstatua se ky objektivi nuk është përcaktuar qartë dhe me terma të matshëm në kushtet kontraktuale.

Në seksionin e Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës Koncesionare, të dokumenteve të procedurës së koncesionit, përcaktohet se: A. Terma të Përgjithshme të MK, 7. **Koncesionari është i interesuar të investojë në ndërtimin e hidrocentraleve me qëllimin e prodhimit të energjisë elektrike dhe rritjen e sigurisë të furnizimit me energji elektrike të gjithë vendit. 11. Shërbimi Publik, Marrëveshja Koncesionare bazohet në Ligjin për Koncesionet dhe**

***pavarësisht Autoriteti Kontraktues ose ERE mund ti kërkojnë Koncesionarit të përmbushë disa detyrime të shërbimit publik në furnizimin me energji elektrike.***

- Në kontratë është përcaktuar se koncesionari mund ta shesë energjinë elektrike në eksport pa asnjë kufizim. Ky përcaktim ka devijuar objektivin kryesor që ishte rritja e kapaciteteve energjetike në vend, sepse koncesionari pasi ka filluar prodhimin e energjisë ka vënë në dispozicion sasi të vogla energjie brenda vendit. Termat e përgjithshme të Marrëveshjes Koncesionare nuk janë reflektuar në detyrime specifike për sasinë e energjisë elektrike për furnizim brenda vendit, të përcaktuara në sasi e vlera për tu bërë të detyrueshme për tu zbatuar gjatë zbatimit.

Arsyetimet e bëra nga Autoriteti Kontraktor se duhet të zbatonin modelin e ri të tregut, nuk qëndrojnë pasi shumë vende të BE, në koncesione të ngjashme kanë vendosur kushte që detyronin koncesionarët të furnizojnë sasi dhe çmime të ulëta për komunitetin. I tillë është shembulli i Norvegjisë ku koncesionarët janë të detyruar të lëvrojnë 10 % të energjisë së prodhuar tek autoritetet lokale ku ndodhet baseni ujour, me kosto të ulët ose me kosto prodhimi.

Mos reflektimi i detyrimeve për furnizimin me energji elektrike brenda vendit në kontratën përfundimtare ka sjellë dhe devijimin e qëllimit kryesor të koncesionit, që ishte rritja e kapaciteteve furnizuese me energji elektrike brenda vendit.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me nenin nr.27., të Ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006, i ndryshuar, “Për koncesionet”, pika a, ku citohet: “Kontratat e koncesionit parashikojnë ato çështje që vlerësohen të përshtatshme nga palët, të tilla si: a) natyra dhe objekti i punëve që duhet të kryhen dhe shërbimet që duhet të jepen nga koncesionari;” (Trajtuar më hollësisht në Pikën 1, faqe 23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

**2.1.Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në të ardhmen në procesin e realizimit të koncesioneve dhe finalizimit të kontratave me operatorët fitues të përcaktohen qartë, saktë dhe me parametra të matshëm objektivat kryesorë të koncesionit.

*Në vijimësi*

**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Lidhur me këtë rekomandim, sqarojmë se është ngarkuar Drejtoria e Partneritetit Publik Privat në Infrastrukturë dhe Energji në bashkëpunim me Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Eficiencën e Energjisë, në cilësinë e drejtorive kompetente që të marrin masat e nevojshme për të ndjekur procesin e realizimit të koncesioneve dhe finalizimit të kontratave me operatorët fitues, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe parimet kryesore, me qëllim zhvillimin e projekteve sa më efikasë, të qëndrueshëm dhe afatgjatë.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se në pikën 6. b, të dokumenteve të procedurës së koncesionit, respektimi optimal i aspekteve ekologjike dhe mjedisore, sigurimi i rrjedhës minimale në shtratin natyral të lumit, i vlerësuar me 5 pikë, ku citohet se projekti duhet të sigurojë një rrjedhje të vazhdueshme në të gjithë shtratin natyral të lumit, në masën jo më pak se 15 % të prurjeve natyrale, për të garantuar zhvillimin e florës dhe faunës në këtë lumë u konstatua se këto kërkesa nuk ishin përcaktuar qartë e saktë në kontratat e lidhura me operatorin fitues.

Kërkesës së dërguar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës për dhënie mendimi në lidhje me koncesionin, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, i ka dhënë përgjigje me shkresën nr. 110 Prot., datë 11.01.2009.

-Duke qenë se lumi Devoll në pjesë të veçanta të rrjedhës së tij shërben edhe si burim ujor për ujitje, ka kërkuar që në kontratën e koncesionit ndërmjet autoritetit kontraktues dhe koncesionarit, të përcaktohen qartë nevojat për ujë për ujitje, që ka bujqësia gjatë periudhës së ujitjes (periudha Maj-Gusht), kjo për faktin se me ujërat e lumit Devoll është e lidhur ujitja e rreth 70 000 ha tokë bujqësore dhe në funksion të kësaj janë bërë investime të konsiderueshme në rehabilitimin e infrastrukturës së ujitjes në mjaft zona të vendit. Për bujqësinë nga hidrocentrali i Banjës duhet të merren rreth 150 milion m<sup>3</sup> ujë nga rrjeti i poshtëm që shfrytëzohen me rrjedhje të lirë dhe konkretisht:

-Nëpërmjet digës së Vlashukut dhe rezervuarit të Thanës dhe rrjetit ekzistues ujitës merren nga lumi Devoll rreth 100 milion m<sup>3</sup> ujë në periudhën Mars-Shtator për mbushjen e rezervuarit të Thanës nëpërmjet të cilit realizohet ujitja e rreth 40 000 ha tokë bujqësore në rrethet e Lushnjës dhe të Fierit;

-Nëpërmjet kanalit lidhës Banjë-Shkumbin duke u kombinuar me rrjetin ekzistues të kanalit Peqin Kavajë (zona e poshtme e Dumresë dhe fushat e Cërrikut, Peqinit dhe Kavajës) shfrytëzohet rreth 40 milion m<sup>3</sup>; nëpërmjet digës së Vlashukut në rrethin e Kuçovës dhe Fierit shfrytëzohen rreth 10 milion m<sup>3</sup> ujë;

Bujqësisë në basenin e Devollit, nevojat për ujë për ujitje nga lumi Devoll, gjatë sezonit arrijnë në rreth 150 milion m<sup>3</sup> ujë.

Në këto kushte kërkesa duhej marrë në konsideratë pasi plotësimi i nevojave për ujë për ujitje nga lumi Devoll është i domosdoshëm për zhvillimin e bujqësisë në zonat fushore të Lushnjës, Fierit, Kavajës, Elbasanit, Beratit e Korçës.

**-Kërkesa e Ministrit të MBUMK, për përcaktime të sakta për ujin për vaditje si dhe parametrat e projektit fillestar për sigurimin e rrjedhës së vazhdueshme të ujit gjatë gjithë vitit për sigurimin e florës dhe faunës së lumit, nuk janë pasqyruar në kontratën përfundimtare mes palëve.**

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me Dokumentet e Procedurës së Koncesionit, pjesa “Nënshkrimi i kontratës, kushtet”, ku citohet: *“Autoriteti Kontraktues do të firmosë me atë ofertues, oferta e të cilit është përzgjedhur si oferta më e mirë. Drafti i kontratës përfshihet si pjesë e këtij dokumentacioni dhe ofertuesi duhet të plotësojë formularin me të dhënat dhe detajet e tij, që gjenden në Ofertë. (Trajtuar më hollësisht në Pikën 1, faqe 23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)*

**3.1.Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në të ardhmen në procesin e realizimit të koncesioneve dhe finalizimit të kontratave me operatorët fitues të përcaktohen qartë, saktë dhe me parametra të matshëm objektivat kryesorë të koncesionit.

*Në vijimësi*

Statusi i pranimit: Pranu

Përgjigje nga subjekti:

Lidhur me këtë rekomandim, sqarojmë se është ngarkuar Drejtoria e Partneritetit Publik Privat në Infrastrukturë dhe Energji në bashkëpunim me Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Eficiencën e Energjisë, në cilësinë e drejtorive kompetente që të marrin masat e nevojshme për të ndjekur procesin e realizimit të koncesioneve dhe finalizimit të kontratave me operatorët fitues, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe parimet kryesorë, me qëllim zhvillimin e projekteveve sa më efikasë, të qëndrueshëm dhe afatgjatë.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit teknik sipas kontratës së punimeve civile “Rikonstruksion i segmentit 3B, Drizë-Gramsh”, në shumë zëra punimesh (ditë pune) si pastrim tombino, problematika nga shpronësimet, dhera të rëna nga reshjet etj., janë raportuar punime nga mekanizmat të rëndë gjermimi, ndërkohë që këto punime mund të realizohen nga mekanizma më të lehtë siç janë ekskavatorët 0.65 m<sup>3</sup>, duke rritur në këtë mënyrë koston e punimeve.

-Nga auditimi rezulton se sipas zërit 2.c.02 “Gërmim në material dherash”, ishte parashikuar volumi në sasinë 434550 m<sup>3</sup>, i cili është certifikuar në sasinë 228067.5 m<sup>3</sup>, me çmim 2.7 Euro/m<sup>3</sup>. Po ashtu, sipas zërit 2.c.03 “Gërmim në material shkëmbor”, ishte parashikuar sasia 6636 m<sup>3</sup> dhe është certifikuar sasia 264964 m<sup>3</sup>, me çmim 6 Euro/m<sup>3</sup>. Ky ndryshim është bërë me argumentimin e ndryshimit të gjendjes së parashikuar me atë të rezultuar faktike. Vlera e punimeve të gjermimit si më sipër është rritur në shumën rreth 900 mijë Euro. Sa më sipër kemi të bëjmë me mangësi gjatë procesit të projektimit të rrugës. Nga ana e kontraktorit dhe mbikëqyrësit të punimeve nuk është përcaktuar fortësia e formacionit të tokës në seksionet përkatëse të gjermimit, për klasifikimin e mundshëm si zë të ri punimi, i cili do të kishte çmim tjetër nga ai i referuar, si dhe nuk është përcaktuar metoda e gjermimit e nevojitur, apo njëtrajtshmëria e formacionit, veprim në kundërshtim me specifikimet teknike Pika 2.03.2.3 “Gërmim në seksion rruge në shkëmb”.

Janë certifikuar punime sipas zërit 4.f. 05 “Reinforced concrete pipe culvert, 500 mm (half pipe)”, në sasinë 3411 ml, me çmim 22 Euro/ml. Nga verifikimi i punimeve të realizuara nuk rezultojnë punime me specifikime të tilla. Kanalet mbrojtëse nga ujërat, janë ndërruar me beton të derdhur në vend, me seksion trapezoidal. Ky veprim është në kundërshtim me specifikimet teknike, Pika 6.08.3, si dhe Kontratën FIDIC, pika 7.01.a. (*Trajtuar më hollësisht në Pikën 2, faqe 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*)

**4.1. Rekomandimi:** Njësia e Zbatimit të Projektit, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të marrin masa për analizimin dhe përcaktimin e fortësisë së formacionit të gjermuar, për përcaktimin e saktë të kategorisë dhe çmimit përkatës për këtë zë punimi.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Lidhur me këtë rekomandim, sqarojmë se është ngarkuar Njësia e Zbatimit të Projektit, në vëmendje të veçantë të Kryetarit të NJZP, z. I.B, në bashkëpunim, me përfaqësues të ARRSH, Z. G.R dhe Zj., A.S, të cilët po bëjnë të gjithë punën e nevojshme për analizimin dhe përcaktimin e fortësisë së formacionit të gjermuar, për përcaktimin e saktë të kategorisë dhe çmimit përkatës për këtë zë punimi, në mënyrë që të jetë në përputhje të plotë me projektin e miratuar. Nga ana e tyre po bëhet një analizë e thellë dhe të gjitha testet teknike me të gjitha mjetet e pajisjet e nevojshme të vendosura në dispozicion nga ARRSH në bashkëpunim edhe me specialistë të tjerë të fushës. Menjëherë pas kësaj, një raport i hollësishëm do të paraqitet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të MIE, me qëllim marrjen e masave të mëtejshme.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

**4.2. Rekomandimi:** Të merren masa për analizimin e çmimit të kanalizimeve të realizuara me beton monolit në raport me kanalizimin e parashikuar me tombino beton arme 500 mm (gjysmë tombino), duke bërë zbritjen e çmimit përkatës.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:



Lidhur me këtë rekomandim, sqarojmë se është ngarkuar Njësia e Zbatimit të Projektit, në vëmendje të veçantë të Kryetarit të NJZP, z. I.B, në bashkëpunim, me përfaqësues të të ARRSH, Z. G.R dhe Zj. A.S, të cilët po bëjnë një analizë të çmimeve për zërat e punimeve të raportuara nga Koncesionari. Në përfundim, një raport i arsyetuar do të dorëzohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të MIE, me qëllim marrjen e masave të mëtejshme.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer në terren lidhur me punimet e kryera për ndërtimin e digave dhe përkatësisht për ndërtimin e digës së Moglicës, rezultoi se shtresa e asfaltit mbi digë ose sipërfaqja e rrugës ka pësuar një rënie e cila është e dukshme në pamje vizuale dhe lë vend për dyshime të arsyeshme të dëmtimit të kurorës së digës.

Thellësia e këtij dëmtimi nuk mund të verifikohet nga grupi i auditimit për vet faktin se kërkon një analizë dhe teste teknike nga specialistë të fushës për të saktësuar nëse dëmtimi i shtresës së asfaltit mbi digë është dëmtim sipërfaqësor apo është më serioz se kaq me qëllim parandalimin e përkeqësimit të situatës. Për sa më sipër është në kundërshtim ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar. (*Trajtuar më hollësisht në Pikën 2, faqe 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*)

**5.1. Rekomandimi:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të marrë masat që të njoftojë Koncesionarin “D.H” SH.A, duke e vënë në dijeni për dëmtimet e konstatuara vizualisht nga grupi i auditimit dhe në të njëjtën kohë duke i kërkuar kryerjen e një analize profesionale teknike me specialistë të fushës përkatëse me qëllim verifikimin e shkallës së dëmtimit të kurorës së digës së Moglicës dhe marrjen e masave të menjëhershme për rehabilitimin e situatës në varësi të seriozitetit të dëmtimit për shmangien e cdo të papriture në të ardhmen që mund të sjellë pasoja të rënda për investimin e kryer por edhe për zonën përreth.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Lidhur me këtë rekomandim, sqarojmë se është ngarkuar Njësia e Zbatimit të Projektit, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për të gjitha korrespondencat me Koncesionarin sa i përket ecurisë së projektit, të vijojë me njoftimin e njëhershëm të Koncesionarit “D.H” SH.A, duke e vënë në dijeni për dëmtimet e konstatuara vizualisht nga grupi i auditimit.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i pa zbatuar**.

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të kontratës së lidhur midis D.H SHA dhe “A” SHPK, me datë 07.07.2016 dhe vlerë 6,328,080.85 Euro, u konstatuan dëmtime të rrugës përsa i përket lotit M03. Konkretisht, në kilometrin e 7-të deri 7.6, rruga ka rrëshqitje dhe çarje të asfaltit në pjesën e djathtë të saj. Në vazhdim në kilometrin e 8-të deri 8.5, rruga ka rrëshqitje dhe dëmtim të bordurave mbajtëse në krahun e djathtë të saj. Në kilometrin e 10-të deri 14, rruga ka dëmtime të vazhdueshme dhe rrëshqitje të terrenit. Gjithashtu në këtë pjesë të aksit, janë dëmtuar reflektorët anësorë. Defektet e mësipërme, përbëjnë rrezik aksidentesh për përdoruesit e rrugës, gjithashtu rritje të kostos për ndërhyrje, nëse nuk merren masa të shpejta për ndërhyrjen për riparim të tyre. Dëmtimet e sinjalistikës vertikale (reflektorë) nga individë të pa identifikuar krijojnë vështirësi në qarkullimin e automjeteve, kryesisht gjatë natës. Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga

ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në Pikën 2, faqe 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)*

**6.1 Rekomandimi:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të marrë masat që të njoftojë ARRSH për dëmtimet e konstatuara nga grupi i auditimit, me qëllim riparimin e tyre për shmangien e avancimit të shkallës së dëmtimit dhe largimin e rrezikut për aksidente të mundëshme në këtë segment.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

MIE, ka vijuar me njoftimin e ARRSH lidhur me dëmtimet e konstatuara nga grupi i auditimit. Nga ana e kësaj të fundit është ngritur grupi i punës (znj. A.S dhe Z. G.R) për të bërë të mundur një analizë tekniko-profesionale sa më të hollësisht me specialistë të fushës. Menjëherë pas kësaj, një raport do të paraqitet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të MIE, me qëllim marrjen e masave të mëtejshme.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga AKBN, lidhur me raportet e monitorimit të Konkensionit të mbajtura nga AKBN, u evidentua se raporti i fundit i monitorimit të HECEVE, është mbajtur në 3-Mujorin e III dhe të IV të vitit 2020 dhe është dërguar në MIE me shkresën me nr. 4598/1 Prot., datë 22.08.2020. Nga raportet e mbajtura nga AKBN, cilësohen mangësi në dokumentacionin e dorëzuar nga Konkensionari në kundërshtim me VKM nr. 547, datë 09.08.2006 i azhurnuar “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, të cilat kanë të bëjnë me njoftimet për fillimin e punimeve të investimit, me njoftimin për përfundimin e punimeve, me mungesën e dokumentacionit që vërteton lejen e ndërtimit për fillimin e punimeve apo edhe mungesa të dokumentave të tjera të cilat janë të domosdoshme për të plotësuar dosjen e plotë të punimeve të kryera nga Konkensionari me qëllim që në fund të afatit të Konkensionit, Shteti Shqiptar të marrë në dorëzim cdo dokumentacion të domosdoshëm për vazhdimin e operimit të Hidrocentraleve të ndërtuara edhe pas largimit të konkensionarit. *(Trajtuar më hollësisht në Pikën 2, faqe 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)*

**7.1. Rekomandimi:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me AKBN dhe institucione të tjera publike nëse është e nevojshme, të marrin masat për plotësimin e dosjes së Konkensionit me të gjitha dokumentet që mungojnë të cilësuar nga raportet e monitorimit të lëshuara nga AKBN.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

MIE, ka ngarkuar znj E.G dhe z. E.D të cilët po merren me evidentimin dhe verifikimin e të gjithë dokumentacionit sa i përket këtij projekti. Një raport i hollësishtëm do të dorëzohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm, në mënyrë të vijohet me marrjen e masave të nevojshme, në rast se do të vërehen mungesë dokumentacioni etj.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

**8. Gjetje nga auditimi:** Në pikën C., të marrëveshjes koncesionare pjesë e dokumenteve të procedurës koncesionare citohet: *“Të drejtat dhe detyrimet e palëve, koncesionari duhet të marrë masa të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet, që eventualisht mund t’i shkaktohen palëve të treta.”*

Më pas në shtesat e kontratave kushtet fillestare kanë ndryshuar duke e kaluar riskun te Autoriteti Kontraktues. -Në pikën 3.7, të shtesës së kontratës është përcaktuar se d) *Autoriteti Kontraktues do të jetë përgjegjës ndaj Koncesionarit për të gjitha kostot, dëmet dhe humbjet që lindin nga çfarëdo mos përfundim i Infrastrukturës Zëvendësuese në afatet e përcaktuara; e) Autoriteti Kontraktues do të mbajë të pacenuar dhe do të dëmshpërblejë Koncesionarin për të gjitha pretendimet, dëmet dhe humbjet që vijnë prej furnitorëve dhe kontraktorëve të tjerë ose çdo palë tjetër të tretë në lidhje me planifikimin, projektimin dhe tenderimin e Infrastrukturës Zëvendësuese ose lidhen me Infrastrukturën Zëvendësuese;*

**-Për sa më sipër duke u nisur nga fakti që Koncesionari do kryejë të gjithë procesin e planifikimit, projektimit dhe tenderimin e Infrastrukturës Zëvendësuese, nuk ka arsye justifikuese përse Autoriteti Kontraktues duhet të merrte përsipër risqet për dëmshpërblim për humbjet që mund të vinin nga furnitorët dhe kontraktorët ose çdo palë tjetër në proces.** Ndryshimi i kushteve të kontratës është në kundërshtim me nenin nr.2., të Ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006, i ndryshuar, “Për koncesionet”, pika 3, ku citohet: *“Koncesion” është marrëveshja, pavarësisht nga emri që i jepet, ndërmjet autoritetit kontraktues dhe koncesionarit, ku përcaktohen kërkesat dhe kushtet e saj dhe në kuptimin e së cilës koncesionari: a) realizon një veprimtari ekonomike që, në të kundërt, do të kryhej nga autoriteti kontraktues për një projekt koncesioni, kontratë administrimi apo shërbime të tjera publike; b) merr përsipër të gjitha ose një pjesë thelbësore të rrezikut të lidhur me këtë veprimtari ekonomike;”*

Marrja përsipër e përgjegjësiave ndaj palëve të treta ku autoriteti kontraktor nuk ka asnjë lidhje kontraktuale rrit riskun e dëmeve ndaj Buxhetit të Shtetit. *(Trajtuar më hollësisht në Pikën 1 faqe 23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)*

**8.1 Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në të ardhmen në procesin e lidhjes së kontratave me operatorët fitues, të mos marrë përsipër rreziqet e lidhura me veprimtarinë ekonomike të cilat i takojnë koncesionarit për tu përballuar.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Lidhur me këtë rekomandim, sqarojmë se është ngarkuar Drejtoria e Partneritetit Publik Privat në Infrastruktura dhe Energji në bashkëpunim me Drejtorinë Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Eficiencën e Energjisë, në cilësinë e drejtorive kompetente që të marrin masat e nevojshme për të ndjekur procesin e realizimit të koncesioneve dhe finalizimit të kontratave me operatorët fitues, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe parimet kryesore duke mbajtur në vëmendje të vecantë rekomandimin e lënë nga ana e KLSH-së për të mos marrë përsipër rreziqet e lidhura me veprimtarinë ekonomike të cilat i takojnë koncesionarit për tu përballuar, por duke bërë një analizë të thellë, që kontrata të zbatohet të gjitha parimet e nevojshme për një kontratë sa më efektive për të dyja palët.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

## **B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga Auditimi:** Me shkresën e shoqërisë D.H sha., date 31.01.2015, nr. Prot. 2015-TR-00132 - për vitin 2014, dhe shkresën e DHP date 02.03.2015, nr. Prot. 2015-TR-00349, është kërkuar rimbursimi i Kostove të Infrastrukturës Zëvendësuese për vitin kalendarik 2014, në përputhje me nenin 7.2.7.5, 7.2.7.7 të Shtojcës së Kontratës së Koncesionit. Shkresave i janë bashkëngjitur kostot e dokumentuara deri me 31 janar 2015 në vlerën 3,972,459 milion euro.

Për kërkesat sa më sipër Ministria e Energjetikës dhe Infrastrukturës ka kryer pagesën më datë 27.03.2015, në vlerën 332,604,347 lekë, (2,367,964.88 euro x 140,46 lek) dhe pagesën datë 08.04.2015 në vlerën 225,303,064 lekë (1,604,494,.12 euro x 140.42 lek).

Me urdhër shpenzimin nr. 78, datë 27.03.2015, për certifikatat 11-19, të paraqitura nga DHP, në vlerën 2,367,964,.88 Euro. Me urdhrin nr. 80, datë 25.03.2015, z. I.B, në cilësinë e zëvendësit të Ministrit, ka urdhëruar pagesën sa më sipër. Me urdhër shpenzimin nr. 100, datë 08.04.2015, MIE ka urdhëruar pagesën e 225,303,064 lekë për shpenzime të kryera nga DHP. Për këtë pagesë është lëshuar dhe urdhri nr. 92 datë 02.04.2015, nga Ministri i përfaqësuar nga z. I.B, për shlyerjen e vlerës 1,604,494 Euro.

Pagesat e mësipërme i takojnë kontratave që ka lidhur DHP me kontraktorë të tretë, për projektme dhe punime në Infrastrukturën Zëvendësuese, në periudhën 2013-2014, kur shtesa e tretë e kontratës koncesionare e cila sqaronte kushtet në të cilat do të bëhej lidhja e kontratave është aprovuar në parlament në shkurt të 2015. Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e përfaqësuar nga Zëvendësministri z. I.B, ka urdhëruar pagesat e mësipërme për shpenzime të paaprovuara nga Kuvendi i Shqipërisë, siç përcaktohet dhe në Ligjin për Koncesionet.

Në shtesën e tretë të Kontratës së Koncesionit, është përcaktuar se në nenin 1 të Kontratës së Koncesionit “Marrëveshja e Infrastrukturës Zëvendësuese” nënkupton marrëveshjen e lidhur më datë 14.2.2014 midis Autoritetit Kontraktues, Shoqërisë së Projektit dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar për projektimin, tenderimin e Infrastrukturës Zëvendësuese (rrugët dhe urat) dhe ndërtimin e Rrugës M15 të Infrastrukturës Zëvendësuese të Moglicës, bashkëngjitur si Aneksi III. Pra kjo marrëveshje është pjesë e Kontratës së Koncesionit dhe si e tillë aprovohet në Këshillin e Ministrave, siç përcaktohet në pikën 4 të Nenit 21, Caktimi i ofertuesit më të mirë dhe negociimet përfundimtare, të ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006, i ndryshuar, ku citohet: *Pas përfundimit të negociimit për kontratën koncesionare, Njësia e Trajtimit të Koncesioneve, brenda 45 ditëve, jep mendim me shkrim për kushtet e kontratës. \*Pas marrjes së mendimit dhe nënshkrimit, kontratat koncesionare me vlerë investimi mbi 20 milion euro paraqiten për miratim në Këshillin e Ministrave. Kontratat koncesionare me vlerë nën 20 milion euro hyjnë në fuqi pas nënshkrimit nga autoriteti kontraktues.*

Me ligjin nr. 7/2015, miratuar më datë, 12.02.2015, “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 10 083”, datë 23.2.2009, i ndryshuar Këshilli i Ministrave ka miratuar dhe përmbajtjen e shtesës së tretë të kontratës së koncesionit. Në lidhje me procesin e projektimit dhe zbatimit të Infrastrukturës Zëvendësuese”, janë përcaktuar rregulla dhe procedura që do të ndiqen nga DHP, dhe do të monitorohen nga Autoriteti Kontraktor.

**Urdhër pagesat e mësipërme janë nxjerrë për të kryer likuidimin e shpenzimeve për të cilat nuk janë zbatuar procedurat përkatëse, si dhe monitorimi i tyre, pasi i përkasin periudhës 2013-2014, para se të aprovohej shtesa e tretë e kontratës nga Këshilli i Ministrave.**

Gjithashtu në shtesën e tretë të kontratës ishte parashikuar se Autoriteti Kontraktues do të monitorojë procedurën e tenderimit të Infrastrukturës Zëvendësuese dhe për këtë qëllim do të caktojë 2 (dy) persona të autorizuar.

Me autorizimin nr.39/153, datë 14.11.2014 të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë është ngarkuar përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor për të: "Verifikuar procedurat e aplikueshme, dokumentacionin e procedurës, ftesat e nisura në adresë të pjesëmarrësve, ofertat e paraqitura, procesin e vlerësimit, dhe çdo fazë tjetër që lidhet me shqyrtimin dhe vlerësimin korrekt të ofertuesve. I autorizuari ka të drejtë të informojë menjëherë Autoritetin Kontraktues, në rast se do të konstatojë ndonjë devijim nga procedurat apo shkelje në procesin e hartimit të dokumentacionit, vlerësimit e përzgjedhjes së ofertuesve dhe është i detyruar të mos përhap këtë informacion tek personat e tretë". Kontratat për ndërtimin e kësaj rruge (projektimi, ndërtimi dhe mbikëqyrja) janë lidhur gjatë viti 2013-2014, ndërsa përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor është caktuar në datën 14.11.2014.

Pa u miratuar, në Këshillin e Ministrave dhe në Kuvend, shtesa nr.3 e kontratës së koncesionit të sipërcituar, menjëherë, pas lidhjes së marrëveshjes në datën 05.09.2013 dhe para lidhje së marrëveshjes së datës 14.2.2014 "Për projektimin dhe tenderimin e Infrastrukturës Zëvendësuese", koncesionari, ka filluar procedurat e konkurrimit për hartimin e projektit të zbatimit të infrastrukturës që do të zëvendësohet: rruga Banja-Gramsh dhe Ura e Trashovicës, rruga Moglicë M03 dhe mbështetje projektimi për punimet në vazhdim në rrugën Moglice M15.

**Pra këto kontrata nuk janë monitoruar dhe mbikëqyrur nga Autoriteti Kontraktor. Vlera 3,972,459 euro përbën efekte negative financiare për Buxhetin e Shtetit.** *Trajtuar më hollësisht në Pikën 4, faqe 56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**1.1. Rekomandimi:** Nga Autoriteti Kontraktor të analizohet vlera 3,972,459 euro, vlerë e cila ka të bëjë me disbursime për shpenzime të kontraktuara jo në kushtet e miratuara dhe jo të monitoruara, dhe të merren masa për tu mos u përsëritur në të ardhmen, pasi kjo vlerë për Buxhetin e Shtetit, përbën efekt ekonomik negativ.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: Pranuar

Përgjigje nga subjekti:

Në lidhje me rekomandimin dhe gjetjet e bëra, sqarojmë se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka ngritur Grupin e Punës, i cili po kryen analizimin e vlerës që ka të bëjë me disbursime për shpenzimet e kontraktuara, si dhe do të bëjë propozimin për marrjen e masave në të ardhmen. Grupi i Punës ka marrë në shqyrtim të gjitha veprimet që janë ndjekur më parë. Persona përgjegjës për ndjekjen e deytrave janë E.M, R.Xh, E.D. Në përfundim, Grupi i Punës, do të paraqesë një raport të arsyetuar pranë Sekretarit të Përgjithshëm të MIE, me qëllim marrjen e masave të mëtejshme në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe parimet kryesore, të cilat garantojnë zhvillimin e projekteve në mënyrë sa më efikase dhe të qëndrueshme.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

**2. Gjetje nga Auditimi:** Në procesin e auditimit të shpenzimeve për rrugën M15 Moglicë u konstatua se kostot e projektimit dhe të mbikëqyrjes së punimeve nuk janë llogaritur në përputhje me tarifatat e përcaktuara në VKM nr. 444, datë 05.09.1994 "Për tarifatat e studimit, drejtimit mbikëqyrjes dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit" dhe VKM nr. 704, datë 29.10.2014 Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Këto VKM rregullojnë, llogaritjen e pagesave për të gjitha shërbimet që kryhen brenda vendit për projektimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin. Konkretisht tarifa mbikëqyrjes është llogaritur shumë më e lartë se përcaktimet e VKM nr. 704, datë 29.10.2014, e cila sipas kësaj VKM duhet të ishte në vlerën 44,043 Euro, ose rreth 0.66 % të vlerës së ndërtimit, që është 6,607,360 Euro. Theksojmë se, shpërblimi i punës projektuese dhe i punës mbikëqyrëse para vitit 2015 rregullohej, me VKM nr. 444, datë 05.09.1994, dhe më pas me VKM nr. 704, datë 29.10.2014. Këto vendime nuk kanë të bëjnë me prokurimin publik dhe nuk kanë dalë në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij apo të ndonjë akt ligjor dhe nënligjor që mund të përcaktoj rregullat të tjera e prokurimit publik, të cilat sipas pikës 3.1, të shtesës së kontratës së koncesionit të miratuar me ligjin nr. 7, datë 15.02.2015, të cilat nuk zbatohen nga Koncesionari në procesin e tenderimit të projektimit, ndërtimit, mbikëqyrjes ose shërbime të tjera ndihmëse në lidhje me Infrastruktura Zëvendësuese. Por, këto VKM, kanë dale në zbatim të akteve ligjore që rregullojnë veprimtarinë e kontrollit dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit brenda vendit, konkretisht kanë dalë në zbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit".

Pra vlerat e kontratave të projektimit dhe të kontratave të mbikëqyrjes të financuara me fonde buxhetore llogariten sipas tarifave të përcaktuara në këto akte ligjore e nënligjore dhe mbi bazën e këtyre vlerave do të vijohet me përzgjedhjen e projektuesit dhe mbikëqyrësit nëpërmjet procedurave të tenderimit të realizuara sipas rregullave të vetë koncesionarit të përcaktuar në neni 3.1 të sipërcituar. Për këtë procedurë konkurrimi, përveç dokumenteve financiar dhe kontratës së lidhur mbas miratimit të shtesës 3 të kontratës së koncesionit, në MIE nuk janë paraqitur, dokumente e procedurës së përzgjedhjes së kontraktorëve fitues për hartimin e projektit të zbatimit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes si dhe shkresat apo dokumente të DHP që i ka kërkuar MIE për të konfirmuar dhe miratuar procedurat e konkurrimit dhe vlerave të ofertave përpara se ato të shpallen fitues.

-Sipas projektit dhe preventivit të zbatimit të hartuar nga projektuesi "I & S", rruga "Banjë-Gramsh dhe Ura e Trashovicës" kishte kosto ndërtimi 30,196,554 Euro. Ndërtimi i kësaj rruge është ndarë në dy kontrata (seksione), seksioni 3A "Banja pjesa lindore e luginës së Holtës me kosto 23,702,604 Euro dhe seksioni 3B "pjesa lindore e luginës së Holtës-Gramsh plus Urën e Trashovicës" me kosto 6,493,950 Euro. Rruga është parashikuar të ndërtohet e gjerë 7 m dhe me gjatësi 15.234 km (me dy korsi të asfaltuara me gjerësi 2x2.5 m = 5 m plus dy bankina anësore të asfaltuara me gjerësi 1 m dhe me gjatësi urash 2.26 km me gjerësi 8.65 m). Projekti dhe preventivi i zbatimit me vlerë ndërtimore 30,196,554 Euro dhe është miratuar nga ARRSH me Vendimin e Këshillit Teknik nr. 66, datë 10.12.2014. Në vijim nga DHP është realizuar procedura e tenderimit për përzgjedhjen e kontratave fituese për ndërtimin e rrugës zëvendësuese Banjë -Gramsh dhe urës së Trashovicës: -Fitues e procedurës së konkurrimit për ndërtimin e seksioni 3A rruga Banjë-Gramsh është shoqëria "A. DHP në datën 16.12.2014 ka lidhur kontratën e sipërmarrjes me këtë shoqëri me vlerë 25,365,321.4 Euro, pa TVSH. -Fitues e procedurës së konkurrimit për ndërtimin e seksioni 3B, rruga Banjë-Gramsh përfshi edhe urën e Trashovicës është shoqëria "E". DHP në datën 16.12.2014 ka lidhur kontratën e sipërmarrjes me vlerë 7,346,881.5 Euro, pa TVSH. Kosto e dy kontratave fituese që do të zbatohen për të gjithë rrugën Banjë-Gramsh është 32,712,202.4 Euro. Kjo kosto është më e madhe për 2,515,648 Euro se, kosto e llogaritur nga projektuesi, para zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe e miratuar nga ARSH që është në shumën 30,196,554 Euro, dhe justifikohet: "Bazuar në nenin 3.5 të draft shtesën 3 të marrëveshjes (e pa miratuar me ligj), DHP me shkresën nr. 01579, datë 11. 12. 2014 i është Drejtuar Ministrit dhe Zv. Ministrit të

MIE, për të miratuar koston e kontratave të negociuara të rrugës Zëvendësuese Banje-Gramsh dhe Ura e Raskovicës.

Si konkluzion: Fillimisht kosto e kësaj rruge sipas projektit të zbatimit ishte parashikuar për 30,196,554 Euro, në përfundim të procedurës tenderuese kontratat fituese u negociuan dhe u rritën në vlerën 32,7712,202 Euro dhe gjatë zbatimit të punimeve u rritën përsëri në vlerën 36,236,836, ose 20% më shumë se kosto së parashikuar në projektin e zbatimit (fondi limit).

-Në vlerën e investimit të kësaj rruge përveç vlerës së ndërtimit, shoqëria DHP ka përfshirë edhe, punën projektuese në vlerën 2,063,264 Euro, punën mbikëqyrëse në vlerën 3,291,766 studime gjeologjike në vlerën 267,169 Euro dhe disa kosto të tjera shtesë në vlerën 1,111,175 Euro (sociale, tarifa publike, sigurimi, etj.), dhe kosto totale e investimit të kësaj rruge për tu financuar nga buxheti i shtetit është 42,970,210 Euro, Në fakt për këtë rrugë me gjatësi totale 5.234 km, kosto fillestare përpara marrjes së ofertave të tenderit, sipas shtesës 3 të kontratës të miratuar me ligjin nr. 7, datë 15.02.2015 ishin parashikuar në shumën 38,142,457 Euro, përfshirë projektimin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen dhe kostove të tjera. Siç tregohet, kosto e përcaktuar në ligj vetëm për këtë rrugë është tejkaluar me 4,827,753 Euro më shumë. Kjo rritje ka të bëjë me rritjen e vlerës së punës projektuese, punës mbikëqyrëse dhe studimeve gjeologjike, tarifat e të cilave janë përcaktuar më të larta se, tarifat e përcaktuara në VKM nr. 444, datë 05.09.1994 "Për tarifat e studimit, drejtimit mbikëqyrjes dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit" dhe VKM nr. 704, datë 29.10.2014. Llogaritja e koston së punës projektuese (tarifa e projektimit) dhe studimit gjeologjik: Sipas projektit dhe preventivit të zbatimit të hartuar nga shoqëria projektuese "I & S" në vitin 2013, vlera e investimit e llogaritur me çmimet e tregut vendas në zbatimit të manualit teknik të çmimeve të vitit 2014 të miratuara me VKM për ndërtimin e rrugës ka dale 30,196,554 Euro, dhe në përfundim të punimeve, kosto e ndërtimit është rritur në vlerën 36,236,836 Euro. Mbështetur në këtë vlerë dhe bazuar në VKM nr. 444, datë 05.09.1994, për këtë kategori rruge, tarifa e projektimit të llogaritur duhet të ishte në vlerën 722,265 Euro (36,236,836Euro x 2%) dhe tarifa e studimit gjeologjik duhet të ishte në vlerë 51,660 Euro ( 36,236,836 Euro x 0.14%) në total duhet të ishin 774,285 Euro. Ndërsa puna projektuese është parashikuar për tu financuar nga buxheti i shtetit në vlerën 2,063,264 Euro dhe studimi gjeologjik në vlerën 267,169 Euro, në total në vlerën 2,330,433 Euro ose 6.43% të vlerës së ndërtimi.

**Pra në kundërshtim me VKM nr. 444, datë 05.09.1994, kosto e punës projektuese dhe e studimit gjeologjik është rritur padrejtësisht për vlerën 1,556,148 Euro (2,330,433 Euro - 774,285 Euro).**

Gjithashtu DHP ka lidhur kontratë me shoqërinë projektuese "I & S" në vitin 2013, në kushtet kur kjo shoqëri nuk kishte por dhe më vonë nuk ka pasur asnjë licence për projektim.

**Vlera 1,556,148 Euro përbën efekt ekonomik negativ për Buxhetin e Shtetit.**

-Dokumentacioni i procedurave të tenderimeve të realizuara nga DHP duke filluar, me dokumentet e tenderi, ftesat për ofertë, ofertat teknike dhe ofertat ekonomike të kompanive si dhe çdo dokument tjetër që lidhet me procesin e prokurimit dhe të miratimit të koston, nuk u vu në dispozicion të grupit të auditimit. Ky dokumentacion është mbajtur nga vetë DHP dhe nuk është përcjell në MIE për tu inventarizuar dhe arkivuar në Ministri.

**Në këto kushte, nuk u krye auditim, mbi ligjshmërinë e shqyrtimit, vlerësimit, kualifikimit, s' kualifikimit të ofertave teknike dhe ofertave ekonomike të shoqërive pjesëmarrëse në këto procedura tenderimi për përzgjedhjen e kontratave fituese.**

Mos vënia në dispozicion të grupit të auditimit, të dokumentacionit të tenderimit është në kundërshtim me nenin 3.5 të shtesës tretë të kontratës së koncesionit të miratuar me ligjin nr. 7, datë 15.02.2015, dhe me nenin 15 dhe 26, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin

dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit". (Trajtuar më hollësisht në Pikën 4, faqe 56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

**2.1. Rekomandimi:** Nga Autoriteti Kontraktor të analizohet vlera 1,556,148 euro, vlerë e cila ka të bëjë me llogaritjen jo sipas kuadrit ligjor të kostos së punës projektuese, dhe të merren masa për të shmangur në të ardhmen, pasi kjo vlerë për Buxhetin e Shtetit, përbën efekt ekonomik negativ.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Në lidhje me rekomandimin dhe gjetjet mbi kryerjen e preventivave, sqarojmë se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka ngritur Grupin e Punës, i cili po kryen analizën mbi llogaritjen e kryer, si dhe do të bëjë propozimet përkatëse për marrjen e masave në të ardhmen, me qëllim shmangien e rasteve të ngjashme dhe pasjen e efektivitetit në kryerjen e procedurës. Personat përgjegjës, të ngarkuar me detyrat e mësipërme janë E.M, R.Xh, E.D, si përfaqësues të MIE dhe G.R , A.S si përfaqësues të ARRSH.

Në përfundim, Grupi i Punës, do të paraqesë një raport të arsyetuar pranë Sekretarit të Përgjithshëm të MIE, me qëllim marrjen e masave të mëtejshme në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe parimet kryesore.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**3. Gjetje nga Auditimi:** -Në dokumentet standarde të procedurës së zgjedhjes së operatorit fitues ishte parashikuar si kusht për zgjedhjen fitues, Tarifa e Koncesionit jo më e vogël se 2 %. Megjithatë në ofertën fituese kjo tarifë ishte 2 %, në kontratën e fundit përcaktohet mos pagesa e tarifës për 15 vjet, siç citohet në pikën 2.10, Në nenin 4.1.1. do të shtohet në fund paragrafi që vijon: **“Pavarësisht sa më sipër, Koncesionari nuk do të paguajë Tarifën e Koncesionit sipas këtij neni 4.1.1 “a” dhe “b”, për hidrocentralin e Banjës dhe të Moglicës për një periudhë 15-vjeçare duke filluar nga data e lëshimit të Certifikatës së Përfundimit Final të Hidrocentralit të Banjës”**.

Shpjegimi i dhënë nga zv. Ministri z. I.B ishte se heqja e tarifës së koncesionit u bë për arsye se shoqëria D.H sh.a., mori përsipër të kryej shërbimet e tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorëve për projektimin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen e Infrastrukturës Zëvendësuese, duke financuar fillimisht vetë dhe më pas nga financimet e buxhetit të shtetit. Ky justifikim nuk qëndron sepse Autoriteti Kontraktor mori përsipër pagesën e kostos totale të shpenzimeve duke filluar nga viti 2015 deri në vitin 2019. Autoriteti Kontraktor nuk vuri në dispozicion vlerësimet e kryera se sa do të ishte kosto nëse projekti do të financohej me kredi nga bankat e nivelit të dytë krahasuar me variantin e financimit nga D.H sh.a.

-Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me nenin nr. 21., të Ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006, i ndryshuar, “Për koncesionet”, Caktimi i ofertuesit më të mirë dhe negociimet përfundimtar, pika 2, ku citohet: **“Kushtet kontraktuale, të deklaruara të pa-negociueshme në kërkesën përfundimtare për propozime, nuk do të jenë objekt i negociimeve përfundimtare.”**

**Përrjashtimi i pagesës së tarifës së koncesionit prej 2%, ka sjellë të ardhura të munguara për Buxhetin e Shtetit në vlerën 5,119,000 Euro deri në gusht 2022.** (Trajtuar më hollësisht në Pikën 1, faqe 23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

**3.1. Rekomandimi:** Nga Autoriteti Kontraktor të analizohet vlera 5,119,000 euro, vlerë e cila ka të bëjë me përjashtimin e pagesës së tarifës së koncesionarit nga shoqëria D.H sh.a., pasi kjo vlerë për Buxhetin e Shtetit, përbën të ardhura të munguara.

*Menjëherë*



**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:** Lidhur me Rekomandimin e lënë, parashtrorjmë si më poshtë:

Referuar analizës mbi vlerën 5,119,000 Euro qe ka te beje me përjashtim te tarifës se koncesionit nga shoqëria D.H, paraprakisht bëjmë me dije se nisma për ndryshimin e ligjit nr. 10083, dt. 23.02.2009 me ligjin e vitit 2015, u be duke pasur parasysht qëllimin e çdo ligji qe është: t'iu sigurojë atyre të cilëve iu drejtohet, një rregullim sa më të saktë të problemit që shqyrtohet duke ofruar një zgjidhje të qëndrueshme për tu dhënë mundësinë subjekteve të ndryshme për te rregulluar disa aspekte te ligjit dhe për të realizuar më mirë të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Në bazë të Nenit 7.2.6 të Kontratës së Koncesionit te miratuar me ligjin nr. 10083, dt. 23.02.2009, Autoriteti Kontraktues Ministria e Energjitikes dhe Industrise është përgjegjës, i vetëm, për ndërtimin me shpenzimet e tij të Infrastrukturës Zëvendësuese ne lidhje me Projektin e Devollit. Infrastruktura zëvendësuese, nënkupton të gjithë atë infrastrukturë që përfaqësohet nga rrugët, urat etj, infrastrukturë, e cila do të përmblytet si rezultat i krijimit të ujëmbledhësit të hirdocentraleve që do të rindërtojë Koncesionari. Në këtë kuptim, kjo infrastrukturë zëvendësuese do ti shërbejë banorëve të të gjithë atyre zonave ku do të shtrihet ujëmbledhësi dhe më gjerë që të lidhen me pjesën tjetër të vendit por edhe koncesionarit i cili do ta përdorë këtë infrastrukturë për të ndërtuar vetë rrugët hyrëse në kantier,

Ne nenin 7.2.6 ndër të tjera cilësohet se : "*Autoriteti Kontraktues do të jetë tërësisht përgjegjës, me shpenzimet e tij, për ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese, me kusht që shumat ashtu siç janë parashtruar në paragrafin paraardhës të paguhen nga Koncesionari në kohën e duhur. Infrastruktura Zëvendësuese duhet të vendoset jo më vonë se tre muaj para Datës së realizimit të Mbushjes me Ujë të Ujëmbledhësit; me kusht që gjithsesi, Infrastruktura Zëvendësuese (i) me të cilën do të lidhen Rrugët Hyrëse dhe (ii) që i nevojitet Koncesionarit për t'u përdorur për tu futur në Shesh (a) përse i përket gjerësisë, rrezes minimale të kthesave, pjerrësisë dhe kapacitetit të ngarkesës, të jetë e një cilësie jo më të ulët se cilësia e infrastrukturës që do të zëvendësohet në përputhje me këtë Nen 7.2.5, dhe (b) ajo duhet të vendoset jo më vonë se 12 muaj pas Datës së Fillimit të Punimeve të Ndërtimit. Nëqoftëse Autoriteti Kontraktues nuk arrin të përmbushë kërkesat e këtij Neni 7.2.5, ai do të kompensojë dhe zhdëmtojë Koncesionarin për të gjitha dëmet që rezultojnë nga kjo shkelje."*

Në bazë të Kontratës së Koncesionit dhe Marrëveshjes "Për mënyrën e pagesave në lidhje me Infrastrukturën Zëvendësuese (Rrugët dhe Urat)" të lidhur midis Shoqërisë së Projektit, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe Autoritetit Rrugor shqiptar me 05.09.2013 "Marrëveshje mbi Mënyrën e Pagesës", është rënë dakord se shumata që Koncesionari do t'i paguajë Autoritetit Kontraktues si kompensim për Infrastrukturën Zëvendësuese do të jetë 10.550.000 Euro (dhjetë milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë Euro).

Sqarojmë se infrastruktura tjetër që përmblytet si shkolla, qendra shëndetësore, varreza, shtepite e banoreve qe permblyten, linja elektrike etj do te perballohet me shpenzimet e Koncesionarit me ane te programeve sociale qe zbatohen sipas standarteve te IFC-se, Bankes Boterore.

Pra sa më sipër, referuar parashikimeve të Kontratës së Koncesionit, pra nenit 7.2.6 është parashikuar qe shteti duhet te ndertonte rrugen 3 muaj para dates se mbushjes me uje se rezervuarit. Nga ana e Koncesionarit, është bërë me dije data e përmblytjes pra data e mbushjes me ujë të rezervuarit, data 05.02.2016.

Duke marrë në konsideratë këtë datë të njoftuar nga Koncesionari dhe parashikimin e Nenit 7.2.6 të Marrëveshjes Koncesionare, Shteti kishte pergjegjesine per te perfunduar ndertimin e

infrastrukturës zëvendësuese brenda nentorit të vitit.2015 d.m.th 3 muaj para dates se njoftuar për mbushjen me ujë të ujëmbledhësit, sic percaktohet në Marreveshjen e Koncesionit.

Duke qene se Autoriteti Kontraktues ishte në vonesë në përmbushjen e detyrimit në lidhje me planifikimin, projektimin dhe ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese dhe nuk arriti të sigurojë fondet e nevojshme për planifikimin, projektimin dhe ndërtimin e saj (konkretisht, këto fonde të nevojshme duhet të ishin planifikuar që në vitin 2013 për buxhetin e vitit 2014 e 2015 gjë e cila nuk u realizua). Gjithashtu duke nisur nga afatet kohore të nevojshme për planifikimin, projektimin lidhjen e kontratave dhe zbatimin e punimeve, duhet të ishin nisur e realizuar procedurat përkatëse dhe të kishte filluar zbatimi i kontratave respektive për ndërtimin e rrugëve, në mënyrë që brenda afatit të parashikuar të përmbytjes, pra brenda datës 05.11.2015 kjo infrastrukturë të ishte funksionale dhe të shmangeshin pretendimet për dëme të shoqërisë Koncesionare.

Mospërmbushja e këtij detyrimi nga ana e Autoritetit Kontraktor, brenda afatit të përcaktuar mund ti sillte shtetit dem financiar për shkak se referuar kushteve të kontratës së Koncesionit, nese kjo infrastrukture nuk ndertohet 3 muaj para mbushjes se rezervuarit me uje dhe sipas Marreveshjes se Koncesionit, Autoriteti Kontraktues do te detyrohet të demshperbleje Koncesionarin per të gjitha demet e shkaktuara si rezultat i kesaj vonese.

Autoriteti kontraktues nuk e ka permbushur detyrimin e tij per fillimin e ndertimit te rrugeve zevendesuese si Banje — Gramsh, Ura Trashovices qe ndikojne mbushjen e rezervuarit te Banjes dhe rruget zevendesuese M1 5 dhe M03 qe ndikojne ne permbytjen e rezervuarit te Moglices. Mospërmbushja e ketij detyrimi con ne kompensim dhe zhdemtim te koncesionarit per te gjitha demet qe rezultojne nga kjo shkelje.

Mospërmbushja e këtij detyrimi nga Autoriteti Kontraktor, lidhet drejtëpërdrejtë, me shkaktimin e vonesave të pashmangshme në mbushjen e rezervuarit dhe vënien në punë të veprës për shkak se mbushja me ujë e rezervuarit do të sjellë automatikisht edhe përmbytjen e infrastrukturës dhe si rezultat do të përmbyten një pjesë e konsiderueshme e rrugëve nacionale që lidhin banorët e këtyre zonave me pjesën tjetër të vendit.

Për shkak të pasojave sociale që mund të shkaktohen tek banorët e zonave që preken nga ujëmbledhësi, rreth 40 mije banorë të cilët izoloohen plotësisht, Koncesionari nuk mund të realizojë mbushjen me ujë të ujëmbledhësit, pa u ndërtuar paraprakisht rrugët që lidhin këta banorë të zonave përkatëse me pjesën tjetër të vendit. Në këtë kuptim, vonesa në mbushjen me ujë të rezervuarit dhe vonesa në vënien në punë të veprës, për shkak të mosndërtimit në kohë të infrastrukturës zëvendësuese nga ana e Autoritetit Kontraktor, do të krijonte efekte të konsiderueshme financiare që do të shkaktohen Koncesionarit.

Demet që i shkaktohen koncesionarit janë të konsiderueshme për shkak se lidhen me:

-efektet ekonomike per cdo dite operimi te HEC-ve. Pra per cdo dite vonese ne perfundimin e infrastruktures zevendesuese, do te vonoje fillimin e operimit te hidrocentraleve. Cdo dem qe Koncesionari do te pesoje, ku perfshihet demi efektiv dhe fitimi i munguar, pra fitimi qe do te nxirrte nga prodhimi dhe shitja ne treg e energjise elektrike ne rast se mbushja e ujembledhesit dhe venia ne pune e hidrocentraleve do te behej ne afat, do ti faturohej Autoritetit Kontraktor.

-demet dytesore qe si rezultat i voneses do ti faturohen Koncesionarit do faturohen nga Kontraktoret e angazhuar per procese te caktuara deri tek komisionimi. Keto deme te "prejardhura" do te alokohen nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktor.

-deme te tjera qe vijne nga shpenzimet operacionale, lidhur me venien ne dispozicion te makinerive, pajisjeve, stafit etj.

Pra kostot financiare te demeve qe mund te pretendonte Koncesionari ne adrese te Autoritetit Kontraktor jane ne vlere te konsiderueshme per shkak te voneses ne ndertimin e infrastruktures nga Autoriteti Kontraktor. Nga nje vleresim paraprak te bere para ndryshimit te kontrates me ligjin e vitit 2015 rezultoi se demit potencial te shkaktuar ndaj koncesionarit, i detyrueshem per zhvendim lidhur me te ardhurat e munguara nga shitja per shkak te voneses ne fillimin e prodhimit eshte rreth 80.200 Euro/dite. Nderkaq, vlere e shtuar per shkak te zgjatjes se kontrates me te njejten kohe vonese eshte 1600 Euro/dite. Ne total vlere e demit te perafert, te likujdueshem nga ana jone per shkak te voneses ne fillimin e prodhimit eshte per nje vit rreth **29.86 milion Euro**, pa perfshire demet e tjera te prejardhura qe mund te pretendohen nga pala koncesionare.

Pervec kostove financiare, vonesa ne ndertimin e infrastruktures zevendesuese, do te vinte ne rrezik kete investim, si nje nga investimet me te qendrueshme per prodhimin e energjise se rinovueshme, me i madhi dhe me afatgjate jo vetem ne Shqiperi, por edhe ne rajon e me gjere me nje teknologji te fundit ne zbatimin e standarteve europiane. Sa me siper, me qellim shmangien e rreziqeve potenciale qe mund ti shkaktoheshin Autoritetit Kontraktor dhe shtetit si rezultat i mospermbushjes ne kohe te ketij detyrimi, ne funksion te zgjidhjes se kesaj problematike, palet lidhen nje marreveshje paraprake "Ne lidhje me projektimin dhe tenderimin e Infrastruktures Zevendesuese (Rrugjet dhe Urat) dhe ndertimin e rrugs M 15 te Infrastruktures Zevendesuese te Moglices" (Marreveshja e Infrastruktures Zevendesuese"), dhe ne vijim ndryshuan kontraten koncesionare.

Ne ndryshimet e kontrates se koncesionit palët nënshkruanin një shtesë të Kontratës së Koncesionit ne vitin 2015 me anë të së cilës Koncesionari merrte përsipër detyrimin të projektojë, tenderojë dhe ndërtojë Infrastrukturën Zëvendësuese. Kushtet e negociuara perfaqesojne kushtet me te mira te mundshme referuar dhe shume kërkesave, pretendimeve dhe kushteve te tjera te kerkuara nga koncesionari si psh kushte të tjera që kishin të bënin me përjashtimin e tij nga detyrimi i shërbimit publik, përjashtimin e tij nga aplikimi i tarifës së transmetimit, nënshkrimin e një marrëveshje shkëmbimi enegjie me KESH sh.a për marrjen në pik të energjisë së prodhuar dhe kthimin e saj gjatë natës, si dhe heqjen plotësisht të kushtit të nivelit të taksave të rritura që ka të bëjë me nivelin mesatar të tyre të aplikuara në BE, etj, kushte të cilat nuk u morën në konsideratë nga ana e Autoritetit Kontraktor gjatë vazhdimësisë së negociatave.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

## **MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit teknik sipas kontratës së punimeve civile "Rikonstruksion i segmentit 3B (Drizë-Gramsh)",rezulton se janë realizuar punimet për rialokimin e linjave elektrike dhe tubacione të ujit. Vlere e parashikuar sipas zërit 1.A.10, ishte 40,000 Euro, e cila gjatë zbatimit të kontratës është shtuar duke e certifikuar me vlerë 95,947.9 Euro. Për realizimin e punimeve janë hartuar preventivat përkatës. Në preventiv janë përfshirë edhe furnizim vendosje shtylla betoni të centrifuguara, reference e të cilëve janë dhe në manualet e çmimeve të ndërtimit. Nga krahasimi i vlerave përkatëse rezulton se **vlere 376,445 lekë ose 2,690 Euro**, është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori JV "E & P" SHPK dhe përbën dëm ekonomik.

Nga verifikimi i punimeve sipas zërit 8 "Ditë pune", për periudhën nga data 06.01.2016 deri me datë 11.01.2016, ku është paraqitur marrja e masave mbrojtëse dhe realizimi i devijimit në dëmtimin e rrugës nga kilometër 13+ 880 deri kilometër 13 + 910, në dokumentin justifikues (format excel), është paraqitur shënimi se ruli nuk punoi, por ishte prezent gjithë ditën. Në dokumentacionin justifikues nuk është paraqitur asnjë foto e realizuar gjatë zbatimit të punimeve.

**Vlera 5,960 Euro** (Rrul 70 orë x 30 Euro/orë, gjenerator 66 orë x 40 Euro/orë, vinç 6 orë x 75 Euro/orë), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.

- Për datat 05.09.2016 dhe datë 21.09.2016, janë përfshirë në ditë pune punëtorë të pa kualifikuar 46 orë, punëtorë të kualifikuar 12 orë, drejtues punimesh 14 ore dhe teknikë 3 orë, po ashtu edhe mjet transporti 6 orë, me vlerë 854 Euro. Procesi i punimeve ka të bëjë me riparim defektesh në shtresat asfaltike, punime të cilat janë në përgjegjësinë e kontraktorit. **Vlera 854 Euro**, është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.

-Sipas zërit 5.H.05 “Metal bridge parapet”, punime të raportuara në Urën e Drashovicës, është certifikuar sasia 131 ml. Nga verifikimi në objekt nuk rezultojnë punime të tilla. Në urë janë ndërtuar vetëm guardrail tip H3, në të dy anët e rrugës dhe nuk është parashikuar dhe rrjedhimisht ndërtuar kalim për këmbësorët, duke vënë në rrezik kalimin e tyre.

**Vlera 3,720 Euro** (62 ml x 60 Euro/ml), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori JV “E & P” SHPK dhe përbën dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kontratën FIDIC, pika 12.2. (*Trajtuar më hollësisht në Pikën 2, faqe 36 Raportit Përfundimtar të Auditimit.*)

**1.1. Rekomandimi:** Nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **13,494 Euro**, nga Kontraktori JV “E. & P.” SHPK, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Lidhur me këtë rekomandim, sqarojmë se nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është ngritur grupi i punës, i cili po merret me analizën përkatëse të situatës teknike dhe financiare, me qëllim evidentimin dhe rakordimin e punimeve sipas preventivave, dhe në terren.

Personat përgjegjës: E.M, G.R-ARRSH, A.S-ARRSH, janë angazhuar për të bërë verifikimet e nevojshme, dhe grupi i punës do të përgatisë dokumentacionin për ndjekje të mëtejshme në gjykatë.

Në përfundim, Grupi i Punës, do të paraqesë një raport të arsyetuar pranë Sekretarit të Përgjithshëm të MIE, me qëllim marrjen e masave të mëtejshme në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe parimet kryesore, të cilat garantojnë zhvillimin e projekteveve në mënyrë sa më efikase dhe të qëndrueshme.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

**2. Gjetje nga Auditimi:** Gjatë auditimit të dokumentacionit justifikues për rimbursimet e kryera u konstatua se shoqëria D.H sh.a., ka vendosur në situacione kosto për shpronësime të truallit si dhe shpenzime sociale dhe ambientale. Në shkresën e DHP, dërguar MIE, datë 31.01.2019, për rimbursimin e kështit të fundit, janë paraqitur si kosto të akumuluar dhe të kërkuara për rrugën zëvendësuese Banjë Gramsh dhe ura e Trashovicës në vlerën 282,316 Euro, dhe për rrugët zëvendësuese të Moglicës 102,626 euro, në total vlerën 384,942 Euro.

Në lidhje me shpronësimet e truallit Këshilli i Ministrave ka nxjerrë VKM nr. 674, datë 15.10.2014, “Për shpronësimin, për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Gramsh-Lozhan”, me vlerë totale 2,726,182 lekë, e cila do të rimburohet nga DHP, VKM nr. 285, datë 13.4.2016 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “hidrocentrali i Banjës - Gramsh dhe ura e Trashovicës”, me vlerë 30,929,985

lekë, të cilat do të përballohen nga buxheti i shoqërisë D.H dhe VKM nr. 464, datë 26.7.2018,” Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rrugët zëvendësuese M03 për ndërtimin e hidrocentralit të Moglicës” me vlerë prej 4,780,005 lekë.

**Duke qenë se në VKM e sipërcituara përcaktohet qartë se shpenzimet e shpronësimeve kryhen nga shoqëria D.H, si dhe nga konstatimet që në dokumentet justifikuese nuk janë paraqitur fatura ose dokumente për shpenzimet sociale dhe ambientale, vlera 384,942 Euro përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit. (Trajtuar më hollësisht në Pikën 4, faqe 56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)**

**2.1. Rekomandimi:** Nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **384,942 Euro**, nga Koncesionari D.H Sh.A., pasi kjo vlerë për Buxhetin e Shtetit, përbën shpenzime jo të justifikuara të fondeve publike.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: Pranu

**Përgjigje nga subjekti:**

Lidhur me këtë rekomandim shprehemi se nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është ngritur grupi i punës, i cili po merret me analizën përkatëse të situatës financiare, lidhur me faturat financiare për t’u rimbursuar sipas parashikimeve ligjore, në zbatim të VKM-ve të sipërcituara.

Personat përgjegjës: E.M, E.D, janë duke bërë verifikimet, lidhur me të gjithë faturat, si dhe vlerat përkatëse, si dhe për të paraqitur fatura ose dokumentet për shpenzimet sociale dhe ambientale. dhe grupi i punës do të përgatisë dokumentacionin për ndjekje të mëtejshme në gjykatë.

Në përfundim, Grupi i Punës, do të paraqesë një raport të arsyetuar pranë Sekretarit të Përgjithshëm të MIE, me qëllim marrjen e masave të mëtejshme në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe parimet kryesore, të cilat garantojnë zhvillimin e projekteveve në mënyrë sa më efikase dhe të qëndrueshme.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

**3. Gjetje nga Auditimi:** Në kërkesën e bërë për rimbursime të shpenzimeve të kryera në periudhën Janar - Qershor 2015 nga shoqëria D.H sh.a, u konstatua zëri kosto supervizimi dhe menaxhimi për rrugën Banjë Gramsh, sektorët 3A dhe 3 B, dhe ura e Trashovicës, me një total prej 631,330 Euro. Paga është kryer për 15 specialistë, që renditen nga specialistë të kualifikuar, ekspertë, në punonjës të huaj të rajonit si dhe në punonjës të huaj ndërkombëtarë. Për të parët pagesa orare është 25 euro, ekspertët 40 euro, më pas 100 euro dhe për punonjësit e huaj 250 euro në orë. Në total janë një punonjës i huaj ndërkombëtar i cili ka punuar 821 orë dhe ka marrë 205,250 euro, tre punonjës të huaj të rajonit të cilët kanë punuar 2175 orë dhe janë paguar 217,500 euro.

Për sa më sipër në dokumentet justifikuese nuk janë paraqitur proceset e punës të kryera, kualifikimet dhe licencat që vërtetojnë se ishin të aftë për të kryer punët e kërkuara, llogaritjet e orëve së punës për person bazuar në pagën përkatëse dhe shpenzimet e përgjithshme administrative të dokumentuara nga analizat e kostove të shpenzimeve të përgjithshme administrative.

Për sa më sipër është në kundërshtim me aneksin V të Kontratës së Koncesionit (e ndryshuar me Shtesën e 3-të të Kontratës së Koncesionit), ku janë caktuar dokumentet që duhet ti paraqiten Autoritetit Kontraktues për Kostot e Infrastrukturës Zëvendësuese të kryera, pika 8 ku citohet: “Dokumentacion nga Shoqëria e Projektit për kostot e veta në lidhje shpenzimet për

*mbikëqyrje/menaxhim të kontratave. Këtu përshihen dietat dhe shpenzimet e lidhura me kryerjen e punës dhe kostoja për ore pune e personelit e dokumentuar nga përshkrimi i punës i punëmarrësit. Kosto e orës së punës për person do llogaritet bazuar në pagën përkatëse dhe shpenzimet e përgjithshme administrative të dokumentuara nga analizat e kostove të shpenzimeve të përgjithshme administrative.”*

**Vlera prej 631,330 Euro përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.** (Trajtuar më hollësisht në Pikën 4, faqe 56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **631,330 Euro**, nga Koncesionari D.H Sh.A., pasi kjo vlerë për Buxhetin e Shtetit, përbën shpenzime jo të justifikuara të fondeve publike.

**Menjëherë**

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Lidhur me këtë rekomandim, sqarojmë se nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është ngritur grupi i punës, i cili po merret me analizën përkatëse lidhur me burimet njerëzore, të përfshira në supervizimin dhe menaxhimin për rrugën Banjë Gramsh, sektorët 3A dhe 3 B, dhe ura e Trashovicës, ku do të evidentohen mbi baza krahasimore situacionet e punimeve, proceset e punës të realizuara nga personat përgjegjës sipas këtyre situacioneve, kualifikimet dhe licencat përkatëse që disponohen dhe janë në përputhje me objektivat e realizuara. Personat përgjegjës: E.M, E.D, G.R-ARRSH, A.S-ARRSH dhe grupi i punës do të përgatisë dokumentacionin për ndjekje të mëtejshme në gjykatë.

Në përfundim, Grupi i Punës, do të paraqesë një raport të arsyetuar pranë Sekretarit të Përgjithshëm të MIE, me qëllim marrjen e masave të mëtejshme në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe parimet kryesore, të cilat garantojnë zhvillimin e projekteve në mënyrë sa më efikase dhe të qëndrueshme.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

### **3.6. . SPITALI BASHKIAK SARANDË**

#### **A. PËRMBLEDHJE**

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 702/1 Prot, datë 04.08.2023, me objekt: “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022”.

Auditimi është kryer nga:

*E.K*

*K.G*

Periudha e auditimit: 01.01.2022 – 31.12.2022

Afati i auditimit: 07.08.2023 - 08.09.2023

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të lartë të shtetit ” dhe të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH, Nr. 1, datë 04.11.2016, “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacion që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit rekomandimeve të KLSH ”.

Duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- a. Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së, të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2022, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjektet e audituara, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- b. Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike, të akteve administrative të nevojshme, si vendime e urdhra për zbatimin e masave organizative;
- c. Të tjera masa e rekomandimeve që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

## **B. HYRJA**

Përfaqësuesit e autorizuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit, audituesit E.K dhe K.G, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna në Spitalin Bashkiak Sarandë, u informuan mbi ecurinë e zbatimit të tyre nga znj. M.Z në cilësinë e nëndrejtorit të Spitali Bashkiak Sarandë.

Objekti i këtij Raporti Përfundimtar është zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në subjektin “Spitali Bashkia Sarandë”

## **C. REZULTATET E AUDITIMIT**

Nga zbatim të programit të auditimit u verifikua dokumentacioni si më poshtë:

Raporti Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Spitalin Bashkiak Sarandë;

Shkresa përcjellëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, administruar në KLSH me nr. prot., datë, administruar në Spitalin Bashkiak Sarandë me nr., prot., datë; Etj.

**Nga auditimi rezulton se:**

### **I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.**

*-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Spitalin Bashkiak Sarandë, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 932 prot., datë 24.10.2022 duke respektuar kështu afatin 20 ditor të dërgimit.*

### **II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.**

*-Nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”, Lidhur me mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi.*

### **III. Rekomandimet e KLSH**

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 386/9 prot., datë 03.10.2022, janë rekomanduar gjithsej:

**a. Janë rekomanduar 18 masa organizative;**

**b. Janë rekomanduar 1 masë për shpërblim dëmi në vlerën 235,166 lekë;**

**c. Janë rekomanduar 2 masa për përdorimin me shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 2,868,527 lekë;**

#### IV. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH

Sipas shkresës së administruar në Ujësjellës Kanalizime Sarandë sh.a., me nr. 932 prot., datë 24.10.2022, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si me poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar Plotësisht	Pa pranuar
1	Organizative	18 masa	18 masa	0
2	Shpërblim dëmi	1 masë	1 masë	0
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	2 masa	2 masa	0

#### V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	18 masa	6		11	1
2	Shpërblim dëmi	2 masa	1		1	
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	2 masa	1		1	

Në mënyrë të analitike statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

#### MASA ORGANIZATIVE

**1.Gjetje nga auditimi:** Procesverbali për përlllogaritjen e fondit limit, në procedurën me objekt “Rikonstruksion i ambienteve të pediatriisë”, është mbajtur në datë 02.09.2020. Fondi limit është bazuar në preventivin e përgatitur nga z. E. R, me licencë A.1279/1, me vlerë 4,918,148 lekë. Çmimet e preventivit, në përgjithësi janë aplikuar bazuar në manualet e çmimeve të ndërtimit, për rastet kur nuk ka referenca, janë hartuar analiza teknike.

Nga verifikimi sipas zërit 2.204/1 “Bojë hidroplastike importi cilësi e parë”, është aplikuar çmimi 471 lekë për m<sup>2</sup>, ndërsa referuar manualeve të punimeve të ndërtimit 2015, çmimi është 431 lekë. Sipas zërit të mësipërm, fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerë 53,280 lekë [1332 m<sup>2</sup> (471 lekë/m<sup>2</sup> – 431 lekë/m<sup>2</sup>)].

-Sipas zërit An.7 “F.V dyer druri me veshje MDF dhe me mbushje material termik” nga ana e z. E. R, në analizën e çmimit është përcaktuar vlera 30,000 lekë/m<sup>2</sup>, ndërsa në preventiv është përcaktuar vlera 37,000 lekë/m<sup>2</sup>. Sipas këtij zëri fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerë 175,000 lekë [25 m<sup>2</sup> x (37,000 lekë/m<sup>2</sup> – 30,000 lekë/m<sup>2</sup>)].

-Sipas zërit An.8 “F.V portë duralumini me dyfish xham dhe me sistem elektronik për hapje” nga ana e z. E. R, në analizën e çmimit është përcaktuar vlera 30,000 lekë/m<sup>2</sup>, ndërsa në preventiv është përcaktuar vlera 42,000 lekë/m<sup>2</sup>. Sipas këtij zëri fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerë 76,800 lekë [6.4 m<sup>2</sup> x (42,000 lekë/m<sup>2</sup> – 30,000 lekë/m<sup>2</sup>)]. Sa më sipër, fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerë 305,080 lekë. Duke qenë se kontrata është nënshkruar me vlerë 4,378,010 lekë, konsiderohet se veprimi i mësipërm nuk ka krijuar pasojë financiare.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 56-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



**1.1. Rekomandim:** Komisionet e përlogaritjes së fondit limit, duhet të aplikojnë çmime me referenca të sakta të manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit. Në rastet kur çmimi i referencës nuk është pjesë e çmimeve të manualit, atëherë duhet të merren për referencë çmimet e zërave më të përfaqshëm, ose duke hartuar analiza të sakta të kostos.

***Vazhdimisht***

**Statusi i pranimit: Pranu**

**Përgjigje nga subjekti:**

Në të gjitha procedurat e prokurimit që do të realizohen nga AK, komisionet e përlogaritjes së fondit limit, apo Njësia e Prokurimit, do të aplikojnë çmime me referenca të sakta të manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.

Në rastet kur çmimi i referencës nuk është pjesë e çmimeve të manualit, atëherë duhet të merren për referencë çmimet e zërave më të përfaqshëm, ose duke hartuar analiza të sakta të kostos për çdo zë pune.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**2. Gjetje nga auditimi:** Për zbatimin e procedurave të prokurimit me objekt “Blerje lëndë djegëse, pellet”, si dhe “Rikonstruksion i ambienteve të pediatrikë”, njësia e prokurimit dhe KVO janë ngritur pa patur në përbërje një specialist të fushës, veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (shfuqizuar) neni 57, pika 4 dhe neni 58.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 56-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandim:** Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë, të marrë masa për krijimin e komisioneve me përbërje të paktën një specialist i fushës, në mënyrë që t’i japë zgjidhje problemeve teknike që lindin gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit për realizimin e tyre me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

***Vazhdimisht***

**Statusi i pranimit: Pranu**

**Përgjigje nga subjekti:**

Janë marrë masa që në krijimin e komisioneve të llogaritjes së fondit limit, Njësia e prokurimit, apo KVO, në përbërjen e tyre të ketë të paktën një **specialist i fushës**, në mënyrë që t’i jepet zgjidhje problemeve teknike që lindin gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit për realizimin e tyre me sukses dhe efektivitet ekonomik, shembull Procedura e mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore (Scanner).

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**3. Gjetje nga auditimi:** Sipas procedurës së prokurimit me objekt “Blerje lëndë djegëse, palet”, me kontratë nr. 262 prot., datë 15.02.2019 me vlerë 3,365,712 lekë në kriteret teknike pika 2, është përcaktuar që OE duhet të ketë gjendje dy kaldaja për palet (me fuqi 480 -500 KW) me disa nga karakteristikat të tilla si: Tipi KN-AT, fuqia motorike 1100 W, dimensionet (2750 mm x 2180 mm x 1720 mm), pesha 1850 kg, kapaciteti ditor i silozit 1.5 m<sup>3</sup>. Në kriteret teknike pika 3, është kërkuar të ketë gjendje dy bruciatorë për palet me karakteristika: Modeli BP 500 kë, dimensionet (380 x 420 x 1250 mm), shneku me diametër, 125 mm, fuqia e motorit të shnekut 190 W dhe dimensionet e tubit të shkarkimit 75 mm.

Vendosja e specifikimeve si më sipër kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit, pasi për makineri të ndryshme dhe me dimensione të ndryshme nga ato të kërkuara, mund të realizohet i njëjti proces, me të njëjtën prodhueshmëri, apo kapacitet. Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i ambienteve të pediatriisë”, është kërkuar që shoqëria duhet të ketë të punësuar në stafin teknik për kryerjen e punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratën individuale të punës të vlefshme, diplomë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën gusht-tetor 2020, 1 inxhinier ndërtimi, një inxhinier hidroteknik dhe 1 inxhinier elektrik. Duke qenë se kemi të bëjmë me punime rikonstruksioni dhe në volume jo të konsiderueshme, është i mjaftueshëm që një OE të ketë të punësuar një inxhinier ndërtimi, ose inxhinier hidroteknik, madje punimet elektrike kanë të bëjnë vetëm me zëvendësime instalimesh, kërkesa për specialist elektrik është e mjaftueshme.

Kërkesat për tre inxhinierë të punësuar, mund të reduktojnë numrin e operatorëve pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, sidomos të ndërmarrjeve të vogla që operojnë në fushën e ndërtimit.

Në tenderin me objekt “Blerje lëndë djegëse, palet”, kanë marrë pjesë 2 OE, nga të cilët vetëm njëri OE ka paraqitur dokumentacion. OE “A.” SHPK, shpallur fitues nuk ka paraqitur dokumentacion që të vërtetojë përputhshmërinë e specifikimeve teknike sa i takon dimensioneve të kaldajës, kapacitetit ditor të silozit, dimensionin e tubit të shkarkimit etj. Mangësitë e mësipërme ndikojnë në garancinë që jep makineria për përballimin e nevojave sipas kapacitetit të parashikuar. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i shfuqizuar), neni 23, pika 2, neni 46, pika 3 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (shfuqizuar) neni 26, pika 5.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 56-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1.Rekomandim:** Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë, të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve që angazhohen me zbatimin e procedurave të prokurimit, me synim realizimin e tyre me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

#### ***Vazhdimisht***

**Statusi i pranimit: Pranuar**

#### **Përgjigje nga subjekti:**

Drejtoria e spitalit dhe burimet njerezore , do të marrin masa për **trajnimin e vazhdueshëm** te punonjesve qe ngarkohen me zhvillimin e procedurave të prokurimit, me synim realizimin e tyre me ekonomikitet, efience dhe efektivitet.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**4.Gjetje nga auditimi:** Referuar realizimit të buxhetit për vitet 2018-2021, konstatohet se nga Spitali Sarandë përveç pamjaftueshmërisë së fondeve dhe mosplotësimit të kërkesave në rritje për shtesë fondesh rezultojnë edhe tejkalime tej parashikimit në mallra të ndryshëm, zëra për të cilët nuk është treguar vëmendje prioritare që në planifikimin e viteve të ardhshëm të bazohen në arritjet e një viti më parë si edhe në pritshmëritë referuar sëmundjeve dhe epidemive në qarkullim. Nga auditimi ka rezultuar se, për planifikimin e nevojave vjetore për barna dhe materiale mjekësore nga Shërbimet mjekësore, gjatë hartimit të projektbuxhetit dhe planit buxhetor (pas miratimit), nuk bëhet analizë mbi gjendjen e ilaçeve, sasinë e konsumit të tyre vjetore, në mënyrë që të justifikojnë dhe argumentojnë listën për nevojat e këtyre barnave. Rritja e sasive të barnave të porositura nuk është e shoqëruar me relacione shpjeguese dhe argumentuese për justifikimin e sasive shtesë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 16-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1.Rekomandim:** Strukturat drejtuese në vazhdimësi të marrin masa për ndjekjen e procedurave të hartimit të PBA, duke siguruar që planifikimet të kryhen mbështetur në analiza të dinamikës të vlerësimit të kostove të nevojshme për ruajtjen e sasisë dhe cilësisë të shërbimeve të ofruara, vlerësimin e të dhënave historike të shpenzimeve, kostove për njësi, si edhe në pritshmëritë referuar sëmundjeve dhe epidemive në qarkullim, duke rritur kërkesat për artikujt të cilët rezultojnë me tejkalim dhe minimizimin e shpenzimeve të tjera, me qëllim uljen e detyrimeve të papaguara të cilat deri në vitin 2021 kanë qenë në nivel të lartë.

*Vazhdimisht*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Strukturat drejtuese të institucionit, në vazhdimësi kanë marrë masa për ndjekjen e procedurave të hartimit të PBA, duke siguruar që planifikimet të kryhen mbështetur në analiza të dinamikës të vlerësimit të kostove të nevojshme për ruajtjen e sasisë dhe cilësisë të shërbimeve të ofruara, vlerësimin e të dhënave historike të shpenzimeve, kostove për njësi, si edhe në pritshmëritë referuar sëmundjeve dhe epidemive në qarkullim, duke rritur kërkesat për artikujt të cilët rezultojnë me tejkalim dhe minimizimin e shpenzimeve të tjera, me qëllim uljen e detyrimeve të papaguara ndaj funitore të ndryshëm.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**5.Gjetje nga auditimi:** Nga departamenti i financës, regjistrimet e veprimeve kontabël, janë kryer me regjistra ose në programin Excel dhe jo me “Bartës informatikë”, të cilët janë programe informatike të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë, gjë e cila ndikon në pasaktësi gjatë procesit të regjistrimit të dokumenteve financiarë, si dhe gabime gjatë kuadrimit të veprimeve kontabël, në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 3, pika 14 që përcakton mënyrën se si mbahet dokumenti kontabël dhe pikën 15 për “Bartësit kontabël” Neni 3 Përkufizime, neni 7, Dokumenti kontabël dhe neni 8.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1.Rekomandim:** Strukturat drejtuese të Spitalit Sarandë të marrin masa për evidentimin e saktë të veprimeve në kontabilitet, nëpërmjet prokurimit të një programi financiar me qëllim përmirësimin e mbajtjes së skedave të kontabilitetit, për të rritur cilësinë e regjistrimit, përpunimit dhe hartimit të pasqyrave financiare.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Në muajin gusht 2023 është kryer blerje e një programi elektronik ekonomik financiar. Gjatë muajit gusht do të kryhet trajnimi i punonjësve dhe në muajin shtator do të fillojë hedhja e të dhënave që nga fillimi i vitit 2023. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**6.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i Pasqyrave financiare për periudhën objekt auditimi u konstatua se:

-Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin. -Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë mbajtur kronologjikisht dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët

e bankës, arkës, magazinës, pagave, etj, por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore.

-Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, për të kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël.

-Nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Kreu III, pika 3.2 “Procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të njërive të qeverisjes së përgjithshme” Nën-pikat 43, 44 dhe 45 i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1.Rekomandim:** Sektori i Financës të marrë masë që në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare, të zbatojë parimet e kontabilitetit në procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare duke ndjekur fazat në mënyrë logjike, që nga mbajtja e dokumenteve përmbledhës të transaksioneve dhe veprimeve që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit në ditarët përkatës kronologjik, saktësimin e pozicionit të çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe pas verifikimit paraprak të pozicionit të llogarive, të cilat duhet të jenë të balancuara, dhe në fund kryerjen e veprimeve të mbylljes së llogarive, deri në pozicionin përfundimtar të tyre, duke evidentuar edhe në librin e veprimeve të ndryshme sistemimet me të gjitha të dhënat e kryera në llogaritë e ndryshme sipas rastit.

*Vazhdimisht*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Programi i finances do të krijojë mundësinë e regjistrimit të të dhënave faktike dhe perpilimin e të gjithave pasqyrave financiare që kërkohen. Gjatë muajit gusht do të regjistrohen në program lista dhe gjendja e artikujve afatshkurter dhe afatgjate si dhe lista dhe gjendja e furnitoreve si dhe do të bëhet regjistrimi i të gjithave veprimeve kontabel të Institucionit duke filluar që nga Janari 2023. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**7.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i Pasqyrave financiare për periudhën objekt auditimi u konstatua se:

-Për aktivet afatgjata jo materiale (Klasa20), konstatohet se Vlera e mbetur në fund të vitit 2021 prej 10,411,705 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, është e pa analizuar dhe nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson.

-Vlera e projekt-studimeve për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë nuk ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe nuk dihet se ku janë ruajtur, nëse janë bërë hyrje në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03. 2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 36 i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1.Rekomandim:** Sektori i Financës të analizojë vlerën 10,639,223 lekë me emërtesat përkatëse të projekt-studimeve dhe të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës të studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime “dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura koresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë. Gjithashtu të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe sistemimet kontabël përkatëse.

*Me mbylljen e pasqyrave të vitit 2022*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Nga verifikimi i kryer nga dega e finances është identifikuar një vlerë prej 227,518 leke e cila përfaqëson projektin e vlerësimit të ndikimit në mjedis (llog.203).Ndërsa për vlerat e tjera gjate hartimit të regjistrat historik dhe regjistrimit të AAGJ ne programin alfa do të rregjistrohen analitikisht sipas struktures dhe do të evidentohet pjesa e mbetur për vlerat të cilat kane kaluar në vlerën totale të ndërtesës.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

**8.Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 38,862,568 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në shumën 37,459,894 lekë. Ndërsa në vlerë historike (vlerë bruto) paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 147,569,642 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 243,833,407 lekë, pra kemi shtesë në vlerën 96,263,765 lekë, ku 540,454 lekë është shtesë pa pagesë për të cilën nuk ka emërtim dhe analizë se nga ka ardhur, po kështu edhe vlera prej 95,723,311 lekë, nga lëvizjet brenda aktiveve, vlerë për të cilën nuk ka asnjë të dhënë se çfarë veprime sistemimi kontabël janë kryer, pasi nuk është mbajtur ditari i veprimeve të ndryshme dhe nuk ka sqarime për to në formatin e Pasqyrave financiare të të dhënave shpjeguese.

-Mungon analiza sipas llojeve të aktiveve që përbëjnë këtë grup aktivesh, me emërtesat aktiv për aktiv dhe vlerat përkatëse, duke munguar kështu inventari kontabël dhe fizik për këtë grup aktivesh, veprim në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75;

-Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III, pika 3.1 “Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, nënpika 30.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1.Rekomandim:** Titullari i Institucionit të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe nëpërmjet Sektorit të Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite, për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet dhe në inventarin fizik.

*Deri në 31.12.2022*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Për këtë rekomandim ka filluar puna për evidentimin e të gjithave pajisjeve, makinerive dhe veglave të punës. Bashkangjitur lista e pajisjeve mjekësore Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**9.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit për vitet 2019, 2020 dhe 2021 janë nxjerrë urdhrat përkatës, rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda afateve të përcaktuara për kryerjen e inventarëve. Referuar dokumentacionit të mbajtur nga komisioni konstatohet se për disa njësi kryerja e inventarizimit paraqet mangësi dhe shkelje të dispozitave ligjore, pasi komisioni ka konstatuar mungesa në artikuj të ndryshëm ka kryer diferencat nga gjendja fizike dhe i ka kaluar brenda ditës së inventarizimit në listën “mallra për jashtë përdorimit dhe funksionit”.

Shuma e diferencave të artikujve për gjendjen fizike krahasuar me gjendjen e kontabilitetit e konstatuar nga inventarët e kryer për vitin 2020 është 7,503,244 lekë dhe shuma për vitin 2021 është 5,412,482 lekë, për të cilat nuk janë zbatuar drejt procedurat e inventarizimit si edhe nuk janë nxjerrë urdhër zhdëmtimet për personat përgjegjës në rastet e diferencave të gjendjes fizike.

-Vlera e propozuar për nxjerrje jashtë përdorimi të mallrave dhe materialeve që kanë humbur vlefshmërinë e përdorimit në spitalin Bashkiak Sarandë është 21,844,733 lekë, për të cilën prej vitit 2019 nuk është vepruar nga strukturat drejtuese dhe nuk janë marrë masa për asgjësimin e tyre si ngritja e komisioneve të vlerësimit, komisionet e asgjësimit, etj.

-Në proces verbal nuk janë argumentuar arsyet e vlerësimit të artikujve nëse janë të nevojshëm ose jo për veprimtarinë e njësisë, vlerësimin e gjendjes fizike dhe mundësinë e përdorimit të mëtejshëm në njësi të tjera si dhe nëse do të nxirret përfundimisht jashtë përdorimit ndërmjet shitjes si material, mbeturinë apo asgjësimit përfundimtar.

-Vlerësimi i aktiveve nuk është bërë sipas kriteve si plotësimi i kohë së shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit, afatit të skadencës, nëse ka, dhe nuk mund të riparohen, kur vlera e riparimit ose e përshtatjes për t'i kthyer në gjendje pune është e barabartë ose më e madhe se vlera e tregut për blerjen e një aktivi të ngjashëm, kur ka kaluar afati i vlefshmërisë së tyre dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuar, kur kanë humbur cilësitë e tyre të caktuara në standardet shtetërore ose në kushtet teknike dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuar a ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formë tjetër, megjithëse nuk ka kaluar afati i vlefshmërisë, etj.

-Relacioni i vlerësimit nuk përmbante procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” Inventarizimi i aktiveve, “Përgjegjësitë për inventarizimin” pikat 85, 86, 87 dhe 89, “Procesi i vlerësimit të aktiveve” pikat 96, 98 dhe “Lista e aktiveve të identifikuara për vlerësim” pikat 102,103 dhe 104. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1.Rekomandim:** Drejtori i institucionit të marrë masa për ngritjen e komisionit të inventarizimit me qëllim verifikimin e diferencave të gjendjes fizike të mallrave të paraqitura nga inventarizimet e viteve 2019-2020 dhe 2021 në shumën 5,412,482 lekë, për të cilat nëse rezultojnë me diferenca të nxirren urdhër zhdëmtimet për personat përgjegjës.

**9.2.Rekomandim:** Drejtori i institucionit të marrë masa për ngritjen e komisionit të vlerësimit të mallrave që kanë humbur vlefshmërinë e përdorimit vlerësuar prej vitit 2019 në shumën 21,844,733 lekë, si edhe të kryej procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit të mallrave që do të

klasifikohen jashtë funksionit, duke kryer analizat dhe argumentimet e bazuara në kriteret përkatëse dhe me relacionet shoqëruese.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Në datën 25.11.2022 me urdhrin nr. 1021 prot është krijuar Komisioni i Inventarizimit për verifikimin e diferencave të aktiveve që dalin jashtë përdorimit.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**10.Gjetje nga auditimi:** Referuar analizës së gjendjes së llog.401- 404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund vitin 2021 rezulton me një gjendje prej 18,556,689 lekë në të cilën janë akumuluar fatura të pa likuiduara të viteve 2019, 2020 dhe 2021, të cilave u ka kaluar afati 30-ditor i pagesës së këtyre faturave, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52 dhe ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 6 “Afati”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1. Rekomandim:** Spitali Sarandë të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (përjashtuar kufizimet e MFE), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim mos krijimin e borxhit për fatura të pa likuiduara dhe futjen e institucionit në vështirësi financiare.

*Vazhdimisht*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Detyrimet kanë ardhur në rënie, bashkëlidhur lista e detyrimeve për vitin 2021 dhe 2022.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**11.Gjetje nga auditimi:** Drejtoria e Financës nuk ka marrë masat e nevojshme për mbajtjen e evidencës kontabël në përputhje me parimet e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Gjendja e llogarisë së fondeve 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 40,150,870 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen në vlerën 34,345,484 lekë të llogarisë analoge 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” të bilancit, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 3.3 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nënpika 8 “Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1.Rekomandim:** Drejtoria e Financës të kryejë veprimet e sistemit kontabël të llogarisë së gjendjes fondeve 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” në fund të vitit 2021, të paraqitur gabim në pasqyrën e performancës, duke e rakorduar me gjendjen llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në aktiv të bilancit. Këto veprime të kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël.

*Deri në 31.12.2022*

**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Në Bilancin 2022 gjendja e fondeve në llogarine 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” në fund të vitit 2022, është e rakorduar me gjendjen llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në aktiv të bilancit. Bashkëngjitur pasqyrat e bilancit 2022.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**12.Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” paraqitet në vlerën 30,638,126 lekë e cila nuk rakordon me ndryshimin e gjendjeve të llogarive të klasës 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese në formatin 1 të bilancit, të cilat paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 31,913,704 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 30,638,126 lekë, ku diferenca e tyre në zbritje është në vlerën prej -1,275,578 lekë, duke ndikuar në saktësinë e informacionit kontabël të ofruar”, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, pika 4 “Shpenzimet, të ardhurat dhe operacionet që lidhen me to në njësitë e qeverisjes së përgjithshme (Përbërja dhe trajtimi kontabël i llogarive të klasave 6, 7 dhe 8) i ndryshuar”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1.Rekomandim:** Drejtoria e Financës të kryejë veprimet e sistemimit kontabël të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”, nëpërmjet saktësimit të gjendjeve të llogarive të klasës e të inventarit qarkullues. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021 si edhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë të llogarisë të ndryshimit të gjendjeve dhe të efekteve që shkaktojnë në llogaritë e fondeve bazë.

*Deri në 31.12.2022*

**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Janë bërë veprimet dhe sistemimet kontable të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” dhe është rakorduar në pasqyrat financiare me gjendjen e inventarit qarkullues. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**13.Gjetje nga auditimi:** Nga Sektori i Financës nuk janë marrë masat e nevojshme për mbajtjen e regjistrit historik të AAGJM, kryerjen e procedurave të plota të inventarizimit si dhe llogaritjen e amortizimit aktiv për aktiv mbi bazë historiku të krijimit të tij.

Nuk janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre si: viti i krijimit, shtesat dhe pakësimet për to, pra nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të pasur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me kap III pika 30, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**13.1.Rekomandim:** Sektori i Financës të hartojë një regjistër të plotë historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vend-ndodhjen, përshkrimin



e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Mbi bazën e tij të llogarisë amortizimin aktiv për aktiv si edhe të realizojë inventar fizik për të gjithë AAGJ, për verifikimin e ekzistencës fizike të tyre.

**Brenda datës 31.12.2022**

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Për këtë rekomandim ka filluar puna për zbatimin duke evidentuar të gjitha aktivitetet në vite dhe me instalimin e programit financiar do hartohet regjistri i plotë historik. Programi i financës do të krijojë mundësinë e regjistrimit të të dhënave faktike dhe perpilimin e të gjithave pasqyrave financiare që kërkohen. Gjate muajit shtator 2023 do të regjistrohen në program lista dhe gjendja e artikujve afatshkurter dhe afatgjatë si dhe lista dhe gjendja e furnitoreve si dhe do të bëhet regjistrimi i të gjithave veprimeve kontabël të Institucionit duke filluar që nga Janari 2023. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

**14.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i funksionimit të strukturave drejtuese në Spitalin Bashkiak Sarandë për periudhën 01.08.2018 deri më 31.12.2021, konstatohet se nuk është ngritur struktura e Këshillit Administrativ si një nga strukturat që drejton dhe jep mendime për mirëfunksionimin e aktivitetit spitalor, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë” neni 12, dhe Rregulloren e funksionimit të institucionit nenet 5 dhe 6.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-16, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1.Rekomandim:** Drejtori i Spitalit Sarandë, të marrë masa dhe të propozojë në Ministrinë së Shëndetësisë Mbrojtjes Sociale për ngritjen e strukturës drejtuese të Këshillit Administrativ, me qëllim përmirësimin, organizimin, financimin, funksionimin dhe kontrollin e veprimtarisë së shërbimit spitalor dhe rritjen e nivelit të shërbimit.

**Brenda datës 31.12.2022**

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Bazuar në Ligjin nr. 55/2022 “Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, neni 14 “Organet drejtuese të spitaleve publike sipas kategorive dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit”, pika 1. Organi drejtues i spitalit ditore dhe spitalit bashkiak është drejtorja e spitalit. Mënyra e krijimit, organizimit dhe funksionimit të spitalit ditore dhe spitalit bashkiak përcaktohet me urdhër të ministrit.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar.**

**15.Gjetje nga auditimi:** Rregullorja e Brendshme e funksionimit të Institucionit nuk është e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, megjithëse është hartuar nuk është miratuar me Urdhër të Drejtorit të Spitalit. Nga shqyrtimi i librit të protokollit për vitin 2018, rezulton se me nr.246 prot., datë 20.02.2018 është dërguar shkresa për miratimin e Rregullore së Brendshme në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por mungon kopja e shkresës përcjellëse si edhe nuk është kthyer përgjigje për miratimin ose jo të kësaj Rregullore e cila daton prej vitit 2018, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë” Kreu III, neni 23.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-16, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**15.1.Rekomandim:** Drejtoria e Spitalit Sarandë të marrë masa për plotësimin e kuadrit ligjor të institucionit, miratimin e rregullores së re dhe statutit duke e përshtatur dhe në koherencë me ndryshimet në strukturë dhe legjislacion, me qëllim monitorimin tekniko-administrativ, duke evidentuar problematika, përgjegjësi dhe rekomandime me afate konkrete brenda kompetencave të përshkruara në Rregulloren dhe statutin e Spitalit.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: Pranuar

**Përgjigje nga subjekti:**

Me shkresën nr.900 prot date 14.10.2022 i është përcjell MSHSSS kërkesa për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Sarandë. Bashkangjitur shkresa së bashku me rregulloren.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

**16.Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me implementimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollit konstatohet se:

-Mungon Kodi Etik, gjithashtu rregullat e etikës nuk janë pjesë e rregullores së brendshme si dhe Institucioni nuk ka një komision etike për të trajtuar këto çështje.

-Nuk është hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre.

-Nuk është ngritur grupi të menaxhimit strategjik.

-Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të personelit nuk është kryer vlerësimi i punës për çdo punonjës i cili realizohet çdo 6 muajor.

-Nuk janë hartuar dhe miratuar programe specifike për trajnimin e stafit.

-Nuk janë hartuar dhe miratuar Strategjitë e Riskut.

-Nuk është hartuar, miratuar, arkivuar Gjurma e Auditit, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre.

-Në lidhje me komunikimin e jashtëm, mungon një faqe zyrtare ëeb në të cilën paraqiten informacione për publikun.

-Nuk është plotësuar asnjë pyetësor vetëvlerësimi në mënyrë që të identifikojë problematikat e kontrollit të brendshëm me qëllim përmirësimin e tyre.

-Për periudhën objekt auditimi nuk është vënë në funksionim Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, nuk njihet nga strukturat drejtuese të SBR e punonjësit e saj, nuk ka funksionuar në asnjë hallkë të njesisë dhe për pasojë, drejtuesit nuk kanë bërë një vlerësim të efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar si dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 77- 81, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**16.1.Rekomandim:** Spitali Bashkiak Sarandë të marrë masa për të rritur performancën në drejtim të përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, të personelit, pasurive dhe buxhetit në zbatim të fondeve buxhetore që menaxhmenti i spitalit të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve por edhe për të siguruar që këto vendime të jenë efektive, si hartimin dhe menaxhimin e strategjisë dhe regjistrit të riskut, krijimin e listave të proceseve kryesore dhe gjurmët e auditimit, me qëllim arritjen e mjaftueshme të aktiviteteve të kontrollit për identifikimin, kontrollin dhe

reduktimin e risqeve, si edhe përfshirjen efektive të sektorëve të ndryshëm në procese, dokumentacionin përkatës, përgjegjësitë personale, mbështetjen e sistemeve të IT.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i pa zbatuar**.

**17.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Shërbimi lavanterisë dhe hotelerisë për nevoja të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Sarandë” me fond limit 97,256,679 lekë, nga ana e KVO është kualifikuar OE “D.” shpk në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe dokumentet e tenderit të hartuar sipas DST të miratuar, KVO ka vepruar me dy standarde në rastin e vlerësimit të ofertave në këtë procedurë prokurimi, ku me njërin OE është treguar shumë strikt dhe me tjetrin shumë liberale.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**17.1.Rekomandim:** DSHSS të marrë masa që në të ardhmen të kryej vlerësim sa më objektiv duke ruajtur paanshmërinë në procedurat që vlerësohet qofshin ato me ofertë më të ulët apo më të lartë. Pasja në vëmendje plotësimin e të gjitha kriterëve për kualifikim në respekt të legjislacionit.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Ky rekomandim do jetë në qendër të vëmendjes gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit që do të zhvillohen e vazhdimësi nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**18.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje kite, reagent e material konsumi laboratorik-3 lote” grupi i përllogaritjes së fondit limit nuk ka respektuar ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 2 për miradministrimin e fondeve publike, duke përzgjedhur një procedurë për testimin e tregut me kosto më të larta sesa marrja në konsiderat e kontratave të mëparshme, kjo e vërtetuar dhe nga ofertat e ardhura që kanë qenë anomlisht të ulëta për me argument përkatës. Grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit e ka fryrë fondin duke përzgjedhur mënyrën e testimit të tregut pa pasur asnjë arsye konkrete edhe pse kontratat e mëparshme janë realizuar me sukses.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**18.1.Rekomandim:** AK, Njësia e prokurimit ose grupi i përllogaritjes së fondit limit, në çdo rast duhet të respektojë çdo specifikim teknik, dizajnim apo projektim të parashikuar, duke marrë në konsideratë kontratat e mëparshme dhe çdo formë tjetër të parashikuar nga legjislacioni për një përdorim sa më të mirë të fondeve publike.

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Ky rekomandim do të meret parasysh për procedurat e prokurimit që do të zhvillohen në vazhdimësi nga anëtarët e komisionit të njësise ose grupi i përllogaritjes së fondit limit.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

## **B.MASA SHPËRBLIM DËMI**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Shërbimi lavanterisë dhe hotelerisë për nevoja të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Sarandë” me vlerë kontrate 96,880,898 lekë, ku fitues është shpallur OE “D.” shpk, rezulton se: mallrat e paraqitura në faturën e muajin shkurt 2022, nuk janë sipas specifikimeve teknike të kontratës (faqet 16 deri në 19 Aneksi nr. 2 “Specifikimet teknike”), pasi nuk kanë ofruar llojin e materialit të butë sipas përmasave të hartuara nga grupi i punës, duke ofruar material të butë jo sipas kontratës (konstatuar edhe nga AK), duke përfituar padrejtësisht vlerën 1,095,579 lekë, e cila konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1.Rekomandim:** DSHSS të marrë masa që t’i kërkojë kontraktorit “D.” shpk, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 1,095,579 lekë, të cilën e ka përfituar padrejtësisht si edhe në të ardhmen shërbimi të kryhet referuar DST dhe kontratës së nënshkruar.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Kontraktorit “D” shpk i është derguar shkresë me nr. 948 prot date 28.10.2022 , kërkesë për shpërblim dëmi dhe arkëtimin e menjëhershëm të vlerës prej 1,095,579. Ne datën 22.12.2022 vihemi në dijeni nga Gjykata Administrative e shkallës së parë Gjirokastër për kërkesë-padinë e “D”SHPK me objekt: Shfuqëzimi i vendimit “ Kërkesë për shpërblim dëmi”, njoftuar me shkresë zyrtare nr.948 prot, datë 28.10.2022, të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Sarandë”, e cila me vendimin nr. 90 date 21.02.2023 vendosi pushimin e çështjes për arsye se gjykata cmon se shkresa nr. 948 prot date 28.10.2022, kërkesë për shpërblim dëmi, drejtuar “D”shpk, objekt shqyrtimi gjyqësor, nuk përbën akt administrativ në kuptimi të dispozitave ligjore të Kodit të Procedurave Administrative dhe për këtë fakt ky kërkim nuk duhej të ishte ngritur në gjykatë.

Dhe me shkresën ne datën 09.08.2023 na vënë ne dijeni se vlerën prej 1,095,579 lekë, ta zbresim nga fatura e shërbimit të kryer për muajin korrik 2023. Bashkëngjitur USH

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar.**

**2.Gjetje nga auditimi:** Referuar dokumentacionit teknik, si dhe verifikimeve në objekt, për kontratën “Rikonstruksion i ambienteve të pediatriisë”, u konstatuan mangësi si më poshtë:

-Sipas zërit 2.4 “Tavan i varur me pllaka gipsi 60 x 60 cm” është certifikuar sasia 341 m2. Nga kjo sasi, sasia 98.7 m2, i përket korridorit të madh. Nga verifikimi i planimetrisë dhe matjeve në objekt rezulton se sipërfaqja e korridorit është 66 m2 (30 m x 2.2 m), nga ku rezulton se është certifikuar më tepër sasia 32.7 m2. Vlera 75,210 lekë (32.7 m2 x 2,300 lekë/m2), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “N” SHPK dhe përbën dëm ekonomik.

Po sipas këtij zëri, rezulton se në sipërfaqen totale të llogaritur nuk është zbritur sipërfaqja e ndriçuesve led (60 cm x 60 cm) për sasinë 40 copë. Vlera 33,120 lekë (40 copë x 0.36 m2 x 2,300 lekë/m2), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “N” dhe përbën dëm ekonomik.

-Sipas zërit 2.3 “Shtresë me pllaka grez importi”, është certifikuar sasia 440 m2. Për korridorin e madh është certifikuar sasia 98.7 m2. Nga verifikimi i planimetrisë dhe matjeve në objekt rezulton se sipërfaqja e korridorit është 66 m2 (30 m x 2.2 m), nga ku rezulton se është certifikuar më tepër

sasia 32.7 m2. Vlera 62,130 lekë (32.7 m2 x 1,900 lekë/m2), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “N” SHPK dhe përbën dëm ekonomik.

-Në lidhje me punimet në tavan llogaritur me diferencë 32.7 m2 janë certifikuar më tepër edhe punimet sipas zërit 3.1 “Patinim tavani allçi (stuko)” me vlerë 14,715 lekë (32.7 m2 x 450 lekë/m2) si dhe zërit 3.2 “Bojë hidroplastike importi cilësi e I) me vlerë 10,791 lekë (32.7 m2 x 330 lekë/m2).

-Nga verifikimi sipas zërit “Portë duralumini me dyfish xham dhe me sistem elektronik për hapje”, rezulton se në librezën e masave, referuar dhe matjeve në objekt është realizuar sasia 5.7 m2, ndërsa është likuiduar sasia 6.4 m2. Vlera 39,200 lekë [(6.4 m2 - 5.7 m2) x 56,000 lekë/m2], është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “N” SHPK dhe përbën dëm ekonomik, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, pika I.17, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 8.2 dhe 8.3.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandim:** Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 235,166 lekë, nga Kontraktori “N” SHPK, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

*Deri më datë 31.12.2022*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Kontraktorit “ N” sh.p.k i është dërguar shkresë zyrtare me datë 14.11.2022 me nr. 990 prot për vënien në dijeni për raportin përfundimtar të KLSH dhe arkëtimin e shumës 235,166 leke për punime të likuiduara por të pa realizuara. Në datën 12.01.2023 me shkresën nr. 40 prot e kemi njoftuar përseri për arkëtimin e vlerës prej 235,166 leke të lenë nga KLSH . Dhe në datën 24.01.2023 me shkresën datë 23.01.2023 na kthen përgjigje se nuk është dakort me konstatimet ku është debitor për kontratën “Rikonstruksion I ambienteve të pediatrie të DSHSS”, sipas raportit të KLSH. DSHSS në datën 26.07.2023 ka dorëzuar kërkesë-padine pranë Gjykatës se shkallës së parë Sarandë për detyrimin e paes së paditur “N” shpk të kthejë shumën prej 235,166 për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

## **C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1.Gjetje nga auditimi:** Të ardhurat nga shërbimet spitalore për vitin 2019, krahasuar me vitin 2018, janë ulur me 511,850 lekë, ndërsa në vitet 2019, 2020 dhe 2021, janë në nivele të qëndrueshme, ndërsa të ardhurat nga parkimi, janë ulur ndjeshëm në vitin 2021. Krahasuar vitin 2019 me 2018, rezulton se të ardhurat nga ky burim janë rritur me 524,050 lekë, për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, janë rritur me 167,300 lekë, ndërsa për vitin 2021, krahasuar me vitin 2020 janë ulur me 767,150 lekë, duke ndikuar negativisht në totalin e të ardhurave të mbledhura nga spitali, e cila reflektohet në uljen e nivelit të të ardhurave të realizuara në vitin përkatës.Për të ardhurat nga parkimi me qëllim menaxhimit e hapësirave të parkimit në territorin e spitalit është

nxjerrë urdhri i drejtorit nr.115, datë 09.11.2018, ku janë përcaktuar edhe tarifat orare të qëndrimit të automjeteve. Të ardhurat në total për vitin 2019 krahasuar me 2018, janë ulur në shumën 12,200 lekë, për vitin 2020 krahasuar me 2019, të ardhurat janë ulur në shumën 14,650 lekë dhe për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, janë ulur në shumën 373,718 lekë. Megjithëse të ardhurat nga shërbimet spitalore janë në nivele të qëndrueshme, ato janë ulur me 767,150 lekë, të ardhurat nga parkimi krahasuar me vitin 2020, si rezultat i mosshfrytëzimit të sipërfaqes së parkimit në favor të spitalit, në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, pika 10 “Përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë, nëpunësve dhe punonjësve publike” dhe rregulloren e institucionit Kreu II “Detyrat dhe kompetencat e zv/drejtorit ekonomik”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 74-76, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandim:** Drejtori i Spitalit, Drejtoria ekonomike dhe shërbimeve, të marrë masa për vënien në funksionim të parkimit në ambientet e brendshme me qëllim shfrytëzimin e hapësirave për parkim në dobi të spitalit dhe rritjen e të ardhurave.

*Në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Në datën 15.03.2023 me urdhrin nr. 258 prot është emëruar punonjësi i parkimit dhe ka filluar të funksionojë.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Shërbimi lavaxterisë dhe hotelerisë për nevoja të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Sarandë” grupi i përlllogaritjes së fondit limit nuk ka respektuar specifikimet teknike të përcaktuara. Mos respektimi i specifikimeve konkretisht përmasave të materialit të butë për pavijonin pediatrik por duke i marrë ato si pavijonet për të rritur ka sjellë një rritje të fondit limit me 2,101,377 lekë, vlerë e cila konsiderohet efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandim:** AK, Njësia e prokurimit ose grupi i përlllogaritjes së fondit limit nëse ka një të tillë, në çdo rast duhet të respektojë çdo specifikim teknik, dizajn apo projektim të parashikuar në përlllogaritjen e fondit limit me qëllim shmangien e diferencave që krijohen dhe përsosmërinë në përcaktimin e fondit që do të prokurohet.

*Në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi si vijon:

Z. A. K., në cilësinë e Drejtorit se nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në:

Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

### **3.7. S.U.O.GJ. “MBRETËRESHA GERALDINË”**

#### **A. PËRMBLEDHJE**

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 702/1 Prot, datë 04.08.2023, me objekt: “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022”.

Auditimi është kryer nga:

*E.K*

*K.G*

Periudha e auditimit: 01.01.2022 – 31.12.2022

Afati i auditimit: 07.08.2023 - 08.09.2023

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të lartë të shtetit*” dhe të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH, Nr. 1, datë 04.11.2016, “*Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacion që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit rekomandimeve të KLSH*”.

Duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- a. Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së, të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2022, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjektet e audituara, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- b. Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike, të akteve administrative të nevojshme, si vendime e urdhra për zbatimin e masave organizative;
- c. Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

#### **B. HYRJA**

Përfaqësuesit e autorizuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit, audituesit E.K dhe K.G, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna në S.U.O.Gj. “Mbretëresha Geraldinë”, u informuan mbi ecurinë e zbatimit të tyre nga znj. E.D në cilësinë e Drejtorit të S.U.O.Gj. “Mbretëresha Geraldinë” Objekti i këtij Raporti Përfundimtar është zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në subjektin S.U.O.Gj. “Mbretëresha Geraldinë”.

#### **C. REZULTATET E AUDITIMIT**

Nga zbatim të programit të auditimit u verifikua dokumentacioni si më poshtë:

Raporti Përfundimtar për auditimin e ushtruar në S.U.O.Gj. “Mbretëresha Geraldinë”;

Shkresa përcjellëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, administruar në KLSH me nr. prot., datë, administruar në S.U.O.Gj. “Mbretëresha Geraldinë” me nr., prot., datë; etj.

Nga auditimi rezulton se:

#### **I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.**

*-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, S.U.O.Gj. “Mbretëresha Geraldinë”, nuk ka kthyer përgjigje në respektim të afatit ligjor prej 20 ditësh.*

## II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

## III. Rekomandimet e KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH janë rekomanduar gjithsej:

a. Janë rekomanduar 18 masa organizative;

## IV. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar Plotësisht	Pa pranuar
1	Organizative	18 masa	18 masa	0
2	Shpërblim dëmi	0 masa	0 masa	0
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	0 masa	0 masa	0

## V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	18 masa	10		8	
2	Shpërblim dëmi	0 masa	0		0	
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	0 masa	0		0	

Në mënyrë të analitike statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

### MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me strukturat drejtuese në SUOGJ rezultojnë se me shkresën nr. 1034 prot., datë 05.11.2019 drejtori i SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë” i është drejtuar MSHMS – së, Ministrisë të Arsimit dhe Sportit, Universitetit të Mjekësisë Tiranë dhe Fondit të Sigurimit të detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), me kërkesë për përcaktimin e një përfaqësuesi për anëtar bordi, në kuadrin e ngritjes së Bordit të Strukturës Shëndetësore Publike të SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”.



- Me shkresën nr. 1034/1 prot., datë 11.11.2019 “Kthim përgjigje” nga ana e Universitetit të Mjekësisë Tiranë, është ridërguar emri i Prof. Dr. A.K, si anëtare e Bordit të Strukturës Shëndetësore Publike të SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”.

- Me shkresën nr. 1034/2 prot., datë 20.11.2019 “Mbi caktimin e përfaqësuesit të Fondit të Sigurimit të detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor”, është dërguar emri i Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH znj. R.D, si anëtare e Bordit të Strukturës Shëndetësore Publike të SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”.

- Me shkresën nr. 1034/3 prot., datë 13.01.20202019 “Kthim përgjigje” nga ana e Ministrisë të Arsimit dhe Sportit, është ridërguar emri i z. O.M, Sekretar i Përgjithshëm si anëtar i Bordit të Strukturës Shëndetësore Publike të SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nuk janë ndërmarrë hapa të mëtjshëm lidhur me ngritjen dhe mbledhjen e Bordit të Strukturës Shëndetësore Publike të SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”, pra kjo strukturë nuk funksionon në SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 66, datë 03.02.2017 “Për përcaktimin e kritereve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare”, pika 9 si dhe Statuti i SUOGJ, Kreu II, pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqen nr. 14-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë” në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa për ngritjen e Bordit të Strukturës Shëndetësore Publike në këtë spital.

**Menjëherë**

**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së u ndërmorën masa të menjëhershëm duke drejtuar Autoriteteve përkatëse për ngritjen e strukturës së bordit sipas parashikimit e akteve nenligjore. Në kuadër të konfirmimit të anëtarëve të bordit u realizuan disa takime dhe veprime ligjore duke mbarvajtur punën dhe procesin e bordit sipas kompetencave që kanë.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**2. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me strukturën organizative rezulton se për periudhën objekt auditimi për muajt e zgjedhur nuk ka tejkallim të strukturës si për numër total punonjësish ashtu edhe për njësitë përbërëse. Me shkresën nr. 345, datë 13.03.2017 “Kërkesë për miratim të projekt rregullore” është dërguar për miratim nga ana e SUOGJ në Ministri rregullorja e institucionit. Kjo rregullore nuk është miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe në bazë të deklaratës së Shefes së Sektorit të Burimeve Njerëzore është punuar me këtë rregullore e cila është e pa miratuar deri në datën 22.07.2020. Me Urdhrin nr. 433 të Drejtorit të Spitalit, datë 22.07.2020 “Miratimin e rregullore së Spitalit Universitar” është miratuar rregullore e re por nuk është miratuar në Ministri. Nga auditimi konstatohet se SUOGJ nuk ka të përcaktuar llojin e arsimit, nivelin arsimor, vjetërsinë në punë apo kualifikim shtesë të nevojshëm për postin e punës. Sa më sipër është në kundërshtim me shkresën nr. 345, datë 13.03.2017 “Kërkesë për miratim të projekt rregullore”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 15-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** Drejtori i Spitalit në bashkëpunim Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrin masa që të miratohen aktet rregullatore të brendshme si dhe të plotësohet struktura me llojin e arsimit, nivelin si dhe vjetërsinë.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Në zbatim është reformuar rregullorja së bashku me tabelen e punonjësve të cilët ngarkohen me detyrat për të kryer të gjitha kushtet duke specifikuar arsimin nivelin e vjetërsisë dhe dokumentacion shtesë provues.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**3. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me programet ekonomiko financiare rezulton se për vitin 2018 buxheti është miratuar me shkresën nr. 50 prot., datë 15.01.2018. Për vitin 2019 buxheti është miratuar dhe përcjellë me shkresën nr. 127/3 prot., datë 15.02.2019 protokolluar në SUOGJ me nr. 288 prot., datë 26.02.2019. Për vitin 2020 buxheti është miratuar me shkresë nr. 189/3 prot., datë 21.02.2020 protokolluar në SUOGJ me nr. 226 prot., datë 27.02.2020. Nga të dhënat rezulton se nga totali i të ardhurave që do mbulojnë shpenzimet e buxhetit për vitin 2018, të ardhurat e veta (nga aktiviteti Mjekësor) zënë 3.4% ose në vlerën 20,556 mijë lekë ndërsa 96.6% janë grante korent të brendshëm në vlerën 574,495 mijë lekë. Në buxhetin e miratuar për vitin 2018, nuk janë programuar si zë më vete likuidimi i të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguara nga viti paraardhës që sipas pasqyrave financiare për vitin 2017, në shumën totale 11,510,662 lekë nga të cilat:

Ilogaria 401-408 *Furnitorë e llogari të lidhura me to* në shumën 10,108,909 lekë

Ilogaria 467- *Kreditorë të ndryshëm* në shumën 1,401,753 lekë

Për vitin 2019, të ardhurat e veta zënë 3.22% ose në vlerën 18,777 mijë lekë ndërsa 96.78% janë grante korent të brendshëm në vlerën 563,628 mijë lekë.

Në buxhetin e miratuar për vitin 2019, nuk janë programuar si zë më vete likuidimi i të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguara nga viti paraardhës që sipas pasqyrave financiare për vitin 2018, janë në shumën totale 14,344,630 lekë nga të cilat:

Ilogaria 401-408 *Furnitorë e llogari të lidhura me to* në shumën 7,813,543 lekë

Ilogaria 467- *Kreditorë të ndryshëm* në shumën 6,531,087 lekë

-Për vitin 2020, të ardhurat e veta zënë 7.3% ose në vlerën 48,950 mijë lekë ndërsa 92.7% janë grante korent të brendshëm në vlerën 616,918 mijë lekë.

Në buxhetin e miratuar për vitin 2020, nuk janë programuar si zë më vete likuidimi i të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguara nga viti paraardhës që sipas pasqyrave financiare për vitin 2019, janë në shumën totale 13,381,249 lekë nga të cilat:

Ilogaria 401-408 *Furnitorë e llogari të lidhura me to* në shumën 6,850,162 lekë

Ilogaria 467- *Kreditorë të ndryshëm* në shumën 6,531,087 lekë. Sa më sipër konstatohet se nuk janë programuar si zë më vete në buxhetet e viteve 2018, 2019, 2020 dhe i detyrimeve të vitit paraardhës duke u akumuluar si borxh i vitit të kaluar pa i klasifikuar në zërat përkatës.

Gjithashtu në vitet (2007-2012), të mbartura në kartelat e kreditorëve pa dokumentacion përkatës në vlerën 985,356 lekë, detyrim kreditor i krijuar në vitin 2019 për vlerën 5,487,357 lekë me Institutin e Ndërtimit si dhe detyrim kreditor i krijuar në vitin 2019, lidhur me mungesë faturash,

penalitete në vlerën 19,287.33 lekë ku në total krijohet shuma prek 12,37,731.33 lekë, vlerë e cila duhet të ishte programuar në buxhetet e viteve përkatëse për shlyerjen e tyre.

**Për vitin 2018,** buxheti është realizuar në total në masë 95.6% ose nga 610,948,175 lekë të programuara, është realizuar 581,098,175 lekë, nga të cilat nga granditë 565,854,129 lekë dhe nga të ardhurat e veta në shumën 18,732,967 lekë. Në zërin Paga llogaria ekonomike 600, është realizuar në masën 99,1% ose nga 270,622,260 lekë të programuara, realizuar në shumën 268,403,234 lekë, nga të cilat nga granditë në vlerën 267,874,018 lekë ose 99.8% të totalit të pagave dhe nga të ardhurat e veta në vlerën 529,216 lekë ose 1.2 % të totalit të pagave. Në zërin sigurime shoqërore llogaria ekonomike 601, është realizuar në masën 98.8% ose nga 43,250,000 lekë të programuara, realizuar në vlerën 42,737,132 lekë, nga të cilat nga granditë në vlerën 42,737,132 lekë ose 100 % të totalit të sigurimeve. Në zërin shpenzimet operative llogaria ekonomike 602, është realizuar në masën 94.5 % ose nga 272,464,647 lekë të programuara, realizuar në vlerën 257,622,680 lekë, nga të cilat nga granditë në vlerën 254,821,608 lekë ose 98,9 % të totalit të shpenzimeve operative ose nga të ardhurat e veta në vlerën 2,801,072 lekë ose 1,1% të totalit të shpenzimeve operative. Në zërin investime llogaria ekonomike 231, është realizuar në masë 63,6% ose nga 24,186,103 lekë të programuara, realizuar në vlerën 15,402,678 lekë, nga të cilat nga të ardhurat e veta në vlerën 15,402,678 lekë ose 100% të totalit të investimeve.

**Për vitin 2019,** buxheti është realizuar në total në masë 95% ose nga 616,645,536 të programuara, është realizuar 587,334,544 lekë, nga të cilat nga granditë 562,463,046 lekë dhe nga të ardhurat e veta në shumën 24,871,498 lekë. Në zërin paga llogaria ekonomike 600, është realizuar në masën 98,3% ose nga 272,023,380 lekë të programuara, realizuar në shumën 267,452,889 lekë, nga të cilat nga granditë e të ardhurat e veta në vlerën 267,452,889 lekë ose 100 % të totalit të pagave. Në zërin sigurime shoqërore llogaria ekonomike 601, është realizuar në masën 96,6 % ose nga 44,300,000 lekë të programuara, realizuar në vlerën 42,958,793 lekë, nga të cilat nga granditë në vlerën 42,958,793 lekë ose 100 % të totalit të sigurimeve. Në zërin shpenzimet operative llogaria ekonomike 602, është realizuar në masën 95,8 % ose nga 263,663,576 lekë të programuara, realizuar në vlerën 252,760,221 lekë, nga të cilat nga granditë në vlerën 251,594,781 lekë ose 95,4 % të totalit të shpenzimeve operative ose nga të ardhurat e veta në vlerën 1,165,440 lekë ose 5,6% të totalit të shpenzimeve operative. Në zërin investime llogaria ekonomike 231, është realizuar në masë 65,5% ose nga 36,175,725 lekë të programuara, realizuar në vlerën 23,706,058 lekë, nga të cilat nga të ardhurat e veta në vlerën 23,706,058 lekë ose 100% të totalit të investimeve.

**Për vitin 2020,** buxheti është realizuar në total në masë 99.4% ose nga 630,528 mijë lekë të programuara, është realizuar 626,766 mijë lekë. Në zërin paga llogaria ekonomike 600, është realizuar në total në masë 99.2% ose nga 276,545 mijë lekë të programuara, është realizuar 274,569 mijë lekë. Në zërin sigurime shoqërore llogaria ekonomike 601, është realizuar në masën 99.6 % ose nga 43,000 mijë lekë të programuara, realizuar në vlerën 42,827 mijë lekë. Në zërin shpenzimet operative llogaria ekonomike 602, është realizuar në masën 99.45% ose nga 294,110 mijë lekë të programuara, realizuar në vlerën 292,509 mijë lekë. Në zërin investime llogaria ekonomike 231, është realizuar në masë 100%. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2006 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 32, neni 65 si dhe UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar pika 101.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 19-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:** SUOGJ Mbretëresha Geraldinë të marrë masat për programimin e buxheteve afat mesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore.

*Në vijimësi*

Statusi i pranimit: Pranuar

**Përgjigje nga subjekti:**

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së u ndërmorën masa të menjëhershëm për programimin e buxheteve afat mesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**3.2 Rekomandimi:** SUOGJ Mbretëresha Geraldinë të marrë masat, që në buxhetin e vitit ushtrimor, të programohet shlyerja e të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguar nga viti paraardhës sipas kërkesave ligjore.

*Në vijimësi*

Statusi i pranimit: Pranuar

**Përgjigje nga subjekti:**

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së u janë ndërmarrë masa për shlyerjen e të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguar nga viti paraardhës sipas kërkesave ligjore. Jemi në proces.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**4. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me evidencën kontabël rezulton se në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të vitit 2020, zëri “*Ndërtesa e konstruksione*” ka pësuar rritje nga vlera 37,812,884 lekë në vitin 2019, në vlerën 63,546,248 lekë në vitin 2020. Nga subjekti, argumentohet se këto shtesa vijnë si rezultat i dhurimeve dhe sistemeve elektrike. Ndërkohë rezulton se në zërin “*Instalime teknike, makineri e pajisje*” rezulton se po ashtu ka rritje në vlerë nga 58,920,004 lekë në vitin 2019, në vlerën 102,426,297 lekë në vitin 2020. Rezulton se në *Shënimet Shpjeguese* nuk ka sqarim lidhur me këta zëra, dhe si e tillë situata është e paqartë dhe nuk jep siguri të arsyeshme.

- Nga auditimi u konstatua se në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të vitit 2020, zëri “*Materiale*” ka pësuar rritje nga vlera 39,987,514 lekë në vitin 2019, në vlerën 67,849,646 lekë në vitin 2020. Nga subjekti, argumentohet se këto shtesa vijnë si rezultat i dhurimeve dhe blerjeve të ndryshme. Rezulton se në *Shënimet Shpjeguese* nuk ka sqarim lidhur me këtë zë. Gjithashtu, shënimet shpjeguese paraqiten të paqarta, të paplota dhe të pa kuptueshme. Sa më sipër është në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 2, paragrafi 49, pikat c dhe d.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 22-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1 Rekomandimi:** Nga Sektori i Financës të merren masa lidhur me plotësimin dhe pasqyrimin e saktë të transaksioneve dhe lëvizjeve kontabël në shënimet shpjeguese.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: Pranuar

**Përgjigje nga subjekti:**

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**5. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me evidencën kontabël rezulton se sipas Urdhrit të Brendshëm administruar në SUOGJ me nr. 1253 prot., datë 01.11.2018 “*Asgjësimin e aktiveve të qëndrueshme sipas llogarive 214, 218, 237, 212 dhe 213 për vitin 2017*”, është ngritur komisioni për asgjësimin i përbërë nga: F.Zh (Kryetar), I.J (Anëtar), E.K

(Anëtar), H.B (Anëtar) dhe G.B (Anëtar). Me shkresën nr. 1315 prot., datë 20.11.2018, me objekt “Ankand për shitje skrapit”, është ngritur ankandi me fond limit **26,656 lekë pa TVSH** për material hekur, gizë, alumin, llamarinë dhe inox (sasia 1600kg). Ky ankand nuk është realizuar pasi me shkresën nr. 1315/3 prot., datë 11.12.2018 nga Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim APP), ka ardhur përgjigja sipas të cilës është cituar se “APP nuk e publikoi informacionin e sjellë, pasi nuk keni respektuar afatin minimal kohor 20 ditor për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje në procedurën e hapur, përcaktuar në pikën 2 të nenit 28, Ligji nr. 9874, datë 14.02.2008 ‘Për Ankandin Publik’ (i ndryshuar).”, dhe “në njoftimin e ankandit keni përcaktuar datën 13.11.2018, si afat të fundit për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje, ndërkohë që Buletini i Njoftimeve Publike të APP – së publikohet në datën 11.12.2018”. Me shkresën nr. 56 prot., datë 15.01.2019 “Formulari i njoftimit të fituesit”, operatori ekonomik A.M SHPK është shpallur fitues për vlerën **26,656 lekë pa TVSH**. Nga grupi i auditimit konstatohet se me faturën nr. 1, datë 11.02.2019, nga operatori ekonomik, është kryer pagesa në vlerën **59,309 lekë pa TVSH**, për shitjen e 3560 kg/skrapi x 16.66 lekë/kg, në favor të institucionit. Pra sa më sipër rezulton se ankandi është shpallur për sasinë **1600 kg**, ndërkohë shitja e skrapit realisht ka qenë në sasinë **3560 kg**. Sa më sipër është në kundërshtim me shkresën nr. 56 prot., datë 15.01.2019 “Formulari i njoftimit të fituesit”, në të cilën përcaktohet se operatori ekonomik A.M SHPK është shpallur fitues për vlerën 26,656 lekë pa TVSH.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 22-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1 Rekomandimi:** Nga Sektori i Financës të merren masat lidhur me analizimin e situatës të krijuar nga shitja e skrapit më tepër nga vlera e përcaktuar.

**Menjëherë**

**Statu i pranimit: Pranu**

**Përgjigje nga subjekti:**

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së janë marrë masat për analizimin e situatës të krijuar nga shitja e skrapit më tepër nga vlera e përcaktuar.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**6. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me evidencën kontabël rezulton se me shkresën nr. 1136/12 prot., datë 09.02.2020 “Relacion përmbledhës mbi Inventarizimin vjetor të pasurisë dhe vlerësimin e jashtë përdorimeve të propozuar në SUOGJ. ‘Mbretëresha Geraldinë’”, komisioni i inventarizimit i është drejtuar Drejtorit të spitalit duke propozuar nxjerrjen jashtë përdorimit të AQT – ve jo funksionale, si godina zyrtar me vlerë **38,400 lekë**, godina marangozi me vlerë **10,800 lekë**, dhe godina oksigjen me vlerë **6,941 lekë**. Arsyeja konstatohet të jetë mos ekzistenca e këtyre godinave që në vitin 2000, shembja e tyre dhe në vendndodhjen e tyre është ndërtuar godina aktuale e administratës. Sa i takon godinës të oksigjenit, rezulton se nuk ekziston që në vitin 1999, dhe pas shembjes në këtë vit është ndërtuar godina e re e oksigjenit, së bashku me depozitën dhe linjat e O<sub>2</sub> të lëngshëm. Grupi i auditimit konstaton se nuk është marrë asnjë masë lidhur me zgjidhjen e kësaj situate dhe marrjen e hapave konkretë lidhur me nxjerrjen nga inventari të këtyre asetëve inekzistente nga vitet 2000. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar me Udhëzimin nr. 24, datë 07.12.2016, nr. 11 datë 06.05.2016 dhe nr. 20 datë 17.11.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 103, G.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 22-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1 Rekomandimi:** Nga Sektori i Financës të merren masa për nxjerrjen jashtë përdorimit dhe çregjistrimin kontabël të aseteve të cilat nuk ekzistojnë më pranë SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së janë marrë masat për nxjerrjen jashtë përdorimit dhe çregjistrimin kontabël të aseteve të cilat nuk ekzistojnë më pranë SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”. Aktualisht jemi në proces.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**7. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimeve rezulton se nga auditimi i procedurës “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (katering)*”, konkretisht dokumentacionit të ngarkuar në SPE (Sistemi i Prokurimit Elektronik) janë ftuar për të marrë pjesë 3 OE. Sipas raportit përmbledhës me nr. 171/4 prot., datë 09.02.2018 është miratuar ky dokument nga ana e Titullarit të AK. Sipas shkresës me nr. 171/5 prot., datë 09.02.2018 është bërë njoftimi i fituesit dhe me shkresën nr. 197 prot., datë 12.02.2018 është bërë dorëzimi i dokumentacionit të fituesit S-A. Sipas aktit me nr. 171/6 prot., datë 14.02.2018 është lidhur kontrata e shërbimit mes Titullarit të AK dhe sipërmarrësit të shërbimit znj. A.T Administratore e S-A. Sipas dokumentacionit rezulton se kontrata e lidhur mes palëve nuk është sipas DST të ngarkuar në SPE pasi ka ndryshime, të cilat edhe pse jo thelbësore janë në kundërshtim me kuadrin ligjor e rregullator të poshtëshënuar. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar neni 59 dhe neni 60 pika 1 si dhe me VKM nr. 914 datë 29.12.2014, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, ndryshuar, neni 22.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 25-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1 Rekomandimi:** Nga ana e SUOGJ Mbretëresha Geraldinë të merren masa për përfshirjen në DST të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm me qëllim njohjen e tyre nga OE për tërësinë e shërbimeve që do të furnizohen, të drejtat dhe detyrimet ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit.

*Në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Në zbatim të rekomandimit të sipërcituar të gjithë dokumentat e tenderit janë plotësuar duke qartësuar pozitën e furnitorve si dhe duke mundësuar saktësinë në ofrimin e shërbimit në përputhje me LPP-në. Në këtë kuadër janë mbarëvajtur të drejtat dhe detyrimet referuar kontratës së furnizimit lidhur ndërmjet palëve sipas përcaktimit të LPP-së dhe dispozitave të Kodit Civil.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**8. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimeve rezulton se nga auditimi i procedurave me objekt ‘*Rikonstruksion i ambienteve ekzistuese për riakomodimin e pacienteve/personelit mjekësor në SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë” dhe ‘Blerje kite reagent dhe materiale konsumi laboratorike për kryerjen e analizave*

*klinike biokimike, imunologjike për laboratorin klinik biokimik* u konstatuan mangësi në drejtim të vendosjes së kriterëve të kualifikimit si dhe të specifikimeve teknike. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 26, 27 dhe 61.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 25-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1 Rekomandimi:** Nga ana e SUOGJ Mbretëresha Geraldinë të merren masa për trajnim në fushën e legjislacionit të prokurimit publik të punonjësve të parashikuar për tu përfshirë në procedurat e prokurimit gjatë vitit.

*Në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Nëpërmjet thirrjes për trajnimin e stafit sipas thirrjes nga ana e APP-së për trajnim në kuadër të legjislacionit të prokurimit publik u realizua trajnimi në platëformën online nga ASPA dhe APP-ja për disa nga persoant pjesë të AK-së në punë e tyre të si persoan përgjegjës apo që merren me dosjet e prokuimit.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**9. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimeve rezulton se nga auditimi i procedurave me objekt ‘Riparime të rrjetit elektrik në Kati 0 dhe kati I në SUOGJ Mbretëresha Geraldinë’, ‘Rikonstruksion i ambienteve ekzistuese për riakomodimin e pacienteve/personelit mjekësor në SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë” dhe ‘Punime elektrike në Kat. II, në objektin e Gjinekologjisë në SUOGJ Mbretëresha Geraldinë’ u konstatua se ftesat ndaj OE nga ana e NJP janë kryer duke mos ndryshuar shpesh operatorët ekonomikë të ftuar në procedurat e prokurimit. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 36, pika 4 si dhe me Udhëzimin nr. 2, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimit të saj me mjete elektronike”, pika 10, paragrafi c. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 25-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1 Rekomandimi:** Nga ana e SUOGJ Mbretëresha Geraldinë të merren masa për trajnim në fushën e legjislacionit të prokurimit publik të punonjësve të parashikuar për tu përfshirë në procedurat e prokurimit gjatë vitit.

*Në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Argumentimi është i njëjtë sipas pikë 8.1 pasi trajnimi është bërë në kuadër të thirrjes së ASPA dhe APP-së. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**10. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimeve rezulton se nga auditimi i procedurave me objekt ‘Rikonstruksion i ambienteve ekzistuese për riakomodimin e pacienteve/personelit mjekësor në SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë” dhe ‘Blerje kite reagent dhe materiale konsumi laboratorike për kryerjen e analizave klinike biokimike, imunologjike për laboratorin klinik biokimik’ u konstatuan mangësi në drejtim

të vlerësimit të ofertave. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 66.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 25-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1 Rekomandimi:** Nga ana e SUOGJ Mbretëresha Geraldinë të merren masa për trajnim në fushën e legjislacionit të prokurimit publik të punonjësve të parashikuar për tu përfshirë në procedurat e prokurimit gjatë vitit.

*Në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Argumentimi është i njëjtë sipas pikë 8.1 dhe 9.1. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**11. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën me objekt “Shërbim evadim, transport dhe trajtim të mbetjeve të rrezikshme spitalore”, rezulton se bazuar në kërkesën e bërë nga Shefi i Sektorit të Inxhinierisë Klinike, si dhe në përlllogaritjen e fondit limit të kryer bazuar në kontratën e vitit të fundit, ka nisur procedura e prokurimit. Me procesverbalin nr. 1 datë 21.02.2018 janë hartuar kriteret e kualifikimit. Nga auditimi konstatohet se kriteret e kapaciteteve teknike të vendosura nga NJP janë të pa qarta dhe konfuze. Pjesa për tu plotësuar nga NJP për kapacitetet teknike është lënë e paplotësuar në DST (Shtojca 7) dhe janë vendosur disa kriteret tek specifikimet teknike për ofrimin e shërbimit (Shtojca 8). Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 46 si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 25-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1 Rekomandimi:** Njësia e Prokurimit në SUOGJ të marrë masa që të plotësojë dokumentet standard të tenderit sipas shtojcave të përcaktuara nga APP si dhe të hartojë kriteret kualifikimi të qarta duke evidentuar dokumentacionin e nevojshëm për dokumentimin e plotësimit të kriterëve si dhe të bëhet argumentimi teknik dhe ligjor i tyre.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Në zbatim të LPP-së kriteret dhe hartimi i dokumentave të tenderit është kusht vlefshmërie për këtë qëllim dhe në konstatimet e KLSH u bë e mundur hartimi i kriterëve të qarta dhe transparente në përputhje me LPP-në dhe me praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare. Argumentimi teknik janë bërë më të qarta dhe më gjithëpërfshirëse.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**12. Gjetje nga Auditimi:** Me shkresën nr. 771, datë 30.01.2018 “Mbi lejimin e institucioneve spitalore për kryerjen e procedurave të prokurimit për nevojat urgjente për barna” MSHMS ka lejuar të gjitha institucionet spitalore të kryejnë prokurime me negociim për nevojat më emergjente të artikujve që janë duke u prokuruar nga Ministria si institucion qendror. Konkretisht, sipas kësaj shkrese citohet se: “Sasitë për të cilat lejoheni të prokuroni vet, nuk duhet të kalojnë ato të miratuara **për mbulimin e nevojave deri në 15 prill 2018**, të planifikuara sipas shkresës nr. 4572, datë 01.11.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm dhe udhëzimeve të Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë nr. 4869 prot. datë 20.11.2017 “Për ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e



*mënyrës dhe afatet që do të ndiqen për zhvillimin e procedurave të përqendruara të prokurimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore për vitin 2018, nga organi qendror blerës”*. Sipas kërkesës së bërë nga ana e Shefes së Farmacisë znj. S.Z, është paraqitur edhe situata e gjendjes së medikamenteve dhe është llogaritur fondi limit në vlerën 8,263,531.68 lekë për 7 lote medikamente. Kjo kërkesë është miratuar nga A.K, përgjegjëse e sektorit të prokurimeve. Të dyja punonjëset kanë vepruar në tejkalim të kompetencave dhe detyrave funksionale pasi kanë kryer veprime pa marrë autorizim nga Titullari. Nga ana e SUOGJ nuk është marrë informacion mbi statusin e procedurës së prokurimit që po zhvillohej në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të vijuar me procedurën e prokurimit pasi referuar shkresës nr. 771, datë 30.01.2018 *“Mbi lejimin e institucioneve spitalore për kryerjen e procedurave të prokurimit për nevojat urgjente për barna”* institucioni është lejuar të prokurojë për nevojat e vetat sasitë deri për 15 prill. Me shkresën nr. 882/1, datë 23.04.2018 *“Dërgohet dokumentacioni për lidhjen e kontratave të furnizimit me barna mes Autoriteteve Kontraktore ....”* është dërguar dokumentacioni për autorizimin e lidhjes së kontratave për nevojat e vitit 2018. Në regjistrin e parashikimit të vitit 2018 i cili me shkresën nr. 189, datë 09.02.2018 i është dërguar Ministrisë së Shëndetësisë është parashikuar procedura:

*“Blerje medikamente - me fond 8,698,565 lekë - Negocim pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës e parashikuar në muajin shkurt”*. Sa më sipër është në kundërshtim me shkresën nr. 771, datë 30.01.2018 *“Mbi lejimin e institucioneve spitalore për kryerjen e procedurave të prokurimit për nevojat urgjente për barna”* institucioni lejohet të prokurojë për nevojat e vetat sasitë deri për 15 prill.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 25-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1 Rekomandimi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor dhe njësia e prokurimit të marrin masa që të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm me organin qendror blerës dhe informacion rast pas rasti mbi ecurinë e procedurave tek organi qendror përpara se të nisnin procedurat e prokurimit.

*Në vijimësi*

**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Në zbatim të rekomandimit ky kriter kryhet si nëpërmjet regjistrin të parashikimeve nga ku i dërgohet kopje fizike e regjistrin me të gjitha zërat që do të prokurohen si dhe me njoftime të herëpashershme për miratim fondesh apo veprime për asistencë në fushën e prokurimit.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**13. Gjetje nga Auditimi:** Në zbatimin e kontratave dhe afatin e lëvrimit të medikamenteve u konstatuan vonesa për të cilat SUOGJ ka mbajtur penalitete por jo në vlerën e duhur. Konkretisht rezulton se Kontrata nr. 421/11, datë 18.04.2018 është lidhur midis I.F dhe SUOGJ me vlerë 568,016.5 lekë, me afat lëvrimi 7 ditë. Penaliteti i kontratës duhet të jetë në vlerën 4,544 lekë(568,016.5 x 0.25 x 4/1000 x 8 ditë) pra penaliteti duhet të ishte llogaritur mbi vlerën 25% të kontratës sepse vlera e pa sjellë brenda afateve është 6,916.5 lekë (1.2% e vlerës së kontratës). Vlera prej 4322.6 lekë përbën dëm ekonomik. Për llogaritjen jo të saktë të penalitetit mban përgjegjësi S.Z me detyrë shefe farmacie, E.H me detyrë Farmaciste, F.K me detyrë mjek dhe A.H në cilësinë e nëpunësit zbatues. Kontrata nr. 421/13, datë 20.04.2018 midis M dhe SUOGJ me vlerë 6,534,861 lekë, me afat lëvrimi 7 ditë. Penaliteti i kontratës duhet të jetë në vlerën 133,500 lekë por është mbajtur vetëm 102,011 lekë. Vlera prej 31,489 lekë përbën dëm ekonomik. Sa më

sipër është në kundërshtim me kontratën nr. 421/13 prot., datë 20.04.2018, nenit 3 si dhe kontrata nr. 421/11, datë 18.04.2018, neni 3.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 25-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1 Rekomandimi:** SUOGJ të marrë masa që të kryej një llogaritje të saktë të penalteteve në zbatimin e kontratave të medikamenteve me qëllim nxitjen e përmbushjes së afateve të lëvrimit.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Komisionet e ndjekjes dhe zbatimit të kontratës llogarisin penaltet sipas formulës së DST-së, Legjislacionit në Prokurimeve në fuqi të APP-së dhe nga KLSH për të mbajtur penaltet për mospërmbushjen e afateve të lëvrimit.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**14. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me shpenzimet rezulton se nga administrim i konsumit të karburantit konstatohet se për çdo lëvizje janë autorizimet përkatëse. Në fund të muajit është hartuar përmbledhësja dhe janë kryer rakordime. Në fletët e udhëtimit mungojnë kilometrat e treguara nga kilometrazhi i makinës në fillim dhe fund të lëvizjes. Autoambulanca është e pajisur me GPS dhe dokumentohen lëvizjes e saj nga raporti mujor i gjeneruar nga sistemi i 127. Në çdo rast janë plotësuar Fletë – Udhëtimet përkatëse dhe Regjistri i misionit dhe lëvizjeve. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

*(Më hollësisht trajtua në pikën 6 faqen nr. 30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1 Rekomandimi:** Drejtoria e SUOGJ të marrë masa në plotësimin e gjithë dokumentacionin justifikues të konsumit të karburantit dhe lëvizjes së automjeteve duke plotësuar kilometrat e përshkruar sipas treguesit përkatës në automjet.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së janë marrë masat për plotësimin e gjithë dokumentacionin justifikues të konsumit të karburantit dhe lëvizjes së automjeteve duke plotësuar kilometrat e përshkruar sipas treguesit përkatës në automjet.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**15. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla u konstatua mos dokumentimi i komunikimit me operatorët ekonomik kur operatori paraardhës nuk është paraqitur për kryerjen e shërbimit / blerjen e mallit. Gjithashtu, në procedurën “Dezinfektim, Deratizim, Dezinsektim të ambienteve SUOGJ” viti 2018 konstatohet se procedura ka një mosrakordim midis datave dhe etapave që është kryer procedura, konkretisht, testimi i tregut është kryer me datë 5 qershor, shpallja e fituesit me datë 4 qershor dhe nisja e kryerjes së shërbimit 31.05.2018. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 03, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” i ndryshuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqen nr. 30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1 Rekomandimi:** SUOGJ të marrë masa që stafin e angazhuar në procedurat e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla të trajnojë stafin pranë institucioneve përkatëse si dhe të azhurnohen me ndryshimet e herëpashershme të legjislacionit.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Në zbatim të LPP-së janë trajnuar nga ASPA si dhe do të trajnohen në vijimësi për shkak të ndryshimeve të herëpashershme në këtë komision.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**16. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të ligjshmërisë në organizimin dhe funksionimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit rezultoi se Sistemi aktual i komunikimit të institucionit nuk është eficient. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. Sa më sipër është në kundërshtim me UMF nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”, pika 15, germa b.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 33-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**16.1 Rekomandimi:** SUOGJ, të marrë masat e nevojshme për implementimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, për identifikimin e aktiviteteve me risk dhe menaxhimin e tij. Të analizohen shkaqet e mos funksionimit të sistemit të komunikimit, të nxirren përgjegjësitë më qëllim që të kryejë funksionet e veta. SUOGJ, të marrë masa për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Të hartohet procedurë e veçantë mbi mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve/ankesave dhe kryerjen e analizimit i tyre.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së janë marrë masat për implementimin e kërkesave në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, për identifikimin e aktiviteteve me risk dhe menaxhimin e tij. Jemi në proces analizimi mbi shkaqet e mos funksionimit të sistemit të komunikimit, dhe po nxjerrim përgjegjësitë më qëllim që të kryejë funksionet e veta. SUOGJ, ka marrë masa për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. SUOGJ, ka hartuar procedurat e veçanta mbi mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve/ankesave dhe kryerjen e analizimit të tyre.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**17. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi rezultoi se për periudhën objekt auditimi struktura e auditit të brendshëm nuk është e plotësuar me asnjë anëtar edhe pse referuar strukturës së miratuar nga ministri z. I.B me shkresën nr. 1371, datë 10.03.2017, kjo njësi duhet të kishte në përbajtje:

Spektori i Auditimit – 3

Shef Spektori (Ekonomist i Lartë) – 1

Specialist (jurist) – 1

Specialist (ekonomist) – 1.

Sa më sipër është në kundërshtim me strukturën e SUOGJ miratuar me shkresën nr. 1371, datë 10.03.2017.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqen nr. 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**17.1 Rekomandimi:** SUOGJ, në bashkëpunim MSHMS, të marrin masa që të plotësojnë strukturën e auditit të brendshëm ose ristrukturimin e spitalit duke e fshirë këtë sektorë dhe mbulimin me auditim nga struktura përkatëse në Ministri.

*Menjëherë*

**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Në zbatim të rekomandimeve janë në përputhje me planin e ristrukturimit të strukturës së SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**18. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se Projekti Shëndetësia elektronike në Shqipëri, regjistri mbarë kombëtar i shëndetësisë elektronike”, është financuar nga Qeveria e Austrisë nëpërmjet QKB në shumë 13,995,000 Euro e dhënë në formë huas së butë, ndërsa kostos lokale, TVSh-në, taksën doganore etj. do të përballohen nga pala shqiptare. Objekti kryesor i projektit është, zhvillimi i një sistemi të integruar të rekordeve elektronike shëndetësore mbarëkombëtare që përmbush kërkesat kryesore operacionale të profesionistëve në të gjithë spitalet dhe politikat në Shqipëri. Gjithsej do të jetë 79 institucione publike të cilat do të jenë në sistemin e integruar. Me urdhrin e brendshëm nr. 1194/2, datë 20.10.2015, Drejtori i Spitalit, ka ngjitur komisionin e marrjes në dorëzim të pajisjeve të projektit, urdhër ky i cili ka dal me 4 . Ky komision ka hartuar procesverbalin e marrjes në dorëzim dhe aktin e kolaudimit në datë 23.10.2015 ose 4 muaj pas ardhjes dhe instalimit të pajisjeve. Veprimet dhe mosveprimet e grupit të ngarkuar për verifikimin e pajisjeve janë në kundërshtim me pikat 42-50 të seksionit “Marrja ne dorëzim e aktiveve të furnizuara” të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Pajisjet e sistemit janë bërë hyrje në magazinën e spitalit me fletë hyrjen nr. 28/1, datë 23.10.2015 ose me 4 muaj vonesë veprim ky në kundërshtim me pikë 39 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, “Çdo hyrje-dalje në magazinë dokumentohet menjëherë”. Gjithashtu konstatohet se pajisjet në Spital kanë mbërritur pa asnjë dokument shoqërues nga magazinat e Infosoft-it. Sistemi elektronik nuk është implementuar, ndonëse për këtë qendër është lëshuar dhe certifikata COHO, e cila nënkupton instalimin, testimin dhe funksionimin e projektit në këtë qendër. Tre PC e përcaktuar për sistemin nuk janë të instaluar dhe qëndrojnë bashke me pjesët e tjera të sistemit në sallën e serverit. Sipas certifikatës COHO të lëshuar për këtë qendër sistemi ka qenë në funksion që në datën 19.06.2015. Arsyeja e mos vendosjes në funksionim të projekti e-Health është se kjo qendër ka pas dhe ka një sistem elektronik të brendshëm (Astraia) të hedhjes së të dhënave dhe aplikimi i të dy sistemeve njëkohësisht krijonte bllokimin e sistemit ekzistues. Në kontratën e blerjes është përcaktuar se për këto raste kur qendra (site) ka një program elektronik ekzistues duhet që nga shitësi të bëhet ndërlidhja e tyre me qëllim që të dhënat të ruhen edhe në projektin e-Health, gjë e cila nuk është bërë për rastin konkret. Pra program e-Health nuk funksionon në spitalin gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”. Gjithashtu , u konstatua se COHO për këtë site është datë 19.06.2015, ndërsa me shkresën nr. 754/1 datë 8.09.2015 afërsisht 3 muaj më vonë, është firmos certifikata COI me ndryshim të listës së pajisjeve, në një kohë që programi e-Health nuk funksiononte në këtë qendër. Nuk ka asnjë dokument që të tregoj arsyet e

ndryshimeve të listës së pajisjeve. Deri në fund të periudhës së auditimit asnjë prej vizitave që kryheshin në këtë qendër nuk hidheshin në sistemin e-Health. Vlera e pajisjeve që janë përfituar nga projekti është 11,360,597 lekë dhe mos vendosja e tyre në punë për qëllimin që janë përfituar përbën efekt financiar negativ. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 11 faqet nr. 38-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**18.1 Rekomandimi:** SUOGJ në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të marrin masa që të vendosin në funksionim sistemin e E-Health me qëllim integrimin e të dhënave shëndetësore të pacientëve në sistemin shëndetësor kombëtar.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Në zbatim të rekomandimeve, në SUOGJ, sistemi e E-Health është në proces implementimi të dhënash

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

### **3.8. UJËSJELLËS KANALIZIME SARANDË SH.A.**

#### **A. PËRMBLEDHJE**

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 702/1 Prot, datë 04.08.2023, me objekt: “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022”.

Auditimi është kryer nga:

*E.K*

*K.G*

Periudha e auditimit: 01.01.2022 – 31.12.2022

Afati i auditimit: 07.08.2023 - 08.09.2023

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të lartë të shtetit ” dhe të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH, Nr. 1, datë 04.11.2016, “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacion që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit rekomandimeve të KLSH ”.

Duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së, të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2022, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjektet e audituara, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike, të akteve administrative të nevojshme, si vendime e urdhra për zbatimin e masave organizative;
- Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

#### **B. HYRJA**

Përfaqësuesit e autorizuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit, audituesit E.K dhe K.G, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna në Ujësjellës Kanalizime Sarandë sh.a., u informuan mbi ecurinë e zbatimit të tyre nga z. A.G në cilësinë e Administratorit të Ujësjellës Kanalizime Sarandë sh.a.

Objekti i këtij Raporti Përfundimtar është zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në subjektin Ujësjellës Kanalizime Sarandë sh.a.

### C. REZULTATET E AUDITIMIT

Nga zbatim të programit të auditimit u verifikua dokumentacioni si më poshtë:

Raporti Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Ujësjellës Kanalizime Sarandë sh.a.;

Shkresa përcjellëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, administruar në KLSH me nr. prot., datë, administruar në shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Sarandë me nr., prot., datë; etj.

Nga auditimi rezulton se:

#### **I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.**

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ujësjellës Kanalizime Sarandë sh.a., ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 248/4 prot., datë 20.10.2022 duke respektuar kështu afatin 20 ditor të dërgimit.

#### **II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.**

-Në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, Ujësjellës Kanalizime Sarandë sh.a., ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 106 prot., datë 25.04.2023 duke respektuar kështu afatin 6 mujor të dërgimit.

#### **III. Rekomandimet e KLSH**

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit në Ujësjellës Kanalizime Sarandë sh.a. janë rekomanduar gjithsej:

a. Janë rekomanduar 20 **masa organizative**;

b. Janë rekomanduar 2 **masa për shpërblim dëmi në vlerën 486,000 lekë**;

c. Janë rekomanduar 5 **masa për përdorimin me shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 141,223 euro + 104,890,174lekë**;

#### **IV. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH**

Sipas shkresës së administruar në Ujësjellës Kanalizime Sarandë sh.a., me nr. 248/4 prot., datë 20.10.2022, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar Plotësisht	Pa pranuar
1	Organizative	23 masa	23 masa	0
2	Shpërblim dëmi	2 masa	2 masa	0
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	5 masa	5 masa	0

#### **V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranura nga ana e subjektit**

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	23masa	4		19	
2	Shpërblim dëmi	2 masa			2	
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	6 masa	2		2	2

Në mënyrë të analitike statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

## MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e kaluar, janë rekomanduar gjithsej 43 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 16 masa, janë zbatuar pjesërisht 2 masa, janë në proces zbatimi 18 masa dhe të pa realizuara janë 7 masa. Janë rekomanduar 5 masa shpërblim dëmi me vlerë 711,556 lekë, nga të cilat janë zbatuar 2 masa me vlerë 78,106 lekë, 1 masë me vlerë 60,169 lekë është në proces zbatimi dhe 2 masa me vlerë 194,480 lekë janë realizuar pjesërisht duke arkëtuar vlerën 143,189 lekë. Janë rekomanduar 4 masa për eliminimin e efekteve negative me vlerë 15,933,150 lekë, nga të cilat janë zbatuar 2 masa dhe nuk janë zbatuar 2 masa të tjera. Janë rekomanduar 9 masa disiplinore, nga të cilat janë zbatuar 8 masa dhe nuk është zbatuar 1 masë. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa “j”.

(Më hollësisht trajtuar në Pikën 1, faqe 13-15, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** UK SHA Sarandë, të marrë masa për realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, për 27 masa organizative, 3 masa shpërblim dëmi, 2 masa për eliminimin e efekteve negative si dhe një masë disiplinore, me synim përmirësimin e situatës dhe rritjen e performancës së shoqërisë.

*Në vijimësi*

Statusi i pranimit: Pranuar

Përgjigje nga subjekti:

Lidhur me rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm, nga ana jonë janë marrë në konsideratë rekomandimet e lëna, për të cilat po punohet në vijimësi për përmirësimin e situatës dhe rritjen e performancës së shoqërisë, nisur edhe nga procesi i ristrukturimit, dhe kalimit të aktivitetit, aktiveve, kërkesave të arkëtueshme dhe detyrimeve në Shoqërinë Rajonale Ujësjetëlës Kanalizime Sarandë sh.a.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**2. Gjetje nga auditimi:** Për vitet 2019-2021 UK SHA Sarandë nuk ka rinovuar kontratën kolektive të punës me Sindikatën. Në kushte të tilla punonjësit marrëdhëniet e punës me Shoqërinë i rregullojnë vetëm nëpërmjet kontratave individuale të punës. Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të punonjësve konkretisht në kontratat individuale të punës citohet se, “Punëmarrësi do të përfitojë shpërblimet që i takojnë sipas legjislacionit në fuqi dhe shpërblimet e tjera të përcaktuara në vendimet e organeve drejtuese të shoqërisë me kontratën kolektive në fuqi”. Kontrata kolektive e punës daton prej vitit 2009 me afat vlefshmërie deri në muajin prill të vitit 2012, pra pas vitit 2012 nuk mund të jetë referencë për kontratat individuale të punës. Kontrata kolektive e punës

konsiderohet si një marrëveshje me shkrim që ka të bëjë me kushtet e punës lidhur ndërmjet organizatave sindikale dhe punëdhënësve, në bazë të së cilës duhet të lidhen kontratat individuale të punës. Në lidhje me këtë situatë Shoqëria gjatë fillimit të vitit 2022 ka nisur bisedimet me Sindikatën për lidhjen e kontratës së re kolektive të punës por deri më datën 01.07.2022, rezulton se ende nuk është nënshkruar kontrata midis palëve, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 159, 160 dhe 161.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 4, faqe 21-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë dhe Këshilli i Administrimit të merren masa për rinovimin e kontratës kolektive të punës.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Me shkresën nr. 1663 Prot. datë 23.05.2022 dërguar nga BSPSH (Sindikata e Pavarur e Punonjesve të Ndërtimit dhe Shërbimeve Publike të Shqipërisë) jemi njoftuar se D.L është zgjedhur Kryetar i Keshillit Sindikal të Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Sarandë sh.a, duke marrë edhe mandatin e përfaqesimit.

Nga ana jone me shkresën nr. 13 Prot. date 10.01.2023, i jemi drejtuar Z. D.L , duke i kërkuar te na informoj mbi ecurine e punës së sindikates.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

**3. Gjetje nga auditimi:** Niveli i pagave i cili është aplikuar për vitet 2019-2021, nga UK SHA Sarandë nuk është miratuar specifikisht nga Asambleja Aksionare (Bashkia Sarandë). Organet drejtuese të Shoqërisë e kanë quajtur të ezauruar miratimin e nivelit të pagave vetëm me miratimin e programit ekonomik ku pjesë e tij është edhe fondi i pagave. Rezultoni se ka keq interpretim nga 64 organet drejtuese të Shoqërisë të Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve” i ndryshuar, neni 6, pika 1.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 4, faqe 21-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë dhe Këshilli i Administrimit në të ardhmen të merren masa për miratimin e nivelit të pagave nga Asambleja Aksionare (Bashkia Sarandë) duke zbatuar në këtë mënyrë detyrimet ligjore në mirë organizimin dhe mirëfunksionimin e institucionit.

**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Mbështetur në vendimin e Keshillit të Ministrave nr.302, datë 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura”, marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetllës-Kanalizime Sarandë Sh.A. datë 22.09.2022 lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkisë Sarandë, Bashkisë Delvinë, Bashkisë Finiq dhe Bashkisë Konispol, është krijuar Shoqëria Aksionare “Shoqëria Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Sarandë Sh.A”, me datë regjistrimi 28.12.2022, e cila ka filluar aktivitetin më datë 01.03.2023.

Me krijimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Sarandë Sh.A, do te behet unifikimi i pagave i cili do te kaloj per shqyrtim ne Keshillin Mbikqyres dhe do te miratohet nga Asambleja e Pergjithshme.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**



**4. Gjetje nga auditimi:** Për vitet 2019-2021, nga UK SHA Sarandë ka funksionuar rregullorja e brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e institucionit miratuar me Vendimin nr. 12, datë 28.05.2020, të Këshillit të Administrimit. Në nenin 20, të kësaj rregulloreje është përfshirë si strukturë edhe Drejtoria e Auditit të Brendshëm. Kjo strukturë nuk duhet të jetë e përfshirë në rregulloren e brendshme të Shoqërisë edhe pse kjo strukturë është vakante për arsye se në Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 3, germa “a”, dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 1, germa “b”, citohet se, “Një Shoqëri Aksionare duhet të ketë pjesë të strukturës së saj një Njësi të Auditit të Brendshëm në rast se struktura e institucionit ka përgjatë tre viteve të fundit 300 punonjës”, ndërkohë që strukturat organizative për periudhën objekt auditimi kanë qenë mesatarisht 165-170 punonjës.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 4, faqe 21-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë dhe Këshilli i Administrimit të merren masa për përditësimin e rregullores së brendshme të institucionit duke hequr nga struktura e UK SHA Sarandë Drejtorinë e Auditit të Brendshëm.

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Në zbatim të këtij rekomandimi, me vendimin nr. 14 datë 02.11.2022 të Këshillit të Administrimit është vendosur “Ndryshimin e Rregullores së Brendshme të Shoqërisë sipas rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

Rregullorja e Brendshme është përditësuar, duke u hequr nga struktura Auditit të Brendshëm.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procesit të rekrutimit të punonjësve nga UK SHA Sarandë konstatohet se, në tre raste janë punësuar punonjës pa procedurë por vetëm me urdhër të Administratorit të Shoqërisë, veprime këto në kundërshtim me Vendimin nr. 11/1, datë 24.04.2020, të Administratorit të Shoqërisë me objekt “Miratimin e procedurës për rekrutimin e punonjësve”.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 4, faqe 21-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë dhe Zyra e Burimeve Njerëzore të merren masat e duhura që rastet e emërimeve të reja të kryhen në përputhje me procedurat dhe rregullat e përcaktuara nga vetë institucioni në lidhje me procesin e rekrutimit të punonjësve.

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Me urdhërin nr. 738/8 datë 28.12.2018 të Administratorit të Shoqërisë është ngritur komisioni për rekrutimin e punonjësve.

Me vendimin nr. 11/1 date 24.04.2020 të Këshillit të Administrimit është vendosur:

1.Miratimin e procedurës për rekrutimin e punonjësve.

2.Miratimi i vlerësimit të punës vjetore për cdo punonjës sipas formularit përkatës.

3. Përcaktimi i pagave të punonjësve dhe niveli i ndarjes së klasave do të aplikohet pas marrjes së vendimit për ndryshimin e pagës së Administratorit nga Asambleja e Përgjithshme. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se Asambleja e Përgjithshme e UK SHA Sarandë me vendim nr. 2 datë 29.12.2020, ka miratuar pasqyrat financiare të vitit 2019, ku rezultati financiar i këtij viti paraqitet me fitim në vlerën 9,727,814 lekë. Sipas këtij vendimi, fitimi i shoqërisë do mbartet për investime të shoqërisë në periudhat e ardhshme, veprim i cili duhet të realizohet brenda periudhës së 6 mujorit të parë të vitit ushtrimorë. Nga UK SHA Sarandë (strukturat përgjegjëse), vendimi për alokimin e fitimit nuk është kryer brenda 6 mujorit të parë të vitit ushtrimor, veprim i cili ka çuar në penalizmin me masë gjobe 10,000 lekë nga Drejtoria rajonale Tatimore. 65 Sa më sipër është në kundërshtim me Vendimin nr. 63 datë 27.01.2016, neni 6, pika 4 “Asambleja e Përgjithshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve që pasojnë mbylljen e vitit financiar”, VKM nr.63 datë 27.01.2016 Neni 10, pika 1 “Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar, të drejtat dhe detyrimet Asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për: b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;”, si dhe ligjin nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar Kreu III Neni 33/1 si dhe “Strategjia për Parandalimin dhe Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura dhe Plani i Veprimit, Ministria e Financave”.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 6, faqe 31-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1. Rekomandimi:** Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë gjatë hartimit dhe miratimit të pasqyrave financiare të marrë për bazë respektimin e afateve sipas dispozitave ligjore në fuqi, si dhe në rastet kur shoqëria rezulton me fitim të periudhës duhet që pjesën më të madhe të fitimit ta përdorë për shlyerjen e detyrimeve të shoqërisë.

*Në vijimësi*

Statusi i pranimit: Pranuar

Përgjigje nga subjekti:

Në zbatim të rekomandimit të mësipërm, konfirmojmë se shoqëria UKS ka mbyllur dhe ka depozituar pranë organeve Tatimore, brenda afatit ligjor (31.03.2023), Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 01.01.2022 deri 31.12.2022 dhe do të kujdeset për respektimin e afateve për miratim në Asamblesë të Përgjithshme dhe depozitimin e tyre pranë QKB me qëllim shmangien e penaliteteve dhe rritjen e panevojshme të kostove. Shoqëria jonë qysh prej vitit 2019 deri në fund të vitit 2022, në mbyllje të aktivitetit vjetor ka rezultuar me humbje dhe si e tillë nuk mundet të bëjë shpërndarje të fitimit të cituar si më sipër. Rekomandimi do të mbahet në konsideratë në periudhat e ardhshme në se shoqëria do të rezultojë me rezultat pozitiv. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**7. Gjetje nga auditimi:** Pas verifikimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua që, arkëtimet me anë të bankës dhe arkës kanë ardhur në rënie duke rritur vlerën e zërit Të drejta të arkëtueshme. Në analizimin e zërit Të drejta të Arkëtueshme dhe nënkategorisë “Njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse Bashkia Sarandë”, vihet re vlera prej 1,041,432 lekë, shumë e cila duhet të rimbursohet nga Bashkia Sarandë mbi mbulimin e

familjeve që kanë përfituar matësit e ujit falas me anë të vendimit nr.18 datë 12.01.2018 “Për subvencionimin e lidhjes së kontratave dhe të vendosjes së matësve të ujit për kategoritë në nevojë”, por që nuk është rimbursuar dhe nuk është pasqyruar si vlerë në dy vitet pasardhëse përkatësisht 2020 dhe 202, veprime në kundërshtim me Kreun II Neni 95 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” i ndryshuar.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 6, faqe 31-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1. Rekomandimi:** Ujësjiellës Kanalizime SHA Sarandë të marrë masat që të kryejë arkëtimet në kohën e duhur sipas plan veprimit dhe natyrës së arkëtimit, duke shmangur faktorët që mund të çojnë në krijimin e borxhit të keq në shoqëri.

*Në vijimësi*

**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Sarandë sh.a ka bërë plan masash për arkëtimin e detyrimeve të abonentëve duke rritur normën e arkëtimit nga 78 % në 83-85 % dhe punon në vijimësi për arkëtimin e detyrimeve sipas planeve të veprimit dhe aksioneve të ndërmara si në drejtim të ndërgjegjësimit të abonentëve për shlyerje vullnetare të detyrimeve, duke përpiluar kontrata të likuidimit me këste po ashtu edhe duke përdorur masa shtrënguese deri në ndërprerjen e furnizimit me ujë të pijshëm të abonentëve. Nga sektori i Borxhit janë përgatitur pasqyrat përkatëse për vjetërsinë e kërkesave të arkëtueshme të ndarë sipas periudhave të krijimit të cilat janë pa shpresë arkëtimi dhe pas hartimit të relacionit do të kalojnë për shqyrtim dhe vendimarrje në mbledhjen më të afërt të Keshillit Mbikqyres të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Sarandë sha, pjese e se ciles është edhe UK Sarandë.

Gjithashtu me Vendimin e Keshillit të Administrimit nr.10 date 24.04.2020 është miratuar normë provizionimi në masën 0.5 % mbi totalin e detyrimeve me qëllim zhvlerësimin e këtyre kërkesave, shpërndarjen e riskut në periudha të ndryshme, pasqyrimin e drejtë, të vertetë e të besueshëm të tyre por edhe të ndryshimeve të fluksit të parasë. Për këtë janë bërë e bëhen analiza për debitorët dhe në veçanti për detyrimet pa shpresë arkëtimi.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

**8. Gjetje nga auditimi:** Në analizimin e zërit Të Drejta të Arkëtueshme vihet re që në nënkategorinë “Kërkesa për të arkëtuar klientë UK Finiq” përbën vlerë e cila është mbartur në vite në shumën 26,871,536 lekë ku sipas Akt- Marrëveshjes nr. 256 prot. datë 24.06.2019 bëhet i mundur dorëzimi i klientëve të Ujësjiellës Kanalizime Finiq por për vlerën e mësipërme që përbën Të drejta të arkëtueshme klientët nuk kanë përfunduar procedurat për çregjistrimin e tyre në librat kontabël. Sa më sipër është në kundërshtim me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit SKK 08.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 6, faqe 31-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1. Rekomandimi:** Ujësjiellës Kanalizime SHA Sarandë, të bëjë të mundur çregjistrimin në librat kontabël të vlerës prej 26,871,536 lekë, mbi të cilën nuk ka asnjë të drejtë mbi arkëtimin e kësaj vlere sipas Akt – Marrëveshjes nr. 256 prot., datë 24.06.2019.

*Në vijimësi*

**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Në lidhje me rekomandimin e mësipërm sqarojmë se, bazuar në VKM nr.302, datë 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura”, marrëveshjen për krijimin e Subjektit të Kompetencave të

Përbashkëta të Ujësjetllës-Kanalizime Sarandë Sh.A. datë 22.09.2022 lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkisë Sarandë, Bashkisë Delvinë, Bashkisë Finiq dhe Bashkisë Konispol, është krijuar Shoqëria Aksionere “Shoqëria Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Sarandë Sh.A”. Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Sarandë sh.a, ka përhithur përveç Ujësjetlles Kanalizime Delvine e Konispol edhe atë të Finiqit dhe do të rrimarë edhe kërkesat e arketueshme të kesaj UK duke rregulluar edhe detyrimin e mbartur në shumën e cituar në këtë rekomandim.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**9. Gjetje nga auditimi:** Në analizimin e zërit Detyrime Afatshkurtra dhe nënkategorisë “Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit” vihet re një rritje në vlerë e këtij zëri që përbëhet nga detyrime ndaj Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës në procedura prokurimi, detyrime ndaj OSHEE përkatësisht gjatë vitit 2019 në vlerën 47,495,662 lekë, gjatë vitit 2020 në vlerën 75,805,518 dhe gjatë vitit 2021 në vlerën 114,177,051 lekë. Në analizimin e zërit Detyrime Afatshkurtra dhe nënkategorisë “Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore” përfshihen detyrimet e muajit dhjetor. Në analizimin e zërit Detyrime Afatgjata dhe në nënkategorinë “Titujt e huamarrjes” përfaqësohet nga dy kredi afatgjata, Kredia IDA në vlerën 1,390,000 SDR dhe Kredia-KFŴ në vlerën 3,566,840 Euro të konvertuara me kursin e ditës për vitet përkatëse. Sipas Marrëveshjes së nën-huas në UK SHA Sarandë, do të investohej shuma prej 1,390,000 SDR e barabartë me 1,954,443 USD. Ndërsa sipas rakordimit me Ministrinë e Financave në 31.12.2017, vlera e disbursuar paraqitet në shumën 2,530,820.86 USD, ndërsa vlera e kredisë sipas Marrëveshjes së nën-huas e shprehur në dollarë është 1,954,443 USD, me një mos rakordim në shumën 576,377 USD. Me dokumentacion është justifikuar përdorimi i fondeve në vlerën 133,040,349 lekë, ndërsa vlera e financimit e shprehur në lekë në datë 07.07.2003 është 233,408,800 lekë. Për diferencën në 100,368,451 lekë, nga zbatuesi i projektit (DPUK/AKUK) nuk është paraqitur dokumentacion justifikues (pranë UK SHA Sarandë) sipas natyrës së shpenzimeve të kryera në kuadër të këtij projekti. Theksojmë se, kjo problematikë është konstatuar edhe në auditimin e mëparshëm të zhvilluar nga KLSH. Në analizimin e zërit Detyrime Afatgjata dhe në nënkategorinë “Detyrime ndaj institucioneve të kredisë”, janë interesat e llogaritura dhe të papaguara ndaj dy kredive të mësipërme në përkatësisht për Kredinë IDA në vlerën 303,064 USD dhe për Kredinë KFŴ në vlerën 466,168 Euro të konvertuara me kursin e ditës së mbylljes së bilancit. Sa më sipër është në kundërshtim me Strategjinë për Parandalimin dhe Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura dhe Plani i Veprimt, Ministria e Financave.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 6, faqe 31-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1. Rekomandimi:** Ujësjetllës Kanalizime SHA Sarandë, të marrë masat mbi likuidimin e detyrimeve të prapambetura ku mund të vazhdojnë të ndjekin grafikun e pagesave sipas planifikimit, duke respektuar parimin e kohës së krijimit të detyrimit sipas natyrës së shpenzimit.

*Në vijimësi*

### **Përgjigje nga subjekti:**

Në zbatim të këtij rekomandimi shoqëria ka marre masa për likuidimin në kohë sipas kushteve kontraktuale të detyrimeve ndaj të tretëve . Kjo duket edhe në faktin se këto detyrime në fund të periudhes ushtrimore viti 2022 janë ulur në krahasim me vitin paraardhës në shumën 5,505,453 lekë. Vlen të përmendet fakti se edhe detyrimet e FSHU te cilat zënë 75 % të totalit

të këtyre detyrimeve nuk janë rritur pasi për gjatë vitit 2022 janë likuajduar të gjitha detyrimet duke mos krijuar detyrime të reja.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**9.2. Rekomandimi:** Ujësjetllës Kanalizime Sarandë sh.a, të marrë masat mbi zgjidhjen e problematikës mbi mos rakordimin e vlerës prej 576,377 USD, midis Akt marrëveshjes së nënhuasë IDA dhe Ministrisë së Financave, gjë e cila ndikon në llogaritjen e interesave dhe në mënyrën se si janë përdorur fondet.

*Në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Në zbatim të këtij rekomandimi, Administratori Shoqërisë me shkresën nr.13 prot. datë 11.01.2019 kërkon nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, AKUM dhe PIU –t të Ujit të na vihen në dispozicion të gjitha dokumentat përkatëse si, situacione punimesh, fatura etj.

Pas kësaj, me shkresën e AKUM-it nr. 3097 prot. datë 31.10.2018 është bërë e mundur dërgimi i situacioneve dhe faturave përkatëse si dhe është bërë rakordimi dhe saktësimi i shumave të kredisë IDA. Me shkresën e Ministrisë Financave, Drejtorisë Strategjike dhe Monitorimit të Borxhit Nr. 814 Prot. Date 18.01.2019 nga rakordimi perfundimtar me AKUM është bere saktësim shume i detyrimit nga 2,530,820,86 USD duke u ulur në vlerën 2,186,718.91 USD.

Jemi në proces saktësim asetesh, materiale, e punime të ndryshme me qëllim inventarizimin, saktësimin e shumave dhe marrjen në kontabilitet të tyre.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**10. Gjetje nga auditimi:** Në analizimin e zërit Aktive Afatgjata dhe nënkategorisë “Parapagime për aktive materiale dhe në proces” ku përfshihet një investim “Itun” në vlerën 287,042,569 lekë, ku pasqyrohet si investim i papërfunduar. Kjo vlerë i përket investimit me objekt “Infrastruktura Ujore e Bashkisë”, sipas raportit të hartuar nga UKS SHA, nuk është marrë në dorëzim për shkak të mosplotësimit të parametrave teknikë të parashikuar në kontratë. Përsa i përket investimit të papërfunduar me objekt “Infrastruktura Ujore e Bashkisë” në vlerën 319,591,667 lekë dhe regjistrimit të tij si llogari jashtë bilanci, është rezultat i faktit se UKS SHA është përfituese e investimit me objekt “Infrastruktura Ujore e Bashkisë”. Ky projekt sipas Drejtorisë së 67 Përgjithshme të Ujësjetllës Kanalizime (DPUK) sot Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizime (AKUK) ka përfunduar më datë 31.12.2011, bazuar në kontratën së lidhur më datë 24.01.2007 ndërmjet Kontraktorit “P. & F. Srl” (Itali) dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) për ndërtimin e tre impianteve të pastrimit, ku është përfshirë edhe Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN) Sarandë. Sipas shkresës nr. 1820, datë 24.07.2014 të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës Kanalizime (sot Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizime) vlera e financimit është në shumën 3,877,126 EUR. Me shkresën nr. 1820, datë 24.07.2014, protokolluar në UKS SHA me nr. 170, datë 10.09.2014 është cilësuar se: - Nga koha e përfundimit të kontratës 31.12.2011 deri në 24.07.2014, UKS SHA është ngarkuar nga ministria e linjës për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e impiantit deri në përfundim të lidhjes së tyre me rrjetet përkatëse të kanalizimeve. - PIU i Ujit në ministrinë e linjës kërkon nga UKS SHA si përfitues që të marrë në dorëzim objektin. - Me shkresën nr. 170/1, datë 15.09.2014 të

Administratorit të UKS SHA, i është kthyer përgjigje Ministrisë, ku është relatuar se objekti nuk mund të merret në dorëzim, pasi mbart problematika të shumta të cilat kanë sjellë mosfunksionimin e tij. - Me shkresat nr. 198, datë 21.06.2016 dhe 230/1, datë 15.07.2016 drejtuar DPUK/AKUK, nga ana e Administratorit, është bërë me dije se “Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura” ITUN, nuk është në funksion për shkaqet të cilat janë bërë prezent me shkresën nr. 170/1, datë 15.09.2014. Theksojmë se vlera totale e financimit për këtë investim është në shumën 3,877,126.92 EUR, nga e cila vlera e kredisë është 2,403,848 EUR (referuar MF). Ky investim nuk është marrë në dorëzim dhe nuk është vënë në përdorim për shkak të mosplotësimit të një sërë komponentësh të kësaj kontrate si: Tubacionet e dërgimit të ujërave kanë rezultuar me çarje; Impianti nuk është vendosur asnjëherë në punë dhe pjesa më e madhe e pajisjeve nuk punojnë; Pompa e furnizimit me ujë të impiantit nuk punon; Pajisjet e pastrimit të grilave nuk punojnë etj.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 6, faqe 31-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1. Rekomandimi:** Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Administrimit dhe Administratori i UKS sh.a., duhet të marrin në analizë këtë situatë, të bëjnë me dije strukturat të cilat kanë përgjegjësinë për këtë investim, si Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve dhe PIU Ujit, për mosfunksionimin e Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura Sarandë, për shkak të dështimit të këtij investimi dhe obligimit të UKS SHA për shlyerjen e detyrimeve të kredisë të marrë për këtë qëllim. UKS sh.a. të kërkojë nga Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve që në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe PIU i Ujit, si kontraktuese me kompaninë zbatuese, të marrin masa të menjëhershme për përfundimin e këtij investimi brenda kostos së parashikuar dhe sipas parametrave teknikë të përcaktuar në kontratë, me qëllim vënien në funksionim të ITUN Sarandë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Në zbatim të rekomandimit të lartpërmendur, konfirmojme se ITUN është në funksion dhe zhvillon aktivitetin e tij qysh prej mbarimit të investimit, pavarësisht problematikave që kishte pasur, të cilat nuk pengonin aktivitetin kryesor. Po ashtu Administratori Shoqërisë UKS sh.a, me shkresën nr.13 Prot. datë 11.01.2019 i kërkon Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës, Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, AKUM dhe PIU –t të Ujit, të na vihen në dispozicion të gjitha dokumentat përkatëse, si situacione punimesh, fatura etj.

Pas kësaj, me shkresën e AKUM-it nr. 3097 prot. datë 31.10.2018 është bërë e mundur dërgimi i situacioneve dhe faturave përkatëse, informacione që nuk ka qene i plote pasi nuk kemi pasur dokumentat kryesore të marrjes në dorëzim si, proces verbal marrje dorezim dhe Akt kolaudimi.

Po ashtu kemi komunikuar nepermjet e-mail me perfaqesuesin e PIU te Ujit i cili ka ndjekur investimet e kryera per ITUN, nga i cili na është vënë në dispozicion dokumentacioni i nevojshëm për të cilat jami ne proces saktësimi për marrjen në kontabilitet gjatë viti 2023. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**11. Gjetje nga auditimi:** UK SHA Sarandë nuk ka hartuar apo miratuar ndryshime të programeve ekonomiko-financiare, shoqëruar me relacion shpjegues të faktorëve të paparashikuar të cilët për vitet 2019, 2020 dhe 2021, kanë çuar në tejkalim të investimeve dhe të disa zërave të shpenzimeve, krahasuar me programin e miratuar, nuk ka bërë një analizë të detajuar të numrit të operatorëve që janë pajisur ose nuk janë pajisur me matës, një analizë të detajuar mbi humbjet teknike ose ato

ekonomike menaxheriale, një analizë të detajuar mbi debitorët dhe gjendjen e likuidimit nga ana e 68 tyre. Mungojnë Programet Ekonomike Afatmesme PBA dhe Programet Ekonomike Afatgjata, mungon plani 5 vjeçar për përmirësimin e performancës dhe plani i biznesit, mungojnë raportimet mbi zbatimin e buxhetit për çdo tremujor në AKUM. Nga sa më sipër rezulton se është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, si dhe Udhëzimin nr. 15 datë 02.02.2018 “Mbi programet e zhvillimi ekonomik të shoqërive tregtare me kapital Shtetëror”.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 3, faqe 18-20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1. Rekomandimi:** Ujësjiellës Kanalizime SHA Sarandë, të marrë masat për programimin e buxheteve afat mesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore. Gjithashtu, të merren masat e nevojshme për programimin në buxhetin e vitit ushtrimor, shlyerja e të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguar si dhe mbledhja e të gjitha detyrimeve nga ana e debitorëve.

*Në vijimësi*

**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Në zbatim të këtij rekomandimi konfirmojmë se janë hartuar planet financiare vjetore të shoqërise.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimeve të kryera me bankë konstatohet se: -Në 20 raste urdhrat për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzimit të mallrave dhe procesverbalet e marrjes së mallrave apo shërbimeve në dorëzim janë të pa protokolluara. -Në 10 raste konstatohen vonesa në likuidimin e operatorëve ekonomikë duke mos respektuar afatet e parashikuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare”, neni 7. Kjo situatë ka ndodhur përgjatë vitit 2021, ku likuidimi i tyre është kryer përgjatë tre mujorit të parë të vitit 2022. Mos likuidimi në kohë i faturave pjesore apo përfundimtare ndaj operatorëve ekonomikë shkakton risk për krijimin e detyrimeve ndaj operatorëve ekonomikë. -Në 20 raste në setin e dokumentacionit justifikues dhe plotësues të bankës, bashkëlidhur nuk ndodheshin autorizimi i shpenzimit, urdhra blerje, kontratat e lidhura ndërmjet palëve si dhe faturat tatimore nuk janë origjinale por fotokopje, si dhe urdhër xhirimet e transaksioneve të kryera për likuidimin e shpenzimeve. Dokumentacioni i mësipërm u plotësua gjatë auditimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare”, neni 7, pika c, germa “i”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 19, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, germa “b” dhe Normën Teknike Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 5, faqe 25-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1. Rekomandimi:** Nga Drejtoria Tregtare të merren masa në të ardhmen për plotësimin dhe sistemimin në mënyrë kronologjike të dokumentacionit justifikues, bashkëlidhur veprimeve të kryera me bankë në zbatim të përcaktimeve të dispozitave ligjore përkatëse.

**Përgjigje nga subjekti:**

Në zbatim të këtij rekomandimi konfirmojmë se janë hartuar planet financiare vjetore të shoqërisë.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**12.2. Rekomandimi:** Administratori i Shoqërisë dhe Drejtoria Tregtare të marrë masa për likuidimin në kohë të furnitorëve sipas afateve të përcaktuara në kontratat dypalëshe ndërmjet tyre me qëllim shmangien e penaliteteve të mundshme.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Në zbatim të këtij rekomandimi shoqëria ka marrë masa për likuidimin në kohë sipas kushteve kontraktuale të detyrimeve ndaj të tretëve. Kjo duket edhe në faktin se këto detyrime në fund të periudhës ushtrimore Viti 2022 janë ulur në krahasim me vitin paraardhës në shumën 5,505,453 lekë. Vlen të përmendet fakti se edhe detyrimet e FSHU të cilat zënë 75 % të totalit të këtyre detyrimeve nuk janë rritur, pasi për gjatë vitit 2022 janë likuiduar të gjitha detyrimet duke mos krijuar detyrime të reja.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me zgjedhje i shpenzimeve për konsumin e karburantit për 9 mjete ose në masën 39.1% të konsumit, konstatohet se me Vendimin nr. 8/1, datë 24.03.2020, të Këshillit Mbikëqyrës janë miratuar normativat për konsumin e karburantit. Ky vendim nuk përfshin periudhën nga data 01.01.2019, deri më datën 23.03.2020, pra mjetet e shoqërisë nuk kanë pasur normativa të miratuara mbi konsumin e karburantit. Shpërndarjen e karburantit për mjetet e saj Shoqëria e realizon nëpërmjet sistemit të tollonave duke u bazuar në kërkesat apo autorizimet ditore të çdo drejtorie, përmes daljes nga magazina sipas fletë-daljeve respektive. Referuar procesit të shpërndarjes që aplikon Shoqëria rezulton se nuk ka një planifikim mujor apo vjetor ku të ketë një plan shpërndarje për çdo sektor, degë apo drejtori. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për këto mjete nuk janë mbajtur kartelat përkatëse në të cilat regjistrohen të gjitha të dhënat e automjetit si dhe shpenzimet që do të kryhen për to, gjithashtu nuk është i evidentuar kilometrazhi i tyre në fillim të vitit dhe në fund të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra, karburant, riparime etj. Këto shpenzime nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi për mirëmbajtjen e tyre. Shpenzimet për konsumin e karburantit mbahen në dosjen e mjetit nga drejtuesi i automjetit ku pjesë përbërëse e dosjes janë edhe urdhri për përdorimin e mjetit, siguracioni vjetor, leje qarkullimi, kontrolli teknik (kolaudimi për të gjitha mjetet ndodhet vetëm i vitit 2022), kërkesat dhe autorizimi për lëvizjen e mjetit, fletëdalja nga magazina dhe fletë-udhëtimi. Mbi dokumentacionin justifikues: -Në rubrikën e parë “Fletë-udhëtimi” përcaktohet tipi i mjetit, personi i cili e ka në ngarkim mjetin (shoferi) nënshkruar prej tij dhe autorizuesit (drejtori, përgjegjësi i sektorit, përgjegjësi i manovrimit sipas rastit) nënshkruar prej tij si dhe sasia e tërhequr e karburantit nga magazina sipas datave përkatëse. -Në rubrikën e dytë “Fletë udhëtimi për nevojat e sektorëve” është pasqyruar lëvizja në total mujore për mjetin të nënshkruara nga drejtuesi i mjetit dhe përgjegjësi i sektorit përkatës. Pjesë e kësaj praktike të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr. 8/1, datë 24.03.2020, janë edhe të dhënat që duhet plotësuar, pra sa është kilometrazhi në fillim të lëvizjes dhe sa është kilometrazhi në fund të lëvizjes së mjetit. Ndërkohë që, nga drejtuesit e mjeteve regjistrohen në këtë rubrikë



vetëm kilometrat e përshkuara në total. Në lidhje me situatën e konstatuar të sipërpërmendur nga organet drejtuese të Shoqërisë nuk ka të përcaktuar një udhëzim, manual dhe rregulla ku të jetë pjesë e Rregullores së Brendshme në të cilën të përcaktohet mënyra e funksionimit, monitorimit dhe organizimit të procesit së shpërndarjes dhe konsumit/realizimit të karburantit për mjetet e Shoqërisë si dhe në të, të përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësitë respektive sipas drejtorive dhe sektorëve, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 19, neni 22, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 5, 10, 19 dhe 36.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 5, faqe 25-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1. Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Tregtare dhe Drejtoria Teknike të merren masa për të hartuar kartelat përkatëse të automjeteve, ku të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet e automjeteve.

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Në zbatim të rekomandimit të mësipërm konfirmojmë se Drejtoria Tregtare dhe ajo Teknike ka bërë të mundur celjen e kartelave të automjeteve në të cilat janë evidentuar të dhënat teknike dhe pjesërisht shpenzimet e kryera për to. Në vijimësi do të plotësohen me të gjitha llojet e punimeve për mirëmbajtjen e tyre.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**13.2. Rekomandimi:** Nga organet drejtuese të Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për hartimin e rregullave në të cilën të përcaktohet mënyra e funksionimit, monitorimit dhe organizimit të procesit së shpërndarjes dhe konsumit/realizimit të karburantit për mjetet e shoqërisë si dhe të përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësitë respektive sipas drejtorive dhe sektorëve përkatës.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Në zbatim të këtij rekomandimi Organet drejtuese të shoqërisë kanë marrë masat përkatëse. Kështu me shkresën nr. 755/1 Prot. Datë 28.12.2018 është gritur grupi i punës për hartimin e rregullave për të përcaktuar mënyrën e funksionimit, monitorimit dhe organizimit të procesit së shpërndarjes dhe konsumit të karburantit për mjetet e shoqërisë si dhe të përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësitë respektive sipas drejtorive dhe sektorëve përkatës. Për sa sipër është hartuar procedura për këtë qëllim e cila është miratuar me Vendimin e Këshillit të Administrimit Nr.8/1Prot., datë 24.03.2020

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me zgjedhje i procedurave të blerjeve të vogla konstatohet se:

-Në 3 raste për vitet 2019-2021 janë realizuar 6 procedura prokurimi me vlera të vogla duke shmangur procedurat normale të prokurimit nga copëzimi i fondin limit, pra këto procedura duhet të kryheshin me procedurë me vlera të larta. -Në 21 raste nuk dokumentohet kërkesa nga sektorët përkatës për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit, adresuar personit përgjegjës të

prokurimit i cili duhet të administrojë dokumentacionin e çdo procedure prokurimi. -Në 14 raste nuk argumentohet mënyra e përlllogaritjes së këtij fondi. -Në 21 raste fatura tatimore nuk është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit. -Në 21 raste urdhri i prokurimit, urdhri për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave, procesverbalet për marrjen në dorëzim të mallrave nuk janë të protokolluara, si dhe dosjet e përzgjedhura për auditim nuk janë të inventarizuara dhe të arkivuara, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 40, pika 3, neni 40, pika 1 dhe 8 dhe 59, pika 2, Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” i ndryshuar, pika 19 si dhe neni 3 dhe 29 të “Normën Teknike Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 5, faqe 25-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1. Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë, Drejtoria Tregtare dhe Zyra Juridike të merren masa që: -Në hartimin e regjistrave të parashikimeve të prokurimeve, të shmanget procedura e copëzimit të fondeve për të njëjtin grup mallrash apo shërbimesh; -Të dokumentohet kërkesa nga sektorët përkatës për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit; -Të argumentohet dhe dokumentohet mënyra e përlllogaritjes së fondit limit; -Për çdo rast faturat tatimore të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e komisionit në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi; - Të bëhet arkivimi i dosjeve të procedurave të prokurimit për të gjitha rastet e mbylljes së procedurës deri në zbatimin e kontratës.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Statusi i pranimit: Pranu

Përgjigje nga subjekti:

Në zbatim të këtij rekomandimi, në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2023 është mbajtur në konsideratë dhe nuk është bërë asnjë copëzim fondi, por në bazë të kërkesave të ardhura nga sektoret përkatës janë miratuar procedura prokurimi të domosdoshme për mire funksionimin e Shoqërisë. Me përfundimin e procedurave të prokurimit është bërë edhe arkivimi i dosjeve.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**15. Gjetje nga auditimi:** Për procedurën e prokurimit “Ndërtim i sistemit të KUZ, rrjet sekondar dhe tercial, Ksamil” fondi limit është përlllogaritur me vlerë 81,947,188 lekë. Nga verifikimi i çmimeve të aplikuara krahasuar me manualët e çmimeve të ndërtimit rezulton se ka mangësi. Nga rillogaritja, rezulton se fondi limit duhet të ishte me vlerë 81,769,833 lekë. Për procedurën e prokurimit “Ndërtim i KUZ Lugu i Dardhës”, fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerë 103,940 lekë. Për procedurën e prokurimit “Përmirësim i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura, Rr. 13 Bibilenjtë, Rr. Abedin Dino, ...” fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerë 177,355 lekë. Për procedurën e prokurimit “Ndërtim rrjet kanalizimi të ujërave të zeza mbi rrugën nr. 5, Lagje nr. 3, Sarandë”, fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerë 162,778 lekë. Kontratat përkatëse janë nënshkruar me vlera më të vogla se fondi limit i rillogaritur. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Pika 2. 71

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 7, faqe 39-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1. Rekomandimi:** Komisionet e përlllogaritjes së fondit limit, duhet të aplikojnë çmime me referenca të sakta të manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit. Në rastet kur çmimi i referencës nuk është pjesë e çmimeve të manualit, atëherë duhet të merren për referencë çmimet e zërave më të përfaqësues, ose duke hartuar analiza të sakta të kostos.

*Në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Në procedurat e prokurimit të zhvilluara në vazhdimësi, përlllogaritja e fondit limit është argumentuar, duke u marr për bazë çmimet e përcaktuara në manualin teknik, punë të ngjashme të kryera (çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga vete apo Autoritete të tjera kontraktore), ose studim tregu, bazuar në mesataren e çmimeve të mara nga ky studim. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**16. Gjetje nga auditimi:** Për zbatimin e procedurës së prokurimit “Blerje e dy automjeteve për nevoja të shoqërisë”, është aplikuar lloji i procedurës “Kërkesë për propozim”. Janë bërë ftesa për pjesëmarrje në procedurën e auditimit për tre OE, të cilët operojnë në fushën e tregtimit të automjeteve dhe jo në pesë OE sa duhet të ishin ftuar sipas kuadrit ligjor e rregullator të prokurimit publik. Konkretisht ky veprim është në kundërshtim me Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (shfuqizuar), neni 46, neni 34, pika 1.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 7, faqe 39-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**16.1. Rekomandimi:** Njësia e prokurimit, sipas rastit dhe procedurave, të respektojë kërkesat ligjore për njoftimin e operatorëve ekonomikë minimalisht në numrin e përcaktuar, me synim sigurimin e një pjesëmarrje sa më të gjerë. Operatorët ekonomikë që ftohen të marrin pjesë në këto procedura, duhet të ndryshohen sa më shumë të jetë e mundur.

*Në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Është mbajtur në konsideratë në të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**17. Gjetje nga auditimi:** Në dokumentet e tenderit sipas procedurës së prokurimit “Ndërtim i sistemit të KUZ, rrjet sekondar dhe tercial, Ksamil”, janë përcaktuar si kritere s’kualifikuese: Disponim licencë sipas pikës N.P 12 “Punime të inxhinierisë mjedisore”. Është kërkuar që OE të ketë drejtues teknik për pozicionin inxhinier mjedisi. Janë kërkuar 4 manovratorë dhe 2 makinistëve, pa marrë në konsideratë faktin se OE mund të ketë kontratë qiraje me OE tjetër për mekanizma dhe automjete. Është vendosur kriteri për disponimin e lejes mjedisore me kod III.2.B “Grumbullim dhe transportim të mbetjeve jo të rrezikshme, në selinë e ushtrimit të aktivitetit”. Në dokumentet e tenderit sipas procedurës së prokurimit “Ndërtim KUZ Lugu i Dardhës”, janë përcaktuar si kritere s’kualifikuese:

-Disponimin e lejes mjedisore me kod III.2.B “Grumbullim dhe transportim të mbetjeve jo të rrezikshme, në selinë e ushtrimit të aktivitetit” - Është kërkuar disponim ose marrje me qira ekskavator me goma dhe ekskavator me zinxhirë, ndërkohë që punimet janë përcaktuar të realizohen vetëm me ekskavator me zinxhirë. Në dokumentet e tenderit sipas procedurës së prokurimit “Përmirësim i KUZ Sarandë (Sarandë ITUN, Bypass dhe vendosje saraçineska

manovrimi, ajrujes)”, janë përcaktuar si kritere s’kualifikuese: - Disponimi ose marrja me qira e një ngjeshësi hidroelektrik (ndërkohë që është kërkuar edhe rul ngjeshës). - Kërkohe disponimi ose marrja me qira ekskavator me zinxhir si dhe skrep/fadromë, ndërkohë që punimet e gërmimit i përkasin vetëm ekskavatorit me goma. - Është kërkuar pjesëmarrja në takim në ambientet e shoqërisë. Mos pjesëmarrja është përcaktuar si kriter s’kualifikues, ndërkohë që nuk kemi të bëjmë me një kontratë të ndërlikuar për të cilën është domosdoshmëri njohja me objektin. Në dokumentet e tenderit sipas procedurës së prokurimit “Ndërtim rrjet kanalizimi të ujërave të zeza mbi rrugën nr. 5, Lagje nr. 3, Sarandë”, janë përcaktuar si kritere s’kualifikuese: -Disponim licence sipas kategorisë NP.12, klasifikimi A, “Punime të inxhinierisë së mjedisit”. - Disponimin e lejes mjedisore me kod III.2.B “Grumbullim dhe transportim të mbetjeve jo të rrezikshme, në selinë e ushtrimit të aktivitetit”. - Është kërkuar disponimi i mekanizimit bobcat, ndërkohë që ka disa lloje mekanizmash që kryejnë të njëjtën punë dhe kanë të njëjtat specifika, por që nuk janë të markës bobcat. - Është kërkuar që OE të kenë në pronësi ose me qira skrep, 2 ekskavator me goma, një sharrë për punim metali, depozitë për grumbullim materiale, pirun dhe helikopter nivelimi. Punimet e gërmimit janë parashikuar me ekskavator me zinxhirë dhe në asnjë rast me ekskavator me goma. Punimet e realizimit të sipërfaqeve të lëmuara me helikopter nuk janë parashikuar në preventiv, madje seksionet e betonit, nuk duhet të jenë të lëmuara, pasi paraqet rrezikshmëri për qarkullimin e automjeteve. Në dokumentet e tenderit sipas procedurës së prokurimit “Mirëmbajtja dhe riparimi i elektropompave të stacioneve të pompimit”, janë përcaktuar si kritere s’kualifikues disponimit të licencës profesionale “NP-7A, Ujësjetës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje”, kriter i cili nuk lidhet ngusht me natyrën dhe volumin e kontratës. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (shfuqizuar) neni 26, pika 5, ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 77, pika 1.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 7, faqe 39-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**17.1. Rekomandimi:** Njësia e prokurimit apo komisioni i ngarkuar, duhet të argumentojnë kriteret e kualifikimit që vendosen në procedurat e prokurimit, duke patur në konsideratë natyrën dhe volumin e kontratës, me synim shmangien e kritereve që krijojnë kufizime për pjesëmarrësit, si dhe krijimin e mundësisë për pjesëmarrje sa më të lartë të biznesit të vogël e të mesëm.

*Në vijimësi*

**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Është mbajtur në konsideratë në të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Ndërtim rrjet kanalizimi të ujërave të zeza mbi rrugën nr. 5, Lagje nr. 3, Sarandë”, rezulton se nga 5 OE të paraqitur janë s’kualifikuar 4 OE. OE “M./S” SHPK është s’kualifikuar me arsyetimin se: -I mungon 1 (një) kamionçinë, pasi mjeti SR. B i mbaronte kontrata në datë 11.12.2020 në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.8 a), ndërkohë që OE ka paraqitur një kamionçinë më shumë. - Ka paraqitur mekanizëm ekskavator me goma i cili nuk ka dokumentacion qarkullimi, ndërkohë që nuk është përcaktuar se duhet të jetë ekskavator me goma i cili qarkullon në rrugë dhe pajiset me dokumentacion si leje qarkullimi etj. - Ka paraqitur mjetin “Sharrë për Punim metali” për të cilin OE nuk ka dorëzuar dokumentacion. Në kontratën e qirasë që OE ka me shoqërinë “E. C.” figuron mjeti të jetë makineri prerëse metalesh me kontroll numerik e cila sipas fotos të paraqitur është e stacionuar në ambiente dhe jo sharrë punimi metali e cila është e lëvizshme dhe përdorshme në terren ku do të realizohet

objekti”. Procesi i prerjes së hekurave (në punimet e kësaj kontrate nuk është parashikuar proces i tillë), mund të realizohet edhe jashtë kantierit. Nga ana e KVO dhe KSHA, shmangiet e mësipërme mund të konsideroheshin devijim i vogël, pasi diferenca e vlerës së ofertave ndërmjet këtij OE me atë fitues është e konsiderueshme dhe kriteri kryesor i procedurës së prokurimit është “Çmimi më i ulët”. Në procedurën e prokurimit “Blerje e dy automjeteve për nevoja të shoqërisë”, në specifikimet teknike të automjeteve, pjesë e dokumenteve të tenderit përcaktohet se ofertuesi duhet të paraqesë dokumente të automjeteve si, libër makine, leje qarkullimi, fotografi në të cilat të shikohen qartë të dhënat e mjetit dhe gjendja e tij estetike. Nga verifikimi në sistemin elektronik të prokurimeve, konstatohet se operatori ekonomik shpallur fitues, nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentacioni i kërkuar si më sipër. Në kushtet e mos plotësimit të këtyre kërkesave, operatori ekonomik duhet të ishte s’kualifikuar. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (shfuqizuar), neni 46.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 7, faqe 39-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**18.1. Rekomandimi:** Komisionet e vlerësimit të ofertave duhet të analizojnë me detaje dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesit, jo vetëm sa i takon sigurimit se ka aftësitë teknike për të realizuar kontratën, por edhe nëse produkti i paraqitur i plotëson specifikimet teknike të parashikuara, me synim shmangien e riskut të dështimit të kontratave dhe mos realizimit në kohë të tyre.

*Në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Është mbajtur në konsideratë në të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (Regjistri për pjesëmarrjen në mbledhje të anëtarëve të Këshillit të Administrimit) për Këshillin e Administrimit dhe Administratori, konstatohet se anëtarët nuk janë mbledhur të paktën 1 (një) herë në muaj, veprim në kundërshtim me VKM nr. 63, date 27/01/2016, Neni 14, Mbledhja dhe vendimet e Këshillit të Administrimit, Pika 1.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 2, faqe 16-17, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**19.1. rekomandimi:** Këshilli i administrimit të marrë masa për zhvillimin e mbledhjeve, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore.

*Vazhdimisht*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Mbështetur në Statutin e Shoqërisë, neni 14, ku përcaktohet “Këshilli i Administrimit mbledhet jo më pak se një herë në muaj dhe sa herë e kërkon interesi i shoqërisë aksionere, me thirrjen e kryetarit”, Këshilli i Administrimit është mbledhur cdo muaj.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**20. Gjetje nga auditimi:** Kontrata e punimeve civile “Ndërtim i kanalizimeve të ujërave të zeza në Bllokun mbi rrugën nr.5, Lagje nr. 3, Sarandë”, është nënshkruar me nr. 590 prot., datë 03.12.2020, me Kontraktorin “JV I. G. & 2. K.”, me vlerë 31,821,600 lekë. Referuar dokumentacionit të dosjes teknike, në shtresën e betonit e cila është vendosur në rrugë, është vendosur zgarë hekuri me dimensione të hekurit 3-5 mm, me kuadratë (plegma) 15 cm x 15 cm,

kjo e konstatuar vetëm në dy seksione dhe anash shtresës së betonit. - Nga verifikimi i dokumentacionit teknik, kokat e pusetave në rrjetin me tubacion 315 mm, ishin parashikuar të ndërtoheshin prej betoni monolit, me dimensione 1.65 m x 1.65 m, me trashësi të mureve 20 cm. Nga verifikimi në objekt rezulton se nuk janë respektuar këto dimensione. Rreth kapakut prej gize është hedhur beton i pa armuar (armimi nuk është përfshirë në peshën e hekurit në situacion), me gjerësi rreth 30 cm rreth kapakut. Sasia e betonit për përgatitjen e tyre është më e vogël se ajo e parashikuar. Në lidhje me realizimin e pusetave si më sipër, ishte parashikuar që ato të ndërtoheshin me formë drejtkëndore me beton të derdhur në objekt. Nga verifikimi në terren rezulton që ato janë vendosur të parapërgatitura si dhe në formë rrethore. Sasia e betonit për përgatitjen e tyre është më e vogël se ajo e parashikuar, për të cilën nuk mund të përcaktohet diferenca për arsye se kemi të bëjmë me punime të cilat janë bërë të pa dukshme në elementët kryesor të tyre. Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve nuk është reflektuar ky fakt, për miratimin e ndryshimit nëse ka qenë e nevojshme si dhe përcaktimin e çmimit për zë të ri punimi, duke qenë se vendosja e pusetave të parapërgatitura nuk është pjesë e preventivit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, pika I.17, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 8.2 dhe 8.3.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 7, faqe 39-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**20.1. Rekomandimi:** UK SHA Sarandë, të ngrejë një komision të veçantë për analizimin e kostos së tombinove rrethore të vendosura nga kontraktori duke reflektuar diferencën në vlerë krahasuar me tombinot e projektuara dhe vlera e diferencës të zbritet nga vlera e garancisë së kontratës së punimeve të bashkimit të operatorëve “JV I. G. & 2. K.” SHPK. Po ashtu, të verifikohet dimensionimi i zgarave të vendosura në shtresën e betonit.

*Deri më datë 31.12.2022*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Nga Administratori i Shoqërisë është ngritur komisioni në zbatim të rekomandimit të KLSH-së. Komisioni i ngritur me datë 28.12.2022 ka hartuar një informacion pas verifikimit në terren (bashkëlidhur).

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga auditimi:** Kontrata “Ndërtim stacioni i ri pus-çpimi në Vrion dhe lidhja me rrjetin kryesor transmetues”, është nënshkruar me nr. 442 prot., datë 20.10.2020, me Kontraktorin “M./S” SHPK, me vlerë 9,404,900 lekë pa TVSH. Bazuar në dokumentacionin përkatës rezulton se për zërin b.1.14 “Pjesë speciale çeliku, Ø ~ 200 mm”, është preventivuar dhe certifikuar sasia 950 kg. Në librezën e masave nuk është detajuar kjo sasi sipas elementëve përkatës, për përcaktimin e saktë të peshës. Nga verifikimi i disa zërave të punimeve në objekt, rezulton se për vendosjen e tubacionit Ø ~ 200 mm, janë parashikuar: F.V brryl 900 , 450 Ø – 200 mm, F.V saraçineska çeliku me fllanxa Ø – 200, F.V Valvula moskthimi Ø – 200, F.V distancor, F.V Nyje bashkuese dhe F.V ventila çeliku me fllanxa (shkarkues + kontroll). I vetmi element i cili konsiderohet pjesë speciale çeliku, janë dado bullonet të cilat janë përdorur për lidhjen e fllanxhave, të cilët janë në sasi 48 copë me peshë 50 kg. Sasia 900 kg është certifikuar pa përcaktuar se cilëve elementë i përkasin. Vlera 270,000 lekë (900 kg x 300 lekë/kg) është përfutur padrejtësisht nga Kontraktori

dhe përbën dëm ekonomik. Nga verifikimi i disa zërave të punimeve rezulton se është vendosur tubacion Ø – 200, në sasinë 28 ml ose 1,078 kg (3 ml është i pa vendosur, por gjendet në objekt). Sasia e certifikuar për këtë zë punimi është 43 ml, ose me peshë 1667.1 kg, nga ku rezulton diferenca 15 ml, ose 589 kg. Vlera 176,700 lekë (589 kg x 300 lekë/kg), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori M./S SHPK dhe përbën dëm ekonomik. Në sheshin e stacionit të pompimit (pusit të çpimit), janë realizuar punime të shtrimit me çakëll, punime të cilat pretendohet se janë realizuar nga kontraktori. Nga verifikimi i dokumentacionit, nuk rezulton i reflektuar në ndonjë dokument realizimi i një procesi të tillë. Po ashtu, sa i përket lidhjes së tubacionit me ankerat e betonit, janë vendosur profile metalike, të cilat nuk përbëjnë pjesë speciale çeliku. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, pika I.17, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 8.2 dhe 8.3.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 7, faqe 39-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** UK SHA Sarandë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 446,000 lekë, nga Kontraktori “M./S” SHPK, për punime të likuiduara port të pa realizuara.

***Brenda datës 31.12.2022***

**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Me shkresën nr. 334/3 Prot. datë 31.10.2022 është njoftuar Shoqëria “M” shpk për likuidimin e shumës.

Po ashtu është ripërsëritur shkresa me datë 10.01.2023, me nr. 335/5 Prot.

Pas marrjes dijeni të shkresës kontraktori na njoftoi se ka hapur padi për anulimin e këtij njoftimi. Pas verifikimit në gjykatë për ecurinë e këtij gjykimi, nga ana jonë do të ngrihet padi për kthimin e shumës

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

**2. Gjetje nga auditimi:** Kontrata “Ndërtim i kafazit të shkallës me vetrata xhami të temperuar” është nënshkruar me nr. 185 prot., datë 06.05.2019, me Kontraktorin “2.” SHPK, me vlerë 3,557,400 lekë. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 45 ditë. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur Shoqëria “I.” SHPK. Nga verifikimi i disa zërave të punimeve u konstatuan diferenca të punimeve të realizuara krahasuar me ato të certifikuara rezulton se për 75 zërin “Mbulim çatie me panele sandwiç”, është certifikuar dhe likuiduar në sasinë 40 m<sup>2</sup>, ndërkohë që nga verifikimi në objekt rezulton se është realizuar sasia 32 m<sup>2</sup>, me një diferencë 8 m<sup>2</sup>. Vlera 40,000 lekë (8 m<sup>2</sup> x 5,000 lekë/m<sup>2</sup>), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “2.” dhe përbën dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, pika I.17, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 8.2 dhe 8.3.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 7, faqe 39-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** UK SHA Sarandë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 40,000 lekë, nga Kontraktori “2.” SHPK, për punime të likuiduara port të pa realizuara.

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Referuar mandat arkëtimit nr. 43 datë 25.01.2023 nga OE “2.” shpk është bërë likuidimi i shumës prej 40 000 leke.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

### **C. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

Nga auditimi i veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Ujësjetës Kanalizime Sarandë, kanë rezultuar shkelje të kuadrit ligjor dhe rregullator me pasojë efekt negativ financiar me vlerë 122,427,934 lekë, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi ndërmjet UK SHA Sarandë dhe OSHEE janë lidhur 23 kontrata për furnizimin me energji elektrike të vetë shoqërisë si dhe funksionimin e stacioneve të pompimit, pompave apo elektropompave. Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera me bankë konstatohet se, detyrimi i lindur nga mos pagesa e faturave të energjisë elektrike ndaj OSHEE deri më datë 31.12.2021, ka arritur në vlerën 114,177,290.87 lekë, si dhe kamatëvonesat mbi këtë detyrim në shumën 101,626,174.54 lekë e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Ujësjetës Kanalizime SHA Sarandë, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 8662, datë 18.09.2000, “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike” i ndryshuar, neni 1.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 5, faqe 25-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa për likuidimin e faturave të energjisë elektrike në afatet e përcaktuara nga kuadri rregullator në fuqi, për të mos krijuar kamatëvonesat, të cilat rëndojnë artificialisht buxhetin e institucionit.

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Në zbatim të këtij rekomandimi shoqëria ka marrë masa për likuidimin në kohë reale detyrimet e FSHU të cilat zënë 75 % të totalit të detyrimeve të pa likuiduara. Kjo duket edhe në faktin se detyrimi nuk është rritur pasi për gjatë vitit 2022 janë likuiduar të gjitha detyrimet duke mos krijuar detyrime të reja.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

**1.2. Rekomandimi:** Nga Këshilli i Administrimit të merren masa të menjëhershme, ku të hartohet një plan emergjent për shlyerjen detyrimeve dhe kamatëvonesave që ka Shoqëria ndaj OSHEE për 23 kontratat për furnizimin me energji elektrike.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:



Është ngritur komisioni për ndjekjen në vijimësi të detyrimeve, principal dhe kamat vonesat, do të rakordohet me FSHU shumë përkatese dhe do të kërkohet prej saj të lidhet akt marreveshje për likuidim me këste të detyrimeve.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera me bankë konstatohet se, ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Bankave BEI, IDA dhe KfW janë lidhur marrëveshjet e financimit konkretisht: 1. Marrëveshja me BEI për Projektin “Infrastruktura Ujore Bashkiake Stacioni i trajtimit të ujërave të ndotura” me vlerë financimi në shumën 2,357,251 Euro. 2. Marrëveshja me IDA për Projektin “Projekti Bashkiak i furnizimit me ujë dhe kanalizime” me vlerë financimi në shumën 2,186,719 USD. 3. Marrëveshja me KfW për Projektin “Infrastruktura ujore Bashkiake I” me vlerë financimi në shumën 4,000,000 Euro. 4. Marrëveshja me KfW për Projektin “Infrastruktura ujore Bashkiake II” me vlerë financimi në shumën 500,000 Euro. Për likuidimin e këtyre shumave të sipërpërmendura ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si përfaqësues i Qeverisë Shqiptare dhe Ujësjetës Kanalizime SHA Sarandë janë nënshkruar akt marrëveshjet nën huaje respektive, ku ende kanë mbetur detyrimet për t’u shlyer deri më datë 31.12.2021, si më poshtë: 1.1. Marrëveshja me BEI për Projektin “Infrastruktura Ujore Bashkiake Stacioni i trajtimit të ujërave të ndotura” UK SHA Sarandë ka detyrimin ndaj MFE në shumën 1,668,815 euro si dhe penalitete në shumën 141,223.38 euro e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Shoqërisë Ujësjetës Kanalizime SHA Sarandë, si pasojë e mos likuidimit në kohë të detyrimeve të parashikuara në akt marrëveshjet nën huaje. 1.2. Marrëveshja me IDA për Projektin “Projekti Bashkiak i furnizimit me ujë dhe kanalizime” ka detyrimin ndaj MFE në shumën 2,304,419 USD. 1.3. Marrëveshja me KfW për Projektin “Infrastruktura ujore Bashkiake I” UK SHA Sarandë ka detyrimin ndaj MFE në shumën 144,959 euro. 1.4. Marrëveshja me KfW për Projektin “Infrastruktura ujore Bashkiake II” UK SHA Sarandë nuk ka detyrim ndaj MFE mbi këtë akt marrëveshje nën huaje.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 5, faqe 25-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** Nga organet drejtuese të Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për analizimin e detyrimeve që janë krijuar ndër vite referuar akt marrëveshjeve të nën huas të lidhura me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si pasojë e paaftësisë paguese për shlyerjen e kredive, ku t’i bëjë me dije ministrisë situatën e vështirë ekonomike financiare të institucionit për zgjidhjen e kësaj problematike me qëllim shmangien e penaliteteve të cilat lindin si pasojë e mos likuidimit në kohë të këtyre kredive.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Në zbatim të këtij rekomandimi në vijimësi do t’i bëhet shkresë Ministrisë së Financave për të mundësuar shmangien e penaliteteve, nisur kjo nga situata e aftësisë së dobët paguese për shlyerjen e këtyre detyrimeve .

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i pa zbatuar**.

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi organizimin e strukturës organizative të aplikuar për vitet 2019-2021, nga UK SHA Sarandë të miratuara respektivisht me Vendimin nr. 15/2, datë 20.12.2017 dhe nr. 3, datë 24.02.2020, të Këshillit të Administrimit me numër 170

punonjës për secilin vendim sa më sipër konstatohet se, është tejkaluar numri i fuqisë punëtore në total me 116 punonjës përgjatë periudhës objekt auditimi konkretisht: për vitin 2019 me 41 punonjës, për vitin 2020 me 13 punonjës dhe për vitin 2021 me 62 punonjës. Shuma e likuiduar për punonjësit mbi strukturën e miratuar është 3,264,000 lekë e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë. Ky efekt ka ardhur si pasojë e punësimeve të reja por edhe të punonjësve me kontrata tre mujore të cilat janë kryer nga Administratori i Shoqërisë sipas vendimeve përkatëse. Nga ana e Administratorit të Shoqërisë dhe Zyra e Burimeve Njerëzore nuk janë marrë masat e duhura për bashkërendimin e punës mbi zbatimin e strukturës së miratuar mbi të cilën nuk duhej të kalohej numri total i punonjësve, gjithashtu ndërmjet tyre nuk rezultoi të ketë patur një komunikim të vazhdueshëm gjatë rekrutimit të punonjësve të rinj në punë me qëllim marrjen e masave të duhura për respektimin e numrit total të punonjësve të miratuar në strukturën organizative, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, pika 1, 77 pika 8, germa “d”, neni 11, pika 1, dhe strukturës organizative të miratuar respektivisht me Vendimin nr. 15/2, datë 20.12.2017, dhe nr. 3, datë 24.02.2020, të Këshillit të Administrimit.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 4, faqe 25-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë të merren masat e duhura që, emërimi i punonjësve të rinj, lëvizja dhe qarkullimi i tyre të bëhet në sinenergji me Zyrën e Burimeve Njerëzore, duke marrë informacion të vazhdueshëm në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator të rekrutimeve në punë.

**3.2. Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë dhe Zyra e Burimeve Njerëzore të merren masat e duhura që, në të ardhmen të respektohet numri i të punësuarve sipas strukturës së miratuar dhe legjislacionit në fuqi, me qëllim përdorimin e fondeve publike me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Në vijimësi rekrutimi i punonjësve është bërë sipas procedurës së miratuar nga Këshilli i Administrimit.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**4. Gjetje nga auditimi:** Me Vendimin nr. 3, datë 05.03.2021, të Këshillit të Administrimit është miratuar shpërblimi në shumën 4,500 lekë konkretisht për 42 punonjës në shumën totale 189,000 lekë me rastin e festës së 8 marsit. Me Vendimin nr. 2, datë 25.02.2022, të Këshillit të Administrimit është miratuar shpërblimi në shumën 5,000 lekë konkretisht për 37 punonjës në shumën totale 185,000 lekë me rastin e festës së 8 marsit. Ndërkohë që Shoqëria ka detyrime për t'u likuiduar referuar kontratave të kredive dhe huave të lidhura me MFE sipas marrëveshjeve me BEI dhe KfW, detyrime dhe kamatëvonesa në likuidimin e energjisë elektrike si dhe është me humbje respektivisht për vitin 2020 në shumën 54,571,029.76 lekë dhe për vitin 2021 në shumën 47,259,026.62 lekë. Gjithashtu Vendimi i KA është në kundërshtim me ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve” i ndryshuar, neni 6, pika 1, germa “b” për arsye se shpërblimi është përfituar para daljes së rezultatit financiar si dhe në kushtet kur Shoqëria ka detyrime për shlyerjen e kredive ndaj MFE por referuar humbjeve sipas periudhave të sipërpërmendura nuk mund të akordojë shpërblim për punonjësit e saj. Në total ky

shpërblim është në shumën 374,000 lekë e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin Ujësjesht Kanalizime SHA Sarandë.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 4, faqe 21-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë dhe Këshilli i Administrimit të marren masa që dhënia e shpërblimeve për punonjësit e saj të kryhet në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse, duke vlerësuar situatën financiare të institucionit me qëllim përdorimin e fondeve publike me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Të gjitha shpërblimet e dhëna për punonjësit janë dhënë bazuar në vendimet e Këshillit të Administrimit.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i pa zbatuar**.

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera me arkë dhe bankë konstatohet se, janë likuiduar gjoba në shumën totale 217,006 lekë, si pasojë e vonesës së deklaratimit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, mos depozitim i pasqyrave financiare për mungesë vendimi nga Asambleja Aksionare etj., konkretisht për vitin 2019 në shumën 150,044 lekë, për vitin 2020 në shumën 25,000 lekë dhe për vitin 2021 në shumën 31,861 lekë. Për sa trajtuar më sipër shuma 217,006 lekë përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Ujësjesht Kanalizime SHA Sarandë.

*(Më hollësisht trajtuar në Pikën 4, faqe 21-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. Rekomandimi:** Nga organet drejtuese të Shoqërisë dhe Drejtoria Tregtare të merren masa që, deklarimi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në sistemin ESIG dhe depozitimi i pasqyrave financiare në QKB të kryhet brenda afateve të parashikuara në dispozitat ligjore përkatëse me qëllimin shmangien e gjobave dhe penalteteve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Në zbatim të këtij rekomandimi konfirmojmë se, nuk kemi raste të deklaratimit me vonesë të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe të depozitimit me vonesë të Pasqyrave Financiare të vitit 2022 në Drejtorinë Rajonale Tatim Taksave Sarandë. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

### **3.9. Ujësjesht Kanalizime Shkodër**

#### **A. PËRMBLEDHJE**

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 702/1 Prot, datë 04.08.2023, me objekt: “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022”.

Auditimi është kryer nga:

*E.K*

*K.G*

Periodha e auditimit: 01.01.2022 – 31.12.2022

Afati i auditimit: 07.08.2023 - 08.09.2023

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të lartë të shtetit ” dhe të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH, Nr. 1, datë 04.11.2016, “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacion që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit rekomandimeve të KLSH ”.

Duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- a. Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së, të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2022, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjektet e audituara, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- b. Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike, të akteve administrative të nevojshme, si vendime e urdhra për zbatimin e masave organizative;
- c. Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

## **B. HYRJA**

Përfaqësuesit e autorizuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit, audituesit E.K dhe K.G, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna në Ujësjellës Kanalizime Shkodër, u informuan mbi ecurinë e zbatimit të tyre nga z. A.B në cilësinë e Administratorit të Ujësjellës Kanalizime Shkodër.

Objekti i këtij Raporti Përfundimtar është zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në subjektin “Ujësjellës Kanalizime Shkodër.”

## **C. REZULTATET E AUDITIMIT**

Nga zbatim të programit të auditimit u verifikua dokumentacioni si më poshtë:

Raporti Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a.;

Shkresa përcjellëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, administruar në KLSH me nr. prot., datë, administruar në shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Shkodër me nr., prot., datë; etj.

Nga auditimi rezulton se:

### **I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.**

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a., ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 5/10 prot., datë 18.10.2022 duke respektuar kështu afatin 20 ditor të dërgimit.

### **II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.**

-Në zbatim të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a., ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 5/11 prot., datë 23.03.2023 duke respektuar kështu afatin 6 mujor të dërgimit.

## **III. Rekomandimet e KLSH**

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit në Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a. me nr.5/9 Prot., datë 26.09.2022 janë rekomanduar gjithsej:

**a.** Janë rekomanduar 24 **masa organizative**;

**b.** Janë rekomanduar 11 **masa për shpërblim dëmi**

**c.** Janë rekomanduar 3 **masa për përdorimin me shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficientës dhe efektivitetit**;

#### IV. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH

Sipas shkresës së administruar në Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a., me nr. 5/10 prot., datë 18.10.2022, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar Plotësisht	Pa pranuar
1	Organizative	24 masa	24 masa	0
2	Shpërblim dëmi	11 masa	11 masa	0
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	3 masa	3 masa	0

#### V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit

Në mënyrë të përmblodhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	24 masa	7		14	3
2	Shpërblim dëmi	11 masa	2		6	3
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	3 masa			3	

Në mënyrë të analitike statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

#### MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Shoqëria “Ujësjetllës - Kanalizime” SHA Shkodër, ka marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna në zbatim të shkresës nr. 601/7prot. datë 31.12.2019, plani i veprimit është miratuar nga Drejtori i Ujësjetllës Kanalizime SHA. Kontrolli i Lartë i Shtetit është informuar mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve, me shkresën nr. 79, datë 17.01.2020. Në zbatim të afatit 20 ditor për kthimin e përgjigjes ndaj KLSH konstatohet se nga UK SHA, është respektuar afati 20 ditor i kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve. Nga auditimi i zbatimit të afatit 6 mujor për raportimin e ecursisë së zbatimit të rekomandimeve, konstatohet UK SHA, nuk e ka përbushur detyrimin e afatit 6-mujor të raportimit, në kundërshtim me nenin 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Shoqëria “Ujësjetllës- Kanalizime” SHA Shkodër, nuk ka zbatuar dhe realizuar në mënyrë të plotë rekomandimet e KLSH-së të dhëna sipas programit të auditimit nr. 520/1Prot. datë 05.06.2020, me objekt: “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshëm të evaduar në periudhën 01.01.2019 - 31.12.2019”. Konkretisht janë rekomanduar nga KLSH: 32 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 4, 20 janë në proces dhe 8 nuk janë zbatuar; 1 masa për shpërblim dëmi me vlerë totale 408 mijë lekë e cila është në proces dhe 1 masë administrative e realizuar. Pra në total janë lënë 34 rekomandime ku nga këto 5 janë zbatuar, 21 janë në proces dhe 8 nuk janë zbatuar. Mos zbatimi i rekomandimeve sa më sipër është

në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”.(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 25-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** UK SHA Shkodër, të marrë masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat rezultuan të pazbatuara, si dhe të ndiqen me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore.

*Menjëherë*

Statusi i pranimi: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Ka vijuar zbatimi i rekomandimeve të lena nga auditimi i mëparshëm, masat me karakter administrativ janë zbatuar, ndersa ato gjyqësore janë në proces.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**2. Gjetje nga auditimi:** Rregullorja e brendshme për UKSHA, Shkodër, është miratuar me Vendimin nr. 23, datë 13.09.2017 dhe gjatë kësaj kohe nuk është përshtatur me ndryshimet në strukturën organizative, Statutin e shoqërisë i miratuar me vendimin nr. 28, datë 01.06.2016 dhe Rregulloren e miratuar me vendimin nr. 13, datë 07.09.2015 “Për miratimin e Rregullores së kritereve të pranimi në punë të punonjësve të shoqërisë”, duke mos ndihmuar në mirëfunksionimin e brendshëm të saj.

Nga auditimi rezulton se, në rregulloren e brendshme nuk është përcaktuar lloji i arsimimit për të gjitha pozicionet e punës si edhe përshkrimi i punës për çdo pozicion, nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në rregulloren për kriteret e pranimi në punë, duke bërë të vështirë identifikimin e detyrave dhe të drejtave që ka çdo punonjës i shoqërisë. Janë përcaktuar vetëm funksionet apo detyrat e disa pozicioneve dhe jo përshkrimi i punës për çdo pozicion. Rregullorja e brendshme vazhdon të jetë e njëjta sipas organizimit të mëparshëm të shoqërisë e cila nuk është në koherencë me ndryshimet dhe rregulloren e rekrutimit e cila daton prej vitit 2015. Në kundërshtim me germa c, pika 2, neni 18 të VKM nr. 63 datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura" dhe Statutin e shoqërisë i miratuar me vendimin nr. 28, datë 01.06.2016. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 35-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandim:** Strukturat drejtuese të shoqërisë, të marrin masa për hartimin e rregullores së funksionimit duke e përshtatur me Rregulloren e kritereve të pranimi në punë të punonjësve të shoqërisë, duke ndihmuar në mirëfunksionimin e brendshëm të saj, si edhe në rregulloren e brendshme të përcaktohet niveli i arsimimit, profesioni, përshkrimi i punës për çdo pozicion me qëllim rekrutimin e punonjësve me aftësi profesionale që ti përgjigjen zhvillimit të shoqërisë.

*Menjëherë*

Statusi i pranimi: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Rregullorja e Brendshme nuk është amenduar, pasi Shoqëria është në proces transferimi bazuar në VKM nr. nr. 302, date 11.05.2022” Per politikat kombetare per riorganizimin e sektorit te furnizimit me uje dhe largimin, trajtimin dhe perpunimit te ujrave te ndotura” dhe do te hartohet rregullore e re nga subjekti me kompetenca te perbashketa Shoqëria Rajonale Ujesjelles-Kanalizime Qarku Shkoder.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**3. Gjetje nga auditimi:** Në përcaktimin e pagave mungojnë grupet e punës të ngritura nga shoqëria, ku ti propozohet Këshillit Administrativ niveli i pagave dhe pagat për çdo pozicion pune, për elementet që përbëjnë pagën si niveli arsimor, vjetërsia në punë, vështirësia, etj., por pagat janë caktuar apriori dhe janë miratuar në Këshill. Shtesat e pagës nuk janë përcaktuar të njëjta për personat në pozicione të barabarta duke bërë kështu diferencime. Në përcaktimin e pagave konstatohet se nuk janë të argumentuar elementet përbërës të pagës, pasi për disa kategori punonjësish janë dhënë shtesa mbi pagën bazë të paargumentuara, konstatohen diferencime në nivelin e pagave për kategori të njëjta, pra në përcaktimin e nivelit të pagave ka diferencime pa u bazuar në legjislacionin në fuqi. Përcaktime të pagave jo sipas vështirësisë, ngarkesës dhe rëndësisë në vendin e punës, diferencime në përcaktimin e nivelit të pagave për punë dhe vend pune të njëjtë, ku për pozicione të njëjta ka nivele të ndryshme page duke treguar sjellje preferenciale për njërin apo tjetrin punonjës. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për Kompetencat e organeve kolegjiale, drejtuese të njësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50% shtetëror” neni 2, pika ç, “Organet Kolegjiale drejtuese të njësive të fondeve speciale, të ndërmarrjeve shtetërore, shoqërive aksionere dhe të institucioneve të tjera publike” dhe nenin 6, pika 1 dhe Kodi i Punës, Neni 115, “Barazia në shpërblim” (ndryshuar me ligjin nr. 136/2015, datë 05.12.2015). (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 35-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1. Rekomandim:** Strukturat drejtuese të shoqërisë, të ngrenë grupe pune për të përcaktuar nivelin e pagave të punonjësve duke analizuar elementët përbërës të pagës, si niveli i arsimit, vështirësia, vjetërsia në punë, pozicioni i vendit të punës, etj., me qëllim përcaktimin e pagave të çdo pozicioni pune dhe mundësive financiare të shoqërisë, si edhe të shmangin diferencimet preferenciale mes punonjësve në drejtim të caktimit të pagave.

*Brenda datës 31.12. 2022*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Ky rekomandim është zbatuar me hartimin e strukture organizative të UKSH 2023.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**4. Gjetje nga auditimi:** Sektori i Auditit të Brendshëm përbëhet nga 3 persona, të cilët janë punësuar pa u pajisur me certifikatën e auditit. Po kështu edhe punonjësja (N.T), e punësuar me 03.03.2021, nuk plotëson 2 prej kriterëve, dëshminë si audituese e brendshme në sektorin publik dhe eksperiencën e punës mbi 3 vite në fushën financiare, referuar kriterëve për vendin e punës. Në dosje referuar librezës së punës dhe CV të paraqitur prej saj, konfirmohet se eksperiencia në punë është e vitit 15 Mars -15 Shtator 2015, si oficer kredie pranë F.B, duke mos e plotësuar kriterin për punësim si edhe kriterin për certifikatën e auditit. Po kështu librezja e punës konfirmon punësimin në SHRSF, Shkodër 2011-2012 me pozicion “Punonjëse shërbimi” dhe 17 Gusht 2018-11 Dhjetor 2019 në pozicionin “Punëtorë” dhe jo kriteri i kërkuar me profesion ekonomiste. Përveç sa më lart, referuar certifikatës familjare të datës 18.02.2021 në dosje, konstatohet se znj .N.T është bashkëshorte e Drejtorit Administrativo-Ligjor të UKSHA, Shkodër z. F.T. Veprime në kundërshtim me Rregulloren e kriterëve të pranimit në punë të punonjësve të shoqërisë, miratuar me vendimin nr.13, datë 07.09.2015 të Këshillit Mbikëqyrës,

Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të shoqërisë, miratuar me vendimin nr.23, datë 13.09.2017, të Këshillit të Administrimit, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar me Ligj nr.9475, dt.09.02.2006, Ligjin nr. 9529, dt.11.5. 2006 dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 35-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1. Rekomandim:** Strukturat drejtuese të shoqërisë, të marrin masa për rekrutimin e punonjësve në pozicionin “audit i brendshëm” sipas nivelit arsimor dhe legjislacionit në fuqi, si edhe largimin e znj. N.T, nga pozicioni i specialistes së AB e cila ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit me bashkëshortin z. F.T, me qëllim rritjen e profesionalizmit dhe shmangien e konfliktit të interesit.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Ky rekomandim është zbatuar menjëherë dhe plotësisht , pasi N.T është larguar nga puna me urdhrin e brendshëm nr. 415, date 14.10.2022

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**5. Gjetje nga auditimi:** Vlera e inventarëve të paraqitura përputhet me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike të kryera në çdo vit ushtrimor. Vlerat e AAGJM prej 2,491,663,593 lekë në fund të vitit 2020, paraqitur në mungesë të inventarëve fizik nuk paraqesin vlerën reale të tyre. Për periudhën 2017-2020, janë kryer vetëm inventarët e magazinave, ndërsa për vitin 2021 nuk është kryer inventarizim për asnjë lloj aktivi. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kreu IV “Sistemi i Kontrollit Periodik të Aktiveve”, Inventarizimi i aktiveve, pikat 73, 74, dhe “Përgjegjësitë për inventarizimin”, Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi pika 95. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 61-76,. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1.Rekomandim:** Strukturat drejtuese të UK SHA, Shkodër, në bashkëpunim me Degën e Financës të nxjerrin urdhrat përkatës për kryerjen e inventarëve fizik të aktiveve në fund të vitit ushtrimor për saktësimin e vlerës të tyre në kontabilitet, duke paraqitur gjendjen reale të aktiveve në pasqyrat financiare.

*Brenda vitit 2022*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Ky rekomandim është zbatuar bazuar ne urdhrin e brendshëm nr. 529 date 16.12.2022.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**6. Gjetje nga auditimi:** Shoqëria ka paraqitur në fund të vitit 2020 gjendjen e llogarisë “Klientë” në vlerën 1,634,194,313 lekë, për të cilën nuk ka njohur zhvlerësim, në mospërputhje me SNRF 9 “Instrumentet financiare”, për këtë arsye këto pasqyra nuk pasqyrojnë realitetin duke mos marrë siguri të arsyeshme lidhur me vlerën e zhvlerësimit që duhej njohur dhe rregullimi që duhej bërë në fitimet e raportuara në pasqyrën e fitim/humbje.

Në këto vlera të konsiderueshme të detyrimeve të arkëtueshme, peshën kryesore për mospagimin e detyruar ndaj SHA Ujësjetës Kanalizime e zënë klientët familjarë me vlerë 957,324,908 lekë dhe “Klientë taksa Bashkie”, në vlerën **533,478,752 lekë**, e cila paraqet detyrimet e abonentëve të



konstatuara (faturimet) për taksat dhe tarifa vendore të pa arkëtuara. Këto detyrime janë të ardhura të munguara të Bashkisë, të cilat nuk janë mbledhur dhe derdhur nga Ujësjetësi në rolin e Agjentit Tatimor. Veprime në kundërshtim me nenin 117 të Ligjit 9920, dt. 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore”, ku parashikohet se “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”, Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe SNRF 9 “Instrumentet financiare”, miratuar me urdhrin e Ministrit Financave nr.65, datë 05.05.2008 “Për shpalljen dhe zbatimin e detyrueshëm të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 61-76, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1.Rekomandim:** Dega e Financës të marrë masa për njohjen dhe pasqyrimin e zhvlerësimit të drejtave të arkëtueshme “Klientë” në pasqyrat financiare në mbyllje të viteve ushtrimore me qëllim marrjen e një sigurie të arsyeshme në lidhje me vlerën e zhvlerësimit që duhet njohur dhe të bëjë rregullimet përkatëse në pasqyrën fitim/humbje dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse  
*Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

**6.2. Rekomandim:** Strukturat drejtuese, të marrin masa shtrënguese për arkëtimin e detyrimeve të arkëtueshme nga abonentët si për shitjen e ujit, ashtu edhe për mbledhjen e tarifave vendore në rolin e Agjentit tatimor, si edhe të bashkëpunojë me Bashkinë Shkodër për evidentimin dhe njohjen e detyrimit të kontabilizuar nga UK SHA, me qëllim rritjen e të ardhurave dhe shmangien e dënimit me gjobë në masën 50 % të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura, situatë e cila sjell vështirësi financiare për shoqërinë.

*Brenda vitit 2022*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

**7. Gjetje nga auditimi:** Llogaria *Të pagueshme ndaj furnitorëve* në bilancin e vitit 2020, paraqitet në vlerën **940,140,410 lekë**, ku ndikim më të madh kanë detyrimet ndaj furnitorëve për fatura të pa likuiduara në vlerën 371,474,198 lekë, ku detyrimet për energjinë elektrike në vlerën 345,675,776 lekë, ose në masën 93%.

Pasqyra e pozicionit financiar përmban si pjesë të faturave të pa likuiduara ndaj furnitorit FSHU vlerën **341,441,339 lekë**, u kërkua konfirmim dhe analiza për këtë vlerë dhe nuk u analizua kjo vlerë nga institucioni, në këto kushte nuk mund të gjykohet nëse duhet bërë ndonjë rregullim në lidhje me fitimet e raportuara në pasqyrën e fitimit/humbjes dhe nëse rezultati financiar është paraqitur drejt.

Pjesë e detyrimeve afatshkurtra në vlerën **35,187,460 lekë**, janë edhe detyrimet për tarifatat dhe taksat vendore të arkëtuara në rolin e agjentit tatimor dhe pa derdhur pranë Bashkisë. Nga dega e financës nuk argumentohet pamundësia e derdhjes së detyrimit. Veprime në kundërshtim me neni 117 të Ligjit 9920, dt. 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore”, “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave” dhe Ligji nr. 25/2018, datë

10.05.2018 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 61-76, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1. Rekomandim:** Strukturat drejtuese të shqyrtojnë situatën e krijuar nga rritja e borxhit duke analizuar me dokumentacion financiar faturat e pa likuiduara dhe të marrin masa për likuidimin e tyre. Për detyrimet në vlerën **35,187,460 lekë**, ndaj Bashkisë Shkodër për tarifatat dhe taksat vendore të mbledhura dhe të pa paguara, të marrë masa për kalimin e tyre në favor të Bashkisë, me qëllim minimizimin e borxhit të krijuar.

*Brenda vitit 2022*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Ky rekomandim është zbatuar bazuar në mandat pagesat përkatëse të xhiruara në favor të Bashkisë Shkodër.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**8. Gjetje nga auditimi:** Detyrimi për TVSH<sup>në</sup> ndaj organeve tatimore sipas UK SHA Shkodër, është në shumën **2,482,923 lekë**. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka paraqitur detyrimin tatimor të TVSH në vlerën **40,129,755 lekë**. Me shkresën nr. 2065, datë 31.12.2021 nga UKSHA Shkodër është kërkuar rregullimi i detyrimeve tatimore duke iu drejtuar DPT dhe Ministrisë Financave dhe Ekonomisë. Me shkresën nr. 2976, datë 07.03.2022, të MFE, lidhur me kërkesën e UK Shkodër ka dërguar DPT dhe Drejtorisë rajonale të tatimeve Shkodër pretendimet dhe kthim përgjigje për zgjidhjen e problemit. Për këtë situatë nga UKSHA nuk janë ndërmarrë veprime për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me rrugë gjyqësore dhe deri në përfundim të auditimit mbetet në fuqi shuma e DPT. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, dt. 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore”, Ligjin nr. 92/2014, datë 28.08.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, seksion II neni 86/3, nenet 89 dhe 107. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 61-76, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1. Rekomandim:** Strukturat drejtuese të shoqërisë, të marrin masa për të analizuar situatën e krijuar me DPT, për detyrimin tatimor të TVSH në vlerën **40,129,755 lekë**. Në bashkëpunim me DPT të saktësojnë shumën e detyrimit dhe arrijnë të një marrëveshjeje për likuidim pjesor të detyrimit, në të kundërt të ndjekin rrugën ligjore me DPT.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Ky rekomandim është në proces gjyqësor, pasi UKSH ka ngritur padi ndaj DPT me çështja mban nr. 386/1063/1645(31170-01013-38-2020)

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**9. Gjetje nga auditimi:** Shitja e ujit të pijshëm të prodhuar si dhe largimi i ujërave të ndotura janë dy sektorët ku realizohen të ardhurat kryesore të shoqërisë UK Shkodër. Prodhimi i ujit të pijshëm është i lidhur me kërkesat e konsumatorit. Prodhimi i ujit në të gjitha stacionet e pompimit llogaritet dhe mbahet manualisht pasi matësit dhe sistemi SCADA i vendosur në qytetin të Shkodrës është jashtë funksionit. Sasia e prodhuar, llogaritet sipas orëve të punës së pompave dhe prurjeve të tyre, ku prurjet nuk janë të sakta pasi me amortizimin e tyre kjo sasi ulet. Duke ju

referuar nevojës mesatare ditore 150 l/ditë/frymë dhe numrit të popullsisë në zonën e shërbimit ku sipas të dhënave të vendosura në dispozicion është 115,063 frymë rezulton se nevojat për ujë janë 17,260 m<sup>3</sup>/ditë ose 6,299,700 m. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave të mallrave, shërbimeve dhe punimeve civile./vit. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion të grupit të auditimit konstatohet se prodhimi i ujit është shumë i lartë nga nevojat e kërkuara sipas standardeve si dhe niveli i faturimit krahasuar me prodhimin është shumë i ulët. Veprimtaria e shoqërisë së UK Shkodër monitorohet nëpërmjet performancës dhe indikatorëve të saj për të garantuar përmbushjen e përgjegjësive dhe për të parë progresin që bëhet për të përmirësuar shërbimet. Nga krahasimi i indikatorëve kryesorë të performancës për periudhën objekt auditimi si dhe objektivat e vendosura nga shoqëria konstatohet se:

- Mungojnë matësit në prodhim, gjë e cila sjell pasqyrim jo të saktë të prodhimit dhe të dhëna jo të besueshme të cilat ndikojnë në treguesit e performancës së shoqërisë;
- Niveli i humbjeve shumë i lartë gjatë periudhës audituese ka ardhur duke u rritur ku për vitin 2020 është në masën 70 %, pra më i lartë se objektivi i vendosur nga shoqëria;
- Niveli i arkëtimit, për periudhën objekt auditimi, ka pësuar rënie nga viti 2018 me 4% në vitin 2021 dhe është mbi objektivin e vendosur nga shoqëria;
- Mbulimi i kostos direkte dhe totale të operimit është poshtë objektivave të vendosura nga shoqëria;
- Kohëzgjatja e furnizimit me ujë ka një rritje me 1 orë nga fillimi i periudhës së audituar deri në fund të saj e cila është 21 orë/ditë;
- Mbulimi i zonës së shërbimit është konstant gjatë gjithë periudhës së audituar konkretisht afërsisht 55% për ujësjellës dhe afërsisht 43% për kanalizimet. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”; Strategjia Kombëtare e Ujit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 130-140, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1. Rekomandimi:** Nga ana e shoqërisë UK Shkodër të merren masa për uljen e humbjeve teknike dhe administrative duke hartuar një plan veprimi të mirë përcaktuar duke grumbulluar të dhëna të besueshme me vendosjen e matësve në prodhim dhe faturim si dhe rritjen e arkëtimit koherente për rritjen e të ardhurave.

*Në vijimësi*

**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Ky rekomandim është në proces, pasi ulja e humbjeve, kostove dhe përmirësimi i shërbimit të furnizimit me ujë kërkon masa administrative dhe teknike në vazhdimësi.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**10. Gjetje nga auditimi:** Dezinfektimi i ujit të pijshëm bëhet me metodën kimike me produktet dezinfektuese, hipokloriti i kalciumit dhe hipokloriti i natriumit. Dezinfektimi me produktin hipoklorit i natriumit bëhet në mënyrë automatike me dozim, duke dozuar një sasi fikse pasi matësit në prodhim në stacione nuk punojnë. Dezinfektimi me produktin hipoklorit i kalciumit bëhet në të gjitha stacionet e tjera të pompimit.

Departamenti i Shëndetit Publik dhe Mjedisit në Shkodër kryen analiza ditore të ujit për klorin mbetës dhe koliformen në 22 pika kontrolli dhe rezultatet i dërgohen UK Shkodër. Në rast se konstatohen ndotje në rrjetet i kërkohet UK Shkodër të marrë masa duke shtuar sasinë e klorit. Pavarësisht se UK Shkodër ka laborator, të ndërtuar në vitin 2020 nga ana e programit GIZ, me të

gjitha pajisjet për kryerjen e analizave të ujit nuk është në funksion. Nga verifikimi u konstatua se mungonin reagentet për kryerjen e analizave dhe ato pak që gjendeshin në të kishin datë skadencë 12/2020 dhe nuk mund të përdreshin, kështu që laboratorit për kryerjen e analizave të ujit është jashtë funksionit dhe duhet të certifikohet nga organet përkatëse. Gjithashtu nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion konstatohet se analiza, për përbërjen fiziko-kimike të ujit të pijshëm për të përcaktuar trajtimin kimik të tij, kryhen në mënyrë periodike nga të tretët. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”; Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 130-140, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1. Rekomandim:** Nga ana e shoqërisë UK Shkodër të merren masa për vendosjen në funksion të laboratorit dhe certifikimin e tij nga organet përkatëse për kryerjen e analizave fiziko-kimike duke siguruar cilësinë e ujit të pijshëm për konsumatorët si dhe shmangien e kostove shtesë nga kryerja e analizave nga të tretët.

*Brenda vitit 2022*

Statusi i pranimit: Pranu

Përgjigje nga subjekti:

Ky rekomandim është në proces, pasi për të vënë në funksion laboratorin kërkohet certifikimi dhe akreditimi i tij, për të cilat duhen një seri kriteresh, për këtë qëllim i kemi bërë shkresë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit nr. 1699 prot, datë 24.10.2022.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**11. Gjetje nga auditimi:** Në qytetin e Shkodrës janë funksionale dy impiante për trajtimin e ujërave të ndotura, një në Shirokë dhe një në Velipojë. Vëllimi i ujit të ndotur që hyn për trajtim në ITUN e Shirokës është afërsisht 31,000 m<sup>3</sup>/vit dhe në ITUN Velipojë është afërsisht 291,000 m<sup>3</sup>/vit pra në total 322,000 m<sup>3</sup>/vit. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion për ITUN Velipojë konstatohet se për tremujorin e tretë të vitit volumi i hyrjes në impiant rritet me 50 %, nga 65,000 m<sup>3</sup> shkon në 100,000 m<sup>3</sup> e cila është si rezultat i akomodimit dhe pushuesve gjatë sezonit turistik në këtë zonë. Numri total i lidhjeve që shkarkojnë ujin e ndotur në sistemin e kanalizimeve dhe që trajtohen në ITUN është 1049 ku nga këto 890 janë ente familjare dhe 159 ente private. Nga ana e ndërmarrjes nuk mund të gjenerohen të dhëna për volumin e faturimit për 1049 klientët që janë të lidhur me sistemin e kanalizimeve që trajtohet nga ITUN. Gjenerimi i volumit të faturuar, për klientët që janë të lidhur me sistemin e kanalizimeve që derdh ujërat e ndotura në ITUN, do të bënte të mundur krahasimin me volumin që hyn në impiant për të gjykuar se sistemi i kanalizimeve është i izoluar dhe nuk kemi ndërthurje të tij me ujërat e bardha si dhe depërtimin e ujërave nëntokësorë të cilat mund të risin koston e trajtimit në impiant.

Laboratorët e ITUN Velipojë dhe Shirokë kryejnë analizat e ujërave të ndotura, në hyrje dhe në dalje të impiantit. Analizat që kryhen janë vlerat e NKO-së (Nevoja Kimike për Oksigjen dhe të NBO-së (Nevoja Biokimike për Oksigjen) të shprehura në mg/l O<sub>2</sub> si dhe nuk kryen për lëndët e ngurtë pezull e shprehur mg/l. Vlerat e lejuara për shkarkimin e ujërave të ndotura në mjedisin pritës janë, për NKO 125 mg/l O<sub>2</sub>, për NBO 25mg/l O<sub>2</sub> dhe për lëndët e mbetura pezull 35mg/l. Nga të dhënat e analizave të kryera dhe të vendosura në dispozicion të grupit të auditimit konstatohet se NKO dhe NBO, para se uji i trajtuar të derdhet në mjedisin pritës, janë brenda normave të lejuara të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion konstatohet se Nevoja Kimike për Oksigjen (COD) është brenda normave të lejuara.

Në të dy impiantet nuk kryhet analiza për lëndët e mbetura pezull (TSS) dhe analizat e kryera nuk japin rezultate të besueshme se uji i trajtuar përpara se të derdhet në trupat ujore pritëse plotëson normat standardin e cilësisë e kërkuar. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”; Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” ; Ligji nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”; Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011“Për mbrojtjen e mjedisit”; VKM Nr.177, dt. 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”, si dhe direktivën e Bashkimit Evropian 91/271/EEC. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 130-140, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1. Rekomandim:** Nga ana e degës së shitjes, të llogaritet sasia e ujit të faturuar për klientët që derdhen ujërat e ndotura në ITUN dhe të krahasohet me sasinë hyrëse në to duke analizuar sistemin e kanalizimeve nëse ka hyrje të ujërave nëntokësore e të bardha në të dhe marrjen e masave të duhura nga ana e shoqërisë duke ulur kështu koston e trajtimit në impiante.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Ky rekomandim është realizuar dhe është në proces, pasi pagesa e ujerave të ndotura që derdhen në ITUN është pjesë integrale e faturës së ujit për çdo klient.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**11.2. Rekomandim:** Shoqëria UK SHA Shkodër të marrë masa për trajnimin e stafit që analizat, e ujit të trajtuar përpara se të derdhet në trupat ujore pritëse të jenë të plota me qëllim dhënien e rezultateve të besueshme se uji i trajtuar plotëson normat, standardin e cilësinë e kërkuar.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Ky rekomandim është në proces, do të realizohet me vënien në funksion të laboratorit.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i pa zbatuar**.

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Automjete” zhvilluar në UKSH SHA për vitin 2020 me fond limit në vlerën e 7,738,750 lekë pa TVSH u konstatuan parregullsi përpara se të derdhet në trupat ujore pritëse të jenë të plota me qëllim dhënien e rezultateve të besueshme se uji i trajtuar plotëson normat, standardin e cilësinë e kërkuar. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”; Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” ; Ligji nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”; Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011“Për mbrojtjen e mjedisit”; VKM Nr.177, dt. 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”, si dhe direktivën e Bashkimit Evropian 91/271/EEC. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 130-140, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Automjete” zhvilluar në UKSH SHA për vitin 2020 me fond limit në vlerën e 7,738,750 lekë pa TVSH u konstatuan parregullsi përpara se të derdhet në trupat ujore pritëse të jenë të plota me qëllim dhënien e rezultateve të besueshme se uji i trajtuar plotëson normat, standardin e cilësinë e kërkuar. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”; Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” ; Ligji nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”; Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011“Për mbrojtjen e mjedisit”; VKM Nr.177, dt. 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”, si dhe direktivën e Bashkimit Evropian 91/271/EEC. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 130-140, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Në datën 09.03.2021 dhe vlerë 9,060,000 lekë me TVSH, të nënshkruar midis UKSH SHA dhe operatorit të shpallur fitues “O.” SHPK. Afati i ekzekutimit të kontratës/dorëzimit të mallrave, është 15 ditë nga data e nënshkrimit ose me datë përfundimi deri në datën 23.03.2021. Në datën 24.03.2021, është nënshkruar midis UKSH SHA dhe operatorit ekonomik “O.” SHPK, amendamenti me nr. 416 Prot., i cili zgjat afatin e ekzekutimit të kontratës bazë deri në datën 24.04.2021. Në vazhdim, në datën 23.04.2021, është nënshkruar midis UKSH SHA dhe operatorit ekonomik “O.” SHPK, amendamenti i dytë me nr. 574 Prot., i cili zgjat afatin e ekzekutimit të kontratës bazë deri në datën 31.05.2021. Si rezultat, shtesa ose amendamenti i parë, ai me nr. 416 Prot., datë 24.03.2021, është i pavlefshëm pasi i referohet pikës 7 të kontratës bazë e cila në fakt ka humbur fuqinë e saj ligjore në datën 23.03.2021, datë në të cilën ka përfunduar dhe kontrata bazë. Për rrjedhojë, kjo shtesë kontrate e cila favorizon OE, nuk duhej nënshkruar nga Titullari i

UKSH SHA (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 76-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**12.1. Rekomandim:** Drejtoria Tregtare në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike në UKSH SHA, të marrin masat që në të ardhmen, gjatë hartimit të amendamenteve të kontratave, të respektohen kushtet e veçanta të kontratës bazë, duke mos i ndryshuar ato me qëllim shmangien e krijimit të situatave favorizuese për operatorët ekonomikë nënshkrues të këtyre kontratave.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Ky rekomandim është realizuar dhe është detyrë në vazhdim, pasi për çdo amendim kontrate zbatohet kuadri ligjor në fuqi, duke mos krijuar asnjë situatë favorizuese për operatorët ekonomikë. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt “*Blerje materiale hidraulike*” zhvilluar në UKSH SHA për vitin 2019 me fond limit në vlerën e 3,464,945 lekë pa TVSH dhe për vitin 2020 me fond limit 6,172,475 lekë pa TVSH, u konstatuan parregullsi lidhur me dokumentimin e mënyrës së përlllogaritjes së vlerës së fondit limit. Tek procesverbalet e mbajtura respektivisht në vitet përkatëse për përlllogaritjen e fondit limit të procedurave të prokurimit, janë pasqyruar vetëm dy oferta dhe jo tre. Procesi i testimit të tregut në vetvete është një fazë negocimi me operatorët ekonomikë për marrjen e ofertave të favorshme. Komisionet e përlllogaritjes së vlerës së kontratave përkatëse, duhej të referohej të paktën tre ofertave të tregut dhe jo dy ofertave. Si rezultat, fondi limit për të dy procedurat e mësipërme, nuk është i bazuar pasi ofertat janë dy dhe jo tre. Në këto kushte, kur përlllogaritja e vlerës së fondit limit është bazuar vetëm tek dy oferta, procedurat e përlllogaritjes së vlerës së fondit limit janë të pavlefshme pasi mënyra e përlllogaritjes së tij, për të dy rastet, nuk është e argumentuar dhe dokumentuar duke mos garantuar konkurrencë dhe barazi në marrjen e ofertave në kundërshtim me nenin 1 të ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, ndryshuar “Për prokurimin publik”, germa “ç” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 76-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**13.1.Rekomandim:** Drejtoria Tregtare në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike në UKSH SHA, njësitë e prokurimit apo të përlllogaritjes së vlerës së fondit limit, të marrin masa që në të ardhmen, në përlllogaritjen e vlerës së fondit limit, në rastin e marrjes së ofertave nga tregu, ti referohen jo më pak se tre ofertave të marra për përlllogaritjen e vlerës së kontratës bazuar në konkurrencë dhe barazi.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Ky rekomandim është realizuar referuar procedurave të prokurimit të zhvilluar gjatë kësaj kohe. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi praktikave të mbajtura për sasinë e karburantit të shpenzuar për automjetet në dispozicion, u konstatua se UKSH SHA, ka në flotën e saj 19 automjete. Institucioni i UKSH SHA, për vitin 2017, ka shpenzuar 5,380,310.45 lekë për karburant, për vitin 2018, ka shpenzuar 5,196,369.14 lekë për karburant, për vitin 2019, ka shpenzuar 4,836,205.06 lekë për karburant, për vitin 2020, ka shpenzuar 3,542,365.02 lekë për karburant dhe për vitin

2021, ka shpenzuar 4,022,403.34 lekë për karburant. Automjetet e UKSH SHA, nuk janë të pajisura të gjitha me sistemin GPS por vetëm disa prej tyre. Nga auditimi i sistemit të monitorimit me GPS, nga 22 mjete në dispozicion të UKSH SHA për periudhën 2017 deri 2021, vetëm 15 prej tyre janë të pajisura me sistem monitorimi. Gjithashtu, u vërejtën mangësi të theksuara në dokumentacionin justifikues të harxhimit të karburantit pasi në shumicën e rasteve e sidomos për automjetet e marra me qira me targa AA...P model Mitsubishi Pajero, AA...P dhe AA...P model Ford Ranger, nuk vërtetohet me dokumentacion justifikues përshkrimi i kilometrave pasi mungonin urdhrat e punës nga eprori direkt për lëvizjen e mjeteve, mungonin relacionet ditore, javore apo mujore nga personat udhëtues. Në shumicën e rasteve mungonin faturat e kasave fiskale të lëshuara nga pikat e karburantit ku janë furnizuar mjetet por edhe firma e kundërfirmuesit apo e eprorit ose firma e dytë. Sasia e karburantit e konsumuar nga këto tre mjete të marra me qira për vitet 2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021 rezulton të jetë afro 22600 litra. Dokumentacioni justifikues i konsumit të karburantit për këto mjete është i paplotë dhe ngre dyshime të arsyeshme për abuzim në sasinë e karburantit të konsumuar pasi ka mungesë të theksuar të gjurmës së auditimit lidhur me itineraret e kryera dhe arsyet e lëvizjeve të këtyre mjeteve” në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 3, pika 19 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 43-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**14.1.Rekomandim:** SHA Ujësjetës Kanalizime Shkodër, Drejtoria Tregtare, Drejtoria Juridike, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, të marrin masat që në të ardhmen, të vendosen në të gjitha automjetet pajisje për monitorimin e lëvizjeve të automjeteve dhe matjes së konsumit të karburantit dhe në të gjitha rastet ky konsum të shoqërohet me dokumentacionin përkatës vërtetues sipas ligjeve dhe rregullave në fuqi.

*Menjëherë*

**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Ky rekomandim është realizuar pasi monitorohen me GPS.Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kontratës me nr. 873 Prot., datë 09.07.2019, me vlerë 47,011,350 lekë me TVSH, të lidhur midis UKSH SHA dhe operatorit ekonomik “A-K” SHPK, për objektin “Ndërtim i stacionit të pompimit dhe rrjeti ujësjetës Kullaj”, u konstatua se zbatimi i punimeve ka përfunduar por ato nuk janë kolauduar për arsye se Titullari i UKSH SHA, nuk ka përcaktuar kolaudatorin pas afro 4 muaj pas përfundimit të punimeve. Konkretisht, njoftimi i përfundimit të punimeve drejtuar titullarit të UKSH SHA është me datë 30.12.2021 i nënshkruar nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve. Pas përfundimit të punimeve të kontratës dhe miratimit të tyre nga mbikëqyrësi i punimeve, UKSH SHA, akoma nuk ka marrë masat për kolaudimin e objektit. Grupi i marrjes në dorëzim të objektit, nuk ka dokumentuar vonesat e deritanishme për mos marrjen në dorëzim të punimeve ose për të argumentuar lidhur me vonesat e mos marrjes në dorëzim. Është nënshkruar nga mbikëqyrësi i punimeve, sipërmarrësi dhe investitori UKSH SHA, situacioni përfundimtar për periudhën e punimeve nga data 01.12.2021 deri 30.12.2021. UKSH SHA, deri në datën 15.04.2022, datë që përfundon auditimit, nuk ka përcaktuar kolaudatorin e punimeve/kontratës pasi kanë kaluar afro 4 muaj nga data e përfundimit të punimeve. UKSH SHA duhej ti referohej nenit 12 të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 76-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**15.1. Rekomandim:** SHA Ujësjetllës Kanalizime Shkodër, të marrë masat që në të ardhmen pas përfundimit të punimeve të kontratës dhe miratimit të tyre nga mbikëqyrësi i punimeve, të kryejë kolaudimin e punimeve të kontratës.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Ky rekomandim është realizuar, pasi objekti është kolauduar bazuar Kontratën e Kolaudimit nr. 1613 prot, date 13.10.2022.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**16. Gjetje nga auditimi:** Anëtarët e Këshillit të Administrimit brenda periudhës së auditimit, nuk kanë lidhur kontratë performance me shoqërinë, por të vetmet akte të hartuara në momentin e emërimit të tyre janë vendimet e riemërimit nga Asambleja e Përgjithshme e UK Shkodër SHA, respektivisht, Vendimi nr. 5, datë 30.05.2019 për riemërimin si administrator të UK Shkodër; Vendimi nr. 6, datë 30.05.2019; Vendimi nr. 7, datë 30.05.2019; Vendimi nr. 4 datë 25.02.2020 dhe Vendimi nr.05, datë 25.02.2020 për lirim, emërimin apo riemërimin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit.

Për sa më lart, është vepruar në mospërputhje me pikën 3 neni 12 i VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, pikën 3 neni 12, pika 5 neni 18 i Statutit të UKSH. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 26-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**16.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Shkodër në cilësinë e Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme të UK SHA Shkodër, të hartojë dhe të lidhë kontratë performance me Administratorin dhe anëtarët e Këshillit të Administrimit, duke e rinovuar çdo vit brenda periudhës tre vjeçare, vetëm mbi bazën e vlerësimeve pozitive të performancës gjatë veprimtarisë së tyre.

*Në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Ky rekomandim nuk është zbatuar. Anëtarët e Këshillit të Administrimit që kanë qene ne detyre ne momentin e hartimit te Raportit përfundimtar janë liruar nga detyra. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i pa zbatuar**.

**17. Gjetje nga auditimi:** Anëtarët e Këshillit të Administrimit të Shoqërisë në disa raste nuk kanë zhvilluar mbledhje mujore. Konkretisht, nga auditimi i vendimmarrjeve të Këshillit të Administrimit të UKSH për periudhën e auditimit rezulton se për periudhën 2017-2021 janë realizuar 62 mbledhje dhe marrë 122 vendime. Këshilli i Administrimit nuk ka zhvilluar mbledhje në muajin Prill 2017 dhe në muajin Prill 2020. Në vitin 2021 janë zhvilluar 13 mbledhje nga të cilat janë marrë 18 vendime.

Për sa më lart, anëtarët e këshillit të Administrimit kanë vepruar jo në përputhje me nenin 14 pika 1.,2., e në vijim të statutin e shoqërisë *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 26-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**17.1.Rekomandimi:** Administratori i shoqërisë edhe në cilësinë e anëtarit të këshillit të administrimit të kërkojnë mbledhje të Këshillit të Administrimit në mënyrë periodike për çdo muaj për problematika që e shqetësojnë shoqërinë.

*Në vijimësi*



Statusi i pranimit: Pranuar

**Përgjigje nga subjekti:**

Ky rekomandim është zbatuar bazuar ne proces-verbalet e mbledhjeve te Këshillit te Administrimit.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**18. Gjetje nga auditimi:** Veprimtaria e shoqërisë për periudhën nën auditim nuk ka qenë efektive dhe eficiente në drejtim të realizimit të indikatorëve kryesor të performancës pasi nga shqyrtimi i raporteve vjetore të veprimtarisë ekonomiko financiare të shoqërisë, rezulton se niveli i synuar nga shoqëria për reduktimin e ujit pa të ardhura, sipas projeksionit të plan biznesit nuk është arritur, kjo sepse shoqëria vazhdon të ketë nivelin e humbjeve në masën 70%. Gjithashtu, norma korrente e arkëtimit nuk është arritur sipas projeksioneve të plan biznesit, pasi ajo varion nga 67% deri në 70% në fund të vitit 2021.

Për sa më lart, anëtarët e Këshillit të Administrimit të Shoqërisë, kanë vepruar jo në përputhje me Vendimin nr.13 datë 14.06.2017 të Këshillit të Administrimit, programin ekonomik të vitit 2017, 2018, 2019, 2020, 2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 30-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**18.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Shkodër në cilësinë e Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a., të analizojë veprimtarinë e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës për arritjen e objektivave të shoqërisë në drejtim të rritjes së treguesve kryesor të performancës përgjatë tre viteve të fundit.

*Në vijimësi*

Statusi i pranimit: Pranuar

**Përgjigje nga subjekti:**

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i pa zbatuar**.

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore në drejtim të krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore, konkretisht nga auditimi i të ardhurave nga qiratë u konstatua se:

Kontrata nr.7165 rep, datë 10.11.2016 ka përfunduar më datë 31.10.2021. Për periudhën objekt auditimi nga grupi i auditimit të KLSH, konstatohet se pas përfundimit të kontratës me nr.7165 rep, datë 10.11.2016, shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Shkodër nuk ka lidhur kontratë me asnjë subjekt jo publik për objektin me sip 40 m<sup>2</sup>.

-Për periudhën objekt auditimi (01.11.2021-31.12.2021), ambienti prej 40m<sup>2</sup> pronë e UKSH është përdorur nga Subjekti A M C sh.a., duke ushtruar aktivitetin në objekt pa kontratë qiramarrje dhe pa arkëtuar asnjë të ardhur nga ky përdorim. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 30-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

**19.1. Rekomandim:** Administratori i shoqërisë të marrë në shqyrtim problematikat e shfaqura gjatë administrimit nga të tretë të pronave të shoqërisë dhe të ngrejë komisione për administrimin dhe raportimin periodik mbi ecurinë e pagesave dhe kushteve të ruajtjes së pronës së shoqërisë të dhënë me qira.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: Pranuar

**Përgjigje nga subjekti:**

Ky rekomandim është zbatuar bazuar ne mandat pagesat e kryera çdo muaj nga subjekti kontraktues M C.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**20. Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me përllogaritjen e fondit limit në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje materiale kompjuterike” për vitin 2020 dhe 2021 nga auditimi rezulton se:

Autoriteti Kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Shkodër, ka realizuar procedura prokurimi përgjatë viteve 2017-2019, respektivisht me objekt prokurimi “blerje materiale kompjuterike” apo “blerje materiale dhe pajisje kompjuterike”, të cilat përveç emërtimeve në dukje të ndryshme kanë patur kërkesa dhe specifikimeve teknike të njëjta për shumicën e zërave të kërkuar në procedurën e zhvilluar në vitin 2020 me objekt “*blerje materiale kompjuterike*”.

Grupi i ngarkuar për llogaritjen e fondit limit në proces verbalin e datës 26.10.2020 është shprehur se nuk ka kontrata të mëparshme të ngjashme dhe për këtë i është drejtuar subjekteve L.A, T dhe B.O për llogaritjen e fondit limit.

Nuk evidentohet qartë se si janë përllogaritur sasi të për materiale kompjuterike nga Autoriteti Kontraktor, pasi nuk ka evidencë dokumentare mbi kërkesat e drejtorive/sectorëve për nevojat e tyre për kompjuter, laptop, printer, monitor, etj., duke mos siguruar gjurmën e auditit për këto kërkesa me qëllim ripërshkrimin e të gjitha veprimtarive individuale deri në vendimmarrjen përkatëse.

Përllogaritja e fondit limit nga anëtarët e grupit, është bërë mbi ofertat ekonomike të marra nga subjektet e sipërcituar, të cilët kanë dhënë ofertë për “Lap Top” në mungesë të specifikime teknike të Autoritetit Kontraktor UKSH.

Në lidhje me hartimin e specifikimeve teknike, nga auditimi rezulton, se:

Në tabelën e mallrave të shtojcës 10 në DST, AK ka kërkuar LapTop 15.6 inch

Në shtrojsën nr.9, AK nuk ka përcaktuar specifikimet teknike për LapTop-in e paraqitur në shtrojsën 10.

Në procedurën e prokurimit “*Blerje materiale kompjuterike*” në vitin 2021.

Grupi i ngarkuar për llogaritjen e fondit limit në proces verbalin e datës 20.09.2021 nuk ka marrë për bazë çmimet referente të kontratave të mëparshme të ngjashme, por i është drejtuar subjekteve të sipërcituar për llogaritjen e fondit limit.

Nuk evidentohet qartë se si janë përcaktuar sasi të materialeve kompjuterike, pasi nga dokumentacioni i administruar nga grupi i auditimit të KLSH nuk është konstatuar evidencë dokumentare mbi kërkesat e drejtorive/sectorëve për kompjuter, laptop, printer, monitor, etj., materiale kompjuterike duke mos evidentuar gjurmën e auditit për këto kërkesat.

Çmimet e ofertuara për mallrat Lap-Top, Printer PSC, NVR 4 kanale, NVR 8 kanale dhe Thermal Printers nga subjektet e sipërcituar janë dhënë në mungesë të kërkesave dhe specifikime Teknik, pra ofertat e marra nga grupi për llogaritjen e FL janë oferta me çmime të improvizuara dhe pa referencë të specifikimeve teknike.

Për sa më lart, NJP ka vepruar në mospërputhje me nenin 23, pika 1,2,3,4, 5 të LPP dhe nenin 27 pika 1 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për hartimin e DST për këtë procedurë prokurimi. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 76-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**20.1.Rekomandimi:** Administratori i shoqërisë në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të planifikojë programe trajnimi në fushën e prokurimeve publike për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore që angazhohet në procedurat e prokurimit publik.

*Në vijimësi*

Statusi i pranimit: Pranuar

**Përgjigje nga subjekti:**

Ky rekomandim është zbatuar, pasi një pjesë e stafit është trajnuar nga Instituti i Eksperteve Fiskal. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**21. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje materiale kompjuterike” për vitin 2020. KVO ka shpallur fitues OE P S dhe lidhur kontratën Nr. 1813 Prot., datë 18.12.2020, në vlerën 1,876,800 lekë (me TVSH).

OE nuk plotëson të gjitha kriteret e kërkuara, pasi ;

AK në shtojcën 9 të DST ka kërkuar që madhësia (size) e Monitorit të jetë  $\geq 22$  inch.;

OE ka paraqitur në ofertë monitorin model HP 22W; Skeda teknike e këtij modeli, tregon që madhësia (size) e monitorit të ofertuar është 21.5 inch pra më i vogël se kërkesat e AK.

Gjithashtu skeda teknike e LapTop-it HP 250 G7 model i ofertuar nga OE nuk është i përkthyer në gjuhën shqipe. OE në katalogun e pajisjeve OE nuk ka paraqitur modelin e monitorit HP 32 inch sipas kërkesave të AK.

Sa më sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave” të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 76-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**21.1.Rekomandimi:** Titullari i AK të marrë masa që t’i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të hartimit të kërkesave për kualifikim nga grupet e punës/njësia e prokurimit dhe procesit të shqyrtimit e vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve nga komisionet e vlerësimit të ofertave, pasi në disa raste hartimi i kërkesave për kualifikim dhe vlerësimi i ofertave, konstatohet jo korrekt.

*Në vijimësi*

Statusi i pranimit: Pranuar

**Përgjigje nga subjekti:**

Ky rekomandim është zbatuar në procedurat e zhvilluara gjatë kësaj kohe. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**22. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje materiale kompjuterike” për vitin 2021. KVO ka shpallur fitues OE P S dhe lidhur kontratën Nr.1753 Prot., datë 05.11.2021, në shumën 2,224,200 lekë (me TVSH).

KVO ka shpallur fitues OE P S, pavarësisht se është oferta e vetme ekonomike, rezulton se ky OE nuk plotëson të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues me pa të drejtë.

Në SEP, OE nuk ka paraqitur katalog për mallrat e ofruara. OE nuk ka paraqitur deklaratë garancie për mallrat sipas të dhënave dhe afateve të përcaktuara në specifikimet teknike të shtojcës nr.5 të DST. OE P S për produktin Printer PSC, që nënkupton një pajisje (all in one) printer, skaner dhe fotokopje, ka ofertuar çmimin për njësi 1,000 lekë, një çmim shumë i ulët, ky fakt tregon qartazi që kemi të bëjmë me një ofertë anomalisht të ulët, ku KVO duhej të kërkonte nga OE sqarime në lidhje me çmimin e ofertuar për Printerin PSC.

Për sa lart, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5.c, të nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave” të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 76-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**22.1.Rekomandim:** Titullari i AK të marrë masa që t’i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të hartimit të kërkesave për kualifikim nga grupet e punës/njësia e prokurimit dhe procesit të shqyrtimit e vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe

ofertave të ofertuesve nga komisionet e vlerësimit të ofertave, pasi në disa raste hartimi i kërkesave për kualifikim dhe vlerësimi i ofertave, konstatohet jo korrekt.

*Në vijimësi*

Statusi i pranimit: Pranuar

Përgjigje nga subjekti:

Ky rekomandim është zbatuar ne procedurat e zhvilluara gjate kësaj kohe. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**23. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit me objekt “Printim Fature”, KVO ka shpallur fitues OE “A-C” dhe ka lidhur Kontratën Nr. 1059 Prot., datë 15.07.2021 në shumën 2,972,202 lekë pa TVSH.

Në lidhje me përlllogaritjen e fondit limit, nga auditimi rezulton se AK Ujësjetllës Kanalizime Shkodër ka realizuar tender në vitin 2019 me objekt “Printim fature” me specifikime teknike të njëjta me tenderin e vitit 2020. Grupi i punës për përcaktimin e FL nuk ishte në kushtet e mungesës së kontratave të mëparshme me objekt dhe specifikime teknike të njëjta.

Llogaritja e Fondit Limit sipas proces verbalit të datës 01.12.2020, nuk ka përfshirë vlerat e kontratave të mëparshme, por është llogaritur vetëm mbi ofertat e subjekteve të sipërcituar.

Nuk evidentohet gjurma e auditit për përcaktimin e sasisë totale vjetore prej 330,612 fatura nga ana e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Konsumatorin mbi numrin e abonentëve/kontratave aktive për qytetin e Shkodrës.

Për sa më sipër, grupi i punës për llogaritjen e FL duhej të merrte për referencë, çmimin 7.9 leke për njësi për “Printim fature dhe zarfim në versionin Selfmailer” të kontratës nr.1508 prot., datë 05.11.2019 të realizuar nga AK Ujësjetllës Kanalizime Shkodër dhe si rrjedhim për sasinë e kërkuar prej 330,612 copë “Printim fature dhe zarfim në versionin Selfmailer”, vlera e përlllogaritur e fondit limit duhej të ishte:  $330,612 \times 7.9 = 2,611,835$  lekë (pa TVSH) dhe jo 3,240,000 lekë siç është përlllogaritur nga grupi i punës për llogaritjen e fondit limit.

Për sa më lart, anëtarët e grupit të punës së ngarkuar për të llogaritur FL kanë vepruar në mospërputhje me nenin 59 pika 2/b të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 76-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**23.1.Rekomandim:** Administratori i shoqërisë në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të planifikojë programe trajnimi në fushën e prokurimeve publike për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore që angazhohet në procedurat e prokurimit publik.

*Në vijimësi*

Statusi i pranimit: Pranuar

Përgjigje nga subjekti:

Ky rekomandim është zbatuar, pasi nje pjese e stafit është trajnuar nga Instituti i Eksperteve Fiskal. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i pa zbatuar**.

**24.Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje kimikate dhe reagente” KVO ka shpallur fitues 2. dhe lidhur Kontratën Nr.610 Prot., datë 05.05.2021 me OE 2. në vlerën 7,141,560 lekë (me TVSH).

Llogaritja e fondit limit për procedurën e prokurimit “Blerje kimikate dhe reagente” është mundësuar nga Sektori i Planifikim/Raportim i përbërë nga znj. A.T dhe znj. S.U. Në Proces

Verbalin e datës 15.02.2021, FL është përlllogaritur në shumën 6,214,775 lekë (pa TVSH). Grupi i punës përlllogaritjen e fondit limit për këtë procedurë, ka marrë oferta nga subjektet: 2.; A 3; G. K.

Komisioni i përlllogaritjes së FL, megjithëse në kushtet e realizimit të kontratave të mëparshme të Autoritetit Kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Shkodër për blerjen e kimikateve dhe reagenteve të cilat kanë patur objekt dhe specifikime teknike të njëjta me procedurën që AK do të realizonte, nuk ka përfshirë vlerën e këtyre kontratave në metodologjinë e llogaritjes së FL për procedurën “Kimikate dhe reagente” për vitin 2021.

Përlllogaritja e fondit limit është bërë jo në referim të kontratave me të njëjtin objekt të realizuara më parë nga UKSH.

Për sa më lart, anëtarët e grupit të punës së ngarkuar për të llogaritur FL kanë vepruar në mospërputhje me nenin 59 pika 2/b të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 76-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**24.1.Rekomandim:** Administratori i shoqërisë në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të planifikoj programe trajnimi në fushën e prokurimeve publike për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore që angazhohet në procedurat e prokurimit publik.

*Në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Ky rekomandim është zbatuar, pasi një pjese e stafit është trajnuar nga Instituti i Eksperteve Fiskal. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i pa zbatuar**.

## **C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga auditimi:** AK ka pranuar dhe ka marrë në dorëzim mallra me specifikime të ndryshme nga ato të ofertura nga OE dhe të pranuar nga KVO.

OE “P S” ka dorëzuar pranë AK mallra të pa kërkuara duke mos ju përmbajtur deklaratës mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6, ku ka pranuar se: “*Përmbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me certifikata e dokumente (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë si dhe marrim përsipër realizimin e objektit sipas grafikut të lëvrimin të përcaktuar nga autoriteti kontraktor*”. Gjithashtu komisioni i zbatimit të kontratës ka vepruar në mospërputhje me kushtet e kontratës duke konfirmuar fiktivisht realizimin e saj dhe si rezultat OE “P S” ka përfituar gjithë shumën e kontratës prej 1,876,800 lekë (me TVSH) duke liruar kontraktuesin nga detyrimi i sigurimit të saj në vlerën 10%. Anëtarët e komisionit të zbatimit të kontratës kanë vepruar në mospërputhje me pikën 3, nenin 4 pika 4.1, 4.2, 4.3; nenin 6 pika 5.1 dhe nenin 26.

Duke ju referuar çmimeve dhe sasive të mallrave të marra në dorëzim në mospërputhje me kontratën të pasqyruar në tabelën nr.2., të aneksit 2.7.1 vlera e përlllogaritur prej **426,000 lekë** konsiderohet dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të UK-Shkodër. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 76-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**1.1.Rekomandim:** Nga ana e UKSH SHA të kërkohet nga subjekti “P S” ShPK, të risjellë produktet duke përmbushur të gjitha kriteret sipas përcaktimeve, në të kundërt të merren masa duke kërkuar në rrugë ligjore dhe ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e vlerës **426,000 lekë me TVSH** ndaj sipërmarrësit “P S”

ShPK, për mallra të furnizuara në kundërshtim me kontratën nr. 1813 Prot., datë 18.12.2020 me objekt “Blerje materiale kompjuterike”

*Deri më datë 31.12.2022*

Statusi i pranimit: Pranuar

**Përgjigje nga subjekti:**

Referuar vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nr. 6403 dt. 04.12.2023, rezulton se përfaqësuesit e ngarkuar nga ana e Ujësjetës Kanalizime Shkodër sh.a. për përfaqësim ligjor të UKSH sh.a. nuk janë paraqitur në seancën e caktuar, pa ndonjë shkak të arsyeshëm për të cilën gjykata duhet të vihet në dijeni paraprakisht. Nisur nga më sipër UKSH sh.a. nuk ka analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë administrative ligjore për shkaqet e mosprezencës në proces si dhe nuk ka një vlerësim të nivelit të mbrojtjes ligjore që përfaqësuesit kanë bërë në gjykatë, referuar padisë apo parashtrimeve të paraqitura.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se: Ruajtja dhe administrimi i mallrave behet në kundërshtim me aktet dhe udhëzimet në fuqi. Gjatë verifikimit fizik të grupit të auditimit në magazinën e UKSH, u konstatua se kompjuteri model Desk Top HP 290 G2 i dorëzuar nga OE “P S” sipas kontratës Nr. 1813 Prot., datë 18.12.2020 dhe gjendje në magazinën e UKSH, nuk kishte grupin e ushqimit të tensionit, siç tregohet në foton nr.1 të aneksit 2.7.1.

Lejimi i heqjes së grupit të ushqimit nga ana e përgjegjësit material të UKSH e ka bërë këtë kompjuter jo funksional, dhe njëkohësisht jashtë mbulimit me garanci nga kontraktuesi, pasi është ndërhyrë në mënyrë të paautorizuar dhe brenda periudhës së garancisë, siç është përcaktuar në DST.

Referuar FL nr.230 datë 28.12.2020, çmimi i “kompjuterit band 1” është **57,600 lekë** (me TVSH), kjo vlerë do të konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e UK Shkodër. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 76-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**2.1.Rekomandim:** Shoqëria Ujësjetës Kanalizime të kërkojë nga personi përgjegjës kthimin e sendit në gjendjen e mëparshme teknike dhe funksionale, në të kundërt të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e shumës **57,600 lekë** për përgjegjësin material z H.K.

*Deri më datë 31.12.2022*

Statusi i pranimit: Pranuar

**Përgjigje nga subjekti:**

Ky rekomandim është zbatuar , është mbajtur proces-verbali i datës 20.12.2022. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar.**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi dokumentacionit mbi zhvillimin e mbledhjeve dhe vendimeve të marra brenda periudhës së auditimit, rezulton se:

Anëtarët e Këshillit të Administrimit kanë përfituar shpërblim edhe në rastin kur nuk kanë zhvilluar mbledhje.

UK SHA Shkodër ka shpërblyer anëtarët e Këshillit të Administrimit edhe në kushtet kur ata nuk kanë kryer asnjë mbledhje, pasi nga auditimi i dokumentacionit të veprimtarisë së këshillit të administrimit dhe atë të drejtorisë tregtare rezultoi se Anëtarët e Këshillit të Administrimit kanë përfituar shpërblim për muajin Prill 2017, respektivisht; z. A.D ka përfituar pagesën mujore prej 72,250 lekë, znj. V.G ka përfituar shumën prej 25,500 lekë dhe znj. K.G në shumën 8,500 lekë. Për sa më lart, anëtarët e këshillit të administrimit kanë përfituar shpërblime në mospërpunje me

përcaktimet e nenit 14 pika 1 e statutit të shoqërisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 26-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1.Rekomandim:** Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime të përdorë përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e shumës prej **106,250 lekë** për përfitimin e pagesës së muajit Prill 2017 në mënyrë të padrejtë nga z. A.D ka përfituar pagesën mujore prej 72,250 lekë, znj. V.G ka përfituar shumën prej 25,500 lekë dhe znj. K.G në shumën 8,500 lekë.

*Deri më datë 31.12.2022*

**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Ky rekomandim është në proces, z. A.D është njoftuar me e-mail për arkëtimin e shumës përkatëse date 04.10.2022. V.G është njoftuar me shkresën nr.515 pro, date 28.03.2023 ndërsa K.G nuk ndodhet në Shqipëri, është me banim të përhershëm në SHBA. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**4.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kontratës Nr.1753 Prot., datë 05.11.2021 me objekt “Blerje materiale kompjuterike” të lidhur nga AK UKSH me subjektin “P S” në shumën 2,224,200 lekë (me TVSH), konstatohet se:

-OE P S nuk ka shoqëruar faturën e materialeve kompjuterike me akt dorëzimit ku të përshkruhej marka/modeli dhe P/N (Part Number).

*Shënim:* Për sa është konstatuar KVO për këtë procedurë prokurimi ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE P S në kushtet kur ky operator nuk ka ngarkuar në SPE katalogun e mallrave sipas sasive dhe specifikimeve të kërkuara nga AK.

- Sasitë dhe specifikimet për produktet informatike të kërkuar nga AK në vitin 2021 nuk përputhen me ato të prokuruar në vitin 2020 për blerjen e materialeve kompjuterike

-Komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka raportuar pranë titullarit të institucionit mungesën e katalogut pasi katalogu i pretenduar i ngarkuar në SPE nga OE P S nuk përputhet me kërkesat e paraqitura në DST nga AK dhe për më tepër, ai është i njëjti katalog që subjekti P S e ka ngarkuar në SPE në procedurën e prokurimit të vitit 2020 me objekt “blerje materiale kompjuterike”.

-Në mungesë të katalogut, komisioni i marrjes në dorëzim ka pranuar mallra të pa kërkuara.

Për sa më sipër, mallrat e dorëzuara nga OE P S nuk mund të identifikohen dhe të krahasohen me modelin/markën dhe specifikimet e kërkuara të AK dhe të ofertuara nga P S dhe në këto kushte komisioni i marrjes në dorëzim ka pranuar mallra të pakërkuara.

-Njëkohësisht komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka evidentuar në PV e marrjes në dorëzim realizimin e shërbimeve FV të montimit/konfigurimit apo vendosjes së produkteve, si: F.V Kamera Bullet, F.v Kamera Dome, F.V NVR 4 kanale, F.V NVR 8 kanale, F.V. H.DD 2 TB 5400 rpm të parashikuara nga AK në Shtojcën 6.

Për sa më sipër, komisioni i marrjes në dorëzim ka vepruar në mospërputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në LPP dhe nenin 4 pika 4.1, 4.2, 4.3, 4.4; 15 pika 15.1, 15.2 të kontratës Nr.1753 Prot., datë 05.11.2021, si dhe pika 2 e Urdhrit të Brendshëm nr.431 datë 08.11.2021, ku parashikohet se: Komisioni ka për detyrë të verifikojë në vazhdimësi realizimin e furnizimeve, duke marrë dhe raportuar në rast problematikash që bien ndesh me kushtet e kontratës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 76-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**4.1.Rekomandim:** Nga ana e UKSH SHA të kërkohet nga subjekti “P. S.” ShPK, të risjellë produktet duke përbushur të gjitha kriteret sipas përcaktimeve, në të kundërt të merren masa duke kërkuar në rrugë ligjore dhe ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **2,224,200 lekë** ndaj sipërmarrësit “P. S.” ShPK,

për mallra të furnizuara në kundërshtim me kontratën Nr.1753 Prot., datë 05.11.2021 me objekt “Blerje materiale kompjuterike”.

*Deri më datë 31.12.2022*

**Statusi i pranimit: Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Ky rekomandim është zbatuar, pasi në momentin e dërgimit të Raportit Përfundimtar, kontrata ka qene e pa likuiduar nga ana e UKSH. Me shkresën nr. 1642/1,prot, date 28.12.2022 i kemi kthyer përgjigje shoqërisë P. S. qe shuma e detyrimit do te mbahet si detyrim qe rrjedh nga konstatimet e KLSH. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i zbatuar**.

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me objekt: “Printim faturash”, me fond limit 3.239.998 lekë (pa TVSH) zhvilluar më datë 05.01.2021, rezultoi se:

-KVO në datën 14.01.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi siç paraqiten në tabelën nr.1 të aneksit nr.7.2.3.

-KVO ka kualifikuar OE “A-C” me ofertën ekonomike 2,972,202 lekë (Pa TVSH), ndërsa OE “I.” e ka s’kualifikuar, ky OE kishte paraqitur ofertën ekonomike në shumën 1,785,305 lekë (Pa TVSH), gjithashtu dhe OE “I. A.” është s’kualifikuar, oferta ekonomike e paraqitur ishte në shumën 2.446,529 lekë (Pa TVSH).

-Operatori ekonomik “I.” dhe “I. A. shpk”, kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar s’kualifikimin e ofertave dhe pas vendimit të AK, kanë paraqitur ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtat pretendime që ka parashtruar edhe përpara autoritetit kontraktor.

KPP ka dalë me Vendimin Nr. 110/2021, datë **04.03.2021**, duke vendos që:

*Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi s’kualifikimin e operatorëve ekonomikë “I.” shpk dhe “I. A.” shpk, duke i kualifikuar këta operatorë ekonomikë.*

-Nga verifikimi i procedurës së prokurimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), në datën 10.03.2021, KVO ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit në zbatim të vendimit të sipërpërmendur të Komisionit të Prokurimit Publik, duke njoftuar ofertuesit për renditjen përfundimtare të ofertave. Nga ku, të 3 (tre) OE pjesëmarrës ishin kualifikuar dhe renditja sipas ofertës ekonomike shpallte fitues OE “I.” mbi bazën e çmimit më të ulët në shumën 1,785,305 lekë (Pa TVSH) dhe më pas renditja vazhdonte me OE “I. A.” në shumën prej 2.446,529 lekë (Pa TVSH) dhe në vend të tretë renditej OE “A-C” me ofertën ekonomike prej 2,972,202 lekë (Pa TVSH). Renditja e OE pjesëmarrës pasqyrohet në tabelën nr.2 të aneksit 2.7.3.

-Operatori ekonomik “A. C.” SHPK, në datën 17.03.2021 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e ofertave të paraqitura nga shoqëritë “I” SHPK dhe “I. A.” SHPK, si dhe duke kërkuar s’kualifikimin e tyre dhe në datën 29.03.2021, ka paraqitur ankesë në KPP, me të njëjtat pretendime që ka parashtruar edhe përpara AK.

Operatori ekonomik “I. A.” shpk, në datën 16.03.2021 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së paraqitur prej shoqërisë “I” SHPK, ndërsa në datën 31.03.2021, operatori ekonomik “I. A.” ShPK ka paraqitur ankesë në KPP, me të njëjtat pretendime që ka parashtruar edhe përpara AK.

Në përfundim KPP ka dalë me Vendimin Nr. 247/2021, date 28.05.2021, sipas të cilit: *“Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorëve ekonomikë “I.” ShPK dhe “I. A.” ShPK, duke i s’kualifikuar këta operatorë ekonomikë”*.



KVO pas rivlerësimit mbi bazën e vendimit të KPP nr. 247/2021, datë 28.05.2021, ka përpiluar raportin përmbledhës mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit me Nr. 926 Prot., datë 24.06.2021. Sipas këtij raporti përmbledhës, kanë paraqitur ofertë 3 OE, 2 OE janë s'kualifikuar dhe është shpallur fitues OE "A C".

AK ka shpallur fituese OE A C nëpërmjet shkresës nr. 927 Prot. date 24.06.2021 dhe ka lidhur Kontratë Nr. 1059 Prot., datë 15.07.2021 në shumën 2,972,202 lekë pa TVSH.

Për sa më lart, dispozitat ligjore kanë përcaktuar kompetencën e KVO të vlerësojë apo rivlerësoj të gjithë dokumentacionin dhe procedurën, pas vendimit respektiv të KPP, duke vepruar në mospërputhje me nenin 64/2 pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik".

Në këto kushte, pavarësisht ankesës së bërë nga OE, trajtimit dhe pranimit të saj nga KPP, AK duhej që brenda 10 ditëve pas daljes së vendimit të bënte me dije KPP për shkaqet për të cilat nuk mund ta shpallte fitues OE "A.-C.", si dhe për vijueshmërinë e procedurës.

Mos shpallja fitues e OE me ofertë më të favorshme ekonomike "I." SHPK në shumën 1,785,305 lekë dhe shpalljen fitues të OE "A. C." sh.p.k., në shumën 2,972,202 lekë, përbën dëm ekonomik për buxhetin e UKSH në shumë 1,186,897 lekë, si diferencë ndërmjet ofertës të shpallur fituese dhe asaj me vlerë më të ulët. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 76-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. Rekomandim:** Nga ana e UKSH SHA të merren masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **1,186,897 lekë** në mënyrë proporcionale për secilin anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave

*Deri më datë 31.12.2022*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Anëtarët e Komisionit kane paraqitur kërkesë padi ne Gjykatën Administrive Tirane e cila me vendimin nr. 1436, date 07.06.2023 ka vendosur pushimin e çështjes. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i pa zbatuar**.

**6.Gjetje nga auditimi:** AK ka shpallur fitues OE A. C për procedurën e prokurimit me objekt: "Printim faturash" dhe ka lidhur Kontratë Nr. 1059 Prot., datë 15.07.2021 në shumën 2,972,202 lekë pa TVSH.

Komisioni i zbatimit të kontratës nuk ka zbatuar detyrimet e përcaktuara si në drejtim të kohës së dorëzimit po ashtu të printimit brenda afateve të përcaktuar në të. Kontraktuesi nuk ka dorëzuar faturat e ujit për muajin Shtator 2021.

Komisioni i zbatimit të kontratës (marrjes në dorëzim), në PV e datës 15.11.2021 ka marrë në dorëzim (sipas komisionit) në përputhje me kushtet e kontratës faturat e muajit Tetor në sasinë 55,796 copë. Sasi kjo sa dyfishi i faturave që duhej të printoheshin për këtë muaj.

Pagesa e kryer në shumën 300,964 lekë, për faturat e muajit Shtator 2021 do të konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë UK Shkodër.

Për sa më lart, Komisioni i zbatimit të kontratës ka vepruar në mospërputhje me kushtet e kontratës Nr. 1059 Prot., datë 15.07.2021 dhe U.B nr. 282 datë 28.07.2021 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 76-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1.Rekomandim:** Nga ana e UKSH SHA të merren masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **300,964 lekë** ndaj sipërmarrësit "A. C." ShPK, për mallra të furnizuara në kundërshtim me kontratën Nr. 1059 Prot., datë 15.07.2021 me objekt "Printim Faturash".

*Deri më datë 31.12.2022*

Statusi i pranimit: Pranuar

**Përgjigje nga subjekti:**

Ky rekomandim është ne proces, është depozituar kërkesa padia ne Gjykatën Administrative Shkodre dhe mban nr. e çështjes gjyqësore 31170-00115-83-2023. Jemi ne pritje te seancave gjyqësore. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

**7.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kontratës Nr. 1059 Prot., datë 15.07.2021 në shumën 2,972,202 lekë pa TVSH me objekt “Printim faturash”, konstatohet se:

Dorëzimi i faturave të muajit shtator është bërë me vonesë prej 31 ditësh, pasi ato duhej të dorëzoheshin brenda datës 15.10.2021, por nga kontraktuesi janë dorëzuar më datë 15.11.2021. Sa më lart kontraktuesi është në mospërputhje me nenin 23 pika 23.1 germa b, të kontratës Nr. 1059 Prot., datë 15.07.2021. ku parashikohet se:

*“Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.”*

Përlllogaritja e shumës së kamat vonesës paraqitet në tabelën nr. 4 të aneksit 2.7.3. Kontraktuesi i detyrohet AK në shumën 36,732 lekë për kamat vonesën. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 76-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**7.1.Rekomandim:** Nga ana e UKSH SHA të merren masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **36,732 lekë** nga përfaqësuesi ligjor i kompanisë A-C, si detyrim ndaj shoqërisë Ujësjetllës Kanalizimeve Shkodër për vonesë të dorëzimit të mallit.

*Deri më datë 31.12.2022*

Statusi i pranimit: Pranuar

**Përgjigje nga subjekti:**

Ky rekomandim është ne proces, është depozituar kërkesa padia ne Gjykatën Administrative Shkodër dhe mban nr. e çështjes gjyqësore 31170-00115-83-2023. Jemi ne pritje te seancave gjyqësore. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Automjete” zhvilluar në UKSH SHA për vitin 2020 me fond limit në vlerën e 7,738,750 lekë pa TVSH u konstatuan parregullsi përsa i përket afateve të ekzekutimit të kontratës me nr. 345 Prot., datë 09.03.2021, vlerë 9,060,000 lekë me TVSH, të nënshkruar midis UKSH SHA dhe operatorit të shpallur fitues “O.” SHPK. Afati i ekzekutimit të kontratës/dorëzimit të mallrave, është 15 ditë nga data e nënshkrimit ose me datë përfundimi deri në datën 23.03.2021. Fatura me nr. 737, datë 22.05.2021, është lëshuar nga operatori ekonomik “O.” SHPK për automjetin Iveco me targë AB...I . Vlera e faturuar është 3,330,000 lekë me TVSH. Fletë-hyrja është me nr. 19 dhe datë 22.05.2021. Fatura me nr. 738, datë 22.05.2021, është lëshuar nga operatori ekonomik “O.” SHPK për automjetin Ford Transit me targë AB...I . Vlera e faturuar është 5,730,000 lekë me TVSH. Fletë-hyrja është me nr. 19/1 dhe datë 22.05.2021. Lëshimi i faturave me këtë datë, vërteton qartësisht se mallrat kanë ardhur me vonesë. Referuar nenit 23 të kontratës bazë me nr. 345 Prot., datë 09.03.2021, “Likuidimi dëmeve për dorëzimin e vonuar”, pika 23.1, germa a), ku cilësohet se: *“Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të*

vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25 % të vlerës së kontratës”, UKSH SHA, Drejtoria Tregtare, duhej të kërkonte dëmshpërblimin në masën 25 % të vlerës së kontratës nga operatori ekonomik “O.” SHPK ose në vlerën **2,265,000 lekë** për dorëzimin e automjeteve jashtë afateve ligjore (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 76-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1. Rekomandim:** SHA Ujësjesllës Kanalizime Shkodër, Drejtoria Tregtare, Drejtoria Juridike, Drejtoria Ekonomike, të marrin masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin nga operatori ekonomik “O.” SHPK në llogari të UKSH SHA, të vlerës **2,265,000 lekë** që i përket penalitetit për vonesa me 61 ditë për dorëzimin e mallrave të prokuruar, jashtë afateve të përcaktuara në kontratë.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: Pranu

**Përgjigje nga subjekti:**

Ky rekomandim është në proces, është depozituar kërkesa padia dhe mban nr. e çështjes gjyqësore 311701-00113-83-2023. Seanca e radhës është me date 12.09.2023 pranë Gjykatës së Shkallës së Pare Administrative Tirane. Për arsye të transferimit të veprimtarisë së UKSH tek subjekti me kompetenca të përbashkëta Shoqëria Rajonale Ujësjesllës-Kanalizime Qarku Shkoder me NIPT-M37819701O, kemi njoftuar me email këtë të fundit për datën dhe orën e seancës gjyqësore me qëllim përfaqësimin dhe mbrojtjen e çështjes. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kontratës me nr. 873 Prot., datë 09.07.2019, me vlerë 47,011,350 lekë me TVSH, të lidhur midis UKSH SHA dhe operatorit ekonomik “A-K” SHPK, për objektin “Ndërtim i stacionit të pompimit dhe rrjeti ujësjesllës Kullaj”, u konstatuan diferenca në zëra punimesh. Njoftimi i përfundimit të punimeve drejtuar titullarit të UKSH SHA është me datë 30.12.2021 i nënshkruar nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve. Është nënshkruar nga personat më sipër, situacioni nr. 2 për periudhën e punimeve nga data 01.11.2020 deri 31.1.2020. Fatura është me nr. 23, datë 31.10.2019, numër serie 69960360 dhe vlerë 12,208.140 lekë me TVSH. Është kryer likuidimi sipas urdhër shpenzimit nr. 4, datë 19.11.2019 në vlerën e 11,597,733 lekë dhe me urdhër shpenzimin me nr. 5, datë 19.11.2019 në vlerën e 610,407 lekë. Në total është likuiduar vlera prej 12,208,140 lekë. Është nënshkruar nga mbikëqyrësi i punimeve, sipërmarrësi dhe investitori UKSH SHA, situacioni përfundimtar për periudhën e punimeve nga data 01.12.2021 deri 30.12.2021. Fatura elektronike është me nr. 194/2021, datë 31.12.2021 dhe vlerë 4,052,504 lekë me TVSH. Nuk është kryer likuidimi për këtë situacion.

-Në total, vlera e likuiduar nga UKSH SHA për llogari të operatorit ekonomik “A-K” SHPK, është 40,554,622 lekë. Nga auditimi në terren në datën 17.03.2022 për zërat e punimeve të kryera, u konstatuan diferenca në zëra punimesh dhe konkretisht:

- Tek situacioni përfundimtar, kapitulli “*Dhoma e Klorinimit, Stacionit të Pompimit, Dhoma e Manovrimit*”, zëri punimeve numër rendor 15, Nr.An. 2.181, Konstrukione metalike të përbëra, ton 0.989, vlera e faturuar me TVSH është 148,350 lekë. Nga auditimi në terren i këtij zëri dhe konkretisht në dhomën e klorinimit, nuk u konstatuan konstrukione metalike të vendosura. Si rezultat, vlera prej 148,350 lekë, është vlerë e faturuar tepër në situacionin përfundimtar.

- Tek situacioni përfundimtar, kapitulli “*Punime Elektrike*”, zëri punimeve numër rendor 7, Nr.An. AN, F.V ndriçues të jashtëm tip prozhektor, copë 12, vlera e faturuar me TVSH është 108,000 lekë ose 9000 lekë për një copë. Nga auditimi në terren i këtij zëri u konstatua se janë vendosur 8

ndriçues të jashtëm dhe jo 12. Pra 4 ndriçues më pak. Si rezultat, vlera prej  $4 \times 9000 = 36,000$  lekë, është vlerë e faturuar tepër në situacionin përfundimtar.

-Tek situacioni përfundimtar, kapitulli “*Punime Elektrike*”, zëri punimeve numër rendor 8, Nr.An. 2,a,113, Panel i matjes së energjisë 1/3 fazor, 10 poste sahat energjie, copë 1, vlera e faturuar me TVSH është 13800 lekë. Nga auditimi në terren i këtij zëri u konstatua se ky zë nuk është ekzekutuar. Si rezultat, vlera prej 13,800 lekë, është vlerë e faturuar tepër në situacionin përfundimtar.

Sa më sipër, vlera e faturuar tepër në situacionin përfundimtar dhe që përbën dëm ekonomik i cili duhet dëmshpërblyer nga OE “A-K” SHPK për llogari të UKSH SHA, është **198,150 lekë** (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 76-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**9.1. Rekomandim:** SHA Ujësjiellës Kanalizime Shkodër, Drejtoria Tregtare, Drejtoria Juridike, Drejtoria Ekonomike, të marrin masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin nga operatori ekonomik “A-K” SHPK në llogari të UKSH SHA, të vlerës **198,150 lekë** që i përket diferencave në zëra punimesh të pa ekzekutuara.

**Menjëherë**

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i pa zbatuar**.

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave për shpenzimet administrative për automjetet e UKSH SHA, u konstatua se institucioni përveç 19 automjeteve në pronësi të tij, kishte në dispozicion dhe në përdorim edhe tre automjete të tjera të cilat janë marrë me qira nga një operator ekonomik me afat 5 vjeçar. Konkretisht, nga auditimi i procedurave të prokurimit të kryera nga UKSH SHA, në SPE u konstatua një procedurë prokurimi me objekt “*Marrje automjete me qira*”, viti 2016, me fond limit 17.400.000 lekë pa TVSH. Fitues i procedurës së prokurimit, është shpallur operatori ekonomik “M. M.” SHPK. Në vazhdim, në datën 06.02.2017 (brenda afatit të auditimit) është lidhur kontrata e qirasë me nr. 136 Prot., midis operatorit ekonomik “M. M.” SHPK dhe UKSH SHA. Sa më sipër, nga momenti që UKSH SHA ka evidentuar se automjeti i marrë në dorëzim nga qiradhënësi ka qenë me defekt, mund të zgjidhte kontratën e qirasë konform germës (a) të nenit 12.2 të kontratës bazë. Në fakt UKSH SHA, ka vazhduar të paguajë qira dhe të përdori mjetin me targa AA...P të markës Mitsubishi Pajero në vend të mjetit të kërkuar nga UKSH SHA dhe të ofruar nga operatori ekonomik “M. M.” SHPK. UKSH SHA, është vënë në dijeni për këtë shkelje edhe nga auditimet e mëparshme të Kontrollit të Lartë të Shtetit por nuk ka marrë asnjë masë për të parandaluar shpenzimet e tepërta. Çmimi i qirasë i ofruar nga “M. M.” SHPK për automjetin Land Rover është 144,000 lekë pa TVSH në muaj dhe 8,640,000 lekë pa TVSH për 60 muaj. Nga investigimet e kryera lidhur me çmimin e qirasë së automjetit Mitsubishi Pajero (të pa ofertuar), u konstatua se qiraja e këtij automjeti është më e ulët se qiraja e automjetit të ofruar Land Rover. Gjithsesi, UKSH SHA mund ti referohej një çmimi të afërt me çmimet e qirasë së dy automjeteve të tjera. Konkretisht, mund të negocionte çmimin 72.000 lekë pa TVSH në muaj edhe për automjetin tip Mitsubishi Pajero. Mitsubishi Pajero i zëvendësuar me Land Roverin, për arsye teknike nuk plotëson (karakteristikat teknike dhe tipin e automjetit) fuqinë motorike sipas DT (Duhej Min-Max 190-2010 kf por është 118 kf). Meqenëse kontrata e qirasë është Leasing Operacional, atëherë edhe vlera e qirasë mund të ishte 72,000 lekë pa TVSH ose 86.400 lekë me TVSH në muaj. Llogaritur për 60 muaj, **penaliteti që i duhej mbajtur operatorit ekonomik “M. M.” SHPK** për mos përmbushje të kriterëve që ai vet ka ofruar, është 86.400 lekë x 60 muaj =

**5,184,000 lekë** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 43-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1.Rekomandim:** SHA Ujësjiellës Kanalizime Shkodër, Drejtoria Tregtare, Drejtoria Juridike, Drejtoria Ekonomike, të marrin masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin nga operatori ekonomik “M. M.” SHPK në llogari të UKSH SHA, të vlerës **5,184,000 lekë** që i përket diferencës së çmimit të qirasë së automjetit të prokuruar me automjetin e marrë në fakt në dorëzim.

*Menjëherë*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

**Përgjigje nga subjekti:**

Ky rekomandim është në proces, është depozituar kërkesa padia dhe mban nr. e çështjes gjyqësore 31183-00176-83-2023. Seanca gjyqësore e radhës është me date 12.09.2023. Për arsye të transferimit të veprimtarisë së UKSH tek subjekti me kompetenca të përbashkëta Shoqëria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Qarku Shkodër me NIPT-M37819701O, kemi njoftuar me email këtë të fundit pre datën dhe orën e seancës gjyqësore me qëllim përfaqësimin dhe mbrojtjen e çështjes. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**11. Gjetje nga auditimi:** UKSH ka kryer pagesa për shërbim mjekësor për periudhën 2016-2022, nëpërmjet kontratave të shërbimit me afat 1 vjeçar dhe të rinovuara çdo vit 3 mjekë në periudha të ndryshme kohore. Referuar legjislacionit, konstatohet se nga UKSHA, Shkodër nuk janë marra masa për të përcaktuar risqet e vendit të punës, nuk është bërë vlerësimi i riskut, vlerësimi i rezultateve parandaluese si edhe nuk jepen informacione në lidhje me rreziqet e vendit të punës, etj. Nuk janë përcaktuar kategoritë ku përfshihen punonjësit që kryejnë punë të rrezikshme për jetën ose punë të vështirë si edhe nuk është detajuar puna që do të kryejë mjeku.

-Nga auditimi konstatohet se për kryerjen e këtij shërbimi nga banka janë kryer pagesat mujore sipas kontratës të pa shoqëruara me dokument justifikues për kryerjen e shërbimit, pra mungon gjurma e auditimit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu III, pika 34/b. “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”.

-Mjekët e kontraktuar nga UKSHA, janë të punësuar paralelisht edhe në Spitalin Rajonal Shkodër, me kontratë kolektive pagë si personel mjekësor i spitalit dhe orar 8-16.

Sipas pagesave të kryera për periudhën e kontraktuar nga shoqëria z. P.Ç është paguar në shumën 1,360,000 lekë, zj. A.B është paguar në shumën 395,000 lekë dhe z. A.Sh është paguar në shumën 590,000 lekë. Shuma e pagesave për kryerjen e shërbimit “mjek në ndërmarrje”, përfituar padrejtësisht për periudhën 2016-Shkurt 2022, është **2,345,000 lekë** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 43-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1. Rekomandim:** Strukturat drejtuese të shoqërisë të marrin masa për ndërprerjen e kontratës së nënshkruar me objekt “Shërbimi me mjek”, duke analizuar legjislacionin në fuqi për domosdoshmërinë e kryerjes së këtij shërbimi, mundësitë financiare të shoqërisë me qëllim uljen e shpenzimeve të pajustificuara.

**11.2. Rekomandim:** Strukturat drejtuese të UKSH, pas bërjes me dije në rrugë shkresore mbi gjetjen dhe rekomandimin e KLSH, të kërkoj nga Spitali Rajonal Shkodër, që në bashkëpunim të marrin masa duke ndjekur rrugët ligjore për arkëtimin e shumës prej **2,345,000 lekë**, përkatësisht nga z. P.Ç shuma 1,360,000 lekë, zj. A.B shuma 395,000 lekë dhe z. A.Sh shuma 590,000 lekë, pagesa të përfituara padrejtësisht për periudhën 2016- Shkurt 2022 për kryerjen e shërbimit “mjek në ndërmarrje”.

Statusi i pranimit: Pranu

**Përgjigje nga subjekti:**

Ky rekomandim është pjesërisht në proces zbatimi. Kontrata me mjekun ka vazhduar, pasi është detyrim ligjor bazuar në ligjin nr. 10237, datë 18.02.2010, për sigurinë në punë dhe shëndetin në punë”. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i pa zbatuar**.

**D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nëpërmjet bankës janë kryer pagesa mujore në favor të kompanisë “M M” në vlerën 345,600 lekë/muaj sipas kontratës datë 06.02.2017 me vlerë 17,400,000 lekë pa tvsh, për kryerjen e shërbimit me objekt “Marrje me qira 3 makina”, nga të cilat 1 Land Rover dhe 2 Ford Ranger. Referuar kontratës së nënshkruar me afat 60 muaj (28.02.2017-19.02.2022) është likuiduar *shuma 20,673,600 lekë*.

Nga drejtoria nuk është bërë vlerësimi i riskut dhe efektivitetit nëse disponibiliteti i makinave do të sigurohej me efektivitet nëpërmjet blerjes dhe këto mjete të ishin ende në shërbim dhe pronësi të ndërmarrjes, apo të siguroheshin me procedurë marrje me qira me afat 5 vjet. Afati i zgjatjes së kontratës prej 5 vjet është i paargumentuar, si edhe në situatën financiare që ndodhet shoqëria marrja e mjeteve me qira është shpenzim i pajustificuar. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” Kreu II “Përgjegjësia menaxheriale” neni 8/1,5 dhe 8/b (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 43-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandim:** Strukturat drejtuese të shoqërisë të marrin masa për eliminimin e shpenzimeve pa efektivitet dhe të paargumentuara, të panevojshme për aktivitetin e shoqërisë me qëllim përmirësimin e rezultatit financiar.

*Në vijimësi*

Statusi i pranimit: Pranu

**Përgjigje nga subjekti:**

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Automjete” zhvilluar në UKSH SHA për vitin 2020 me fond limit në vlerën e 7,738,750 lekë pa TVSH u konstatua se UKSH SHA, ka përdorur për blerjen e automjeteve, fondin e akorduar nga AKUM, fond i cili duhej të investohej nga institucioni për makineri pajisje në funksion të arritjes së objektivave të Ujësjetës së atë të prodhimit dhe shpërndarjes së ujit për banorët ose për largimin e ujërave të ndotura. Detajimi i fondit, sipas shkresës me nr. 1241 Prot., datë 24.06.2019 të AKUM, cilësohet se ky fond, do të përdoret sipas pikës 8-b të Udhëzimit nr. 2 të MIE, datë 02.04.2019 për “*Miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subveconëve shtetërore për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjetës kanalizimeve*”. Tek pika 8, *Subvencioni*, nën-pika 8.6 (vi) e këtij udhëzimi cilësohet “*Për blerjen e makinerive, pajisjeve që ndihmojnë SHA UK në realizimin e objektivave, sipas biznes planit të miratuar*”. Vlera e akorduar nga AKUM për UKSH SHA, ka qenë e parashikuar të shpenzohej vetëm për zërin “Makineri Pajisje”. Sa më sipër, shpenzimi i kryer nga UKSH SHA për blerje automjetesh në

vlerën e 9,060,000 lekë, është shpenzim i cili është bërë në kundërshtim me ligjet dhe rregullat në fuqi dhe me parimet e ekonomicitetit, eficensës dhe efektivitetit të fondeve publike. Vlera e shpenzuar prej **9,060,000 lekë, konsiderohet shpenzim me efekt financiar negativ për UKSH SHA, në kundërshtim me parimet 3E.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 76-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandim:** SHA Ujësjiellës Kanalizime Shkodër, Drejtoria Tregtare, Drejtoria Juridike, të marrin masat që në të ardhmen, fondet e akorduara nga institucionet qendrore, të investohen vetëm në ato zëra për të cilat janë akorduar duke influencuar pozitivisht në rritjen e performancës së institucionit dhe arritjen e objektivave parësore.

*Në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Ky rekomandim është zbatuar dhe do të zbatohet në vazhdimësi.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

**3. Gjetje nga auditimi:** UKSH SHA, përveç 19 automjeteve në pronësi të tij, ka në dispozicion dhe përdorim edhe 3 automjete të marra me qira në vitin 2016, për 60 muaj ose 5 vjet, me vlerë 20,736,000 lekë me TVSH, sipas kontratës së qirasë me nr. 136 Prot., datë 06.02.2017, lidhur me OE “M. M.” SHPK. Sipas dokumentacionit, prej datës 03.03.2017, mjete me targa AA...A i markës Land Rover, është zëvendësuar me mjete me targa AA...P të markës Mitsubishi, për arsye se mjete me targa AA...A ka pësuar defekt në pjesën e brendshme të motorit, riparimi i së cilit kërkon një afat të gjatë kohe për tu riparuar nga prodhuesi.

UKSH SHA, është vënë në dijeni për këtë shkelje edhe nga auditimet e mëparshme të Kontrollit të Lartë të Shtetit por nuk ka **marrë asnjë masë për të parandaluar shpenzimet e tepërta**, duke vepruar në shkelje të kontratës me nr. 136 Prot., datë 06.02.2017 dhe konkretisht nenit 12.2 “Zgjidhja e kontratës nga qiramarrësi”, germa (d) ku cilësohet se: “Në rast të ndërprerjes së kontratës vitin e fundit të saj nga qiramarrësi, qiradhënësi nuk do të aplikojë penaltet për prishjen përpara kohe të saj”. Çmimi i qirasë i ofruar nga “M. M.” SHPK për automjetin Land Rover është 144,000 lekë pa TVSH në muaj ose 8,640,000 lekë pa TVSH për 60 muaj (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 76-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandim:** SHA Ujësjiellës Kanalizime Shkodër, Drejtoria Tregtare, Drejtoria Juridike, Drejtoria Ekonomike, të marrin masat që në të ardhmen, të zbatojnë me përpikmëri rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit duke i vlerësuar ato për një mirë përdorim të fondeve publike.

*Në vijimësi*

Statusi i pranimit: **Pranuar**

Përgjigje nga subjekti:

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi.**

### **3.10. Ujësjiellës Kanalizime Vlorë**

#### **PËRMBLEDHJE**

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim *KLSH*), ushtroi auditim në **Ujësjiellës Kanalizime SHA, Vlorë** mbi “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022” për auditimin e kryer në vitin 2022, për periudhën 01.04.2018 – 31.12.2021 paraqitur me shkresën e administruar

në KLSH me nr. 553/15 prot., datë 30.01.2023 (*administruar në subjekt me nr. 217 prot., datë 01.02.2023*), duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH<sup>së</sup> të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2022, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;

b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;

c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet të fondeve;

ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në subjekt u mbajt Akt Verifikimi nr. 1, datë 08.09.2023, administruar në Zyrën e UKV me nr. 217/5 prot, datë 08.09.2023, për të cilin nuk është paraqitur observacion nga ana e subjektit. Pas dërgimit të Projektraportit të Auditimit, nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observacione.

### **Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:**

#### **I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.**

*-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", UKV SHA ka respektuar këtë afat duke kthyer përgjigje sipas shkresës së administruar në institucion me nr. 217/4 prot., datë 20.02.2023.*

#### **II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.**

*-Nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas parashikimeve në Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna",*

#### **III. Rekomandimet e KLSH**

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 553/15 port., datë 30.01.2023 dhe në UKV SHA me nr. 217 prot., datë 01.02.2023, janë rekomanduar gjithsej:

a. Janë rekomanduar **19 masa organizative;**

b. Janë rekomanduar **8 masa për shpërblim dëmi në vlerën 15,135,681 lekë;**

c. Janë rekomanduar **6 masa për përdorimin me shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomikitetit, efikasitetit dhe efektivitetit në shumën 1,840,237,792 lekë;**

d. Janë rekomanduar **22 masa disiplinore në kompetencë të Titullarit të AK;**

#### **IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH**

Sipas shkresës së administruar në UKV SHA me nr. 217 prot., datë 01.02.2023, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si me poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
-----	----------------------	-------------	---------	------------



1	Organizative	19 masa	19 masa	0
2	Shpërblim dëmi	8 masa 15,135,681 lekë	7 masa 14,826,585 lekë	1 masë 309,096 lekë
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	6 masë 1,840,237,792 lekë	6 masë 1,840,237,792 lekë	0
4	Masa Disiplinore	22	22	-

## V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit

Në mënyrë të përbledhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	19 masa	3	4	12	-
2	Shpërblim dëmi	7 masa 14,826,585 lekë	-	-	7 masa 14,826,585 lekë	-
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	6 masë 1,840,237,792 lekë	1 masë 1,696,800 lekë	1 masë 1,262,456,739 lekë	4 masa 576,084,253 lekë	-
4	Masa Disiplinore	22	22	-	-	-

### I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 702/1, prot., datë 04.08.2023, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. A.L, (Përgjegjës grupi)
2. J.H.

### I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 553/15 prot., datë 30.01.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

### I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

### I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

## I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Ujësjellës Kanalizime SHA, Vlorë, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 553/15 prot., datë 30.01.2023, rezulton se nga **55** masa të rekomanduara (*organizative, shpërblim dëmi dhe 3-E, Disiplinore*), janë pranuar nga subjekti **54** masa ose 98 %. **Nga të pranuarat (54):** janë zbatuar plotësisht **26**, ose 48.1 % e tyre, janë zbatuar pjesërisht **5** masa ose 9.2 %, janë në proces zbatimi **23** masa ose 42.6 % dhe nuk ka asnjë masë pa zbatuar.

Nga sa shikohet niveli i realizimit është në masën 48.1 %, gjë e cila tregon se Ujësjellës Kanalizime SHA, Vlorë e ka vlerësuar procesin e zbatimit të rekomandimeve.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	19 masa	3	4	12	-
2	Shpërblim dëmi	7 masa 14,826,585 lekë	-	-	7 masa 14,826,585 lekë	-
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	6 masë 1,840,237,792 lekë	1 masë 1,696,800 lekë	1 masë 1,262,456,739 lekë	4 masa 576,084,253 lekë	-
4	Masa Disiplinore	22	22	-	-	-
<b>SHUMA</b>		<b>54</b>	<b>26</b>	<b>5</b>	<b>23</b>	<b>-</b>

## II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 48.1 % kurse ai i atyre në proces ose të zbatuara pjesërisht është 51.9 %, nivele këto të cila tregojnë vlerësimin pjesërisht të këtij procesi në lidhje me ndjekjen e procedurave të duhura për zbatimin e rekomandimeve.

## III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, UKV SHA, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 217/4 prot., datë 20.02.2023 duke respektuar kështu afatin 20 ditor të dërgimit.

III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”,

III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Ujësjellës Kanalizime SHA Vlorë administruar në KLSH me nr. 582/13 prot., datë 10.01.2022, dhe protokolluar në UKV SHA me nr. 54 prot., datë 14.01.2022, janë rekomanduar gjithsej:

29 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 2 masa, zbatuar pjesërisht 2 masa, në proces zbatimi 23 masa dhe e pa zbatuar 1 masë.

8 masa shpërblim dëmi, nga të cilat janë zbatuar 1 masë, të zbatuara pjesërisht 1 masë, në proces zbatimi 2 masa dhe të pa zbatuara 4 masa

11 masa për eliminimin e efekteve negative, nga të cilat janë zbatuar 1 masë dhe në proces zbatimi 8 masa dhe nuk janë zbatuar 2 masa

9 masa disiplinore, nga të cilat janë zbatuar 9 masa.

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa “j”.

(Më hollësisht në Pikën 1, faqe 15, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** UK Vlorë SHA të marrë masa për realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, me synim realizimin e objektivave dhe në përmbushjen e misionit të shoqërisë.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: I pranuar

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKV SHA janë rritur përpjekjet për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme. Konkretisht është marrë Vendimi nr. 4, datë 02.09.2022 me nr. 12 prot., datë 02.09.2022 me objekt *Për miratimin e Strukturës së NjAB*. Për sa i takon masave për shpërbim dëmi dhe atyre për përdorimin me EEE janë ende në proces.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe natyrës së tij, ky rekomandim konsiderohet si I pranuar dhe Në proces zbatimi.

**2. Gjetje nga auditimi:** Në total për vitet 2018-2021 nga UK Vlorë SHA janë zhvilluar 97 procedura prokurimi me vlera të vogla me fond limit në vlerën 39,914,183 lekë pa TVSH dhe realizim kontrate në vlerën 35,030,637 lekë pa TVSH me një diferencë mosrealizimi në vlerën 4,883,546 lekë pa TVSH. Me zgjedhje janë audituar në total 47 procedura prokurimi me vlera të vogla me fond limit në vlerën 23,904,893 lekë pa TVSH dhe realizim kontrate në vlerën 21,465,036 lekë pa TVSH ose në masën 59.8% e vlerës së fondit limit ku konstatohet se:

-Për vitin 2018 dhe 2019 nga UK Vlorë SHA nuk disponohet urdhri për ngritjen e komisionit të prokurimeve me vlera të vogla.

-Për vitin 2018 dhe 2019 në 2 raste janë shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëzuar fondin limit.

-Në 2 raste në dosjet e prokurimeve nga UK Vlorë SHA nuk disponohet urdhri i titullarit për nisjen e procedurës së prokurimit.

-Në 19 raste nuk dokumentohet kërkesa nga sektorët përkatës për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit, adresuar personit përgjegjës të prokurimit i cili duhet të administrojë dokumentacionin e çdo procedure prokurimi.

- Në 16 raste nuk argumentohet dhe dokumentohet mënyra e përlogaritjes së fondit limit.
- Në 3 raste fondi limit nuk është përlogaritur nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla por nga komisione kryesisht specialist të Zyrës së Financës referuar urdhrave respektiv të Administratorit të UK Vlorë SHA.
- Në 47 raste nuk është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlera të vogla.
- Në 30 raste në sistemin e prokurimit publik të APP-së nuk është dërguar ftesa për ofertë pesë operatorëve ekonomikë ndërkohë që objektin/shërbimin e përcaktuara në këto procedura e ofrojnë edhe operatorë të tjerë.
- Në 37 raste duke u bazuar në klasifikimin përfundimtar në sistemin e prokurimit publik të APP-së për operatorët ekonomikë të cilët janë s'kualifikuar nga ky klasifikim për të vazhduar më tej procedurën, nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla nuk janë mbajtur procesverbalet e s'kualifikimit të tyre.
- Në 24 raste duke bazuar në klasifikimin përfundimtar në sistemin e prokurimit publik të APP-së për operatorët ekonomikë të cilët janë kualifikuar për të vazhduar procedurën në klasifikimin përfundimtar nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla nuk janë mbajtur procesverbalet e tërheqjes apo s'kualifikimit të tyre.
- Në 16 raste në sistemin e prokurimit publik të APP-së nuk është respektuar afati i njoftimit (24 orë) pra kalimi nga një operatorë ekonomikë tek tjetri në rastet e tërheqjes apo s'kualifikimit të tyre.
- Në 2 raste kur fondi limit ka qenë i njëjtë midis operatorë ekonomikë, nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla nuk është zhvilluar procesi i hedhjes së shortit në prani të operatorëve por është njoftuar vetëm njëri prej operatorëve në sistemin e prokurimit publik të APP-së.
- Në 5 raste në dosjet e prokurimeve nuk disponohet të gjitha dokumentacionet e përcaktuara në kriteret e ftesës për ofertë (vërtetime që OE nuk është në proces falimentimi, pagesat mbi detyrimeve të kontributeve për sigurimet shoqërore, deklarata për përmbushjen e specifikimeve teknike, disponueshmërisë e mjeteve të transportit etj.) të cilat përbëjnë s'kualifikim të operatorëve për mos plotësimin e tyre ndërkohë që nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla edhe këto kriteret nuk janë përmbushur operatorët janë shpallur fitues.
- Në 13 raste mallrat nuk janë bërë hyrje në institucion brenda afateve të përcaktuara në kriteret e ftesës për ofertë.
- Në 32 raste fatura tatimore nuk është nënshkruar nga të anëtarët e komisionit.
- Në 2 raste bashkëlidhur faturës tatimore dhe fletë-hyrjes së mallrave në magazinë nuk ndodhet procesverbali i marrjes në dorëzim të mallrave.
- Në 25 raste kanë rezultuar vonesa nga UK Vlorë SHA në likuidimin e faturave tatimore ndaj operatorë ekonomikë duke sjell risk për krijimin e detyrimeve kontraktuale.
- Në 1 rast likuidimi i fature pjesore (siguracion automjeti) është kryer 42 ditë përpara lëshimit të faturës nga operatori ekonomikë.
- Në 4 raste deri më datën 16.09.2022, nuk janë likuiduar ende operatorët ekonomikë duke u krijuar detyrime kontraktuale ndaj tyre.
- Në 2 raste procedura e prokurimit ka mbetur në fazën e shpalljes fitues të operatorit ekonomikë pra nuk ka furnizim të mallrave apo likuidim të tyre. Nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla në lidhje me këtë situatë nuk është mbajtur asnjë procesverbal ku të jetë pjesë e dosjes së këtyre procedurave.
- Në 47 raste dosjet e procedurave të prokurimit me vlera të vogla nuk janë të inventarizuara dhe arkivuara.

Për sa më sipër në kundërshtim me Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 3 dhe neni 29 miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 40, pika 1, pika 3, pika 5, pika 8, neni 59, pika 2 dhe neni 64, pika 2, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, germa “a”, pikat 42-50, Udhëzimi nr. 3, datë 08.01.2018, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” i ndryshuar, pika 2, pika 5, pika 6, pika 9, pika 11, pika 12, pika 14, germa “a” dhe “b”, pika 19 dhe Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 12 dhe pika 16. (Më hollësisht në Pikën 1, faqe 18-19, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë, Drejtoria Tregtare dhe Dega Juridike të merren masa që të përcaktohen të gjitha të dhënat që lidhen me objektin e prokurimit, të dhënat teknike sasiore të mallit/shërbimit/punës që prokurohet, grafikun e lëvritimit, shërbimit/ punës objekt prokurimi, afatin e paraqitjes si dhe dokumentet që duhet të dorëzojë operatori ekonomik.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**3.** “Blerje programi për fiskalizimin e faturave dhe integritet me sistemin e Billing” viti 2021, me fond limit 588,000 lekë pa TVSH ku është shpallur fitues më datë 16.07.2021, OE “B E” me fond limit 580,000 lekë pa TVSH i cili ka lëshuar faturën tatimore nr. 2302/2022, datë 27.04.2021, në shumën 580,000 lekë shpenzim i cili deri më datë 16.09.2022, nuk është likuiduar. Ky shërbim është kryer pa dokumentacionin e plotë justifikues pasi në mbështetje të faturës tatimore nuk ndodhet procesverbali i marrjes në dorëzim të këtij shërbimi, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, germa “b”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 91-93 të Projektraportit të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** Nga organet drejtuese të shoqërisë të merren masat e duhura për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të shërbimeve, ndjekjen dhe dokumentimin e vijueshmërisë së tyre.<sup>1</sup>

*Menjëherë*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKV SHA është ngritur grupi i punës sipas rekomandimit.

**Komenti i audituesve:** Nga ana e UKV SHA sipas shkresës me nr. 2826/16 prot., datë 03.11.2022 është marrë në dorëzim shërbimi i kontratës me objekt *Fiskalizimi i faturave për vitin 2022*. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *I zbatuar*.

**4. Gjetje nga auditimi:** Gjatë analizimit të inventarit të shoqërisë u konstatuan 20 mjete të pa targuara që nuk ishin në përdorim si dhe mjete të tjera të cilat ishin të amortizuara plotësisht të

<sup>1</sup> Pas takimit ballafaques zhvilluar në ambientet e KLSH-së u vu në dispozicion dokumentacioni i cili provonte që Operatori Ekonomik “BNT Electronic” jep shërbimin mbi fiskalizimin e faturave dhe shërbimet E-billing.

cilat UKV duhet ti kishte nxjerrë jashtë përdorimit në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit SKK1.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr.22-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. Rekomandimi:** Ujësjetës Kanalizime Vlorë SHA të marrë masat për nxjerrjen jashtë përdorimi për automjetet e mësipërme të cilat janë të amortizuara dhe nuk plotësojnë elementet bazë për të qenë Aktive të shoqërisë

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKV SHA sipas shkresës me nr. 1528 prot., datë 17.07.2023 është ngritur Urdhri i Brendshëm me objekt *Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të AAM të propozuara për jashtë përdorimit* por që aktualisht nuk ka vepruar si komision.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit dhe faktit të sipërcituar rezulton se ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**5. Gjetje nga auditimi:** Gjatë filtrimi të të dhënave të nxjerra nga sistemi mbi regjistrimin e abonentëve të rinj me matëset përkatës për vitet 2018-2021, u gjetën problematika si më poshtë:

-55 Abonentë të rinj nuk kishin numër serial matësi,

-78 Abonentë të rinj kanë numër serial “0” dhe 65 Abonentë me numër vule “0”.

-1048 Abonentë të rinj kanë matësa me numër serial të njëjtë (dy ose tre abonentë më një numër serial matësi)

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr.22-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. Rekomandimi:** UK Vlorë SHA të marrë masat mbi korrigjimin dhe plotësimin e të dhënave të sakta mbi numrat serial dhe numrin e vulave të matësive të ujit si dhe të bëjnë verifikimet mbi pasojat që kanë sjellë këto problematika.

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKV, në zbatim të shkresës me nr. 217/3 prot., datë 19.06.2023 është hartuar ana e Kryetares së Degës së Shitjes *Relacioni* me nr. 1279 prot., datë 19.06.2023 sipas të cilit është bërë korrigjimi i serisë së matësit për 72 klientë/abonentë. Gjithashtu, për 1048 abonentët me numër të njëjtë numri serial janë verifikuar dhe kryer korrigjimet përkatëse për 256 abonentë. Jemi në proces për rregullimin e të gjitha problematikave të tjera.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të sipërcituar ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*. Verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës.

**6. Gjetje nga auditimi:** Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt *“Furnizim vendosje matësish uji”* për vitin 2019, në analizimin e hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta u konstatua se janë vendosur kriterë të cilat nuk ishin në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë:

Kriteri për pajisjen me licencë NS-12A duke qenë se A.K. nuk ka parashikuar montim dhe mirëmbajtje të një sistemi të plotë por vetëm montimin e matësive të ujit.

Vendosja e kriterit për në lidhje me numrin e punonjësve që duhet të jenë minimumi 30, kemi një mos rakordim me shtojcën nr.12 ku A.K. ka kërkuar që për realizimin e kontratës nevojiten 15 punonjës + stafi inxhinierik.

A.K. kërkon nga O.E. pjesëmarrës vërtetim nga Dega e tatim taksave për xhiron mesatare gjatë 3 viteve të fundit me vlerë jo më të vogël se fondi limit i kësaj procedure prokurimi, por duke qenë

se fondi prej 9,720,624 lekë pa TVSH është vlerë mbi kufirin e ulët monetar atëherë vlera e kërkuar nga A.K. nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Anomalitë e mësipërme janë gjetur dhe nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik, të cilët me anë të një emaili drejtuar shoqërisë i kërkon ndryshimin dhe korrigjimin e anomalive të sipërcituara, të cilat nuk janë marrë në konsideratë, në kundërshtim me Nenin 23 “*Specifikimet Teknike*”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr.36-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1. Rekomandimi:** UK Vlorë SHA në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**7. Gjetje nga auditimi:** Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “*Rrethimi i depove të ujit dhe Stacionet e Pompimit të SHA UK Vlorë*” për vitin 2019, në analizimin e hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta u gjetën kriterë të cilat nuk ishin në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë:

O.E. duhet të dëshmojë se ka të punësuar të paktën

2 teknik ndërtim

2 elektrikist

2 hidraulik

15 punonjës të kualifikuar me IQT profesione të ndryshme

70 persona të punësuar, për vlerën që ka procedura e prokurimit, përbën kriterë diskriminues për O.E. e tjerë.

Duke marrë parasysh vlerën dhe madhësinë e kontratës, kriteret e vendosura më sipër janë të fryra dhe nuk lejojnë pjesëmarrjen e O.E. të tjerë në garë, në kundërshtim me Nenin 23 “*Specifikimet Teknike*”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr.36-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**7.1. Rekomandimi:** UK Vlorë SHA, në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**8. Gjetje nga auditimi:** Gjatë analizimit të procedurës së prokurimit me objekt “*Blerje kompjuter dhe pajisje të tjera elektronike*” për vitin 2019, në hartimin e specifikimeve teknike kërkohet

produkti me emërtim “Macbook Air 13.3” i cili përkon me Brandin Apple dhe kategorisë Macbook. Gjithashtu produkti i mësipërm gjendet në kartelën e ish-administratorit të shoqërisë z. D.Xh i cili pas largimit nga detyra dhe nga institucioni nuk ka bërë dorëzimin mbi këtë produkt, në kundërshtim me Nenin 23 Pika 5<sup>2</sup> të ligjit të Prokurimit Publik Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr.28-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1. Rekomandimi:** UK Vlorë SHA gjatë hartimit të specifikimeve teknike të bazohet në legjislacionin në fuqi, duke mos krijuar pengesa mbi konkurrencën e drejtë si dhe të marrë masat që për personat që ndërpresin marrëdhëniet e punës me shoqërinë, të bëjnë dorëzimet mbi materialet e marra në dorëzim.

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht rekomandimi mbi specifikimet teknike. Për sa i përket dorëzimit të Macbook Air, aktualisht nga ana e ish Administratorit z. D.Xh nuk është bërë dorëzimi i këtij produkti.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër rezulton se rekomandimi konsiderohet si *I pranuar* por *Pjesërisht i zbatuar*.

**9. Gjetje nga auditimi:** Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje kapak pusetash metalik dhe zgara kunetash shiu dhe furnizim vendosje zgarash shiu në Lungomare 2020”, në analizimin e hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta u gjetën kriterë të cilat nuk ishin në proporcion me objektin e kontratës si më poshtë:

Inxhinier ndërtimi të pajisur me certifikatën për Mbrojtjen e shëndetit dhe të sigurisë në punë  
Inxhinier ndërtimi të pajisur me certifikatën për ndihmën e parë dhe ndërhyrje ndaj emergjencave,  
Kamionçina vetëshkarkuese 5 copë

Të ketë në pronësi ose me qira laborator të akredituar për kryerjen e testimeve dhe inspektimeve të ndryshme të materialeve të ndërtimit

Duke marrë parasysh vlerën dhe madhësinë e kontratës, kriteret e vendosura më sipër janë të fryra dhe nuk lejojnë pjesëmarrjen e O.E. të tjerë në garë, në kundërshtim me Nenin 23 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr.43-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1. Rekomandimi:** UK Vlorë SHA, në zhvillimin e procedurave të prokurimit, veçanërisht në hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta, të ketë parasysh që të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe në *proces zbatimi*.

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga analizimi i mbi likuidimin e kreditorëve të shoqërisë nuk gjendet ndonjë praktikë mbi mënyrën e likuidimit të tyre, respektimi të një radhe ose përdorimit të

<sup>2</sup> Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.



metodave ku të garantohet që të gjithë kreditorët të paguhen në kohë dhe në rastet kur kreditorët nuk janë paguar apo në rast ankesash për mos pagese nga kreditorët, ti shpjegohen rrethanat me arsyetimin përkatës, gjë që ka sjell kreditorë të mbartur ndër vite dhe të pa likuiduar.

Totali i kreditorëve të krijuar është 1,262,456,739 lekë pa TVSH.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr.32-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1. Rekomandimi:** UK Vlorë SHA të marrë masat si dhe të gjejë mënyrën mbi zvogëlimin e vlerës së kreditorëve dhe të arrijë të likujdojë duke respektuar parimin e kohës së krijimit të detyrimit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** UKV SHA ka vijuar punën duke kryer likuidime paralelisht, pra si ato të mbartura ndër vite edhe ato aktuale të krijuara rishtazi me qëllim vijueshmërinë normale të shërbimit të ujësjellësit.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër si dhe referuar argumenteve të dhëna nga subjekti, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *I zbatuar pjesërisht*.

**11. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt *“Ndërtim KUZ, rrjeti terciar (lidhjet familjare) për UK Vlorë”* rezulton se në lidhje me kriteret është bërë ankesë nga ana e OE C sipas shkresës së administruar në UKV SHA me nr. 786 prot., datë 25.03.2021 si dhe sugjerime nga ana e APP. Me marrjen e ankesës, nga ana e ish Titullarit është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit sipas shkresës me nr. 787 prot., datë 25.03.2021 deri në shqyrtimin e saj nga komisioni i shqyrtimit të ankesës (KSHA) me përbërje znj. J.K, z. M.N si dhe z. P.J. Sipas shkresës me nr. 807 prot., datë 26.03.2021 KSHA nuk ka marrë në konsideratë pretendimet e OE C dhe ky qëndrim është shprehur në formë vendimi edhe nga ana e ish Titullarit të AK. Ky vendim i është përcjellë OE të ankuar sipas shkresës me nr. 807/1 prot., datë 26.03.2021. Sipas dokumentit të administruar në UKV SHA me nr. 822 prot., datë 29.03.2021 rezulton se nga ana e APP janë bërë sugjerime në lidhje me kriteret. Me marrjen e njoftimit nga ana e APP përmes postës elektronike (dokumenti i protokolluar në UKV SHA me nr. 822 prot., datë 29.03.2021), sipas shkresës nr. 822/1 prot., datë 29.03.2021 Kryetari i NJP znj. E.G i ka kërkuar Komisionit të ngritur për sipas shkresës me nr. 398 prot., datë 10.02.2021 me përbërje znj. A.Xh, znj. K.K dhe znj. E.M, duke vënë në dijeni edhe ish Titullarin, në lidhje me e-mailin e dërguar nga ana e APP dhe ka kërkuar njëkohësisht edhe sqarimet nga ana e personave të mësipërm për të gjitha konstatimet e APP për të argumentuar e sqaruar ose ndryshuar kriteret e vendosura nga ana e këtij komisioni. Me shtojcën nr. 913 prot., datë 08.04.2021 është ndryshuar afati kohor për dorëzimin e ofertave nga data 19.04.2021, ora 11:00 deri më datën 26.04.2021, ora 11:00. Sipas shkresës nr. 914 prot., datë 08.04.2021 është hequr pezullimi i procedurës me Urdhër të ish Titullarit. Me shkresën nr. 822 prot., datë 16.04.2021, nga ana e Komisionit hartues të kriterëve dhe specifikimeve teknike janë ndryshuar kriteret e veçanta të kualifikimit, ndryshime këto një pjesë e të cilave rezultojnë të jenë edhe pjesë e ankesës së bërë nga ana e OE ankimues C, të cilat sipas KSHA dhe vendimit të ish Titullarit nuk qëndronin. Konkretisht kriteret e kërkuar për tu ndryshuar nga ana e OE dhe të ndryshuar pas sugjerimeve të APP janë ato në lidhje me kriteret e licencave dhe kategoritë e tyre si dhe kriteri në lidhje me numrin e të punësuarve. Pavarësisht sugjerimeve të APP dhe kërkesës së bërë nga ana e Kryetarit të NJP znj. E.G, nga ana e Komisionit hartues të kriterëve të veçanta të kualifikimit, përsëri (as në fazën e parë) **nuk është bërë argumentimi teknik dhe ligjor i kriterëve të vendosura/ndryshuara**. Sa më sipër është në

kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, neni 2, “Parimet e përzgjedhjes”, neni 20, “Mosdiskriminimi”, VKM nr. nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 26, “Kontratat për punë publike”, pikat 3 dhe 5, neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 3 si dhe Rregulloren e Brendshme e UKV SHA.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr.45-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1 Rekomandimi:** Nga ana e UKV SHA të merren masa për shqyrtimin e plotë të sugjerimeve të bëra nga ana e APP në rastet e konstatimit nga ana e këtij institucioni gjatë analizimit të dokumentacionit, të mospërputhjeve me dispozitat ligjore, si një vlerë e shtuar e procesit të prokurimit në tërësi.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**12. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën me objekt “Ndërtim KUZ, rrjeti terciar (lidhjet familjare) për UK Vlorë”, rezulton se janë vendosur kritere diskriminuese e të paargumentuara teknikisht dhe ligjërisht. Konkretisht rezultojnë të paargumentuara kërkesat si më poshtë:

Kriteri:

1. “Lejen e ndërtimit”

2. “Operatori/et ekonomike ofertues duhet të disponojnë licenca profesionale të shoqërisë për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me VKM nr.42 date 16.01.2008, i ndryshuar.

3. “Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë një punësim mesatar të paktën 250 punonjës me kohë të plotë pune për tre muajt e fundit Janar, Shkurt, Mars 2021.

4. “Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencat e lëshuara nga QKB si me poshtë

5. “Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij personel të kualifikuar / certifikuar;

6. “Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e punonjësve jo më pak se 30 (tridhjetë) punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga institucionet e akredituara sipas legjislacionit në fuqi, si dhe dëshmitë e kualifikimit profesional të lëshuar në përputhje me legjislacionin nga institucionet e arsimit të akredituara.

7. “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Tabela nr. 1, Aneksi nr. 1)

Kërkesat rezultojnë të paargumentuara, diskriminuese dhe jo në përputhje me domosdoshmëritë që paraqet realizimi i këtij investimi. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, neni 2, “Parimet e përzgjedhjes”, neni 20, “Mosdiskriminimi”, VKM nr. nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 26, “Kontratat për punë publike”, pikat 3 dhe 5, neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 3 si dhe Rregulloren e Brendshme e UKV SHA.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr.45-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1 Rekomandimi:** Nga ana e UKV SHA të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kriterëve në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencës dhe ekonomikitet si dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për një konkurrencë të lirë e të ndershme.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**13. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën me objekt “Ndërtim KUZ, rrjeti terciar (lidhjet familjare) për UK Vlorë”, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit është shpallur fitues OE i vetëm pjesëmarrës OE G. 2 me të cilin sipas aktit me nr. 1658 prot., datë 29.06.2021 është lidhur kontrata e sipërmarrjes së punimeve mes Autoriteti Kontraktor UKV SHA e përfaqësuar nga ish Titullari z. Sh.L dhe OE G. 2 e përfaqësuar nga znj. A.U me vlerë të kontratës 328,106,325.228 lekë me TVSH dhe me afat zbatimi kontrate 6 muaj. Sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga ana e OE G. 2, referuar materialeve si më sipër, e kryesisht atyre fotografike rezulton se nga ana e Autoritetit Kontraktor e konkretisht komisionit të ndjekjes së punimeve z. K.M, znj E.M, z. N.C dhe z. K.L si dhe mbikëqyrësit të punimeve z. F.B, është lejuar kryerja e punimeve nga nënkontraktorë të pa miratuar dhe të padeklaruar nga ana e sipërmarrësit të punimeve G. 2. Konkretisht konstatohet se këto punime janë kryer nga shoqëria sipërmarrëse e punimeve E me NIPT L-T. Nga materialet konstatohet gjithashtu se mjetet e përdorura gjatë punimeve nuk janë ato për të cilat OE është shpallur fitues i procedurës së prokurimit. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 61, “Objekti dhe qëllimi”, pika 1 dhe 2, VKM nr. nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 75, “Nënkontraktimi”, pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7, kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes të lidhur sipas aktit me nr. 1662 prot., datë 30.06.2021.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr.45-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1 Rekomandimi:** Nga ana e UKV SHA të merren masa për kryerjen e një monitorimi efikas të kontratave të zbatimit me qëllim arritjen e objektivave të investimit përmes një procesi ligjor që nga nisja e procesit të prokurimit e deri në përfundim të zbatimit të punimeve.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Aktualisht nga ana e UKV SHA për investimet e prokuruar në vijimësi është caktuar për secilin prej tyre një monitorues kontrate.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *I zbatuar*. Megjithatë, konfirmimi i këtij rekomandimi do të bëhet përsëri në auditimin e radhës.

**14. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën me objekt “Ndërtim KUZ, rrjeti terciar (lidhjet familjare) për UK Vlorë”, rezulton se në lidhje me këtë praktikë kontrata është lidhur me datë 29.06.2021 dhe punimet janë deklaruar se kanë filluar me datë 20.09.2021. Nga analiza e zërave të situacionit nr. 1 rezulton se OE ka kryer një volum pune për periudhën 20 shtator 2021 – 30 nëntor 2021 në shumën prej 68,423,504 lekë pa TVSH. Grupi i auditimi ka bërë një analizë duke krahasuar volumet e situacionuara me ato të parashikuara

sipas grafikut të punimeve të cilat paraqiten në Anekse, Tabela nr. 2. Pas kërkesës për dokumentacion nga ana e subjektit u dorëzuan vetëm raportet mujore duke filluar nga ai për muajin nëntor 2021 dhe nuk rezultojn të jetë hartuar asnjë raport mujor për muajt shtator dhe tetor 2021. Nga 34 mjete/makineri/pajisje që janë kërkuar në Dokumentet e Tenderit e që njëkohësisht janë cilësuar si të nevojshme nga ana e AK për realizimin e punimeve, rezultojn se në kantier pretendohet se janë realizuar këto volume pune me 10 punëtorë dhe me vetëm prezencën e drejtuesit teknik dhe të asnjë prej inxhinierëve të tjerë të kërkuar kur në fakt janë kërkuar 250 të punësuar të total. Me stafin, mjetet dhe afatin si më sipër nga ana e mbikëqyrësit të punimeve është certifikuar si i kryer ndër të tjera edhe volumi i punës prej 22,410 ml tub HDPE, volum ky i cili është praktikisht i pamundur në rrethanat e sipërpërmendura. Nga ana e mbikëqyrësit janë deklaruar si të realizuara volumet e punimeve në 118 akse rrugore të qytetit të Vlorës, situatë kjo e cilat është praktikisht e pamundur në kushtet si më sipër. Një veprim i tillë e denatiron krejtësisht procesin e prokurimit dhe kuptimin e garës publike për vet faktin se AK ka kërkuar ndaj OE kapacitete teknike, ligjore dhe mbi të gjitha financiare.

Deri në përfundim të auditimit në terren nuk rezultojn të jenë kryer pagesa ndaj sipërmarrësit të punimeve për situacionin nr. 2.

Sipas shkresës së administruar në institucion me nr. 586 prot., datë 15.03.2022, rezultojn se në datë 10.03.2022 është bërë një kërkesë nga ana e mbikëqyrësit z. F.B, për shtyrjen e afatit të realizimit të punimeve. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nuk rezultojn të këtë asnjë miratim nga ana e AK në lidhje me miratimin e kësaj kërkesë.

Sipas kontratës së nënshkruar mes AK dhe OE G. 2 rezultojn se afati i fillimit të punimeve është parashikuar të jetë data e lidhjes së kontratës dhe marrjen e lejes së ndërtimi. Duke qenë se sheshi i ndërtimit është liruar me datë 20.09.2021 rezultojn se afati i përfundimit të punimeve duhet të ishte data 20.03.2022. Në fakt sipas korrespondencave të përshkruara më sipër rezultojn se punimet janë ende në proces dhe kontrata është amenduar sipas aktit me nr. 801 prot., datë 06.04.2022 me një afat të shtyrjes së punimeve me 6 muaj, duke konsideruar si datë të përfundimit të punimeve 29.09.2022. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7/1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr.45-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1 Rekomandimi:** Nga ana e UKV SHA të merren masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës me qëllim analizimin e situatës në lidhje me praktikën e situacionit nr. 1 duke identifikuar akset konkrete së bashku me volumet respektive (librezat e masave, vizatimet sipas faktit, dokumente të tjera të nevojshme), si dhe dokumentacionit fotografik të mjeteve të përdorura gjatë zbatimit, kjo për të bërë një krahasim mes kapaciteteve reale të shfaqura nga kontraktori gjatë punimeve me ato të reflektuara në situacionin nr. 1 dhe nxjerrjen e një konkluzioni mbi vërtetësinë apo fiktivitetin e kësaj pagese.

***Brenda përfundimit të kontratës***

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër si dhe në mungesë të analizimit të argumenteve, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar dhe Pjesërisht i zbatuar*.

**14.2 Rekomandimi:** Nga ana e UKV SHA të merren masa për analizimin e argumenteve të paraqitura nga ana e kontraktorëve për shtyrjen e punimeve.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër si dhe në mungesë të analizimit të argumenteve, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Pjesërisht i zbatuar*.

**15. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje materiale hidraulike, viti 2021*” rezulton se pas anulimit të procedurës së parë, janë hartuar Urdhrat e rinj për rinisjen e procedurës së prokurimit. Pas ri njoftimit të kontratës, me shkresën e administruar në UKV SHA me nr. 876 prot., datë 02.04.2021 rezulton se nga ana e APP janë bërë rekomandime për saktësimin/riformulimin e kriterëve me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen në plotësimin e tyre nga ana e OE ofertues të cilat mund të mbarten edhe gjatë procesit të vlerësimit nga ana e KVO. Me shkresën nr. 876/1 prot., datë 02.04.2021 nga ana e personit përgjegjës për prokurimin znj. E.G është bërë një kërkesë për sqarim drejtuar komisionit hartues të kriterëve dhe për dijëni ish Titullarit të AK z. Sh.L. Sipas kësaj shkrese është kërkuar sqarim nga ana e komisionit për të gjitha pikat e kryera nga ana e monitorimit të APP për të argumentuar, sqaruar ose ndryshuar kriteret e vendosura nga ana e tij. Nga auditimi rezulton se kjo shkresë nuk ka marrë përgjigje dhe në vijim është vazhduar procedura e prokurimit pa argumentuar teknikisht dhe ligjërisht kriteret e cituara në shkresën e APP. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, neni 1, “*Objekti dhe qëllimi*”, neni 2, “*Parimet e përzgjedhjes*”, neni 20, “*Mosdiskriminimi*”, VKM nr. nr. 914, datë 29.12.2014, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, ndryshuar, neni 27, “*Kontratat e mallrave*”, pikat 1 dhe 3, neni 57, “*Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit*”, neni 61, “*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*”, pika 3 si dhe Rregulloren e Brendshme të UKV SHA.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr.62-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**15.1 Rekomandimi:** Nga ana e UKV SHA të merren masa për shqyrtimin e plotë të sugjerimeve të bëra nga ana e APP në rastet e konstatimit nga ana e këtij institucioni gjatë analizimit të dokumentacionit, të mospërputhjeve me dispozitat ligjore, si një vlerë e shtuar e procesit të prokurimit në tërësi me qëllim krijimin e kushteve të përshtatshme për një konkurrencë të lirë e të ndershme.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**16. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën me objekt “*Blerje materiale hidraulike, viti 2021*”, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit është shpallur fitues BOE i vetëm i kualifikuar nga 2 pjesëmarrës në total. Konkretisht fitues është shpallur BOE A.C. & A. S. me të cilin sipas aktit me nr. 1257 prot., datë 18.05.2021 është lidhur kontrata e sipërmarrjes së punimeve mes Autoriteti Kontraktor UKV SHA e

përfaqësuar nga ish Titullari z. Sh.L dhe BOE me vlerë të kontratës 56,383,692 lekë me TVSH dhe me afat zbatimi kontrate 12 muaj. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës si dhe nga verifikimi me zgjedhje i produkteve objekt kontrate rezultoi se nuk përputhen me specifikimet teknike disa prej tyre. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, VKM nr. nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 77, “Mbikëqyrja e kontratës”, kontrata me nr. 1257 prot., datë 18.05.2021, neni 8 Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet, neni 9 Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike dhe neni 12 Testimet dhe Inspektimet tek Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, Urdhri i ish – Titullarit nr. 170 prot., datë 20.01.2021, Urdhri i ish – Titullarit nr. 1262 prot., datë 18.05.2021 si dhe Rregulloren e Brendshme e UKV SHA.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr.62-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**16.1 Rekomandimi:** Nga ana e UKV SHA të merren masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës me qëllim identifikimin e produkteve konkrete të sjella nga ana e BOE A.C & A. S në zbatim të kontratës së lidhur sipas aktit nr. 1257 prot., datë 18.05.2021 me objekt ‘Blerje materiale hidraulike, viti 2021’. Për produktet e dorëzuara jo në përputhje me parametrat e kërkuar të rivlerësohet çmimi njësi i tyre si dhe të analizohet nevojshmëria ose jo e AK për ato produkte. Në çdo rast çmimet e reja për produktet duhet të marrin në konsideratë uljen nga e çmimi i tregut sipas përqindjes së uljet nga BOE nga vlera e fondit limit.

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga UKV SHA, sipas shkresës nr. 884 prot., datë 25.04.2023 është ngritur komisioni përkatës për zbatimin e këtij rekomandimi nga ana e të cilit, sipas relacionit me nr. 887/1 prot., datë 10.05.2023 i cili ka verifikuar produktet objekt kontrate. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *I zbatuar*.

**17. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “Përmirësime të sistemit me ujë në lagjet ish-fabrika e Çimentos-Partizani-Karabash, dhe rindërtimi i ujësjellësit në Babicë të vogël, njësia administrative Qendër Vlorë, viti 2021” rezultoi se nga analiza e relacionit me nr. 350 prot., datë 05.02.2021 jo të gjithë elementët e përmendur në sugjerimin e bërë nga ana e APP janë trajtuar nga ana e këtij Komisioni. Konkretisht rezultojnë të pa trajtuara ato në lidhje me argumentimin e numrit të lartë të inxhinierëve, disponimit të inxhinierit gjeolog dhe atij gjeoteknik. Përveç sa më sipër, sugjerimi i APP nuk ka marrë përgjigje as në lidhje me argumentimin teknik e njëkohësisht edhe ligjor të numrit të mjeteve, të punësuarve dhe të stafit drejtues duke bërë që procedura e prokurimit të vijojë pa argumentuar teknikisht dhe ligjërishit kriteret e cituara në shkresën e APP. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, neni 2, “Parimet e përzgjedhjes”, neni 20, “Mosdiskriminimi”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 26, “Kontratat për punë publike”, pikat 3 dhe 5, neni 57 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 3 si dhe Rregulloren e Brendshme e UKV SHA.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr.71-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**17.1 Rekomandimi:** Nga ana e UKV SHA të merren masa për shqyrtimin e plotë të sugjerimeve të bëra nga ana e APP në rastet e konstatimit nga ana e këtij institucioni gjatë analizimit të

dokumentacionit, të mospërputhjeve me dispozitat ligjore, si një vlerë e shtuar e procesit të prokurimit në tërësi me qëllim krijimin e kushteve të përshtatshme për një konkurrencë të lirë e të ndershme.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**18. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “*Përmirësime të sistemit me ujë në lagjet ish-fabrika e Çimentos-Partizani-Karabash, dhe rindërtimi i ujësjellësit në Babicë të vogël, njësia administrative Qendër Vlorë*”, për sa i takon dokumentacionit të fituesit rezultojnë se BOE i shpallur fitues nuk plotëson kriteret si më poshtë:

Kriteri:

1. “*Për të provuar se ka përvojën e duhur, Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar mesatarisht të paktën 160 (njëqind e gjashtëdhjetë) punonjës, për periudhën (Qershor 2020 - Nëntor 2020), llogaritur mbi bazën e kohës së plotë të punës.*”

2. “*Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencat e lëshuara nga QKB si me poshtë:*

- *Licencë për grumbullim, transportim dhe riciklimin e mbetjeve jo të rrezikshme ( mbetje inerte),kodi III .2.B*

3. “*Operatori ekonomik duhet të ketë 3 (tre) ekspert për hartimin e raporteve të VNM-së për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për problemet mjedisore dhe të thirret si ekspert për të vlerësuar një raport VNM apo rezultatet e auditimit, të shoqëruar me certifikatën e lëshuar nga autoriteti kompetent në bazë të VKM –së nr. 122, datë 17.02.2011, i ndryshuar.*”

Sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezultojnë se oferta e BOE .A.K. & L. nuk është shoqëruar me analizat teknike për çdo zë punimi ndërtimor, sipas formatit të unifikuar dhe programit të miratuar dhe metodologjisë së përcaktuar në kreun I të Udhëzimit nr. 2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave, si dhe VKM nr. 514, datë 15.8.2007.

Përveç sa më sipër, rezultojnë se nga ana e BOE .A.K. & L. janë vënë në dispozicion mjete dhe staf teknik ( të deklaruar si të dedikuar ekskluzivisht për këtë kontratë ) të cilët rezultojnë të angazhuar edhe në kontrata të tjera paralele duke qenë kështu në kushtet e deklarimit të rremë me qëllim kualifikimi.

Si konkluzion nga sa më sipër rezultojnë se është favorizuar padrejtësisht BOE .A.K. & L. përmes kualifikimit dhe shpalljes fitues edhe pse me mangësi në dokumentacion dhe në drejtim të plotësisht të kriterëve si më sipër.

Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*”, Titulli IV Parimi i detyrimit të besnikërisë, neni 14, pika 1 dhe neni 163, ligjin 10 296 datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar Kreu II, *Përgjegjshmëria Menaxheriale*, neni 8, pika 1 dhe 8, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, neni 1, “*Objekti dhe qëllimi*”, neni 46, “*Kualifikimi i Ofertuesve*”, neni 53, “*Shqyrtimi i Ofertave*”, pika 3 dhe pika 5, germa c, VKM nr. nr. 914, datë 29.12.2014, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, ndryshuar, neni 66, “*Kualifikimi i ofertuesve*” si dhe Rregulloren e Brendshme e UKV SHA.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr.71-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**18.1 Rekomandimi:** Nga ana e UKV SHA të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlera të vogla për vitet 2018-2021 konstatohet se, në 2 raste likuidimi i tyre është kryer pa dokumentacionin e plotë justifikues konkretisht:

1. “*Dreke festive me rastin e 8 marsit*” viti 2018, me fond limit 100,000 lekë pa TVSH ku është shpallur fitues më datë 07.03.2018, OE “A.T.V” me fond limit 97,000 lekë pa TVSH i cili ka lëshuar faturën tatimore nr. 74, datë 18.03.2018, në shumën **104,760 lekë** me TVSH likuiduar me transaksionin e datës 11.05.2018, në V Bankë. Likuidimi i kësaj procedure është kryer pa dokumentacionin e plotë justifikues pasi në mbështetje të faturës tatimore nuk ndodhet lista emërore e miratuar nga Administratori i UKV SHA për punonjësit të cilët do të marrin pjesë në këtë aktivitet si dhe procesverbali i nënshkruar prej punonjësve të cilët kanë marrë pjesë në këtë aktivitet festiv.

2. “*Aktivitet festiv me rastin e 8 marsit*” viti 2019, me fond limit 200,000 lekë pa TVSH ku është shpallur fitues më datë 08.03.2019, OE “A.T.V” me fond limit 198,000 lekë pa TVSH i cili ka lëshuar faturën tatimore nr. 50, datë 08.03.2019, në shumën **204,336 lekë** me TVSH likuiduar me transaksionin e datës 05.07.2019, në I.S.P Bankë. Likuidimi i kësaj procedure është kryer pa dokumentacionin e plotë justifikues pasi në mbështetje të faturës tatimore nuk ndodhet lista emërore e miratuar nga Administratori i UKV SHA për punonjësit të cilët do të marrin pjesë në këtë aktivitet si dhe procesverbali i nënshkruar prej punonjësve të cilët kanë marrë pjesë në këtë aktivitet festiv.

**1.1 Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Vlorë të merren të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e **vlerës prej 309,096 lekë**, nga personat të cilët kanë shkaktuar këtë dëm ekonomikë ndaj buxhetit të Shoqërisë. Për këtë të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit.

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: *I papranuar*

**2.Gjetje nga auditimi:** “*Kryerje shërbimi për Avolxhim elektromotorësh*”, për nevoja të SHA UK Vlorë” viti 2019, me fond limit 780,000 lekë pa TVSH ku është shpallur fitues më datë 06.01.2020, OE “E” me fond limit 672,000 lekë pa TVSH i cili ka lëshuar faturën tatimore nr. 49, datë 10.01.2020, në shumën **806,400 lekë** me TVSH likuiduar me transaksionin e datës 07.08.2020, në Union Bankë. Likuidimi i kësaj procedure është kryer pa dokumentacionin e plotë justifikues pasi në mbështetje të faturës tatimore nuk ndodhet procesverbali i kryerjes dhe marrjes në dorëzim të këtij shërbimi.



**2.1 Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Vlorë të merren të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej 806,400 lekë nga personat përgjegjës. Për këtë të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërbllimin e dëmit.

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKV SHA pas njoftimit për arkëtim vullnetar sipas shkresës me nr. 1112 prot., datë 26.05.2023, sipas shkresës me nr. 1547/3 prot., datë 18.07.2023 është bërë kërkesë padi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me objekt detyrimin e subjektit E të kthimit të shumës së përfiturar me pasojë dëm ekonomik në shumën prej 806,400 lekë në llogari të UKV SHA.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të sipërcituar rezulton se ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**3. Gjetje nga auditimi:** Referuar auditimit të dy procedurave të prokurimit me vlera të vogla të realizuara përgjatë vitit 2018 me objekt “*Sigurimi i mjeteve motorike të UKV Sh.a*”, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet përkatëse kartelat e automjeteve, pajisjen me siguracione të mjeteve, inventarin kontabël dhe sasisë e tërhequr të karburantit nga magazina për secilin mjet ku konstatohet se:

Me shkresën nr. 69 prot., datë 23.01.2019, është kryer procesi i inventarizimit për mjetet e transportit të UKV SHA për vitin 2018.

Me shkresën nr. 28 prot., datë 11.01.2019, është përgatitur relacioni për inventarët e vitit 2018, drejtuar Këshillit të Administrimit nga znj. R.A me detyrë Drejtor Tregtar ku është paraqitur propozimi për nxjerrje jashtë përdorimit për pesë automjete.

Me shkresën nr. 789 prot., datë 11.07.2019, me Urdhër të Brendshëm të Administratorit të UKV SHA z. D.Xh është ngritur komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve dhe aktiveve afatgjata materiale i përbërë nga znj. A.Xh kryetare e komisionit dhe anëtarët z. A.B, z. P.Sh, z. E.V, z. M.K, z. A.Gj, z. A.L, znj. E.P, z. D.Z.

Me procesverbalin mbi vlerësimin për nxjerrje jashtë përdorimit të vlerave materiale të datës 20.12.2019, të mbajtur nga anëtarët e komisionit të sipërpërmendur, si pjesë e tabelës së këtij procesverbali citohet se, “Shitje me procedurë për pesë mjete të cilat ndodhen jashtë përdorimit” konkretisht për mjetet, Autoveturë (8+1) marka Benz VL...C, ATM (furgon) tip ford targa VL...C, Mjet Piaggio APE (3RR) e kuqe, mjet teknologjik ekskavator me rrota pneumatike dhe autoveturë (4+1) tip Benz targa VL...B e bardhë. Në kushte të tilla janë kryer verifikimet për sasinë e tërhequr të karburantit nga magazina për këto pesë mjete të cilat kanë dalë jashtë përdorimit ku konstatohet se, për mjetin Piaggio APE (3RR) ngjyrë e kuqe e pa targuar edhe pse bazuar në fletën e inventarit dhe në procesverbalin e datës 20.12.2019, në të cilën ky mjet ka dalë jashtë përdorimit, ka vazhduar të tërhiqet dhe të konsumohet karburant në sasinë 3,597.29 litra në shumën 548,926 lekë deri në muajin prill të vitit 2021, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, pikat 5-10, pikat 35-36. Për sa trajtuar më sipër, vlera totale prej 548,926 lekë përbën dëm ekonomikë për Buxhetin e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime SHA Vlorë.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 91-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1 Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Vlorë të merren të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej 548,926 lekë, nga personat të cilët kanë

shkaktuar këtë dëm ekonomikë ndaj buxhetit të Shoqërisë. Për këtë të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit.

*Menjëherë*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKV SHA pas njoftimit për arkëtim vullnetar sipas shkresës me nr. 1113 prot., datë 26.05.2023, sipas shkresës me nr. 1547/5 prot., datë 18.07.2023 është bërë kërkesë padi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me objekt detyrimin e subjektit F të kthimit të shumës së përfiturar me pasojë dëm ekonomik në shumën prej 548,926 lekë në llogari të UKV SHA.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të sipërcituar rezulton se ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**4. Gjetje nga auditimi:** Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje matësa uji” për vitin 2018 morrën pjesë 7 O.E. ku fitues u shpall O.E. “F.G shpk” me ofertë 16.695.000 lekë pa tvsh, oferta më e lartë. Pas analizimi të procesverbalit mbi hapjen e ofertave dhe mbi arsyet e s’kualifikimit të O.E. të tjerë pjesëmarrës, për O.E. A. sh.p.k. arsyet e s’kualifikimi nuk qëndrojnë, të analizuara si më poshtë:

Sipas A.K. në faqen e dytë të dokumentit me emër “Certifikata Aprovimi për përdorim uji të pijshëm” nuk ka asnjë të dhënë mbi tipin e matësit që është certifikuar, sipas grupit të auditimit nuk qëndron pasi tipi i matësit që i është dhënë certifikata, gjendet në faqen e parë.

Sipas A.K. nuk janë paraqitur manualët e matësive të përdorimit në katalog por pas verifikimit të dokumentacionit të sjellë nga O.E. A ShPK arsyeja e mësipërme për s’kualifikim nuk qëndron pasi manualët e matësive janë të ngarkuara në sistemin e prokurimit.

Sipas A.K. Q1 i matësit ultrasonik të ofruar është 40 litra për orë ndërkohë që është kërkuar të jetë i barabartë ose më i vogël se 13 litra për orë bazuar në specifikimet teknike, por sipas përgjigjes nga O.E. dhe nga analizimi nga grupi i auditimit ofrimi i një matësi që mat 40 litra për orë, i kalon specifikimet teknike.

Dy arsyet e tjera mbi s’kualifikimin e O.E. janë paraqitja e baterive si mostër të matësit ultrasonik me jetëgjatësi 10 vjet ndërkohë që në specifikimet teknike është kërkuar 15 vjet, por që garancia e matësve të kërkuar në specifikimet teknike është 10 vite gjithashtu edhe për paraqitjen si mostër e matësit TK-3C e të matësit TK-5C është 1” por në përmasat 1 ½, të cilat sipas grupit të auditimit mund të kishin kërkuar sqarime të mëtejshme mbi produktet e paraqitura.

Sipas grupit të auditimit, nga analiza e situatës së mësipërme duke marrë parasysh dhe diferencën prej 4,328,600 lekë pa TVSH midis ofertës së dy operatorëve si dhe duke u bazuar në Nenin 53 Pika 4<sup>3</sup> të ligjit nr. Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar, “Për prokurimin publik”, duke i klasifikuar arsyet e mësipërme në devijime të vogla, oferta e O.E. A sh.p.k. duhej të ishte pranuar dhe të ishte shpallur fituese, pra duke i shkaktuar një dëm shoqërisë në vlerën 4,328,600 lekë pa TVSH.

*(Më hollësisht në Pikën 2, faqe 28-29, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Vlorë të merren të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej 4,328,600 lekë, nga personat të cilët kanë shkaktuar këtë dëm ekonomikë ndaj buxhetit të Shoqërisë. Për këtë të ndiqen të gjitha procedurat

---

<sup>3</sup> Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj

e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit.

*Menjëherë*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKV SHA pas njoftimit për arkëtim vullnetar sipas shkresës me nr. 1113/1 prot., datë 26.05.2023, sipas shkresës me nr. 1547/4 prot., datë 18.07.2023 është bërë kërkesë padi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me objekt detyrimin e subjektit F.G të kthimit të shumës së përfituar me pasojë dëm ekonomik në shumën prej 4,328,600 lekë në llogari të UKV SHA.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të sipërcituar rezulton se ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**5. Gjetje nga auditimi:** Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “*Blerje materiale hidraulike*” për vitin 2018 morën pjesë 4 O.E. ku fitues u shpall O.E. “A.C dhe A.S.G” me ofertë 30,556,640 lekë pa TVSH. Pas analizimit të procesverbalit mbi hapjen e ofertave dhe mbi arsyet e s’kualifikimit të O.E. të tjerë pjesëmarrës, për O.E. J SHA arsyet e s’kualifikimi nuk qëndrojnë, të analizuar si më poshtë:

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.5 në lidhje me mostrat e paraqitura kur supozohet që nuk janë paraqitur të gjitha mostrat e kërkuara ku në përgjigje nga O.E. në fjalë është sqaruar se është sasi e madhe mostrash dhe produktesh në specifikimet teknike gjë që bën të vështirë, si dhe nga vetë Autoriteti Kontraktues në përgjigjen nr. 611 Prot., datë 19.06.2018 e kanë pohuar që dhe paraqitja e mostrave të produkteve është e pa mjaftueshme sepse duke qenë se shumë produkte nuk e shkruajnë në trup emrin e prodhuesit, ku do të ishte e vështirë për to për përcaktimin e specifikimeve të mostrës së paraqitur.

Arsyeja tjetër e s’kualifikimit të O.E. është mos paraqitja e katalogut të prodhuesit në gjuhën shqipe, ku nga shqyrtimi i katalogut, i cili është voluminoz dhe përmban vetëm foto dhe shifra mbi specifikimet teknike të produkteve

Arsyeja tjetër e s’kualifikimit të O.E. është që tubot plastike nuk prodhohen nga plastike e ricikluar, ku lënda e parë e përdorur për prodhimin e tyre duhet të jetë e prodhuar nga kompani që bëjnë pjesë në “PE100+ Association” ose ekuivalente, ku në dokumentat e O.E. gjendet skeda teknike SABIC SA, prodhues i cili është pjesë e “PE100+ Association.

Përsa i përket O.E. fitues, nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ana e Operatorit vihen re mangësi në përmbushjen e kritereve të veçanta si më poshtë:

lënda e parë e përdorur për prodhimin e tyre duhet të jetë e prodhuar nga kompani që bëjnë pjesë në “PE100+ Association” ose ekuivalente dhe kjo vërtetohet me anë të një kontrate/ deklarate e prodhuesit të lëndës së parë lëshuar për prodhuesin e tubove, kriter i cili nuk është përmbushur nga O.E.

Nga dokumentacioni i sjellë nga O.E., mbi kriterin e veçantë mbi vërtetimin që vulat e ofruara nuk kanë përmbajtje materialesh toksike, raport testimi në përputhje me standardin ISO 527-2 ose ekuivalent nuk gjendet në dokumentacionin e sjellë nga O.E

Sipas grupit të auditimit, nga analiza e situatës së mësipërme duke marrë parasysh dhe diferencën prej **6,625,840** lekë pa TVSH midis ofertës së dy operatorëve si dhe duke u bazuar në Nenin 53 Pika 4<sup>4</sup> të ligjit nr. Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar, “Për prokurimin publik”, duke i

---

<sup>4</sup> Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj

klasifikuar arsyet e s'kualifikimi të O.E. "J" sh.p.k. mësipërme në devijime të vogla, oferta e O.E. "J" sh.p.k. duhej të ishte pranuar dhe të ishte shpallur fituese, pra duke i shkaktuar një dëm shoqërisë në vlerën 6,625,840 lekë pa TVSH.

*(Më hollësisht në Pikën 2, faqe 32-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Vlorë të merren të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e **vlerës prej 6,625,840 lekë**, nga personat të cilët kanë shkaktuar këtë dëm ekonomik ndaj buxhetit të Shoqërisë. Për këtë të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit.

*Menjëherë*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKV SHA pas njoftimit për arkëtim vullnetar sipas shkresës me nr. 1113/2 prot., datë 26.05.2023, sipas shkresës me nr. 1547/7 prot., datë 18.07.2023 është bërë kërkesë padi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me objekt detyrimin e subjektit A-C të kthimit të shumës së përfituar me pasojë dëm ekonomik në shumën prej 6,625,840 lekë në llogari të UKV SHA.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të sipërcituar rezulton se ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit, në dosjen e procedurës së prokurimit "Blerje materiale elektrike për vitin 2019", mungon dokumentacioni fizik përkatës. Auditimi i procedurës së mësipërme në fjalë është bërë bazuar nga sistemi dhe nga të dhënat e marra nga magazina dhe nga zyra e financës. Gjithashtu vlera totale kontratës me është 8.988.204 lekë me TVSH. Likuidimi i faturës përkatëse është kryer në datën 26.01.2021, gati dy vite me vonesë dhe për këtë A.K. është hedhur në gjyq duke rritur detyrimet mbi kontratën në fjalë në vlerat e mëposhtme:

-Vlera e kamatëvonesës 954,038 lekë me TVSH

-Vlera e tarifës përmbarrimore 150.485 lekë me TVSH, pra në total me 1,104,523 lekë me TVSH, duke i shkaktuar shoqërisë një dëm në total prej 1,104,523 lekë pa TVSH.

*(Më hollësisht në Pikën 2, faqe 35-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1. Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Vlorë të merren të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e **vlerës prej 1,104,523 lekë**, nga personat të cilët kanë shkaktuar këtë dëm ekonomik ndaj buxhetit të Shoqërisë. Për këtë të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit.

*Menjëherë*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKV SHA pas njoftimit për arkëtim vullnetar sipas shkresës me nr. 1113/5 prot., datë 26.05.2023, sipas shkresës me nr. 1547/1 prot., datë 18.07.2023 është bërë kërkesë padi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me objekt detyrimin e subjektit F.G të kthimit të shumës së përfituar me pasojë dëm ekonomik në shumën prej 1,104,523 lekë në llogari të UKV SHA.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të sipërcituar rezulton se ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**7. Gjetje nga auditimi:** Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “*Rrethimi i depove të ujit dhe Stacionet e Pompimit të SHA UK Vlorë*” për vitin 2019 morën pjesë 3 O.E. ku fitues u shpall O.E. “B dhe R C” me ofertë 2,192,507 lekë pa TVSh, oferta më e lartë. Në hartimin e specifikimeve teknike janë kërkuar kritere të cilat duken të fryra për objektin e prokurimit, gjë e cila ka çuar dhe në mos vendimmarrjen e saktë në përcaktimin e O.E. fitues.

Pas analizimit të procesverbalit mbi hapjen e ofertave dhe mbi arsyet e s’kualifikimit të O.E. të tjerë pjesëmarrës, për O.E. S sh.p.k. arsyet e s’kualifikimi nuk qëndrojnë, të analizuar si më poshtë:

Mungesa e vërtetimit për shlyerje e detyrimeve të energjisë elektrike për Muajin prill, por pas verifikimit të dokumentacionit të O.E., vërtetimi i OSHEE mban datën 27.04.2019 ku vërtetohet që deri në këtë datë detyrimet janë 0.

Sipas A.K., O.E. nuk plotëson kriterin për 2 mjete transporti kamionçinë 1-3 ton për arsye të mos paraqitjes së certifikatës së transportit të mjetit, por nga verifikimi dhe nga ankesa që O.E ka drejtuar citon qartë legjislacionin që për mjetet e transportit deri në 1.5 ton nuk nevojitet certifikatë për transport mallrash.

2 Automjete vetëshkarkuese mbi 10 ton janë paraqitur me certifikatë pronësie subjekti B dhe kontratë qeraje me z. B.K, i cili pas verifikimit si dhe pas sqarimit nga ana e O.E. ishte ortak i kompanisë B, edhe pse ky kriter është sqaruar dhe në Raport që është i ekzagjeruar për objektin e prokurimit.

Sipas grupit të auditimit, nga analiza e situatës së mësipërme duke marrë parasysh dhe diferencën prej **439,847** lekë pa TVSH midis ofertës së dy operatorëve si dhe duke u bazuar në Nenin 53 Pika 4<sup>5</sup> të ligjit nr. Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar, “Për prokurimin publik”, duke i klasifikuar arsyet e mësipërme në devijime të vogla, oferta e O.E. A sh.p.k. duhej të ishte pranuar dhe të ishte shpallur fituese, pra duke i shkaktuar shoqërisë dëm në vlerën 439,847 lekë pa TVSH.

(Më hollësisht në Pikën 2, faqe 37-39, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1. Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Vlorë të merren të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e **vlerës prej 439,847 lekë**, nga personat të cilët kanë shkaktuar këtë dëm ekonomik ndaj buxhetit të Shoqërisë. Për këtë të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit.

*Menjëherë*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKV SHA pas njoftimit për arkëtim vullnetar sipas shkresës me nr. 1113/3 prot., datë 26.05.2023, sipas shkresës me nr. 1547/6 prot., datë 18.07.2023 është bërë kërkesë padë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me objekt detyrimin e subjektit R C të kthimit të shumës së përfituar me pasojë dëm ekonomik në shumën prej 439,847 lekë në llogari të UKV SHA.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të sipërcituar rezulton se ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**8. Gjetje nga auditimi:** Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “*Prodhim Soletina Betoni dhe tubo betoni*” për vitin 2020 morën pjesë 2 O.E. ku fitues u shpall O.E. “C sh.p.k.” me ofertë 4,422,289 lekë pa TVSh, oferta më e lartë.

---

<sup>5</sup> Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj

Në hartimin e specifikimeve teknike janë kërkuar kritere të cilat duken të fryra për objektin e prokurimit, gjë e cila ka çuar dhe në mos vendimmarrjen e saktë në përcaktimin e O.E. fitues. Pas analizimit të procesverbalit mbi hapjen e ofertave dhe mbi arsyet e s'kualifikimit të O.E. të tjerë pjesëmarrës, për O.E. A sh.p.k. arsyet e s'kualifikimi nuk qëndrojnë, të analizuar si më poshtë:

O.E. paraqet vërtetim OSHEE vetëm për një kontratë në qytetin e Vlorë, mungon vërtetimi i debisë për kontratat në Tiranë ku OE zhvillon aktivitet në këtë qark

O.E ekonomik deklaron dy inxhinierë ndërtimi të cilët duhet të jenë të siguara në list-pagesat janar-tetor 2019. Njëri prej tyre është me siguracion të pjesshëm në këtë periudhë, 8-22 ditë, kriter i cili përmbushët pasi nuk cilësohet në specifikimet teknike si dhe është kriter i ekzagjeruar dhe i pa sqaruar nga ana e komisioni të hartimit të specifikimeve teknike

Në pikën 2.3 të kapaciteti teknik një nga mjetet e kërkuara, konkretisht mjeti XXX figuron pa foto të mjetit ku të duket qartë targa e tij, ku nga verifikimi i dokumentacionit nga ana e grupit të auditimit, targa e automjetit nuk duket qartë por janë karakteristikat e tjera të automjetit si dhe mund të lind e drejta e A.K. ti kërkojë O.E. sqarime të mëtejshme mbi të.

Sipas grupit të auditimit, nga analiza e situatës së mësipërme duke marrë parasysh dhe diferencën prej **972,449** lekë pa TVSH midis ofertës së dy operatorëve si dhe duke u bazuar në Nenin 53 Pika 4<sup>6</sup> të ligjit nr. Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar, "Për prokurimin publik", duke i klasifikuar arsyet e mësipërme në devijime të vogla, oferta e O.E. A sh.p.k. duhej të ishte pranuar dhe të ishte shpallur fituese. Gjithashtu për sa i përket likuidimit, subjekti nuk ka sjellë faturë për vlerën prej 3,461,392 lekë dhe pas verifikimi të arsyes mbi mos likuidimin e subjektit dhe moskryerjes së punimeve doli që kontrata është ndërprerë. Sipas grupit të marrjes në dorëzim kontratat është ndërprerë duke mbajtur një procesverbal i firmosur vetëm nga njëra palë, duke mos pasur dakordësinë midis dy palëve. Dëmi i shkaktuar shoqërisë në vlerën **972,449 lekë**, i cili mund të rritet për shkak se përbën risk për nisjen e procesit gjyqësor nga ana e O.E. për zgjidhje të kontratës së njëanshme.

*(Më hollësisht në Pikën 2, faqe 41-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1. Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Vlorë të merren të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e **vlerës prej 972,449 lekë**, nga personat të cilët kanë shkaktuar këtë dëm ekonomik ndaj buxhetit të Shoqërisë. Për këtë të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit.

*Menjëherë*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKV SHA pas njoftimit për arkëtim vullnetar sipas shkresës me nr. 1113/4 prot., datë 26.05.2023, sipas shkresës me nr. 1547 prot., datë 18.07.2023 është bërë kërkesë padë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me objekt detyrimin e subjektit C të kthimit të shumës së përfituar me pasojë dëm ekonomik në shumën prej 972,449 lekë në llogari të UKV SHA..

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të sipërcituar rezulton se ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

---

<sup>6</sup> Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj

## **C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Përgjatë viteve 2020 dhe 2021, janë zhvilluar dy procedura prokurimi me vlera të vogla për të cilat objekti i tyre ka qenë blerje e kompjuterëve, printerave dhe pajisjeve të tjera ndihmëse elektronike konkretisht:

1. “*Kompjuter të përdorur dhe pajisje të tjera për nevoja të SHA UKV*” viti 2020, me fond limit në shumën 800,000 lekë pa TVSH ku është shpallur fitues më datë 23.07.2020, OE “MIFEEL” me fond limit 668,000 lekë pa TVSH i cili ka lëshuar faturën tatimore nr. 86, datë 30.07.2020, në shumën **801,600 lekë** me TVSH likuiduar me transaksionin e datës 04.08.2020, në U. Bankë.

2. “*Blerje kompjutera dhe printera për nevoja të SHA UK Vlorë*” viti 2021, me fond limit në shumën 799,500 lekë pa TVSH ku është shpallur fitues më datë 25.05.2021, OE “M” me fond limit 746,000 lekë pa TVSH i cili ka lëshuar faturën tatimore nr. 93/2021, datë 31.05.2021, në shumën **895,200 lekë** me TVSH likuiduar me transaksionin e datës 16.11.2021, në Raiffeisen Bankë.

Bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “*Për tatimin mbi të ardhurat*” i ndryshuar, neni 25, pika 5, germa “c”, përcaktohet se: “*Dy kategoritë e mëposhtme të aktiveve amortizohen me metodën e vlerës së mbetur, në bazë të një sistemi grupimi, me përqindje si më poshtë: a) Kompjuterë, sisteme informacioni, produkte “Software” dhe pajisje të ruajtjes së të dhënave me 25%*”.

Referuar dispozitave ligjore të sipërpërmendura nga UKV SHA nuk mund të zhvillohen procedura prokurimi për blerjen e pajisjeve elektronike (kompjuter, printera dhe materiale ndihmëse të tyre) të cilat i përkasin llogarisë “*Inventar ekonomik*” duke marrë në konsideratë që norma e amortizimit të tyre është e lartë 25% në vit mbi vlerën e mbetur. Për sa trajtuar më sipër, vlera totale prej **1,696,800 lekë** për Buxhetin e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Vlorë përbën efekt negativ në menaxhimin me economicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 91-93 të Projektraportit të Auditimit*).

**1.1 Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë dhe Drejtoria Tregtare të merren masa në të ardhmen për mos zhvillimin e procedurave të prokurimit me objekt pajisje elektronike të përdorura duke marrë në konsideratë faktin që këto mallra kanë normë amortizimi të lartë, me qëllim korrigjimin e kësaj praktike në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKV SHA nuk janë zhvilluar më procedura për blerje pajisje elektronike të përdorura.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga deklaratat e mësipërme e subjektit si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *I zbatuar*. Megjithatë, konfirmimi i këtij konkluzioni do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**2. Gjetje nga auditimi:** Bazuar në listën e automjeteve të shoqërisë për 3 vite janë investuar **37,650,244 lekë pa TVSH** për mirëmbajtjen e 20 mjeteve të cilat janë plotësisht të amortizuara, të cilat duhet të ishin nxjerrë jashtë përdorimit, mjete të cilat bazuar dhe në deklaratat e punonjësve ku thonë se nuk janë eficiente si në përdorim ashtu dhe në konsumimin e karburantit. Gjatë verifikimit të automjeteve në terren u konstatuan që automjetet ishin plotësisht të amortizuara dhe nga ana vizuale dhe nga ana teknike.

(Më hollësisht në Pikën 2, faqe 22-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Ujësjetllës Kanalizime Vlorë SHA të marrë masat për nxjerrjen jashtë përdorimi për automjetet e mësipërme të cilat janë të amortizuara dhe nuk plotësojnë elementet bazë për të qenë Aktive të shoqërisë

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKV SHA sipas shkresës me nr. 1528 prot., datë 17.07.2023 është ngritur Urdhri i Brendshëm me objekt *Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të AAM të propozuara për jashtë përdorimit* por që aktualisht nuk ka vepruar si komision.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit dhe faktit të sipërcituar rezulton se ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga analizimi i mbi likuidimin e kreditorëve të shoqërisë nuk gjendet ndonjë praktikë mbi mënyrën e likuidimit të tyre, respektimi të një radhë ose përdorimit të metodave ku të garantohet që të gjithë kreditorët të paguhet në kohë dhe në rastet kur kreditorët nuk janë paguar apo në rast ankesash për mos pagesë nga kreditorët, ti shpjegohen rrethanat me arsyetimin përkatës, gjë që ka sjell kreditorë të mbartur ndër vite dhe të palëkundura.

Totali i kreditorëve të krijuar është 1,262,456,739 lekë pa TVSH.

(Më hollësisht në Pikën 2, faqe 86-91, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** UK Vlorë SHA të marrë masat si dhe të gjejë mënyrën mbi zvogëlimin e vlerës së kreditorëve dhe të arrijë shlyerjen e detyrimeve dhe kamatëvonesave që ka Shoqëria ndaj të tretëve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** UKV SHA ka vijuar punën duke kryer likuidime paralelisht, pra si ato të mbartura ndër vite edhe ato aktuale të krijuara rishtazi me qëllim vijueshmërinë normale të shërbimit të ujësjetllësit.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër si dhe referuar argumenteve të dhëna nga subjekti, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *I zbatuar pjesërisht*.

**4. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën me objekt *“Ndërtim KUZ, rrjeti terciar (lidhjet familjare) për UK Vlorë”*, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit është shpallur fitues OE i vetëm pjesëmarrës OE G. 2 ku sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se ky OE është favorizuar padrejtësisht pasi nuk përmbush kriteret e vendosura nga ana e NJP. Konkretisht konstatohet se nga ana e këtij OE nuk janë paraqitur dëshmi për plotësimin e kërkesave si më poshtë:

Kriteri

1. *“Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen punë të ngjashme për:*

a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e hapjes se ofertave”*

2. *“Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencat e lëshuara nga QKB si me poshtë:*

*Licence për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve inerte që mund të krijohen Kodi III.2.B”*



4. “Operatori/et ekonomike ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga administratori) stafin kryesor teknik të shoqërisë

5. “Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij personel të kualifikuar / certifikuar si:

-1 (një) ekspert zjarifikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të ligjit 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, me objekt pune për Hartimin e akteve të ekspertizës për zjarret e rëna”, certifikuar nga Drejtoria e MZSH, pranë Ministrisë së Brendshme”.

Sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE (Sistemi i Prokurimit Elektronik) rezulton se oferta e OE G. 2 nuk është shoqëruar me analizat teknike për çdo zë punimi ndërtimor, sipas formatit të unifikuar dhe programit të miratuar dhe metodologjisë së përcaktuar në kreun I të Udhëzimit nr. 2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave, si dhe VKM nr. 514, datë 15.8.2007 si dhe me pikën 11. Si konkluzion nga sa më sipër rezulton se është favorizuar padrejtësisht OE G. 2 përmes kualifikimit dhe shpalljes fitues edhe pse me mangësi në dokumentacion dhe në drejtim të plotësimit të kriterëve si më sipër. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Titulli IV Parimi i detyrimit të besnikërisë, neni 14, pika 1 dhe neni 163, ligjin 10 296 datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar Kreu II, Përgjegjshmëria Menaxheriale, neni 8, pika 1 dhe 8, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, neni 46, “Kualifikimi i Ofertuesve”, neni 53, “Shqyrtimi i Ofertave”, pika 3 dhe pika 5, germa c, VKM nr. nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 66, “Kualifikimi i ofertuesve” si dhe Rregulloren e Brendshme e UKV SHA.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr.45-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1 Rekomandimi:** Nga ana e UKV SHA të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet të fondeve siç është ai si më sipër në rastin e vlerës prej **274,779,449 lekë pa TVSH.**

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi.*

**5. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën me objekt “Blerje materiale hidraulike, viti 2021”, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit është shpallur fitues BOE i vetëm i kualifikuar nga 2 pjesëmarrës në total. Konkretisht fitues është shpallur BOE A.C. & A. S.. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se janë vendosur kriterë diskriminues dhe të paargumentuara teknikisht dhe ligjërish. Konkretisht rezulton se është kërkuar ndër të tjera edhe prezenca e një inxhinieri hidraulik ose mekanik kur në fakt kontrata është e llojit *Mallra*. Gjithashtu, rezulton se specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke mos përshkruar minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që të garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP-së. Kërkesat e bëra nuk janë bërë plotësisht në terma funksionalë pasi nuk janë ta argumentuara teknikisht dhe ligjërish.

Grupi i auditimit ka kryer një analizë të kriterëve të vendosura në raport me ato të përmbushura në ana e BOE fitues, ku në gjykim të audituesve krijohet një dyshim i arsyeshëm dhe i mbështetur në

argumente konkrete mbi paracaktimin e OE fitues përmes vendosjes së specifikimeve teknike fikse të paargumentuara dhe që nuk lidhen me ndonjë domosdoshmëri konkrete me nevojat e AK, ku duke i krahasuar kërkesat dhe të dhënat e produkteve sipas katalogut konstatohet se edhe për sa i takon kërkesave edhe për sa i takon vlerave korresponduese, këto specifikime, rezultojnë se janë marrë në mënyrë identike nga prodhuesi P P SA. T A. Spër të cilin është autorizuar OE A-C, anëtar i BOE sipas një shkresë të datës 20.08.2019.

Nga sa më sipër, duke krahasuar konstatohet se edhe vlerat korresponduese të këtyre specifikimeve, janë marrë në mënyrë identike nga prodhuesi të për të cilin është autorizuar OE A-C, anëtar i BOE.

Në përfundim të sa më sipër konstatohet se përmes paracaktimit të kritereve diskriminuese, vendosjes së specifikimeve teknike të paargumentuara teknikisht dhe ligjërish, të cilat janë marrë në mënyrë identike dhe në disa raste edhe në rend kronologjik po të njëjtë me ato të katalogëve të produkteve të ofruara në procedurën e prokurimit, janë krijuar kushte për trajtim jo të njëjtë të të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve e që rrjedhimisht kanë shërbyer si pengesë për një konkurrencë të lirë e të ndershme.

**Vlera e investimit prej 48,568,832 lekë është prokuruar në kundërshtim me parimet e efijencës, ekonomikitetit dhe efektivitetit,** kjo si pasojë e veprimeve dhe/apo mosveprimeve të ndërmarra nga ana e ish titullarit të AK z. Sh.L si dhe komisionit hartues të specifikimeve teknike. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Titulli IV Parimi i detyrimit të besnikërisë, neni 14, pika 1 dhe neni 163, ligjin 10 296 datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar Kreu II, Përgjegjshmëria Menaxheriale, neni 8, pika 1 dhe 8, Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, neni 2, “Parimet e përzgjedhjes”, neni 20, “Mosdiskriminimi”, VKM nr. nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 26, “Kontratat për punë publike”, pikat 3 dhe 5, neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 3 si dhe Rregulloren e Brendshme e UKV SHA.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr.62-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**5.1 Rekomandimi:** Nga ana e UKV SHA të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e investimit me qëllim krijimin e kushteve të përshtatshme për një konkurrencë të lirë e të ndershme si dhe shmangien e përdorimit të fondeve pa efektivitet, efijencë dhe ekonomikitet si siç është ai si më sipër në rastin e vlerës prej **56,383,692 lekë pa TVSH.**

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi.*

**6. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “Përmirësime të sistemit me ujë në lagjet ish-fabrika e Çimentos-Partizani-Karabash, dhe rindërtimi i ujësjellësit në Babicë të vogël, njësia administrative Qendër Vlorë” rezultojnë se në përfundim të procedurës së prokurimit është shpallur fitues BOE .A.K. & L.. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultojnë se kriteret e vendosura nga ana e komisioneve të ngritura për hartimin e tyre janë diskriminuese, jo në përputhje me nevojat e investimit, kufizuese, mbi domosdoshmëritë dhe përtej nevojave që paraqet realizimi konkret i punimeve civile.

Konstatohet gjithashtu, se edhe pas sugjerimeve të bëra nga ana e APP, Autoriteti Kontraktor ka mbajtur po të njëjtin qëndrim duke vendosur po të njëjtat kritere kufizuese për operatorët pjesëmarrës, situatë e cila krijon një dyshim të arsyeshëm për paracaktimin e fituesit në këtë procedurë prokurimi. Argumentet e dhëna nga ana e komisionit i cili ka ri argumentuar këto kritere pas sugjerimeve të APP janë në disa raste jashtë kontekstit dhe nuk justifikojnë përdorimin e tyre pasi nuk janë në raport të drejtë me punimet civile të parashikuara në preventiv dhe disa prej sugjerimeve të bëra nuk kanë gjetur trajtim nga ana e këtij komisioni. Konkretisht:

Kriteri:

1. “Operatori/et ekonomike ofertues duhet të disponojnë licenca profesionale të shoqërisë për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet te paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me VKM nr.42 date 16.01.2008, i ndryshuar.
2. “Për të provuar se ka përvojën e duhur, Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar mesatarisht të paktën 160 (njëqind e gjashtëdhjetë) punonjës, për periudhën (Qershor 2020 - Nëntor 2020), llogaritur mbi bazën e kohës së plotë të punës.
3. “Operatori duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit teknik që do të angazhohet për realizimin e punimeve stafin inxhinierik”
4. “Operatori ekonomik duhet të disponojë në stafin e tij punonjës të certifikuar (me dëshmi profesionale, në përputhje me zërat e punimeve në preventiv.
5. “Operatori ekonomik duhet të ketë 3 (tre) ekspertë për hartimin e raporteve të VNM-së për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për problemet mjedisore dhe të thirret si ekspert për të vlerësuar një raport VNM apo rezultatet e auditimit, të shoqëruar me certifikatën e lëshuar nga autoriteti kompetent në bazë të VKM –së nr. 122, datë 17.02.2011, i ndryshuar.
6. “Operatori ekonomik duhet të jetë e pajisur me licencat e lëshuara nga QKB
7. “Operatori ekonomik duhet të disponojë kontratë bashkëpunimi me një laborator të akredituar në fushën e testeve të materialeve të ndërtimit në përputhje me S SH ISO/IEC 17025:2006 e vërtetuar kjo me certifikatat e akreditimit nga organizma akreditues.
8. “Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi / qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

(Tabela nr. 2, Aneksi nr. 1)

Për sa më sipër këto kërkesa rezultojnë të paargumentuara, diskriminuese dhe jo në përputhje me domosdoshmëritë që paraqet realizimi i këtij investimi. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, neni 2, “Parimet e përzgjedhjes”, neni 20, “Mosdiskriminimi”, VKM nr. nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 26, “Kontratat për punë publike”, pikat 3 dhe 5, neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 3 si dhe Rregulloren e Brendshme e UKV SHA.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr.71-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1 Rekomandimi:** Nga ana e UKV SHA të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e investimit me qëllim krijimin e kushteve të përshtatshme për një konkurrencë të lirë e të ndershme si dhe shmangien e përdorimit të fondeve pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet si siç është ai si më sipër në rastin e vlerës prej **207,270,868 lekë pa TVSH.**

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

## **E. MASA DISIPLINORE**

### **E.1. Për punonjësit në marrëdhënie pune**

#### **E.1.2 Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me statute të parashikuara në ligje të veçanta**

Për shkeljet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, sipas personave përgjegjës i propozojmë Asamblesë së Përgjithshme, Këshillit të Administrimit si dhe Administratorit të Shoqërisë, që mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, Statutin e Ujësjetës Kanalizime Vlorë SHA, si dhe në Kontratën Individuale të Punës, të marrë masat disiplinore si më poshtë:

Masa disiplinore nga “*Vërejtje*” deri në “*Paralajmërim për ndërprerje të kontratës së punës*”, për punonjësit e mëposhtëm:

**Znj. L.C**, në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve me vlera të vogla për vitin 2018.

**Z. A.Gj**, në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve me vlera të vogla për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

**Znj. L.D**, në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve me vlera të vogla për vitin 2018, 2019, 2020.

**Z. D.Z**, në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike për procedurën Blerje Kompjuterë dhe pajisje të tjera elektronike”.

**Z. E.Sh**, në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike për procedurën Blerje Kompjuterë dhe pajisje të tjera elektronike”.

**Znj. J.D** në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve me vlera të vogla për vitin 2021 dhe anëtare e komisionit hartues të specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale hidraulike për vitin 2018” në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1 “Objekti dhe qëllimi”, Neni 2 “Parimet e përzgjedhjeje”

**Znj. J.K** në cilësinë e anëtare e komisionit hartues të specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale hidraulike për vitin 2018” në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1 “Objekti dhe qëllimi”, Neni 2 “Parimet e përzgjedhjeje”

**Znj. T.Xh**, në cilësinë e përgjegjësës së magazinës në lidhje me magazinimin e mallrara të prokuruarë me anë të procedurave të mëposhtme:

-“Blerje materiale hidraulike për vitet 2018, 2019, 2021 si dhe “Blerje matësa uji dhe rakorderi për matësa” për vitet 2018, 2019, 2020.

**Z. V.M** në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt Blerje kapak pusetash metalik dhe zgara kunetash shiu dhe furnizim vendosje zgarash shiu në lungomare” 2020 dhe për procedurën e prokurimit me objekt “Prodhim Soletina Betoni” në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1 “Objekti dhe qëllimi”, Neni 2 “Parimet e përzgjedhjeje”.

**Z. S.N** në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkeljet e mëposhtme: -S’kualifikim i padrejtë O.E. për procedurën e prokurimit me objekt “Prodhim Soletina Betoni” në kundërshtim me

Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar:

Neni 1, “Objekti dhe qëllimi

Neni 46, “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1,

Neni 53, “Shqyrtimi i ofertave”

VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar:

Neni 66, “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 3.

**Znj. E.M** në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit “Përmirësime të sistemit me ujë në lagjet ish-fabrika e çimentos-Partizani-Karabash dhe rindërtimi i ujësjellësit në Babicë të vogël, njësia administrative Qendër-Vlorë” dhe në procedurën e prokurimit “ Ndërtim KUZ, rrjeti terciar (lidhjet familjare) për UK Vlorë” në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1 “Objekti dhe qëllimi”, Neni 2 “Parimet e përzgjedhjeje” Neni 20 “Mosdiskriminimi” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar.

**Z. F.V** në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit “Përmirësime të sistemit me ujë në lagjet ish-fabrika e çimentos-Partizani-Karabash dhe rindërtimi i ujësjellësit në Babicë të vogël, njësia administrative Qendër-Vlorë”.

**Z. O.P** në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve me vlera të vogla për vitin 2021 si dhe anëtarit të komisionit të prokurimeve me vlerë të lartë.

**Znj. L.M,** në cilësinë e specialistes së financës për likuidimin e faturave të blerjeve të vogla pa dokumentacionin e plotë justifikues.

**Znj. R.A,** në cilësinë e Shefes së Financës, për likuidimin e faturave të blerjeve të vogla pa dokumentacionin e plotë justifikues.

**Z. P.Sh** në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike në procedurën e prokurimit me objekt ‘Mirëmbajta e automjeteve’.

- Për moszbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26 në procedurat e blerjes së mallrave për mjetet motorike duke shkaktuar shpenzim pa ekonomikitet, efencë dhe efektivitet për buxhetin e shoqërisë.

**Znj. E.G** në cilësinë e kryetarës së njësisë së prokurimit për vitin 2021 për shkeljet në procedurat e mëposhtme:

Procedura e prokurimit me objekt “ Ndërtim KUZ, rrjeti terciar (lidhjet familjare) për UK Vlorë”  
Procedura e prokurimit me objekt “Përmirësime të sistemit me ujë në lagjet ish-fabrika e cimentos-Partizani-Karabash dhe rindërtimi i ujësjellësit në Babicë të vogël, njësia administrative Qendër-Vlorë”.

procedura e prokurimit me objekt “Blerje materiale hidraulike për vitin 2021”

në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, Neni 57, “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”.

**Znj. E.H** në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkeljet e mëposhtme:  
- S’kualifikim i padrejtë O.E. për procedurën e prokurimit me objekt “Përmirësime të sistemit me ujë në lagjet ish-fabrika e cimentos-Partizani-Karabash dhe rindërtimi i ujësjellësit në Babicë të vogël, njësia administrative Qendër-Vlorë”

- S’kualifikim i padrejtë O.E. për procedurën e prokurimit me objekt “ Ndërtim KUZ, rrjeti terciar (lidhjet familjare) për UK Vlorë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar:

Neni 1, “Objekti dhe qëllimi

Neni 46, “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1,

Neni 53, “Shqyrtimi i ofertave”

dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar

Si dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje kompjutera dhe pajisje të tjera elektronike” në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1 “Objekti dhe qëllimi”, Neni 2 “Parimet e përzgjedhjeje” Neni 20 “Mosdiskriminimi” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar.

**Znj. L.M** në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkeljet e mëposhtme:  
- S’kualifikim i padrejtë O.E. për procedurën e prokurimit me objekt “Përmirësime të sistemit me ujë në lagjet ish-fabrika e çimentos-Partizani-Karabash dhe rindërtimi i ujësjellësit në Babiçë të vogël, njësia administrative Qendër-Vlorë”

- S’kualifikim i padrejtë O.E. për procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim KUZ, rrjeti terciar (lidhjet familjare) për UK Vlorë”

- S’kualifikim i padrejtë O.E. për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale hidraulike për vitin 2021”

- S’kualifikim i padrejtë O.E. për procedurën e prokurimit me objekt “Prodhim Soletina Betoni”

- S’kualifikim i padrejtë O.E. për procedurën e prokurimit me objekt “Rrethimi i depove të ujit dhe Stacionet e pompimit të UK Vlorë SHA” në kundërshtim me

Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar:

Neni 1, “Objekti dhe qëllimi

Neni 46, “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1,

Neni 53, “Shqyrtimi i ofertave”

dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar

**Z. H.S** në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkeljet e mëposhtme:

- S’kualifikim i padrejtë O.E. për procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim KUZ, rrjeti terciar (lidhjet familjare) për UK Vlorë”

- S’kualifikim i padrejtë O.E. për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale hidraulike për vitin 2021” në kundërshtim me

Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar:

Neni 1, “Objekti dhe qëllimi

Neni 46, “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1,

Neni 53, “Shqyrtimi i ofertave”

dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar

**Z. K.R** në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve me vlera të vogla për vitin 2020, 2021

dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Përmirësime të sistemit me ujë në lagjet ish-fabrika e cimentos-Partizani-Karabash dhe rindërtimi i ujësjellësit në Babiçë të vogël, njësia administrative Qendër-Vlorë” në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1 “Objekti dhe qëllimi”, Neni 2 “Parimet e përzgjedhjeje” Neni 20 “Mosdiskriminimi” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar.

**Z. N.C** në cilësinë e anëtarit të komisionit të ndjekjes dhe monitorimit të kontratës për procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim KUZ, rrjeti terciar (lidhjet familjare) për UK Vlorë”, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkeljet e mëposhtme:

-S’kualifikim i padrejtë O.E. për procedurën e prokurimit me objekt “Rrethim i depove të ujit dhe Stacionet e Pompimit të SHA UK Vlorë”

-S’kualifikim i padrejtë O.E. për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale hidraulike për vitin 2018”

-S'kualifikim i padrejtë O.E. për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje matësa uji për vitin 2018” në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar: Neni 1, “Objekti dhe qëllimi  
Neni 46, “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1,  
Neni 53, “Shqyrtimi i ofertave”

- Në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimeve me vlera të vogla për vitin 2020

Pranueshmëria e rekomandimit: *L pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht Urdhrit të Titullarit të UKV SHA me nr. 468 prot., datë 28.02.2023 për dhënien e masave disiplinore për të gjithë punonjësit sipas Raportit Përfundimtar të KLSH si dhe Urdhrave tjerë për çdo praktikë, rezulton se për 17 nga 21 punonjës janë dhënë masat disiplinore *Vërejtje me paralajmërim për ndërprerjen e kontratës së punës*. Për 4 punonjësit e tjerë nuk janë dhënë masat pasi janë larguar dhe nuk janë më në marrëdhënie pune me institucionin.

#### **IV KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME**

Në përfundim të procesit të auditimit, nga Ujësjetllës Kanalizime SHA Vlorë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën nr. 553/15 prot., datë 30.01.2023 (*administruar në subjekt me nr. 217 prot., datë 01.02.2023*), konstatohet se 48.1 % e rekomandimeve janë zbatuar dhe janë zbatuar pjesërisht dhe janë në proces zbatimi rekomandimet në lidhje me arkëtimin e dëmeve si dhe ato për përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet. Duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore, si më poshtë:

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** (*Gjetja nr. 8 e Masave Organizative të Raportit Përfundimtar të Auditimit*) Gjatë analizimit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje kompjuter dhe pajisje të tjera elektronike” për vitin 2019, në hartimin e specifikimeve teknike kërkohet produkti me emërtim “Macbook Air 13.3” i cili përkon me Brandin Apple dhe kategorisë Macbook. Gjithashtu produkti i mësipërm gjendet në kartelën e ish-administratorit të shoqërisë z. D.Xh i cili pas largimit nga detyra dhe nga institucioni nuk ka bërë dorëzimin mbi këtë produkt, në kundërshtim me Nenin 23 Pika 5<sup>7</sup> të ligjit të Prokurimit Publik Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar.

**1.1. Rekomandimi:** UK Vlorë SHA gjatë hartimit të specifikimeve teknike të bazohet në legjislacionin në fuqi, duke mos krijuar pengesa mbi konkurrencën e drejtë si dhe të marrë masat që për personat që ndërpresin marrëdhëniet e punës me shoqërinë, të bëjnë dorëzimet mbi materialet e marra në dorëzim.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** (*Gjetja nr. 10 e Masave Organizative të Raportit Përfundimtar të Auditimit*) Nga analizimi i mbi likuidimin e kreditorëve të shoqërisë nuk gjendet ndonjë praktikë mbi mënyrën e likuidimit të tyre, respektimi të një radhe ose përdorimit të metodave ku të

---

<sup>7</sup> Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

garantohet që të gjithë kreditorët të paguhen në kohë dhe në rastet kur kreditorët nuk janë paguar apo në rast ankesash për mos pagese nga kreditorët, ti shpjegohen rrethanat me arsyetimin përkatës, gjë që ka sjell kreditorë të mbartur ndër vite dhe të pa likuiduar.

Totali i kreditorëve të krijuar është 1,262,456,739 lekë pa TVSH.

**2.1. Rekomandimi:** UK Vlorë SHA të marrë masat si dhe të gjejë mënyrën mbi zvogëlimin e vlerës së kreditorëve dhe të arrijë të likuidojë duke respektuar parimin e kohës së krijimit të detyrimit.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga Auditimi:** (Gjetja nr. 14 e Masave Organizative të Raportit Përfundimtar të Auditimit) Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën me objekt “Ndërtim KUZ, rrjeti terciar (lidhjet familjare) për UK Vlorë”, rezulton se në lidhje me këtë praktikë kontrata është lidhur me datë 29.06.2021 dhe punimet janë deklaruar se kanë filluar me datë 20.09.2021. Nga analiza e zërave të situacionit nr. 1 rezulton se OE ka kryer një volum pune për periudhën 20 shtator 2021 – 30 nëntor 2021 në shumën prej 68,423,504 lekë pa TVSH. Grupi i auditimit ka bërë një analizë duke krahasuar volumet e situacionuara me ato të parashikuara sipas grafikut të punimeve të cilat paraqiten në Anekse, Tabela nr. 2. Pas kërkesës për dokumentacion nga ana e subjektit u dorëzuan vetëm raportet mujore duke filluar nga ai për muajin nëntor 2021 dhe nuk rezulton të jetë hartuar asnjë raport mujor për muajt shtator dhe tetor 2021. Nga 34 mjete/makineri/pajisje që janë kërkuar në Dokumentet e Tenderit e që njëkohësisht janë cilësuar si të nevojshme nga ana e AK për realizimin e punimeve, rezulton se në kantier pretendohet se janë realizuar këto volume pune me 10 punëtorë dhe me vetëm prezencën e drejtuesit teknik dhe të asnjë prej inxhinierëve të tjerë të kërkuar kur në fakt janë kërkuar 250 të punësuar të total. Me stafin, mjetet dhe afatin si më sipër nga ana e mbikëqyrësit të punimeve është certifikuar si i kryer ndër të tjera edhe volumi i punës prej 22,410 ml tub HDPE, volum ky i cili është praktikisht i pamundur në rrethanat e sipërpërmendura. Nga ana e mbikëqyrësit janë deklaruar si të realizuara volumet e punimeve në 118 akse rrugore të qytetit të Vlorës, situatë kjo e cilat është praktikisht e pamundur në kushtet si më sipër. Një veprim i tillë e denatyrton krejtësisht procesin e prokurimit dhe kuptimin e garës publike për vet faktin se AK ka kërkuar ndaj OE kapacitete teknike, ligjore dhe mbi të gjitha financiare. Deri në përfundim të auditimit në terren nuk rezultuan të jenë kryer pagesa ndaj sipërmarrësit të punimeve për situacionin nr. 2. Sipas shkresës së administruar në institucion me nr. 586 prot., datë 15.03.2022, rezulton se në datë 10.03.2022 është bërë një kërkesë nga ana e mbikëqyrësit z. F.B, për shtyrjen e afatit të realizimit të punimeve. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nuk rezulton të këtë asnjë miratim nga ana e AK në lidhje me miratimin e kësaj kërkesë. Sipas kontratës së nënshkruar mes AK dhe OE G. 2 rezulton se afati i fillimit të punimeve është parashikuar të jetë data e lidhjes së kontratës dhe marrjen e lejes së ndërtimi. Duke qenë se sheshi i ndërtimit është liruar me datë 20.09.2021 rezulton se afati i përfundimit të punimeve duhet të ishte data 20.03.2022. Në fakt sipas korrespondencave të përshkruara më sipër rezulton se punimet janë ende në proces dhe kontrata është amenduar sipas aktit me nr. 801 prot., datë 06.04.2022 me një afat të shtyrjes së punimeve me 6 muaj, duke konsideruar si datë të përfundimit të punimeve 29.09.2022. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, neni 7/1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3.



**3.1 Rekomandimi:** Nga ana e UKV SHA të merren masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës me qëllim analizimin e situatës në lidhje me praktikën e situacionit nr. 1 duke identifikuar akset konkrete së bashku me volumet respektive (librezat e masave, vizatimet sipas faktit, dokumente të tjera të nevojshme), si dhe dokumentacionit fotografik të mjeteve të përdorura gjatë zbatimit, kjo për të bërë një krahasim mes kapaciteteve reale të shfaqura nga kontraktori gjatë punimeve me ato të reflektuara në situacionin nr. 1 dhe nxjerrjen e një konkluzioni mbi vërtetësinë apo fiktivitetin e kësaj pagese.

*Brenda përfundimit të kontratës*

**3.2 Rekomandimi:** Nga ana e UKV SHA të merren masa për analizimin e argumenteve të paraqitura nga ana e kontraktorëve për shtyrjen e punimeve.

*Në vijimësi*

## **B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**3. Gjetje nga auditimi:** (Gjetja nr. 3 e Masave për Eliminimin e Efekteve Negative të Konstatuara në Administrimin e Fondeve Publike dhe për Menaxhimin me Ekonomicitet, Eficiencë dhe Efektivitet të Fondeve Publike të Raportit Përfundimtar të Auditimit) Nga analizimi i mbi likuidimin e kreditorëve të shoqërisë nuk gjendet ndonjë praktikë mbi mënyrën e likuidimit të tyre, respektimi të një radhë ose përdorimit të metodave ku të garantohet që të gjithë kreditorët të paguhen në kohë dhe në rastet kur kreditorët nuk janë paguar apo në rast ankesash për mospagesë nga kreditorët, ti shpjegohen rrethanat me arsyetimin përkatës, gjë që ka sjell kreditorë të mbartur ndër vite dhe të palëkundura.

Totali i kreditorëve të krijuar është 1,262,456,739 lekë pa TVSH.

(Më hollësisht në Pikën 2, faqe 86-91, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** UK Vlorë SHA të marrë masat si dhe të gjejë mënyrën mbi zvogëlimin e vlerës së kreditorëve dhe të arrijë shlyerjen e detyrimeve dhe kamatëvonesave që ka Shoqëria ndaj të tretëve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

*Në lidhje me masat e konstatuara në proces zbatimi apo të zbatuara pjesërisht, nga ana e subjektit të audituar Ujësjellës Kanalizime SHA, Vlorë të vijojnë përpjekjet duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore deri në zbatimin e plotë të tyre.*

### **3.11. Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë**

#### **PËRMBLEDHJE**

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), ushtroi auditim në Ujësjellës Kanalizime SHA, Gjirokastrë mbi “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022” për auditimin e kryer në vitin 2022, për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2021 paraqitur me shkresën e administruar në KLSH me nr. 249/8 prot., datë 03.08.2022 (administruar në subjekt me nr. 1201 prot., datë 15.08.2022), duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH<sup>ssë</sup> të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2022, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

- vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
- vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
- vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve;
- vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në subjekt u mbajt Akt Verifikimi nr. 1, datë 08.09.2023, administruar në Zyrën e UKGJ me nr. 3353 prot, datë 08.09.2023, për të cilin nuk është paraqitur observacion nga ana e subjektit. Pas dërgimit të Projektraportit të Auditimit, nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observacione.

**Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:**

**I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.**

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, UKGJ SHA ka respektuar këtë afat duke kthyer përgjigje sipas shkresës së administruar në institucion me nr. 1201/1 prot., datë 19.08.2022.

**II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.**

-Nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas parashikimeve në Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

**III. Rekomandimet e KLSH**

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 249/8 port., datë 03.08.2022 dhe në UKGJ SHA me nr. 1201 prot., datë 15.08.2022, janë rekomanduar gjithsej:

- Janë rekomanduar **22 masa organizative;**
- Janë rekomanduar **5 masa për shpërblim dëmi në vlerën 9,041,862 lekë;**
- Janë rekomanduar **6 masa për përdorimin me shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomikitetit, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 65,886,776 lekë;**
- Janë rekomanduar **masa 14 disiplinore.**

**IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH**

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 249/8 port., datë 03.08.2022 dhe në UKGJ SHA me nr. 1201 prot., datë 15.08.2022, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si me poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Organizative	22 masa	22 masa	-
2	Shpërblim dëmi	5 masa 9,041,862 lekë	5 masa 9,041,862 lekë	-

3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	6 masa 65,886,776 lekë	6 masa 65,886,776 lekë	-
4	Masa Disiplinore	14	14	-

## V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit

Në mënyrë të përmblodhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	22 masa	6	-	14	2
2	Shpërblim dëmi	5 masa 9,041,862 lekë	-	-	4 masa 8,741,862	1 masë 300,000
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	6 masa 65,886,776 lekë	-	1 masë 23,000,000 nga 49,662,348	3 masa 10,567,436	3 masa 32,319,340
4	Masa Disiplinore	14	13	-	-	1

### I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 702/1, prot., datë 04.08.2023, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. A.L, (Përgjegjës grupi)
2. J.H.

### I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 249/8 prot., datë 03.08.2022, administruar në UKGJ SHA me nr. 1201 prot., datë 15.08.2022, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

### I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

### I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

## I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Ujësjiellës Kanalizime SHA, Gjirokastrë, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 249/8 prot., datë 03.08.2022, administruar në UKGJ SHA me nr. 1201 prot., datë 15.08.2022, rezulton se nga **47** masa të rekomanduara (*organizative, shpërblim dëmi dhe 3-E, Disiplinore*), janë pranuar nga subjekti **47** masa ose 100 %. **Nga të pranuarat (47)**: janë zbatuar plotësisht **19**, ose 40.4 % e tyre, është zbatuar pjesërisht **1** masë ose 2.1 %, janë në proces zbatimi **21** masa ose 44.7 % dhe nuk janë zbatuar **7** masa ose 14.9 %.

Nga sa shikohet niveli i realizimit është në masën 40.4 %, gjë e cila tregon se Ujësjiellës Kanalizime SHA, Gjirokastrë e ka vlerësuar procesin e zbatimit të rekomandimeve.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	22 masa	6	-	14	2
2	Shpërblim dëmi	5 masa 9,041,862 lekë	-	-	4 masa 8,741,862	1 masë 300,000
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	6 masa 65,886,776 lekë	-	1 masë 23,000,000 nga 49,662,348	3 masa 10,567,436	3 masa 32,319,340
4	Masa Disiplinore	14	13	-	-	1

## II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 40.4 % kurse ai i atyre në proces ose të zbatuara pjesërisht është 49.1 %, nivele këto të cila tregojnë vlerësimin e këtij procesi në lidhje me ndjekjen e procedurave të duhura për zbatimin e rekomandimeve.

## III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.  
-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, UKV SHA, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 1240 prot., datë 23.08.2022.

III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”,

III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për

rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:

## **MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, rezulton se përmes shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 1420/8 port., datë 30.08.2019 dhe në Ujësjetës Kanalizime SHA Gjirokastrë me nr. 921 prot., datë 02.09.2019, janë rekomanduar gjithsej 70 masa, të pranuar këto në masën 100 %. Nga këto, rezulton se janë realizuar plotësisht 44 masa, janë realizuar pjesërisht 17 masa, është në proces zbatimi 1 masë dhe nuk janë zbatuar 8 masa. Situata e zbatueshmërisë së rekomandimeve të lëna paraqitet e detajuar sipas Aneksit nr. 2.1.1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e kontrollit të lartë të Shtetit” neni 15. Gjithashtu, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve rezulton se nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të Raportit të Auditimit. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 20 – 21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori UKGJ SHA, të marrin masa të menjëhershme për rishikimin dhe zbatimin e të gjitha masave të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH. Gjithashtu, të rishikohen rekomandimet të cilat janë zbatuar pjesërisht si dhe të vijojnë procedurat përkatëse për përfundimin e rekomandimeve të konsideruara në proces.

***Brenda vitit 2022***

Pranueshmëria e rekomandimit: I pranuar

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKGJ SHA është hartuar një plan masash sipas shkresës me nr. 1201/1 prot., datë 19.08.2022.

**Komenti i audituesve:** Nga ana e UKGJ SHA nuk u vu në dispozicion një dokument mbi ecurinë e zbatueshmërisë së rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* por *I pazbatuar*.

**1.2 Rekomandimi:** Nga ana e UKGJ SHA të merren masa për raportimin në kohë dhe brenda afateve të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve.

***Në vijimësi***

Pranueshmëria e rekomandimit: I pranuar

**Komenti i subjektit:** Nga ana e UKGJ SHA është hartuar një plan masash sipas shkresës me nr. 1201/1 prot., datë 19.08.2022.

**Komenti i audituesve:** Nga ana e UKGJ SHA janë marrë masa vetëm për raportimin pas 20 ditësh nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit por jo për atë pas 6 muajsh mbi ecurinë e zbatueshmërisë së rekomandimeve. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* por *I pazbatuar*.

**2 Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me vendimet e strukturave drejtuese në UKGJ SHA, nga grupi i auditimit është konstatuar se në mbledhjet e Këshillit nuk janë marrë në analizë problematikat kryesore të institucionit, nuk janë kontrolluar e mbikëqyrur zbatimi i politikave tregtare të shoqërisë nga administratori. Në mbledhjet e Këshillit

të Administrimit, në përgjithësi janë marrë vendime për ndryshime strukture dhe rritje/ulje pagash. Këshilli i Administrimit, në rastet që është mbledhur, përgjithësisht nuk ka analizuar problematikat me karakter rregullator, ekonomik dhe financiar të shoqërisë, por në opinionin e grupit të auditimit vlerësohet se për problematikat e diskutuara nuk janë nxjerrë konkluzione mbi mbarëvajtjen dhe funksionimin e shoqërisë për ta orientuar drejt në zgjidhjen e problematikave, nëpërmjet përshpejtimit të reformave të sektorit. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 63, 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajnimin e ujërave të ndotura”, neni 13.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqen nr. 22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** Këshilli i Administrimit të shoqërisë Ujësjetës Kanalizime Gjirokastër SHA gjatë veprimtarisë së tij të marrë masa për të analizuar problematikat me karakter rregullator, ekonomik dhe financiar të shoqërisë me qëllim mbarëvajtjen e veprimtarisë funksionale të saj.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: I pranuar

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht. Këshilli i ri Mbikëqyrës merr vendime me karakter ekonomik dhe rregullator, financiar.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si ***I pranuar dhe Në proces zbatimi.***

**3. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me programet ekonomik – financiare rezulton se Shoqëria Aksionare UKGJ nuk ka hartuar apo miratuar ndryshime të programeve ekonomik-financiare, shoqëruar me relacion shpjegues të faktorëve të paparashikuar të cilët për vitet 2019, 2020 dhe 2021, kanë çuar në tejkalim të investimeve dhe të disa zërave të shpenzimeve, krahasuar me programin e miratuar, nuk ka bërë një analizë të detajuar të numrit të operatorëve që janë pajisur ose nuk janë pajisur me matës, një analizë të detajuar mbi humbjet teknike ose ato ekonomike menaxheriale, një analizë të detajuar mbi debitorët dhe gjendjen e likuidimit nga ana e tyre. Shoqëria Aksionare UKGJ nuk ka hartuar apo miratuar ndryshime të programeve ekonomik-financiare, shoqëruar me relacion shpjegues të faktorëve të paparashikuar për vitet 2019, 2020 dhe 2021, gjë që ka çuar në tejkalim të investimeve dhe të disa zërave të shpenzimeve, krahasuar me programin e miratuar. Mungojnë Programet Ekonomike Afatmesme PBA dhe Programet Ekonomike Afatgjata, mungon plani 5 vjeçar për përmirësimin e performancës dhe plani i biznesit, mungojnë raportimet mbi zbatimin e buxhetit për çdo tremujor në AKUK, pranë prefektit dhe pranë Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, VKM nr. 848, datë 07.12.2016 si edhe Udhëzimin nr. 15 datë 02.02.2018 “Mbi programet e zhvillimi ekonomik të shoqërive tregtare me kapital Shtetëror”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 23 – 24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** UKGJ SHA të marrë masat për programimin e buxheteve afat mesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore. Programimi në buxhetin e vitit ushtrimor shlyerjen e të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguara së bashku me mbledhjen e të gjitha detyrimeve nga ana të debitorëve.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: I pranuar

**Komenti i subjektit:** Është miratuar nga KM dhe AP me vendimet përkatëse. (Vendim nr. 3/1 date 23.12.2023 dhe Vendim nr. 01, datë 13.01.2023.)

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *I zbatuar*.

**4. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me pagat, ligjshmërinë e rekrutimeve etj. rezulton se struktura organizative e UKGJ SHA është ndryshuar 3 herë në vitin 2019, 24 herë në vitin 2020 dhe 20 herë në vitin 2021. Nga grupi i auditimit konstatohet se emërimet dhe lëvizjet personeli për periudhën objekt auditimi janë kryer si më poshtë:

-Për vitin 2019: 172 emërimet, largimet, pezullimet, dorëheqjet, ndryshimet pozicioni dhe ndryshimet page,

-Për vitin 2020: 197 emërimet, largimet, pezullimet, dorëheqjet, ndryshimet pozicioni dhe ndryshimet page,

-Për vitin 2021: 199 emërimet, largimet, pezullimet, dorëheqjet, ndryshimet pozicioni dhe ndryshimet page.

Numri i punonjësve është i pa miratuar dhe i pa programuar nga Këshilli i Administrimit,

-Niveli i pagave është diferencial dhe diskriminues, dhe në përgjithësi nuk përkon me nivelin e arsimit përkatës,

-Struktura është e paqartë dhe e paorganizuar në kuptimin e drejtorive, specialistëve, punonjësve dhe varësia e punonjësve me eprorët përkatës nuk është e mirë përcaktuar.

-Paqartësia në strukturën organizative dhe lëvizjet e brendshme mund të sjellin pasiguri, paqartësi dhe mos njohje të detyrave funksionale dhe të ndikojnë në performancën e ulët të punonjësve të UKGJ SHA.

-Në hartimin e strukturës, Auditimi i Brendshëm i Shoqërisë është përfshirë në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, duke mos garantuar një proces dhe veprimtari të pavarur nga pikëpamja funksionale, që garanton dhe vlerëson funksionimin e drejtimit financiar dhe sistemin e kontrollit të brendshëm. Aktualisht shoqëria nuk ka punonjës në këtë pozicion. Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se ka një paqartësi në strukturën organizative dhe lëvizjet e brendshme mund të sjellin pasiguri, paqartësi dhe mos njohje të detyrave funksionale dhe të ndikojnë në performancën e ulët të punonjësve të UKGJ SHA. Sa më sipër është në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Administrimit nr. 1, datë 09.01.2019.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 25 – 32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1 Rekomandimi:** Nga Këshilli i Administrimit, Administratori i Shoqërisë dhe Burimet Njerëzore të merren masa për parashikimin e saktë të numrit të punonjësve, duke ju referuar nevojave specifike të shoqërisë, bazuar në funksionin e saj primar.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Pas reformimit të institucionit, parashikimi i nevojave për numrin e punonjësve është hartuar nga ana e AKUM i cili është miratuar më pas me Vendimin e Aksionarit MIE. Palët e mësipërme kanë kryer analizat e veta e në kushte të tilla mendojmë se ka qenë i saktë planifikimi i numrit të punonjësve.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *I zbatuar*.

**5. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me pagat, ligjshmërinë e rekrutimeve, strukturën organizative etj., rezulton se për periudhën objekt auditimi në UKGJ SHA:

Në vitin 2019 – janë emëruar 49 punonjës të përhershëm dhe provizorë;

për vitin 2020 – 45 punonjës të përhershëm dhe provizorë;

për vitin 2021 – 21 punonjës të përhershëm dhe provizorë.

Në fakt konstatohet se në përgjithësi nuk shpallen e vendet vakante dhe nuk është dokumentuar në asnjë rast intervistimi apo testimi i kandidatëve. Për mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve për punësim pranë UKGJ SHA nuk ka në asnjë rast kritere qarta, të përcaktuara lidhur me vakancat dhe nuk ka asnjë informacion apo gjurmë si janë kryer këto procedura. Po ashtu procedura e ndjekur gjatë kësaj përzgjedhje nuk është e qartë dhe transparente, sepse nuk ka të dokumentuar asnjë nga hapat që duhet të ndiqen për rekrutimin e punonjësve të rinj. Nga auditimi konstatohet se gjatë periudhës objekt auditimi në total janë dhënë 143 masa disiplinore në UKGJ SHA, nga këto 86 “Vërejtje me shkrim”, 25 masa “Vërejtje me shkrim, paralajmërim për largim nga puna”, 1 masa “Kalim në një detyrë të një niveli apo klasë më të ulët”, 23 masa “Pezullim nga puna” dhe 8 masa “Pushim nga puna”. Janë audituar 70 nga këto procedura, pra 48 %. Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinore konstatohet se nuk ka procedura transparente dhe nuk ka komision apelimi. Po ashtu nga grupi i auditimit konstatohet se janë mbajtur nga paga e punonjësve pagesa si më poshtë paraqitur lidhur me masën disiplinore “Pezullim nga puna”, masë kjo në kundërshtim me parashikimet e Kontratës Kolektive dhe atyre Individuale. Për vitin 2019 janë pezulluar punonjës për 79 ditë pune, në vlerën 118,027 lekë. Për vitin 2020 janë pezulluar punonjës për 393 ditë pune, në vlerën 592,842 lekë. Për vitin 2021 janë pezulluar punonjës për 23 ditë pune, në vlerën 27,182 lekë. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligj nr. 136/2015, datë 05.12.2015, Kontrata Kolektive, neni 21, pika 1 dhe Kontrata Individuale, neni 9.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 25 – 32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1 Rekomandimi:** Nga Administratori i UKGJ SHA të merren masa të menjëhershme për ngritjen e Komisionit të rekrutimit, shpalljen e pozicioneve vakante të punës, si dhe ndjekja me transparencë e rekrutimit të punonjësve të rinj, mundësi të barabarta punësimi, nxitjen e konkurrencës me qëllim rekrutimin e punonjësve sa më të kualifikuar.

*Menjëherë*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Me reformimin e shoqërisë, UKGJ SHA ka miratuar në Këshillin Mbikëqyrës Rregulloren e Përcaktimit të Kritereve të punësimit. Me urdhër nr. 147/6 datë 29.09.2022 me nr. 1407/1 prot., datë 29.09.2022 është krijuar para reformës komisioni i rekrutimit të punonjësve të rinj dhe pas reformës përmes shkresës me nr. 153 prot., datë 16.01.2023, urdhër nr. 37, datë 16.01.2023.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht shkresës me nr. 362/3 prot., datë 21.02.2023 Këshilli i Mbikëqyrës ka miratuar Rregulloren e Përcaktimit të Kritereve të punësimit në Shoqërinë Rajonale UKGJ SHA. Nisur nga sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *I zbatuar*.

**5.2 Rekomandimi:** Nga Administratori i UKGJ SHA të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi dhe transparencë të procedurave të dhënies të masave disiplinore, si dhe ngritjen e komisionit të apelimit lidhur me dhënien e masave disiplinore në këtë shoqëri.

*Menjëherë*



Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Me urdhrat përkatës janë dhënë masat disiplinore si dhe ngritja e Komisionit të Apelimit përpara reformës (shkresa me nr. 1389/7 prot., datë 27.09.2022, urdhër nr. 143/7 datë 27.09.2022) dhe pas reformës (shkresa me nr. 153/1 prot., datë 16.01.2023, urdhër nr. 37/1 datë 16.01.2023)

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht shkresave si më sipër, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *I zbatuar*.

**6. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me shpenzimet e kryera më arkë dhe bankë rezulton se për muajin Tetor libri i arkës është i paplotësuar gjë që sjell llogaritje gabim të mbetjes së datës, llogaritur në muajin pasardhës në vlerën 22,725 lekë ku në të vërtetë kjo shumë është në vlerën 21,470 lekë pra llogaritur 1,255 lekë më shumë. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e njësive në sektorin publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 33 – 47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1 Rekomandimi:** UKGJ SHA të marrë masat për plotësimin dhe mbajtjen në mënyrë koherente të librit të arkës dhe llogaritjen e tyre në mënyrë të saktë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *I zbatuar*.

**7. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me blerjet e vogla rezulton se në procedurën me objekt “Informatizimi i sistemit të kontabilitetit Financiar”, gjatë hartimit të specifikimeve teknike nuk është marrë në konsideratë afati i lëvrimit të shërbimit, duke mos marrë parasysh pasojat mbi vazhdueshmërinë e shërbimit muajin. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM Nr. 914, Datë 29.12.2014 “Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Neni 12 “Njoftimi i Kontratës”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 33 – 47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1 Rekomandimi:** UKGJ SHA të marrë masat që gjatë rasteve të hartimit të specifikimeve teknike në fushën e Teknologjisë së Informacionit të bazohet në legjislacionin përkatës dhe në praktikat më të mira.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**8. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me blerjet e vogla rezulton se në procedurën me objekt “Pjesë këmbimi, bateri, goma”, Me anë të aktmarrëveshjes nr. 1056/3 prot., datë 17.09.2019 kërkohet të bëhet heqja e disa shërbimeve sipas preventivit dhe zëvendësimi me punime të tjera ku në total vlera e shërbimeve të hequra arrin në shumën 123,000

lekë pa TVSH dhe për shërbimet që janë kryer nuk është mbajtur procesverbali i duhur dhe nuk janë pasqyruar në faturë. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligjin nr. 9855, datë 26.12.2007, Ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009, Ligjin nr. 10 309, datë 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin nr. 131/2012, Ligjin nr. 182/2014 dhe Ligjin nr. 47/2017, Ligjin nr. 103/2018 dhe Vendim nr. 914, datë 29.12.2014 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 33 – 47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1 Rekomandimi:** UKGJ SHA të marrë masat që të deklarojë të gjithë punimet e zëvendësuara me shërbimet sipas preventivit të procedurës së prokurimit si dhe të pasqyrohen në faturë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar/I papranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht. Në vijim janë marrë për të deklaruar të gjitha punimet e zëvendësuara me shërbimet sipas preventivit të procedurës së prokurimit.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**9. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me blerjet e vogla rezulton se në procedurën me objekt “*Blerje Pajisje informatike*” janë s’kualifikuar nga gara Operatorët Ekonomik të mëposhtëm:

A.D 550.000

D.Xh 565.000

E.A 565.000

J 581.900

O.T 533.333

sipas procesverbalit nr. 1449/5 datë 01.09.2020 për arsye se nuk kanë të specifikuar në ekstrakt objektin e prokurimit por në fakt, referuar faqes zyrtare të QKB-së rezulton se OE në fjalë kanë në objektin e veprimtarisë së tyre objektin e prokurimit. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar, Neni 46 “*Kualifikimi i ofertuesve*”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 33 – 47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1 Rekomandimi:** UKGJ SHA të marrë masat që në procedurat e ardhshme të prokurimit të marrë në konsideratë objektin e veprimtarisë së OE të cilët e kanë të specifikuar në ekstrat objektin e prokurimit.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht. Në vijim janë marrë në konsideratë vetëm ata OE të cilën kanë në objektin e veprimtarisë së tyre natyrën e shërbimit/punës/mallit të prokuruar.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**10. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontabilitetin, rezulton se në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të vitit 2021, zëri “*Të drejta të arkëtueshme*” ka pësuar rritje nga vlera 144,398,367 lekë në vitin 2020, në vlerën 172,903,495 lekë në vitin 2021. Nga subjekti, argumentohet se këto shtesa vijnë si rezultat i parapagimeve të

ndryshme,, por në fakt këto shpenzime janë financuar nga buxheti i shtetit, të cilat nuk janë paraqitur në kontabilitet. Sa i takon zërit “Lëndë e parë dhe Materiale të Konsumueshme”, rezulton një rënie nga viti 2020 në vlerën 16,672,487 lekë, në vitin 2021 në vlerën 15,800,475 lekë. Konstatohet se në shënimet shpjeguese nuk ka sqarim lidhur me këta zëra dhe si e tillë situata është e paqartë dhe nuk jep siguri të arsyeshme. Shënimet shpjeguese paraqiten të paqarta, të paplota dhe të pa kuptueshme. Sa më sipër është në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 2, paragrafi 49, pikat c dhe d.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 48 – 51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1 Rekomandimi:** Nga ana e UKGJ SHA, Drejtoria Tregtare, të merren masa për analizimin e llogarive të pasqyrave financiare (“Të drejta të arkëtushme” dhe “Lëndë e parë dhe Materiale të Konsumueshme”), duke pasqyruar saktë transaksionet dhe burimet e financimit të tyre në shënimet shpjeguese të bilancit.

*Menjëherë*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht. Në vijim janë marrë masa për të hartuar shënime shpjeguese të thjeshta dhe të kuptueshme për palët e treta.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**11. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontabilitetin, rezulton se me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme nr. 5, datë 02.12.2019, janë shkarkuar Audituesit Ligjorë, për arsye të paargumentuara. Është lidhur Kontrata e Shërbimit me nr. 1946 prot, datë 31.12.2019 midis Administratorit dhe Audituesve Ligjorë. Me shkresën nr. 182 prot, datë 10.02.2022 është hartuar akti i përbashkët për zgjidhjen me marrëveshjes të kontratës së shërbimit, për shkak të largësisë. Me vendimin i Asamblesë nr. 01, datë 22.02.2022 janë emëruar dy auditues ligjorë, për Auditimin e Pasqyrave Financiare 2019. Kontrata e shërbimi mes palëve është lidhur me shkresën nr. 213/1 prot, datë 25.02.2022 për auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2019. Sa më sipër, rezulton se Pasqyrat Financiare për periudhën objekt auditimit nuk janë audituar nga Audituesit ligjorë, veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, struktura e miratuar e shoqërisë”, neni 13, pika 3.f. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 48 – 51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1 Rekomandimi:** Asambleja e Aksionareve dhe Administratori i UKGJ SHA të analizojnë situatën dhe të marrin masa për auditimin e Pasqyrave Financiare.

*Menjëherë*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht. Nga ana e AP janë emëruar Audituesit e rinj ligjor me Vendim nr. 1, datë 22.02.2022 për auditimin e PF për vitet ushtrimore 2019, 2020 dhe në vazhdim.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *I zbatuar*.

**12. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Blerje kamionçine” rezulton se me shkresën nr. 1702/2 prot., datë 16.10.2020 është ngritur komisioni për testimin e tregut me përbërje z. K.L Shofer, z. M.B Shofer

dhe z. B.Sh përgjegjës sektori nga ana e të cilit është mbajtur proces. Ky grup punë ka marrë 3 oferta nga OE të ndryshëm që operojnë të tregun e materialeve objekt kontrate. Në fakt në gjykim të Grupit të Auditimit, nga ana e këtij komisioni nuk janë ezauruar në mënyrën e duhur hapat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2. Konkretisht, nga ana e tyre janë përdorur alternativat e marrjes së ofertave nga OE të ndryshëm (të cilët në gjykim të grupit të auditimit as nuk përfaqësojnë tregun) dhe jo të dhëna të tjera nga institucione si INSTAT apo çmime të tjera zyrtare të njohura nga institucione si organet tatimore a doganore të cilat në gjykim të Grupit të Auditimit janë shumë herë më të besueshme krahasuar me studimin e tregut të kryer nga ky komision. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 52 – 90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1 Rekomandimi:** Nga ana Titullarit të AK dhe komisioneve të ngritura të merren masa për rritjen e besueshmërisë dhe transparencës gjatë ushtrimit të detyrave të ngarkuara përmes vlerësimit të më shumë se një mundësie për përcaktimin e vlerës së fondit limit duke marrë të dhëna edhe nga mundësitë e tjera të ofruara nga LPP dhe RrPP.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ardhja e Raportit të Auditimit deri aktualisht nuk ka patur procedura të tjera prokurimi të zhvilluara për automjete.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**13. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Blerje kamionçine” rezultojnë se sipas shkresës me nr. 1702/3 prot., datë 19.10.2020 është bërë një kërkesë nga ana e NJP drejtuar Titullarit të AK për kontraktimin e ekspertit të jashtëm për përcaktimin e specifikimeve teknike, përlllogaritjen e fondit limit dhe preventivit. Me shkresën nr. 1702/4 prot., datë 19.10.2020 nga ana e Titullarit me Urdhrin nr. 209/2 datë 19.10.2020 është ngarkuar personi përgjegjës për prokurimin për ti bërë kërkesë për kontraktim një eksperti të jashtëm, specialist i fushës dhe lidhjen e kontratës përkatëse të shërbimit. Me shkresën nr. 1702/5 prot., datë 19.10.2020 vetë Titullari i AK z. G.LI i ka bërë kërkesë z. V.N për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje kamionçine”. Në vijim me shkresën nr. 1702/6 prot., datë 20.11.2020 është lidhur kontrata e shërbimit mes Titullarit të AK dhe z. V.N e cila nuk ka parashikuar afat dhe rezultojnë të mos ketë parashikuar pagesë. Në zbatim të kontratës nga ana e z. V.N me shkresën nr. 1702/7 prot., datë 23.11.2020 janë dorëzuar specifikimet teknike të objektit kamionçinë për procedurën e prokurimit “Blerje kamionçine”. Sipas shkresës nr. 1702/8 prot., datë 23.11.2020 është mbajtur procesverbali i hartimit të Urdhrit të Prokurimit dhe me shkresën nr. 1702/9 por., datë 23.11.2020 është ngritur Urdhri i Prokurimit nr. 209/3 datë 23.11.2020. Me procesverbalin e datës 23.11.2020 është mbajtur procesverbali i miratimit të Kriterëve të Përgjithshme dhe Veçanta të Kualifikimit. Me shkresën nr. 1702/11 prot., datë 24.11.2020 është miratuar Formulari i Njoftimit të kontratës i cili është publikuar në Buletinin nr. 111 të datës 1 Dhjetor 2020. Me procesverbalin e datës 07.12.2020 është bërë hapja e ofertave. Raporti përmbledhës i vlerësimit është hartuar dhe miratuar nga ana e Titullarit të AK në datë 14.12.2020. Nga analiza e fakteve dhe kronologjisë së ngjarjeve të dokumentuara si më sipër rezultojnë se studimi i tregut është bërë në mënyrë fiktive dhe nuk është i bazuar në prova të besueshme pasi këto çmime duhet të ishin marrë pas hartimit të specifikimeve teknike dhe jo pas

tyre, kjo për vet faktin se çmimi merret për një produkte të caktuar me parametrat dhe kërkesat (specifikimet teknike) sipas nevojave të AK. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 52 – 90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**13.1 Rekomandimi:** Nga ana e UKGJ SHA të merren masa për dokumentimin e kronologjisë së ngjarjeve të ndodhura sipas atyre në fakt dhe shmangien e veprimeve fiktive gjatë procedurave të prokurimit, me qëllim mirë përdorimin e fondeve të UKGJ SHA.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**14. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje kamionçine*”, nga analiza e specifikimeve teknike si dhe kriterëve të vendosura nga eksperti i fushës, z. V.N e të miratuara nga ana e Titullarit të AK z. G.LI rezulton se janë hartuar kriteret të pa argumentuara teknikisht dhe ligjërisht të cilat kanë kufizuar pjesëmarrjen e OE në procedurën e prokurimit. Nga sa më sipër nuk janë argumentuar teknikisht dhe ligjërisht kriteret pasi referuar kërkesës së bërë sipas shkresës nr. 1464 prot., datë 01.09.2020 të Përgjegjës të Sektorit të KUZ dhe z. K.L drejtuar Administratorit të UKGJ SHA z. G.LI nuk ka asnjë referencë për ndonjë domosdoshmëri për kriteret si më sipër. Duhet theksuar këtu se kriteret në lidhje me fuqinë motorike, masën maksimale të autorizuar, vitin e prodhimit, treguesin e kodomoetrit me deri në 200,000 km, gjerësinë e caktuar deri në mm, domosdoshmërinë e gomave të pasme për të qenë teke si dhe domosdoshmërinë e mjetit për të patur një emetim Euro 4 (*në një kohë kur importimi i këtyre mjete për periudhën e zhvillimit të procedurës ka qenë i ndaluar me ligj*) jo vetëm që janë krejtësisht diskriminuese por ato as nuk janë të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese dhe natyrën e kontratës. Specifikimet teknike nuk kanë përshkruar minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që të garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP-së për të vlerësuar mallin si të pranueshëm për funksionet e kërkuara e për rrjedhojë janë hartuar të tilla që nuk kanë krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve si rrjedhojë e arsyeve të sipërpërmendura. Referuar LPP është saktësuar fakti se specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik dhe ato duhet ti referohen standardeve kombëtare, ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato duhet t’u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare. Kërkesat e bëra nuk janë në terma funksionale pasi nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht. Sa më sipër është në kundërshtim me ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, neni 2, “Parimet e përzgjedhjes”, neni 20, “Mos diskriminimi”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, neni 27, “Kontratat e mallrave”, Neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, Rregulloren e Përgjithshme të punës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 52 – 90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1 Rekomandimi:** Nga ana e UKGJ SHA të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kriterëve në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**15. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje kamionçine*”, konkretisht atij të ngarkuar në SPE nga ana e OE T.-D. rezulton se ky OE është favorizuar padrejtësisht pasi nuk përmbush kriteret e vendosura nga ane NJP. Konkretisht për sa i takon produkteve konstatohet se nga ana e këtij OE nuk janë paraqitur dëshmi për plotësimin e kërkesave në lidhje me *Shtojcën 5/1* si dhe dëshmi të vlefshme në lidhje me punët e ngjashme. Për sa më sipër rezulton se ky OE nuk përmbush kriteret në lidhje me dokumentacionin ligjor të kërkuar si dhe ato që lidhen me kapacitetin teknik e për rrjedhojë duhet të ishte s’kualifikuar. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*”, Titulli IV Parimi i detyrimit të besnikërisë, neni 14, pika 1, Neni 16 *Abuzimi me detyrën dhe formën e shoqërisë*, neni 163, pika 1, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, Neni 1, “*Objekti dhe qëllimi*”, Neni 46, “*Kualifikimi i Ofertuesve*”, Neni 53, “*Shqyrtimi i Ofertave*”, Pika 3 dhe Pika 5, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, ndryshuar, Neni 66, “*Kualifikimi i ofertuesve*”, si dhe me Rregulloren e Përgjithshme të punës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 52 – 90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**15.1 Rekomandimi:** Nga ana e UKGJ SHA të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**16. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “*Materiale hidraulike për mirëmbajtjen e rrjetit hidraulik*”, rezulton se specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke mos përshkruar minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që të garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP-së për të vlerësuar mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara e për rrjedhojë janë hartuar të tilla që nuk kanë krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve si rrjedhojë e arsyeve të sipërpërmendura. Referuar LPP është saktësuar fakti se specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik dhe ato duhet ti referohen standardeve kombëtare, ndërkombëtare, specifikimeve teknike

të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato duhet t'u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare. Kërkesat e bëra nuk janë bërë plotësisht në terma funksionalë pasi nuk janë ta argumentuara teknikisht dhe ligjërisht. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 1, "Objekti dhe qëllimi", Neni 2, "Parimet e përzgjedhjes", Neni 20, "Mos diskriminimi", Neni 23, "Specifikimet Teknike", VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar, Neni 27, "Kontratat e mallrave", Neni 61, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", si dhe me Rregulloren e Përgjithshme të punës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 52 – 90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**16.1 Rekomandimi:** Nga ana e UKGJ SHA të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kriterëve në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**17. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt "Studim-Projektim i Ujësjetës, Fshati Golem, Gjirokastër", rezulton se sipas shkresës së administruar në UKGJ me nr. 1417/1 prot., datë 26.08.2020, është nxjerrë një Urdhër nga ana e Titullarit të AK z. G.LI me nr. 171, datë 26.08.2020 sipas të cilit është caktuar grupi i punës për verifikimin në terren të gjendjes së sistemit të ujësjetës të fshatit Golem. Në përbërje të këtij grupi janë përfshirë znj. Ç.D, kryetare (me pozicion inxhinier pranë Drejtorisë Teknike) dhe z. B.R (me pozicion mirëmbajtës Hidraulik) dhe z. A.B (me pozicion Hidraulik) anëtarë. Sipas shkresës nr. 1471/2 prot., datë 02.09.2020 Grupi i punës si më sipër ka dorëzuar në UKGJ relacionin përkatës në zbatim të Urdhrit të Titullarit. Me shkresën nr. 1604/1 prot., datë 30.09.2020 është hartuar Detyra e Projektimit nga ana e ing. Ç.D dhe është miratuar nga ana e Titullarit të AK z. G.LI në shumën **4,505,616 lekë pa TVSH**. Me shkresën nr. 207 prot., datë 11.02.2021 është bërë një kërkesë nga ana e ing. Ç.D për kontraktimin e inxhinierit Hidroteknik si ekspert fushe, kjo për shkak të infektimit të stafit aktual me COVID 19. Me shkresën nr. 207/1 prot., datë 11.02.2021 është nxjerrë nga ana e Titullarit Urdhri nr. 22, datë 11.02.2021 sipas të cilit është ngarkuar personi përgjegjës për prokurimin për marrjen e një eksperti të jashtëm (specialist i fushës) për përlogaritjen e fondit limit, specifikimeve teknike si dhe për hartimin e detyrës së projektimit për procedurën me objekt *Studim – projektim i Ujësjetës fshati Golem, Gjirokastër*. Për studimin e tregut është mbajtur procesverbal nr. 257 prot., datë 19.02.2021. Me shkresën nr. 293 prot., datë 26.02.2021 i është kërkuar ing. B.B nga ana e Titullarit të AK, pjesëmarrja në procedurën e prokurimit si ekspert i jashtëm, duke sqaruar faktin se pagesa për këtë shërbim do të jetë në shumën 10,000 lekë. Për sa më sipër është lidhur kontrata e shërbimit sipas aktit me nr. 311 prot., datë 02.03.2021 mes Titullarit dhe ing. B.B në cilësinë e punëmarrësit duke parashtruar si detyra të këtij të kontraktuari shërbimet si më poshtë:

**Përlogaritjen e fondit limit;**

Specifikimet teknike;

### **Hartimin e detyrës së projektimit;**

Hartimi i kritereve të përgjithshme dhe të veçanta;

Sipas shkresës nr. 347/1 prot., datë 09.03.2021 është bërë edhe përcaktimi i fondit limit nga ana e personit të kontraktuar ing. B.B në shumën prej **4,505,616 lekë pa TVSH.**

Me shkresën nr. 352 prot., datë 10.03.2021 është nxjerrë nga ana e Titullarit të AK Urdhri për ngritjen e NJP me nr. 43, datë 10.03.2021 me përbërje ing. B.B, znj. S.G dhe znj. M.D. Sipas procesverbalit me nr. 352/2 prot., datë 10.03.2021 nga ana e ekspertit të fushës të kontraktuar z. B.B janë hartuar Kriteret e Përgjithshme dhe të Veçanta të Kualifikimit përfshirë këtu ato ligjore dhe ato financiare. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se DST janë miratuar nga ana e Titullarit të AK me shkresën nr. 360/2 prot., datë 11.03.2021. Nga krahasimi i detyrës së projektimit të hartuar nga ana e ing. Ç.D sipas shkresës me nr. 1604/1 prot., datë 30.09.2020 si dhe detyrës së hartuar nga ana e ing. B.B, ekspert i kontraktuar sipas aktit me nr. nr. 311 prot., datë 02.03.2021, rezulton se këto dy materiale janë identike dhe kjo detyrë projektimi është hartuar paraprakisht e miratuar nga Titullari dhe në vijim është kontraktuar një ekspert për po të njëjtën detyrë kur ky dokument (detyra e projektimit dhe fondi limit) ka qenë i gatshëm 5 muaj para se të lidhej kontrata me ekspertin ing. B.B. Nga sa më sipër, në gjykim të Grupit të Auditimit nga ana e UKGJ janë kryer veprime fiktive duke kontraktuar ekspertë të jashtëm me profesion inxhinier Hidroteknik edhe pse UKGJ ka në stafin e vet inxhinier Hidroteknik dhe për më tepër për një shërbim pjesërisht të kryer më parë nga stafi i UKGJ SHA e të miratuar nga vetë Titullari. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 52 – 90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**17.1 Rekomandimi:** Nga ana e UKGJ SHA të merren masa për dokumentimin e kronologjisë së ngjarjeve të ndodhura sipas atyre në fakt dhe shmangien e veprimeve fiktive gjatë procedurave të prokurimit, me qëllim mirë përdorimin e fondeve të UKGJ SHA.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi.*

**18. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “*Studim-Projektim i Ujësjetës, Fshati Golem , Gjirokastër*”, rezulton se sipas shkresës me nr. 360/3 prot., datë 12.03.2021 është miratuar nga ana e Titullarit Njoftimi i Kontratës dhe në Buletinin nr. 42, datë 23 mars 2021 është bërë publikimi i kësaj kontrate. Sipas shkresës nr. 360/4 prot., datë 16.03.2021 dhe dokumentacionit të ngarkuar në SPE si dhe atij të vënë në dispozicion, rezulton se nga ana e AK nuk janë ftuar 5 OE për të dorëzuar oferta por 4, ose 1 më pak. Konkretisht rezulton se janë ftuar për të paraqitur ofertë OE:

A. 2014;

S.A.E;

H. – A.;

47. & I. P.;

Në dosje disponohet dokumentacioni argumentues i kërkesës për ofertë nga këta OE ku konstatohet se objekti i aktivitetit përputhet me atë të nevojshëm për realizimin e objektit të kontratës. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin



publik”, i ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, neni 34, “Kërkesa për propozime”, VKM nr. datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, neni 39, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 52 – 90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**18.1 Rekomandimi:** Nga ana e AK të merren masa për rritjen e eficiencës dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, sigurimin e mirë përdorimit të fondeve publik, nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës, sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik si dhe sigurimin e integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik përmes ftesës së të paktën 5 OE në procedurat e llojit kërkesës për propozime.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**19. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “*Studim-Projektim i Ujësjellësit, Fshati Golem , Gjirokastër*”, rezulton se janë kërkuar ndër të tjera kriteret si më poshtë:

### **1. Kriteri**

“*Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencën profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licencave profesionale në fushën e studimit e projektimit), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme:*

*7a-Projektim,Ura vepra arti deri 10m*

*8.b- Rilevime inxhinierike kadastrale.*

Në fakt vendosja e kriterëve të tilla është e panevojshme, diskriminuese dhe jo në përputhje me kërkesat e parashtruara në detyrën e projektimit.

### **2. Kriteri**

“*Operatori ekonomik duhet të paraqesë si staf kryesor :*

*Staf kryesor, drejtues teknik të shoqërisë në projektim për zbatimin e kontratës në kategoritë si më poshtë:*

*Inxhinier Ndërtimi I (një),*

*Inxhinier Hidroteknik I (një),*

*Inxhinier Gjeologe (Gjeologji/ Gjeologji Miniera) I (një),*

*Inxhinier Gjeodet, I (një),*

*Inxhinier Mekanik, I (një),*

*Inxhinier Elektrik, I (një).*

*Për Inxhinieret të mësipërm duhen dorëzuar detyrimisht Licenca profesionale, Diplomë / kopje vërtetim, kontrate noteriale pune, CV, si dhe të figurojnë si punonjës, në listë pagesat e shoqërisë për tre Muajt të fundit nga zhvillimi i tenderit:*

### **3. Kriteri**

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë staf mbështetës si më poshtë:*

*Përveç stafit kryesor, Operatori ekonomik duhet të ketë në përbërjen e stafit (në listë pagesë) staf mbështetës të cilët duhet të jenë të gatshëm për pozicionet dhe detyrat që do të propozohen të kryejnë gjatë shërbimit:*

*Tre Inxhinier civil ndërtimi*

*Tre Inxhinier hidroteknik*

*Inxhinier Gjeoinformatik sistemeve Gis*

*Një Ekspert i pajisur me Certifikatën e vlerësimit të ndikimit në mjedis VNM (duhet të jetë i pajisur me certifikatë të lëshuar nga Ministria e Mjedisit sipas ligjit në fuqi)”*

Së pari nuk rezulton e argumentuar arsyeja e klasifikimit mes stafit të kërkuar për të qenë pjesë e licencës së shoqërisë pra si Drejtues Teknik dhe atij të konsideruar mbështetës. Pra kjo ndarje nuk mbështet në asnjë argument teknik dhe ligjor duke krijuar kështu kushte diskriminuese për OE pjesëmarrës. Së dyti nuk është i argumentuar stafi i kërkuar prej 3 ing. Ndërtimi dhe 3 ing. hidroteknik. Së treti nuk është e argumentuar se përse kontratat me stafin që është pjesë e Drejtuesve Teknik është kërkuar që të jenë me kontratë noteriale pune dhe stafi mbështetës të jetë më kontratë të thjeshtë pune. Gjithashtu, rezulton i pa argumentuar inxhinieri gjeolog/inxhinier minierash pasi referuar detyrës së projektimit nuk kemi të bëjmë me galeri nëntokësore/miniera. Për më tepër duhet sqaruar fakti se kriteri nuk ka specifikuar qartë specialitetin që duhet të ketë inxhinieri gjeolog por është mjaftuar duke cituar *Inxhinier Gjeologe ( Gjeologji / Gjeologji Miniera)*. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga ana e OE fitues rezulton se OE H – A ka paraqitur si dëshmi dokumente për ing. Agim Mësonjësi me diplomë nga Fakulteti i Gjeologji Minerave, dega Gjeologji dhe titulli ing. Gjeolog Naftë i cili nuk ka lidhje me objektin e prokurimit.

#### **4. Kriteri**

*Dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për objektin të prokurimit: Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se 25 (Njëzet e Pesë) punonjës për tre Muajt e Fundit.*

Në fakt një numër i tillë prej 25 të punësuarish është krejtësisht i paargumentuar teknikisht dhe ligjërish dhe jo i mbështetur në një grafik pune. Edhe referuar kërkesave për staf si më sipër ky numër është gati 1.5 herë më i lartë se ai i nevojshëm

#### **5. Kriteri**

*- Operatori Ekonomik duhet të zotërojë dhe të paraqesë dy GPS në pronësi apo kontratë qiraje.*

*- Operatori Ekonomik duhet të zotërojë dhe të paraqesë një 2 Makina në pronësi apo kontratë qiraje*

Në fakt një numër prej 2 pajisjes dhe mjetesh është i paargumentuar teknikisht dhe ligjërish dhe jo i mbështetur në një grafik pune.

Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, Neni 2, “Parimet e përzgjedhjes”, Neni 20, “Mos diskriminimi”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, Neni 28, “Kontratat e shërbimeve”, pikat 1 dhe 3, Neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 3 si dhe me Rregulloren e Përgjithshme të punës.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 52 – 90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**19.1 Rekomandimi:** Nga ana e UKGJ SHA të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kriterëve në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet.

***Në vijimësi***

Pranueshmëria e rekomandimit: **I pranuar**

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**20. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “*Materiale hidraulike për mirëmbajtjen e rrjetit hidraulik*”, rezulton se sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke mos përshtetur minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që të garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP-së për të vlerësuar mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara e për rrjedhojë janë hartuar të tilla që nuk kanë krijuar kushte për konkurrencë të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve si rrjedhojë e arsyeve të sipërpërmendura. Referuar LPP është saktësuar fakti se specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik dhe ato duhet ti referohen standardeve kombëtare, ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato duhet t’u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare. Kërkesat e bëra nuk janë bërë plotësisht në terma funksionalë pasi nuk janë ta argumentuara teknikisht dhe ligjërish. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, Neni 1, “*Objekti dhe qëllimi*”, Neni 2, “*Parimet e përzgjedhjes*”, Neni 20, “*Mos diskriminimi*”, Neni 23, “*Specifikimet Teknike*”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Neni 27, “*Kontratat e mallrave*”, Neni 61, “*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*”, si dhe me Rregulloren e Përgjithshme të punës.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 52 – 90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**20.1 Rekomandimi:** Nga ana e UKGJ SHA të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

## **MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se me Urdhrin e Administratorit nr. 1305 prot, datë 05.08.2020 “*Marrje në punë jurist të jashtëm*”, është punësuar jurist i jashtëm i përkohshëm, për ndjekjen e seancave gjyqësore me OSHEE SHA/FSHU SHA. Me shkresën nr. 1305/1 prot, datë 05.08.2020 është lidhur kontrata individuale e punës, e cila hyn menjëherë në fuqi, dhe pagesa përcaktohet në vlerën 25,000 lekë në muaj. Sa më sipër, referuar faktit se në strukturën e UKGJ SHA ka punonjës specialist jurist, dhe kjo çështje është humbur në Gjykatën e Apelin, vlera e pagesës së punonjësit nga UKGJ SHA, konsiderohet prej **300,000 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë UKGJ SHA**. Sa më sipër është në kundërshtim me Statutin e shoqërisë dhe VKM nr. 62, datë 27.01.2016 “*Për riorganizimin e operatorëve që*

ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, struktura e miratuar e shoqërisë, neni 18, pika 7, germa l.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 48 – 51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Asambleja e Aksionareve dhe Administratori i shoqërisë UKGJ SHA të analizojnë **dëmin ekonomik** me vlerë **300,000 lekë**, shkaqet të cilat kanë sjellë këtë situatë dhe të marrin masa lidhur me përcaktimin e kritereve të punësimit të punonjësve të përkohshëm, të jashtëm.

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nuk është bërë arkëtimi i shumës.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* por *I pazbatuar*.

**2. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën me objekt “*Materiale për mirëmbajtjen e rrejtit*” konstatohet se referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga ana e OE F.G ky OE është favorizuar padrejtësisht pasi nuk përmbush kriteret e vendosura nga ane NJP. Konkretisht për sa i takon produkteve konstatohet se nga ana e OE F.G nuk janë paraqitur dëshmi për plotësimin e kërkesave si më poshtë:

**Rakorderi PE**

... *Produkti duhet të jetë konform me standardin EN 12201-3:2001 ose ekuivalentin e saj, për këtë ofertuesi duhet të paraqesë në ofertën e tij certifikatën përkatëse;*

**Fasheta PE**

... *Ofertuesi duhet të paraqesë për produktet fasheta PE certifikatë aprovimi të lëshuar nga Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar për përdorimin në sistemet e ujit të pijshëm (p.sh DVGW)*

**Reduksion PE 16**

... *Produktet duhet të jenë të markuara në trup me markën CE dhe produkti duhet të jetë konform me standardin EN 12201-3:2001 ose ekuivalentin e saj, për këtë ofertuesi duhet të paraqesë në ofertën e tij certifikatën përkatëse*

**Saraçineskë me levë**

... *Saraçineskat duhet të respektojnë apo të jenë në përputhje me standardin e ANSI B2.1 ose DIN për sa i përket sistemit të konjeksionit apo sistemit të instalimit të tyre në tubacione.*

**Tub HDPE**

... *Produktet duhet të kenë certifikatë aprovimi të lëshuar nga Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar për përdorimin në sistemet e ujit të pijshëm (p.sh DVGW). Tubat HDPE duhet të vërtetojnë rezistencën e tyre ndaj presioneve të larta dhe deformimit mekanik ndaj forcave statike e dinamike tubat duhet të jenë konform me standardin EN 12201 ose ekuivalent, për të vetuar këtë ofertuesi duhet të paraqesë në ofertën e tij certifikatën përkatëse.*

*Ofertuesi gjithashtu në ofertën e tij duhet të paraqesë test raportet për çdo përmasë të artikujve sipas preventivit ku të vërtetohen që artikujt janë prodhuar e testuar në lidhje me vetitë fiziko-mekanike sipas standardeve : EN 12201-2; EN 3126; EN 1133; EN 2505*

*TUB HDPE100 φ 18mm PN 16*

*Tubat të jenë të testuar të durojnë presion minimalisht 16bar ...*

*TUB HDPE100 φ 20mm PN 16*

*Tubat të jenë të testuar të durojnë presion minimalisht 16bar ...*

*TUB HDPE100 φ 25mm PN 16*

*Tubat të jenë të testuar të durojnë presion minimalisht 16bar ...*

*TUB HDPE100 φ 32mm PN 16*

*Tubat të jenë të testuar të durojnë presion minimalisht 16bar ...*

*TUB HDPE100 φ 40mm PN 16*

*Tubat të jenë të testuar të durojnë presion minimalisht 16bar ...*

*TUB HDPE100 φ 50 mm PN 16*

*Tubat të jenë të testuar të durojnë presion minimalisht 16bar ...*

*TUB HDPE100 φ 63 mm PN 16*

*Tubat të jenë të testuar të durojnë presion minimalisht 16bar ...*

*TUB HDPE100 φ 75 mm PN 16*

*Tubat të jenë të testuar të durojnë presion minimalisht 16bar ...*

*TUB HDPE100 φ 110 mm PN 16*

*Tubat të jenë të testuar të durojnë presion minimalisht 16bar ...*

#### **Manikota EF**

*... Produktet duhet të jene të markuara në trup me markën CE dhe produkti duhet të jetë konform me standardin EN 12201-3:2001 ose ekuivalentin e saj, për këtë ofertuesi duhet të paraqesë në ofertën e tij certifikatën përkatëse.*

#### **Fasheta EF me thike ( trapan të integruar)**

*... Produktet duhet të jenë të markuara në trup me markën CE dhe produkti duhet të jetë konform me standardin EN 12201-3:2001 ose ekuivalentin e saj, për këtë ofertuesi duhet të paraqesë në ofertën e tij certifikatën përkatëse.*

#### **Brryl EF**

*... Produktet duhet të jenë të markuara në trup me markën CE dhe produkti duhet të jetë konform me standardin EN 12201-3:2001 ose ekuivalentin e saj, për këtë ofertuesi duhet të paraqesë në ofertën e tij certifikatën përkatëse.*

Në kushte të tilla ky OE duhet të ishte s'kualifikuar për mos përmbushje të kriterëve të vendosura nga ana e NJP. Gjithashtu, nga sa më sipër, rezulton se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së mallrave tek shoqëria F.G, nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht mallrat nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e cituar si më sipër e për pasojë nuk konfirmohet që këto mallra janë të njëjta me ato të prokuruar dhe për të cilën shoqëria F.G është shpallur fituese dhe më pas është likuiduar. Në këto kushte **vlera 2,129,676 lekë për UKGJ SHA dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik** dhe si e tillë duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria F.G. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, Neni 46, “Kualifikimi i Ofertuesve”, Neni 53, “Shqyrtimi i Ofertave”, pika 3 dhe 5, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, neni 66, Rregulloren e Përgjithshme të punës si dhe kontratën e lidhur sipas aktit me nr. 251/6 prot., datë 13.05.2019 mes AK dhe OE F.G.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 52 – 90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** Nga ana e UKGJ SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **2,129,676 lekë** ndaj furnitorit OE F.G për furnizimet kryera jo në përputhje me kushtet e kontratës të lidhur nr. 251/6 prot., datë 13.05.2019 me objekt ‘Materiale për mirëmbajtjen e rrjetit’ të prokuruar nga AK.

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: L pranuar

**Komenti i subjektit:** Aktualisht nuk është bërë arkëtimi i shumës. Nga ana e UKGJ SHA janë bërë njoftimet përkatëse si dhe padia në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Lushnje.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht shkresave me nr. 1260/3 prot., datë 26.08.2022, me nr. 1383 prot., datë 02.05.2023 dhe nr. 1383/2 prot., datë 31.05.2023 është bërë njoftimi për ekzekutimin vullnetar dhe më pas me shkresën nr. 2947 prot., datë 03.08.2023 është bërë padia përkatëse në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Lushnje. Nisur nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**3. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën me objekt “*Matës uji dhe rakorderi*” konstatohet se sipas shkresës me nr. 239/8 prot., datë 12.04.2019 është ngritur grupi përkatës i marrjes në dorëzim të mallrave i përbërë nga z. A.M, z. T.B dhe z. A.Gj të cilët në datë 16.05.2019 kanë bërë edhe marrjen në dorëzim të mallrave objekt prokurimit. Pas kërkesës së bërë z. F.Rr mbi produktet e kontratës objekt prokurimi u konstatua se këto produkte nuk janë plotësisht konform kërkesave të AK, konkretisht:

Matësit Uji 3/4", në sasinë prej 10 copë, ose vlera **14,000 lekë** nuk janë shoqëruar me logon e UKGJ;

Matësit Uji 1", në sasinë prej 10 copë, ose vlera **49,000 lekë** nuk janë shoqëruar me logon e UKGJ; Për rrjedhojë rezulton se produktet e sipërpërmendura nuk janë në përputhje me kërkesat e AK dhe si të tilla nuk duhet të ishin marrë në dorëzim nga Grupi përkatës e për rrjedhojë **vlera prej 63,000 lekë përbën dëm ekonomik dhe si e tillë duhet të paguhet nga ana e OE A SHPK.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 52 – 90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** Nga ana e UKGJ SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **63,000 lekë** ndaj furnitorit OE A për furnizime të kryera jo në përputhje me kushtet e kontratës të lidhur A ShPK nr. 239/8 prot., datë 12.04.2019 me objekt ‘*Matës uji dhe rakorderi*’.

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Aktualisht nuk është bërë arkëtimi i shumës. Nga ana e UKGJ SHA janë bërë njoftimet përkatëse si dhe padia në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Lushnje.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht shkresave me nr. 1260 prot., datë 26.08.2022 dhe me nr. 1331 prot., datë 02.05.2023 është bërë njoftimi për ekzekutimin vullnetar dhe më pas me shkresën nr. 2946 prot., datë 03.08.2023 është bërë padia përkatëse në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Lushnje. Nisur nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**4. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje kamionçine*”, si dhe verifikimit të mjetit të sjellë në UKGJ rezulton se malli i ofruar nga OE T.-D. nuk përmbush kriteret e përcaktuara në DST pasi:

Fuqia motorike sipas dokumentacionit të sjellë është me fuqi motorike 88 kŴ nga 110 kŴ që është kërkuar;

Rrotat aktive janë ato të aksit të përparmë dhe jo të aksit të pasmë ndryshe nga sa është kërkuar; Makina ka një gjerësi prej 2000 mm, kur në fakt është kërkuar të jetë jo më pak se 2125 mm.

Për rrjedhojë rezulton se është favorizuar ky OE edhe në fazën e marrjes në dorëzim të mjetit. Vlera prej **1,881,180 lekë** konsiderohet si dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe UKGJ SHA. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*”, Titulli IV Parimi i detyrimit të besnikërisë, neni 14, pika 1, *Neni 16 Abuzimi me detyrën dhe formën e shoqërisë*, neni 163, pika 1, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, Neni 1, “*Objekti dhe qëllimi*”, Urdhrin nr. 1702/14 prot., datë 14.01.2021 si dhe

kontratën e furnizimit të lidhur mes AK dhe OE T.-D. sipas aktit me nr. nr. 1702/13 prot., datë 31.12.2020. Neni 66, “Kualifikimi i ofertuesve”, si dhe me Rregulloren e Përgjithshme të punës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 52 – 90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1 Rekomandimi:** Nga ana e UKGJ SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **1,881,180 lekë** ndaj furnitorit OE T.-D. për furnizimin e kryer jo në përputhje me kushtet e kontratës të lidhur nr. 1702/13 prot., datë 31.12.2020 me objekt ‘Blerje kamionçine’, kjo në rast të mos zëvendësimit të mallit objekt prokurimi sipas atij të kërkuar nga AK në DST.

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: I pranuar

**Komenti i subjektit:** Aktualisht nuk është bërë arkëtimi i shumës. Nga ana e UKGJ SHA janë bërë njoftimet përkatëse si dhe padia në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Lushnje.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht shkresave me nr. 1260/1 prot., datë 26.08.2022, me nr. 1330 prot., datë 02.05.2023 dhe 1330/2 prot., datë 31.05.2023 është bërë njoftimi për ekzekutimin vullnetar dhe më pas me shkresën nr. 2977 prot., datë 04.08.2023 është bërë padia përkatëse në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Lushnje.. Nisur nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**5. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën me objekt “Materiale hidraulike për mirëmbajtjen e rrjetit hidraulik” konstatohet se referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga ana e OE E.L ky OE është favorizuar padrejtësisht pasi nuk përmbush kriteret e vendosura nga ane NJP. Konkretisht për sa i takon produkteve konstatohet se nga ana e OE nuk janë paraqitur dëshmi për plotësimin e kërkesave si më poshtë:

**I. Kriteri**

*“ISO 17885:2015 (Sistemet me tuba plastike-rakorderi mekanike për sisteme me tuba presioni) ose certifikate ekuivalente”*

*ISO 5922:2005 për rakorderi zingato ose certifikata të tjera ekuivalente nga institucione të aprovuar.*

*ISO 228 për pajisjet me shtrëngim dhe filetimit për tuba ujësjellësi ose certifikata të tjera ekuivalente nga institucione të aprovuar.*

*ISO 15874 për rakorderite me ngjitje elektrofuzion, sisteme të tubave plastike për ujësjellësa dhe për kanalizime nën presion, ose certifikata të tjera ekuivalente nga institucione të aprovuar.*

*Ofertuesi duhet të dorëzojë për të gjithë mallrat objekt prokurimi Autorizim Prodhuesi, ose distributori në rast se do të paraqitet autorizim distributori operatori ekonomik ta vërtetojë këtë duke paraqitur kontratë premtimi, letër angazhimi/akt-marrëveshje lidhur mes Kompanisë prodhuese dhe Distributorit të autorizuar.*

*Ofertuesi duhet të paraqesë dokumente teknike për artikujt të cilët janë objekt prokurimi si katalog apo fragmente katalogu/skeda teknike të produkteve sipas preventivit.*

*Të gjitha certifikata ISO dhe Standardet e kërkuara në këto specifikime mund të zëvendësohen me standarde ekuivalente ose standarde të tjera të pranuar ndërkombëtarisht që sigurojnë një cilësi të barabartë ose më të lartë se standardet e përmendura”*

Në lidhje me kërkesën si më sipër rezulton se ky OE ka paraqitur dëshmitë sipas tabelës të paraqitur në Aneksin nr. 2.7.1. Duke analizuar rezulton se OE nuk ka paraqitur dëshmi për përmbushjen e kriterëve në lidhje me certifikatat:

*ISO 17885:2015 (Sistemet me tuba plastike-rakorderi mekanike për sisteme me tuba presioni) ose certifikate ekuivalente”*

ISO 5922:2005 Për rakorderi zingato ose certifikata të tjera ekuivalente nga institucione të aprovuar.

ISO 228 për pajisjet me shtrëngim dhe filetimit për tuba ujësjellësi ose certifikata të tjera ekuivalente nga institucione të aprovuar.

ISO 15874

Gjithashtu, rezulton se OE E.L ka paraqitur në 13 raste dokumente të pa përkthyer dhe të pa noterizuara. Sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se OE E.L ka paraqitur Autorizimin e Prodhuesit T S S.P.A ndaj OE A të datës 08.11.2018 e cila është e pa përkthyer dhe e pa noterizuar në gjuhën shqipe. Gjithashtu, sipas këtij dokumenti OE A është autorizuar me kërkesë të tij që të përdorë këtë dokument (autorizim) në procedurat e prokurimit dhe nëse ky OE (A) shpallet fitues i kontratës, për procedurën respektive ai do të mund të garantojë furnizimin e kontratës me produktet tona sipas specifikimeve<sup>8</sup>. Njëkohësisht, nisur nga ky Autorizim, OE A sipas dokumentit të ngarkuar në sistem të datës 24.04.2020 ka autorizuar OE E.L të ofrojë në tender produktet e kompanisë T S S.P.A, për të cilat ky OE (A) ka pretenduar se është distributor i autorizuar. Në fakt, siç u shpreh edhe më sipër OE A nuk është i tillë dhe në këto kushte ky dokument nuk është vlefshëm për kriterin e vendosur sipas NJP e për rrjedhojë OE E.L duhet të ishte s'kualifikuar. Nga sa më sipër rezulton se ky OE nuk përmbush disa ndër kriteret më kryesore në prokurimin e mallrave, që janë kërkesat për cilësinë e produkteve. Për rrjedhojë ky OE duhet të ishte s'kualifikuar.

Sipas shkresës me nr. 724/6 prot., datë 08.06.2020 është ngritur grupi përkatës i marrjes në dorëzim të mallrave i përbërë nga z. B.Sh, z. F.Rr dhe z. E.I të cilët në po këtë datë kanë bërë edhe marrjen në dorëzim të mallrave objekt prokurimit. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se marrja në dorëzim e produkteve objekt kontratë është bërë pas dorëzimit edhe të faturës tatimore datë 08.06.2020, fatura tatimore nr. 36, datë 08.06.2020, vlera 4,668,006 lekë me TVSH. Nga sa më sipër u sqarua në lidhje me mangësitë në drejtim të cilësisë gjatë fazës së paraqitjes së dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së mallrave tek Shoqëria E.L, nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht mallrat nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e kërkuar sipas DST dhe Shtojcës përkatëse. Pra specifikimet teknike (që janë pjesë e kontratës), nuk përmbushen për mallrat e sjellë në AK dhe nuk konfirmojnë se mallrat janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria E.L ka fituar tenderin dhe është likuiduar. Në kushte të tilla ky OE duhet të ishte s'kualifikuar për mos përmbushje të kriterëve të vendosura nga ana e NJP.

**Si përfundim rezulton se nuk konfirmohet përputhshmëria me kushtet e kontratës (Kushtet e Vecanta të Kontratës dhe Specifikimet Teknike) për shumën prej 4,668,006 lekë me TVSH, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik dhe si e tillë duhet të paguhet nga ana e furnitorit të kontratës E.L.** Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Titulli IV Parimi i detyrimit të besnikërisë, neni 14, pika 1, Neni 16 Abuzimi me detyrën dhe formën e shoqërisë, neni 163, pika 1, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, Neni 46, “Kualifikimi i Ofertuesve”, Neni 53, “Shqyrtimi i Ofertave”, pika 3 dhe 5, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, neni 66, Rregulloren e Përgjithshme të punës si dhe kontratën e lidhur sipas aktit me nr. 724/5 prot., datë 25.05.2020 mes AK dhe OE E.L.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 52 – 90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

<sup>8</sup> Përkthim i Audituesve Shtetërorë të KLSH



**5.1 Rekomandimi:** Nga ana e UKGJ SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **4,668,006 lekë** ndaj furnitorit OE E.L për furnizimet kryera jo në përputhje me kushtet e kontratës të lidhur me nr. 724/5 prot., datë 25.05.2020 me objekt ‘*Materiale hidraulike për mirëmbajtjen e rrjetit hidraulik*’.

*Menjëherë*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Aktualisht nuk është bërë arkëtimi i shumës. Nga ana e UKGJ SHA janë bërë njoftimet përkatëse si dhe padia në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Lushnje.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht shkresave me nr. 1260/2 prot., datë 26.08.2022, me nr. 1330 prot., datë 02.05.2023 dhe 1332 prot., datë 02.05.2023 është bërë njoftimi për ekzekutimin vullnetar dhe më pas me shkresën nr. 2978 prot., datë 04.08.2023 është bërë padia përkatëse në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Lushnje.. Nisur nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

## **MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKEDHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontabilitetin, rezulton se UKGJ SHA është në proces gjyqësor për kontratat si dhe për çmimin e Stacionit të Pompimit Buduk. Shoqëria ka punësuar një jurist të jashtëm për ndjekjen e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët gjyqësore. Situata e procedurës gjyqësore të Shoqërisë UKGJ SHA, paraqitet si më poshtë:

Palë paditëse Shoqëria Aksionare UKGJ me objekt padie “Deklarimin e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv të faturave të energjisë elektrik, si më poshtë:

-Fatura nr. 304420478 (Buduk), në vlerën 40,235,520 lekë për periudhën 30.11.2018 - 31.12.2018, Fatura e Stacionit të Pompimit Picar m, nr. 304419229, në vlerën 208,588 lekë për periudhën 30.11.2018 - 31.12.2018,

-Fatura e Stacionit Pulari Lazarat me nr. 304418205, në vlerën 201,835.20 lekë për periudhën 28.11.2018 - 31.12.2018,

-Fatura e Stacionit të Pompimit Golem, me nr. 304419314, në vlerën 622,579.20 lekë për periudhën 30.11.2018 - 31.12.2018,

-Fatura e Stacionit të Pompimit Lazarat Qendër, me nr. 304419254, në vlerën 384,384 lekë,

-Fatura e Stacionit të Pompimit Lazarat Qendër, me nr. 304419654, në vlerën 45,696 lekë, për periudhën 27.11.2018 - 27.12.2018.

-Vendimi civil i **Gjykatë të Shkallës së Parë Gjirokastrë**, me nr. 21-2019-2272/624, datë 05.12.2019, paraqitet si më poshtë

-Pranimi i pjesshëm i padisë,

-Konstatimin e pavlefshmërisë të titullit ekzekutiv të faturës të energjisë elektrike me nr. 304420478 për muajin Dhjetor 2018,

-Konstatimin e pavlefshmërisë të titullit ekzekutiv të faturës të energjisë elektrike me nr. 304418205 për muajin Dhjetor 2018,

-Konstatimin e pavlefshmërisë të titullit ekzekutiv të faturës të energjisë elektrike me nr. 304419314 për muajin Dhjetor 2018,

-Konstatimin e pavlefshmërisë të titullit ekzekutiv të faturës të energjisë elektrike me nr. 304419229 për muajin Dhjetor 2018,

-Konstatimin e pavlefshmërisë të titullit ekzekutiv të faturës të energjisë elektrike me nr. 304419654 për muajin Dhjetor 2018,

-Konstatimin e pavlefshmërisë të titullit ekzekutiv të faturës të energjisë elektrike me nr. 304419254, për shumën 5,222.4 lekë, si dhe përlogaritjen mes sasisë së energjisë elektrike të harxhuar më tepër mbi çmimin 12.4 lekë/kWh, të llogaritur në këtë faturë,

-Rrëzimin për pjesën tjetër të padisë.

**Gjykata e Apelit Gjyrokastër** me vendimi civil nr. 20-2021-418/159, datë 07.05.2021, ka përcaktuar:

-Rrëzimin e vendimit nr. 21-2019-2272/624, datë 05.12.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe pushimin e gjyqimit për padinë me objekt konstatimin e pavlefshmërisë të titujve ekzekutiv fatura tatimore shitje për kontratat me emërtim: Buduk, Lazarat Qendër (Pularia), Ujësjellës Golem, Picar, Lazarat Qendër dhe Fushë Kordhocë.

-Ndryshimin e këtij vendimi sa i përket kërimit për kundërshtimin e çmimit të aplikuar në faturat objekt kundërshtimi.

-Lënien në fuqi për pjesën e rrëzuar dhe atë të shpenzimeve gjyqësore.

-Sa më sipër detyrimi i lindur nga mos pagesa e faturave të energjisë elektrike ndaj FSHU SHA deri në periudhën objekt auditimi, ka arritur në vlerën **46,979,553** lekë dhe kamatëvonesat e këtij detyrimi në vlerën **49,662,348** lekë detyrim ky i cili përbën **përdorim pa efektivitet, efizienz dhe ekonomikitet të fondeve të buxhetit të shtetit dhe të vet UKGJ SHA**. Sa më sipër është në kundërshtim me Statutin e shoqërisë dhe VKM nr. 62, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 48 – 51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Asambleja e Aksionareve dhe Administratori i shoqërisë UKGJ SHA të analizojnë situatën e mësipërme mbi përdorimin pa efektivitet, efizienz dhe ekonomikitet të fondeve në shumën prej **49,662,348 lekë** me qëllim identifikimin e shkaqeve konkrete të cilat kanë sjellë këtë situatë dhe të njëkohësisht të merren masa emergjente për likuidimin e këtyre detyrimeve.

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e AKUM është bërë një subvencion në shumën prej 23,000,000 lekë me qëllim likuidimin e detyrimeve të prapambetura. Aktualisht shuma e detyrimeve pas reformimit është në masën rreth 715,000,000 lekë.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *I zbatuar pjesërisht*.

**2. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me pagat, ligjshmërinë e rekrutimeve, strukturën organizative etj., rezulton se orët shtesë të punës janë orë pune të cilat kryhen në rastet e emergjencave të ndryshme të paparashikuara, si p.sh.: avari në rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm ose në rrjetin e kanalizimeve, në rastet e përmbytjeve ose të disa rrethanave/avarive të natyrave të ndryshme. Kryerja e orëve shtesë justifikohet me anë të një procesverbali që nënshkruhet nga drejtuesi i sektorit përkatës dhe nga punonjësi. Duke u bazuar të relacionet e procesverbaleve, Administratori i UKGJ SHA, vendos për kompensimin e orëve

shtesë të kryera ose ditë pushimi. Pas nënshkrimit nga Administratori procesverbali depozitohet në degën e financës. Llogaritja e orëve jashtë orarit të punës bëhet me masën 100 % të pagës orare ditore duke u llogaritur mbi pagën bazë sipas vendit të punës, dhe llogaritja është e njëjtë edhe në ditë feste. Konkretisht të dhënat në lidhje me orët jashtë orarit jepen sipas tabelës së mëposhtme:

UKGJ SHA	Orë jashtë orari	Vlera ALL
Periudha	Ditë Normale	Ditë Normale
Viti 2019	2,558	618,718
Viti 2020	3,614	884,294
Viti 2021	1,361	365,630
Totali	7,533	1,868,642

Vlera **1,868,642 lekë** konsiderohet **përdorim pa efektivitet, efizienz dhe ekonomicitet i fondeve të buxhetit të shtetit dhe të vet UKGJ SHA**. Sa më sipër është në kundërshtim me Kodin e Punës, neni 87, pika 1 dhe 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 25 – 32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë dhe Sektori i Financës, të merren masa për analizimin e vlerës prej **1,868,642 lekë si përdorim pa efektivitet, efizienz dhe ekonomicitet i fondeve**, si dhe të merren masa për përcaktimin në rregulloren e shoqërisë të masës në të cilën duhet të kryhen pagesat për orët shtesë mbi kohën normale të punës.

*Menjëherë*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Pas reformimit të institucionit, është hartuar nga ana e AKUM rregullorja e institucionit e cila është miratuar më pas me Vendimin e Aksionarit MIE.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* por *I pazbatuar*.

**3. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me pagat, ligjshmërinë e rekrutimeve, strukturën organizative etj., rezulton se në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 4 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **3,788,350 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore. Për periudhën objekt auditimi, janë në gjykim 3 çështje gjyqësore në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, të cilat në Gjykatën e Shkallës të Parë Gjirokastër janë humbur nga UKGJ SHA në vlerën **374,852 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore. Në total për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera **3,788,350 lekë** e cila konsiderohet **përdorim pa efektivitet, efizienz dhe ekonomicitet i fondeve të buxhetit të shtetit dhe të vet UKGJ SHA**. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 136/2015, datë 05.12.2015.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqet nr. 25 – 32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** Nga Administratori, sektori Juridik dhe Burimet Njerëzore të UKGJ SHA, të merren masa për analizimin e vlerës prej **3,788,350 lekë**, si **përdorim pa efektivitet, efizienz dhe ekonomicitet i fondeve të buxhetit të shtetit dhe të vet UKGJ SHA** dhe për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të shkëputjes të marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, dhe të

procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** -

**Komenti i audituesve:** Ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* por *I pazbatuar*.

**4. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me shpenzimet e kryera më arkë dhe bankë rezultojnë se në datë 29.10.2019 është likuiduar urdhër shpenzimi nr. 99142 datë 25.10.2019 në vlerën 896,000 lekë (500,000 lekë gjobë + 496,000 lekë kamatëvonesa + shpenzime përbarimore) si gjobë nga Inspektorati Sanitar Shtetëror për shkak të shkeljeve të mëposhtme:

Mos mirëmbajtja e kushteve higjieno sanitare të depove

Nuk janë depot e pajisura me akt miratim higjieno sanitare datë 08.04.2019

Shuma totale prej **896,000 lekë përbën një efekt ekonomik negativ në rezultatin financiar** duke qenë një vlerë e konsiderueshme shpenzimesh për buxhetin e shoqërisë. Sa më sipër është në kundërshtim me ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e njësive në sektorin publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 33 – 47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1 Rekomandimi:** UKGJ SHA të marrë masat për përmbushjen e qëllimeve dhe kryerjen e veprimtarisë së saj konform rregullave dhe ligjeve në fuqi.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Ndaj UKGJ SHA nuk ka patur më aplikime për gjopa nga Inspektorati Sanitar Shtetëror.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**5. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën me objekt “Matës uji dhe rakorderi” konstatohet se sipas procesverbalit të datës 28.02.2019 është bërë përcaktimi i Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të Kualifikimit të cilat janë miratuar nga ana e ish – Administratorit po në datë 28.02.2019. Publikimi i njoftimit të kontratës është bërë sipas Buletini nr. 9 të datës 4 Mars 2019. Në lidhje me kriteret është bërë ankesë nga 4 OE të cilëve u është kthyer përgjigje nga ana e AK. Nga analiza e specifikimeve teknike si dhe kriterëve të vendosura nga eksperti i fushës, anëtar i NJP rezultojnë se janë hartuar kriteret dhe specifikime teknike të pa argumentuara teknikisht dhe ligjërish të cilat kanë kufizuar pjesëmarrjen e OE në procedurën e prokurimit nga ana e të cilëve edhe janë paraqitur ankesat përkatëse si më sipër duke bërë që të përdoren pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet fondet në shumën **4,754,280 lekë**. Konkretisht:

**Matës uji në të thatë multi-jet 2”**

*Për temperaturë uji deri në 50°*

*Matësi duhet të ketë element sigurie për të dalluar nëse është ushtruar forcë mbi fushën e tij për të penguar lëvizjen e lirë të numërorit;*

*Matësit e ujit duhet të kenë të shkruar logon UKGJ*

***Matës uji në të thatë multi-jet 1”***

*Për temperaturë uji deri në 50°*

*Matësi duhet të ketë element sigurie për të dalluar nëse është ushtruar forcë mbi fushën e tij për të penguar lëvizjen e lirë të numërorit;*

*Matësit e ujit duhet të kenë të shkruar logon UKGJ*

***Për matësit e thatë Singel jet 3/4”***

*Për temperaturë uji deri në 50°*

*Numrat në fushën e matësit që tregojnë matjen e ujit të konsumuar duhet të jenë të mbyllur në mënyrë hermetike, në një kasë që nuk krijon kondensim për të penguar leximin dhe të jenë të ndarë në 2 ngjyra (5 numra me të njëjtën ngjyrë që tregojnë m<sup>3</sup> dhe tre numra me një ngjyrë tjetër që tregojnë nënfishat e m<sup>3</sup>)*

*Matësi duhet të ketë element sigurie për të dalluar nëse është ushtruar forcë mbi fushën e tij për të penguar lëvizjen e lirë të numërorit;*

*Matësit e ujit duhet të kenë të shkruar logon UKGJ*

***Për matësit e thatë Singel-jet ½”***

*Të jetë për ujë të pijshëm dhe ekrani të rrotullohet në 360°*

*Për temperaturë uji deri në 50°*

*Numrat në fushën e matësit që tregojnë matjen e ujit të konsumuar duhet të jenë të mbyllur në mënyrë hermetike, në një kasë që nuk krijon kondensim për të penguar leximin dhe të jenë të ndarë në 2 ngjyra (5 numra me të njëjtën ngjyrë që tregojnë m<sup>3</sup> dhe tre numra me një ngjyrë tjetër që tregojnë nënfishat e m<sup>3</sup>)*

*Matësi duhet të ketë element sigurie për të dalluar nëse është ushtruar forcë mbi fushën e tij për të penguar lëvizjen e lirë të numërorit;*

*Matësit e ujit duhet të kenë të shkruar logon UKGJ*

**SPECIFIKAT E SARAÇINESKËS :**

*Saraçineska duhet të ketë të gdhendur në trup (jo në dorezë ):*

- 1) dimensionin;*
- 2) Presionin;*
- 3) Emrin e prodhuesit;*
- 4) Kodin e produktit.*

*Saraçineskat duhet të kenë garanci 5 (pesë ) vjeçare*

Nga sa më sipër nuk janë argumentuar teknikisht dhe ligjërishit specifikimet pasi referuar kërkesës së bërë sipas shkresës nr. 173 prot., datë 18.02.2019 të Përgjegjës së Degës së Shitjes znj. M.H drejtuar ish – Administratorit të UKGJ SHA nuk ka asnjë referencë për ndonjë domosdoshmëri për afatin e caktuar prej 22 ditësh pune. Duhet theksuar këtu se kriteret në lidhje me temperaturën, ndryshimet e ngjyrave të sasisë së ujit të konsumuar ku janë kërkuar me 5 numra të njëjtën ngjyrë dhe 3 të tjerë më ngjyra tjetër apo kriteri sipas të cilit është kërkuar që matësi të ketë element sigurie për të dalluar nëse është ushtruar ndonjë forcë mbi fushën e tij për të penguar lëvizjen e lirë të numërorit jo vetëm që janë krejtësisht diskriminuese por ato as nuk janë të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese dhe natyrën e kontratës. Gjithashtu, konstatohet se kërkesat për ngjyrën e shifrave janë kërkuar për matësit multi jet 1” dhe 2” dhe jo për të gjithë matësit dhe përveç kësaj konstatohet në mënyrë krejtësisht të paargumentuar është vendosur kriteri për shkrimin e logos së UKGJ, specifikim ky krejtësisht jashtë çdo domosdoshmërie që mund të ketë përdorimi i këtyre matësve për sa kohë të gjithë këta kanë një numër unik identifikimi. Për sa i takon specifikimeve të saraçineskave konstatohet se pa asnjë argument teknik apo ligjor është kërkuar që dimensionet,

presioni, emri i prodhuesit dhe kodi i produktet të jetë domosdoshmërisht e gdhendur në trup dhe jo në dorezë dhe ndryshe nga matësit për të cilat është kërkuar garanci 3 vjeçare (të cilët në total kanë një vlerë shumë më të lartë në krahasim me ato të saraçineskave) për saraçineskat është kërkuar një garanci 5 vjeçare. Specifikimet teknike nuk kanë përshkruar minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që të garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP-së për të vlerësuar mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara e për rrjedhojë janë hartuar të tilla që nuk kanë krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve si rrjedhojë e arsyeve të sipërpërmendura. Referuar LPP është saktësuar fakti se specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik dhe ato duhet ti referohen standardeve kombëtare, ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato duhet t'u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare. Kërkesat e bëra nuk janë terma funksionale pasi nuk janë ta argumentuara teknikisht dhe ligjërisht. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, Neni 2, “Parimet e përzgjedhjes”, Neni 20, “Mos diskriminimi”, Neni 23, “Specifikimet Teknike”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Neni 27, “Kontratat e mallrave”, Neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, si dhe me Rregulloren e Përgjithshme të punës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 52 – 90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1 Rekomandimi:** Nga ana e UKGJ SHA të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kriterëve në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**6. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën me objekt “*Studim-Projektim i Ujësjetës, Fshati Golem , Gjirokastër*” konstatohet se referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga ana e BOE H.-A. & SRP A. E. ky BOE është favorizuar padrejtësisht pasi nuk përmbush kriteret e vendosura nga ane NJP duke bërë që të përdoren pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet fondet në shumën **4,917,156 lekë me TVSH**. Konkretisht për sa i takon produkteve konstatohet se nga ana e OE nuk janë paraqitur dëshmi për plotësimin e kërkesave si më poshtë:

Për ing. P. T. nuk është paraqitur Licenca profesionale sipas kërkesave të DST;

Për ing. K. K nuk është paraqitur Licenca profesionale sipas kërkesave të DST;

Për ing. E. M nuk është paraqitur Licenca profesionale sipas kërkesave të DST;

Ing. E. M nuk figuron në listë pagesën e muajit dhjetor duke mos përmbushur kështu kriterin sipas kërkesave të DST në lidhje me prezencë në listë-pagesë për 3 muajt e fundit;

Ky OE nuk ka paraqitur dëshmi për inxhinier elektrik;

Për ing. L. Pustina është paraqitur Diplomë nga Fakulteti i Inxhinierisë të Universitetit të Tiranës, në degën Mekanikë por me titull Inxhinier Mekanik për Transport duke mos përmbushur kështu

kriterin sipas kërkesave të DST. Referuar licencës në projektim që disponon znj. Pustina rezulton se ato janë si më poshtë:

*Kat. 11:*

*a – Projektim sinjalistikë jo ndriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe parkime;*

*b – Projektim sinjalistike jo ndriçuese në autostrada rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore dhe në degëzime me hekurudhën;*

*c – Projektim sinjalistikë jo ndriçuese në aeroporte dhe heliporte;*

*d – Projektim sinjalistike ndriçuese në infrastrukturë.*

Sipas Kontratës së Bashkëpunimit të lidhur mes palëve me nr. 914 rep. 75 kol. datë 23.03.2021 ndarja e shërbimeve mes palëve ka parashikuar se OE H – A ka marrë përsipër të ofrojë 10 % të stafit mbështetës kur në fakt, referuar dokumentacionit të ngarkuar në DST nuk ka dëshmuar se disponon staf mbështetës. Në kushte të tilla ky OE duhet të ishte s’kualifikuar. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Titulli IV Parimi i detyrimit të besnikërisë, neni 14, pika 1

Neni 16 *Abuzimi me detyrën dhe formën e shoqërisë*, neni 163, pika 1, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, Neni 46, “Kualifikimi i Ofertuesve”, Neni 53, “Shqyrtimi i Ofertave”, Pika 3 dhe Pika 5, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Neni 66, “Kualifikimi i ofertuesve” si dhe me Rregulloren e Përgjithshme të punës.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 52 – 90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1 Rekomandimi:** Nga ana e UKGJ SHA të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Është zbatuar plotësisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga natyra e këtij rekomandimi, verifikimi i zbatueshmërisë së tij do të kryhet në auditimin e radhës. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

## **MASA DISIPLINORE**

### **E.1. PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE**

*E.1.1 Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” si dhe neni 8 të Kontratës Individuale të Punës me nr. 839 prot., datë 21.08.2019 të lidhur mes Aksionarit të vetëm të Asamblesë së Përgjithshme z. F.G dhe Administratorit të UKGJ SHA, **i rekomandojmë Aksionarit**, vlerësimin e shkeljeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit me qëllim verifikimin e përmbushjeve ose jo të detyrave që burojnë nga neni 4 (Detyrimet e Administratorit) i kësaj kontrate dhe shkarkimin e tij në rast të konfirmimit të këtyre shkeljeve e konkretisht:*

Përdorimin pa EEE në shumën **49,662,348 lekë** si detyrim i UKGJ SHA ndaj FSHU SHA;

Dëmin ekonomik në shumën **8,678,862 lekë** si rrjedhojë e mosrespektimit të kushteve të kontratës nga OE dhe mungesës së kontrollit nga UKGJ SHA në tre kontrata;

Përdorimin pa efektivitet në shumën **5,656,992 lekë** në drejtim të strukturës organizative, dhënies së pagave dhe shpërblimeve si dhe zbatimin e ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna;

Përdorimin pa efektivitet në shumën 9,671,436 lekë si rrjedhojë e mosrespektimit të kuadrit përkatës ligjor e rregullator si dhe mungesës së kontrollit nga drejtimi i UKGJ SHA në dy procedura prokurimi;

Mangësi të ndryshme si më poshtë:

Në cilësinë e Titullarit të shoqërisë gjatë periudhës objekt auditimi nuk ka marrë masa efektive për zbatimin e të gjitha rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm si dhe për kthimin në afat të përgjigjes brenda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre rekomandimeve;

Në cilësinë e Titullarit të shoqërisë gjatë periudhës objekt auditimi nuk ka marrë masa efektive për analizimin e problematikave kryesore të UKGJ SHA në mbledhjet e Këshillit, për kontrollin e mbikëqyrjes së politikave tregtare të shoqërisë, mos nxjerrjen e konkluzioneve mbi mbarëvajtjen dhe funksionimin e shoqërisë për ta orientuar atë drejt në zgjidhjen e problematikave nëpërmjet përshejtimit të reformave të sektorit siç parashtrohet në VKM nr. 63, 27.01.2016 *“Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajnimin e ujërave të ndotura”*;

Në cilësinë e Titullarit të shoqërisë gjatë periudhës objekt auditimi nuk ka marrë masa efektive për të hartuar apo miratuar ndryshime të programeve ekonomiko-financiare, shoqëruar me relacione shpjeguese të faktorëve të paparashikuar të cilët për vitet 2019, 2020 dhe 2021 kanë çuar në tejkalim të investimeve dhe të disa zërave të shpenzimeve, krahasuar me programin e miratuar, nuk është bërë një analizë e detajuar të numrit të operatorëve që janë pajisur ose nuk janë pajisur me matës, mungon një analizë e detajuar mbi humbjet teknike ose ato ekonomike menaxheriale, mungon një analizë e detajuar mbi debitorët dhe gjendjen e likuidimit nga ana e tyre. Shoqëria nuk ka Programet Ekonomike Afatmesme PBA dhe Programe Ekonomike Afatgjata, mungon plani 5 vjeçar për përmirësimin e performancës dhe plani i biznesit, mungojnë raportimet mbi zbatimin e buxhetit për çdo tremujor në AKUK, pranë prefektit dhe pranë Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore;

Në cilësinë e Titullarit të shoqërisë gjatë periudhës objekt auditimi nuk ka marrë masa për krijimin e një strukture të qëndrueshme organizative duke bërë 3 herë ndryshime në vitin 2019, 24 herë ndryshime në vitin 2020 dhe 20 herë ndryshime në vitin 2021. Nga grupi i auditimit konstatohet se emërimet dhe lëvizjet e personeli për periudhën objekt auditimi janë kryer si më poshtë:

-Për vitin 2019: 172 emërimet, largime, pezullime, dorëheqje, ndryshime pozicioni dhe ndryshime page,

-Për vitin 2020: 197 emërimet, largime, pezullime, dorëheqje, ndryshime pozicioni dhe ndryshime page,

-Për vitin 2021: 199 emërimet, largime, pezullime, dorëheqje, ndryshime pozicioni dhe ndryshime page.

Numri i punonjësve është i pa miratuar dhe i pa programuar nga Këshilli i Administrimit,

-Niveli i pagave është diferencial dhe diskriminues dhe në përgjithësi nuk përkon me nivelin e arsimit përkatës,

-Struktura është e paqartë dhe e paorganizuar në kuptimin e drejtorive, specialistëve, punonjësve dhe varësia e punonjësve me eprorët përkatës nuk është e mirë përcaktuar;

-Në përgjithësi nuk shpallen e vendet vakante dhe nuk është dokumentuar në asnjë rast intervistimi apo testimi i kandidatëve;

- Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinore konstatohet se nuk ka procedura transparente, dhe nuk ka komision apelimi.

Ka paqartësi në strukturën organizative dhe lëvizjet e brendshme sjellin pasiguri dhe mos njohje të detyrave funksionale dhe ndikojnë në performancën e punonjësve të UKGJ SHA;



-Në hartimin e strukturës, Auditi i Brendshëm të Shoqërisë është përfshirë në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, duke mos garantuar një proces dhe veprimtari të pavarur nga pikëpamja funksionale, që garanton dhe vlerëson funksionimin e drejtimit financiar dhe sistemin e kontrollit të brendshëm. Aktualisht shoqëria nuk ka punonjës në këtë pozicion.

*(Masën për Titullarin ja rekomandojmë Aksionarit të UKGJ SHA, Titullarit të Bashkisë Gjirokastrë për shkeljet dhe mangësitë e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit pasi të analizojë materialin e paraqitur dhe të marrë vendimin përkatës, vendim ky të cilin KLSH do ta shqyrtojë në ardhmen)*

Pranueshmëria e rekomandimit: I pranuar

#### **Komenti i subjektit:**

**Komenti i audituesve:** Nga ana e ish Aksionarit Kryesor (në atë kohë Bashkia Gjirokastrë) dhe atij aktual (MIE) nuk është kryer vlerësimi i shkeljeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit me qëllim verifikimin e përmbushjeve ose jo të detyrave që burojnë nga neni 4 (Detyrimet e Administratorit) i kontratës dhe shkarkimin e tij në rast të konfirmimit të këtyre shkeljeve e konkretisht. Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet *I pranuar* por *I pazbatuar*.

**E.1.2** Mbështetur në nenet 37, 141 e 153, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, neni 9 i kontratave individuale të punës si dhe rregullores së brendshme të institucionit, **i rekomandojmë Administratorit të UKGJ SHA**, të marrë masat disiplinore si më poshtë:

“**Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna**”, për punonjësit e mëposhtëm:

Znj. Ç.D

- Për mangësitë e konstatuara gjatë auditimit të procedurave të prokurimit me objekt ‘*Materiale për mirëmbajtjen e rrjetit, viti 2019*’, ‘*Matës uji dhe rakorderi, viti 2019*’, ‘*Blerje kamionçine, viti 2020*’, ‘*Materiale hidraulike për mirëmbajtjen e rrjetit hidraulik, viti 2020*’ dhe ‘*Studim-Projektim i Ujësllësit, Fshati Golem , Gjirokastrë*’ në cilësinë e punonjësit të angazhuar si anëtar i NJP, hartuesi të specifikimeve teknike, anëtarit të KVO si dhe në lidhje argumentimin e shpenzimeve, verime këto me pasojë përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve në shumën **9,671,436 lekë me TVSH;**

Znj. M.Xh

- Për mangësitë e konstatuara gjatë auditimit të procedurave të prokurimit me objekt ‘*Blerje kamionçine, viti 2020*’, ‘*Materiale hidraulike për mirëmbajtjen e rrjetit hidraulik, viti 2020*’ dhe ‘*Studim-Projektim i Ujësllësit, Fshati Golem , Gjirokastrë*’ në cilësinë e punonjësit të angazhuar si anëtar i KVO, verime këto me pasojë përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve në shumën **4,917,156 lekë me TVSH;**

Z. A.K

- Për mangësitë e konstatuara gjatë auditimit të procedurave të prokurimit me objekt ‘*Blerje kamionçine, viti 2020*’, ‘*Materiale hidraulike për mirëmbajtjen e rrjetit hidraulik, viti 2020*’ dhe ‘*Studim-Projektim i Ujësllësit, Fshati Golem , Gjirokastrë*’ në cilësinë e punonjësit të angazhuar si anëtar i KVO, verime këto me pasojë përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve në shumën **4,917,156 lekë me TVSH;**

Z. B.Sh

- Për mangësitë e konstatuara gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt ‘*Blerje kamionçine, viti 2020*’ si dhe gjatë auditimit të zbatimit të kontratës me objekt ‘*Materiale*

*hidraulike për mirëmbajtjen e rrjetit hidraulik, viti 2019*' në cilësinë e anëtarit të grupit të marrjes në dorëzim të mallrave, verime këto me pasojë mos konfirmimin e përputhshmërisë me kushtet e kontratës (Kushtet e Veçanta të Kontratës dhe Specifikimet Teknike) për shumën prej **2,129,676 lekë me TVSH**, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik;

Z. F.Rr

- Për mangësitë e konstatuara gjatë auditimit të zbatimit të kontratës me objekt '*Materiale hidraulike për mirëmbajtjen e rrjetit hidraulik*' në cilësinë e anëtarit të grupit të marrjes në dorëzim të mallrave, verime këto me pasojë mos konfirmimin e përputhshmërisë me kushtet e kontratës (Kushtet e Veçanta të Kontratës dhe Specifikimet Teknike) për shumën prej **4,668,006 lekë me TVSH**, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik;

Z. E.I

- Për mangësitë e konstatuara gjatë auditimit të zbatimit të kontratës me objekt '*Materiale hidraulike për mirëmbajtjen e rrjetit hidraulik*' në cilësinë e anëtarit të grupit të marrjes në dorëzim të mallrave, verime këto me pasojë mos konfirmimin e përputhshmërisë me kushtet e kontratës (Kushtet e Veçanta të Kontratës dhe Specifikimet Teknike) për shumën prej **4,668,006 lekë me TVSH**, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik;

Z. K.L

- Për mangësitë e konstatuara gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt '*Blerje kamionçine, viti 2020*' në cilësinë e anëtarit të grupit të përlllogaritjes së fondit limit si dhe nga auditimi i zbatimit të kontratës me po të njëjtin në cilësinë e anëtarit të grupit të marrjes në dorëzim të mallrave, verime këto me pasojë mos konfirmimin e përputhshmërisë me kushtet e kontratës (Kushtet e Veçanta të Kontratës dhe Specifikimet Teknike) për shumën prej **1,881,180 lekë me TVSH**, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik;

Z. A.D

- Për mangësitë e konstatuara gjatë auditimit të zbatimit të kontratës me objekt '*Blerje kamionçine, viti 2020*' në cilësinë e anëtarit të grupit të marrjes në dorëzim të mallrave, verime këto me pasojë mos konfirmimin e përputhshmërisë me kushtet e kontratës (Kushtet e Veçanta të Kontratës dhe Specifikimet Teknike) për shumën prej **1,881,180 lekë me TVSH**, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik;

Z. F.M

- Për mangësitë e konstatuara gjatë auditimit të zbatimit të kontratës me objekt '*Blerje kamionçine, viti 2020*' në cilësinë e anëtarit të grupit të marrjes në dorëzim të mallrave, verime këto me pasojë mos konfirmimin e përputhshmërisë me kushtet e kontratës (Kushtet e Veçanta të Kontratës dhe Specifikimet Teknike) për shumën prej **1,881,180 lekë me TVSH**, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik;

Z. A.M

- Për mangësitë e konstatuara gjatë auditimit të zbatimit të kontratave me objekt '*Materiale hidraulike për mirëmbajtjen e rrjetit hidraulik, viti 2019*' dhe '*Matës uji dhe rakorderi, viti 2019*' në cilësinë e anëtarit të grupit të marrjes në dorëzim të mallrave, verime këto me pasojë mos konfirmimin e përputhshmërisë me kushtet e kontratës (Kushtet e Veçanta të Kontratës dhe Specifikimet Teknike) për shumën prej **2,255,676 lekë me TVSH**, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik;

Z. R.Ç

- Për mangësitë e konstatuara gjatë auditimit të zbatimit të kontratës me objekt '*Materiale hidraulike për mirëmbajtjen e rrjetit hidraulik, viti 2019*' në cilësinë e anëtarit të grupit të marrjes në dorëzim të mallrave, verime këto me pasojë mos konfirmimin e përputhshmërisë me kushtet e

kontratës (Kushtet e Veçanta të Kontratës dhe Specifikimet Teknike) për shumën prej **2,192,676 lekë me TVSH**, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik;

**“Vërejtje”**, për punonjësit e mëposhtëm:

Znj. D.A

- Për mangësitë e konstatuara gjatë auditimit të procedurave të prokurimit me objekt ‘*Materiale për mirëmbajtjen e rrjetit, viti 2019*’ dhe ‘*Matës uji dhe rakorderi, viti 2019*’ në cilësinë e personit të angazhuar si anëtar i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.

Znj. M.D

- Për mangësitë e konstatuara gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt ‘*Matës uji dhe rakorderi, viti 2019*’ në cilësinë e personit të angazhuar si anëtar i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave si dhe në procedurën me objekt ‘*Materiale hidraulike për mirëmbajtjen e rrjetit hidraulik*’ në cilësinë e anëtarit të NJP.

Pranueshmëria e rekomandimit: I pranuar

**Komenti i subjektit:** Nga ana e Titullarit të AK janë marrë masat për dhënien e masave disiplinore sipas atyre të rekomanduara.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, janë zbatuar të gjitha rekomandimet në lidhje me dhënien e masave disiplinore sipas atyre të rekomanduara. Për sa më sipër rekomandimet konsiderohen *Të pranuar* dhe *Të zbatuara*.

#### **IV KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

Në përfundim të procesit të auditimit, nga Ujësjetës Kanalizime SHA Gjirokastrë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën nr. 249/8 prot., datë 03.08.2022 (*administruar në subjekt me nr. 1201 prot., datë 15.08.2022*), konstatohet se 40.4 % e rekomandimeve janë zbatuar dhe nga ana e subjektit janë zbatuar pjesërisht dhe janë në proces zbatimi rekomandimet në lidhje me arkëtimin e dëmeve si dhe ato për përdorimin e fondeve me efektivitet, efizienz dhe ekonomikitet. Duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore, si më poshtë:

#### **MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga Auditimi:** (*Gjetja nr. 1 e Masave Organizative të Raportit Përfundimtar të Auditimit*) Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, rezulton se përmes shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 1420/8 port., datë 30.08.2019 dhe në Ujësjetës Kanalizime SHA Gjirokastrë me nr. 921 prot., datë 02.09.2019, janë rekomanduar gjithsej 70 masa, të pranuar këto në masën 100 %. Nga këto, rezulton se janë realizuar plotësisht 44 masa, janë realizuar pjesërisht 17 masa, është në proces zbatimi 1 masë dhe nuk janë zbatuar 8 masa. Situata e zbatueshmërisë së rekomandimeve të lëna paraqitet e detajuar sipas Aneksit nr. 2.1.1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e kontrollit të lartë të Shtetit*” neni 15. Gjithashtu, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve rezulton se nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të Raportit të Auditimit. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, neni 30, **Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre**, paragrafi 2.

**1.1 Rekomandimi:** Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori UKGJ SHA, të marrin masa të menjëhershme për rishikimin dhe zbatimin e të gjitha masave të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH. Gjithashtu, të rishikohen rekomandimet të cilat janë zbatuar pjesërisht si dhe të vijnë procedurat përkatëse për përfundimin e rekomandimeve të konsideruara në proces.

*Menjëherë*

**1.2 Rekomandimi:** Nga ana e UKGJ SHA të merren masa për raportimin në kohë dhe brenda afateve të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve.

*Në vijimësi*

## **MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga Auditimi:** (Gjetja nr. 1 e Masave Për Shpërblim Dëmi të Raportit Përfundimtar të Auditimit) Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se me Urdhrin e Administratorit nr. 1305 prot, datë 05.08.2020 “Marrje në punë jurist të jashtëm”, është punësuar jurist i jashtëm i përkohshëm, për ndjekjen e seancave gjyqësore me OSHEE SHA/FSHU SHA. Me shkresën nr. 1305/1 prot, datë 05.08.2020 është lidhur kontrata individuale e punës, e cila hyn menjëherë në fuqi, dhe pagesa përcaktohet në vlerën 25,000 lekë në muaj. Sa më sipër, referuar faktit se në strukturën e UKGJ SHA ka punonjës specialist jurist, dhe kjo çështje është humbur në Gjykatën e Apelin, vlera e pagesës së punonjësit nga UKGJ SHA, konsiderohet prej **300,000 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë UKGJ SHA**. Sa më sipër është në kundërshtim me Statutin e shoqërisë dhe VKM nr. 62, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, struktura e miratuar e shoqërisë, neni 18, pika 7, germa l.

**1.1 Rekomandimi:** Asambleja e Aksionareve dhe Administratori i shoqërisë UKGJ SHA të analizojnë **dëmin ekonomik** me vlerë **300,000 lekë**, shkaqet të cilat kanë sjellë këtë situatë dhe të marrin masa lidhur me përcaktimin e kriterëve të punësimit të punonjësve të përkohshëm, të jashtëm.

*Menjëherë*

## **MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKEDHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1. Gjetje nga Auditimi:** (Gjetja nr. 1 e Masave për Eliminimin e Efekteve Negative të Konstatuara në Administrimin e Fondeve Publike dhe për Menaxhimin me Ekonicitet, Eficiencë dhe Efektivitet të Fondeve Publike të Raportit Përfundimtar të Auditimit) Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontabilitetin, rezulton se UKGJ SHA është në proces gjyqësor për kontratat si dhe për çmimin e Stacionit të Pompimit Buduk. Shoqëria ka punësuar një jurist të jashtëm për ndjekjen e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët gjyqësore. Situata e procedurës gjyqësore të Shoqërisë UKGJ SHA, paraqitet si më poshtë:

Palë paditëse Shoqëria Aksionare UKGJ me objekt padie “Deklarimin e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv të faturave të energjisë elektrik, si më poshtë:

-Fatura nr. 304420478 (Buduk), në vlerën 40,235,520 lekë për periudhën 30.11.2018 - 31.12.2018, Fatura e Stacionit të Pompimit Picar m, nr. 304419229, në vlerën 208,588 lekë për periudhën 30.11.2018 - 31.12.2018,

-Fatura e Stacionit Pulari Lazarat me nr. 304418205, në vlerën 201,835.20 lekë për periudhën 28.11.2018 - 31.12.2018,

- Fatura e Stacionit të Pompimit Golem, me nr. 304419314, në vlerën 622,579.20 lekë për periudhën 30.11.2018 - 31.12.2018,
- Fatura e Stacionit të Pompimit Lazarat Qendër, me nr. 304419254, në vlerën 384,384 lekë,
- Fatura e Stacionit të Pompimit Lazarat Qendër, me nr. 304419654, në vlerën 45,696 lekë, për periudhën 27.11.2018 - 27.12.2018.
- Vendimi civil i **Gjykatë të Shkallës së Parë Gjirokastër**, me nr. 21-2019-2272/624, datë 05.12.2019, paraqitet si më poshtë
- Pranimi i pjesshëm i padisë,
- Konstatimin e pavlefshmërisë të titullit ekzekutiv të faturës të energjisë elektrike me nr. 304420478 për muajin Dhjetor 2018,
- Konstatimin e pavlefshmërisë të titullit ekzekutiv të faturës të energjisë elektrike me nr. 304418205 për muajin Dhjetor 2018,
- Konstatimin e pavlefshmërisë të titullit ekzekutiv të faturës të energjisë elektrike me nr. 304419314 për muajin Dhjetor 2018,
- Konstatimin e pavlefshmërisë të titullit ekzekutiv të faturës të energjisë elektrike me nr. 304419229 për muajin Dhjetor 2018,
- Konstatimin e pavlefshmërisë të titullit ekzekutiv të faturës të energjisë elektrike me nr. 304419654 për muajin Dhjetor 2018,
- Konstatimin e pavlefshmërisë të titullit ekzekutiv të faturës të energjisë elektrike me nr. 304419254, për shumën 5,222.4 lekë, si dhe përlllogaritjen mes sasisë së energjisë elektrike të harxhuar më tepër mbi çmimin 12.4 lekë/kwh, të llogaritur në këtë faturë,
- Rrëzimin për pjesën tjetër të padisë.

**Gjykata e Apelit Gjirokastër** me vendimi civil nr. 20-2021-418/159, datë 07.05.2021, ka përcaktuar:

- Rrëzimin e vendimit nr. 21-2019-2272/624, datë 05.12.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe pushimin e gjykimit për padinë me objekt konstatimin e pavlefshmërisë të titujve ekzekutiv fatura tatimore shitje për kontratat me emërtim: Buduk, Lazarat Qendër (Pularia), Ujësjiellës Golem, Picar, Lazarat Qendër dhe Fushë Kordhocë.
- Ndryshimin e këtij vendimi sa i përket kërimit për kundërshtimin e çmimit të aplikuar në faturat objekt kundërshtimi.
- Lënien në fuqi për pjesën e rrëzuar dhe atë të shpenzimeve gjyqësore.
- Sa më sipër detyrimi i lindur nga mos pagesa e faturave të energjisë elektrike ndaj FSHU SHA deri në periudhën objekt auditimi, ka arritur në vlerën **46,979,553** lekë dhe kamatëvonesat e këtij detyrimi në vlerën **49,662,348** lekë detyrim ky i cili përbën **përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve të buxhetit të shtetit dhe të vet UKGJ SHA**. Sa më sipër është në kundërshtim me Statutin e shoqërisë dhe VKM nr. 62, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 48 – 51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Asambleja e Aksionareve dhe Administratori i shoqërisë UKGJ SHA të analizojnë situatën e mësipërme mbi përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve në shumën prej **49,662,348 lekë** me qëllim identifikimin e shkaqeve konkrete të cilat kanë sjellë këtë situatë dhe të njëkohësisht të merren masa emergjente për likuidimin e këtyre detyrimeve.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga Auditimi:** (Gjetja nr. 2 e Masave për Eliminimin e Efekteve Negative të Konstatuara në Administrimin e Fondeve Publike dhe për Menaxhimin me Ekonomicitet, Eficiencë dhe Efektivitet të Fondeve Publike të Raportit Përfundimtar të Auditimit) Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me pagat, ligjshmërinë e rekrutimeve, strukturën organizative etj., rezulton se orët shtesë të punës janë orë pune të cilat kryhen në rastet e emergjencave të ndryshme të paparashikuara, si p.sh.: avari në rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm ose në rrjetin e kanalizimeve, në rastet e përmbytjeve ose të disa rrethanave/avarive të natyrave të ndryshme. Kryerja e orëve shtesë justifikohet me anë të një procesverbali që nënshkruhet nga drejtuesi i sektorit përkatës dhe nga punonjësi. Duke u bazuar të relacionet e procesverbaleve, Administratori i UKGJ SHA, vendos për kompensimin e orëve shtesë të kryera ose ditë pushimi. Pas nënshkrimit nga Administratori procesverbali depozitohet në degën e financës. Llogaritja e orëve jashtë orarit të punës bëhet me masën 100 % të pagës orare ditore duke u llogaritur mbi pagën bazë sipas vendit të punës, dhe llogaritja është e njëjtë edhe në ditë feste. Konkretisht të dhënat në lidhje me orët jashtë orarit jepen sipas tabelës së mëposhtme:

UKGJ SHA	Orë jashtë orari	Vlera ALL
Periudha	Ditë Normale	Ditë Normale
Viti 2019	2,558	618,718
Viti 2020	3,614	884,294
Viti 2021	1,361	365,630
Totali	7,533	1,868,642

Vlera **1,868,642 lekë** konsiderohet **përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve të buxhetit të shtetit dhe të vet UKGJ SHA**. Sa më sipër është në kundërshtim me Kodin e Punës, neni 87, pika 1 dhe 2.

**2.1 Rekomandimi:** Nga Administratori i Shoqërisë dhe Sektori i Financës, të merren masa për analizimin e vlerës prej **1,868,642 lekë si përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve**, si dhe të merren masa për përcaktimin në rregulloren e shoqërisë të masës në të cilën duhet të kryhen pagesat për orët shtesë mbi kohën normale të punës.

*Menjëherë*

**3. Gjetje nga Auditimi:** (Gjetja nr. 3 e Masave për Eliminimin e Efekteve Negative të Konstatuara në Administrimin e Fondeve Publike dhe për Menaxhimin me Ekonomicitet, Eficiencë dhe Efektivitet të Fondeve Publike të Raportit Përfundimtar të Auditimit) Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me pagat, ligjshmërinë e rekrutimeve, strukturën organizative etj., rezulton se në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 4 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **3,788,350 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbartimore. Për periudhën objekt auditimi, janë në gjykim 3 çështje gjyqësore në Gjykatën e Apelit Gjyrokastër, të cilat në Gjykatën e Shkallës të Parë Gjyrokastër janë humbur nga UKGJ SHA në vlerën **374,852 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbartimore. Në total për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera **3,788,350 lekë** e cila konsiderohet **përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve të buxhetit të shtetit dhe të vet UKGJ SHA**. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 136/2015, datë 05.12.2015.

**3.1 Rekomandimi:** Nga Administratori, sektori Juridik dhe Burimet Njerëzore të UKGJ SHA, të merren masa për analizimin e vlerës prej **3,788,350 lekë**, si **përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve të buxhetit të shtetit dhe të vet UKGJ SHA** dhe për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të shkëputjes të marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **MASA DISIPLINORE**

### **D.1. PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE**

*D.1.1 Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” si dhe nenit 8 të Kontratës Individuale të Punës me nr. 839 prot., datë 21.08.2019 të lidhur mes Aksionarit të vetëm të Asamblesë së Përgjithshme z. F.G dhe Administratorit të UKGJ SHA, i rekomandojmë Aksionarit (aktualisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë), vlerësimin e shkeljeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit me qëllim verifikimin e përmbushjeve ose jo të detyrave që burojnë nga neni 4 (Detyrimet e Administratorit) i kësaj kontrate dhe shkarkimin e tij në rast të konfirmimit të këtyre shkeljeve e konkretisht:*

Përdorimin pa EEE në shumën **49,662,348 lekë** si detyrim i UKGJ SHA ndaj FSHU SHA;

Dëmin ekonomik në shumën **8,678,862 lekë** si rrjedhojë e mosrespektimit të kushteve të kontratës nga OE dhe mungesës së kontrollit nga UKGJ SHA në tre kontrata;

Përdorimin pa efektivitet në shumën **5,656,992 lekë** në drejtim të strukturës organizative, dhënies së pagave dhe shpërblimeve si dhe zbatimin e ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna;

Përdorimin pa efektivitet në shumën **9,671,436 lekë** si rrjedhojë e mosrespektimit të kuadrit përkatës ligjor e rregullator si dhe mungesës së kontrollit nga drejtimi i UKGJ SHA në dy procedura prokurimi;

Mangësi të ndryshme si më poshtë:

Në cilësinë e Titullarit të shoqërisë gjatë periudhës objekt auditimi nuk ka marrë masa efektive për zbatimin e të gjitha rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm si dhe për kthimin në afat të përgjigjes brenda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre rekomandimeve;

Në cilësinë e Titullarit të shoqërisë gjatë periudhës objekt auditimi nuk ka marrë masa efektive për analizimin e problematikave kryesore të UKGJ SHA në mbledhjet e Këshillit, për kontrollin e mbikëqyrjes së politikave tregtare të shoqërisë, mos nxjerrjen e konkluzioneve mbi mbarëvajtjen dhe funksionimin e shoqërisë për ta orientuar atë drejt në zgjidhjen e problematikave nëpërmjet përsheptimit të reformave të sektorit siç parashtrohet në VKM nr. 63, 27.01.2016 “Përrriorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajnimin e ujërave të ndotura”;

Në cilësinë e Titullarit të shoqërisë gjatë periudhës objekt auditimi nuk ka marrë masa efektive për të hartuar apo miratuar ndryshime të programeve ekonomiko-financiare, shoqëruar me relacione shpjeguese të faktorëve të paparashikuar të cilët për vitet 2019, 2020 dhe 2021 kanë çuar në tejkalim të investimeve dhe të disa zërave të shpenzimeve, krahasuar me programin e miratuar, nuk është bërë një analizë e detajuar të numrit të operatorëve që janë pajisur ose nuk janë pajisur me matës, mungon një analizë e detajuar mbi humbjet teknike ose ato ekonomike menaxheriale, mungon një analizë e detajuar mbi debitorët dhe gjendjen e likuidimit nga ana e tyre. Shoqëria nuk ka Programet Ekonomike Afatmesme PBA dhe Programe Ekonomike Afatgjata, mungon plani 5 vjeçar për përmirësimin e performancës dhe plani i biznesit, mungojnë raportimet mbi zbatimin e

buxhetit për çdo tremujor në AKUK, pranë prefektit dhe pranë Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore;

Në cilësinë e Titullarit të shoqërisë gjatë periudhës objekt auditimi nuk ka marrë masa për krijimin e një strukture të qëndrueshme organizative duke bërë 3 herë ndryshime në vitin 2019, 24 herë ndryshime në vitin 2020 dhe 20 herë ndryshime në vitin 2021. Nga grupi i auditimit konstatohet se emërimet dhe lëvizjet personeli për periudhën objekt auditimi janë kryer si më poshtë:

-Për vitin 2019: 172 emërimet, largimet, pezullimet, dorëheqjet, ndryshimet pozicioni dhe ndryshimet page,

-Për vitin 2020: 197 emërimet, largimet, pezullimet, dorëheqjet, ndryshimet pozicioni dhe ndryshimet page,

-Për vitin 2021: 199 emërimet, largimet, pezullimet, dorëheqjet, ndryshimet pozicioni dhe ndryshimet page.

Numri i punonjësve është i pa miratuar dhe i pa programuar nga Këshilli i Administrimit,

-Niveli i pagave është diferencial dhe diskriminues dhe në përgjithësi nuk përkon me nivelin e arsimit përkatës,

-Struktura është e paqartë dhe e paorganizuar në kuptimin e drejtorive, specialistëve, punonjësve dhe varësia e punonjësve me eprorët përkatës nuk është e mirë përcaktuar;

-Në përgjithësi nuk shpallen e vendet vakante dhe nuk është dokumentuar në asnjë rast intervistimi apo testimi i kandidatëve;

- Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinore konstatohet se nuk ka procedura transparente, dhe nuk ka komision apelimi.

Ka paqartësi në strukturën organizative dhe lëvizjet e brendshme sjellin pasiguri dhe mos njohje të detyrave funksionale dhe ndikojnë në performancën punonjësve të UKGJ SHA;

-Në hartimin e strukturës, Auditimi i Brendshëm të Shoqërisë është përfshirë në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, duke mos garantuar një proces dhe veprimtari të pavarur nga pikëpamja funksionale, që garanton dhe vlerëson funksionimin e drejtimit financiar dhe sistemin e kontrollit të brendshëm. Aktualisht shoqëria nuk ka punonjës në këtë pozicion.

*(Masën për Titullarin ja rekomandojmë Aksionarit të UKGJ SHA, aktualisht **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë** për shkeljet dhe mangësitë e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit pasi të analizojë materialin e paraqitur dhe të marrë vendimin përkatës, vendim ky të cilin KLSH do ta shqyrtojë në ardhmen)*

***Në lidhje me masat e konstatuara në proces zbatimi, nga ana e subjektit të audituar Ujësjetës Kanalizime SHA, Gjrokastër të vijojnë përpjekjet duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore deri në zbatimin e plotë të tyre.***

**Shënim 1:** *Të gjithë punonjësit që atakohen në këtë projekt raport auditimi duhet tu bëhen prezent mangësitë dhe problemet për të cilat mbajnë përgjegjësi, mundësisht tu jepen fotokopje të dokumentacionit që ka lidhje me ta, në mënyrë që të njihen dhe të bëjnë komentet dhe shpjegimet përkatëse, nëse kanë.*

**Shënim 2:** *Ky material të përcillet edhe Aksionarit Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.*



### 3.12. Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve

#### PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në Agjencinë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve dhe të Infrastrukturës së Mbetjeve mbi “*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022*” për auditimin e kryer në vitin 2022, për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2021 paraqitur me shkresën e administruar në KLSH me nr. 888/14 prot., datë 27.04.2022 (*administruar në subjekt me nr. 71/2 prot., datë 04.05.2022*), duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH<sup>së</sup> të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2022, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:
  - a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
  - b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
  - c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, eficiency dhe ekonomicitet të fondeve;
  - ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në subjekt u mbajt Akt Verifikimi nr. 1, datë 08.09.2023, administruar në Zyrën e AKUM me nr. 1492/1 prot, datë 08.09.2023, për të cilin nuk është paraqitur observacion nga ana e subjektit. Pas dërgimit të Projektraportit të Auditimit, nga ana e subjektit janë paraqitur observacionet të cilat janë trajtuar përgjatë materialit.

#### Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

#### **I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.**

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, AKUM *ka respektuar* këtë afat duke kthyer përgjigje sipas shkresës së administruar në AKUM me nr. 998 prot., datë 23.05.2022.

#### **II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.**

-Nga ana e subjektit të audituar *nuk janë marrë masa* për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas parashikimeve në Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*”,

#### **III. Rekomandimet e KLSH**

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 888/14 port., datë 27.04.2022 dhe në AKUM me nr. 71/2 prot., datë 04.05.2022, janë rekomanduar gjithsej:

- a. Janë rekomanduar **20 masa organizative**;
- b. Janë rekomanduar **3 masa për shpërblim dëmi në vlerën 22,965,731 lekë**;

c. Janë rekomanduar **4 masa për përdorimin me shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit në shumën 155,059,641 lekë;**

b. Janë rekomanduar **3 masa administrative;**

b. Janë rekomanduar **12 masa disiplinore;**

#### **IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH**

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 888/14 port., datë 27.04.2022 dhe në AKUM me nr. 71/2 prot., datë 04.05.2022, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si me poshtë:

<b>Nr.</b>	<b>Lloji i rekomandimit</b>	<b>Rekomanduar</b>	<b>Pranuar</b>	<b>Pa pranuar</b>
1	Organizative	20 masa	20	-
2	Shpërblim dëmi	3 masa 22,965,731 lekë	3 masa 22,965,731 lekë	-
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	4 masa 155,059,641 lekë	4 masa 155,059,641 lekë	-
4	Masa Administrative	3 masa	3 masa	-
5	Masa Disiplinore	12 masa	12 masa	-

#### **V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit**

Në mënyrë të përmblodhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

<b>Nr.</b>	<b>Lloji i rekomandimit</b>	<b>Pranuar</b>	<b>Statusi i zbatimit</b>			
			<b>Zbatuar plotësisht</b>	<b>Zbatuar pjesërisht</b>	<b>Në zbatim proces</b>	<b>Pa zbatuar</b>
1	Organizative	20 masa	10	1	9	-
2	Shpërblim dëmi	3 masa 22,965,731 lekë	2 masa 12,085,473 lekë	-	1 masë 10,880,258 lekë	-
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	4 masa 155,059,641 lekë	2 masa 26,745,180 lekë	-	2 masa 128,314,461 lekë	-
4	Masa Administrative	3 masa	-	-	-	3
5	Masa Disiplinore	12 masa	-	-	11	1

#### **I/1 HYRJA**

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 702/1, prot., datë 04.08.2023, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. A.L, (Përgjegjës grupi)
2. J.H.

## I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 888/14 prot., datë 27.04.2022 (administruar në AKUM me nr. 71/2 prot., datë 04.05.2022), së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

## I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

## I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

## I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe të Infrastrukturës së Mbetjeve, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 888/14 prot., datë 27.04.2022 (administruar në AKUM me nr. 71/2 prot., datë 04.05.2022), rezulton se nga **42** masa të rekomanduara (organizative, shpërblim dëmi dhe 3-E, Disiplinore), janë pranuar nga subjekti **42** masa ose 100 %. **Nga të pranuarat (42):** janë zbatuar plotësisht **14**, ose 33.3 % e tyre, është zbatuar pjesërisht **1** masë ose 2.4 %, janë në proces zbatimi **23** masa ose 54.7 % dhe nuk janë zbatuar **4** masa ose 9.5 %.

Nga sa shikohet niveli i realizimit është në masën 33.3 %, gjë e cila tregon se Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe të Infrastrukturës së Mbetjeve nuk e ka vlerësuar plotësisht procesin e zbatimit të rekomandimeve.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	20 masa	10	1	9	-
2	Shpërblim dëmi	3 masa 22,965,731 lekë	2 masa 12,085,473 lekë	-	1 masë 10,880,258 lekë	-
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	4 masa 155,059,641 lekë	2 masa 26,745,180 lekë	-	2 masa 128,314,461 lekë	-
4	Masa Administrative	3 masa	-	-	-	3
5	Masa Disiplinore	12 masa	-	-	11	1
<b>SHUMA</b>		<b>42</b>	<b>14</b>	<b>1</b>	<b>23</b>	<b>4</b>

## II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 33.3 % kurse ai i atyre në proces ose të zbatuara pjesërisht është 57.1 %, nivele këto të cila tregojnë mos vlerësimin plotësisht të këtij procesi në lidhje me ndjekjen e procedurave të duhura për zbatimin e rekomandimeve.

### **III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM**

**III/1-Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.**

*-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, AKUM ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr. 998 prot., datë 23.05.2022.*

**III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.**

*-Nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”,*

**III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:**

### **B. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt ‘Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë’, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE V.H & B. & E., të përfaqësuar këta sipas prokurës së posaçme me nr. 8315 rep. 4040 kol. Datë 13.07.2019 nga OE V.H me nr. licence për zbatim punimesh NZ.3930/18 datë 06.12.2018 me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. A.B me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019 me vlerë 462,629,496 lekë me TVSH dhe me afat të zbatimit të punimeve 12 muaj. Sipas shkresës së administruar në subjekt me nr. 703 prot., datë 26.03.2021, është bërë një kërkesë nga ana e zv. Drejtorit të Përgjithshëm drejtuar Ujësjetës Kanalizime SHA Vlorë, për caktimin e një inxhinieri me licencën përkatëse për të qenë pjesë e grupit të kolaudimit të punimeve të përfunduara. Kësaj kërkesë, Ujësjetës Kanalizime SHA Vlorë, i ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 830/1 prot., datë 11.05.2021, administruar në AKUM me nr. 703/1 prot., datë 14.05.2021 sipas të cilës ka caktuar inxhinierin përkatës. Grupi i kolaudimit është caktuar sipas Urdhrit nr. 1136 prot., datë 31.05.2021 të Zv. Drejtorit të Përgjithshëm. Në fakt ky urdhër është nxjerrë pas 3.5 muajsh dhe jo pas 30 ditësh nga përfundimi i punimeve dhe përveç kësaj, ky urdhër as nuk ka përcaktuar afatin e zgjatjes së procesit të kolaudimit. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 12, Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, Kreu II, pika 2 si dhe me Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, pika 10.1, paragrafi i dytë.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 74-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**1.1 Rekomandimi:** Nga AKUM në të ardhmen të merren masat për caktimin e kolaudatorit ose grupit të kolaudimit në afatet e duhura ligjore me qëllim realizimin e objektit të investimit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** *Sipas deklaratave të bëra nga ana e punonjësve të AKUM grupet e kolaudimit janë ngritur në afatet e duhura konform kuadrit ligjor e rregullator.*

**Komenti i audituesve:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht:

Akt Kolaudimi Nr. 2374 Prot 14/11/2022;

Akt-Marrje në Administrim dhe shfrytëzim paraprak datë 14/11/2022 nga UKV SHA;

Shkresë nr. 2402 prot. datë 17.11.2022 dërguar nga AKUM për UKV SHA (Përfituesit) me te cilën është përcjelle akt marrje ne administrim dhe shfrytëzim paraprak i objektit.

Si dhe deklaratave të stafit të AKUM ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi* megjithatë konfirmimi i tij do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**2. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt *‘Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë’*, rezulton se në zbatim të Urdhrit nr. 69, datë 07.10.2021, *“Për monitorimin e situacionit përfundimtar nr. 6 dhe fondit rezervë”*, grupi i punës ka hartuar një shkresë drejtuar Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse ku vë në dijeni edhe Titullarin z. C.K mbi faktin se në stacionin 102/1 ku mblidhen prurjet e të gjitha stacioneve të tjera, pompat e reja të vendosura me investimin e realizuar nga sipërmarrësi BOE V.H & B. & E., ishin nxjerrë jashtë stacionit të pompimit dhe ishin çmontuar nga UK Vlorë me argumentin se në reshjet e fundit në qytetin e Vlorës këto pompa nuk arrinin të përçonin prurjen maksimale duke shkaktuar përmbytje.

Kjo ndërhyrje ka konsistuar në zëvendësimin e pompave të reja me kapacitet  $Q=225$  l/s,  $H=9.83$  m, 26.8 KW me pompat e vjetra, pra me pompat ekzistuese përpara kryerjes së investimit. Sipas pretendimeve të sipërmarrësit, rezulton se gjatë heqjes së pompave, ato nuk janë ngritur me zinxhirët e ankorimit që janë lënë në çdo pompë në rast avarie dhe nuk janë hequr tubat udhëzues dhe për pasojë janë dëmtuar dhe shkëputur nga pjesa e murit të stacionit tubat udhëzuar për sescilën pompë.

Nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, e përfaqësuar nga ish – Drejtori i Përgjithshëm z. C.K, sipërmarrësi i punimeve BOE V.H & B. & E. si dhe mbikëqyrësi i punimeve BOE D & H nuk janë marrë masat e duhura për evidentimin e saktë dhe në kohë të mangësive dhe shkaqeve prej të cilave ka ardhur mungesa e funksionimit të pompave e duke lejuar marrjen në dorëzim nga ana e Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA, kur në fakt ky institucion (UKV SHA) nuk është në rolin e Investitorit dhe kjo aq më tepër për një punë e cila nuk i është nënshtruar procesit të kolaudimit. Aktualisht objekti ende nuk është kolauduar nga ana e Grupit të Punës.

Mungesa e vendimmarrjes nga ana e Titullarit në lidhje me ndryshimin e gjendjes, ka ndikuar në procesin e marrjes në dorëzim të punimeve, duke u bërë shkak për mos evidentimin në kohë të mangësive të zbatimit dhe më pas në ndarjen e përgjegjësive në rast të identifikimit të tyre. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*, Kreu II, pika 10.2, Urdhrit nr. 1136 prot., datë 31.05.2021, ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar, neni 12,

Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 74-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**2.1 Rekomandimi:** Nga ana e AKUM të merren masa që nga personat kryesorë përgjegjës për ndërtimin e objektit, konkretisht investitori Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, sipërmarrësit si dhe mbikëqyrësit e punimeve të evidentohen saktë dhe në kohë mangësitë dhe shkaqet prej nga rezultojnë këto mangësi.

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** *Nga ana e Titullarit të AKUM me shkresën nr. 2116/1 prot., datë 04.10.2022 është zëvendësuar grupi i mëparshëm i kolaudimit me argumentin e mos përmbushjes së detyrave të ngarkuara nga ana e ish Titullarit për kolaudimin e punimeve.*

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion (shkresa me nr. 2116/1 prot., datë 04.10.2022, ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *I zbatuar*.

**2.2 Rekomandimi:** Nga ana e AKUM të merren masa që nga personat kryesorë përgjegjës për ndërtimin e objektit, konkretisht investitori Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, sipërmarrësit si dhe mbikëqyrësit e punimeve të ndiqen procedurat e marrjes pjesore në dorëzim të punimeve vetëm pas nënshkrimit të procesverbalit të kolaudimit.

**Menjëherë**

**Komenti i subjektit:** *Sipas deklaratave nga punonjësit e AKUM, janë marrë masat dhe është nënshkruar proces-verbali mes palëve AKUM, Sipërmarrës, Mbikëqyrës, sh.a. U.K Vlorë në terren, janë bërë riparimet dhe defektet e objektit dhe aktualisht objekti është i kolauduar me Akt kolaudimi nr. 2374 prot., datë 14.11.2022.*

**Komenti i audituesve:** Referuar shkresave me nr. 2374 prot., datë 14.11.2022 (akti i kolaudimit) dhe asaj me nr. 2402 prot., datë 17.11.2022 (akti i marrjes në dorëzim) i është dërguar përfituesit (UK Vlorë) proces verbali i marrjes në dorëzim të përkohshëm të objektit bashkë me dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *I zbatuar*.

**3. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt ‘Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit’, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE L & B & A K & B, të përfaqësuar këta sipas prokurës së posaçme me nr. 454 rep. 1344 kol. datë 13.08.2019 nga OE L me nr. licence për zbatim punimesh NZ. 3386/7 me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. A.B me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019 me vlerë 320,833,499.7 lekë me TVSH dhe me afat të zbatimit të punimeve 12 muaj. Në lidhje me zbatimin e punimeve Grupi i Auditimit kreu verifikim në terren në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve. Sipas lejes së miratuar me Vendimin nr. 985/7, datë 17.03.2020, është parashikuar në pikën 10 të saj se zhvilluesi do të duhej të depozitonte mbetjet ndërtimore në Jug të fshatit Vidhas, Nj.A. Papër nën juridiksionin e Bashkisë Elbasan. Leja e miratuar me Vendimin nr. 985/7, datë 17.03.2020, në pikën 10 të saj ka cituar se vendi depozitimit i materialeve do të jetë ai i caktuar sipas Vendimit nr. 66, datë 23.05.2019 të Këshillit të Bashkisë Elbasan. Ky Vendim administrohet në Bashkinë

Elbasan me nr. 3862/1 prot., datë 29.05.2019 dhe në Prefekturën e Qarkut Elbasan me nr. 823 prot., datë 29.05.2019 dhe është marrë ndër të tjera në bazë të:

- Ligjit nr. 10431 datë 09.06.2011 'Për mbrojtjen e mjedisit';
- Ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 'Për menaxhimin e integruar të mbetjeve'
- VKM nr. 575 datë 24.06.2015 'Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte', pika 15, 17, gerrat a,b,c, ç;
- VKM nr. 389 datë 27.06.2018 'Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 452 datë 11.07.2012 të Këshillit të Ministrave 'Për landfillet e mbetjeve''.

Në kuptimit të ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 'Për menaxhimin e integruar të mbetjeve', pika 52 dhe VKM nr. 575 datë 24.06.2015 'Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte', pika 4, paragrafi i dytë, sipërmarrësi i punimeve në rastin në fjalë është Zotëruesi i mbetjeve inerte. Sipas këtij kuadri ligjor "Zotëruesi i mbetjeve inerte", është personi fizik ose juridik, i cili, gjatë aktivitetit të tij të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objekteve, prodhon, transporton ose trajton mbetje inerte të cilat janë të renditura në kapitullin 17, të Vendimit nr. 99, datë 18.2.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve", të ndryshuar dhe/ose krijuesi i mbetjeve ose çdo person që zotëron mbetje. Në vijim në pikën 15 të VKM nr. 575 datë 24.06.2015 'Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte' citohet se: Zotëruesit e mbetjeve inerte janë të detyruar të dorëzojnë mbetjet inerte në vend depozitimitin e përkohshëm ose lëndfillet e trajtimit të mbetjeve inerte, kundrejt tarifës për ton/mbetje, të propozuar nga operatori dhe të miratuar nga njësitë e qeverisjes vendore. Nga auditimi nuk rezulton asnjë provë dokumentare për të konfirmuar se nga ana e sipërmarrësit të punimeve janë kryer këto pagesa për ton/mbetje sipas tarifës së miratuar nga ana e Bashkisë Elbasan si dhe asnjë marrëveshje me operatorë të pajisur me leje mjedisore, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, dhe me licencë të tipit III.2.B, sipas Vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta". Gjithashtu, nuk rezulton asnjë dokument i plotësuar dhe i nënshkruar mbi transferimin e këtyre mbetjeve me qëllim regjistrimin e tyre në Regjistrin e Transfertave Individuale, sipas vendimit nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme". Në kushte të tilla nga ana e sipërmarrësit të punimeve nuk janë respektuar drejt pikat 4, 5 dhe 6, të VKM nr. 575 datë 24.06.2015 në vend depozitimitin e përkohshëm të përcaktuar nga NJQV-ja. Sipas dokumentacionit fotografik dhe argumenteve nga subjekti i audituar, rezulton se nga ana e sipërmarrësit të punimeve nuk janë kryer procese pune për depozitimin e materialit të dalë nga gërmimet por vetëm transporti i këtyre materialeve dhe shkarkimi i tyre (edhe nëse ka ndodhur nuk konfirmohet sasia). Edhe pse ky veprim rezulton të jetë kryer në kundërshtim me pikat e cituara në pikën 3 si më sipër përsëri nuk konfirmohet kryerja e proceseve të punës për depozitimin, e cila edhe nëse do të ishte rasti nuk është detyrë e firmës sipërmarrëse.

Nëse do ti referohemi analizës së bërë nga ana e Projektuesit në lidhje me depozitimin, do të konstatohet se nën këtë zë janë parashikuar si më poshtë:

Sp + p - 3.19 o.p x 125 lekë/o.p = 398.8 lekë/m<sup>3</sup> + Sig. Shoqërore 67 lekë/m<sup>3</sup> = 465 lekë/m<sup>3</sup>;

Ekskavator me kove 0.25 m<sup>3</sup> - 0.1 o.p x 2,800 lekë = 280 lekë/m<sup>3</sup>;

Shpenzime plotësuese 8 % x 745 lekë/ m<sup>3</sup> = 60 lekë/m<sup>3</sup>;

Fitimi 10 % x 745 lekë/m<sup>3</sup> = 74.5 lekë/m<sup>3</sup>;

**TOTALI = 880 lekë/m<sup>3</sup>**

Në këto kushte, nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion arrihet në konkluzionin se nuk konfirmohet kryerja e depozitimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 10431 datë 09.06.2011 ‘Për mbrojtjen e mjedisit’, Ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 ‘Për menaxhimin e integruar të mbetjeve’ VKM nr. 575 datë 24.06.2015 ‘Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte’, VKM nr. 389 datë 27.06.2018 ‘Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 452 datë 11.07.2012 të Këshillit të Ministrave ‘Për landfillet e mbetjeve’ dhe as kryerja e zërit sipas parashikimeve të projektuesit.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 74-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**3.1 Rekomandimi:** Nga ana e AKUM, në cilësinë e Zhvilluesit të Lejes së Ndërtimit nr. 985/10 prot., datë 04.06.2020, miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Elbasan nr. 985/7, datë 17.03.2020, ti kërkohet Bashkisë Elbasan, ndjekja e të gjitha procedurave të nevojshme administrative në të gjitha shkallët e gjykimit, konfiskimi i garancisë financiare në masën 4 % të preventivit, ose shumës **12,833,340 lekë** për shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit, nga ana e subjektit ndërtues shoqërisë BOE L & B & A K & B me të cilin është lidhur kontrata përkatëse e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019 me objekt ‘Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit’.

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: Lpranuar

**Komenti i subjektit:** *Me shkresën me nr. 618 prot., datë 07.04.2022 dhe shkresën me nr. 2345 prot., datë 07.11.2022 rezulton se nga ana e Titullarit janë ngritur përkatësisht grupi i punës për monitorimin e përfundimit të punimeve dhe një grup pune për të monitoruar rekomandimet e lëna nga KLSH. Në vijim të këtyre Urdhrave, nga punonjësit e ngarkuar janë kryer inspektimet përkatëse në përfundim të të cilave komisionet kanë hartuar relacionet. Komisioni i ngritur me Urdhër nr. 2345 prot., datë 07.11.2022 me përbërje të tij z. A.K, znj. A.Xh dhe z. G.Ll, me Memon e datës 28.12.2022 ka sugjeruar fillimin e procedurave të kolaudit. Me shkresën nr. 2542 prot., datë 09.12.2022 BOE L & B & A K & B, ka dorëzuar pranë AK-së Njoftim për përfundim punimesh duke theksuar faktin se punimet, me përjashtim të zërit Montim Pompash kanë përfunduar në 15.03.2022 (shkresa me nr. 516 prot., datë 23.03.2022) dhe në njoftimin e kësaj date (28.12.2022) ka përfunduar edhe montimi i pompave pas ndërtimit të godinës së re.*

**4. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratën me objekt ‘Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit’, rezulton se në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE L & B & A K & B, të përfaqësuar këta sipas prokurës së posaçme me nr. 454 rep. 1344 kol. datë 13.08.2019 nga OE L me nr. licence për zbatim punimesh NZ. 3386/7 me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. A.B me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019 me vlerë 320,833,499.7 lekë me TVSH dhe me afat të zbatimit të punimeve 12 muaj. Nga auditimi rezulton se projekt-preventivi i hartuar nga ana e projektuesit janë përfshirë në preventiv e njëkohësisht edhe në ofertën e paraqitur nga sipërmarrësi i punimeve BOE L & B & A K & B zëra për kryerjen e testeve të linjave të shtruara. Në fakt referuar *Specifikimeve Teknike*, pika 4.9 *Analiza e Çmimit Njësi përcaktohet se:* “Çmimi njësi për Tubat, Valvolat, Hidrantet dhe pjesët speciale përfshin furnizimin, transportin ngarkimin, shkarkimin dhe transportin e materialeve dhe pajisjeve të nevojshme gjatë instalimit të tyre si dhe vendosjen e të gjitha elementëve të tyre në mënyrë të përsosur dhe testimin që do të bëhet për presionin e punës me të cilën do të punojnë”. Gjithashtu, referuar kontratës së sipërmarrjes të lidhur mes palëve sipas aktit me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019, neni 26 Inspektimet, pika 1 *përcaktohet se:* “Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve



*duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës*". Për rrjedhojë likuidimi i këtyre zërave sipas këtij preventivi në vlerën **1,833,240 lekë pa TVSH** do të përbënte dëm ekonomik dhe si i tillë duhet të zbritet përmes ndryshimeve në projekt-preventiv sipas procedurave përkatëse, pasi aktualisht ky zë punimesh i preventivuar dhe në analizën e çmimeve për njësi nuk është likuiduar me situacione por është parashikuar në preventiv. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 Specifikimet Teknike, pika 4.9 Analiza e Çmimit Njësi, kontratën e sipërmarrjes të lidhur mes palëve sipas aktit me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019, neni 26 Inspektimet, pika 1si dhe me kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes me objekt 'Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmes dhe qytetin e Elbasanit' lidhur sipas aktit nr. 3166 prot., datë 23.10.2019. *Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 74-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**4.1 Rekomandimi:** Nga AKUM si dhe mbikëqyrësi i punimeve, të merren masat organizative për ndryshimin e zërave të preventivit të kontratës në vlerën **1,833,240 lekë pa TVSH** pasi kryerja e testeve të linjave të shtruara është përfshirë në çmimin e vendosjes së tubave dhe përveç kësaj, kostot e testeve dhe inspekteve duhet të financohen tërësisht nga ana e kontraktorit.

**Menjëherë**

**Komenti i subjektit:** *Deri tani është bërë kolaudimi i pjesshëm i objektit. Në preventivin përfundimtar do të kryhet zbritja e këtyre zërave. Nga ana e AKUM janë marrë masat për të mos kryer pagesën e preventiveve të dorëzuar deri në mbylljen e kolaudit të objektit.*

**5. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionin në dosjen teknike të zbatimit të punimeve të kontratës me objekt 'Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit' rezultuan mangësitë si më poshtë:

Referuar dokumentacionit fotografik të ndodhur në dosjen teknike rezulton se shtrati i kanaleve, kjo të paktën në rastet e dokumentuara, nuk është pastruar sipas kërkesave të parashikuara në pikën 2.14 të *Specifikimeve Teknike* dhe pikën 2.15.

Nga sondazhet e kryera për punimet e situacionuara rezultoi se materiali i përdorur si zhavorr lumi nuk përmbush kushtet e parashikuara në *Specifikimet Teknike* pasi ka përmbajtje të lartë materiali të imët dhe përmban fraksione me dimensione më të mëdha se 75 mm, konkretisht me dimensione të diametrit maksimal 15 cm, 17 cm e deri në 20 cm, kjo në kundërshtim me pikën 2.16 të *Specifikimeve Teknike*.

Mbushjet me të cilat janë realizuar kanalet nuk janë përgatitur sipas kushteve të diktuar nga projektuesi në lidhje me lagështinë, përzierjen, përhapjen dhe ngjeshjen në objekt me rul vibrues, me ngjeshës të posaçëm dore ose ngjeshës mekanik. Për punimet e ngjeshjes nuk është kryer asnjë testim, kjo në kundërshtim me pikën 2.17 të *Specifikimeve Teknike*.

Në dosjen teknike mungon aprovimi i mbikëqyrësit të punimeve për vendin e marrjes së zhavorrit. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, kontratën e sipërmarrjes të lidhur mes palëve sipas aktit me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019, neni 26 Inspektimet, pika 1 si dhe me kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes me objekt 'Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmes dhe qytetin e Elbasanit' lidhur sipas aktit nr. 3166 prot., datë 23.10.2019. *Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 74-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**5.1 Rekomandimi:** Nga ana e AKUM si dhe mbikëqyrësi i punimeve të kryhen inspektive me qëllim verifikimin e shtrateve të kanaleve për të verifikuar pastërtinë e tyre nga mbetjet urbane dhe mbetje të tjera të dëmshme. Dokumentacioni i sipërcituar të kërkohet nga ana e mbikëqyrësit ndaj sipërmarrësit të punimeve përpara fazës së kolaudimit dhe të kontrollohet gjatë marrjes në dorëzim nga komisioni përkatës i ngritur me Urdhër të Titullarit.

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: I pranuar

**Komenti i subjektit:** Me shkresën me nr. 618 prot., datë 07.04.2022 dhe shkresën me nr. 2345 prot., datë 07.11.2022 rezulton se nga ana e Titullarit janë ngritur përkatësisht grupi i punës për monitorimin e përfundimit të punimeve dhe një grup pune për të monitoruar rekomandimet e lëna nga KLSH. Në vijim të këtyre Urdhrave, nga punonjësit e ngarkuar janë kryer inspektimet përkatëse në përfundim të të cilave komisionet kanë hartuar relacionet. Komisioni i ngritur me Urdhër nr. 2345 prot., datë 07.11.2022 me përbërje të tij z. A.K, znj. A.Xh dhe z. G.Ll, me Memon e datës 28.12.2022 ka sugjeruar fillimin e procedurave të kolaudimit. Me shkresën nr. 2542 prot., datë 09.12.2022 B L & B & A K & B, ka dorëzuar pranë AK-së Njoftim për përfundim punimesh duke theksuar faktin se punimet, me përjashtim të zërit Montim Pompash kanë përfunduar në 15.03.2022 (shkresa me nr. 516 prot., datë 23.03.2022) dhe në njoftimin e kësaj date (28.12.2022) ka përfunduar edhe montimi i pompave pas ndërtimit të godinës së re.

**5.2 Rekomandimi:** Nga ana e AKUM si dhe mbikëqyrësi i punimeve të kryhen inspektive me qëllim verifikimin e shtrateve të kanaleve për të verifikuar nëse materiali i përdorur si zhavorr lumi përmbush kushtet e parashikuara në *Specifikimet Teknike*. Dokumentacioni i sipërcituar të kërkohet nga ana e mbikëqyrësit ndaj sipërmarrësit të punimeve përpara fazës së kolaudimit dhe të kontrollohet gjatë marrjes në dorëzim nga komisioni përkatës i ngritur me Urdhër të Titullarit.

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: I pranuar

**Komenti i subjektit:** Me shkresën me nr. 618 prot., datë 07.04.2022 dhe shkresën me nr. 2345 prot., datë 07.11.2022 rezulton se nga ana e Titullarit janë ngritur përkatësisht grupi i punës për monitorimin e përfundimit të punimeve dhe një grup pune për të monitoruar rekomandimet e lëna nga KLSH. Në vijim të këtyre Urdhrave, nga punonjësit e ngarkuar janë kryer inspektimet përkatëse në përfundim të të cilave komisionet kanë hartuar relacionet. Komisioni i ngritur me Urdhër nr. 2345 prot., datë 07.11.2022 me përbërje të tij z. A.K, znj. A.Xh dhe z. G.Ll, me Memon e datës 28.12.2022 ka sugjeruar fillimin e procedurave të kolaudimit. Me shkresën nr. 2542 prot., datë 09.12.2022 BOE L & B & A K & B, ka dorëzuar pranë AK-së Njoftim për përfundim punimesh duke theksuar faktin se punimet, me përjashtim të zërit Montim Pompash kanë përfunduar në 15.03.2022 (shkresa me nr. 516 prot., datë 23.03.2022) dhe në njoftimin e kësaj date (28.12.2022) ka përfunduar edhe montimi i pompave pas ndërtimit të godinës së re.

Për sa më sipër është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 994 prot., datë 09.11.2023 nga ana e BOE L & B & A K & B nga ana e të cilëve pretendohet si më poshtë trajtuar.

**Pretendimi i subjektit:**

“Janë zbatuar me përpikmëri parashikimet e kontratës së sipërmarrjes nr. 3889 prot., datë 31.12.2019, projektit të zbatimit, specifikimeve teknike dhe ofertës ekonomike të shpallur fituese. Nga Bashkia Elbasan në rolin e përfituesit të investimit dhe juridiksionit territorial të zonës ku do realizohet ky investim, është miratuar leja infrastrukurore, me vendimin nr. 985/7 datë 17.03.2020 për realizimin e punimeve të këtij objekti. Gjithashtu, po nga Bashkia Elbasan është miratuar leja

e ndërtimit me nr. 985/10 prot., datë 04.06.2020. Me vendimin nr. 985/7, datë Leja infrastrukturore Bashkia Elbasan ka përcaktuar vend-depozitim të mbetjeve ndërtimore të krijuara për këtë objekt gjatë realizimit të punimeve ku në pikën nr. 10 të dispozitivit të saj është vendosur se: Në zbatim të VKB nr. 66, datë 23.05.2019, Zhvilluesi është i detyruar që mbetjet ndërtimore të depozitohen në jug të Fshatit Vidhas, NJA Papër, më trull shtet me nr. pasurie 52/26 me kapacitet maksimal 1,000,000 ton/vit nën juridiksionin e Bashkisë Elbasan. Materiali i dalë rishtazi gjatë realizimit të punimeve është grumbulluar në kantier dhe më pas është transportuar me kamionët e sipërmarrësve të punimeve në vend depozitimet e përcaktuara nga Bashkia Elbasan, në Fshatin Vidhas, NJP Papër. Bashkia Elbasan me shkresën nr. 749 prot., datë 10.02.2022 deklaroi se: Pas përfundimit të punimeve Shoqëritë L & B & A K & B kanë bërë pastrimin e territorit rreth objekteve të ndërtuara nga mbetjet e ndryshme ndërtimore dhe inertet, dhera si dhe transportimin, depozitim të tyre në vend-depozitim në jug të fshatit Vidhas NJA Papër. ... (vijon observacioni) ”

#### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH<sup>-së</sup>:**

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe atij të paraqitur me observacionet e dërguara sipas shkresës së administruar në KLSH me nr. 994 prot., datë 09.11.2023 rekomandimet e mësipërme të praktikës me objekt ‘Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit’ do të vlerësohen plotësisht në vijim në auditimin e ardhshëm që do të zhvillohet pranë AKUM. Për sa më sipër rekomandimet e kësaj praktike do të konsiderohen të pranuar dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces*.

**6. Gjetje nga auditimi:** Gjatë zbatimit të kontratës “Ndërtim i kolektorit kryesor të ujërave të zeza dhe I.T.U.P në Gjirin e Lalzit”, kanë rezultuar diferenca të volumeve të parashikuara krahasuar me ato faktike, por edhe nevoja për ndryshime.

Me Urdhër nr. 39 prot., datë 19.04.2018, është ngritur grupin e punës për negociimin e çmimeve për zëra të rinj punimesh.

Në këto analiza çmimesh për zëra të rinj punimesh ka referenca nga studimi i tregut i realizuar, ndërsa për zëra të tjerë janë hartuar analiza të kostos, për të cilat u konstatuan mangësi pasi në përcaktimin e çmimeve sipas zërave të miratuara duhet të reflektohej vetëm ndryshimi i çmimit të bazës materiale dhe jo hartimi i analizave të plota. Veprimet të cilat bien në kundërshtim me Udhëzimi nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika a.

*Më hollësisht trajtuar në Pikën 6 faqe 74-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**6.1. Rekomandimi:** AKUM, të marrë masa për analizimin në detaje të çmimeve që përcaktohen në zëra të rinj punimesh, të cilat nevojiten të përcaktohen nga ndryshimet e mundshme të projektit gjatë zbatimit të kontratës.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e AKUM është mbajtur diferenca e ardhur si pasojë e mangësive në drejtim të hartimit të analizave për zërat e rinj.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht shkresës me nr. 410 prot., datë 03.03.2022 nga ana e AKUM i është mbajtur kontraktorit të punimeve STRABAG AG shuma përkatëse prej **3,720,837 lekë pa TVSH** e ardhur si pasojë e mangësive në drejtim të hartimit të analizave të çmimeve për zërat e rinj. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *I zbatuar*. Megjithatë konfirmimi i tij do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**7. Gjetje nga auditimi:** U konstatuan vonesa në likuidimin e dëmshpërblimit të ish-pronarëve të shpronësuar, për interes publik, në zbatimin e projektit “Përmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madhe”. Pavarësisht se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (shkresa nr. 3534 prot., datë 17.12.2018) me Vendimin Nr. 657 Regj., datë 11.12.2018 ka vendosur: mospranimin e kërkesës së AKUM, për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit Nr. 3401 datë 28.09.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, e cila linte në fuqi të Vendimin Nr. 6577, datë 28.12.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, e cila vendosi: 1. Pranimin e pjeshëm të padisë (të shtetasit A.B); 2. Shfuqizimin e pikës 4 të listës së pronarëve të VKM Nr.772, datë 16.09.2015;3. Detyrimin e palëve të paditura (AKUM...) për t’i shpërblyer paditësit diferencën e krijuar në shumën 6.619.144 lekë; pavarësisht lajmërimit nga ana e përmbaruesit A. K. drejtuar AKUM për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimet; pavarësisht vënieve nën sekuestro të llogarive të AKUK (AKUM) që në një kohë para periudhës në fokus auditim, sikurse dhe vendosjes të sekuestros mbi llogaritë e AKUM me 07.08.2020, shlyerja e detyrimit është bërë me vonesë në katër këste.

Për këtë situatë, sikurse informuar formalisht nëpërmjet postës elektronike (datë 27 tetor 2021) nga znj. N. A. Përgjegjëse e Sektorit të Financës, Drejtoria Ekonomike, z. A. B. është likuiduar me këste, për shkak të mungesës së fondeve, duke filluar pagesat pas një viti dhe duke përfunduar pas afro dy vitesh, pavarësisht se duhej programuar dhe parashikuar në fondet buxhetore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të akorduara në ligjin vjetor të buxhetit pasardhës. Këto vonesa janë në shkelje të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, pika 3, germës a) dhe germës b), si dhe pikës 4.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 28-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1. Rekomandimi:** AKUM të sigurojë shlyerjen pa vonesë të pagesave të dëmshpërblimeve për efekt shpronësimi, objekt vendimesh gjyqësore.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** *Nga ana e AKUM janë marrë masa për likuidimin pa vonesa të vendimeve gjyqësore brenda mundësive dhe tavanëve buxhetore të institucionit.*

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht Urdhër shpenzimit me nr. 478, datë 29.12.2022 me objekt *Pagesë për ekzekutim vendimi gjyqësor*, rezulton se nga ana e AKUM është likuiduar shumën e mbetur ende pa likuiduar prej 5,859,248 lekë për subjektin Luigj Suka. Nisur nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi* megjithatë konfirmimi i tij do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**8. Gjetje nga auditimi:** U konstatua se nga Koordinatorin i Njesisë të Zbatimit të Projektit, lidhur me procesin e shpronësimit, nuk ka raportime të dokumentuara. Lidhur me detyrimin e Koordinatorit të Njesisë së Zbatimit të projektit “Përmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madhe” për të raportuar pranë Drejtorit të Përgjithshëm të AKUM, lidhur me shpronësimet sikurse konfirmuar nga e - maili i datës 21 tetor 2021, marrë nga znj. R. K., shkruhet: “Njësia e zbatimit ka raportuar ne vazhdimësi me Drejtorin e Përgjithshëm ne mbledhje periodike ne lidhje me shpronësimet por jo te dokumentuara”. Nga sa pohohet, konstatohet se raportimi lidhur me shpronësimet mbetet një detyrim i cili nuk dokumentohet, nëpërmjet asnjë akti shkresor, ndaj përmbushja e këtij detyrimi konsiderohet e përcaktuar nga Koordinatorja e Njesisë së Zbatimit të Projektit. Mosraportimi është në shkelje të Urdhrit të Ministrit të MIE, Nr. 88, datë 24.02.2020,

me të cilin është miratuar “Rregullorja e brendshme për organizimin dhe funksionimin e AKUM”, nenit 17, pikë 4.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 6 faqe 28-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**8.1. Rekomandimi:** Të sigurohet në AKUM një raportim i vazhdueshëm dhe i dokumentuar mbi proceset e shpronësimit dhe detyrimeve që rrjedhin prej tij, tek Drejtori i Përgjithshëm.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** *Nga ana e Zyrës së Zbatimit që ndjek Projektin pranë AKUM me objekt "Përmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madhe", janë marrë masat përkatëse duke kryer raportimin mujor periodik tek Titullari i AKUM dhe Sektori Ligjor në lidhje me procesin e shpronësimit. Dokumentacioni në lidhje me sa më sipër janë korrespondencat me e-mail për periudhën gusht 2022 – korrik 2023.*

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të mësipërm, ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *I zbatuar*.

**9. Gjetje nga auditimi:** Nën faqja e Njoftimeve “Shpronësime” e faqes zyrtare të AKUM, është e pazhvilluar dhe pa asnjë përmbajtje apo informacion. Mungojnë aktet ligjore dhe nënligjore që udhëheqin procesin e shpronësimit, si dhe kriteret e dhënies së shpërblimeve për efekt të shpronësimeve.

Mos zhvillimi i nën faqes së Njoftimeve, “Shpronësime” e faqes zyrtare të AKUM, është në shkelje të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nenit 7, pikës 1, germave k), l), iii. *Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 28-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**9.1. Rekomandimi:** Të sigurohet nga AKUM zhvillimi i nën faqes së Njoftimeve, “Shpronësime” tek faqja zyrtare e agjencisë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** *Nën faqja e Njoftimeve, "Shpronësime" është hapur në Faqen Zyrtare të AKUM. Më pas nga Zyra e Zbatimit që ndjek Projektin e Tiranës së Madhe pranë AKUM në bashkëpunim me sektorët e tjerë që do të përfshihen në këtë proces do të bëhet përditësimi në mënyrë të vazhdueshme i qytetarëve të pa likuiduar në nën faqen "Shpronësime" të Faqes Zyrtare të AKUM.*

**Komenti i audituesve:** Referuar verifikimit në faqen zyrtare të AKUM në nën faqen shpronësime me adresë <https://akum.gov.al/publications/expropriation> informacioni është publikuar. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *I zbatuar*. Megjithatë konfirmimi i detajeve të publikuara do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**10. Gjetje nga auditimi:** AKUM nuk ka përgatitur kërkesën për shpronësim dhe dosjen përkatëse të dokumentacionit shoqërues konform parashikimeve ligjore mbi shpronësimin, lidhur me zhvillim e Projektit “Rehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranës”. Sikurse vënë në dukje në shkresën nr. 8086/1 prot., datë 21.10.2019 (apo nr. 2667/1 prot., datë 2b2.11.2019, prototokoll i AKUM) Sektori i Shpronësimeve të MIE, konstatohet se AKUM nuk ka përgatitur kërkesën për shpronësim dhe dosjen përkatëse të dokumentacionit shoqërues konform parashikimeve ligjore mbi shpronësimin, duke bërë që të mungojë: Projekti i miratuar dhe argumentet përkatëse ligjore për interesin publik lidhur me realizimin e tij; Lejet dhe miratimet përkatëse nga organet kompetente sipas ligjit, në përputhje me natyrën dhe llojin e projektit që kërkohet të realizohet; Aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit, nga vetë kërkuesi i shpronësimit ose me të tretët, si

dhe afatet përkatëse; si dhe shumë dokumente të tjerë të nevojshëm për ecurinë e kërkesës për shpronësim.

Mos përgatitja e kërkesës për shpronësim dhe dosjes përkatëse të dokumentacionit shoqëruar konform parashikimeve nga AKUM, është në shkelje të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, nenit 10, pikës 1, germave b), d), dh).

*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 28-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**10.1. Rekomandimi:** AKUM të angazhohet seriozisht në përgatitjen e kërkesave për shpronësim dhe dosjeve të cilat shoqërojnë procesin e shpronësimit, duke shmangur shkeljet e konstatuara.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e AKUM është kryer përgatitja e dosjes për shpronësim nga e para. Me Urdhrin e Brendshëm nr. 29 datë 07.04.2022, nr. 619 prot., ka ngritur Grupin e përhershëm të punës për koordinimin, organizimin dhe zbatimin e procesit të shpronësimit i cili ka ndjekur praktikën për verifikimin online të statusit juridik të pasurive pronë private që preken nga zhvillimi i projektit me objekt: “Rehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranës. AKUM ka bërë aplikimet online sipas kërkesave ligjore me pagesat përkatëse për konfirmimin nga ASHK të statusit juridik të pronës për të gjithë listën e pronarëve që preken nga ky projekt. Pritet përgjigja zyrtare nga ASHK. Në buxhetin e vitit 2023 është parashikuar edhe vlera përkatëse e fondit për këtë qëllim nën zërin Kosto Lokale.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht Urdhrit të Brendshëm dhe Aplikimeve pranë ASHK-së në vitin 2022 dhe 2023 ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *I zbatuar*. Megjithatë konfirmimi i tij do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**11. Gjetje nga auditimi:** ASHK ka vënë me vonesë në dispozicion të AKUM zyrtarisht informacionin e kërkuar mbi pasuritë pronë private, që preken nga zbatimi i Projektit “Rehabilitimi i Rrjetit Hidrik”. Nga AKUM më datë 14.09.2020 është kryer procedura e aplikimit online për verifikimin e statusit juridik të pronave që preken në zbatim të projektit “Rehabilitimi i Rrjetit Hidrik”. Me shkresën nr. 2327/1 datë 28.09.2020 ASHK ka dërguar faturën për shërbimin kadastral për të cilin AKUM do aplikonte në portal, në përgjigje të kërkesës së AKUM për këtë informacion, përcjellë me shkresën nr. 2327 prot., datë 14.09.2020.

Me shkresën nr. 3326 prot., datë 24.12.2020 (protokoll i AKUM) ASHK ka vënë në dispozicion zyrtarisht informacionin e kërkuar mbi pasuritë pronë private që preken nga zbatimi i Projektit “Rehabilitimi i Rrjetit Hidrik”, në kuadër të aplikimit të kryer online nga AKUM.

Referuar vonesës në dhënien e shërbimit për të cilin ka aplikuar AKUM, konstatohet shkelja e afateve procedurale nga ASHK në dhënien e shërbimit kadastral. Ndërkohë AKUM duhej të kishte insistuar pranë ASHK për respektimin e afateve.

Vonesat e vënies në dispozicion të AKUM nga ASHK, të informacionit të kërkuar mbi pasuritë pronë private, që preken nga zbatimi i Projektit “Rehabilitimi i Rrjetit Hidrik”, janë në shkelje të Ligjit Nr. 111/2018 “Për kadastrën”, nenit 29, pikës 3.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 28-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**11.1. Rekomandimi:** AKUM të insistojë me vëmendje të shtuar në marrjen e informacionit nga ASHK, lidhur me statuset juridike të pasurive të cilat preken nga proceset e shpronësimit, duke synuar një ndërveprim më efikas me ASHK.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** *Nga ana e AKUM është kryer përgatitja e dosjes për shpronësim nga e para. Me Urdhrit e Brendshëm nr. 29 datë 07.04.2022, nr. 619 prot., ka ngritur Grupin e përhershëm të punës për koordinimin, organizimin dhe zbatimin e procesit të shpronësimit i cili ka ndjekur praktikën për verifikimin online të statusit juridik të pasurive pronë private që preken nga zhvillimi i projektit me objekt: “Rehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranës”. AKUM ka bërë aplikimet online sipas kërkesave ligjore me pagesat përkatëse për konfirmimin nga ASHK të statusit juridik të pronës për të gjithë listën e pronarëve që preken nga ky projekt. Pritet përgjigja zyrtare nga ASHK. Në buxhetin e vitit 2023 është parashikuar edhe vlera përkatëse e fondit për këtë qëllim nën zërin Kosto Lokale.*

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht Urdhrit të Brendshëm dhe Aplikimeve pranë ASHK-së në vitin 2022 dhe 2023 ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *I zbatuar*. Megjithatë konfirmimi i tij do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**12. Gjetje nga auditimi:** AKUM nuk ka përgatitur kërkesën e shpronësimit dhe dosjen përkatëse të dokumentacionit shoqërues, brenda afateve kohore përcaktuara nga parashikimet ligjore mbi shpronësimin, referuar Projektit “Rehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranës”. Me shkresën nr.469 Prot., datë 24.02.2021 AKUM ka dërguar dosjen e plotë për kërkesën për shpronësim në MIE. Në këtë pikë procesi i shpronësimit nuk është e sigurt se mund të përmbyllet pozitivisht, meqë referuar shkresës me lëndë: “Kujtesë mbi plotësimin e dokumentacionit të kërkesës për shpronësim” nr. 1994 prot., datë 21.02.2020 (nr. 605 prot., datë 24.02.2020, protokoll i AKUM), ku MIE tërhiqte vëmendjen dhe sqaronte se, “Meqenëse kanë kaluar mbi 4 muaj dhe nga ana juaj nuk është dërguar dokumentacioni i kërkuar, Ju bëjmë me dije se vonesat e tej zgjatura në plotësimin e dokumentacionit, përbëjnë shkak për kthimin e dosjes së shpronësimit dhe refuzimin e kërkesës për shpronësim, referuar përcaktimeve të nenit 12, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, duke shtuar në fund se: “Sa më sipër, lutemi plotësimin e dokumentacionit të kërkuar brenda 30 ditëve, në të kundërt do të procedohet me kthimin e kërkesës për shpronësim”.

Nga data 21.02.2020 kanë kaluar rreth 13 muaj, pra 12 muaj përtej afatit 30 ditor, të lënë si afat nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimeve të MIE. Kësaj vonese i ka paraprirë edhe vonesa tjetër prej katër muajsh, e cila u bë shkas për dërgimin e shkresës nr. 1994 prot., datë 21.02.2020 (nr. 605 prot., datë 24.02.2020, protokoll i AKUM), nga MIE. Duke përjashtuar AKUM – in nga përgjegjësia për vonesën ASHK, sigurisht, konstatohet se vonesa në dërgimin e kërkesës për shpronësim lidhet me administrimin jo në përputhje me ligjin, nga ana e AKUM. Vërtetë nga MIE nuk është refuzuar kërkesa për shpronësim e AKUM, por konsideruar edhe koha që MIE ka tashmë dosjen në dispozicion, dhe nuk ka dhënë përgjigje lidhur me praktikën, shtyn të mendohet se kërkesa, për shkak të kalimit të afateve, mund të jetë e destinuar për refuzim për kapërcim të afateve.

Mosrespektimi i afateve për përgatitjen e kërkesës për shpronësim dhe dosjes përkatëse, është në shkelje të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, nenit 12, pikave 2) dhe 3). *Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 28-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**12.1. Rekomandimi:** AKUM të angazhohet seriozisht në përgatitjen e kërkesave për shpronësim brenda afateve kohore.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e AKUM është kryer përgatitja e dosjes për shpronësim nga e para. Me Urdhër të Brendshëm nr. 29 datë 07.04.2022, nr. 619 prot., ka ngritur Grupin e përhershëm të punës për koordinimin, organizimin dhe zbatimin e procesit të shpronësimit i cili ka ndjekur praktikën për verifikimin online të statusit juridik të pasurive pronë private që preken nga zhvillimi i projektit me objekt: “Rehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranës”. AKUM ka bërë aplikimet online sipas kërkesave ligjore me pagesat përkatëse për konfirmimin nga ASHK të statusit juridik të pronës për të gjithë listën e pronarëve që preken nga ky projekt. Pritet përgjigja zyrtare nga ASHK. Në buxhetin e vitit 2023 është parashikuar edhe vlera përkatëse e fondit për këtë qëllim nën zërin Kosto Lokale.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht Urdhër të Brendshëm dhe Aplikimeve pranë ASHK-së në vitin 2022 dhe 2023 ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *I zbatuar*. Megjithatë konfirmimi i tij do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**13. Gjetje nga auditimi:** - Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlera të vogla në 10 prej tyre në mënyrë të përmbledhur u konstatuan si më poshtë:

- Përgatitja e specifikimeve në 8 procedura nuk është bërë nga Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, apo një tjetër komision i ngritur me urdhër të posaçëm të Titullarit, por nga persona të paautorizuar nga Titullari i AKUM;

- Përllogaritja e fondit limit në 8 procedura nuk është bërë nga Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, apo një tjetër komision i ngritur me urdhër të posaçëm të Titullarit, por nga persona të paautorizuar nga Titullari i AKUM;

- Marrja e mallrave dhe shërbimeve në 4 procedura nuk është bërë nga Komisioni i marrjes në dorëzim të aktiveve, apo nga ndonjë komision i ngritur me urdhër të posaçëm nga Titullari i AKUM;

- Fatura e shitjes në 5 procedura, nuk rezultojnë të firmosura nga Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël;

Këto praktika janë në shkelje të Udhëzimit nr. 3, i APP, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, pikave 5 dhe 19, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenit 59, pikave 1 dhe 2, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikave 42 dhe 43.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 28-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**13.1. Rekomandimi:** Njësitë dhe drejtuesit e niveleve të ndryshme të AKUM, si dhe komisionet e blerjeve me vlera të vogla të marrin masat, që për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, të mos përsëriten shkeljet e konstatuara sa më sipër, duke siguruar zbatimin me përpikmëri të kuadrin rregullativ ligjor.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e AKUM janë marrë të gjitha masat e nevojshme për mos përsëritjen e shkeljeve të konstatuara në drejtim të kuadrin përkatës ligjor e rregullator për blerjet e vogla. Konkretisht janë nxjerrë Urdhër të Brendshëm nr. 3 datë 11.01.2023 me nr. 38 prot., Urdhër të Brendshëm nr. 75 datë 02.11.2021, Urdhër nr. 76 datë 02.11.2021 Urdhër nr. 18 datë 25.02.2022 si dhe Urdhër nr. 12, datë 08.02.2023.



**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të mësipërm ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *I zbatuar* megjithatë konfirmimi i tij do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për periudhën objekt auditimi u konstatua se dosjet e procedurave të prokurimit nuk janë arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, nenin 4/26 dhe “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 19 si edhe udhëzimet e APP-së.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 48-74, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**14.1.Rekomandimi:** AKUM të marrë masa për sistemimin e dosjeve të procedurave të prokurimit, inventarizimit dhe arkivimin e tyre, sipas lidhjeve dhe në mënyrë kronologjike.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** *Nga ana e AKUM janë marrë të gjitha masat e nevojshme për sistemimin e dosjeve të procedurave të prokurimit, inventarizimi dhe arkivimin e tyre, sipas lidhjeve dhe në mënyrë kronologjike.*

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht procesverbaleve të inventarizimit të dosjeve, ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *I zbatuar* megjithatë konfirmimi i tij do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**15. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit me objekt “*Përmirësimi i infrastrukturës së ujërave të zeza në zonën bregdetare Vlorë*”, me fond limit 407,368,357 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019, janë kualifikuar dy operatorë ekonomik:

a. BOE “B” SHPK. & “V.H” SHPK & “E” SHPK, me vlerë 389,375,085 lekë pa TVSH, i shpallur fitues.

b. Operatori ekonomik “A.K” SHPK me vlerë 399,953,374 lekë pa TVSH.

Nga auditimi i DST, dokumenteve të paraqitura nga BOE “V.H” SHPK & “E” SHPK & “B” SHPK, u konstatua se BOE i mësipërm nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara sipas DST, konkretisht si më poshtë:

- Shoqëria “E” SHPK nuk ka përmbushur kriterin për mjetet dhe pajisjet që ka në dispozicion, konkretisht për mjetin Autobot Uji, kjo pasi referuar kontratës së bashkëpunimit me nr. 8314 Rep, nr. 4039 Kol, datë 13.07.2019 kjo shoqëri ka marrë përsipër të kryejë punime me autobot por nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për posedimin e autobotit.

- Shoqëria “E” SHPK nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e kriterëve të veçanta për kualifikim ku kërkohet që OE te disponojë Licence QKL III.2.B. (Grumbullim, Transportim mbetjeje Urbane).

KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “V.H” SHPK & “E” SHPK & “B” SHPK, me ofertën, 389,375,085 lekë pa TVSH, duke mos plorësuar kriteret e kërkuara në DST, veprime në kundërshtim me nenin 46 “*Kualifikimi i ofertuesve*” e nenit 53 “*Shqyrtimi i ofertave*”, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 48-74, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**15.1.Rekomandimi:** AKUM të marrë masa në të ardhmen që për çdo operator ekonomik të kualifikuar, të sigurojë plotësimin e të gjitha kritereve të kërkuar në dokumentet standarde të tenderit në mënyrë që të shmangë praktikën në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: I pranuar

**Komenti i subjektit:** *Nga ana e AKUM janë marrë të gjitha masat e nevojshme për verifikimin e plotë të dokumentacionit të OE të shpallur fitues.*

**Komenti i audituesve:** Nisur nga deklaratat e mësipërme ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi* megjithatë konfirmimi i tij do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit për periudhën objekt auditimi rezultoi se për të gjitha procedurat e prokurimit të audituara Autoriteti Kontraktor ka lidhur kontrata me operatorë ekonomikë të shpallur fitues pa pasur fondet e plota (në llogarinë përkatëse) të nevojshme për të marrë angazhimet buxhetore për realizimin e punimeve, ndërkohë që kontratat kanë qenë me kohëzgjatje brenda 12 muajve referuar DST dhe kontratës së lidhur. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar neni 40 “E drejta për të kryer shpenzime”, neni 50 “Angazhimet buxhetore” dhe neni 51 “Menaxhimi i angazhimeve” dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, nenin 70 “Lidhja e Kontratës”, neni 76 “Kohëzgjatja e kontratës” pika 1.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 48-74, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**16.1. Rekomandimi:** AKUM në cilësinë e AK të marrin masat e nevojshme që në përfundim të procedurave të prokurimit të nënshkruaj kontratën vetëm pasi fondi i nevojshëm për realizimin e kontratës të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: I pranuar

**Komenti i subjektit:** *Nga ana e AKUM janë marrë e nevojshme për marrjen e konfirmimit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për disponueshmërinë e fondeve përpara lidhjes së kontratës.*

**Komenti i audituesve:** Nisur nga deklaratat e mësipërme si dhe referuar shkresave me nr. 2246, prot., datë 18.10.2022 me objekt *Kërkesë për prokurim me vlerë të plotë* nga AKUM drejtuar MIE dhe përgjigjes së MIE sipas shkresës me nr. 2009/2 prot., datë 25.10.2022, rezulton se ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi* megjithatë konfirmimi i tij do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**17. Gjetje nga auditimi:** -Nga auditimi i respektimit të afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna rezulton se nga ana e AKUM nuk është raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve pas këtij auditimi. Sipas Vendimit të Kryetarit të KLSH – së nr. 98, nr. 675/24 prot., datë 01.10.2020, gjatë auditimit të kryer në bazë të Autorizimit nr. 675/8, datë 14/07/2020 me objekt: “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve”, lidhur me 34 rekomandimet e lëna gjithsej, nga këto, 7 masa organizative, 15 masa zhdëmtimi, 10 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike dhe 2 masa për parandalimin e dëmit ekonomik, pasi u konstatua se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve ishte si më poshtë: Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 7 masa organizative, të cilat janë pranuar dhe zbatuar

plotësisht 7; Rekomandime për Masa për Zhdëmtim janë lënë 15 rekomandime për shumën 494.674 mijë lekë nga të cilat, janë pranuar 15, janë në proces zbatimi 12, dhe është zbatuar 3 masë në shumën 5,491 mijë lekë; Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike janë lënë 10 rekomandime, nga të cilat janë pranuar 8 dhe zbatuar, si dhe 2 rekomandime nuk janë pranuar; Rekomandime për parandalimin e dëmit ekonomik janë lënë 2 rekomandime të cilat janë pranuar dhe janë në proces zbatimi, në shkresën nr. 675/37 prot. të datës 06.10.2020, “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme”, pasi referuar Pikës I, vihet në dukje se: “Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit Nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju ri kërkojmë që, për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, ose të zbatuara pjesërisht të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre, si vijon...në Pikë II kërkohej: “Për të gjitha rekomandimet e tjera që konsiderohen “në proces zbatimi”, inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda 3 mujorit të tretë, të vitit 2020 dhe në mbështetje të nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve tona, të raportohet me shkrim pranë KLSH mbi ecurinë e zbatimit të tyre”. Sa më lart, është në shkelje të Ligjit Nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 115-123, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**17.1. Rekomandimi:** Drejtori i Përgjithshëm i AKUM të marrë masa që të raportojë pranë KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve duke zbatuar afatin 6 -mujor si dhe të përsheptojë procesin e realizimit të rekomandimeve që janë në proces zbatimi.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** *Nga ana e AKUM nuk janë marrë e nevojshme për raportimin në KLSH të zbatueshmërisë së rekomandimeve pas afatit 6-mujor të dorëzimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit të mëparshëm. Për sa i takon rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm rezulton se nga 15 të rekomanduara, 3 janë zbatuar dhe 12 kanë qenë në proces zbatimi. Nga këto 12 në proces sqarojmë si më poshtë: 1. Gjetje nga auditimi: Procedura e prokurimit “Furnizim Makineri – Pajisje për Ndërmarrjen SH.A, Vlorë” me fond limit 154,636,278 lekë pa TVSH, me fitues operatorin ”V” me ofertë 151,543,951 lekë. Në këtë procedurë nga 4 operatorë pjesëmarrës janë s`kualifikuar 3 operatore ekonomike. Një nga këta operatorët “P.I” sipas KVO, është s`kualifikuar se nuk plotëson kriteret e veçanta të kërkuara në DT. Ky operator ka paraqitur ofertën ekonomike më të ulët se fituesi në vlerën 14,907,951 lekë pa TVSH. Për këtë s`kualifikim ky operator ka bërë ankesë pranë AK i cili nuk e ka marrë parasysh këtë ankesë. Në vijim, operatori ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik i cili me Vendim Nr. 496 date 06.07.2017 ka vendosur të mos e pranojë ankesën e operatorit “P.I”. Me këtë vendim të KPP ky operator, nuk ka qenë dakord dhe ka bërë rekurs në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, e cila me vendim nr. 4980 datë 22.12.2017 ka rrëzuar ankesën e operatorit “P.I”. Përsëri ky operator ka bërë rekurs në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, e cila me Vendimin nr.22236, datë 31.05.2018 ka vendosur ndryshimin e Vendimit nr. 4980 datë 22.12.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë duke shfuqizuar vendimin e KPP nr.496 datë 05.07.2017 dhe detyrimin e AKUM të shpërblejë këtë shoqërinë shumën 16,389,000 lekë. Me njohjen e këtij vendimi, KPP, AKUM në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit kanë bërë rekurs kundër këtij vendimi në Gjykatën e Lartë, Tiranë me shkresë nr.1178/1 datë 12.07.2018. Çështja*

vazhdon të jetë në proces gjykimi në Gjykatën e Lartë. Rekomandimi: AKUM të bashkëpunojë me Avokatin e Shtetit për tu përgatitur dhe ndjekur të gjitha shkallët e gjyqësorit dhe fitimi e këtij gjyqi, me qëllim shmangien e dëmit ekonomik që mund ti shkaktohet buxhetit të buxhetit të shtetit në shumën 18,113,941 lekë. Në lidhje me këtë rast shoqëria në fjale zotëron një titull ekzekutiv të formës së prerë dhe të ekzekutueshëm pavarësisht se nga palët e paditura është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Bashkëlidhur: Rekursin e depozituar në Gjykatën e Lartë nga KPP; Korrespondenca e mbajtur me Avokaturën e Shtetit. Referuar këtij rekomandimi i cili në Akt-Verifikimin Nr.1 të Kontrollit të Lartë të Shtetit është pranuar dhe ka qenë në proces zbatimi, informojmë: Akoma nuk ka një datë nga Gjykata e Lartë për shqyrtim. AKUM ka kryer likuidimin e Kreditorit "P.I".

2. Gjetje nga auditimi: Procedura e prokurimit "Përfundimi i rrjetit të Kanalizimeve të Ujërave të Zeza në zonën e Përroi i Agait - Qerret, LOTI II (Linjat KUZ Përroi Agait, Stacioni Pompimit Nr.1 deri tek Stacioni Pompimit Nr.2) me fond limit 353.062.840 lekë pa TVSH, me fitues Operatorin ekonomik "A.K" me ofertë 331,573,620 lekë. Në këtë procedurë nga 6 operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 5 operatorë ekonomik. Një nga operatorët "G. 2", sipas KVO, është s'kualifikuar me arsyen se nuk plotëson kriteret e veçanta të kërkuara në DT dhe veçanërisht nuk plotëson e kriterit për punë të ngjashme. Ky operator ka paraqitur ofertën ekonomike më të ulët se fituesi në vlerën 43,135,663 lekë pa TVSH. Operatori Ekonomik "G. 2" ka bërë ankesë pranë AK i cila nuk e ka marrë parasysh këtë ankesë. Më pas ky operator ka paraqitur ankesë në KPP i cili në përfundim të shqyrtimit në themel me Vendim Nr. 822/2016 datë 26.10.2016 ka vendosur të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "G. 2". Me këtë vendim të KPP, operatori " G. 2 ", nuk ka qenë dakord dhe ka bërë ankesë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë e cila me Vendimin nr.845, datë 06.03.2017 ka vendosur: shfuqizimin pjesërisht të Vendimit nr.822/2016 , datë 26.10.2016 të KPP, për s'kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "G. 2". Menjëherë me njohjen e këtij vendimi, KPP, AK dhe Avokati i Shtetit kanë bërë rekurs në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Çështja vazhdon të jetë në proces gjykimi nga kjo Gjykatë. Rekomandimi: AKUM të bashkëpunojë me Avokatin e Shtetit për tu përgatitur dhe ndjekur të gjitha shkallët e gjyqësorit dhe fitimi e këtij gjyqi, me qëllim shmangien e dëmit ekonomik që mund ti shkaktohet buxhetit të buxhetit të shtetit në shumën 51,762,795 lekë . Pranuar dhe në proces si rekomandim: AKUM, KPP, AK dhe Avokati Shtetit kanë bërë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë dhe kjo çështje aktualisht është në proces gjyqësor, në listë-pritje Komenti i grupit të Auditimit Grupi i auditimit shqyrtoj dokumentacionin bashkëlidhur akt verifikimit, dhe u konstatua se deri në momentin e auditimit në terren AKUM-së nuk është përcaktuar një datë nga Gjykata Administrative të Apelit. Sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces. Në përfundim të proceseve gjyqësore, në rast se, Vendimi i Gjykatës merr formë të prerë dhe është në favor të operatorit të skualifikuar, të merren masa për të ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e dëmit ekonomik që përcaktohet nga vendimi i gjykatës Me hyrjen në fuqi të Vendimit të Gjykatës Përgjigja e institucionit: Pranuar dhe në proces si rekomandim: AKUM, KPP, AK dhe Avokati Shtetit kanë bërë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë dhe Çështja vazhdon të jetë në proces gjykimi nga kjo Gjykatë, në listëpritje. Komenti i grupit të Auditimit Grupi i auditimit shqyrtoj dokumentacionin bashkëlidhur akt verifikimit, dhe u konstatua se deri në momentin e auditimit në terren AKUM-së nuk është përcaktuar një datë nga Gjykatën Administrative të Apelit. Sa sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces. Referuar këtij rekomandimi i cili në Akt-Verifikimin Nr.1 të Kontrollit të

Lartë të Shtetit është pranuar dhe ka qënë në proces. Akoma nuk ka një datë nga Gjykata Administrative e Apelit për shqyrtim.

**3. Gjetje nga auditimi:** Procedura e prokurimit “Ndërtim i rrjetit të ujësjellësit dhe KUZ në fshatin Luz, Kavaje” me fond limit 307,415,618 lekë pa TVSH, me fitues Operatori Ekonomik “A.K” me vlerë oferte 294,815,756 lekë. Në këtë procedurë nga 4 operatorë pjesëmarrës janë s`kualifikuar 3 operatore ekonomik për mos përmbushje të disa kriterëve të veçanta të kërkuara në DT. Të 3 operatorët e s`kualifikuar kanë paraqitur ofertat ekonomike më të ulëta se fituesi në vlerën që shkojnë nga 45,000,000 lekë në 77,310,876 lekë me TVSH. Sipas, KVO s`kualifikimi i tyre është bërë kryesisht sepse dokumentacioni i dorëzuar prej tyre është për punë në ujësjellës dhe në këto kushte, nuk plotëson piken, përvojë e suksesshme në ekzekutimin e punë të ngjashme të së njëjtës natyrë KUZ. Për këto s`kualifikime, dy nga operatorët, “B. & Ç. & G. C” dhe “E. & L. & B.” kanë bërë ankesë pranë AK e cila nuk i ka pranuar këto ankesa. Në vijim të dy operatorët kanë paraqet ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik i cili me Vendimin Nr. 652/2017, ka vendosur, të mos i pranojë këto ankesa. Me këtë vendim të KPP, këta operatorë nuk ka qënë dakord dhe ka bërë rekurs në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe çështja vazhdojnë të jene në gjykim e sipër. Meqenëse çështja e s`kualifikimit të këtyre operatorëve vazhdon të jetë akoma në shqyrtim nga gjykatat Administrative, auditimi nuk mundë të dali me vlerësim në lidhje me ligjshmërinë apo jo të këtij s`kualifikimi. Megjithatë me qëllim shmangien tej zgjatjes së procedurës së prokurimeve që vijnë si pasojë e ankimeve, dhe eliminimin e kostove që kanë operatorët si pasojë e ankimeve por edhe përdorimin pa eficiency, efektivitet dhe ekonomicitet apo dhe dëmeve ekonomike që mundë të rrjedhin nga fitimi i gjyqëve nga operatori dalim me konkluzionin se, KVO duhet të ishte me tolerante duke ju referuar pikës 4 të nenit 53 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” dhe mangësitë e konstatuara në dokumentacionin teknik të këtij operatori t`i konsideronte si devijime të vogla. Kështu, do të kishim edhe kursim të fondeve buxhetore në vlerën 77,310,876 lekë me TVSH që është diferenca e vlerës së ofertës së operatorit fitues, me vlerën e ofertës së bashkimit të operatorëve “B. & “C. & G. C” i cili ka paraqitur ofertën ekonomike më të ulët. Rekomandimi: AKUM të bashkëpunojë me Avokatin e Shtetit për tu përgatitur dhe ndjekur të gjitha shkallët e gjyqësorit dhe fitimi e këtij gjyqi, me qëllim shmangien e dëmit ekonomik që mund ti shkaktohet buxhetit të buxhetit të shtetit në shumën 77,310,876 leke. Përgjigja e institucionit: Pranuar dhe në proces si rekomandim: Në shkallë të parë është fituar nga ana AKUM. Operatoret ekonomik të s`kualifikuar “B.” & C. & G. Co, kanë iniciuar proces gjyqësor për s`kualifikimin e tyre. Bashkëpunuar me Avokaturën e Shtetit për përgatitjen e mbrojtjes para gjykatës. Në proces gjyqësor, në listë pritje. Komenti i grupit të Auditimit Grupi i auditimit shqyrtoj dokumentacionin bashkëlidhur akt verifikimit. Sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces. Në përfundim të proceseve gjyqësore, në rast se Vendimi i Gjykatës merr formë të prerë dhe është në favor të operatorit të s`kualifikuar, të merren masa për të ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e dëmit që përcaktohet nga vendimi gjykatës. Me hyrjen në fuqi të Vendimit të Gjykatës. Përgjigja e institucionit: Pranuar dhe në proces si rekomandim: Operatorët ekonomik të s`kualifikuar “B.” & C. & G. C kanë iniciuar proces gjyqësor për s`kualifikimin e tyre, proces i cili është në listë pritje. Komenti i grupit të Auditimit Grupi i auditimit shqyrtoj dokumentacionin bashkëlidhur akt verifikimit. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces Referuar këtij rekomanimi i cili në Akt-Verifikimin Nr.1 të Kontrollit të Lartë të Shtetit është pranuar dhe ka qënë në proces, informojmë Akoma nuk ka një datë gjykimi nga Gjykata Administrative e Apelit për shqyrtim.

4. Gjetje nga auditimi: Procedura e prokurimit me objekt, "Rehabilitimi i rrjetit te ujësjellësit te qytetit te Përmetit" me fond limit: 497,705,115 lekë pa TVSH, me fitues operatori Ekonomik "A." me vlerë oferte 489,207,527 lekë. Në këtë procedurë nga 5 operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 4 operatore ekonomik. Ndër operatorët e s'kualifikuar 2 operatorë "G. C" dhe "A. & B. & B&E & L" kanë paraqitur ofertat ekonomike më të ulta se fituesi në vlerën që shkojnë nga rreth 20 milion lekë në rreth 110 milion lekë. Sipas, KVO s'kualifikimi i tyre është sepse nuk plotësojnë disa kërkesa të veçanta, te vendosura në DT, kryesisht që ka të bëjë me mosplotësimin përvojës së mëparshme të suksesshme në ekzekutimin e punë të ngjashme të së njëjtës natyrë. Për këto s'kualifikime, operator "A. & B. & B&E & L" ka bërë ankesë pranë AK e cila nuk e ka pranuar këtë ankesë. Në vijim ky bashkim operatorësh paraqet ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik i cili me Vendim Nr. 527/2017 ka vendosur të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomik "L. & B. & E." & B. N & A.". Me këtë vendim të KPP, ky bashkim operatorësh, nuk ka qenë dakord dhe ka bërë rekurs për pezullimin e këtij vendimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe çështja deri në momentin e këtij auditimi vazhdon të jetë në proces gjykimi në gjykatat administrative.

Meqenëse çështja e s'kualifikimit të këtyre operatorëve vazhdon të jetë akoma në shqyrtim nga gjykatat administrative, auditimi nuk mundi të dalë me vlerësim në lidhje me ligjshmërinë apo jo të këtyre s'kualifikimeve. Megjithatë nisur nga sa u parashtrua më sipërme qëllim shmangien tej zgjatjes së procedurës së prokurimeve që vijnë si pasojë e ankimeve, dhe eliminimin e kostove që kanë operatorët si pasojë e ankimeve por edhe përdorimin pa efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve buxhetore, KVO duhet të ishte me tolerante dhe ti referohej pikës 4 të nenit 53 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" që, mangësitë e konstatuara në dokumentacionin teknik të këtyre operatorëve konsiderohen si, devijime të vogla. Kështu, do të kishim edhe kursim të fondeve buxhetore në vlerën 98,032,681 lekë i cila do të dilte nga diferenca e vlerës së ofertës së operatorit të shpallur fitues dhe vlerës së ofertës së të BO "A. & B & E & B. & L", që është oferta me e ulët ekonomikisht e paraqitur në këtë tender. Rekomandimi: AKUM të bashkëpunojë me Avokatin e Shtetit për tu përgatitur dhe ndjekur të gjitha shkallët e gjyqësorit dhe fitimi e këtij gjyqi, me qëllim shmangien e dëmit ekonomik që mund ti shkaktohet buxhetit të buxhetit të shtetit në shumën 98,032,681 lekë. Përgjigja e institucionit: Pranuar dhe në proces si rekomandim: Shkallë të parë është fituar nga AKUM. Operatorët e s'kualifikuar kanë paraqitur çështjen në gjykatë. Aktualisht nuk ka dalë ende data e gjyqit në Apel (listë pritje) Komenti grupit të Auditimit Grupi i auditimit shqyrtoj dokumentacionin bashkëlidhur akt verifikimit. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces. Në përfundim të proceseve gjyqësore, në rast se, Vendimi i Gjykatës merre formë të prerë dhe është në favor të operatorit të s'kualifikuar, të merren masa për të ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e dëmit që përcaktohet nga vendimi i gjykatës. Me hyrjen në fuqi të Vendimit të Gjykatës Përgjigja e institucionit: Pranuar dhe në proces si rekomandim: Shkallë të parë fituar nga AKUM. Operatorët e s'kualifikuar kanë paraqitur çështjen në gjykatë. Komenti i grupit të Auditimit: Grupi i auditimit shqyrtoj dokumentacionin bashkëlidhur akt verifikimit. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces Referuar këtij rekomandimi i cili në Akt-Verifikimin Nr.1 të Kontrollit të Lartë të Shtetit është pranuar dhe ka qenë në proces, informojmë: Akoma nuk ka një datë nga Gjykata Administrative e Apelit për shqyrtim.

5. Gjetje nga auditimi: Procedura e prokurimit me objekt, "Ujësjetillësi i jashtëm Ersekë nga burimet Mavro dhe Galldishte & Rrjeti i brendshëm i ujësjetillësit Ersekë" me fond limit 363,748,731 lekë pa TVSH, me fitues, operatori ekonomik "A." me ofertë 358,059,753.5

lekë. Në këtë procedurë nga 5 operatorë pjesëmarrës janë s` kualifikuar 4 operatore ekonomik, 3 nga këto operatorë të s` kualifikuar: “B.”, “P.” dhe BO “L & B.-N & “H.” & E.”, kanë paraqitur ofertat ekonomike më të ulët se fituesi që shkojnë nga rreth 10 milion lekë, me TVSH në rreth 72 milion lekë, me TVSH. Sipas, KVO s` kualifikimi i tyre është bërë sepse nuk përmbushin disa kërkesa të veçanta të vendosura në DT dhe kryesisht sepse nuk plotëson përvojë të suksesshme në ekzekutimin e punë të ngjashme të së njëjtës natyrë, kërkesë kjo e vendosur në DT. Për këto s` kualifikime, BO “L & “B.-N & H. & E.” ka bërë ankesë pranë AK e cila nuk e ka pranuar këtë ankesë. Në vijim ky bashkim operatorësh paraqet ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik i cili me Vendimin Nr. 815 date 03.12.2018 ka përfunduar procedimin administrativ për këtë procedurë, duke lënë në fuqi vendimin e KVO për s` kualifikimin e këtij operatori. Me këtë vendim të KPP, ky bashkim operatorësh, nuk ka qenë dakord dhe ka bërë rekurs për pezullimin e këtij vendimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë e cila me vendim nr.159 datë 20.12.2018, nuk ka pranuar kërkesën e këtij operatori. Çështja vazhdon të jetë në proces gjykimi në gjykatën administrative të shkallës së parë Tiranë. Meqenëse çështja e s` kualifikimit të këtyre operatorëve vazhdon të jetë akoma në shqyrtim nga gjykatat administrative, auditimi nuk mundi të dalë me vlerësim në lidhje me ligjshmërinë apo jo të këtyre s` kualifikimeve. Megjithatë nisur nga sa u parashtrua më sipërme qëllim shmangien tej zgjatjes së procedurës së prokurimeve që vijnë si pasojë e ankimeve, dhe eliminimin e kostove që kanë operatorët si pasojë e ankimeve por edhe përdorimin pa eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve buxhetore, KVO duhet të ishte me tolerante dhe ti referohej pikës 4 të nenit 53 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” që, mangësitë e konstatuara në dokumentacionin teknik të këtyre operatorëve konsiderohen si, devijime të vogla. Kështu, do të kishim edhe kursim të fondeve buxhetore në vlerën 71,984,286 lekë, i cila do të dilte nga diferenca e vlerës së ofertës së operatorit të shpallur fitues dhe vlerës së ofertës së operatorëve të tjerë të s` kualifikuar dhe konkretisht, të operatorit “B.”, që është oferta me e ulët ekonomikisht e paraqitur në këtë tender. Rekomandimi: AKUM, të bashkëpunojë me Avokatin e Shtetit për tu përgatitur dhe ndjekur të gjitha shkallët e gjyqësorit dhe fitimi e këtij gjyqi, me qëllim shmangien e dëmit ekonomik që mund ti shkakatohet buxhetit të shtetit në shumën 71,984,286 lekë. Përgjigja e institucionit: Pranuar dhe në proces si rekomandim: Fituar në shkallë të parë, ankimuar nga paditësit në Apel. Në listë pritje për gjykim. Bashkëlidhur Vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë. Komenti i grupit të Auditimit. Grupi i auditimit shqyrtoj dokumentacionin bashkëlidhur akt verifikimit. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces. Në përfundim të proceseve gjyqësore, në rast se Vendimi i Gjykatës merre formë të prerë dhe është në favor të operatorit të s` kualifikuar, të merren masa për të ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e dëmit që përcaktohet nga vendimi i gjykatës. Me hyrjen në fuqi të Vendimit të Gjykatës. Përgjigja Institucionit: Pranuar dhe në proces si rekomandim. Çështja është në Gjykatën Administrative te Apelit, në listë pritje Komenti i grupit të Auditimit: Grupi i auditimit shqyrtoj dokumentacionin bashkëlidhur akt verifikimit. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces. Referuar këtij rekomandimi i cili në Akt-Verifikimin Nr.1 të Kontrollit të Lartë të Shtetit është pranuar dhe ka qenë në proces, ju informojmë se: Akoma nuk ka dale date shqyrtimi ne gjykatën administrative te apelit. 6.Detyrat e KLSH për kontratën nr. 2101, datë 23.07.2015, lidhur me Bashkimin e Operatoreve Ekonomike “A.” SHPK & “Ç” SHPK & “B. B” SHPK & “S. AB” SHPK me objekt: “ Furnizimi me ujë i qytetit të Kukësit dhe të 14 fshatrave përreth “ faza e II” si dhe shtesës së kontratës me nr 1042, datë 24.04.2017 dhe ku Referuar këtij rekomandimi qe në Akt-Verifikimin Nr.1 të Kontrollit të Lartë të Shtetit është pranuar dhe ka qenë në proces, informojmë: Problematika është zgjidhur me Akt-Marrëveshje

Nr.2991 Prot datë 23.11.2020. Dokumentacioni justifikues: Shkrese e AKUM Nr. 1843 prot datë 30.08.2022 drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit Tirane “Kërkesë për informacion” për proceset gjyqësore të cituara më lartë. Shkrese nr. 1339/1 prot datë 07.09.2022 Kthim përgjigje e Gjykatës Administrative të Apelit Tirane, protokolluar pranë AKUM me Nr. 1843/1 prot., datë 12.09.2022.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se AKUM nuk ka raportuar në KLSH mbi zbatueshmërinë e rekomandimeve të lëna. Për sa i takon rekomandimeve të kategorisë *Masa për shpërblim dëmi* rezulton se AKUM ka vijuar përpjekjet për ndjekjen në rrugë gjyqësore të arkëtimeve. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Pjesërisht i zbatuar*.

**18. Gjetje nga auditimi:**-Grupi i Auditimit i ka kërkuar Koordinatorës së Njesisë së Zbatimit të Projektit më datë 26.10.2021 observacionet e AKUM, lidhur me konstatimet dhe gjetjet e KLSH – së, si pas lënies së Akt - Verifikimit Nr. 1, nr. 2494 prot., datë 30.08.2019 (protokolli i brendshëm i AKUKM), ashtu dhe në fazën e Projekt Raportit, si dhe kundërshtimet e Raportit të Auditimit. Me e-mailin e datës 26.10.2021, përgjigja e dhënë nga Koordinatorja e Njesisë së Zbatimit të Projektit “Përmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madhe”, znj. R.K ishte: “Ne vijim.... gjej bashkëngjitur Akt Verifikimin nga Auditimi i KLSH si dhe Raportin Përfundimtar nga Auditimi i vitit 2019. Observacione nga ky auditim nuk u gjet as në zyrë as ne protokoll.... Aktualisht kjo çështje ndodhet në Arbitrazh, Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC) dhe po ndiqet nga Avokatura e Shtetit, e cila na përfaqëson si institucion.... AKUM është në kontakt të vazhdueshëm me Avokaturën e Shtetit duke i asistuar me çdo dokumentacion të kërkuar prej tyre”. Grupit të Auditimit të tilla dokumente nuk i janë vënë në dispozicion nga subjekti.

Ndërkohë që Avokatura e Shtetit, me shkresën nr. 882/33, datë 28.12.2021, me lëndë: “Kërkesë për vënie në dispozicion informacioni/dokumentacioni”, drejtuar KLSH –së, pasi komunikon nevojën për sigurim informacioni dhe/ose çdo dokumenti të prodhuar nga KLSH në kuadër të Programit të Auditimit nr. 362/1, me objekt: “Auditim Përputhshmërie” të kryer pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës – Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, mbi Projektin për Përmirësimin e Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madhe, i ka përcjellë KLSH – së përkatësisht: raportin përfundimtar nr.362/9 prot., datë 28.10.2019 të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe komentet e Konsulentit TEC, J. & E., mbi akt-konstatimet e bëra Kontrollit të Lartë të Shtetit. Mosvënia në dispozicion të grupit të auditimit të dokumentacionit të kërkuar, është në shkelje të Ligjit Nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Neni 26 “Aksesi në dokumentet zyrtare”, paragrafët 1) dhe 2).

*Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 115-123, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**18.1. Rekomandimi:** AKUM pa asnjë rezervë t’i sigurojnë audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit akses të plotë në dokumentet zyrtare, objekt auditimi.

***Në vijimësi***

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** *Nga ana e AKUM janë marrë e nevojshme për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar në vijimësi të raporteve institucionale.*

**Komenti i audituesve:** Ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi*, megjithatë konfirmimi i tij do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.



## **C. MASA SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratës nr. 3889 prot., datë 31.12.2019 me objekt “Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit”, me vlerë 320,833,499.7 lekë me TVSH, me afat të zbatimit të punimeve 12 muaj, lidhur midis BOE “L. & B. & A.K & B.”, SHPK të përfaqësuar nga OE “L” SHPK dhe Autoritetin Kontraktor i përfaqësuar nga z. A.B rezultoi se: Nga auditimi i dosjes teknike të kontratës, krahasimi i librezës së masave, situacionit progresiv, projektit të miratuar me ndryshime, etj. rezultoi se i janë likuiduar 4 zëra punimesh të situacionuara por të pakryera në fakt në vlerën **10,880,258** lekë pa TVSH, (Aneksi 2.6.2.1). Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nën pikat 3.2 dhe 3.3 si dhe me kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes me objekt “Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit” lidhur sipas aktit nr. 3166 prot., datë 23.10.2019.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 74-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**1.1 Rekomandimi:** Nga ana e AKUM të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës **10,880,258** lekë pa TVSH nga sipërmarrësit BOE “L. & B. & A. K. & B.” SHPK sa përfituar padrejtësisht punime të pakryera por të likuiduara.

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: I pranuar

**Komenti i subjektit:** *Me shkresën me nr. 618 prot., datë 07.04.2022 dhe shkresën me nr. 2345 prot., datë 07.11.2022 rezulton se nga ana e Titullarit janë ngritur përkatësisht grupi i punës për monitorimin e përfundimit të punimeve dhe një grup pune për të monitoruar rekomandimet e lëna nga KLSH. Në vijim të këtyre Urdhrave, nga punonjësit e ngarkuar janë kryer inspektimet përkatëse në përfundim të të cilave komisionet kanë hartuar relacionet. Komisioni i ngritur me Urdhër nr. 2345 prot., datë 07.11.2022 me përbërje të tij z. A.K, znj. A.Xh dhe z. G.Ll, me Memon e datës 28.12.2022 ka sugjeruar fillimin e procedurave të kolaudimit. Me shkresën nr. 2542 prot., datë 09.12.2022 BOE L. & B. & A. K. & B. , ka dorëzuar pranë AK-së Njoftim për përfundim punimesh duke theksuar faktin se punimet, me përjashtim të zërit Montim Pompash kanë përfunduar në 15.03.2022 (shkresa me nr. 516 prot., datë 23.03.2022) dhe në njoftimin e kësaj date (28.12.2022) ka përfunduar edhe montimi i pompave pas ndërtimit të godinës së re.*

Për sa më sipër është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 994 prot., datë 09.11.2023 nga ana e BOE L. & B. & A. K. & B. nga ana e të cilëve pretendohet si më poshtë trajtuar.

**Pretendimi i subjektit:**

*“Janë zbatuar me përpikmëri parashikimet e kontratës së sipërmarrjes nr. 3889 prot., datë 31.12.2019, projektit të zbatimit, specifikimeve teknike dhe ofertës ekonomike të shpallur fituese. Nga Bashkia Elbasan në rolin e përfituesit të investimit dhe juridiksionit territorial të zonës ku do realizohet ky investim, është miratuar leja infrastrukturore, me vendimin nr. 985/7 datë 17.03.2020 për realizimin e punimeve të këtij objekti. Gjithashtu, po nga Bashkia Elbasan është miratuar leja e ndërtimit me nr. 985/10 prot., datë 04.06.2020. Me vendimin nr. 985/7, datë Leja infrastrukturore Bashkia Elbasan ka përcaktuar vend-depozitimin e mbetjeve ndërtimore të krijuara për këtë objekt gjatë realizimit të punimeve ku në pikën nr. 10 të dispozitivit të saj është vendosur se: Në zbatim të VKB nr. 66, datë 23.05.2019, Zhvilluesi është i detyruar që mbetjet*

ndërtimore ti depozitohet në jug të Fshatit Vidhas, NJA Papër, më truall shtet me nr. pasurie 52/26 me kapacitet maksimal 1,000,000 ton/vit nën juridiksionin e Bashkisë Elbasan. Materiali i dalë rishtazi gjatë realizimit të punimeve është grumbulluar në kantier dhe më pas është transportuar me kamionët e sipërmarrësve të punimeve në vend depozitimet e përcaktuara nga Bashkia Elbasan, në Fshatin Vidhas, NJP Papër. Bashkia Elbasan me shkresën nr. 749 prot., datë 10.02.2022 deklaroi se: Pas përfundimit të punimeve Shoqëritë L. & B. & A. K. & B. kanë bërë pastrimin e territorit rreth objekteve të ndërtuara nga mbetjet e ndryshme ndërtimore dhe inertet, dhera si dhe transportimin, depozitimin e tyre në vend-depozitimin në jug të fshatit Vidhas NJA Papër. ... (vijon observacioni)”

#### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH<sup>-së</sup>:**

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe atij të paraqitur me observacionet e dërguara sipas shkresës së administruar në KLSH me nr. 994 prot., datë 09.11.2023 rekomandimet e mësipërme të praktikës me objekt ‘Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit’ do të vlerësohen plotësisht në vijim në auditimin e ardhshëm që do të zhvillohet pranë AKUM. Për sa më sipër rekomandimet e kësaj praktike do të konsiderohen Të pranuar dhe statusi i rekomandimit cilësohet si Në proces.

**2. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratës nr. 2446 prot., datë 26.08.2019 me objekt “Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë”, me vlerë 462,629,496 lekë me TVSH, me afat të zbatimit të punimeve 12 muaj, lidhur midis BOE “V.H & B. & E.”, SHPK të përfaqësuar nga OE “V.H” SHPK dhe Autoritetin Kontraktor i përfaqësuar nga z. A.B rezultoi se:

Nga auditimi i dosjes teknike të kontratës, krahasimi i librezës së masave, situacionit progresiv, projektit të miratuar me ndryshime, etj. rezultoi se i janë likuiduar 17 zëra punimesh të situacionuara por të pakryera në fakt në vlerën **8,364,636** lekë pa TVSH, (Aneksi 2.6.1.1). Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3 si dhe me kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes me objekt “Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit” lidhur sipas aktit nr. 1226 prot., datë 26.04.2019.

Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 74-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**2.1 Rekomandimi:** Nga ana e AKUM të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës **8,364,636** lekë pa TVSH nga sipërmarrësit BOE “V.H & B. & E.” SHPK sa përfituar padrejtësisht punime të pakryera por të likuiduara.

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: I pranuar

**Komenti i subjektit:** Nga ana e AKUM janë marrë e nevojshme për mbajtjen nga pagesat pasardhëse ndaj BOE “V.H & B. & E.” të shumën prej 8,364,636 lekë pa TVSH.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht shkresës me nr. 1055/1 prot., datë 13.07.2023 drejtuar Mbikëqyrësit dhe Kontraktorit për ndalimin e vlerës totale prej **49,799,585.2 lekë** (ku përfshihet edhe vlera e cituar më sipër) në situacionin përfundimtar është bërë njoftimi i sipërmarrësit për ndalimin e shumës prej **8,364,636 lekë pa TVSH** nga shuma totale. Gjithashtu, aktualisht kjo shumë rezultoi të papaguar ndaj tij. Nisur nga

sa më sipër ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *I zbatuar*, megjithatë konfirmimi i tij do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**3. Gjetje nga auditimi:** Gjatë zbatimit të kontratës “Ndërtim i kolektorit kryesor të ujërave të zeza dhe I.T.U.P në Gjirin e Lalzit”, janë bërë ndryshime të cilat kanë rezultuar edhe me zëra të rinj punimesh. Nga verifikimi i analizës së kostos së tyre, konstatohen mangësi si më poshtë:

- Sipas zërit 2.2.5 (2.116 + an.23) “Rrethim me mur me blloqe betoni, kanxhella dhe derë hyrëse”, por edhe për rrethimet e stacioneve të pompave, është përfshirë zë i ri i punimeve “Trarë themeli beton monolit C 20/25”. Çmimi i aplikuar për këtë zë është 15,145 lekë/m<sup>3</sup>. Nga analiza e çmimit konstatohet se ka rritje të sasisë për zërin kallëpe konkretisht, kallëp muri nga përcaktimi në manual në sasinë 3.5 m<sup>2</sup>, është aplikuar sasia 10 m<sup>2</sup> dhe kallëp trari nga 3.5 m<sup>2</sup> në 4 m<sup>2</sup>. Çmimi i betonit C 20/25 në manual është 5,388 lekë/m<sup>3</sup>, ndërsa në analizën e re është paraqitur 6,629 lekë/m<sup>3</sup>. Çmimi i betonit është rritur me pretendimin se duhet përdorur betopompa, por në këtë rast nuk kemi hedhje të betonit në lartësi. Nga ribërja e llogaritjeve rezulton se çmimi që duhet të aplikohet të ishte 12,376 lekë/m<sup>3</sup>. Sipas këtij zëri është likuiduar sasia 148.8 m<sup>3</sup>. Vlera **412,027 lekë** [148.8 m<sup>3</sup> x (15,145 – 12,376)], është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “S. AG” SHPK dhe përbën dëm ekonomik.

- Sipas zërit 2.2.5 (2.116 + an.23) “Rrethim me mur me blloqe betoni, kanxhella dhe derë hyrëse”, për kolonat metalike profil katror me dimensione (5 x 5 cm x 1.5 mm), me lartësi 1.75 m, është aplikuar çmimi 4,660 lekë për copë. Nga verifikimi i këtij çmimi në sitin e Subjektit “Megatek”, rezulton se për profil me gjatësi 6 m, çmimi është 3,140 lekë, ose 1050 lekë për kolonë (890 lekë + 18 % struktura). Nga verifikimi i manualit të çmimeve të ndërtimit viti 2015, rezulton se çmimi i hekurit profil dhe shirit është 94 lekë për kg, ose 827.2 lekë për kolonë. Duke marrë në konsideratë çmimin e tregut (1050 lekë për kolonë) si dhe numrin 277 copë impianti dhe 53 copë stacionet e pompimit), vlera **1,191,300 lekë** [(4,660 lekë – 1,050 lekë) x 330 copë], është përfituar padrejtësisht nga kontraktori “S. AG” dhe përbën dëm ekonomik.

- Nga shqyrtimi i zërit 1.1.B.3 “Mbikalim i linjës me presion” rezulton se janë përfshirë konstruksione metalike për mbështjen e tubit në sasinë 16.43 ton, me çmim 216,364 lekë/ton. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në konstruksione metalike është përfshirë tubacioni me diametër Ø 711 mm dhe spesor 11 mm, me gjatësi 82 m. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në kontratën bazë, për ndërtimin e kalimit ishte parashikuar çmimi për tubacion çeliku është 187,111 lekë për ton dhe i konstruksionit metalik 216,364 lekë/ton. Sa më sipër, çmimi i tubit të çelikut duhet të ndahej nga çmimi i konstruksioneve metalike. Pesha e tubit e përcaktuar konstruksion është 15.3 ton. Vlera **447,571 lekë** (216,364 -187,111) x 15.3 ton, është përfituar padrejtësisht nga kontraktori “S. AG” dhe përbën dëm ekonomik.

- Nga shqyrtimi i zërit “Propozime shtesa V.O”, nënzëri “Rezervuar betoni me volum 36.9 m<sup>3</sup>”, janë përfshirë punime elektrike, kablo, kablo tokëzimi, ndriçues infrastrukture, për mbrojtjen nga zjarri dhe pompat, është parashikuar vlera 1,593,879 lekë. Nga verifikimi i analizës së çmimeve të detajuar rezulton se është përfshirë transport me vlerë 1,870 lekë, materiale ndërtimi me vlerë 1,364,169.5 lekë pa përfshirë 18 % të fitimit dhe shpenzime të përgjithshme (63,771 lekë transport, 76,525 lekë ngjeshje tabani dhe 1,223,873 lekë shtresë çakulli). Vendosja e vlerës së mësipërme pa asnjë argumentim, për zëra që nuk kanë të bëjnë me punime elektrike, si dhe duke marrë në konsideratë se sistemi zjarrfikës parashikohet më vete, vlera e likuiduar në shumën **1,539,879 lekë**, është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “S. AG” SHPK dhe përbën dëm ekonomik.

-Sipas zërit “Ndërtim linje elektrike kabllore nëntokësore me kablo 24 kV, ALXLPE. 3 x 1 x 240/25 mm<sup>2</sup>, sipas rregullores së OSHEE, sipas tipologjisë së zonës ku kalon linja, mufta dhe

terminale për kabllot, tuba çeliku Ø 160 mm për intersektimet me rrugë të linjës, shtresë mbrojtëse me tulla të plota dhe shirit sinjalizues”, rezulton se analiza e çmimit është rishikuar për të gjithë elementët dhe jo vetëm për elementët e shtuar. Në këtë analizë çmimi, sa i përket shtresës mbrojtëse me tulla të plota, krahas materialit dhe punëtorisë, është përfshirë edhe zëri makineri, zë i cili mund të përfshihet në rast të ndërtimit të murit dhe jo shtresë me tulla. Vlera **130,060 lekë** (20,150 x 18% x 5.47 km), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “S. AG” SHPK dhe përbën dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të ndërtimit” i ndryshuar, pika 2 dhe 11, Udhëzimi i Këshillit Të Ministrave nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” si dhe VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, pika 4.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 74-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**3.1. Rekomandimi:** AKUM të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **3,720,837 lekë**, nga Kontraktori BOE “S. AG” SHPK, përfituar padrejtësisht si pasojë e mangësive në hartimin e analizës së kostos së punimeve të ndërtimit.

*Menjëherë*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** *Nga ana e AKUM është mbajtur diferenca e ardhur si pasojë e mangësive në drejtim të hartimit të analizave për zërat e rinj.*

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht shkresës me nr. 410 prot., datë 03.03.2022 nga ana e AKUM i është mbajtur kontraktorit të punimeve S. AG shuma përkatëse prej **3,720,837 lekë pa TVSH** e ardhur si pasojë e mangësive në drejtim të hartimit të analizave të çmimeve për zërat e rinj. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *I zbatuar*. Megjithatë konfirmimi i tij do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

## **D. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me zbatimin e kontratës me objekt ‘Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë’, rezultoi se punimet e konsideruara si të përfunduara nga palët (sipërmarrës, mbikëqyrës) nuk janë kolauduar nga ana e Grupit të Punës të ngritur me Urdhrin nr. 1136 prot., datë 31.05.2021 gjithashtu nga ana e Autoritetit Kontraktor nuk është miratuar situacioni përfundimtar i punimeve dhe as ai i përdorimit të fondit rezervë. Grupi i punës më datën 22.04.2021 ka miratuar situacionin nr. 5 i cili nga ana e sipërmarrësit është dorëzuar me datë 02.03.2021 dhe nga ana e mbikëqyrësit të punimeve më datën 02.03.2021, kur si datë e përfundimit të punimeve ishte parashikuar data 15.02.2021. Autoriteti Kontraktor gjatë periudhës në auditim nuk ka paraqitur dokumentacion për marrjen në dorëzim dhe miratim të situacionin përfundimtar nr. 6, por për ta konfirmuar atë nëse është apo jo i vërtetë dhe nëse punimet janë kryer konform kontratës së sipërmarrjes. Nga ish Titullarit z. C.K, me Urdhrin nr. 69, datë 07.10.2021, administruar në AKUK me nr. 1926, prot., datë 07.10.2021, “Për monitorimin e situacionit përfundimtar nr. 6 dhe fondit rezervë” është ngritur Grupi i Punës. Ky Grup Pune ka hartuar një shkresë drejtuar Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse

duke vënë në dijeni edhe Titullarin mbi faktin se në stacionin 102/1 ku mblidhen prurjet e të gjitha stacioneve të tjera, pompat e reja të vendosura me investimin e realizuar nga sipërmarrësi BOE V.H & B. & E., ishin nxjerrë jashtë stacionit të pompimit dhe ishin çmontuar nga vetë UK Vlorë me argumentin se në reshjet e fundit në qytetin e Vlorës këto pompa nuk arrinin të përçonin prurjen maksimale duke shkaktuar përmytje. Për këtë arsye nga ana e Grupit të Punës u la si detyrë që kontraktori të bënte dhe një herë kontrollin mbi konfigurimin e pompave nëse defekti fillon aty apo nga projektuesi në kriteret e projektimit për pompat që ka vendosur në projekt, pasi kontraktori thekson se çdo pompë është marrë sipër specifikimeve teknike përkatëse të projektit. Në fakt sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nuk disponohen testimet e kryera në zbatim të pikës 4.16 TESTIMI DHE INSPEKTIMI I PAJISJEVE të dokumentit me titull Rehabilitimi i Sistemit të Stacioneve të Pompimit të K.U.Z Vlorë, Specifikimet Teknike. Në përfundim, rezulton se edhe pas datës në të cilën punimet duhet të kishin përfunduar, ky grup pune ka lenë rekomandime sikur kontrata të ishte ende në proces apo si të ishte grup kolaudimi dhe nga asnjë prej palëve përgjegjës nuk janë marrë masa për aplikimin e penalteteve duke favorizuar padrejtësisht sipërmarrësin e punimeve. Situacionet dhe likuidimet përkatëse paraqiten sipas tabelës së paraqitur në Aneksin nr. 2.6.1.2. Duke patur parasysh se vlera e kontratës pas ndryshimeve dhe miratimeve të marra nga ana e Projektuesit dhe Autoritetit Kontraktor është në masën 441,699,656 lekë me TVSH rezulton se punimet e pa miratuara dhe të pa marra aktualisht në dorëzim nga ana e Autoritetit Kontraktor janë në vlerën 163,931,250 lekë me TVSH, ose 37 % e vlerës së kontratës. Nga ana e ish – Titullarit të Autoritetit Kontraktor z. C.K, ish – zv. Drejtorit të Përgjithshëm z. F.Sh si dhe mbikëqyrësi i punimeve BOE D. & HE – SK nuk janë marrë masa për aplikimin e penalteteve për vonesa në përfundimin në afat të zbatimit të kontratës dhe realizimin e punimeve, kjo në zbatim të nenit 38 të lidhur sipas aktit nr. 2446 prot., datë 26.08.2019, e ndryshuar. Konkretisht rezulton se ndaj sipërmarrësit të punimeve nuk janë aplikuar penaltetet për dorëzimin me vonesë të situacionit nr. 5 dhe mos dorëzimit deri aktualisht të situacionit nr. 6 i përlogaritur sipas tabelës së paraqitur në aneksin nr. 2.6.1.3. Vlera e pa aplikuar e penalteteve prej **25,715,880 lekë përbën përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve të AKUM** për shkak të mos arritjes së funksionit kryesor të këtij investimi dhe si e tillë ka rënduar situatën financiare të AKUM dhe atë funksionale të investimit në Ujësjellës Kanalizime Vlorë. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 10 296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 8, pika 1, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 77 Mbikëqyrja e kontratës, Kontrata e sipërmarrjes së punimeve të lidhur sipas aktit nr. 2446 prot., datë 26.08.2019, e ndryshuar, neni 38 si dhe me kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes me objekt ‘Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë’.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 74-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**1.1 Rekomandimi:** Nga AKUM të merren masat e nevojshmet për nxjerrjen e përgjegjesisë dhe shmangien e praktikave të cilat ndikojnë në përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve si pasojë e mos përmbushjes së qëllimeve kryesore të investimeve në vlerën prej **25,715,880 lekë pa TVSH** e shkaktuar në kontratën e lidhur mes sipërmarrësit BOE “V.H & B. & E.” si penaltet i aplikuar për vonesa në realizimin e kontratës së sipërmarrjes të lidhur sipas aktit me nr. 2446 prot., datë 26.08.2019 me objekt ‘Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë’.

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: I pranuar

**Komenti i subjektit:** *Nga ana e AKUM janë marrë e nevojshme për mbajtjen nga pagesat pasardhëse ndaj BOE “V.H & B. & E.” të shumën prej 25,715,880 lekë pa TVSH.*

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht shkresës me nr. 1055/1 prot., datë 13.07.2023 drejtuar Mbikëqyrësit dhe Kontraktorit për ndalimin e vlerës totale prej **49,799,585.2 lekë** (ku përfshihet edhe vlera e cituar më sipër) në situacionin përfundimtar është bërë njoftimi i sipërmarrësit për ndalimin e shumës prej **25,715,880 lekë pa TVSH** nga shuma totale. Gjithashtu, aktualisht kjo shumë rezulton e papaguar ndaj tij. Nisur nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *I zbatuar*, megjithatë konfirmimi i tij do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**2. Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë humbur 10 çështje gjyqësore, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **126,031,384 lekë e cila përbën efekt financiar negative për buxhetin e shtetit**; si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës në vlerën 8,740,707 lekë, si dëmshpërblime për shpronësime në masë të pa drejtë në vlerën 19,850,459 lekë dhe si dëmshpërblim për kontratat e investimit në vlerën 97,440,218 lekë, shpenzime përmbarrimore për këto vendime kapin vlerën e 6,443,953 lekë dhe shpenzimet gjyqësore në vlerën 851,287 lekë.

*Më hollësisht trajtuar në Pikën 2, faqe 22 deri 28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**2.1. Rekomandimi:** Nga Drejtori i Përgjithshëm, Departamenti Ligjor dhe Departamenti i Ekonomik i AKUM të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të gjitha proceseve gjyqësore të iniciuara ndaj Institucionit, për menaxhimin sa më të mirë të fondeve publike. Drejtuesit e institucionit duhet të shmangin në maksimum detyrimin e tarifave përmbarrimore dhe likuidimin e detyrimeve të rrjedhura nga vendimmarrjet e gabuara në mënyrë vullnetare për të shmangur tarifën përmbarrimore që kanë kapin vlerën e 6,443,953 lekë. Në çdo rast të nxirren përgjegjësitë dhe të merren masat e duhura.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** *Në lidhje me Rekomandimin për ndjekjen e proceseve gjyqësore, Titullari i AKUM ka nxjerrë Urdhër të brendshëm nr. 305 prot., datë 17.02.2022, ku urdhëron Sektorin Ligjor dhe Prokurimeve të ndjekë rregullisht me përgjegjësi, profesionalizëm dhe korrektësi të gjitha proceset gjyqësore të iniciuara ndaj Institucionit në të gjitha shkallët e gjyqimit me anë të përfaqësimit në çdo seance gjyqësore nga juristët e këtij Sektori. Në zbatim të këtij Urdhri, janë marrë të gjitha masat për ndjekjen me korrektësi dhe profesionalizëm të të gjitha proceseve gjyqësore.*

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër si dhe nga natyra e tij, ky rekomandim do të konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimit*, megjithatë konfirmimi i tij do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**3. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit me objekt “*F.V Matësa prodhimi/konsumi dhe pajisje për ndërmarrjet Durrës, Elbasan, Lushnjë, Vlore, Fier, Kavajë*”, me fond limit 365,599,130 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2019, është kualifikuar:

a. BOE “G. E. S ve T.” & “A SHPK, me ofertën në vlerën 300,631,377 lekë pa TVSH, i shpallur fitues.

Nga auditimi i DST, dokumenteve të paraqitura nga BOE “G. E. S ve T.” & “A” SHPK u konstatua se BOE i mësipërm nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara sipas DST, konkretisht si më poshtë:

- Shoqëria “A” SHPK nuk përmbush kriterin 2.3 Për kapacitetin teknik, pika 1.a për përvojën e suksesshme në realizimin e të paktën: “Kontrate e ngjashme për furnizim me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet të realizuar gjatë tri viteve të fundit, datë e përllogaritur nga data e hapjes së ofertave”.

Referuar kontratës së bashkëpunimit kjo shoqëri ka marrë përsipër të kryejë 30% të të punimeve, konkretisht fondi limit 365,599,130 lekë \* 30%=**109,679,739 lekë** pa TVSH.

Nga auditimi dokumenteve të paraqitur nga ky OE në SPE rezulton se shuma e punëve të ngjashme të kryera në asnjë rast nuk e kalojnë shumën 50,000,000 lekë ose **13.6%** e fondit limit.

- Shoqëria A nuk plotëson kërkesat për stafin teknik pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për inxhinierët e kërkuar në DST si: 1 (një) Inxhinier Mekatronik dhe 6 (gjashtë) Inxhinier Elektronik.

KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “G. E. S ve T.” & “A” SHPK, me ofertën, 300,631,377 lekë pa TVSH, duke mos plotësuar kriteret e kërkuara në DST, veprime në kundërshtim me nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve” e nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, duke shkaktuar efekt negativ financiar me vlerë **2,283,077 lekë**.

*Më hollësisht trajtuar në Pikën 5, faqe 48 deri 74, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**3.1.Rekomandimi:** AKUM nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të miratuara në DST, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** *Nga ana e AKUM janë marrë të gjitha masat e nevojshme për verifikimin e plotë të dokumentacionit të OE të shpallur fitues.*

**Komenti i audituesve:** Nisur nga deklaratat e mësipërme ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi* megjithatë konfirmimi i tij do të kryhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i punimeve të realizuara në objekt sipas kontratës “Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura në zonën bregdetare Dhralë, Palasë, Lot i parë”, u konstatuan mangësitë si më poshtë:

- Tek impianti i trajtimit të ujërave të ndotura nuk është realizuar zëri mbushje me dhe humosor t=15 cm, mbi soletën e ITUN.

- Trotuari nuk është ndërtuar sipas specifikimeve teknike pasi nuk është realizuar me pllaka, por me shtresë betoni, në sasinë 80 m<sup>2</sup> për sheshin e impiantit dhe 16 m<sup>2</sup> për stacionin e pompave. Gjithsesi, për këtë trotuar janë realizuar shtresa betoni. Vlera e likuiduar për këtë zë punimi në shumën 153,000 lekë (96 m<sup>2</sup> x 1,600 lekë/m<sup>2</sup>), përbën efekt negativ financiar, pasi konsiderohet funksional.

- Portat hyrëse në impiant dhe stacion pompimi janë ndërtuar me peshë 0.21 ton, ndërsa është certifikuar me peshë 1.7 ton, sipas llogaritjeve si më poshtë:

Elementët e portës 5 x 5 cm (t=4mm), gjatësi 16 ml, me peshë 98 kg.

Kolonat e mbajtëse, profil 8 x 8 cm (t=8 mm), gjatësi 4 m, me peshë 72 kg.

Rrjeta mbushëse me peshë 40 kg.

Diferenca në peshë rezulton 1.49 ton (1.7 ton – 0.21 ton). Pavarësisht peshës së vendosur, dyert janë funksionale. Vlera 551,300 lekë (1.49 ton x 185,000 lekë/ton x 2 copë), përbën efekt negativ financiar.

- Sipas zërit I.1.An 34 “Konstruksion metalik çelik i pa oksidueshëm (shkallët, zgarat, kapakët etj.), është certifikuar sasia 2 ton, me çmim 325,000 lekë. Nga verifikimi ilibrezës së masave rezulton se për kapakët e pusetave është certifikuar sasia 1.96 ton. Nga verifikimi në terren i punimeve rezulton se kapakët janë ndërtuar me llamarinë me trashësi 2.5 mm. Nga përlogaritjet, rezulton se për puseta me dimensione 140 cm x 140 cm (8 copë), pesha e llogaritur është 0.12 ton për copë, ndërkohë që nga llogaritjet për materialin e vendosur faktik rezulton se një kapak pusete peshon 0.06 ton. Për kapakët e pusetave me dimensione 100 cm x 100 cm (12 copë), pesha e llogaritur është 0.08 ton, ndërkohë që nga llogaritjet sipas realizimit faktik rezulton pesha 0.035 ton. Sa më sipër është certifikuar më shumë sasia 1 ton (0.48 ton + 0.54 ton). Pavarësisht se kapakët e kryejnë funksionin e përcaktuar, vlera 325,000 lekë (1 ton x 325,000 lekë), konsiderohet efekt negativ financiar dhe vlera e plotë e efektit negativ është me vlerë **1,029,300 lekë**.

Nga verifikimi i punimeve në objekt u konstatuan muri anësor prej beton arme ka pësuar çedim, duke u spostuar në pjesën e fugave. Ky spostim nuk është në distancë të konsiderueshme, por mund të krijojë problem me kalimin e kohës në qëndrueshmërinë e impiantit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, kreu III, pika 4.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 74-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**4.1. Rekomandimi:** AKUM në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa duke i kërkuar kontraktorit përmirësimin dhe rregullimet përkatëse të identifikuar si dhe të realizojë zërin mbushje me dhe humosor mbi soletë, brenda periudhës së garancisë së defekteve.

### ***Brenda periudhës së garancisë së punimeve.***

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** *Është zbatuar rekomandimi i KLSH. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht shkresës me nr. 282 prot., datë 16.02.2022 drejtuar OE GJ. sipas rekomandimit të KLSH si dhe shkresës me nr. 1380 prot., datë 07.07.2022 “Mbi garancinë e punimeve të objektit Impianti i trajtimit të ujerave të ndotura në zonën bregdetare Dhrale Palasë Loti i parë” është sqaruar fakti se nga ana e Titullarit të AK është ngritur me shkresën nr. 1188 prot., datë 21.06.2022 Grupi i Punës i cili ka verifikuar dhe njëkohësisht konfirmuar zbatueshmërinë e rekomandimeve në datën 24.06.2022.*

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *I zbatuar*.

## **E. MASA ADMINISTRATIVE**

**E. I -** Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12 Kreu III, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i



**rekomandojmë**, Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Elbasan, të vlerësojë shkeljet e konstatuara:

1. Subjektit “A. M.” SHPK me përfaqësues ligjor E.M, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.2892/2, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin ‘Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmes dhe qytetin e Elbasanit’, për certifikimin e punimeve të pakryera të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike me pasojë dëm ekonomik vlerën **10,880,258 lekë pa TVSH**.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 74-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**E. II** - Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Vlorë, të vlerësojë shkeljet e konstatuara:

2. Nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “D.” SHPK me përfaqësues ligjor S.G & “H. & S.” SHPK me përfaqësues ligjor F.B, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin ‘Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë’, për certifikimin e punimeve të pakryera të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike me pasojë dëm ekonomik vlerën **8,364,636 lekë pa TVSH** si dhe mungesën e aplikimit të penalteteve për vonesa në përfundimin në afat të punimeve, me pasojë përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe economicitet në vlerën **25,715,880 lekë pa TVSH**.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 74-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**E. III** - Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12 Kreu III, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Durrës, të vlerësojë shkeljet e konstatuara:

Shoqëria “T.” SHPK, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin “Ndërtim i kolektorit kryesor të ujërave të zeza ITUP, në zonën turistike të Gjirit të Lalzit, Durrës”, nuk ka verifikuar me korrektësi analizat teknike të çmimeve për zëra të rinj të punimeve, me pasojë dëm ekonomik me vlerë 3,720,837 lekë.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 74-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Pranueshmëria e rekomandimit: I pranuar

**Komenti i subjektit:** *Rekomandimi nuk ka qenë i qartë për sa i takon adresimit se nga kush do të njoftohej Kryeinspektori i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor të zonës në të cilën është kryer investimi i rezultuar me shkelje. Megjithatë do të kemi në konsideratë në vijimësi në investimet e ardhshme.*

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *I pazbatuar*.

## **F. MASA DISIPLINORE**

Bazuar e në referim të nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe kontratës individuale të punës, neni 11, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të AKUM fillimin e procedurave për dhënie masë disiplinore, si më poshtë:

**“Vërejtje”, për:**

**1. znj. L.V,**

**2. z. A.Ç**

Në procedurën e prokurimit me objekt “Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmes dhe qytetin Elbasan”, kanë hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës.

Znj. L.V nuk ka inventarizuar dosjet e prokurimit.

Në procedurën e prokurimit me objekt “Përmirësimi i infrastrukturës së ujërave të zeza në zonën bregdetare Vlorë”, ka hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës.

Znj. A.C, në procedurën e prokurimit me objekt “Impiant i Trajtimi të Ujërave të Ndotura dhe sistemi KUZ Drimadhe, Dhermi”, si anëtare e NjP, ka hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës. Znj. A.C, në procedurën e prokurimit me objekt “Furnizimi me ujë i zonave turistike Drimadhes, Dhërmi dhe përmirësimi i rrjetit të ujësjetillësit të fshatit Dhërmi”, ka hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës, si dhe në zbatimin e procedurës së prokurimit “F.V Matësa prodhimi/konsumi dhe pajisje për ndërmarrjet Durrës, Elbasan, Lushnjë, Vlore, Fier, Kavajë”, kanë kualifikuar dhe shpallur fitues një B, pasi nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara në DST, në lidhje me punë të ngjashme dhe stafin teknik.

**3. z. A.B**

**4. z. E.S, në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit për arsye se:**

Në procedurën e prokurimit me objekt “Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmes dhe qytetin Elbasan”, kanë hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës. z. E.S, nuk ka inventarizuar dosje prokurimi.

z. A.B, në procedurën e prokurimit me objekt “F.V Matësa prodhimi/konsumi dhe pajisje për ndërmarrjet Durrës, Elbasan, Lushnjë, Vlore, Fier, Kavajë”, ka hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës.

**5. znj. M.M, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit për arsye se:**

Në procedurën e prokurimit me objekt “Impiant i Trajtimi të Ujërave të Ndotura dhe sistemi KUZ Drimadhe, Dhermi”, kanë hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës. Në procedurën e prokurimit me objekt “Furnizimi me ujë i zonave turistike Drimadhes, Dhërmi dhe përmirësimi i rrjetit të ujësjetillësit të fshatit Dhërmi”, kanë hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës. Nuk ka kryer inventarizime të dosjeve të prokurimit, si dhe në procedurën e prokurimit me objekt “F.V Matësa prodhimi/konsumi dhe pajisje për ndërmarrjet Durrës, Elbasan, Lushnjë, Vlore, Fier, Kavajë”, kanë hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës.

**6. z. J.O, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit për arsye se:**

Në procedurën e prokurimit me objekt “Përmirësimi i infrastrukturës së ujërave të zeza në zonën bregdetare Vlorë”, kanë hartuar kriteret të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës.

**7.z. J.Gj,**

**8. z. A.M,**

**9. z. Z.I, në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit për arsye se:**

Në procedurën e prokurimit me objekt “F.V Matësa prodhimi/konsumi dhe pajisje për ndërmarrjet Durrës, Elbasan, Lushnjë, Vlore, Fier, Kavajë”, kanë hartuar kriteret të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës. z. J.Gj dhe A.M, në zbatimin e procedurës së prokurimit “Përmirësimi i infrastrukturës së ujërave të zeza në zonën bregdetare Vlorë”, kanë kualifikuar dhe shpallur fitues BOE, *i renditur i katërti*, me vlerë 389,375,085 lekë, pasi nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara në DST. z. J.Gj dhe z. Z.I, gjatë zbatimit të kontratës “Ndërtim i kolektorit kryesor të ujërave të zeza ITUP, në zonën turistike të Gjirit të Lalzit, Durrës”, sa i përket çmimeve për zëra të rinj punmesh, janë konstatuar mangësi në hartimin e analizave teknike, me pasojë dëm ekonomik me vlerë 3,720,837 lekë.

**10. z. S. Z.**

**11. z. G.LI, në cilësinë e anëtarëve të KVO, për arsye se:**

Në zbatimin e procedurës së prokurimit “F.V Matësa prodhimi/konsumi dhe pajisje për ndërmarrjet Durrës, Elbasan, Lushnjë, Vlore, Fier, Kavajë”, kanë kualifikuar dhe shpallur fitues një BOE, pasi nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara në DST, në lidhje me punë të ngjashme dhe stafin teknik. Z. F.M, në zbatimin e procedurës së prokurimit “Përmirësimi i infrastrukturës së ujërave të zeza në zonën bregdetare Vlorë”, kanë kualifikuar dhe shpallur fitues BOE, *i renditur i katërti*, me vlerë 389,375,085 lekë, pasi nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara në DST. z. F.M, Gjatë zbatimit të kontratës “Ndërtim i kolektorit kryesor të ujërave të zeza ITUP, në zonën turistike të Gjirit të Lalëzit, Durrës”, sa i përket çmimeve për zëra të rinj punimesh, janë konstatuar mangësi në hartimin e analizave teknike, me pasojë dëm ekonomik me vlerë 3,720,837 lekë.

**12. z. G. A., në cilësinë e anëtarit të grupit të negocimit, për arsye se:**

Gjatë zbatimit të kontratës “Ndërtim i kolektorit kryesor të ujërave të zeza ITUP, në zonën turistike të Gjirit të Lalëzit, Durrës”, sa i përket çmimeve për zëra të rinj punimesh, janë konstatuar mangësi në hartimin e analizave teknike, me pasojë dëm ekonomik me vlerë 3,720,837 lekë.

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** *Rekomandimi është në proces.*

**Komenti i audituesve:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht shkresës me nr. 71/3 prot., datë 20.05.2022 drejtuar 11 punonjësve nga 12 të rekomanduar nga ana e KLSH (me përjashtim të z. E.S) janë njoftuar punonjësit për fillimin e procedurës disiplinore. Aktualisht nuk rezultojnë të jenë dhënë masat sipas rekomandimit të bërë por vetëm njoftimi si më sipër. Për rrjedhojë ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces*.

#### **IV KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME**

Në përfundim të procesit të auditimit, nga Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën nr. 888/14 prot., datë 27.04.2022 (*administruar në subjekt me nr. 71/2 prot., datë 04.05.2022*), konstatohet se 33.3 % e rekomandimeve janë zbatuar dhe nga ana e subjektit janë zbatuar pjesërisht dhe janë në proces zbatimi disa prej rekomandimeve në lidhje me masat organizative, përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet si dhe masat disiplinore. Duke parë punën e

pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **rikërkojmë**<sup>9</sup> të vazhdojnë procedurat ligjore, si më poshtë:

## **B. MASA ADMINISTRATIVE**

**B. I** – Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Vlorë, **të vlerësojë shkeljet e konstatuara:**

1. Nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “**D.**” SHPK me përfaqësues ligjor S.G & “**H. & S.**” SHPK me përfaqësues ligjor F.B, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin “Përmirësimi i Infrastrukturës së Ujërave të Zeza në zonën Bregdetare, Vlorë”, për certifikimin e punimeve të pakryera të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike me pasojë dëm ekonomik vlerën **8,364,636 lekë pa TVSH** si dhe mungesën e aplikimit të penalteteve për vonesa në përfundimin në afat të punimeve, me pasojë përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet në vlerën **25,715,880 lekë pa TVSH**.

**B. II** - Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12 Kreu III, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë** Titullarit të Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve të kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Durrës, **të vlerësojë shkeljet e konstatuara:**

1. Nga shoqëria “**T.**” SHPK, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin “Ndërtim i kolektorit kryesor të ujërave të zeza ITUP, në zonën turistike të Gjirit të Lalzit, Durrës”, nuk ka verifikuar me korrektësi analizat teknike të çmimeve për zëra të rinj të punimeve, me pasojë dëm ekonomik me vlerë **3,720,837 lekë**.

**Menjëherë**

***Në lidhje me masat e konstatuara në proces zbatimi, nga ana e subjektit të audituar Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve të vijojnë përpjekjet duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore deri në zbatimin e plotë të tyre.***

---

<sup>9</sup> Disa prej rekomandimeve të lëna në lidhje me praktikën me objekt ‘Përmirësimi i furnizimit me ujë për lagjen Krastë e Vogël, Harmës dhe qytetin e Elbasanit’ do të vlerësohen në auditimin e radhës që do të kryhet në AKUM.

### 3.13. AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR Projekti Ndërtimi i by-pass-eve Fier & Vlorë

#### PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në Autoritetin Rrugor Shqiptar mbi “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022” për auditimin e kryer në vitin 2022 për Projektin “Ndërtimi i by-pass-eve Fier & Vlorë”, për periudhën nga fillimi i Projektit deri me datë 31.12.2021 paraqitur me shkresën e administruar në KLSH me nr. 7/18 prot., datë 28.06.2022, administruar në ARRSH me nr. 7143 prot., datë 29.06.2022, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH<sup>së</sup> të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2022, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;

b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;

c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, eficiency dhe ekonomikitet të fondeve;

ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në subjekt u mbajt Akt Verifikimi nr. 1, datë 08.09.2023, administruar në Zyrën e ARRSH me nr. 7023 prot, datë 04.09.2023, për të cilin nuk është paraqitur observacion nga ana e subjektit. Pas dërgimit të Projektraportit të Auditimit, nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observacione.

#### Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

#### **I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.**

-Në kundërshtim me nenin 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ARRSH nuk ka respektuar këtë afat pasi nuk ka kthyer përgjigje për të informuar KLSH mbi planin e veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

#### **II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.**

-Nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas parashikimeve në Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

#### **III. Rekomandimet e KLSH**

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 7/18 port., datë 28.06.2022 dhe në ARRSH me nr. 7143 prot., datë 29.06.2022, janë rekomanduar gjithsej:

a. Janë rekomanduar **16 masa organizative;**

b. Janë rekomanduar **2 masa për shpërblim dëmi në vlerën 68,252.38 Euro;**

c. Janë rekomanduar 3 masa për përdorimin me shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit në shumën 4,614,071.11 Euro;

#### **IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH**

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 7/18 port., datë 28.06.2022, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si me poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Organizative	16 masa	15	1
2	Shpërblim dëmi	2 masa 68,252.38 Euro	2 masa 68,252.38 Euro	-
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	3 masa 4,614,071.11 Euro	3 masa 4,614,071.11 Euro	-

#### **V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit**

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	15 masa	6	1	7	1
2	Shpërblim dëmi	2 masa 68,252.38 Euro	54,428.38 euro	-	13,824 euro	-
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	3 masa 4,614,071.11 Euro	-	-	3 masa 4,614,071.11 Euro	-

#### **I/1 HYRJA**

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 702/1, prot., datë 04.08.2023, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. A.L, (Përgjegjës grupi)
2. J.H.

#### **I/2. OBJEKTI AUDITIMIT**

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 7/18 prot., datë 28.06.2022, administruar në ARRSH me nr. 7143 prot., datë 29.06.2022, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

#### **I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:**

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

#### I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

#### I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Autoriteti Rrugor Shqiptar, Projekti 'Ndërtimi i by-pass-eve Fier & Vlorë', në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 7/18 prot., datë 28.06.2022, administruar në ARRSH me nr. 7143 prot., datë 29.06.2022, rezulton se nga **21** masa të rekomanduara (*organizative, shpërblim dëmi dhe 3-E, Disiplinore*), janë pranuar nga subjekti **20** masa ose 95.2 %. **Nga të pranuarat (20)**: janë zbatuar plotësisht **7**, ose 35 % e tyre, është zbatuar pjesërisht **1** masë ose 5 %, janë në proces zbatimi **11** masa ose 55 % dhe nuk është zbatuar **1** masë ose 5 %.

Nga sa shikohet niveli i realizimit është në masën 35 %, gjë e cila tregon se Autoriteti Rrugor Shqiptar nuk e ka vlerësuar plotësisht procesin e zbatimit të rekomandimeve.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	15 masa	6	1	7	1
2	Shpërblim dëmi	2 masa 68,252.38 Euro	54,428.38 euro	-	13,824 euro	-
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	3 masa 4,614,071.11 Euro	-	-	3 masa 4,614,071.11 Euro	-
	<b>SHUMA</b>	<b>20</b>	<b>7</b>	<b>1</b>	<b>11</b>	<b>1</b>

#### II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 35 % kurse ai i atyre në proces është 40 %, nivele këto të cila tregojnë se ARRSH nuk e ka vlerësuar plotësisht procesin e zbatimit të rekomandimeve e për rrjedhojë duhet të intensifikojë përpjekjet për zbatimin e rekomandimeve në proces, zbatimin e plotë të rekomandimeve të zbatuara pjesërisht si dhe zbatimin e rekomandimeve të pazbatuara.

#### III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

III/1-Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

-Në kundërshtim me nenin 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ARRSH nuk ka respektuar këtë afat pasi nuk ka kthyer përgjigje për të informuar KLSH mbi planin e veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin

nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”,

III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetja nga auditimi:** Sipas nenit 2 të Marrëveshjes data e fundit e disponueshërisë së kredisë është 30.04.2015. Nga auditimi rezulton se me shkresën nr.9280/1.prot, date 23/06/2015 Ministri i Financave i ka kërkuar përfaqësuesit të BERZH shtyrja e afatit të kredisë deri në 2017 me argumentin se sipas marrëveshjes, Data e Fundit e Disponueshmërisë së Transhit A të Huasë, është data 30 prill 2015. Fillimi i zbatimit të pjesës së projektit që lidhet me ndërtimin e Bypass – it të Fierit, pjesë e cila financohet nëpërmjet Transhit A të Huas, ka hasur vonesa të ndryshme. Për rrjedhojë kontrata përkatëse e punimeve e lidhur në muajin Maj 2013 përfundon në muajin Shkurt 2017 (duke përfshirë edhe periudhën e garancisë së defekteve). Mbështetur në sa më sipër Ministri i Financave ka kërkuar shtyrjen e Datës së Fundit të Disponueshmërisë së Transhit A të Huas deri në 30 prill 2017.

Deri në përfundim të auditimit nuk u paraqit ndonjë dokument që vërteton se kur është aprovuar shtyrja e afatit nga BERZH. Nga ana e ARRSH dhe Ministrisë së Financave nuk janë marrë masat e nevojshme për zgjatjen e afatit të disbursimit të projektit në kohë duke vendosur në pasigurinë e vazhdimin të disbursimit.

- Me Amendamentin Nr.1, datë 14.02.2019, e cila është përcjell me shkresë nr. 149/5, datë 11.07.2019, është miratuar afati i fundit për kryerjen e disbursimeve për transhin A të marrëveshjes së huasë datën 31 Janar 2021. Nga auditimi konstatohet se ka një periudhë prej 21 muajsh pa marrë miratimin e shtyrjes së disbursimeve.

ARRSH ka një korrespondencë të vazhdueshme me Ministrinë ku ka kërkuar kryerjen e procedurave për zgjatjen e afatit të disbursimeve por referuar amendamentit, Ministria e ka paraqitur kërkesën për shtyrje të afatit të disbursimeve në 26.12.2018 (19 muaj më vonë nga kërkesa e parë e ARRSH) në kundërshtim me Ligjin e Marrëveshjes.

Gjatë kësaj periudhe nuk ka patur asnjë kërkesë për disbursime dhe nuk është kryer asnjë disbursim nga ARRSH pasi kompania e ndërtimit ka ndërprerë punimet “S. C. Spa” dhe ARRSH është duke zhvilluar procedurën e ritenderimit.

- Me Amendamentin nr. 2, datë 26.11.2021 (Vendimi i KM nr. 444, datë 22.07.2021) është shtyrë afati i disbursimeve deri në 30.06.2022. Referuar shkresës së disbursimit Ministria e Financave i është drejtuar BERZH në 12.04.2021 ose 6 muaj më vonë se ARRSH ka paraqitur kërkesën e saj. (Me shkresën nr. 7721, datë 14.10.2020 ARRSH ka kërkuar shtyrje të afatit të kredisë së BERZH deri në 30.06.2022).

Mosamendimi i marrëveshjes brenda afateve të përcaktuara është në kundërshtime me nenin 2 të ligjit nr. 8/2012, datë 09.02.2012 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 18-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



**1.1 Rekomandimi:** ARRSH në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (ministria e linjës) dhe Ministrinë e Financave (si përfaqësuese e huamarrësit) të marrin masa që të bashkërendojnë punën dhe në çdo rast të kryejnë kërkesat për amendimin e marrëveshjeve të huave brenda afateve të marrëveshjeve duke ulur riskun e ndërprerjes së financimit.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nuk ka patur projekte të reja me financime nga donatorë të huaj por do të merret në konsideratë në momentin e realizimit të tyre.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga fakti se ARRSH nuk ka patur deri aktualisht projekte me financime nga donatorë të huaj, ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi*.

**2. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi u konstatua se deri në fund të periudhës objekt auditimi nuk u vendosën në dispozicion dokumentet e kërkuara si:

- “*Plani i veprimit për rivendosjen për komponentin 1*” ku nënkupton planin e veprimit të rivendosjes për komponentin 1, të përfunduar nga ARRSH dhe të dorëzuar Bankës nga ARRSH-ja në emër të Huamarrësit, plani i të cilit do të zbatohet në përputhje me kërkesat e politikës sociale dhe mjedisore të Bankës.

- “*Plani i veprimit për rivendosje për komponentin 2*” ku nënkupton planin e veprimit për rivendosje për komponentin 2, i cili do të bihet dakord me Bankën përpara datës së fillimit të transhit B.

- “*Planet e veprimit për rivendosje*” ku nënkupton planin e veprimit për rivendosje për komponentin 1 dhe planin e veprimit për rivendosje për komponentin 2.

- “*Strategjia e taksave rrugore*” ku nënkupton strategjinë e taksave rrugore për Shqipërinë, të përgatitur nga konsulentët për Huamarrësin. Strategjia e taksave rrugore do të formulojë politikën e taksave rrugore dhe do të identifikojë seksionet që mund të jenë të përshtatshme për taksim rrugor në Shqipëri.

- “*Studimi i qëndrueshëm i transportit*” ku nënkupton studimin e qëndrueshëm të transportit të përgatitur nga konsulentët për Huamarrësin. Politika e qëndrueshme e transportit do të identifikojë masat për përmirësimin e qëndrueshmërisë së sektorit të transportit në Shqipëri.

Mos vendosja në dispozicion e dokumenteve të mësipërme referuar Ligjit të marrëveshjes ARRSH bën me përgjegjësi stafin aktual. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 7-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1 Rekomandimi:** ARRSH të marrë masa për krijimin e arkivës për projektet me financim të huaj ku të arkivohen të gjitha dokumentet nga fillimi i projektit me qëllim dokumentimin e vijueshmërisë së projektit.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Aktualisht projektet në proces kanë arkivën e vet të ruajtjes së dokumentacionit, i cili i dorëzohet arkivit kryesor të ARRSH pas përfundimit të periudhës së garancisë.

**Komenti i audituesve:** Statusi i zbatimit të këtij rekomandimit cilësohet si *I zbatuar* megjithatë konfirmimi i tij do të realizohet në auditimet e ardhshme.

**3. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi rezultoi se aktualisht Ekipi i Zbatimit të Projektit përbëhet nga staf i strukturës së ARRSH me profesion inxhinier konkretisht: nga përgjegjësi i Sektorit të Menaxhimit të Projekteve të Huaja; një specialiste e Sektorit të Menaxhimit të Projekteve të Huaja i cili ndjek zbatimin e kontratës së Fierit; një specialiste e Sektorit të Menaxhimit të Projekteve të Brendshme e cila referuar Urdhrit nr. 94 datë 18.06.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH përveç detyrave funksionale në këtë sektor do të ndjekë edhe detyrat e specialistes së Sektorit të Menaxhimit të Projekteve të Huaja, detyra që lidhen me ndjekjen e projektit të ndërtimit të By Passit Vlorë.

Sipas VKM nr. 276 datë 16.05.2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe statutit të “Autoritetit Rrugor Shqiptar”, këto njësi janë në varësi të Drejtorisë së Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes dhe nuk e kanë të specifikuar llojin e arsimimit të kërkuar për specialistët.

Referuar rregullores së brendshme nr. 7493/2, datë 04.09.2018 miratuar me vendim bordi nr. 10, datë 04.09.2018 detyrat e Sektorit të Menaxhimit të Projekteve të Huaja kanë të bëjnë me marrjen e masave për të siguruar që punimet janë kryer në mënyrë të kënaqshme sipas kontratës.

Sektori i Menaxhimit të Projekteve të Huaja nuk ka në përbërjen e tij një specialist/ekonomist, dhe aktualisht ana financiare e projektit ndiqet nga specialistët e sektorit të financës në Drejtorinë e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës në kundërshtim me marrëveshjen financiare ku përcaktohet se njësia e zbatimit duhet të marrë masa për mbajtjen e llogarive të projektit, librave kontabël dhe hartimit të pasqyrave financiare të projektit.

Për sa më sipër është në kundërshtim me nenin 3 të seksionit 03 i ligjit nr. 8/2012, datë 09.02.2012 “Marrëveshja e ratifikuar e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 18-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** ARRSH me qëllim eliminimin e problemeve të cilat mund të dalin si pasojë e mos ngritjes së njësive të zbatimit të projektit sipas kushteve të përcaktuara dhe të rëna dakord ndërmjet palëve në marrëveshje, si dhe referuar faktit se projekti është drejt përfundimit, të marrë masa që në të ardhmen të respektohet dhe përcaktohet struktura permanente e Njësive të Zbatimit të Projektit me specialistët e fushës, sipas kushteve të specifikuara në marrëveshjet e ratifikuara.

Pranueshmëria e rekomandimit: I pranuar

**Komenti i subjektit:** Nuk ka patur projekte të reja me financime nga donatorë të huaj por do të merret në konsideratë në momentin e realizimit të tyre.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga fakti se ARRSH nuk ka patur deri aktualisht projekte me financime nga donatorë të huaj, ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi*.

**4. Gjetje nga Auditimi:** Referuar marrëveshjes së financimit, qëllimi i projektit të by passit të Fierit është të *përmirësohet udhëtimi kohor dhe i sigurt, në veçanti përmes trafikut, si dhe për të lehtësuar kongjestionin dhe problemet mjedisore në qytetin e Fierit, ndërsa By-Passit i Vlorës do të ndihmojë në përmirësimin e integritetit rajonal, në facilitetet e tregtisë, mbështetjen e zhvillimit të turizmit në pjesën jugore të Shqipërisë, përmirësimin e kushteve të transportit rrugor në zonën e Vlorës, reduktimi i ngjeshjes/ngarkesës/mbipopullimit në trafikut në qytetin e Vlorës si dhe në rrjetin rrugor të bregdetit jugor të Shqipërisë.*

Objektivat e përcaktuara në marrëveshjen e ratifikuar për projektet e sipërpërmendura nuk janë objektiva konkrete dhe të matshme kjo pasi: nuk ka të dhëna të përcaktuara të kohës së shkurtuar me përfundimin e aksit të ri rrugor; nuk ka të dhëna krahasimore të kostos së operimit të

*automjeteve dhe të dhënave të sigurisë; lehtësimi i probleme mjedisore etj. duke e bërë të vështirë matjen e objektivave të përcaktuara në rast se punimet do të kishin përfunduar.*

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin Nr.8/2012, datë 09.02.2012 “Marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)” ligjin nr. 80/2012 “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve (BEI)” dhe ligjin nr. 109/2014 datë 31.07.2014 “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për By-Passin e Vlorës”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 28-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1 Rekomandimi:** ARRSH në bashkëpunim me të gjitha institucionet e përfshira në hartimin dhe miratimin e marrëveshjeve të financimit të marrë masa që për projektet që hartohen në të ardhmen të përcaktohen objektiva të qarta dhe të matshme, me synim monitorimin e saktë të përfitimeve që arrihen nga zbatimi i tyre.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nuk ka patur projekte të reja me financime nga donatorë të huaj por do të merret në konsideratë në momentin e realizimit të tyre.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga fakti se ARRSH nuk ka patur deri aktualisht projekte me financime nga donatorë të huaj, ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi*.

**5. Gjetja nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se nuk është realizuar objektivi i përgjithshëm i marrëveshjeve të financimit:

Ndërtimi i një by pass 22 km në qytetin e Fierit i cili referuar kontratës së punimeve civile për By Passin e Fierit punimet duhet të kishin përfunduar brenda datës 03.06.2018, por afati është shtyrë disa herë dukë sjellë si pasojë shtyrjen në kohë të arritjes së objektivave dhe përfitimeve nga zbatimi i këtij projekti.

Ndërtimi i një by pass 29 km në qytetin e Vlorës, i cili referuar kontratës së punimeve civile për By Passin e Vlorës, punimet duhet të kishin përfunduar në 30.06.2018, por afati është shtyrë, dukë sjellë si pasojë shtyrjen në kohë të arritjes së objektivave dhe përfitimeve nga zbatimi i këtij projekti.

Nevoja për shtyrjen e afateve është argumentuar me problematikat që lidhen kryesisht *me shpronësimet për pronat ku kalon gjurma e projektit, si dhe mos bashkëpunimi i Bashkisë Vlorë në lidhje me pajisjen me dokumentacionin e pronësisë për banorët që preken nga ndërtimi i By-Pass-it të Vlorës, problemeve ligjore me kontraktorin “S.”, si dhe mungesa e financimit për By Passin e Fierit nga BEI si pasojë e vonësive të shkaktuara nga Qeveria Shqiptare për shtyrjen e marrëveshjes së financimit,* veprime të cilat kanë dhënë ndikim negativ për të gjithë projektin.

Gjithashtu si pasojë e problematikave të hasura dhe vonësive në zbatimin e projektit nga ana e kontraktorit të punimeve mund të ngrihet pretendimi për llogaritje (claim) në të ardhmen pasi disa prej vonësive janë si pasojë e kontraktuesit. Sa më lart është në kundërshtim me Ligjin Nr.8/2012, datë 09.02.2012 “Marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)”, Ligjin nr. 80/2012 “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve (BEI)”; Ligjin nr. 109/2014 datë 31.07.2014 “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për By-Passin e Vlorës” dhe kontratat e zbatimit

të punimeve nr. 9946 datë 08.11.2018, appendix to tender; nr. 9719 datë 05.11.2018, appendix to tender. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1 Rekomandimi:** ARRSH të marrë masa që për projektet në proces si dhe për projekte që do të financohen në të ardhmen, të zbatohen me korrektësi detyrimet kontraktore, duke zgjidhur praktikisht çështjet që kanë të bëjnë me shpronësimin për interes publik, problematika të cilat kanë lidhje me administrimin e pushtetit vendor, ndikimin në mjedis, si dhe problematika të cilat kanë lidhje me shtyrjen në kohë të afatit të disbursimeve etj., me synim minimizimin e riskut të vonesave, të cilat shoqërohen me mos arritjen e objektivave dhe kosto shtesë për Projektin.

### *Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nuk ka patur projekte të reja me financime nga donatorë të huaj por do të merret në konsideratë në momentin e realizimit të tyre.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga fakti se ARRSH nuk ka patur deri aktualisht projekte me financime nga donatorë të huaj, ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi*.

**6. Gjetja nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi nga ARRSH në rolin e Njësisë së Zbatimit të Projektit nuk ka dorëzuar tek Banka Evropiane e Investimeve informacion në përmbajtje dhe formë dhe kohën e specifikuar në Skedulën/Formularin A.2, ose siç është rënë dakord në kontratën e financimit, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 109/2014, datë 31.07.2014, “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për by-pass-in e Vlorës”, neni 8, seksioni 8.01. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 36-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1 Rekomandimi:** ARRSH në rolin e Agjencisë së Zbatimit të Projektit, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit referuar kërkesave të përcaktuara në marrëveshjen e financimit të projektit, me qëllim ecurinë e disbursimeve pa vonesa dhe përfundimin e Projektit në afatin e caktuar.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nuk ka patur projekte të reja me financime nga donatorë të huaj por do të merret në konsideratë në momentin e realizimit të tyre.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga fakti se ARRSH nuk ka patur deri aktualisht projekte me financime nga donatorë të huaj, ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi*.

**7. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi ARRSH nuk ka mbajtur të regjistruara në sistemin e kontabilitetit libra dhe regjistra të rregullt llogarish, ku të pasqyrohen saktë hyrje të plota dhe të sakta për të gjitha transaksionet financiare, duke përfshirë shpenzimet në lidhje me Projektin dhe regjistra të kontratave të financuara nga shumat e huas, por veprimet financiare janë hedhur në programin “Excel”, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 109/2014, datë 31.07.2014, “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për by-pass-in e Vlorës”, neni 6, seksioni 6.07. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 36-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1 Rekomandimi:** Strukturat drejtuese të ARRSH dhe Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës të marrin masa për implementimin e një programi financiar, me qëllim evidentimin dhe

pasqyrimin e saktë të veprimeve financiare, ecurinë e kontratave dhe çdo transaksioni që kryhet për Projektin.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e ARRSH veprimet financiare për Projektet me financime të huaja janë mbajtur njësojë siç është vepruar edhe me llogaritë e vet ARRSH. Përveç kësaj, duhet theksuar fakti se projekti ka qenë në 6 mujorin e fundit të aktivitetit të tij dhe pajisja me një program të ri financiar nuk do të ndikonte në mënyrë të ndjeshme në menaxhimin e projektit.

**Komenti i audituesve:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* por statusi i tij cilësohet si *I pazbatuar* pasi nuk janë evidentuar dhe pasqyruar veprimet financiare, ecuria e kontratave dhe as transaksione që janë kryer për Projektin në një program kontabiliteti.

**8. Gjetje nga auditimi:** Referuar kushteve të marrëveshjeve të financimit të Projektit parashikohet se, Huamarrësi do të garantojë që zbatuesi do t'i dorëzojë bankës pas përfundimit të secilit prej viteve të tij financiar raportin vjetor të konsoliduar dhe pa konsoliduar të zbatuesit nga auditues të pavarur. Për periudhën nga fillimi i projektit deri në 31.12.2021, nuk është kryer asnjë auditim dhe të jetë paraqitur raport nga auditues të pavarur. Për sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8/2012, datë 09.02.2012, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të by-pass-eve të rrugës së Fierit dhe Vlorës”, neni 4, seksioni 4.01, dhe Ligjin nr. 109/2014, datë 31.07.2014, “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për by-pass-in e Vlorës”, nenin 8, seksioni 8.02. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 36-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**8.1 Rekomandimi:** ARRSH në rolin e Njesisë së Zbatimit të Projektit në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për kryerjen e auditimit të veprimtarisë së Projektit nga auditues të pavarur, me qëllim respektimin e kërkesave të përcaktuara në marrëveshjen financiare dhe njohjen me problematikat/rekomandimet e audituesve për përmirësimin e punës.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I papranuar*

**Komenti i subjektit:** Siç e kemi cituar edhe në observacionet, sqarojmë se është përgjegjësia e Huamarrësit për të kryer auditimin e projektit, nëpërmjet audituesve ndërkombëtarë.

**Komenti i audituesve:** Nga ana e ARRSH nuk u vu në dispozicion asnjë dokumentacion për të dëshmuar përmbushjen e këtij rekomandimi. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet *i papranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Pa zbatuar*.

**9. Gjetje nga auditimi:** Referuar nenit 6, seksionet 6.01, dhe 6.04, të Ligjit nr. 8/2012, datë 09.02.2012, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të by-pass-eve të rrugës së Fierit dhe Vlorës”, janë përcaktuar angazhimet të cilat duhet të implementohet nga ARRSH për disponueshmërinë e transhve A dhe B të kësaj marrëveshje. Lidhur me këtë situatë nga ARRSH nuk disponohet asnjë dokumentacion ku të vërtetohet se janë realizuar kushtet e parashikuara në marrëveshje për disponueshmërinë e transhit A dhe B edhe pse disbursimet për këto dy transhe kanë vazhduar nga donatori. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 36-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**9.1 Rekomandimi:** Nga ARRSH të merren masa në të ardhmen në projektet me financime të huaja, për zbatimin e të gjitha angazhimeve dhe kushteve për disponueshmërinë e fondeve me qëllim shmangien e vonesave për kryerjen e disbursimeve.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nuk ka patur projekte të reja me financime nga donatorë të huaj por do të merret në konsideratë në momentin e realizimit të tyre.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga fakti se ARRSH nuk ka patur deri aktualisht projekte me financime nga donatorë të huaj, ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi*.

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me zgjedhje mbi realizimin e disburimeve konstatohet se, në 15 raste janë hasur vonesa në lëvrimin e fondeve nga Banka e Shqipërisë në bankat e nivelit të dytë konkretisht në llogaritë speciale të hapura për Projektin “Ndërtimi i by-pass-eve Fier-Vlorë”. Kjo situatë ka ndodhur për arsye të bërjes aktiv të transhit nga MFE/Banka e Shqipërisë dhe kreditimit të transhit në bankat e nivelit të dytë. Vonesat në lëvrimin e fondeve janë në kundërshtim me ligjin nr. 109/2014, datë 31.07.2014, “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për By-Pass-in e Vlorës”, neni 8, seksioni 8.01. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 36-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**10.1 Rekomandimi:** Nga ARRSH në rolin e Njesisë së Zbatimit të Projektit të marrë masat e duhura që, deri në përfundim të projektit por edhe për projekte të tjera që do të zbatohen prej saj, në rast se do të ketë vonesa në lëvrimin e fondeve nga Banka e Shqipërisë në llogaritë speciale në bankat e nivelit të dytë të bëjë me dije Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për zgjidhjen e kësaj problematike me qëllim shmangien e vonesave në procesin e disbursimeve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nuk ka patur projekte të reja me financime nga donatorë të huaj por do të merret në konsideratë në momentin e realizimit të tyre.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga fakti se ARRSH nuk ka patur deri aktualisht projekte me financime nga donatorë të huaj, ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi*.

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i nivelit të disbursimeve deri më datë 31.12.2021, të Projektit “Ndërtimi i By-pass-eve Fier-Vlorë” konstatohet se, për përfundimin e tij do të duhen fonde shtesë në shumën totale 2,834,313.02 Euro konkretisht:

a) Për përfundimin e kontratës së ndërtimit të punimeve të by-pass-it të Vlorës do të nevojiten fonde shtesë në shumën 2,195,593.08 Euro. Konkretisht për realizimin e kësaj kontrate financimi në total prej donatorëve ka qenë në shumën 53,000,000 Euro nga të cilat është disbursuar shuma 41,114,098.94 Euro ose në masën 77.5%. Nga ky fond mbetet për t’u disbursuar shuma 11,885,901 Euro ndërkohë që për përfundimin e kësaj kontrate duhen fonde në shumën 14,081,494.08 Euro. Për financimin e kontratës së supervizionit dhe mbikëqyrjes së punimeve financimi në total prej donatorëve ka qenë në shumën 700,000 Euro gjithashtu me amendimet e kontratës ka pasur edhe mbështetje buxhetore në shumën 3,158,500 Euro ku totali i financimit shkon në shumën 3,858,500

Euro nga të cilat është disbursuar shuma 3,126,585 Euro ose më masën 81%. Nga ky fond mbetet për t'u disbursuar shuma 731,915 Euro.

b) Për përfundimin e kontratës së ndërtimit të punimeve të by-pass-it të Fierit do të nevojiten fonde shtesë në shumën 224,062.34 Euro. Konkretisht për realizimin e kësaj kontrate financimi në total prej donatorëve ka qenë në shumën 70,000,000 Euro nga të cilat është disbursuar shuma 68,562,437 Euro ose në masën 97.9%. Nga ky fond mbetet për t'u disbursuar shuma 1,437,563 Euro ndërkohë që për përfundimin e kësaj kontrate duhen fonde në shumën 1,661,625.34 Euro. Për financimin e kontratës së supervizionit dhe mbikëqyrjes së punimeve financimi në total prej donatorëve ka qenë në shumën 858,210 Euro gjithashtu me amendimet e kontratës ka pasur edhe mbështetje buxhetore në shumën 1,621,959. Euro ku totali i financimit shkon në shumën 2,480,169.4 Euro nga të cilat është disbursuar shuma 2,480,169.4 Euro ose më masën 10%. Nga ky fond mbetet për t'u disbursuar shuma 414,657.6 Euro.

Në lidhje me këtë situatë është parashikuar në marrëveshjet e financimit në rast se do të duhen fonde shtesë për përfundimin e Projektit do të mbulohen me financim nga Qeveria Shqiptare. Gjithashtu kjo situata ka ardhur si pasojë edhe e ndërprerjes së punimeve nga OE "S. C. S.p.a". Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 109/2014, datë 31.07.2014, "Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për by-pass-in e Vlorës", neni 8, seksioni 8.01 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 36-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1 Rekomandimi:** ARRSH në rolin e Njesisë së Zbatimit të Projektit të informojë Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për sigurimin e fondeve shtesë për përfundimin e Projektit me qëllim shmangien e riskut për ndërprerjen e punimeve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e ARRSH janë marrë masat e nevojshme për sigurimin e fondeve shtesë, mbi të cilat edhe janë kryer pagesat ndaj kontraktorëve të punimeve dhe konsulentëve përkatës.

**Komenti i audituesve:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion (shkresa me nr. 8742 prot., datë 08.09.2022 drejtuar MIE, etj.) rezulton se ARRSH ka marrë masat e nevojshme për sigurimin e fondeve. Statusi i zbatimit të këtij rekomandimit cilësohet si *I zbatuar* megjithatë konfirmimi i tij do të realizohet në auditimet e ardhshme.

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me zgjedhje i pagesave të TVSH-së të kryera nga Qeveria Shqiptare në 44 raste janë konstatuar vonesa në likuidimin e TVSH-së konkretisht, në 10 raste për kontratën e supervizionit të punimeve dhe 6 raste për kontratën e ndërtimit të punimeve të "By-pass-it të Vlorës" si dhe në 12 raste për kontratën e supervizionit të punimeve dhe 16 raste për kontratën e ndërtimit të punimeve të "By-pass-it të Fierit", pra këto pagesa nuk janë kryer brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", neni 7. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 36-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1 Rekomandimi:** ARRSH/Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës të marrin masa për likuidimin në kohë të detyrime ndaj kontraktorëve për pagesat e TVSH-së me qëllim eliminimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura dhe respektimin e kushteve kontraktuale.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Aktualisht ARRSH ka marrë masat e nevojshme përmes kërkesave për fonde buxhetore shtesë në MIE/MFE me qëllim mbulimin e detyrimeve si dhe minimizimin e rasteve të kryerjes me vonesë të pagesave dhe uljen e riskut për penalitete ndaj institucionit nga ana e Kontraktorëve.

**Komenti i audituesve:** Statusi i zbatimit të këtij rekomandimit cilësohet si *I zbatuar* megjithatë konfirmimi i tij do të realizohet në auditimet e ardhshme.

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se janë hasur problematika gjatë procesit të shpronësimeve, të cilat kanë sjellë vonesa në zbatimin e punimeve. Vonesat e shkaktuara nga procesi i shpronësimeve ngarkojnë me përgjegjësi ARRSH në rolin e agjencisë së zbatimit të projektit, e cila sipas marrëveshjeve të huas duhet të sigurojë të gjitha të drejtat mbi tokën dhe truallin ku do të kaloj projekti, të drejta të cilat duhen të sigurohen para fillimit të punimeve. Referuar pagesave të kryera për këtë qëllim, vlera e mbetur (detyrim) pa u paguar për shpronësime është 789,538,358 lekë, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8/2012, datë 09.02.2012, “*Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të by-pass-eve të rrugës së Fierit dhe Vlorës*”, neni 6, seksioni 6.01, germa “c”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet 36-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**13.1 Rekomandimi:** ARRSH/Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës së bashku me Drejtorinë e Shpronësimeve të marrin masa dhe ndjekin në kohë problematikat e shkaktuara nga procesi i shpronësimeve si edhe të analizojnë detyrimin e pa paguar në shumën **789,538,358** lekë me qëllim eliminimin e detyrimeve të prapambetura dhe vazhdimin e përfundimit në afat të Projektit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Aktualisht ARRSH deri në datë 02.06.2023 rezulton me një detyrim të prapambetur të zërit *Shpronësime* për të gjitha objektet/investimet në proces që menaxhohen nga ky institucion në vlerën prej 500,000,000 lekë (shkresa dërguar në MIE me nr. 4726 prot., datë 02.06.2023). Ndërsa, për sa i takon shpronësimeve të projektit *Ndërtimi i by-pass-eve Fier & Vlorë* rezulton se ky investim nuk ka detyrime të kësaj natyre (për shpronësime).

**Komenti i audituesve:** Statusi i zbatimit të këtij rekomandimi cilësohet si *I zbatuar* megjithatë konfirmimi i tij do të realizohet në auditimet e ardhshme.

**14. Gjetje nga auditimi:** Raportimet për realizimin e disbursimeve dhe shpenzimeve janë dorëzuar në MFE ku në përgjithësi janë kryer sipas kuadrit rregullator ligjor por konstatohet se, në 8 raste për vitin 2016, në 4 raste për vitin 2017, në 8 raste për vitin 2018, në 5 raste për vitin 2019, në 3 raste për vitin 2020 dhe në 8 raste për vitin 2021, nga ARRSH nuk janë respektuar afatet për raportimin mbi realizimin e disbursimeve dhe shpenzimeve në MFE në zbatim të përcaktimeve të pikës 5.5, të Udhëzimit nr. 8, datë 17.02.2003 “*Për evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj*”. Gjithashtu konstatohet se, në 2 raste për vitin 2016, në 1 rast për vitin 2017, në 1 rast për vitin 2018, në 4 raste për vitin 2019, në 2 raste për vitin 2020 dhe në 2 raste për vitin 2021, nga ARRSH nuk është raportuar mbi realizimin e disbursimeve në MFE. Mos raportimi i realizimit të disbursimeve është në kundërshtim me Udhëzimit nr. 8, datë 17.02.2003 “*Për evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj*”. Për muajt që nuk ka pasur disbursime nuk është raportuar në



MFE por është quajtur e ezauruar me raportimin vjetor të disbursimeve në të cilën pasqyrohet dhe përfshihet situata e disbursimeve për secilin muaj të vitit ushtrimor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 36-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1 Rekomandimi:** ARRSH/Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës të marrë masa që të raportojë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë realizimin e disbursimeve financiare dhe shpenzimeve të Projektit brenda afateve të parashikuara në kuadrin rregullator ligjor përkatës.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Aktualisht ARRSH ka marrë masat e nevojshme për raportimin në kohë në MFE dhe MIE.

**Komenti i audituesve:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht shkresat me nr. 8087 prot., datë 05.08.2022, nr. 8719 prot., datë 07.09.2022, nr. 9567 prot., datë 05.10.2022 dhe nr. 10550 prot., datë 03.11.2022 rezulton se ARRSH ka raportuar brenda afateve ligjore. Për sa më sipër statusi i zbatimit të këtij rekomandimit cilësohet si *I zbatuar*.

**15. Gjetje nga auditimi:** Marrja në dorëzim e aksit kryesor të “By-pass-it të Fierit” nga Autoriteti Rrugor Shqiptar është kryer nëpërmjet procesverbalit të datës 19.07.2021, i mbajtur ndërmjet Komisionit të Marrjes në Dorëzim i ngritur në zbatim të urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH-së me shkresën nr. 7259/1 prot., datë 20.11.2014, dhe OE “C. G. C. Co” së bashku me Supervizorin e Punimeve J.V “S.-T.-S.”. Deri më datë 31.12.2021, datë e cila përkon me fundin e vitit ushtrimor 2021, nga ARRSH nuk është bërë regjistrimi si aset të “Rrugës kryesore të by-pass-it të Fierit” në regjistrat e kontabilitet me veprim ekstra kontabël në momentin e marrjes në dorëzim referuar procesverbalit të datë 19.07.2021, dhe duke u bazuar në këtë regjistrim fillestar të kryhet regjistrimi përfundimtar në pasqyrat financiare të vitit 2021. Gjithashtu ky regjistrim nuk është kryer as në program financiar në kushtet kur nga ARRSH nuk disponohet program financiar për mbajtjen e kontabilitetit. Regjistrimi si aset është i domosdoshëm që nga momenti në të cilën fillon jetën e dobishme aktivi si dhe llogaritja e amortizimit që nga momenti vendosjes në funksion (vlerë e cila mund të përlllogaritet deri në mbylljen e pasqyrave financiare). Ky regjistrim është kryer në muajin mars periudhë në të cilën përfundon afati për mbylljen e pasqyrave financiare për vitin 2021, të cilat janë depozituar pranë MIE dhe MFE me shkresën nr. 4094 prot., datë 29.03.2022. Për sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 2, dhe Standardi Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale”, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet 82-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1 Rekomandimi:** ARRSH/Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës të marrë masa që, të kryej regjistrimin e aseteve të përfunduara të Projektit në regjistrat e kontabilitetit me veprim ekstra kontabël në momentin e marrjes së dorëzim prej saj me qëllim përlllogaritjen e amortizimit në momentin në të cilën fillon jetën e dobishme aktivi dhe më pas të kryhet regjistrimi në pasqyrat financiare sipas vitit ushtrimor përkatës.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Aktualisht ARRSH rezulton se në mbylljen e llogarive vjetore të projekteve By pass Fier dhe Vlorë, për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2021 dhe 1 janar – 31 dhjetor 2022,

përkatësisht me shkresat 4094 prot., datë 29.03.2022 dhe 4821/1 prot., datë 29.03.2023, në pikën 15 të Pyetësorit me Shënimet Shpjeguese bashkëlidhur PF, janë reflektuar në bilanc asetet përkatëse pas marrjeve përfundimtare në dorëzim të punimeve civile për Projektin By Pass Fier, vlera 6,685,144,344 lekë me TVSH e cila ka kaluar në llogarinë 213 *Rrugë, rrjete dhe vepra ujore*. Ndërsa, për sa i takon Projektin By Pass Vlorë zbatimi i punimeve është ende në provës.

**Komenti i audituesve:** Statusi i zbatimit të këtij rekomandimi cilësohet si *I zbatuar* megjithatë konfirmimi i tij do të realizohet në auditimet e ardhshme.

**16. Gjetje nga Auditimi:** Në kontratën me objekt “Ndërtimi i By-Pass-it Vlorë”, për periudhën objekt auditimi u konstatuan se, nga ana e punëdhënësit janë miratuar 26 (njëzetë e gjashtë) Urdhër Ndryshime por në disa prej tyre ka patuar vonesa në miratimin e tyre të cilat ndikojnë në realizimin e projektit në kohë dhe me cilësi. Konkretisht, urdhër ndryshimi nr.2 (VO.2) miratuar nga supervizori, nr. 1174 datë 02.04.2020 është miratuar afërsisht pas 5 muajsh nga ana e Këshillit Teknik me vendim Nr.51, datë. 25.11.2019, urdhër ndryshimi nr.6 (VO.6) miratuar nga supervizori, Nr. 1031 datë 13.02.2020 është miratuar afërsisht pas 4 muajsh nga ana e Këshillit Teknik me vendim Nr.28, datë 03.06.2020, urdhër ndryshimi nr.8 (VO.8) miratuar nga supervizori Nr. 1174 datë 02.04.2020 është miratuar afërsisht pas 2 muajsh nga ana e Këshillit Teknik me vendim Nr. 28, datë 03.06.2020, urdhër ndryshimi nr.10 (VO.10) miratuar nga supervizori Nr. 1266 datë 30.04.202 është miratuar afërsisht pas 1,5 muajsh nga ana e Këshillit Teknik me vendim Nr. 28, datë 03.06.2020. Për sa më sipër, vonesat në miratimin e urdhër ndryshimeve nga ana e Këshillit Teknik, ndikojnë në realizimin e punimeve sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Këto vonesa nuk bëjnë të mundur përfundimin e projektit sipas ligjit nr. 80/2012 datë 13.09.2012 “*Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve (BEI)*” neni 6, pika 6.02 “*Përmbushja e projektit*” dhe kontratës së zbatimit të punimeve nr. 9719 prot. datë 05.11.2018. “*Kushte të Përgjithshme të Kontratës*” nën klauzola 1.1.3.3 “*Koha e përfundimit*” (*Time for Completion*). (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet 60-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**16.1 Rekomandimi:** ARRSH të marri masa për shmangen e vonesave në miratimin e urdhër ndryshimeve duke përcaktuar afate kohore për miratimin e tyre nga të gjitha shkallët dhe ana e Këshillit Teknik në një kohë sa më optimale, për realizimin e projekteve sipas afateve të përcaktuara në kontratat e tyre.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Aktualisht ARRSH ka marrë masat e nevojshme për miratimin në kohë të urdhër ndryshimeve teknike pavarësisht se nuk është diktuar një afat kohor për të gjitha shkallët.

**Komenti i audituesve:** Statusi i zbatimit të këtij rekomandimit cilësohet si *I zbatuar pjesërisht* megjithatë konfirmimi i tij do të realizohet në auditimet e ardhshme.

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga Auditimi:** Në objektin “*Ndërtimi i By-Pass-it Fier*”, sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH) dhe OE “C.”-*Kuvajt* me nr. 9719 datë 05.11.2018, për zbatimin e punimeve civile, me vlerë me vlerë 37,944,221.56 euro pa TVSH, me afat përfundimi të punimeve 455 ditë, realizimi i punimeve civile deri në fund të periudhës së audituar është në masën 99%. Nga auditimi i dokumentacionit dhe verifikimi i kryer në terren, në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (mbikëqyrësi i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në situacionin e ndërmjetëm (*IPC nr. 27*) volume pune të pasqyruara në librezat e masave

dhe të situacionuara por të pakryera në fakt, për 3 (tre) zëra punimesh, në shumën 8,348.38 Euro pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; - Kontrata e shërbimit të konsulencës e lidhur me datë 21.07.2010. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 60-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Nga ana e ARRSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **8,348.38 Euro pa TVSH** ndaj sipërmarrësit OE “C.”-Kuvajt, për punime të pakryera por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes së punimeve, të lidhur sipas aktit me nr. 9719 datë 05.11.2018 me objekt “Ndërtimi i By-Pass-it Fier”.

*Menjëherë*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Aktualisht ARRSH ka marrë masat e nevojshme për arkëtimin e shumës prej 8,348.38 euro në certifikatën përfundimtare të punimeve.

**Komenti i audituesve:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht shkresës së administruar në ARRSH me nr. 5270 prot., datë 20.06.2023, si dhe certifikatës pjesore dhe finale nr. 31, rezulton se OE “C.”-Kuvajt i janë zbritur shuma prej 8,348.38 euro me citimin zbritje nga KLSH (*Deduction from Albanian Government Audit*). Për sa më sipër rekomandimi cilësohet si *I zbatuar*.

**2. Gjetje nga Auditimi:** Në objektin “*Ndërtimi i By-Pass-it Vlorë*”, sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSh) dhe BOE “*G. 2” SHPK & “I. di C. ing. E.M”* me nr. 9946 datë 08.11.2018, për zbatimin e punimeve civile, me vlerë me vlerë 35,874,357.4 Euro pa TVSH, me afat përfundimi të punimeve 823 ditë, realizimi i punimeve civile deri në fund të periudhës së audituar është në masën 92%. Nga auditimi i dokumentacionit dhe verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (mbikëqyrësi i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në situacionin e ndërmjetëm (*IPC nr.13*) volume pune të pasqyruara në librezat e masave dhe të situacionuara por të pakryera në fakt deri në këtë fazë të projektit, për 2 (dy) zëra punimesh, në shumën 59,904 Euro pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; - Kontrata e shërbimit të konsulencës e lidhur me datë 22.11.2013, Kreu, “*Detyrimet e kontraktuesit*” shtojca 1 Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, neni 7, “*Detyrime të Përgjithshme*”, pika 7.4, Shtesa e kontratës Nr. 5 datë 12.11.2018 artikulli 4, “*Qëllimi i punimeve*” “*Scope of work*” pika 4.2.2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 60-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** ARRSH dhe mbikëqyrësi i punimeve të marrin masa për reflektimin e volumeve të punimeve të situacionuara por të pa kryera në fakt, në situacionin pasardhës deri në atë përfundimtar në vlerën **59,904 Euro pa TVSH** e cila konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shtetit deri në këtë fazë të projektit, të përfutuara më tepër nga sipërmarrësi i punimeve sipas kontratës nr. 9946 datë 08.11.2018. Në rast se këto reflektime nuk kryhen deri në situacionin

përfundimtar ana e ARRSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e vlerës.

### *Menjëherë e në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Aktualisht ARRSH ka marrë masat e nevojshme për arkëtimin e shumës prej 59,904 euro në certifikatën përfundimtare të punimeve.

**Komenti i audituesve:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht shkresës së supervisorit me nr. 2885 e datës 04.05.2022, administruar në ARRSH me nr. 5259/1 prot., datë 10.05.2022, si dhe certifikatës pjesore nr. 15, administruar në ARRSH me nr. 8081/2 prot., datë 19.09.2022 rezulton se B "G. 2" SHPK & "I. di C. ing. E.M" i janë zbritur shuma prej 46,080 euro (nga 59,904 euro të rekomanduara) si punime të pakryera por të likuiduara kurse shuma prej 13,824 euro do të zbritet në vijimësi me certifikatë përfundimtare. Për sa më sipër rekomandimi cilësohet si *I zbatuar pjesërisht*.

## **C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga Auditimi:** Në kontratën me objekt "Ndërtimi i By-Pass-it Fier" është miratuar me Urdhër Ndryshimin nr.1 (VO.1) kërkesa e punëdhënësit, operim pjesor për trafik. Me letrën Nr. 1871 Prot, datë 25.02.2019, "*Operim pjesor për trafik*" ARRSH i kërkon supervisorit të udhëzojë kontraktorin të marrë masa për rishikimin e grafikut të punimeve që të bëjë të mundur funksionimin e njërën krah të By-Pass-it të Fierit deri në Qershor 2019. Kjo për të evituar trafikun gjatë sezonit turistik. Gjithashtu nga ana e punëdhënësit, në këtë letër, kërkohet që kontraktori të përgatisë një plan për menaxhimin e trafikut. Referuar nën-klauzolës 3.3 "*Udhëzimet e inxhinierit*" (*Instructions of the Engineer*) me letrën Prot.AL/FI-LE/048/19 datë 26.02.2019 ka urdhëruar kontraktorin të marrë masa për këto ndryshime në përputhje me nën-klauzolën 13.3 "*Procedurat e ndryshimit*" (*Variation Procedure*).

Kontraktori me letrën A-59 datë 12.03.2019 "*Operim pjesor për trafik*" krahas miratimeve që kërkohen për materiale në pikën 3, "*Kosto shtesë për përfundimin e kontratës në prezencë trafiku*", thekson se operimi pjesor i trafikut do të ketë efekte në aktivitet e mbetura të kontraktorit për përfundimin e kontratës. Gjithashtu, kontraktori thekson se, zona e punimit do të jetë e reduktuar, pjesë të aktivitetit duhet të modifikohen dhe do të kërkohen masa për mirëmbajtjen e rrugës. Në VO. 1 është miratuar edhe zëri "*Plani i menaxhimit të trafikut*" me kosto totale 297,868.20 Euro i cili ka ardhur si rezultat i kërkesës së ARRSH Nr. 1871 Prot, datë 25.02.2019, "*Operim pjesor për trafik*". Zëri, "*Plani i menaxhimit të trafikut*" nuk është në funksion ose i lidhur me zërat e tjerë të parashikuar në kontratën e lidhur midis ARRSH dhe "C."-*Kuvajt*, nr. 9719 datë 05.11.2018 si dhe në marrëveshjen financiare të ratifikuar me ligjin nr. 80/2012 datë 13.09.2012. ARRSH me letrën Nr. 3711/1 datë 12.06.2019 ka njoftuar miratimin e VO.1 në parim sipas Vendim të Këshillit Teknik Nr.19, datë. 10/06/2019, si dhe miratimi (no-objection) nga BERZH është më datë 12.11.2019. Referuar punimeve shtesë, që do të kryhen sipas ndryshimeve të miratuara në VO. 1, me VO. 1.1 është miratuar shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve me 122 ditë, me kosto totale shtesë 334,876.83 Euro ku nga këto 67 ditë shtohen si rezultat i miratimit të zërit "*Plani i menaxhimit të trafikut*".

Për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 67 ditë si rezultat i kërkesës së ARRSH-së për “Operim pjesor për trafik” ka kosto shtesë në vlerë 244,476.33 Euro. Pra, për sa më sipër, vlera e projektit nga kërkesa e punëdhënësit, për “Operim pjesor për trafik”, është rritur në total me (297,868.20 Euro+244,476.33 Euro) 542,344.53 Euro pa TVSH.

-Në urdhër ndryshimin nr.4 VO.4 është miratuar edhe kërkesa e Bashkisë Fier me Nr. 9363 Prot. datë 13.11.2019 për rehabilitimi e rrugës hyrëse në perëndim të Fierit me vlerë totale 116,640 Euro. Nga ana e ARRSH-së rehabilitimi i rrugës hyrëse me fondet e projektit është bërë me Vendimin e Këshillit Teknik Nr.36 datë 20.07.2020 si dhe miratimi (no-objection) nga BERZH është më datë 08.09.2020. Bashkia Fier si pronare e rrugës duhet ta riparonte atë me financime të tjera pa u prekur fondet e projektit pasi në asnjë pikë të specifikimeve të projektit nuk përcaktohet rehabilitimi i rrugëve dytësore (lidhëse) me rrugën në ndërtim. Pra, për sa më sipër, vlera e projektit nga kërkesa e Bashkisë Fier, për rehabilitimin e rrugës hyrëse, është rritur me 116,640 Euro pa TVSH. Pra në total vlera e rritur e projektit është **658,984.53** Euro e cila konsiderohet shpenzim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet i fondeve të projektit. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 80/2012 datë 13.09.2012 “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve (BEI)” neni 6, pika 6.02 “Përmbushja e projektit”, dhe kontratën e zbatimit të punimeve nr. 9719 prot. datë 05.11.2018. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 60-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** ARRSH të marri masa që në të ardhmen, për Projektet në proces dhe të reja, të mos miratojë ndryshime, që nuk janë të lidhura me zbatimin teknik të punimeve dhe të pa parashikuar në objektivat e financimit, që risin koston e tyre.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nuk ka patur projekte të reja me financime nga donatorë të huaj por do të merret në konsideratë në momentin e realizimit të tyre.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga fakti se ARRSH nuk ka patur deri aktualisht projekte me financime nga donatorë të huaj, ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi*.

**2. Gjetje nga Auditimi:** ARRSH me nr. 5349/1, datë 08.06.2021 ka përcjellë te Supervizori kërkesa e Policisë së Shtetit Nr.1097/8, datë 02.06.2021 në të cilën kërkohet mbështetja e MIE dhe ARRSH për përdorimin e aksit të By-Pass-it të Vlorës gjatë sezonit turistik Korrik-Shtator 2021. Supervizori bazuar në klauzolën 13.3 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës, “Procedurat e ndryshimit” (Variation Procedure), me shkresën Nr.2206, datë 10 Qershor 2021 instrukttoi Kontraktorin të prezantojë një propozim gjithëpërfshirës me synimin që Supervizori të bëjë vlerësimin e kushteve nën të cilat mund të përdoret gjurma e By-Pass-it për kalimin e trafikut gjatë sezonit veror. Vlerësimi i kontraktorit për punime shtesë, për hapjen e trafikut gjatë sezonit turistik, është 1,000,000 Euro ku në të përfshihen dhe punime përfundimtare të cilat janë pjesë e kontratës. Duke zbritur këto punime përfundimtare vlera e koston shtesë është afërsisht 700,000 Euro. Pas vlerësimit të propozimit të kontraktorit për hapjen e trafikut gjatë sezonit turistik në By-Pass-in e Vlorës Supervizori ka paraqitur për miratim këtë urdhër ndryshim me vlerë 440,485.01 Euro tek punëdhënësi pasi vlera e saj e kalon 1% të vlerës së kontratës. Autoriteti Kontraktor (ARRSH) me Vendimin e Këshillit Teknik Nr. 24 datë 08.07.2021 ka miratuar në parim planin e menaxhimit të trafikut, sinjalistikën vertikale provizore si dhe masat e sigurisë duke vlerësuar një kosto përfundimtare pas vlerësimit dhe saktësimit të volume të punimeve shtesë për hapjen e trafikut. Hapja e trafikut ka sjell reduktimin e punimeve të kontraktorit e cila sipas tij do të kërkojë një

shtyrje afati prej 77 ditë të përfundimit të kontratës e për rrjedhojë do të shoqërohet me kosto shtesë për zërat e përgjithshëm të saj (garancia e punimeve, menaxhimi i projektit etj.) si dhe kosto shtesë për supervizionimin e punimeve. Vlera prej **440,485.01 Euro pa TVSH** e miratuar për hapjen e trafikut gjatë sezonit veror, përbën rritje të koston së projektin e By-Pass-it Vlorë dhe nga grupi i auditimit konsiderohet **shpenzim i fondeve të projektit pa ekonomicitet, efijencë dhe efektivitet**. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 109/2014 datë 31.07.2014 “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për By Pass-in e Vlorës” neni 6, pika 6.02 si dhe kontratën e zbatimit të punimeve nr. 9946 prot. datë 08.11.2018.(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 60-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** ARRSH të marri masa që në të ardhmen, për Projektet në proces dhe të reja, të mos miratojë ndryshime, që nuk janë të lidhura me zbatimin teknik të punimeve dhe të pa parashikuar në objektivat e financimit, që risin koston e tyre dhe gjithashtu të marri masa për krijim e kushteve që punimet të mbarojnë sipas afateve kontraktuale duke shmangur një hapje tjetër provizore e cila rrit edhe më shumë koston e projektit.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *L pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nuk ka patur projekte të reja me financime nga donatorë të huaj por do të merret në konsideratë në momentin e realizimit të tyre.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga fakti se ARRSH nuk ka patur deri aktualisht projekte me financime nga donatorë të huaj, ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi*.

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, si pasojë e pezullimit të punimeve nga OE “S. C. Spa” dhe lidhja e kontratave të reja për ndërtimin e punimeve, ka çuar mos përfundimin brenda afateve të parashikuara në marrëveshjet e financimit duke shtyrë njëkohësisht në kohë edhe afatet e përfundimit të kontratave të mbikëqyrjes së punimeve duke krijuar një kosto shtesë për Projektin në shumën totale 3,516,301 Euro konkretisht:

**a)** Për realizimin e komponentit “*Punime dhe mbikëqyrje e punimeve të by-pass-it të Vlorës*” midis KE dhe Shoqërisë “E. O.” S.a është lidhur kontrata nr. 2013/332-025, datë 22.11.2013, me vlerë fillestare 1,663,300Euro pa TVSH dhe me vlerë të amenduar 3,858,500 Euro pa TVSH. Me amendimin nr. 6, datë 14.09.2021, nr. 2013/332-025/ 2018/401-331, është shtyrë afati i disbursimit deri më datën 15.10.2023, me 22.5 muaj si dhe është amenduar vlera e kontratës prej një shtese në shumën 700,000 Euro nga Qeveria Shqiptare, ku vlera e kontratës shkon 3,858,500 ose **1,493,500** Euro nga parashikimi i financimit në marrëveshjen e Grantit (3,858,500 Euro - 2,365,000 Euro = 1,493,500 Euro) si pasojë e shtyrjes së afatit të punimeve, vlerë e cila përbën kosto shtesë për Projektin.

**b)** Për realizimin e komponentit “*Punime dhe mbikëqyrje e punimeve të by-pass-it të Fierit*” midis ARRSH dhe BOE “S. srl & S. C. E. srl & T. Spa” është lidhur kontrata më datë 21.07.2010, me vlerë fillestare 715,800 Euro pa TVSH dhe me vlerë të amenduar 2,894,827 Euro pa TVSH. Shtyrja e afatit të kontratës së konsulentit është shoqëruar me shtesë së vlerës së saj (me 7 shtesa kontrate) duke bërë që vlera e rishikuar të jetë 2,881,011 Euro pa TVSH ose 2,165,211 Euro më shumë se vlera fillestare. Shtesa e kontratës së konsulencës dhe mbikëqyrjes ka sjell një kosto shtesë për buxhetin e Projektit në shumën 2,022,801 Euro. Shuma 858,210 Euro është mbuluar me financim nga Coperacione italiane dhe shuma **2,022,801** Euro nga Qeveria Shqiptare.

Për sa më sipër është në kundërshtim me marrëveshja financiare e datës 30.11.2011, midis Qeverisë Shqiptare dhe Komisionit Evropian dhe Ligji nr. 9342, datë 10.02.2005. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqet 36-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** Nga ARRSH të merren masat për përfundimin e punimeve në afatet e përcaktuara, me qëllim eliminimin e rritjes së vlerës së kontratave të konsulentit, të cilat janë rritur me 3,516,301 Euro, si edhe në të ardhmen për projektet me financime të huaja të zbatojnë me korrektësi afatet kohore për realizimin e projekteve sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjet financiare.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nuk ka patur projekte të reja me financime nga donatorë të huaj por do të merret në konsideratë në momentin e realizimit të tyre.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga fakti se ARRSH nuk ka patur deri aktualisht projekte me financime nga donatorë të huaj, ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi*.

#### **IV KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

Në përfundim të procesit të auditimit, nga Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën nr. 7/18 prot., datë 28.06.2022 (*administruar në subjekt me nr. 7143 prot., datë 29.06.2022*), konstatohet se 35 % e rekomandimeve janë zbatuar dhe nga ana e subjektit janë zbatuar pjesërisht dhe janë në proces zbatimi rekomandimet në lidhje me arkëtimin e dëmeve si dhe ato për përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet. Duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore, si më poshtë:

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** (*Gjetja nr. 7 e Masave Organizative të Raportit Përfundimtar të Auditimit*) Për periudhën objekt auditimi ARRSH nuk ka mbajtur të regjistruara në sistemin e kontabilitetit libra dhe regjistra të rregullt llogarish, ku të pasqyrohen saktë hyrje të plota dhe të sakta për të gjitha transaksionet financiare, duke përfshirë shpenzimet në lidhje me Projektin dhe regjistra të kontratave të financuara nga shumat e huas, por veprimet financiare janë hedhur në programin “Excel”, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 109/2014, datë 31.07.2014, “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për by-pass-in e Vlorës”, neni 6, seksioni 6.07.

**1.1 Rekomandimi:** Strukturat drejtuese të ARRSH dhe Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës të marrin masa për implementimin e një programi financiar, me qëllim evidentimin dhe pasqyrimin e saktë të veprimeve financiare, ecurinë e kontratave dhe çdo transaksioni që kryhet për Projektin.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** (*Gjetja nr. 8 e Masave Organizative të Raportit Përfundimtar të Auditimit*) Referuar kushteve të marrëveshjeve të financimit të Projektit parashikohet se, Huamarrësi do të garantojë që zbatuesi do t'i dorëzojë bankës pas përfundimit të secilit prej viteve të tij financiar raportin vjetor të konsoliduar dhe pa konsoliduar të audituar të zbatuesit nga auditues të pavarur. Për periudhën nga fillimi i projektit deri në 31.12.2021, nuk është kryer asnjë auditim dhe të jetë paraqitur raport nga auditues të pavarur. Për sa më sipër është në kundërshtim

me Ligjin nr. 8/2012, datë 09.02.2012, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të by-pass-eve të rrugës së Fierit dhe Vlorës”, neni 4, seksioni 4.01, dhe Ligjin nr. 109/2014, datë 31.07.2014, “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për by-pass-in e Vlorës”, nenin 8, seksioni 8.02.

**2.1 Rekomandimi:** ARRSH në rolin e Njesisë së Zbatimit të Projektit në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për kryerjen e auditimit të veprimtarisë së Projektit nga auditues të pavarur, me qëllim respektimin e kërkesave të përcaktuara në marrëveshjen financiare dhe njohjen me problematikat/rekomandimet e audituesve për përmirësimin e punës.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga Auditimi:** (Gjetja nr. 16 e Masave Organizative të Raportit Përfundimtar të Auditimit) Në kontratën me objekt “Ndërtimi i By-Pass-it Vlorë”, për periudhën objekt auditimi u konstatuan se, nga ana e punëdhënësit janë miratuar 26 (njëzetë e gjashtë) Urdhër Ndryshime por në disa prej tyre ka patuar vonesa në miratimin e tyre të cilat ndikojnë në realizimin e projektit në kohë dhe me cilësi. Konkretisht, urdhër ndryshimi nr.2 (VO.2) miratuar nga supervizori, Nr. 1174 datë 02.04.2020 është miratuar afërsisht pas 5 muajsh nga ana e Këshillit Teknik me vendim Nr.51, datë. 25.11.2019, urdhër ndryshimi nr.6 (VO.6) miratuar nga supervizori, Nr. 1031 datë 13.02.2020 është miratuar afërsisht pas 4 muajsh nga ana e Këshillit Teknik me vendim Nr.28, datë 03.06.2020, urdhër ndryshimi nr.8 (VO.8) miratuar nga supervizori Nr. 1174 datë 02.04.2020 është miratuar afërsisht pas 2 muajsh nga ana e Këshillit Teknik me vendim Nr. 28, datë 03.06.2020, urdhër ndryshimi nr.10 (VO.10) miratuar nga supervizori Nr. 1266 datë 30.04.202 është miratuar afërsisht pas 1,5 muajsh nga ana e Këshillit Teknik me vendim Nr. 28, datë 03.06.2020. Për sa më sipër, vonesat në miratimin e urdhër ndryshimeve nga ana e Këshillit Teknik, ndikojnë në realizimin e punimeve sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Këto vonesa nuk bëjnë të mundur përfundimin e projektit sipas ligjit nr. 80/2012 datë 13.09.2012 “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve (BEI)” neni 6, pika 6.02 “Përbushja e projektit” dhe kontratës së zbatimit të punimeve nr. 9719 prot. datë 05.11.2018. “Kushte të Përgjithshme të Kontratës” nën klauzola 1.1.3.3 “Koha e përfundimit” (Time for Completion).

**3.1 Rekomandimi:** ARRSH të marrë masa për shmangen e vonesave në miratimin e urdhër ndryshimeve duke përcaktuar afate kohore për miratimin e tyre nga të gjitha shkallët dhe ana e Këshillit Teknik në një kohë sa më optimale, për realizimin e projekteve sipas afateve të përcaktuara në kontratat e tyre.

*Në vijimësi*

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga Auditimi:** (Gjetja nr. 2 e Masave Për Shpërblim Dëmi të Raportit Përfundimtar të Auditimit) Në objektin “Ndërtimi i By-Pass-it Vlorë”, sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSh) dhe B “G. 2” Shpk & “I. di C. ing. E.M” me nr. 9946 datë 08.11.2018, për zbatimin e punimeve civile, me vlerë me vlerë 35,874,357.4 Euro pa TVSH, me afat përfundimi të punimeve 823 ditë, realizimi i punimeve civile deri në fund të periudhës së audituar është në masën 92%. Nga auditimi i dokumentacionit dhe verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (mbikëqyrësi i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në situacionin e ndërmjetëm (IPC nr.13) volume pune të pasqyruara në librezat e masave dhe të situacionuara por të pakryera në fakt deri në këtë fazë të projektit, për 2 (dy) zëra punimesh,



në shumën 59,904 Euro pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafët 3.2 dhe 3.3; - Kontrata e shërbimit të konsulencës e lidhur me datë 22.11.2013, Kreu, “Detyrimet e kontraktuesit” shtojca 1 Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, neni 7, “Detyrime të Përgjithshme”, pika 7.4, Shtesa e kontratës Nr. 5 datë 12.11.2018 artikulli 4, “Qëllimi i punimeve” “Scope of Work” pika 4.2.2.

**1.1 Rekomandimi:** ARRSH dhe mbikëqyrësi i punimeve të marrin masa për reflektimin e volumeve të punimeve të situacionuara por të pa kryera në fakt, në situacionin pasardhës deri në atë përfundimtar në vlerën **59,904 Euro pa TVSH** e cila konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e shtetit deri në këtë fazë të projektit, të përfituara më tepër nga sipërmarrësi i punimeve sipas kontratës nr. 9946 datë 08.11.2018. Në rast se këto reflektime nuk kryhen deri në situacioni përfundimtar ana e ARRSH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e vlerës.

*Menjëherë e në vijimësi*

*Në lidhje me masat e konstatuara në proces zbatimi, nga ana e subjektit të audituar Autoriteti Rrugor Shqiptar të vijojnë përpjekjet duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore deri në zbatimin e plotë të tyre.*

### **3.14. AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR Projekti Ndërtimi i Rrugës Qukës-Qafë Plloçë**

#### **PËRMBLEDHJE**

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në Autoritetin Rrugor Shqiptar mbi “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022” për auditimin e kryer në vitin 2022 për Projektin “Ndërtimi i Rrugës Qukës-Qafë Plloçë”, për periudhën nga fillimi i Projektit deri me datë 31.12.2021 paraqitur me shkresën e administruar në KLSH me nr. 8/6 port., datë 30.06.2022 dhe në ARRSH me nr. 7323 prot., datë 05.07.2022, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH<sup>së</sup> të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2022, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:
  - a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
  - b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
  - c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve;
  - ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në subjekt u mbajt Akt Verifikimi nr. 1, datë 08.09.2023, administruar në Zyrën e ARRSH me nr. 7022 prot, datë 04.09.2023, për të cilin nuk është paraqitur observacion nga ana e subjektit. Pas dërgimit të Projektraportit të Auditimit, nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observacione.

**Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:**

**I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.**

-Në kundërshtim me nenin 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ARRSH nuk ka respektuar këtë afat pasi nuk ka kthyer përgjigje për të informuar KLSH mbi planin e veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

**II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.**

-Nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas parashikimeve në Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna".

**III. Rekomandimet e KLSH**

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 8/6 port., datë 30.06.2022 dhe në ARRSH me nr. 7323 prot., datë 05.07.2022, janë rekomanduar gjithsej:

a. Janë rekomanduar **19 masa organizative;**

b. Janë rekomanduar **2 masa për shpërbllim dëmi në vlerën 43,379.86 USD;**

c. Janë rekomanduar **3 masa për përdorimin me shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit në shumën 669,055.6 USD;**

**IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH**

Sipas shkresës së administruar në KLSH m nr. me nr. 8/6 prot., datë 30.06.2022, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si me poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Organizative	19 masa	19	-
2	Shpërbllim dëmi	2 masa 43,379.86 USD	1 masa 10,259.86 USD	1 33,120 USD
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	3 masa 669,055.6 USD	2 masa 577,055.6 USD	1 masë 92,000 USD

**V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit**

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në zbatim proces	Pa zbatuar
1	Organizative	19 masa	10	-	9	-
2	Shpërbllim dëmi	1 masë 10,259.86 USD	1 masa 10,259.86 USD	-	-	-

3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	2 masa 577,055.6 USD	-	-	2 masa 577,055.6 USD	-
---	---	-------------------------	---	---	-------------------------	---

### I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 702/1, prot., datë 04.08.2023, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. A.L, (Përgjegjës grupi)
2. J.H.

### I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 8/6 port., datë 30.06.2022 dhe në ARRSH me nr. 7323 prot., datë 05.07.2022, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

### I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

### I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

### I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Autoriteti Rrugor Shqiptar, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH për Projektin “Ndërtimi i Rrugës Qukës-Qafë Plloçë” me shkresën nr. 8/6 port., datë 30.06.2022 dhe në ARRSH me nr. 7323 prot., datë 05.07.2022, rezulton se nga **24** masa të rekomanduara (organizative, shpërblim dëmi dhe 3-E, Disiplinore), janë pranuar nga subjekti **22** masa ose 91.7 %. **Nga të pranuarat (22):** janë zbatuar plotësisht **11**, ose 50 % e tyre, nuk ka asnjë masë të zbatuar pjesërisht, janë në proces zbatimi **11** masa ose 50 % dhe nuk ka masa të pazbatuara.

Nga sa shikohet niveli i realizimit është në masën 50 %, gjë e cila tregon se ARRSH e ka vlerësuar procesin e zbatimit të rekomandimeve.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	19 masa	10	-	9	-
2	Shpërblim dëmi	1 masë 10,259.86 USD	1 masa 10,259.86 USD	-	-	-

3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	2 masa 577,055.6 USD	-	-	2 masa 577,055.6 USD	-
<b>SHUMA</b>		<b>22</b>	<b>11</b>	<b>-</b>	<b>11</b>	<b>-</b>

## II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 50 % kurse ai i atyre në proces është 50 %, nivele këto të cila tregojnë vlerësimin e këtij procesi në lidhje me ndjekjen e procedurave të duhura për zbatimin e rekomandimeve.

## III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

**III/1-Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.**  
 -Në kundërshtim me nenin 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ARRSH nuk ka respektuar këtë afat pasi nuk ka kthyer përgjigje për të informuar KLSH mbi planin e veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

**III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.**

-Nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

**III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:**

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Projekti origjinal i zbatimit për Lot<sup>in</sup> 2 ka rezultuar me mangësi të cilat konsistojnë në:

- Mungesë të vizatimeve në projekt, llogaritje të gabuara konstruktive si dhe mungesë e studimit gjeologjik/gjeoteknik, për urat nr. 4, nr. 10 dhe nr. 11.
- Parashikimi i ndërtimit të mureve mbajtës dhe pritës me lartësi shumë të madhe të cilat arrijnë deri 24 m, teknikisht problematike në ndërtim si dhe kosto shumë e madhe e projektit.
- Diferenca të volumeve të paraqitura në projekt, krahasuar me faktin në terren, rezultuar pas azhurnimit të volumeve.

Lot 2, shtrihet në kuotën 720 metër mbi nivelin e detit (mnd) në kilometër 18+000, ndërsa pas km 22+585, kuotat e rrugës janë mbi 1000 m mnd. Ndërtimi i rrugës në të tilla lartësi, krijon vështirësi të shumta dhe kosto të larta, kryesisht sa i përket mirëmbajtjes dimërore.

Po ashtu, ky segment por jo vetëm, shtrihet në terrene jo të qëndrueshme nga pikëpamja gjeologjike, të cilat kërkojnë investime të konsiderueshme për parandalimin e rrëshqitjeve, si dhe kosto të larta mirëmbajtje pas ndërtimit të saj.

Është vepruar në kundërshtim me Kushtet Teknike të Projektimit. Mos zbatimi i kushteve teknike të projektimit, si dhe monitorimi jo i duhur gjatë procesit të prokurimit të këtij shërbimi, ka sjellë si pasojë rritje të koston së projektit, shtyrje të afatit të përfundimit të punimeve si dhe vënie me vonesë në efikasitet të investimit. (*Trajtuar më hollësisht në pikën 5, faqe 46 deri 70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1 Rekomandimi:** ARRSH të marrë masa për monitorimin me korrektësi të hartimit të projekteve të zbatimit për projekte në proces dhe ato në vijimësi, në mënyrë që të shmangen kostot që vijnë nga përgatitja e projekteve me mangësi, të cilat shkaktojnë kosto shtesë në realizimin e projekteve.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Aktualisht ARRSH ka miratuar projektin final të seksioneve 1 dhe 2 i cili edhe në zbatim punimesh. Për sa i përket hartimit të projekteve, ARRSH përmes stafit ka marrë pjesë në takime të vazhdueshme me qëllim përmirësimin dhe plotësimin e projektit të zbatimit. Konkretisht na vazhden e takimeve të mëparshme në datën 03.08.2022 është realizuar një mbledhje me KT, Projektuesin si dhe Oponencën Teknike.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *I zbatuar* megjithatë konfirmimi i tij do të realizohet në auditimet e ardhshme.

**2. Gjetje nga auditimi:** Projekt-zbatimi për Lot<sup>in</sup> 2, është rishikuar sipas Vendimit të Këshillit Teknik (KT) të ARRSH nr. 13 prot., datë 15.03.2016. Projekti është rishikuar për arsytet si më poshtë:

- Ndryshimit të vijës së tokës së parashikuar në projekt me vijën e tokës reale pas rilevimit topografik.

- Diferencës së vërejtur midis sasive të zërave të punimeve të kontratës me ato të paraqitura në projekt.

- PANDësisë teknike për realizimin e mureve mbajtës deri në 24 m lartësi.

Për sa më sipër KT i ARRSH ka marrë Vendimin nr. 13, datë 15.03.2016, duke miratuar si më poshtë:

- Përditësimin e volumeve të punimeve nga km 18+000 deri km 27+800 dhe nga km 32+450 deri km 33+800.

- Të pranohet zgjidhjen e re teknike propozuar nga kontraktori dhe miratuar nga konsulenti për spostimin e aksit nga km 27+800 deri km 32+450.

- Spostimin e aksit në të djathtë të projektit nga km 28+700 27+800 deri km 32+450. Dhe uljen e nivelatës në maksimum 22 m në zonën e tunelit të parë.

- Zëvendësimin e 5 urave me tombino katrore.

- Evitimin e mureve mbajtëse mbi 10 m si dhe evitimin e mureve pritës mbi 4 m.

- Për propozimin në lidhje me ndërtimin e tuneleve, projekti i detajuar do të diskutohet në Këshillin teknik e konkretisht tuneli nr. 1 me gjatësi 707 m dhe tuneli nr. 2 me gjatësi 327 m etj.

Kosto e propozuar për ndryshimet e mësipërme është 4,864,475 USD.

Në lidhje me ndërtimin e tuneleve KT i ARRSH ka marrë Vendimin nr. 52, datë 01.08.2016, si më poshtë:

- Të miratojë projektin teknik të detajuar të paraqitur nga Kontraktori “C. G. (K.S.C)” dhe përgatitur nga studio “OTM”, për tunelin nr. 1 me gjatësi 716 m dhe tunelin nr. 2 me gjatësi 311 m.

Kostoja për dy tunelet, daljen e emergjencës, si dhe infrastrukturën e nevojshme për instalimet nëntokësore dhe sistemin elektromekanik, është parashikuar me vlerë 21,891,744 USD.

Gjatë zbatimit të kontratës, deri në momentin e auditimit, janë miratuar tre shtesa si më poshtë:

Shtesa nr. 1, datë 23.12.2016, ka të bëjë me miratimin e urdhër ndryshimit nr. 1, me vlerë financiare 4,825,169.3 USD.

Urdhër ndryshimin nr. 2, 3 dhe 4, ka të bëjë me shtesë të afatit të përfundimit të punimeve, për vonesa të ardhura për shkaqe jo në përgjegjësinë e Kontraktorit. Data e përfundimit të punimeve, sipas kësaj shtese është 30.09.2021.

Shtesa nr. 6 e kontratës është miratuar me nr. 7405/1 prot., datë 10.09.2021. Kjo shtesë ka të bëjë me rishikimin e volumeve të punimeve, pa ndryshuar çmimin e kontratës. Rishikimi i volumeve reflekton rregullimet me shtesa dhe pakësime, të cilat janë të nevojshme për përfundimin e 10.5 kilometër rrugë me një shtresë konglomerat bituminoz me trashësi 10 cm, shpërndarje dhe ngjeshje materiali me makineri.

KT i ARRSH ka marrë Vendimin nr. 25, datë 04.05.2017, si më poshtë:

- Miratimin në parim për zëvendësimin e urës nr. 4 me tombino kuti 2 (5 x 5) m dhe miratimin e projektit të ri për ndërtimin e urave nr. 10 dhe 11. Sipas këtyre ndryshimeve kosto e projektit ulet me vlerë 594,303 USD.

KT i ARRSH ka marrë Vendimin nr. 64, datë 03.12.2018, si më poshtë:

- Pranimin e zgjidhjeve të reja teknike të prezantuara dhe të vlerësuara nga konsulenti për Lot<sup>in</sup> 2, për spostimin e aksit nga km 33+300 deri 33+800.

KT i ARRSH ka marrë Vendimin nr. 11, datë 17.05.2019, si më poshtë:

- Miratimin në parim për projektin e fibrave optike, me kushtin e unifikimit me Lot 1.

- Për pjesët elektro-mekanike Drejtoria e planifikimit Strategjik dhe operacioneve të vazhdojë komunikimin me projektuesit për të zgjidhur pyetjet e ngritura nga oficeri i projektit.

- Miratimin në parim të rishikimit të volumeve.

- Supervizori të hartojë dhe më pas të auditojë projektimin e menaxhimit të trafikut, si për zonat e menaxhimit të situatave dimërore.

Ndryshimet e shumta të projektit kanë sjellë pasoja të shumta si për rritjen e kostos, ashtu dhe afatit të përfundimit të punimeve.

*(Trajtuar më hollësisht në pikën 5, faqe 46 deri 70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** ARRSH dhe Njësia e Menaxhimit të Projektit, në bashkëpunim me Mbikëqyrësin e Punimeve të marrin masa për zbatimin e projektit të azhurnuar, duke mbajtur në konsideratë ekonomikitetin, eficiencën dhe efektivitetin, pa cenuar standardet e miratuara dhe cilësinë e punimeve.

*Në vijimësi*

**Komenti i subjektit:** Aktualisht ARRSH ka miratuar projektin final të seksioneve 1 dhe 2 i cili edhe në zbatim punimesh. Për sa i përket hartimit të projekteve, ARRSH përmes stafit ka marrë pjesë në takime të vazhdueshme me qëllim përmirësimin dhe plotësimin e projektit të zbatimit. Konkretisht na vazhden e takimeve të mëparshme në datën 03.08.2022 është realizuar një mbledhje me KT, Projektuesin si dhe Oponencën Teknike.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi* megjithatë konfirmimi i tij do të realizohet në auditimet e ardhshme.

**3. Gjetje nga auditimi:** Gjatë zbatimit të kontratës, kontraktori ka paraqitur 8 pretendime si më poshtë:

- Në mars 2018, kontraktori ka paraqitur pretendim për kohë shtesë në përfundimin e punimeve. Nga vlerësimi i Supervizorit Kontraktori ka të drejtë për një shtesë prej 15 muajsh, të afatit të përfundimit të punimeve, për vonesa të shkaktuara jo në përgjegjësinë e tij.

- Pretendimin mbi diferencën e çmimit njësi për zërat e punimeve dhe i përforcuar (terramesh). Nga vlerësimi i Supervizorit pretendimi konsiderohet i drejtë, por është kërkuar që nga ana e Kontraktorit të paraqiten të gjithë sasitë për zërat përkatës të punimeve.

- Kosto shtesë gjatë shpimit të pilotave për urën 10 dhe 11. Ky pretendim është bërë i pavlefshëm, me ndryshimet që i janë bërë projektit.

- Kosto shtesë për dëme të shkaktuara si pasojë e kushteve fizike të paparashikuara në kilometër 28+600 deri kilometër 29+150, si pasojë e rrëshqitjeve të datës 07.03.2018. Ky pretendim nuk është pranuar nga ana e Supervizorit, pasi ai është paraqitur jashtë periudhës 28 ditore nga ndodhja e ngjarjes, e përcaktuar në kushtet e kontratës Pika 4.10 dhe 20.1.

- Kosto shtesë për shkak të vonesave në dhënien e instruksioneve për realizimin e projektit për mbrojtjen dhe stabilizimin e skarpatave. Ky pretendim nuk është vlerësuar në thelb, për arsye të mosdakordësive mes Supervizorit dhe Kontraktorit lidhur me adresën dhe datën e dërgimit.

- Kosto shtesë për shkak të vonesave të në pagesën e IPC 18 dhe 19. Nga ana e Supervizorit është vlerësuar se pretendimi nuk ka baza kontraktuale.

- Kosto shtesë për shkak të vonesave të në pagesën e IPC 21. Nga ana e Supervizorit është vlerësuar se pretendimi nuk ka baza kontraktuale.

- Kosto shtesë për shkak të vonesave të në pagesën e IPC 22. Nga ana e Supervizorit është vlerësuar se pretendimi nuk ka baza kontraktuale.

Deri në momentin e auditimit nuk është diskutuar asnjë nga pretendimet e kontraktorit. Nga ana e drejtorit të PIU, është informuar se ka vullnet për tërheqje nga pretendimet e mësipërme nga ana e Kontraktorit, por pa u finalizuar në mënyrë zyrtare. Gjithsesi, shqyrtimi i tyre konsiderohet i pezulluar. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në: *Kushtet Teknike të Projektimit. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës Pika 14.6. Kontrata e punimeve civile, me shtesat. (Trajtuar më hollësisht në pikën 5, faqe 46 deri 70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:** Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe Mbikëqyrësi i Punimeve duhet të zbatojnë me korrektësi detyrimet kontraktore, për shmangien e penalizimeve të mundshme gjatë zbatimit të kontratës. Shqyrtimi i pretendimeve të kontraktorit duhet të bëhet me korrektësi, duke kërkuar edhe mendimin e Bordit të Diskutimeve, në rastet e mospranimeve nga ana e Kontraktorit.

*Gjatë zbatimit të kontratës*

Pranueshmëria e rekomandimit: *L pranuar*

**Komenti i subjektit:** Në Amendimet Nr. 8 të Kontratave të Punimeve Civile të miratuara nën financimin shtesë, sipas shkresave me nr. 3136 prot., datë 31.07.2023 dhe nr. 5339 prot., datë 21.06.2023 është dakordësuar zyrtarisht nën firmosje që Kontraktorët heqin dorë nga gjithë pretendimet/penalitetet e mëparshme të ngritura gjatë implementimit të Projektit. Në perspektivë gjatë implementimit të pjesës së mbetur të Projektit, rekomandimet e KLSH gjenden të drejta.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *I zbatuar* megjithatë konfirmimi i tij do të realizohet në auditimet e ardhshme.

**4. Gjetje nga auditimi:** Ndryshimi nr. 1 i kontratës për **Lot<sup>in</sup> 3**, është miratuar me datë 24.11.2016. Arsye e ndryshimit ka të bëjë me impaktin e financimit të projektit. Ndryshimi përfshin përfundimin e vizatimeve të detajuara dhe raportin teknik dhe aprovimin e tyre.

- Ndryshimi nr. 2 i kontratës ka të bëjë me shtesën në afatin e kontratës së shërbimeve konsulente, si pasojë e zgjatjes së afatit të kontratës së punimeve civile deri me datë 15.01.2019. Për këtë arsye kontrata është shtyrë me afat 17 muaj dhe 12 muaj të periudhës së riparimit të defekteve. Impakti financiar sipas kësaj shtese është 969,800 USD (837,800 USD, për shërbimet konsulente + 96,000 USD pagesa për stafin e PMU).

- Ndryshimi nr. 3, është aprovuar me datë 16.01.2019, i cili ka të bëjë me shtyrjen e afatit të shërbimeve konsulente si pasojë e shtyrjes së afatit të përfundimit të kontratës së punimeve civile deri me datë 15.10.2020. sipas këtij ndryshimi, shërbimet konsulente janë shtyrë me afat 22 muaj (nga data 01.04.2019 deri me datë 31.01.2021). Impakti financiar është me vlerë 1,341,800 USD (1,251,800 USD shërbime konsulente + 90,000 pagesa për stafin e PMU).

Problemet e hasura në projektin e zbatimit, si dhe mungesa e financimit ka rezultuar me shtyrje të afatit të përfundimit të kontratës së punimeve civile dhe rrjedhimisht të shërbimeve konsulente. Deri në periudhën e auditimit janë parashikuar pagesa për shërbime konsulente mbi kontratën bazë me vlerë 2,089,600 USD.

KT i ARRSH ka marrë Vendimin nr. 68, datë 06.10.2016, duke miratuar në parim projektin e ri të propozuar nga Kontraktori me vlerë 39,974,086 USD.

Projekti origjinal ka rezultuar me mangësi që kanë të bëjnë me:

-Nuk rezulton asnjë studim gjeologo-gjeoteknik, si dhe nuk është evidentuar asnjë zonë e rrëshqitshme në terren.

- Nuk ka të dhëna studimore gjeoteknike të përfshira në projektin teknik.

- Ka mospërputhje topografike nga vizatimet krahasuar me faktin, diferenca të kuotave dhe koordinata që lëvizin nga 4 deri në 5 m.

- Ka mangësi në projektimin e ndërtimit të mureve mbajtës betonarme, në lidhje me vizatimin strukturor për mure mbi 12 m që arrijnë deri në 27 m lartësi.

- Mungojnë vizatimet për tombino drejtkëndëshe.

Janë parashtruar dy alternativa:

- Alternativa e parë ka të bëjë me ruajtjen e gjurmës së rrugës bashkë me elementët e saj, duke bërë ri projektimin e veprave. Sipas kësaj alternative, kosto e projektit shkon në 64,055,899.4 USD.

Alternativa e dytë ka të bëjë me ndryshim të projektit në tërësi duke marrë në konsideratë edhe zonat e rrëshqitshme me kosto 40,700,000 USD. Pas negociimit me konsulentin kosto është përcaktuar me vlerë 39,974,086 USD. Si pasojë e korrektimeve në projektin origjinal vlera e kontratës është rritur në shumën 6,577,291 USD.

Në projektin e miratuar ka dhe zëra të rinj punimesh siç është ndërtim tokë e përforcuar. Çmimi përkatës është përllogaritur bazuar në studimin e tregut dhe është vendosur 160 USD për m<sup>2</sup>. Duke marrë në konsideratë urdhër ndryshimet e miratuara, por edhe ato të miratuara, pritet që vlera e kontratës të bëhet rreth 39.9 milionë USD, me një shtesë referuar kontratës bazë me vlerë rreth 6.5 milionë USD, ose 19 % më e lartë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në: Kushtet Teknike të Projektimit. Specifikimet Teknike të Kontratës,



pika 3.7.2. (Trajtuar më hollësisht në pikën 5, faqe 46 deri 70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1 Rekomandimi:** ARRSH dhe Njësia e Menaxhimit të Projektit, në bashkëpunim me Mbikëqyrësin e Punimeve të marrin masa për miratimin e urdhër ndryshimeve të cilat janë në proces miratimi, duke mbajtur në konsideratë economicitetin, eficiencën dhe efektivitetin, pa cenuar standardet e miratuara dhe cilësinë e punimeve.

*Në vijimësi*

**Komenti i subjektit:** Aktualisht ARRSH ka miratuar projektin final të seksionit 3 i cili edhe në zbatim punimesh. Për sa i përket hartimit të projekteve, ARRSH përmes stafit ka marrë pjesë në takime të vazhdueshme me qëllim përmirësimin dhe plotësimin e projektit të zbatimit. Konkretisht na vazhden e takimeve të mëparshme në datën 19.07.2023 është realizuar një mbledhje me KT dhe Projektuesin.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi* megjithatë konfirmimi i tij do të realizohet në auditimet e ardhshme.

**5. Gjetje nga auditimi:** Kontrata e punimeve civile për Lot<sup>in</sup> 3, është nënshkruar me datë 06.09.2015. Afati kontraktor për përfundimin e punimeve është përcaktuar 22 muaj, ose me datë 22.07.2017.

Bazuar në ndryshimin e kontratës nr. 2, afati i përfundimit të punimeve është shtyrë deri me datë 15.01.2019. Bazuar në ndryshimin nr. 3, afati i përfundimit të punimeve është shtyrë deri me datë 15.10.2020. Për mungesë financimi, punimet nuk kanë filluar akoma, të cilat rezultojnë të pezulluara edhe në periudhën e auditimit të mëparshëm.

Fondet në dispozicion për këtë kontratë janë me vlerë 25 milionë USD. Duke marrë në konsideratë faktin se nuk është marrë asnjë masë për sigurimin e fondeve për vazhdimin e punimeve, pezullimi dhe ndërprerja e realizimit të tyre do të sjellë pasoja si financiare ashtu dhe teknike të cilat kanë të bëjnë me:

- *Vonesën e vënies në funksionim të plotë të rrugës, pasi ndërtimi i lotit 1 dhe 2, nuk do të jetë efektiv pa vënien në funksionim të lot 3, pasi lot 3 është vazhdim i dy loteve të mëparshme, pra investimi për ndërtimin e rrugës nuk do të bëhet eficient për një periudhë të caktuar duke mos arritur përfitimet e parashikuara të projektit.*

- *Degradimin e punimeve të realizuara si rrëshqitje të skarpateve, dëmtim të shtresave rrugore, dëmtim të tokës së përforcuar si pasojë e filtrimit të ujërave në tabanin e rrugës, për të cilat do të kërkohen punime dhe fonde shtesë, pa marrë në konsideratë shtesat e fondeve për arsye të tjera si mangësitë në projektin origjinal.*

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në: *Kushtet Teknike të Projektimit. Specifikimet Teknike të Kontratës, Pika 3.7.2. (Trajtuar më hollësisht në pikën 5, faqe 46 deri 70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1 Rekomandimi:** Njësia e Menaxhimit të Projektit dhe ARRSH, pavarësisht kërkesave të herë pas herë për financimin e plotë të punimeve, duhet të rikërkojnë pranë institucioneve kompetente miratimin e fondeve të parashikuara për përfundimin e Lot 3, shoqëruar me dokumentacionin përkatës i cili duhet të paraqesë pasojat e mungesës së financimit.

*Menjëherë*

**Komenti i subjektit:** Aktualisht mes Fondit Saudit për Zhvillim dhe Këshillit të Ministrave të RSH është lidhur një Marrëveshje Huaje me vlerë totale 74 mln USD duke shtuar kështu vlerën fillestare të Projektit e cila ka qenë në masën 25 mln USD.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *I zbatuar*.

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i punimeve të realizuara në objekt rezultojnë se në kilometër 22+500, ka cedim të tabanit të rrugës. Shtresa e konglomeratit kishte pësuar çarje si rezultat i mbushjes pa ngjeshjen e duhur dhe rrëshqitjeve të mundshme të bazamentit në pjesën e poshtme të rrugës. Në rast të mos ndërhyrjes, ky dëmtim do të shtohet, po ashtu edhe pasojat do të jenë më të mëdha. Në këtë segment, kishte edhe dëmtim të pjesës hyrëse të murit mbajtës prej gabioni, si pasojë e presionit të rrëshqitjeve të skarpatës.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës Pika 14.6. Kontrata e punimeve civile, me shtesat.

*(Trajtuar më hollësisht në pikën 5, faqe 46 deri 70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1 Rekomandimi:** Mbikëqyrësi i punimeve të kërkojë nga kontraktori analizimin e shkaqeve dhe pasojave të rrëshqitjes që kanë filluar dëmtimin në vepra të arit si dhe në shtresa rrugore, riparimin e tyre dhe marrjen e masave paraprake, duke verifikuar edhe në seksione të tjera rrugore, me synim parandalimin e dëmtimit të tyre.

*Menjëherë*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Me evidentimin e planit rrëshqitës në këtë zonë në fillim të vitit 2022, me rifillimin e punimeve nën Amedment No. 8 kjo rrëshqitje është nën analizim dhe trajtim. Projekti i azhurnuar i miratuar ka konsideruar gjithë zonat rrëshqitëse të evidentuara dhe ato potencialisht të rrëshqitshme, duke parashikuar edhe masat inxhinierike përkatëse që duhen ndërmarrë.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi* megjithatë konfirmimi i tij do të realizohet në auditimet e ardhshme.

**7. Gjetje nga auditimi:** Në kontratën e zbatimit të punimeve civile me objekt “Ndërtim i rrugës Qukës-Qafë Plloçë, Lot<sup>in</sup> 1”, nr. 11 prot. datë 09.05.2015, nga ana e ARRSH konstatohen vonesa në miratimin e ndryshimeve të propozuara nga kontraktori. Konkretisht, për urdhër ndryshim nr.1 propozimi i kontraktori ka datën 25.01.2017 dhe miratimi sipas Vendim nr. 39 të KT datë 10.07.2017 pra afërsisht 6 muaj, për urdhër ndryshim nr.2 propozimi i kontraktori është 17.05.2019 dhe miratimi nga ARRSH është më datë 30.07.2020 sipas Addendum nr.4 e cila është një vit me vonesë. Miratimi me vonesë i urdhër ndryshimeve nga ana e Autoritetit Kontraktor krijon mosrealizimin e punimeve në kohë dhe me cilësi si dhe mosrealizimin e objektivave të projektit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.128/2013 datë 25.04.2013, Seksioni 2 “Ndërtimi dhe përfundimi i Asetit” pika 2.3 “Në përputhje me seksionet 3 dhe 6, ndërtimi i Asetit do të përfundojë brenda 4 (katër) vjetëve nga data e disbursimit të parë” si dhe kontrata e zbatimit të punimeve civile nr. 11 prot, datë 09.05.2015 kushtet e përgjithshme të kontratës “Koha e përfundimit (Time for completion)”. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 5, faqe 46 deri 70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1 Rekomandimi:** ARRSH të marrë masa për shmangen e vonesave në miratimin e urdhër ndryshimeve duke përcaktuar afate kohore për miratimin e tyre nga të gjitha shkallët e Këshillit

Teknik në një kohë sa më optimale, për realizimin e projekteve sipas afateve të përcaktuara në kontratat e tyre.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Aktualisht ARRSH ka marrë masat e nevojshme për miratimin në kohë të urdhër ndryshimeve teknike.

**Komenti i audituesve:** Statusi i zbatimit të këtij rekomandimit cilësohet si *I zbatuar* megjithatë konfirmimi i tij do të realizohet në auditimet e ardhshme.

**8. Gjetje nga auditimi:** Në kontratën e zbatimit të punimeve civile me objekt “Ndërtim i rrugës Qukës-Qafë Plloçë, Lot<sup>in</sup> 1”, nr. 11 prot. datë 09.05.2015, konstatohet se ka një shtrirje në kohë gati 7 vjet dhe ndërprerje të tyre për mungesë fondesh. Nga vizita në terren u konstatua se; skarpitet e krijuara nga gërmimi kanë humbur formën e tyre dhe rrëshqitje ku në disa raste kanë dëmtuar muret pritëse, materiali i rënë nga skarpitet ka krijuar mbushje pas mureve pritëse i cili nuk është i përshtatshëm për kullimin e ujërave i cili ku duhet të pastrohet dhe të bëhet mbushja me materialin e parashikuar në kontratë sipas specifikimeve teknike dhe në një pjesë të konsiderueshme të trasesë janë dëmtuar shtresat e bazës nga kushtet atmosferike. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 128/2013 datë 25.04.2013, Seksioni 2 “Ndërtimi dhe përfundimi i Asetit” pika 2.3 “Në përputhje me seksionet 3 dhe 6, ndërtimi i Asetit do të përfundohet brenda 4 (katër) vjetëve nga data e disbursimit të parë” si dhe kontrata e zbatimit të punime civile nr. 11 prot, datë 09.05.2015, Specifikimet Teknike. (Trajtuar më hollësisht në pikën 5, faqe 46 deri 70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1 Rekomandimi:** ARRSH dhe mbikëqyrësi i punimeve të marrin masa për mbrojtjen e skarpitëve dhe realizimin e punimeve sipas specifikimeve teknike duke shmangur në të ardhmen dëmtimet e tyre dhe kostot shtesë për rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

*Menjëherë*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Aktualisht ARRSH ka miratuar me Vendim KT nr. 31, datë 19.09.2022 masat për mbrojtjen dhe stabilizimin e skarpitëve të seksioneve nr. 1 dhe nr. 2. Aktualisht punimet janë në proces.

**Komenti i audituesve:** Statusi i zbatimit të këtij rekomandimit cilësohet si *I zbatuar* megjithatë konfirmimi i tij do të realizohet në auditimet e ardhshme.

**9. Gjetje nga auditimi:** Banka Islamike për Zhvillim për Lot<sup>in</sup> I, sipas kontratës, ka financuar segmentin me gjatësi prej 15.1 km ku fillon në km 2+900-18+000 dhe segmenti 0-2+900 është financuar nga buxheti i shtetit ku punimet kanë përfunduar në vitin 2013. Pjesa e rrugës prej 2.9 km e financuar nga buxheti i shtetit nuk ka përfunduar plotësisht ku nuk janë realizuar shtresat asfaltike të rrugës (konglomerat, binder, tapet) si dhe mbrojtja e skarpitëve. Nga vizita në terren u konstatua se ky segment është i përdorshëm nga banorët e zonës dhe me mungesën e shtresave asfaltike nga qarkullimi i mjeteve dhe kushtet atmosferike janë dëmtuar shtresat e bazës dhe nën-bazës si dhe skarpitet. Për përfundimin e segmentit km 0-2+900 nga ana e menaxhimit të projektit dhe konsulentit është bërë një vlerësim i punimeve të nevojshme të cilat janë përafërsisht 5.1 milion US\$ pa TVSH ku çmimet për njësi janë sipas VKM Nr.629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar. Nga ana e ARRSH nuk është marrë asnjë masë për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e

*punimeve të kryera.* Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.128/2013 datë 25.04.2013, Seksioni 2 “Ndërtimi dhe përfundimi i Asetit” pika 2.5 “Përfituesi do të përmirësojë dispozitat e kontratës së punimeve civile për segmentin rrugor prej 2.9 km fillestarë, me qëllim që të realizohet i njëjti nivel sigurie dhe pajisjet e tjera të autostradës sipas parashikimit në segmentin rrugor të Projektit” si dhe ligji nr. 10164, datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar” neni 5 “Funksionet e Autoritetit” pika 1. Autoriteti ka këto funksione: ku thuhet: ç) Krijon dhe mirëmban sistemin për administrimin e rrugëve shtetërore dhe të urave. (Trajtuar më hollësisht në pikën 5, faqe 46 deri 70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1 Rekomandimi:** ARRSH të marri masa për sigurimin e fondeve për përfundimin e punimeve në segmentin prej 2.9 km me qëllim që të realizohet i njëjti nivel sigurie dhe vendosjen e plotë të tij në shërbim të komunitetit në të njëjtën kohë me segmentet e tjera.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Aktualisht rezulton se sipas deklaratave të punonjësve të ARRSH, ky aks duke qenë se është nën trafik të rënduar prej mjeteve për ndërtimin e seksionit nr. 1, ndërtimi i aksit prej 2.9 km është parashikuar të realizohet me fondet e buxhetit, pra nga vet ARRSH. Për rrjedhojë, duke qenë se punimet për seksionin nr.1 parashikohet të përfundojnë në vitin 2024, kohë kur edhe pretendohet të dorëzohet i gjithë projekti, edhe ky aks do të kompletohet përgjatë vitit 2024, por gjithmonë në fazën përfundimtare të gjithë projektit.

**Komenti i audituesve:** Statusi i zbatimit të këtij rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi* megjithatë konfirmimi i tij do të realizohet në auditimet e ardhshme.

**10. Gjetje nga auditimi:** Objektivat e përcaktuara në marrëveshjen e ratifikuar me ligjin nr. 128/2013 nuk janë objektiva konkrete dhe të matshme, kjo pasi nuk ka të dhëna të përcaktuara të kohës së shkurtuar me përfundimin e aksit të ri rrugor, nuk ka të dhëna krahasimore të kostos së operimit të automjeteve dhe të dhënave të sigurisë duke e bërë të vështirë matjen e objektivave të përcaktuara në rast se punimet do të kishin përfunduar. Veprime jo në përputhje me ligjin nr. 128/2013, datë 25.04.2013, dhe Marrëveshje Huaje për Projektin e ndërtimit të rrugës Tiranë-Elbasan-Qukës-Qafë Pllaçë ndërmjet Fondit Saudit për Zhvillim dhe Republikës së Shqipërisë e ratifikuar në Parlament me Ligjin nr. 46/2014, datë 24.04.2013.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 1, faqe 10 deri 17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1 Rekomandimi:** Në të ardhmen ARRSH të marrë masa për përcaktimin dhe hartimin e objektivave konkrete dhe të matshme gjatë hartimit të marrëveshjes në mënyrë të tillë që me përfundimin e projektit të arrihet një konkluzion i saktë mbi efektivitetin e investimit të kryer.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nuk ka patur projekte të reja me financime nga donatorë të huaj por do të merret në konsideratë në momentin e realizimit të tyre.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga fakti se ARRSH nuk ka patur deri aktualisht projekte me financime nga donatorë të huaj, ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi*.

**11. Gjetje nga auditimi:** Referuar kushteve të përcaktuara në marrëveshje dhe në kontratat për punimet civile, aksi rrugor Qukës-Qafë e Pllaçës duhet të kishte përfunduar. Konkretisht Punimet civile për lotin 1 duhet të kishin përfunduar në datë 23.06.2018 por afati është shtyrë deri në datë 30.06.2022. Për lotin 2, punimet duhet të kishin përfunduar në 30.06.2018 por afati është shtyrë

deri në 30.06.2022, ndërkohë që Punimet civile të lotit 3 duhet të kishin përfunduar në datë 07.07.2017 por punimet janë shtyrë deri në datë 31.12.2024. Nevoja për shtyrjen e afateve ka ardhur si rezultat i problematikave që lidhen kryesisht me pasaktësitë dhe mangësitë e projektit origjinal të Kontratës, vonesa prej çështjeve mjedisore të ngritura nga Ministria e Mjedisit dhe mungesa e financimit të lotit 3. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 128/2013 datë 25.04.2013, Seksioni 2 “Ndërtimi dhe përfundimi i Asetit”.

*(Trajtuar më hollësisht në pikën 1, faqe 10 deri 17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1 Rekomandim:** ARRSH dhe PMU të marrin masa që në të ardhmen për projektet me financime të huaja të zbatojnë me korrektësi afatet kohore për realizimin e projekteve sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjet financiare dypalëshe.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nuk ka patur projekte të reja me financime nga donatorë të huaj por do të merret në konsideratë në momentin e realizimit të tyre.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga fakti se ARRSH nuk ka patur deri aktualisht projekte me financime nga donatorë të huaj, ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi*.

**12. Gjetje nga auditimi:** Në marrëveshjen e ratifikuar për projektin e rrugës Qukës-Qafë e Plloçë, nuk është identifikuar konkretisht objektivi i përgjithshëm por janë identifikuar katër objektivat specifikë të projektit si më poshtë:

- Sigurimi i lidhjes rrugore më të shkurtër të mundshme me fshatrat e izoluara jugore, kufijtë e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë (FYROM) dhe Greqisë e Evropës me Ballkanin e brendshëm;

- Shkurtimi i kohës së udhëtimit, koston e operimit të automjeteve dhe rritja e rehatisë, sigurisë dhe besueshmërisë;

- Përmbushja e kërkesave të tashme dhe të ardhme të transportit duke përfunduar Korridorin 8.

- Të ndihmojë përshpejtimin e aktiviteteve ekonomike, duke përmirësuar aksesin e njerëzve në pikat turistike, mjediset shoqërore, bizneset dhe mundësitë e punësimit që rrjedhin nga ndërlidhja e shtuar e brendshme dhe rajonale.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 128/2013 datë 25.04.2013, Seksioni 2 “Ndërtimi dhe përfundimi i Asetit”. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2, faqe 17 deri 25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1 Rekomandimi:** ARRSH/PMU të marrë masa për analizimin e faktorëve për përmirësimin e gjendjes aktuale dhe arritjen e objektivave të përcaktuara, të merren masat që në të ardhmen të hartohen objektiva konkrete dhe të matshme gjatë hartimit të marrëveshjes në mënyrë të tillë që me përfundimin e projektit të arrihet auditimi i objektivave të realizuara.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nuk ka patur projekte të reja me financime nga donatorë të huaj por do të merret në konsideratë në momentin e realizimit të tyre.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga fakti se ARRSH nuk ka patur deri aktualisht projekte me financime nga donatorë të huaj, ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi*.

**13. Gjetje nga auditimi:** Ndërtimi i aksit rrugor Qukës-Qafë Plloçë konkretisht, Punimet Civile për Lotin 1 duhet të kishin përfunduar brenda datës 23.06.2018, por afati është shtyrë deri më datë 30.06.2022. Për Lotin 2, punimet duhet të kishin përfunduar në 30.06.2018, por afati është shtyrë deri në 30.06.2022, ndërsa për Lotin 3 punimet duhet të kishin përfunduar më datë 07.09.2017, por afati është shtyrë deri më 31.12.2024. Megjithatë edhe pse afatet për përfundimin e Projektit janë amenduar nga ai fillestari përsëri projekti nuk ka përfunduar.

Referuar problematikave të paraqitura nga konsulenti në lidhje me problemet dhe mangësitë e realizimit të Projektit fillestar të aksit rrugor, kushteve natyrore dhe ndërprerja e punimeve për Lotin 3 si pasojë e mungesës së financimit ku për përfundimin e Lotit 1 dhe 2 duhen 56.8 milionë USD dhe për Lotin 3 duhen 49.3 milionë USD, përfundimi në kohë i kohë i punimeve nuk është realizuar edhe pse lidhur me mungesën e financimit është marrë miratimi në parim nga donatori ku deri më datën 31.12.2021, ky proces është në fazën e draft-marrëveshjes ku pritet ratifikimi i marrëveshjes së financimit në Parlament. Shtyrja e afateve të përfundimit të punimeve sjellin si pasojë rritjen e kostove të projektit dhe arritjen me vonësë të objektivave të parashikuara. (Trajtuar më hollësisht në pikën 2, faqe 17 deri 25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**13.1 Rekomandimi:** Nga ana e ARRSH/PMU të merren masat për vënien në dijeni të vazhdueshme të MFE për rëndësinë e përfundimit të Projektit dhe zgjidhjen e problemit të financimit për këtë projekt.

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: I pranuar

**Komenti i subjektit:** Pas kërkesave të bëra nga ARRSH, objekti është kompletuar për nga ana e planifikimit me fondet e nevojshme për përfundimin e plotë të punimeve.

**Komenti i audituesve:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se është lidhur marrëveshja financiare me IDB (Banka Islamike për Zhvillim) për seksionet nr. 1 dhe nr. 2 e cila është deklaruar efektive në nga institucion sipas shkresës me nr. RHTR/MENA/2481, datë 02.01.2023. Nisur nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *I zbatuar*.

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i disbursimeve financiare të projektit u konstatua se, realizimi i tyre në afatet kohore nuk është respektuar duke i tejkalluar ato në dyfishin e kohës së parashikuar në marrëveshjen e financimit, kjo si rrjedhojë e vonësave në realizimin e punimeve nga faktorët teknik “*Problematika ne projektin e zbatimit*” si dhe në faktorët natyrorë. Projekt i cili ka filluar në 21 Janar 2016 dhe afat përfundimi Dhjetor 2018. Pas një ndërprerje të punimeve në Janar 2017, për shkak të temperaturave të ulëta dhe ngricave, që prej 15 Marsit 2017 punimet kanë rifilluar. Ndërkohë që me afatet e amenduara për realizimin e Projektit deri më datë 31.12.2021, për Lot<sup>et</sup> 1 dhe 2 realizimi financiar është në shumën 113.04 milionë USD ose në masën 90.43% të kontratave si dhe për Lotin 3 realizimi financiar është në shumën 23.4 milionë USD ose në masën 50.9 % të kontratave. Gjithashtu për sigurimin e fondeve shtesë për përfundimin e të tre loteve aktualisht Qeveria Shqiptare dhe Donatorët (ku nga donatorët janë miratuar në parim këto fonde) janë në fazën e hartimit të Draft-Marrëveshjes së Financimit konkretisht 56.8 milionë USD për Lotin 1 dhe 2 si dhe 49.3 milionë USD për Lotin 3. Çelja e fondeve shtesë është e domosdoshme për mbarëvajtjen e të gjithë Projektit sepse aktualisht punimet për përfundimin e Lot<sup>it</sup> 3 janë ndërprerë sepse nuk ka më financim, duke rrezikuar kështu përfundimin me sukses të Lotit 3 por dhe të gjithë Projektit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 128/2013 datë 25.04.2013. (Trajtuar më hollësisht në pikën 3, faqe 25 deri 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1 Rekomandimi:** ARRSH/Njësitë e Menaxhimit të Projektit të marrin masa për realizimin e disbursimeve sipas planit si dhe të kërkojnë nga donatorët ndryshimet e duhura kur ecuria e projektit nuk është në nivelin e parashikuar.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga data e dërgimit të Raportit të KLSH në lidhje me këtë auditimi nuk ka patur as nevojë dhe as ndryshim plani disbursimesh e për rrjedhojë nuk i janë kërkuar të tilla as donatorit.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *I zbatuar*.

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga ndryshimet e kërkuara dhe të miratuara në Projektin fillestar si dhe miratimi i shtyrjes së afatit kohor të përfundimit të veprës ka sjellë si domosdoshmëri shtyrjen e afatit të kontratave të shërbimeve konsulente. Deri më datën 31.12.2021, janë miratuar shtesa në afate por edhe financiare të cilat për lot 1 dhe lot 2, kapin vlerën e 3.19 milionë USD si dhe për lot 3 me vlerë 2.31 milionë USD. Duke marrë në konsideratë faktin se kontratat janë në proces, shpenzimet konsulente do të pësojnë rritje të mëtejshme. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 128/2013 datë 25.04.2013. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 3, faqe 25 deri 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1 Rekomandimi:** Njësitë e Menaxhimit të Projektit të marrin masa që të reduktojnë në maksimum stafin e konsulentit duke mbajtur vetëm ato që janë të domosdoshëm për ndjekjen e punimeve si dhe të marrin masa për arritjen e marrëveshjeve me mirëkuptim për pezullimin e kontratave të mbikëqyrjes së punimeve sidomos për lot 3, deri në momentin e rifillimit të punimeve.

*Përgjatë zbatimit të Projektit*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Për periudhën 01.01.2022 deri në 31.07.2023 stafi i supervizionit të seksioneve nr. 1 dhe nr. 2 ka operuar me numër të reduktuar, kjo në zbatim të rekomandimit të KLSH por edhe me qëllim përdorimin e fondeve me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

**Komenti i audituesve:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se konsulenti, në nisje të kontratës është likuiduar për një shpenzime mesatar mujor në masën prej 93,400 USD/muaj ndërsa në vitin 2023 kjo shumë është reduktuar në masën 45,470 USD në muaj.

Nisur nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *I zbatuar*.

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me zgjedhje i pagesave të TVSH-së të kryera nga Qeveria Shqiptare për kontratat e punimeve civile dhe kontratave të konsulencës/supervizionit të punimeve të Projektit, në shtatë raste janë konstatuar vonesa në likuidimin e TVSH-së Lotin 1 dhe 2, pra këto pagesa nuk janë kryer brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*”, neni 7.

*(Trajtuar më hollësisht në pikën 3, faqe 25 deri 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**16.1 Rekomandimi:** Nga Njësitë e Menaxhimit të Projektit së bashku me Drejtorinë e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës të marrin masa për likuidimin në kohë të detyrimeve ndaj kontraktorëve për pagesat e TVSH-së me qëllim eliminimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura dhe respektimin e kushteve kontraktuale.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Aktualisht ARRSH ka marrë masat e nevojshme përmes kërkesave për fonde buxhetore shtesë në MIE/MFE me qëllim mbulimin e detyrimeve si dhe minimizimin e rasteve të kryerjes me vonesë të pagesave dhe uljen e riskut për penalitete ndaj institucionit nga ana e Kontraktorëve.

**Komenti i audituesve:** Statusi i zbatimit të këtij rekomandimit cilësohet si *I zbatuar* megjithatë konfirmimi i tij do të realizohet në auditimet e ardhshme.

**17. Gjetje nga auditimi:** Raportimet për realizimin e disbursimeve dhe shpenzimeve për periudhën nga fillimi i Projektit deri më 30.05.2021, janë dorëzuar në MFE, ku në përgjithësi janë kryer mbi bazën e dispozitave ligjore përkatëse por bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, për Lot<sup>et</sup> 1 dhe 2 në 3 raste për vitin 2016, në 1 rast për vitin 2017, në 2 raste për vitin 2019, në 1 rast për vitin 2020, në 1 rast për vitin 2021, si dhe për Lot<sup>in</sup> 3 në 2 raste për vitin 2016, në 3 raste për vitin 2017, në 1 rast në vitin 2018, në 1 rast për vitin 2019, në 3 raste për vitin 2020 dhe në 1 rast në vitin 2021, nga ARRSH nuk janë respektuar afatet për raportimin mbi realizimin e disbursimeve dhe shpenzimeve në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në zbatim të përcaktimeve të pikës 5.5, të Udhëzimit nr. 8, datë 17.02.2003 “Për evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj”.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 3, faqe 25 deri 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**17.1 Rekomandimi:** Njësitë e Menaxhimit të Projekteve të marrin masa që të raportojnë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë realizimin e disbursimeve financiare dhe shpenzimeve të Projektit brenda afateve të parashikuara në kuadrin rregullator ligjor përkatës.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Aktualisht ARRSH ka marrë masat e nevojshme për raportimin në kohë në MFE dhe MIE.

**Komenti i audituesve:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht shkresat me nr. 3022 prot., datë 03.04.2023, nr. 3037 prot., datë 02.05.2023 dhe 3167 prot., datë 04.09.2023 rezulton se ARRSH/PMU ka raportuar brenda afateve ligjore. Për sa më sipër statusi i zbatimit të këtij rekomandimit cilësohet si *I zbatuar* megjithatë konfirmimi i tij do të realizohet në auditimet e ardhshme.

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimit i procedurës së prokurimit për përzgjedhjen e konsulentit për lotin I dhe II për ndërtimin e segmentit rrugor “Qukës-Qafë Plloçë” me operatorë fitues “C. E. C.” (CEC) u konstatua se nga ana e komisionit për vlerësimin e ofertave, për operatorin (CID) edhe pse është vlerësuar maksimalisht në eksperiencën të ngjashme dhe në një vlerësim shumë të lartë në stafin përbërës, për sa i përket pikës (teknika dhe metodologjia) kemi një vlerësim mjaft ulët duke marrë në konsideratë eksperiencat e ngjashme dhe stafin element që ka sjellë dhe mos fitimin e kësaj procedure nga ky operator i cili është paraqitur dhe me ofertë më eficiente. Veprime jo në përputhje me Udhëzuesin e vitit 2005 të Bankës Islamike për Prokurimet seksioni D. Pika 2.35. (Trajtuar më hollësisht në pikën 4, faqe 38 deri 46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**18.1 Rekomandimi:** Komisioni i vlerësimit të ofertave në çdo rast të kryejë një vlerësim sa më objektiv me korrektesë dhe me integritet të operatorëve për të përfituar një vlerësim të saktë dhe pa interpretime të ndryshme, për të arritur eficiencën maksimale në procedurat e prokurimit.

*Në vijimësi*



Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nuk ka patur projekte të reja me financime nga donatorë të huaj por do të merret në konsideratë në momentin e realizimit të tyre.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga fakti se ARRSH nuk ka patur deri aktualisht projekte me financime nga donatorë të huaj, ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi*.

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimit i procedurës së prokurimit për përzgjedhjen e konsulentit për lotin I dhe II për ndërtimin e segmentit rrugorë “ Qukës-Qafë Plloçë” me operatorë fitues “C. E. C.” (CEC) u konstatua se nga ana e komisionit për vlerësimin e ofertave, ka patur vlerësime me “ZERO” për operatorët pjesëmarrës duke mos dhënë apo kërkuar informacione më të detajuara për këtë vlerësim, element i kritikuar dhe rekomanduar për rishikim dhe nga financuesi në shkresën nr. 2680 datë 04.12.2013 për dhënien e “NO Objection” për këtë procedurë, duke patur në vëmendje në të ardhmen ndryshimin e sjelljes me qëllim rritjen e pjesëmarrjes dhe të konkurueshmërisë. (*Trajtuar më hollësisht në pikën 4, faqe 38 deri 46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**19.1 Rekomandimi:** Komisioni i ngritur për vlerësimin e ofertave në të ardhmen të jetë sa më korrekt dhe me integritet në vlerësimin e operatorëve, dhënien apo marrjen e një informacioni sa më të detajuar për operatorët me qëllim shmangien e vlerësimeve jo bindëse dhe rritjen e konkurueshmërisë në përzgjedhjen e fituesit.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nuk ka patur projekte të reja me financime nga donatorë të huaj por do të merret në konsideratë në momentin e realizimit të tyre.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga fakti se ARRSH nuk ka patur deri aktualisht projekte me financime nga donatorë të huaj, ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi*.

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në raportin shkurt 2017 (Për lot<sup>in</sup> 2), pika 8.4 “*Facilitetet e Konsulentit*”, përcaktohet: “*Deri në këtë periudhë kontraktori ka siguruar “1 automjete tip A, 1 automjet tip B dhe 1 automjet tip C”*. Kontraktori duhet të blejë edhe dy automjete Tip A, viti 2015. Rezulton se deri në këtë datë nuk janë furnizuar dy automjete.

Nga lidhja e kontratës deri me datë 31.12.2018 janë përfshirë për pagesë:

Tip A - 36 muaj x 3 automjete = 108 muaj

Tip B - 35 muaj x 1 automjet = 35 muaj

Tip C - 23 muaj x 1 automjet = 23 muaj

Sa më sipër, bazuar në periudhën e aktivitetit deri në muajin qershor 2017 (18 muaj), rezulton se pavarësisht se nuk janë siguruar mjetet, pagesat për shërbim të tyre sipas zërit j Zërit 1.2.7.a “*Kosto e drejtimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve për inxhinierin dhe stafin e tij*” është likuiduar për 108 muaj. Pagesa për këtë shërbim duhet të realizohet vetëm pas furnizimit të automjeteve, pra për një periudhë 72 muaj.

Sa më sipër, pagesa **me vlerë 21,600 USD** [(18 muaj x 2 mjete x 500 USD/muaj) + TVSH], është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.

- Sa i takon zyrave për konsulentin, kontraktori është likuiduar në masën 50 %, ose 10,000 Euro, ndërsa sipas zërit 1.2.8 “*Pastrim dhe mirëmbajtje zyresh, kosto e laboratorit*” është likuiduar me

vlerë 32,800 USD (41 muaj x 800 USD/muaj). Duke marrë në konsideratë faktin se nga ana e kontraktorit nuk është furnizuar laborator (*nuk ishte parashikuar ndërtimi i një laboratorit*), si dhe faktin se zyrat janë vënë në dispozicion të Mbikëqyrësit të Punimeve në muajin shkurt 2017 (12 muaj me vonesë), **vlera 11,520 USD** [12 muaj x 800 USD/muaj) + TVSH], është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.

Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me specifikimet teknike Pika 1.31.

Në kontratën bazë nuk është parashikuar ndërtimi i një laboratorit, por janë parashikuar shpenzime për punonjës laboratorit dhe kosto operimi. Gjatë zbatimit të kontratës për lot 1 dhe lot 2, është konkluduar me realizimin e provave materiale që për lot 2, të realizohen në laboratorin e ndërtuar nga kontraktori sipas lot 1. Kostoja e laboratorit është përcaktuar që të ndahet sipas Kontraktorëve. Pavarësisht sa më sipër, kostoja për mirëmbajtje operim dhe staf laboratorit është likuiduar sipas parashikimit për të dy lotet, pa reduktuar kostot e pa nevojshme nga përdorimi i vetëm një laboratorit. Nga ana e Mbikëqyrësit të Punimeve dhe PMU duhet të merreshin masa për reduktimin e kostos duke reduktuar pagesat përkatëse për lot 2. Ky veprim është në kundërshtim me Specifikimet Teknike të Kontratës Pika 4, ku përcaktohet: “Kontraktori është përgjegjës për sigurimin e një laboratorit në ose afër objektit të punimeve me pajisjet përkatëse për realizimin e të gjitha testeve nga dita në ditë, në mënyrë që të demonstrojë përfundimin e punimeve në përputhje me specifikimet teknike...”.

- Në seksionin nr. 2, sipas zërit 6.1 “Gërmim në shkëmb seksion i lirë, me ekskavator 1 m<sup>3</sup>, plus transport me automjet në vendin e caktuar për mbushje të rrugës”, është likuiduar sasia 86,003 m<sup>3</sup>. Sipas zërit 6.2 “Ngarkim dhe transport me automjet në vendin e caktuar nga bashkia, me pak se 5 km”, është certifikuar sasia 125,523 m<sup>3</sup>. Pavarësisht se nga ana e drejtorit të PIU, kjo sasi është zbritur për t’u mos likuiduar, veprimi i mësipërm është në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës Pika 14.3 ku përcaktohet: “Kontraktori do t’i paraqesë Mbikëqyrësit të Punimeve situacionin në 6 kopje, në mbyllje të muajit përkatës, me paraqitje të detajuar të vlerës për të cilën Kontraktori e konsideron të justifikuar për pagesë, shoqëruar me dokumente mbështetëse justifikuese”. Pagesat si më sipër janë trajtuar edhe në auditimin e mëparshëm, por nuk janë marrë masa për zbritjen e vlerave përkatëse (*Trajtuar më hollësisht në pikën 5, faqe 46 deri 70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1 Rekomandimi:** ARRSH të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **33,120 USD pa TVSH**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit përfituar padrejtësisht nga kontraktori “C. G. C. G Co. (Kuwait) & A.-B. Sh.p.k”.

**Në vijimësi**

Pranueshmëria e rekomandimit: I papranuar

**Komenti i subjektit:** Në lidhje me këtë çështje, sikurse kemi vënë materialet e duhura në dispozicion Ekipit Auditues të KLSH gjatë periudhës së Auditimit dhe referuar në Observacionet e PMU dhe Supervizionit në fazën e Projekt-Raportit të KLSH demonstron që të tre automjetet e Tipt A, (i) janë siguruar nga Kontraktori që në Korrik 2015, (ii) kanë operuar në Projekt gjatë kësaj periudhe, (iii) kostot e operimit sipas Zërit 1.2.7 (a) janë certifikuar saktë nga Supervizioni për periudhën 108 muaj. Sikurse deklaron dhe konfirmon Supervizioni me shkresën Nr. 472-C-S1S2-078 datë 21/04/2022 (Sqarime/Observacione mbi Akt-Konstatimet Nr. 5 dhe Nr. 7), Kontraktori i Lot-2 ka angazhuar në kantier 4 Laboratore të miratuar, dhe për të cilat nuk është kërkuar dhe aplikuar asnjë pagesë nga Projekti. Kokretisht:

Laboratori i Kontraktorit “A.-B.” – I miratuar nga Supervizioni,

Laboratori “N.-C.” Shpk – I miratuar nga Supervizioni

Laboratori “T.-I.” Shpk – I miratuar nga Supervizioni  
Laboratori “N.-A.” Shpk – I miratuar nga Supervizioni

Supervizioni, sipas shkresës së mësipërme, konfirmon se pagesat ndaj Kontraktorit për shërbimet në laborator janë realizuar sipas Kontratës, dhe nuk ka asnjë kosto të shtuar. Supervizioni me shkresën Nr. 472-C-S1S2-078 datë 21/04/2022 (Sqarime/Observacione mbi Akt-Konstatimet Nr. 5 dhe Nr. 7), konfirmon se referuar edhe shkresave të Kontraktorit Nr. A03 datë 30/04/2015 për zyrat, dhe A-010 datë 07/07/2015 për mobilimin, Mbikëqyrësi i Punimeve ka operuar dhe punuar në zyrat e vëna në dispozicion nga Kontraktori dhe kompletuar nga ai, sipas parashikimeve të Kontratës; dhe certifikimi i pagesave përkatëse dhe likuidimet janë korrekte. Për më tepër, referuar deklaratimit të ekipit KLSH se zyrat janë vënë në dispozicion vetëm në muajin Shkurt 2017, logjikshëm ngrihet pyetja se ku ka operuar dhe funksionuar stafi i Supervizionit nga lidhja e Kontratës Prill 2015 deri në Shkurt 2017, kur Projekti shtrihet mes maleve dhe mbi 10 km nga qendrat e banuara?! Në vazhdim, Supervizioni bën me dije se në Dhjetor 2015, Misioni i IsDB ka inspektuar gjithë Projektin, dhe mbledhjet përkatëse me Kontraktorin, Supervizionin, PMU janë mbajtur pikërisht në zyrat e Supervizionit në kantier. Ndaj, certifikimi dhe likuidimi për shërbimet e zyrave është korrekt.

Duhet të theksojmë, se konform kontratës çdo veprim arbitrar i njëanshëm i ndërmarrë nga Punëdhënësi (ARRSH/PMU) ndaj Kontraktorit, i pa certifikuar nga Supervizioni, sjell impakte penalitetesh financiare dhe kontraktuale në dëm të Punëdhënësit, dhe Projektit. Në këto kushte, kur Supervizioni konfirmon, demonstroi dhe certifikon që këto detyrime të Kontraktorit janë përmbushur dhe likuiduar konform Kontratës, ARRSH/PMU nuk mund të ndërmarrë veprime me impakte të rënda kontraktuale dhe financiare. Në këto kushte ftojme ekipin e KLSH të rishikojë rekomandimin e bërë pasi nuk është i bazuar në fakte por në një lapsus të vetëm të një dokumenti të gati 7 viteve më parë. Fakt është shërbimi është kryer dhe dokumentuar në disa gjurmë të tjera të ndryshme. Zbatimi i rekomandimit (nxjerrja e urdhër-zhdëmtimit) na vendos në si ARRSH/PMU përballë një situatë jo të favorshme e mbi të gjitha të padrejtë kundrejt kontraktorit, kjo për të vetmen arsye se trajtimi gjyqësor i një çështjeje të tillë kontraktuale nuk mund të mbrohet nga ana jonë kur as ne nuk ndajmë të njëjtin mendim si Ju. Me gjasa çështja e trajtuar në Gjykatën e Strasbourg pa diskutim e me kosto shtesë për ARRSH do të fitohet nga ana e kontraktorit.

**Komenti i subjektit:** Në lidhje me këtë çështje, sqarojmë se rekomandimi i mësipërm, pavarësisht argumenteve të përmendura nga ana juaj praktikisht nuk është zbatuar sipas përcaktimeve në rekomandimin me nr. 1.1 të kategorisë **MASA SHPËRBLIM DËMI**. Nisur nga sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet *i pa pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *I pazbatuar*.

**2. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “Ndërtim i rrugës Qukës-Qafë Plloçë, Lot<sup>in</sup> 1” sipas kontratës të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH) dhe BOE “S.” & “A.” SHPK me nr. 11 prot. datë 09.05.2015 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 38,199,652.84 USD pa TVSH me afat përfundimi të punimeve 1096 ditësh, nga auditimi i dokumentacionit si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe mbikëqyrësit të punimeve rezultuan se, në librezat e masave dhe në situacionin e ndërmjetëm, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt, për 3 (tre) zëra punimesh, në shumën **10,259.86 USD pa TVSH** e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nën pikat

3.2 dhe 3.3. si dhe Kontratës së shërbimit me objekt “Mbikëqyrja e punimeve për e rrugës Qukës-Qafë Plloçë, Lot 1&2” lidhur me datë 19.02.2014, e ndryshuar (Trajtuar më hollësisht në pikën 5, faqe 46 deri 70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** ARRSH të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **10,259.86 USD pa TVSH**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve BOE “S.” & “A.” SHPK me të cilin është lidhur kontrata nr. 11 prot. datë 09.05.2015.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Aktualisht ARRSH ka marrë masat e nevojshme për zbritjen e shumës prej 10,259.86 USD në certifikatën pasardhëse me nr. 13.

**Komenti i audituesve:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht sipas certifikatës pjesore nr. 13 dhe librezës së masave, rezulton se BOE “S. & A.” i janë zbritur shuma prej 10,259.86 USD. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *I zbatuar*.

## **C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Urdhër ndryshimi nr. 1, është paraqitur me datë 07.09.2016 dhe është miratuar me vlerë 4,825,169.3 USD. Ky ndryshim ka të bëjë me përmirësimin e projektit të zbatimit i cili ka rezultuar me mangësi.

- Urdhër ndryshimi nr. 2, paraqitur me datë 15.09.2017, si pasojë e rishikimit të disa zërave punimesh, vlera e kontratës sipas këtij ndryshimi është zbritur në shumën 299,265.6 USD.

Urdhër ndryshimi nr. 3, është miratuar në gusht 2019. Nuk ka shtesë të vlerës së kontratës sipas këtij urdhri. Janë shtuar shpenzime të përgjithshme me vlerë 363,514.6 USD, shpenzime për tombino me vlerë 167,351.54 USD, shpenzime për ura me vlerë 97,798.5 USD, shpenzime për punime tuneli me vlerë 320,936.4 USD, shpenzime për fibrat optike me vlerë 219,408.58 USD dhe janë zbritur punime rruge me vlerë 1,169,036.7 USD. Afati i përfundimit të punimeve është shtyrë për datë 31.03.2020.

Përveç punimeve të cilat nevojiten të realizohen, si pasojë e shtesës në afatin e përfundimit të punimeve nevojiten edhe shpenzime të tjera të cilat nuk ndikojnë në efektivitetin e punimeve siç janë shpenzimet e përgjithshme. Deri në përfundimin e afatit të parashikuar me 31.03.2020, janë parashikuar shpenzime shtesë për sigurime, kosto e operimit të automjeteve në disponim të mbikëqyrësit të punimeve, kosto laboratorit dhe pagesa për drejtues mjeti me vlerë 363,541 USD, vlerë e cila përbën efekt negativ financiar. Për periudhën nga data 31.03.2020, janë realizuar shpenzime të tjera për aksesin e mbikëqyrësit të punimeve. Për këtë periudhë këto shpenzime janë shtuar me vlerë **577,055.6 USD, vlerë e cila konsiderohet shpenzime pa efektivitet**, e cila vjen si pasojë e mos realizimit të punimeve në afatin e përcaktuar në kontratë. Kjo vlerë i shtohet shpenzimeve të përcaktuara në auditimin e mëparshëm me vlerë 363,541 USD.

Urdhër ndryshimi nr. 4, me vlerë 10,310,700 USD, ka të bëjë me rishikimin e projektit të urave 1, 2 dhe 3, si dhe punime për stabilizimin dhe mbrojtjen e shpateve në kilometër 18.9 deri kilometër 28.7.

Urdhër ndryshimi nr. 5, me vlerë 7,813,033 USD, ka të bëjë me stabilizimin dhe mbrojtjen e skarpateve nga kilometër 28.7 deri 29.1.

Urdhër ndryshimi nr. 6, me vlerë 2,937,405 USD, ka të bëjë me furnizim pajisje për rrugë, shenja rrugore etj.

Urdhër ndryshimi nr. 7, me vlerë 3,497,128 USD, ka të bëjë me infrastrukturën elektromekanike dhe panele për tunelet. Deri në momentin e auditimit, nuk është proceduar me urdhër ndryshimi nr. 4, 5, 6 dhe 7, në pritje të miratimit të fondeve.

Me miratimin e këtyre ndryshimeve, vlera e kontratave pritet të shkojë 92,216,207 USD. Veprime jo në përputhje me ligjin nr. 128/2013 datë 25.04.2013 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Istisna'a dhe të marrëveshjes së agjencisë Istisna'a ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim për Ndërtimin e Segmentit Qukës-Qafë Plloçë, si pjesë e Korridorit rrugor Tiranë-Korçë, për lot<sup>in</sup> 1 dhe 2”. Seksioni 2 “Ndërtimi dhe përfundimi i Asetit” pika 2.3 “Në përputhje me seksionet 3 dhe 6, ndërtimi i Asetit do të përfundohet brenda 4 (katër) vjetëve nga data e disbursimit të parë”. (Trajtuar më hollësisht në pikën 5, faqe 46 deri 70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** ARRSH të marrë masa që për projektet në zbatim të menaxhojë në mënyrë sa më korrekte zbatimin e tyre, në mënyrë që të shmangen shtesat e afateve të përfundimit të punimeve, me synim zvogëlimin e kostove të pa nevojshme dhe vënien në eficiencë të veprave në afatet e parashikuara, duke arritur kthimin e investimit po në këto afate.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nuk ka patur projekte të reja me financime nga donatorë të huaj por do të merret në konsideratë në momentin e realizimit të tyre.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga fakti se ARRSH nuk ka patur deri aktualisht projekte me financime nga donatorë të huaj, ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi*.

**2. Gjetje nga auditimi:** Në preventivin e punimeve, zëri 2.2 “Shërbime për stafin e inxhinierit” janë parashikuar furnizimi i 12 automjeteve në shërbim të mbikëqyrësit të punimeve dhe PMU. Duke marrë në konsideratë faktin se për lot 1 dhe lot 2, është parashikuar furnizimi i 5 automjeteve, rezulton se për këtë kontratë numri i tyre është mbi nevojat për këtë shërbim. Nisur nga fakti se kontrata e mbikëqyrjes së punimeve është pezulluar për faktin e mos financimit të punimeve, mbajtja e tyre në përdorim të mbikëqyrësit të punimeve do të rrisë kostot e projektit për shërbime të pa nevojshme. Po ashtu, bazuar në specifikimet teknike, duke qenë se këto mjete në përfundim të kontratës do të kalojnë si asete pranë ARRSH, me kalimin e kohës ato do të amortizohen. Për Kontratën loti 1 dhe 2, janë parashikuar 3 automjete Tip A, 1 automjet Tip B dhe 1 automjet Tip C, ndërsa për lot 3, janë parashikuar 4 automjete Tip A, 3 automjete Tip B, 4 automjete Tip C dhe 1 automjet Tip D. Bazuar në pagesat e realizuara sipas zërit të mësipërm, si pasojë e parashikimit të pa argumentuar në preventivin original të punimeve, për këtë segment është shpenzuar më tepër vlera 92,000 USD (1 automjet Tip A x 15,000 USD + 2 automjete Tip B x 13,000 USD + 3 automjete Tip C x 12,000 USD + 1 automjet Tip D x 15,000 USD). Duke qenë se dorëzimi i automjeteve në përfundim të kontratës shoqërohet me amortizim të tyre (sidomos për faktin e shtyrjes së afatit të përfundimit), **vlera 92,000 USD, përbën rritje të pa argumentuar të kostos së projektit dhe konsiderohet shpenzim pa efektivitet për projektin.** Megjithëse problematika e trajtuar më sipër është trajtuar edhe në auditimin e mëparshëm, nuk janë marrë masat e kërkuara (Trajtuar më hollësisht në pikën 5, faqe 46 deri 70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** ARRSH të marrë masa për monitorimin e projekt zbatimeve dhe preventivave përkatës për projekte në proces dhe ato që do hartohen në të ardhmen, në mënyrë që të shmangen kostot e pa nevojshme dhe jo efektive në realizimin e projekteve.

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nuk ka patur projekte të reja me financime nga donatorë të huaj por do të merret në konsideratë në momentin e realizimit të tyre.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga fakti se ARRSH nuk ka patur deri aktualisht projekte me financime nga donatorë të huaj, ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi*.

**2.2 Rekomandimi:** Njësia e Menaxhimit të Projektit, t'i kërkojë kontraktorit dorëzimin e menjëhershëm të automjeteve të pa nevojshme në dispozicion të Mbikëqyrësit të Punimeve dhe tyre pranë ARRSH. Me rifillimin e punimeve, në zërin shpenzime të përgjithshme të bëhet reduktimi i shpenzimeve për drejtues mjete, shërbimet e mirëmbajtjes apo shpenzime të tjera për këtë automjete, me synim reduktimin e kostove të pa arsyeshme dhe të pa argumentuara.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I papranuar*

**Komenti i subjektit:** Nuk ka.

**Komenti i audituesve:** Në lidhje me këtë rekomandim nuk u vu në dispozicion asnjë dokument mbi dorëzimin e mjeteve të panevojshme nga ana e mbikëqyrësit në ARRSH.

#### **IV KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

Në përfundim të procesit të auditimit, nga Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën nr. 8/6 port., datë 30.06.2022 (*administruar në subjekt me nr. 7323 prot., datë 05.07.2022*), konstatohet se 50 % e rekomandimeve të pranuar janë zbatuar dhe nga ana e subjektit janë në proces zbatimi rekomandimet në lidhje me masat organizative si dhe ato për përdorimin e fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet. Duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **rikërkojmë** vijimin e përpjekjeve duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore deri në zbatimin e plotë të rekomandimeve në proces.

### **3.15.. FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT Projekti Ndërtimi i Rrugës së Lumit të Vlorës**

#### **PËRMBLEDHJE**

Kontrrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në Fondin Shqiptar të Zhvillimit mbi “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022” për auditimin e kryer në vitin 2022 për Projektin “Ndërtimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”, për periudhën nga fillimi i Projektit (2016) deri me datë 31.12.2021 paraqitur me shkresën e administruar në KLSH me nr. 6/11 port., datë 22.11.2022 dhe në FSHZH me nr. 241/19 prot., datë 23.11.2022, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH<sup>së</sup> të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2022, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

- a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
- b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
- c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve;
- ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në subjekt u mbajt Akt Verifikimi nr. 1, datë 08.09.2023, administruar në Zyrën e FSHZH me nr. 2751/2 prot, datë 04.09.2023, për të cilin nuk është paraqitur observacion nga ana e subjektit. Pas dërgimit të Projektraportit të Auditimit, nga ana e subjektit janë paraqitur observacionet të cilat janë trajtuar përgjatë materialit.

**Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:**

**I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.**

*-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, FSHZH ka respektuar këtë afat duke kthyer përgjigje sipas shkresës së administruar në FSHZH me nr. 241/20 prot., datë 12.12.2022. Gjithashtu, është ngritur Urdhri nr. 53, datë 12.12.2022 me objekt “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH mbi gjetjet e konstatuara nga auditimi i Projektit Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”.*

**II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.**

-Nga ana e subjektit të audituar janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas parashikimeve në Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: *“Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”,* Konkretisht, sipas shkresës së administruar në FSHZH me nr. 1856 prot., datë 17.05.2023 me objekt *Raportim mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të Auditimit të Përputhshmërisë për Projektin ‘Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës’* është informuar KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

**III. Rekomandimet e KLSH**

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 6/11 port., datë 22.11.2022 dhe në FSHZH me nr. 241/19 prot., datë 23.11.2022, janë rekomanduar gjithsej:

- a. Janë rekomanduar **9 masa organizative;**
- b. Është rekomanduar **1 masë për shpërblim dëmi në vlerën 1,307,114 lekë;**
- c. Janë rekomanduar **2 masa për përdorimin me shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomikitetit, eficiencës dhe efektivitetit në shumën 140,760,283.45 lekë;**
- d. Është rekomanduar **1 masë disiplinore për punonjësit e gjetur me përgjegjësi.**

#### **IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH**

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 6/11 port., datë 22.11.2022 dhe në FSHZH me nr. 241/19 prot., datë 23.11.2022, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si me poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Organizative	9 masa	7	2
2	Shpërblim dëmi	1 masë 1,307,114 lekë	1 695,700 lekë	1 611,414 lekë
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	2 masa 140,760,283.45 lekë	2 masa 140,760,283.45 lekë	-
4	Masa Disiplinore	1 masë	-	1

#### **V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit**

Në mënyrë të përmblodhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	7 masa	3	-	3	1
2	Shpërblim dëmi	1 695,700 lekë	-	1 masë 695,700 lekë	-	-
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	2 masa 140,760,283.45 lekë	1 masë 129,292,638.45	-	1 masë 11,467,645	-

#### **I/1 HYRJA**

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 702/1, prot., datë 04.08.2023, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. A.L, (Përgjegjës grupi)
2. J.H.

#### **I/2. OBJEKTI AUDITIMIT**

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 6/11 port., datë 22.11.2022 dhe në FSHZH me nr. 241/19 prot., datë 23.11.2022, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

#### **I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:**

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.



#### I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

#### I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH për Projektin “Ndërtimi i Rrugës së Lumit të Vlorës” me shkresën nr. 6/11 port., datë 22.11.2022 dhe në FSHZH me nr. 241/19 prot., datë 23.11.2022, rezulton se nga **13** masa të rekomanduara (*organizative, shpërblim dëmi dhe 3-E, Disiplinore*), janë pranuar nga subjekti **10** masa ose **76.9 %**. **Nga të pranuarat (10)**: janë zbatuar plotësisht **4**, ose **40 %** e tyre, është zbatuar pjesërisht 1 masë, ose **10 %**, janë në proces zbatimi **4** masa ose 40 % dhe nuk është zbatuar një masë ose **10 %**.

Nga sa shikohet niveli i realizimit është në masën 40 %, gjë e cila tregon se FSHZH e ka vlerësuar procesin e zbatimit të rekomandimeve por duhet të vijojë përpjekjet për zbatimin e plotë të rekomandimeve të tjera të zbatuara pjesërisht, atyre në proces si dhe të marrë nisma për zbatimin e rekomandimeve të pazbatuara.

Nr.	Lloji rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	7 masa	3	-	3	1
2	Shpërblim dëmi	1 695,700 lekë	-	1 masë 695,700 lekë	-	-
3	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	2 masa 140,760,283.45 lekë	1 masë 129,292,638.45	-	1 masë 11,467,645	-
<b>SHUMA</b>		<b>10</b>	<b>4</b>	<b>1</b>	<b>4</b>	<b>1</b>

#### II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 40 % kurse ai i atyre të zbatuara pjesërisht dhe atyre në proces është 50 %, nivele këto të cila tregojnë vlerësimin e këtij procesi në lidhje me ndjekjen e procedurave të duhura për zbatimin e rekomandimeve por edhe domosdoshmërinë për të vijuar përpjekjet për zbatimin e plotë të rekomandimeve të tjera të zbatuara pjesërisht, atyre në proces si dhe marrjen e nismave për zbatimin e rekomandimeve të pazbatuara.

#### III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

*III/1-Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”. -Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, FSHZH ka respektuar këtë afat duke kthyer përgjigje sipas shkresës së administruar në FSHZH me nr. 241/20 prot., datë 12.12.2022. Gjithashtu, është ngritur Urdhri nr. 53, datë 12.12.2022 me objekt “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH mbi gjetjet e konstatuara nga auditimi i Projektit Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”.*

**III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.**

-Nga ana e subjektit të audituar janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas parashikimeve në Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se:

*“Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”,*

Konkretisht, sipas shkresës së administruar në FSHZH me nr. 1856 prot., datë 17.05.2023 me objekt *Raportim mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të Auditimit të Përputhshmërisë për Projektin ‘Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës’* është informuar KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

**III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:**

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me marrëveshjet e financimit rezulton se marrëveshja e ratifikuar me ligjin nr. 50/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab për financimin e projektit “Rehabilitimi i rrugës së lumit të Vlorës” ka parashikuar përfundimin e Projektit me datë 31.12.2019, përfundimin e afatit të disbursimit me datë 31.12.2020 si dhe financimin sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Zëri	Alokimi i shumave (Dinarë Kuvajtian)	Përqindja e kostos totale të zërit
1	Ndërtimi i punimeve civile	9,913,000	77 %
2	Shërbime Konsulence	777,000	100 %
3	Kontigjenca të pa alokuara	1,310,000	
	TOTAL	12,000,000	

Në lidhje me sa më sipër duhet theksuar fakti se termi ‘Projekt’ i referohet pjesës korresponduese të punimeve dhe konsulencës që mund të realizohet me këtë shumë. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se, me shkresën e administruar në MFE me nr. 2455/1 prot., datë 25.02.2019 është bërë kërkesë për rialokimin e fondeve nga kategoria *Kontigjenca të pa alokuara* në shumën 1,310,000 KD në llogari të kategorisë *Ndërtimi i punimeve civile*, shtyrjes së datës së përfundimit të punimeve deri me datë 31.12.2021 si dhe zgjatjen e afatit të disbursimit të fondeve të Projektit deri me datë 31.12.2022. Konkretisht është kërkuar të miratohet kalimi i fondeve sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Zëri	Alokimi i shumave (Dinarë Kuvajtian)	Përqindja e kostos totale të zërit
1	Ndërtimi i punimeve civile	11,223,000	77 %
2	Shërbime Konsulence	777,000	100 %
3	Kontigjenca të pa alokuara	0	0
	TOTAL	12,000,000	

Me shkresën nr. 4344/1 prot., datë 27.03.2019, administruar në FSHZH me shkresën me nr. 438/1 prot., datë 29.03.2019, është dërguar nga ana e Ministrisë së Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj, Drejtoria e Bashkërendimit dhe Sigurimit të Ndihmës së Huaj, Sektori i Sigurimit të Ndihmës së Huaj dhe Marrëveshjeve, shkresa me lëndë *Mbi kredinë e Fondit të Kuvajtit për financimin e Projektit të rehabilitimit të rrugë së Lumit të Vlorës*. Sipas kësaj shkrese MFE ka njoftuar FSHZH për miratimin e rialokimit të fondeve dhe për faktin se Fondi Kuvajtian nuk ka shprehur ndonjë kundërshti në lidhje me shtyrjen e afateve si dhe për faktin se kanë qenë duke u vijuar komunikimet me Fondin Kuvajtian me qëllim formalizimin e ndryshimeve të kërkuara nëpërmjet një dokumenti ndryshues. Në fakt, referuar këtij dokumenti të datës 26.03.2019 bashkëlidhur rezulton se nga ana e Fondit Kuvajtian është dhënë miratimi për rialokimin e fondeve si dhe për zgjatjen e afatit të disbursimit por nuk është shprehur mendim në lidhje me zgjatjen e afatit të realizimit Projektit. Pas një kërkesë të Fondit Kuvajtian në lidhje me një dokument amendimi të propozuar nga pala shqiptare, me shkresën e administruar në MFE me nr. 2455/4 prot., datë 03.07.2019 është dërguar në FSHZH për mendim draft dokumenti ndryshues i Marrëveshjes së Huas duke përfshirë në këtë draft ndryshimet në lidhje me:

*Rialokimin e fondeve të kontigjencës;*

*Shtyrjen e afatit të përfundimit të Projektit deri më datë 31.12.2021;*

*Shtyrjen e afatit të disbursimit deri më 31.12.2022;*

Në rrugë elektronike i është dërguar Fondit Kuvajtian më datë 16.07.2019 Drafti i ndryshimit të Marrëveshjes së Huas si më sipër nga ana e të cilit është kthyer përgjigje me datë 05.09.2019 duke miratuar këtë Draft. Me shkresën e administruar në MFE me nr. 19184/5prot., datë 28.01.2020 është njoftuar Fondi Kuvajtian në lidhje me Miratimin në Parim të Marrëveshjes Ndryshuese të Marrëveshjes së Huas dhe me pas kjo është miratuar me VKM nr. 178, datë 26.02.2020 “*Për miratimin e Marrëveshjes Ndryshuese, me Shkëmbim Letrash, të Marrëveshjes së Huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit, për Zhvillimin Ekonomik Arab, për Financimin e Projektit “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”, ratifikuar me ligjin nr. 50/2016*”. Nga sa më sipër rezulton se miratimi me VKM i shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve është kryer përtej afatit në të cilin punimet duhet të kishin përfunduar, kjo pavarësisht miratimit me shkëmbim letrash mes palëve. Sa më sipër është në kundërshtim me marrëveshjen e ratifikuar me ligjin nr. 50/2016, “*Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab për financimin e projektit “Rehabilitimi i rrugës së lumit të Vlorës”, Shtojca 2 Përshkrimi i Projektit si dhe Ligji nr. 43/2016, “Për Ratifikimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, neni 23 Ndryshimi i marrëveshjeve ndërkombëtare. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 16 – 18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Nga ana e FSHZH, në cilësinë e Njësinë Zbatuese të Projektit, të merren masa për të intensifikuar përpjekjet për miratimin në kohë dhe brenda afateve të parashikuara të ndryshimeve të kushteve të marrëveshjeve të financimit si dhe njoftimin e MFE për rastet kur marrëveshjet janë në kushtet e zbatimit të tyre jashtë afateve të miratuar në marrëveshjet përkatëse.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *L pranuar*

**Komenti i subjektit:** *FSHZH ka bërë të gjitha përpjekjet maksimale për të njoftuar në kohë dhe vazhdimisht si për këtë projekt ashtu edhe për projektet e tjera por nisur nga fakti se FSHZH nuk ka asnjë të drejtë për të ndërmarrë dhe për të përmbyllur drejtpërdrejtë procedurat për lidhjen dhe për ndryshimin e marrëveshjes së financimit, praktika ka ngelur në pritje të miratimeve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Punëve të Jashtme. Megjithatë në vijimësi*

*FSHZH do të intensifikojë përpjekjet por ritheksojmë se miratimi i praktikave do kohën e nevojshme.*

**Komenti i audituesve:** Nisur nga fakti se FSHZH nuk ka patur deri aktualisht projekte me financime nga donatorë të huaj, ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi*.

**2. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me objektivat e projektit rezulton se në Shtojcën 2 të Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Arab, datë 30.03.2016, është përcaktuar se komponentët kryesore të projektit do të jenë si më poshtë:

*1. Përgatitja e punimeve në vendin e punës; 2. Shtrimi i sipërfaqes; 3. Rehabilitimi i kullimit, duke përfshirë ura, tombino, mure mbajtës, gjithashtu siguria dhe ndriçimi, etj. 4. Shërbimi i konsulencës.*

Gjithashtu, objektivi kryesor i projektit është përcaktuar realizimi i punimeve në përputhje me standardet e pranuar dhe *qëndrueshmëria e infrastrukturës publike*, në zonën e Bregdetit të Jugut, specifikisht në zonën e Lumit të Vlorës, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët dhe ridimensionimin e sektorit të turizmit si një nga shtyllat kryesore të ekonomisë lokale dhe rajonale.

Në zbatim të kërkesave Shtojca 3, pika 4, të Marrëveshjes së Huas datë 30.03.2016, është lidhur Kontrata e Shërbimit të Konsulencës për projektin “*Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës*”, ndërmjet FSHZH dhe konsulentit “*JV P. & E. G*” në datë 18.01.2018.

- Nga auditimi, nuk rezulton vlerësimi i objektivave se projekti do të gjenerojë një numër të konsiderueshëm të përfitimeve social-ekonomike dhe ambientale si *Mundësinë e hyrjes në rrugën e përmirësuar; Mundësi më e madhe për lidhjen me tregjet rajonale dhe lokale për tregtimin e produkteve lokale, përmirësimin e ndëreveprimin social; Uljen e papunësisë nëpërmjet krijimit të punëve të reja dhe intensifikimit të aktiviteteve ekonomike ekzistuese; Diversifikimin e ekonomisë lokale nëpërmjet promovimit të aktiviteteve të turizmit; Bashkëveprimin social të përmirësuar dhe rritjen e aktiviteteve kulturore dhe sportive; Pakësimin e familjeve që jetojnë nën nivelin e varfërisë, etj*, parashikuar në Shtojcën A, pika II Objektivat, të kontratës së sipërcituar (ToR).

- Nga auditimi, rezulton se Kontraktori nuk ka respektuar kriteret ku kërkohet që Raporti Fillestar duhet të përshkruaj planin që Konsulenca ka vendosur lidhur me detyrat e saj, si edhe stafin, gjithashtu edhe vërejtjet siç ajo i gjykon parashikuar në pikën 2, Shtojca B “*Kërkesa Raportuese*” të Kontratës Konsulencës.

- Nga auditimi, rezulton se FZSHH nuk ka administruar një Raport Fillestar (Inception Report) i konsulentit me elementet kryesore përbërës, ku përfshin synimet dhe objektivat e projektit, gjithashtu Manualin e Kontrollit të Cilësisë bashkëlidhur, parashikuar në seksionin VI, Shtojca A, të Kontratës së Konsulentit.

- Gjithashtu rezulton se FZSHH nuk ka të dhëna për punësimin e punëtorëve lokalë nga Kontraktori sipas përcaktimeve në Kontratën e Punës, Kushtet e Aplikimit të Veçantë, Pjesa II A, pika 27, paragrafi i shtuar i nën-pikës 34.1.

- Nga raportet e konsulentit nuk rezulton të jetë raportuar në mënyrë të veçantë për infrastrukturën urbane, gjithashtu mbi realizimin e hyrjeve-daljeve të fshatrave të zonës në rrugën e Lumit të Vlorës, për pasojë nuk rezulton e qartë mënyra dhe përgjegjësia e realizimit të tyre sipas kërkesave në seksionin II, Shtojca A, “*Përshkrimi i Projektit*” të Kontratës së Konsulentit ku përcaktohet se ndërtimi i infrastrukturës urbane përbëhet nga trotuaret, zonat e parkimit, ndriçimi publik, vendosja e kabllit optik, instalimi i sinjalistikës rrugore, etj.

- Gjithashtu me përfundimin e punimeve, (dy lotet e para) bashkitë respektive për çdo prej kontratave të punimeve, gjatë inspektimeve të tyre nuk kanë marrë pjesë, dhe për pasojë nuk kanë firmosur Certifikatat e Përfundimit të Punimeve siç është parashikuar në nenin 5 “Për realizimin e punimeve” të Marrëveshjeve të Investimit.

Sa sipër, duke qenë se pronari i rrugës që rehabilitohet është Autoriteti Rrugor Shqiptar, kontratat e mësipërme nuk kanë krijuar mundësi për funksionimin e duhur midis aktorëve të projektit dhe për këtë arsye ato duhet të përmirësohen. Sa më sipër është në kundërshtim me Kushtet e Aplikimit të Veçantë, Pjesa II A, pika 27, nën-pika 34.1, të kontratës së punimeve, Kapitulli IV Shtojca, Aneksi A, seksionet II dhe VI, e Kontratës për Shërbimin e Konsulencës “Për rehabilitimin e rrugës së Lumit të Vlorës”, ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe JV “P.” & “E. G”, datë 18.01.2018, Kreu II Objektivat si dhe Kërkesat e Shtojcës 2, të Marrëveshjes së Huas datë 30.03.2016.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 19 – 22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** Drejtori Ekzekutiv i FSHZH, nëpërmjet Departamentit të Menaxhimit të Projekteve, si edhe Njesisë përkatëse të Menaxhimit të Projektit të marrë masa për vlerësimin aktual të objektivave të matshëm për projektin “Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës” deri në përfundimin e projektit me qëllim arritjen e qëndrueshmërisë të infrastrukturës urbane dhe përfundimin me sukses të rehabilitimit të rrugës të Lumit të Vlorës.

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Vlerësimi i plotë i objektivave do të realizohet pas përfundimit të plotë të projektit, pra pas garancisë së punimeve edhe për lotin e III, me përfshirjen e të gjitha palëve të nevojshme.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga fakti se ende është në proces garancie loti i III, ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi*.

**2.2 Rekomandimi:** Drejtori Ekzekutiv i FSHZH të marrë masa për ndryshimet përkatëse të marrëveshjeve të investimeve me bashkitë, për të përcaktuar kërkesa dhe përgjegjësi të qarta vendimmarrjen nga ana NjVV për pjesë e tyre të territorit, ashtu edhe për pjesëmarrjen e tyre si aktorë në realizimin e projektit.

**Në vijimësi**

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e FSHZH janë marrë masa për zbatimin e këtij rekomandimi.

**Komenti i audituesve:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht marrëveshjes së investimit me Bashkinë Berat dhe Bashkinë Gjirokastër rezulton se FSHZH ka rritur kërkesat/detyrimet e Bashkive në drejtim të realizimit të tyre. Për rrjedhojë ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *I zbatuar*.

**3. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me disbursimet referuar pjesës së financimit të Kredisë nr. 943, për Projektin për sa i përket kontratave të sipërmarrjeve të punimeve për Lot I dhe Lot II është konstatuar se në pesë raste disbursimet e IPC<sup>ve</sup> nuk janë kryer brenda afateve të parashikuara në klauzolën nr. 60.11 të kontratave. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se janë hasur vonesa në disbursimin e IPC<sup>ve</sup> për pjesën takuese prej 77 % të mbuluar Fondi Kuvajtian. Nga këto 5 raste, në 2 prej tyre, sipas shkresës së administruar në FSHZH me nr. 889 prot., datë 07.06.2019, nga ana e Kontraktorit për LOT 1 “A. M.-T. M”, janë paraqitur ankesa (*Claim*) për IPC<sup>të</sup> 5 dhe 6. Në vijim të korrespondencave mes Fondit Kuvajtian,

FSHZH, Kontraktorit dhe Supervizorit është dakordësuar mes palëve tërheqja për ankesën me datë 03.07.2019 në takimin e muajit. Sa më sipër është në kundërshtim me Klauzolën 60.11, e Kontratave të Sipërmarrjes së Punimeve për Lot I dhe Lot II.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 23 – 26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:** Nga FSHZH, Drejtori Ekzekutiv, Drejtori i Departamentit të Menaxhimit të Projekteve dhe Përgjegjësi i Njësisë së Projektit të merren masat e nevojshme organizative dhe mbikëqyrëse duke shmangur të gjitha praktikave penguese në disponibilitetin e fondeve në mënyrë që procesi i pagesave të IPC<sup>ve</sup> të realizohet brenda afateve të përcaktuar në kontratë duke eliminuar mundësitë për penalitete (*Claim*) nga kontraktorët.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e FSHZH janë intensifikuar përpjekjet për shmangien e praktikave penguese me pasojë mundësitë për ankesa nga kontraktorët. Aktualisht nuk rezultojnë ankesa në lidhje me vonesat e pagesave.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *I zbatuar*, megjithatë konfirmimi i këtij konkluzioni do të bëhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**4. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me disbursimet rezulton se në Marrëveshjen Financiare të ratifikuar me ligjin nr. 50/2016 datë 5.5.2016 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab t të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab për Financimin e Projektit “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës” me vlerë financimi 12,000,000 dinarë kuvajtian (afërsisht 4,828,677,230 lekë), nuk është parashikuar mënyra e lëvrimit të shumave të huas nga Fondi Kuvajtian. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky lëvrim është kryer si më poshtë:

- Pas marrjes së aplikimit nga FSHZH, Fondi Kuvajtian urdhëron Bankën Kombëtare të Kuvajtit për disbursimin e shumave të aplikuara dhe në këtë moment njoftohet edhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë me anë të dokumentit *Debit Advice* për urdhër transfertën;
- Nga Banka Kombëtare Kuvajtiane shuma lëvrohet në një llogari në CITI Bank New York në Shtetet e Bashkuara të Amerikës;
- Kjo shumë kalon më pas nga CITI Bank New York në llogari të kontraktorit apo konsulentit, sipas rastit.

Mos parashikimi i procedurës dhe afatit të nevojshëm për lëvrimin e fondeve deri në llogarinë e përfituesit final si dhe kalimi i pagesave në hallkat e mësipërme ka sjellë si rezultat vonesa në disbursimin e pagesave pjesore (IPC), duke mos u respektuar afatet e parashikuara në kontratën e sipërmarrjes së punimeve dhe asaj të konsulencës e duke e ekspozuar FSHZH si implementues të Projektit ndaj riskut për penalitete nga ana e Kontraktorëve (*Claim*). Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 775, datë 24.09.2010 “Për administrimin e financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë”, pika 18.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 23 – 26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1 Rekomandimi:** Nga FSHZH të merren masa në të ardhmen që, në fazën e negocimeve me donatorët, draft - Marrëveshjet Financiare të përfshijnë edhe mënyrën e lëvrimit të shumave të huas në llogari të përfituesit final.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I papranuar*

**4.2 Rekomandimi:** Nga FSHZH të merren masa në të ardhmen që gjatë lidhjes së kontratave të cilat financohen nga donator të huaj në afatet e pagesave të parashikuara në to, të përfshihen edhe afatet të cilat i duhen donatorit për të kryer disburimin final për pjesën takuese, duke shmangur penalitetet e mundshme.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Siç e kemi thënë edhe më parë, rekomandimi do të merret në konsideratë në çdo rast kur afati i pagesave nga donatori do të jetë i përcaktuar në marrëveshjen e huasë.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi* megjithatë konfirmimi i këtij konkluzioni do të bëhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**5. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratave për punime civile, rezulton se Kontraktori A. M.-T. M. ka nisur punimet në datën 30.03.2017 me njoftimin për fillimin e punimeve nga mbikëqyrësi i përkohshëm i emëruar nga klienti (FSHZH). Me Vendimin nr. 04, datë 27.03.2017 të Drejtorit Ekzekutiv të FSHZH (Klienti), është emëruar Z. Xh.N si mbikëqyrës i përkohshëm i punimeve për objektin “*Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës aksi Selenicë-Kuç-Qeparo*” Lot 1. Në fakt veprimet e Fondit Shqiptar të Zhvillimit kanë rezultuar në kundërshtim me kërkesat e Shtojcës 3, pika 4, të Marrëveshjes së Huas datë 30.03.2016, për zgjedhjen e konsulentit. Gjithashtu, nuk është respektuar Ligji nr. 8417, datë 22.11.1998, neni 122 pika 2 ku përcaktohet përparësia e marrëveshjeve ndërkombëtare, në rastin kur ligjet e vendit nuk pajtohen me të. Në shkresën e kontraktorit Ref. Nr. ATM/BA/pmt/006 datë 09.06.2017, drejtuar klientit (FSHZH), është bërë me dije mungesa e funksionimit të mbikëqyrësit të përkohshëm. Me shkresën e sipërcituar është njoftuar klienti (FSHZH), se nuk është marrë akoma njoftimi zyrtar për fillimin e punimeve, gjithashtu nuk është rishikuar nga mbikëqyrësi i përkohshëm programi në vendin e punimeve dhe përcaktimi i buxhetit me ndryshimet e mundshme përkatëse. Kërkesa e sipërcituar nga Kontraktori është mbështetur në Kushtet e Aplikimit të Posaçëm, pjesa II A, pika 1, nën-pika 1.1.(a) (iv) e kontratës punimeve CWC/ICB/2016/1 datë 24.02.2017, ku përcaktohet se inxhinieri (konsulenti) i caktuar nga punëdhënësi vepron si inxhinier për qëllimet e kontratës dhe jo si inxhinier thjesht i emëruar. Gjithashtu, sipas pikës 5 në kushtet e sipërpërmendura, nën-pika 2.1(b) inxhinieri siguron aprovimin specifik përpara se klienti (FSHZH) të ushtrojë autoritetin e tij. Mbikëqyrësi i përkohshëm, gjatë periudhës 30.03.2017-31.01.2018, nuk ka mundur të ushtrojë veprimtarinë e tij për kontrollin dhe certifikimin e punimeve të kryera. Mbikëqyrësi, duke qenë një individ i emëruar, nuk plotësonte kushtet lidhur me kapacitetet e konsulentit të parashikuara në termat e referencës, ku është parashikuar një staf me disa inxhinierë mbikëqyrës në vend, inxhinierë të kontrollit të cilësisë, inxhinierë topograf, si edhe specialist ambienti, etj. Qëllimi i shërbimit të mbikëqyrjes (konsulentit apo inxhinierit), konform pikës 1 shkronja d) të Udhëzimit për Konsulentët të Fondit (Huadhënësi), është të sigurojë implementimin e projektit në përputhje me vizatimet dhe specifikimet teknike, si dhe të sigurojë që shërbimet teknike të jenë të lidhura me interpretimet e dokumenteve të kontratës, kontrollin e shpenzimeve, certifikimin e materialeve, volumet dhe faturat e dorëzuara nga Kontraktori, gjithashtu, ndryshime të tilla të projektit dhe specifikimeve teknike që bëhen të domosdoshme gjatë realizimit të projektit. Nga ana e klientit (FSHZH) nuk është provuar me dokumente, raportime dhe akte që mbikëqyrësi i përkohshëm të ketë ushtruar kontrollet e sipërpërmendura, orientimet (instruksionet), dhe certifikimet e punimeve përkatëse. Nga auditimi konstatohet se Kontraktori ka kryer punime në vlerën prej **686,634,246 lekë** pa TVSH për periudhën 30.03.2017-30.01.2018, dhe për shkak të mungesës të funksionimit të mbikëqyrjes (certifikimin e punimeve

dhe miratimit të situacioneve përkatëse) nuk ka marrë asnjë pagesë. Kontrata e shërbimit të konsulencës për projektin “Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës”, ndërmjet FSHZH dhe konsulentit JV P. & E. G është lidhur në datë 18.01.2018, ndërkohë që punimet kishin filluar në datë 30.03.2017. Nga shërbimi i konsulencës është miratuar Certifikata e Ndërmjetme e Pagesës (IPC) nr. 1 datë 21.05.2018 për periudhën e punimeve 30.03.2017-31.03.2018 dhe për volumet që janë mbështetur me dokumente justifikues, në vlerën prej **395,110,145.00 lekë** ose 23.7 % e vlerës gjithsej prej 1,669,014,765 lekë pa TVSH, të parashikuar në preventivin fitues të tenderit. Sa sipër, Kontraktori ka patur një progres të ulët të kryerjes së punimeve. Certifikata e Ndërmjetme e Pagesës nr. 1 (IPC nr. 1) është dorëzuar nga Kontraktori për shqyrtim tek konsulenti në datë 24.04.2018. Certifikata e Marrjes në Dorëzim (TOC) është lëshuar nga konsulenti në datën 26/11/2019. Certifikata Finale e Pranimi, pas periudhës së përgjegjësisë për defektet, është lëshuar në datën 26.11.2020. Veprimet e Fondit Shqiptar të zhvillimit rezultojnë në kundërshtim me Kushtet e Aplikimit të Posaçëm, pjesa II A, pika 1, nën-pika 1.1.(a) (iv) e kontratës CWC/ICB/2016/1 datë 24.02.2017 dhe pikës 5 në kushtet e sipërpërmendura, nën-pika 2.1(b), gjithashtu në kundërshtim me pikën 1 shkronja d) të Udhëzimit për Konsulentët të Fondit (Huadhënësi) si dhe me kushtet teknike të parashikuara në projektin e zbatimit, duke shkaktuar si pasojë kryerjen e punimeve nga Kontraktori pa miratimin paraprak dhe pa certifikimin e konsulentit, në vlerën prej 686,634,246 lekë pa TVSH. Këtë e vërteton jo vetëm fakti se për periudhën në fjalë Kontraktori nuk ka përfituar asnjë pagesë nga klienti, por edhe fakti që punimet e kryera për periudhën e mësipërme janë certifikuar për herë të parë nga konsulenti i përzgjedhur JV P. & E. G, i cili ka filluar veprimtarinë në fillim të Shkurtit 2018. Veprimet e Klientit në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator kanë shkaktuar rritjen e riskut për kryerjen e punimeve jashtë standardeve të parashikuara në specifikimet teknike. Faktikisht sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga inspektimi në vendin e punimeve të konsulentit, në datat 19-20 Qershor 2018, është gjetur se Kontraktori nuk ka përmbushur specifikimet teknike për shtresën e zhavorrit të imët (ana e djathtë e rrugës) në seksionet si më poshtë:

-km 1+600-km 1+670 gjerësia e seksionit tërthor e shtresës është gjetur 5-10 cm

- km 1+950-km 2+125 gjerësia e seksionit tërthor e shtresës është gjetur më pak se 10 cm.

Sipas seksionit 28.02, pika 4 e Specifikimeve Teknike, gjerësia e seksionit tërthor të shtresës duhet të ishte 20 cm. Sa më sipër, veprimet e klientit kanë shkaktuar përfundimin e kontratës CWC/ICB/2016/1 me rreth 44 muaj, nga 39 muaj të parashikuara ( përfshi 3 muaj shtesa e miratuar). Sa më sipër është në kundërshtim me Marrëveshja e Huas, neni IV seksioni 4.04, seksioni 4.05, Shtojca 3, pika 4 e Marrëveshjes së Huas datë 30.03.2016, Neni 122 pika e ligjit nr. 8417, datë 22.11.1998 “Kushtetuta e Shqipërisë”, Pika 1, nën-pika 1.1.(a) (iv) II A e kontratës punimeve CWC/ICB/2016/1 datë 24.02.2017, Pika 5, nën-pika 2.1(b) e Kushteve të kontratës së punimeve II A, pika 1 shkronja d) e Udhëzimit për Konsulentët të Fondit (Huadhënësi).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 31 – 41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1 Rekomandimi:** Drejtori Ekzekutiv i FSHZH me Departamentin e Menaxhimit të Projekteve dhe Njësinë përkatëse të Menaxhimit të Projektit të analizojnë rezultatet e dy loteve të para të projektit “Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës”, si edhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për një koordinim më të mirë midis aktorëve përgjegjës për realizimin e projektit brenda afateve të parashikuara nga Marrëveshja e Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Arab.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I papranuar*



**6. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për objektin “*Loti II - Ura e Gjormit, Brataj – Ura Laskos*” rezulton se me datë 17.04.2019 është lidhur kontrata mes Titullarit të AK z. D.A. dhe përfaqësuesve të S. AG z. M. M. dhe z. I. T. me vlerë 4,236,665,117 lekë me TVSH. Sipas shkresës me nr. 828/3 prot., datë 21.04.2020 është miratuar nga ana e Titullarit, kërkesa e kontraktorit S. AG për nën kontraktimin e një pjese të punimeve tek operatori E. në masën 45 % dhe përmes shkresës nr. 828/2 prot., datë 21.04.2020 është miratuar kontraktimi i punimeve tek OE RRUGA URA ASFALTIM NR. 2 në masën 45 %.

- Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e punimeve, konkretisht: “*Projektin e Zbatimit (Vizatimet sipas faktit, As-Built); Pagesave pjesore IPC; Fletëve të Matjes (Measurement Sheets)*”; Etj. si dhe nga verifikimi i kryer në terren rezultoi se:

- Gjendja e skarpateve në një pjesë të tyre ishte problematike pasi në shumë raste realizimi i tyre nuk është kryer sipas skicës së librezës së masave dhe projektit, pra nuk është kryer në plan të rrafshët por është kryer me diferenca të dukshme duke lënë në shumë raste edhe gjurmët e gërmimit me ekskavator apo me mjete të tjera. Në rastet kur janë hasur materiale shkëmbore, gërmimi nuk është kryer sipas seksionit tërthor të pasqyruar në vizatimet sipas faktit.

Për rrjedhojë nuk është arritur të sigurohet qëndrueshmëria e skarpateve duke bërë që në shumë raste kanalet të jenë me material të rrëzuar nga këto skarpate. Përveç sa më sipër rezulton se nga ana e firmës sipërmarrëse punimet në skarpate janë kryer jo në përputhje me specifikimet teknike të kontratës pasi në pjesën më të madhe të tyre, skarpatat rezultuan të shembura dhe/ose jo të qëndrueshme, me material të shkrifët në rrugë, kanalet rezultuan të mbushur me materialin e rrëzuar nga skarpatat dhe në shumë raste masivet e gurëve me dimensione të konsiderueshme ishin në rrugë duke u bërë kështu një shkak i mundshëm për ndodhjen e aksidenteve.

Nga verifikimi i Grupi i Auditimit të gjithë aksit për të dy segmentet dhe rezultoi se situata e skarpateve dhe pjesërisht ajo e kanaleve ishin tejet problematike.

Konkretisht, referuar specifikimeve teknike Seksioni 4, pika 4.01, nga verifikimi në terren u konstatua se në shumë raste këto pjerrësi nuk përputheshin me projektin e zbatimit. Kjo mos përputhje qëndronte në ndryshimin e këndeve të pjerrësisë mes vizatimit dhe faktit, apo masive të pa gërmuara në skarpatë të cilat nuk krijonin një plan të rrafshët ashtu siç edhe është paraqitur detaji i projektit mbi të cilin janë kryer edhe volumet e punës për pagesat e kryera ndaj kontraktorit të punimeve S. AG. Për rrjedhojë rezulton se nuk është treguar kujdes i veçantë në dhënien e formës ekzakte të pjerrësive dhe përveç kësaj, këto pjerrësi nuk janë kryer në përshtatje me karakteristika fiziko – mekanike të formacioneve.

Gjithashtu në dosje nuk disponohen testet e nevojshme që janë kryer në laboratorin e kantierit në lidhje me natyrën e formacioneve, shkallën e tyre të kompaktësisë dhe përmbajtjen e lagështisë.

Për sa i takon kanaleve të betonit në shumë raste u konstatua mos respektim i detajeve të projektit, kryesisht për sa i përket formës lineare, estetike në dimensione në disa raste dhe pa respektuar as trashësinë dhe vendosjen e hekurit sipas kërkesave të projektit.

Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”, Kreu II, pika 8.1, Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafët 3.2 dhe 3.3, Kontrata e shërbimit të konsulencës e lidhur me datë 18.01.2018 mes FSHZH dhe konsulentit Artikulli 3 *Obligimet e Kontraktorit* tek Kushtet e përgjithshme të Kontratës, pika 3.1.1 dhe 3.1.2.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 31 – 41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1 Rekomandimi:** Nga ana e FSHZH, në rolin e investitorit dhe njëkohësisht e Klientit në kontratën e lidhur me datë 18.01.2018 mes FSHZH dhe BOE P. & E. G, nisur nga problematikat e konstatuara në drejtim të skarpateve gjatë inspektimit në terren në prezencë të Audituesve, përfaqësuesve të FSHZH dhe konsulentit, për kryerjen e një azhornimi topografik, me qëllim saktësimin e volumeve të punimeve të kryera dhe korigjimin (në rast të konstatimit të ndryshimeve) të volumeve të situacionit përfundimtar të zërave që preken nga këto ndryshime.

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Gjendja e skarpateve dhe realizimi i tyre është kryer sipas skicës së librezës së masave dhe projektit të azhornuar (as-built). Edhe në rastet e masave shkëmbore, gërmimi është kryer sipas seksionit tërthor të pasqyruar në vizatimet sipas faktit. Për rrjedhojë është arritur të sigurohet qëndrueshmëria e skarpateve. Nga ana e firmës sipërmarrëse punimet në skarpate janë kryer në përputhje me specifikimet teknike të kontratës. Këndet e pjerrësisë janë ruajtur sipas vizatimit dhe faktit. Gjithashtu në dosje disponohen testet e nevojshme që janë kryer në laboratorin e kantierit në lidhje me natyrën e formacioneve, shkallën e tyre të kompaktësisë dhe përmbajtjen e lagështisë. Plani i rilevimit është realizuar në përputhje me faktin, pjerrësitë e skarpateve projektin e azhornuar, u rishikuan edhe një herë volumet e gërmimit, u krahasuan librezat e masave dhe rezultuan si ato të paraqitura me parë. Rilevimi topografik dhe librezat e masave bashkëlidhur këtij Raporti.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet *i pranuar* por *I pa zbatuar*.

**6.2 Rekomandimi:** Nga ana e FSHZH, në rolin e investitorit dhe njëkohësisht e Klientit në kontratën e lidhur me datë 18.01.2018 mes FSHZH dhe BOE P. & E. G, nisur nga problematikat e konstatuara në drejtim të kanaleve anësore të betonit gjatë inspektimit në terren në prezencë të Audituesve, përfaqësuesve të FSHZH dhe konsulentit ku u konstatua mungesa e respektimit të dimensioneve dhe materialit përforcues (hekur), për kryerjen e sondazheve shtesë me qëllim identifikimin e të gjitha rasteve të tjera ku nuk janë respektuar detajet e projektit të miratuar. Pas kryerjes së këtyre sondazheve, në rast të konstatimit të ndryshimeve nga ato të deklaruara në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar të reflektohen ndryshimet në volume dhe në vlerë.

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e FSHZH është ngritur Urdhri i Drejtorit Ekzekutiv me nr. 53, datë 12.12.2022 me objekt "Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH mbi gjetjet e konstatuara nga auditimi i Projektit Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës". Pas një raporti pjesor me nr. 4066 prot., datë 16.12.2022 të hartuar nga ana e grupit të ngritur me këtë qëllim, u Urdhërua nga ana e Titullarit (nr. 54, datë 28.12.2022) likuidimi i garancisë për pjesën takuese të verifikuar nga ky raport pjesor (shuma 90,651,969.25 lekë pa TVSH). Më tej, pas raportit të dytë pjesor, njëkohësisht final, të hartuar në maj 2023 nga ana e Grupit të Punës, sipas shkresës me nr. 1753 prot., datë 09.05.2023 të miratuar edhe nga ana e Titullarit, është arritur në konkluzionin se ndaj OE S. AG duhet të mbahet shuma prej **1,289,980 lekë pa TVSH**. Përveç kësaj, nga ana e Grupit të Punës u lanë detyra për riparimet e nevojshme për zëra si ato që lidhen me punimet e betonit të kanaleve, përforcimit me hekur dhe bankinat anësore. Pas lënies

së detyrave dhe kryerjes së tyre nga ana e sipërmarrësit u rifverifikuan punimet riparuese të cilat rezultuan sipër preventivit.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *I zbatuar* megjithatë konfirmimi i këtij konkluzioni do të bëhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratave për punime civile, konkretisht:

Projektit të Zbatimit (Vizatimet sipas faktit, As-Built);

Pagesave pjesore;

Fletëve të Matjes (Measurement Sheets);

Praktikave të Urdhër Ndryshimeve (Variation Order) nga VO nr. 1 deri tek VO nr. 3;

Korrespondencave mes Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), Konsulentit dhe Kontraktorit të punimeve;

Etj.,

si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave (Measurement Sheets) dhe në situacionin përfundimtar volume pune të pakryera në fakt. Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:

Nr.	Kodi i Preventivit	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)
1	E/1.2	Gërmim dheu me ekskavator zinxhir 1.0 m <sup>3</sup> , në kanale me gjerësi > 2 ml, tokë e zakonshme, kat. IV me shkarkim në mjet	695,700
2	E/1.8	F.V Tub PVC φ - 90 mm	611,414
<b>SHUMA</b>			<b>1,307,114</b>

Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, pika 8.1, Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Kontrata e shërbimit të konsulencës e lidhur me datë 18.01.2018 mes FSHZH dhe konsulentit:

Artikulli 3 *Obligimet e Kontraktorit* tek Kushtet e përgjithshme të Kontratës, pika 3.1.1 dhe 3.1.2; Shtesa A – Përshkrimi i Shërbimeve, Pika II Përshkrimi i Projektit, qëllimi i shërbimeve, detyrat dhe objektivat e pritshëm Qëllimi i Shërbimeve;

Shtesa A – Përshkrimi i Shërbimeve, Pika III. 3 Kontrata e Shërbimit, Aktivitete gjatë fazës së Ndërtimit;

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 31 – 41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Nga ana e FSHZH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **1,307,114 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit OE A. M. – T. M. për punime të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me kërkesat e projektit por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur me datë 24.02.2017 me nr. CWC/ICB/2016/1 me objekt ‘Rindërtimi i rrugës Vlora bypass – Peshkepi – Ura Gjorm Lot 1’.

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e Drejtorit Ekzekutiv është nxjerrë Urdhër i Brendshëm me nr. 54, datë 28.12.2022 për ndjekjen e të gjitha procedurave gjyqësore nga ana e FSHZH për kthimin e shumës prej **695,700 lekë** në Buxhetin e Shtetit. Në vijim, nga ana e Drejtorit Ekzekutiv është njoftuar përmes shkresës me nr. 1794 prot., datë 11.05.2023 OE A. M. – T. M. për arkëtimin e shumës si më sipër e cila nuk është arkëtuar deri aktualisht.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Pjesërisht i zbatuar*.

### **C. MASA PËR ELEMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKEDHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCEDHE E FEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratave për punime civile, konkretisht: *Projektit të Zbatimit (Vizatimet sipas faktit, As-Built); Pagesave pjesore; Fletëve të Matjes (Measurement Sheets); Praktikave të Urdhër Ndryshimeve (Variation Order) nga VO nr. 1 deri tek VO nr. 3; Korrespondencave mes Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), Konsulentit dhe Kontraktorit të punimeve; Etj.*

si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (supervizori i punimeve) nga auditimi rezulton se në lidhje me zërin Tek kategoria E, Zëri D/10 Shtresë zhavorr lumi t=20 cm për kanalet e betonit, sipas librezës së masave dhe situacionit përfundimtar janë pasqyruar volumi total prej 18,847.37 m<sup>2</sup>. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konkretisht materialeve fotografike të dosjes teknike si dhe verifikimit në terren në prezencë të konsulentit dhe përfaqësuesve të FSHZH, konstatohet se ky volum në disa raste është kryer me material zhavorri të përzier me tokë vegjetale. Pavarësisht sa më sipër rezulton se kanalet rezultojnë të qëndrueshme dhe pa devijime apo mangësi të drejtim të shfrytëzimit të rrugës. Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se tek kategoria G Punime Bioinxhinierike, Zëri G/2 Rrafshim skarpate në gjërmim, konstatohet se sipas librezës së masave (dokumenti Measurement Sheets), janë pasqyruar volumi për rrafshimin e skarpateve prej 90,751.71 m<sup>2</sup>. Në fakt, referuar verifikimit në terren të punimeve faktike në prezencë të supervizorit si dhe kronologjisë së punimeve arrihet në konkluzionin se volumet e punës për këtë zë janë kryer gjatë punimeve të gjërmimit nën zërat ‘Gjërmim në tokë kategoria III seksion i detyruar për formimin e trupit të rrugës me ekskavator me zinxhir 1m<sup>3</sup> përfshirë shkallëzimin e skarpateve në seksionet në mbushje, sipas profileve’, ‘Gjërmim në tokë kategoria IV seksion i detyruar me ekskavator 1m<sup>3</sup> me zinxhir për formimin e trupit të rrugës përfshirë shkallëzimin e skarpateve në seksionet në mbushje, sipas profileve’, ‘Gjërmim në tokë kategoria III për heqjen e tokës vegjetale seksion të lirë me ekskavator me zinxhirë 1m<sup>3</sup>’, ‘Gjërmim dheu me ekskavator zinxhir 0.5 m<sup>3</sup>, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria IV, me shk në mjet’ si dhe zërin ‘Gjërmim në tokë kategoria III për gjerësi kanali deri në 2 m me ekskavator me zinxhir 0.5m<sup>3</sup> me shkarkim në mjet’. Gjithashtu, konstatohet se nën këtë zë janë likuiduar edhe volume pune për rrafshimin e materialeve shkëmbore, rrafshimin e kanaleve si dhe rrafshimin e sheshpushimeve të shkallëzimeve. Referuar Specifikimeve teknike, pika 4.05 rezulton se është cituar se: *Gjërmimet e Përgjithshme përbëhen nga gjërmimet për hapjen e rrugës, vendeve të ndërrimit dhe pune ndihmese si për shembull, gjërmimet për segmente të rrugës në prerje, nivelimi i dherave, rregullimi i skarpateve në gjërmim apo mbushje, formimi dhe thellimi i bazamentit të mbushjes, kanalet anësore, kanalizimet e nëndheshme, kanalet etj., si edhe ato për themele të strukturave.*

Nga verifikimi në terren rezultoi se në disa raste skarifikimi i skarpateve nuk është kryer sipas skicës së librezës së masave dhe projektit (nuk është kryer në plan të rrafshët) por është kryer me

diferenca. Për rrjedhojë rezulton se janë përdorur pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet fondet në shumë **11,467,645 lekë pa TVSH**. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, pika 8.1, Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafët 3.2 dhe 3.3, Kontrata e shërbimit të konsulencës e lidhur me datë 18.01.2018 mes FSHZH dhe konsulentit:

Artikulli 3 Obligimet e Kontraktorit tek Kushtet e përgjithshme të Kontratës, pika 3.1.1 dhe 3.1.2; Shtesa A – Përshkrimi i Shërbimeve, Pika II Përshkrimi i Projektit, qëllimi i shërbimeve, detyrat dhe objektivat e pritshëm Qëllimi i Shërbimeve;

Shtesa A – Përshkrimi i Shërbimeve, Pika III. 3 Kontrata e Shërbimit, Aktivitete gjatë fazës së Ndërtimit;

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 31 – 41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** FSHZH të marrë masa për shmangien e praktikave në të cilat konstatohen mbivendosje zërash të ndryshëm për të njëjtët procese pune me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve të projekteve.

*Në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** FSHZH ka marrë masa për shmangien e praktikave në të cilat konstatohen mbivendosje zërash të ndryshëm për të njëjtët procese pune me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve të projekteve.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga deklaratat e mësipërme të subjektit, ky rekomandim konsiderohet *I pranuar* dhe statusi i rekomandimit cilësohet si *Në proces zbatimi* megjithatë konfirmimi i këtij konkluzioni do të bëhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

**2. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për objektin “Loti II - Ura e Gjormit, Brataj – Ura Laskos” rezulton se me datë 17.04.2019 është lidhur kontrata mes Titullarit të AK z. D.A dhe përfaqësuesve të S. AG z. M.M dhe z. I.T me vlerë 4,236,665,117 lekë me TVSH. Sipas shkresës me nr. 828/3 prot., datë 21.04.2020 është miratuar nga ana e Titullarit, kërkesa e kontraktorit S. AG për nën kontraktimin e një pjese të punimeve tek operatori E në masën 45 % dhe përmes shkresës nr. 828/2 prot., datë 21.04.2020 është miratuar kontraktimi i punimeve tek OE RRUGA URA ASFALTIM NR. 2 në masën 45 %.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e punimeve, konkretisht: *Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit, As-Built); Pagesat pjesore IPC; Fletët e Matjes (Measurement Sheets); Etj.*

si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave (Measurement Sheets) dhe në situacionin përfundimtar volume pune të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike në shumën prej 129,292,638.45 lekë pa TVSH në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)
<b>Segmenti 1 Ura e Gjormit - Brataj</b>		
1	Gjeotekstil me gramaturë 200 g/m <sup>2</sup>	317,795
2	Shtresë stabilizant t=10 cm për bankinat	1,733,535.79

3	Gërmim në shkëmb seksion i detyruar me ekskavator 0.5 m <sup>3</sup> me zinxhir me gjerësi kanali 2 m me shkarkim në mjet	427,063
4	Struktura të holla monolite betoni të armuara C 20/25 për kanalet e betonit, sipas vizatimeve	5,904,329
5	Struktura të holla monolite betoni të armuara C 20/25 për kunetat e betonit, sipas vizatimeve	1,853,189
6	Shtresë zhavorr lumi t=20 cm për kanalet e betonit	3,921,855.09
7	Volume për punime gërmimi për zërin e mësipërm	1,667,022.8
8	Volume për transportin e materialit të pa gërmuar gërmimi për zërin e mësipërm	930,581.6
9	Mbjellje me bar e skarpateve dhe mbushje me dhe vegjetal t = 20 cm	2,118,142
10	Rrafshim skarpate në gërmim	1,371,810
11	Transporti i materialit zhavorr të pa gërmuar në fakt për Fibrat Optike	462,742.89
12	Mbushje me zhavorr për Fibrat Optike	940,401.79
13	Punimet e gërmimit në seksionin në piketën 5+831	3,665,808
14	Transporti i materialit të gërmuar	23,692,449.49
SHUMA Segmenti 1		<b>45,340,917.45</b>
<b>Segmenti 2 Brataj – Ura e Laskos</b>		
1	Shtresë stabilizant t=10 cm për bankinat	3,230,033.63
2	Struktura të holla monolite betoni të armuara C 20/25 për kanalet e betonit, sipas vizatimeve	8,216,401
3	Struktura të holla monolite betoni të armuara C 20/25 për kanalet e betonit, sipas vizatimeve	1,451,613
4	F V. H.ekur betoni i zakonshëm për kanalin e betonit Ø 6 ~ 10mm	2,045,659
5	Struktura të holla monolite betoni të armuara C 20/25 për kunetat e betonit, sipas vizatimeve	5,412,793.44
7	Shtresë zhavorr lumi t=20 cm për kanalet e betonit	6,155,009.91
8	Volume për punime gërmimi për zërin e mësipërm	2,098,985
9	Volume për transportin e materialit të pa gërmuar gërmimi për zërin e mësipërm	1,374,436.44
10	Mbjellje me bar e skarpateve dhe mbushje me dhe vegjetal t = 20 cm	10,574,022.5
11	Rrafshim skarpate në gërmim	3,086,247.46
12	Transporti i materialit zhavorr të pa gërmuar në fakt për Fibrat Optike	834,002.45
13	Mbushje me zhavorr për Fibrat Optike	1,670,423.39
14	Mbushje, përhapje dhe ngjeshje me zhavorr në trupin e rrugës	1,098,010
15	Transporti i materialit të gërmuar	36,704,083.86
SHUMA Segmenti 2		<b>83,951,721</b>
<b>TOTAL</b>		<b>129,292,638.45</b>

Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, pika 8.1, Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Kontrata e shërbimit të konsulentës e lidhur me datë 18.01.2018 mes FSHZH dhe konsulentit:

Artikulli 3 *Obligimet e Kontraktorit* tek Kushtet e përgjithshme të Kontratës, pika 3.1.1 dhe 3.1.2; Shtesa A – Përshkrimi i Shërbimeve, Pika II Përshkrimi i Projektit, qëllimi i shërbimeve, detyrat dhe objektivat e pritshëm Qëllimi i Shërbimeve;

Shtesa A – Përshkrimi i Shërbimeve, Pika III. 3 Kontrata e Shërbimit, Aktivitete gjatë fazës së Ndërtimit;

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 31 – 41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** Nga ana e FSHZH të merren masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës me qëllim analizimin e vlerës **129,292,638.45 lekë pa TVSH** në lidhje punët e kryera jo

në përputhje me specifikimet teknike dhe/apo të kryera jo sipas përshkrimeve të bëra në situacionin përfundimtar, kjo përmes edhe një verifikimi më të plotë në terren<sup>10</sup> si dhe nxjerrjen e një konkluzioni për kontratën e sipërmarrjes të lidhur me datë 17.04.2019 me objekt 'Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës, Loti 2 Segmenti Ura e Gjormit – Brataj Ura a Laskos'.

**Menjëherë**

Pranueshmëria e rekomandimit: I pranuar

**Komenti i subjektit:** Nga ana e FSHZH është ngritur Urdhri i Drejtorit Ekzekutiv me nr. 53, datë 12.12.2022 me objekt "Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH mbi gjetjet e konstatuara nga auditimi i Projektit Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës". Pas një raporti pjesor me nr. 4066 prot., datë 16.12.2022 të hartuar nga ana e grupi të ngritur me këtë qëllim, u Urdhërua nga ana e Titullarit (nr. 54, datë 28.12.2022) likuidimi i garnacisë për pjesën takuese të verifikuar nga ky raport pjesor (shuma 90,651,969.25 lekë pa TVSH). Më tej, pas raportit të dytë pjesor, njëkohësisht final, të hartuar në maj 2023 nga ana e Grupit të Punës, sipas shkresës me nr. 1753 prot., datë 09.05.2023 të miratuar edhe nga ana e Titullarit, është arritur në konkluzionin se ndaj OE S. AG duhet të mbahet shuma prej **1,289,980 lekë pa TVSH**.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër si dhe referuar USHP nr. 464, datë 14.08.2023, ky rekomandim konsiderohet I pranuar dhe statusi i rekomandimit cilësohet si I zbatuar megjithatë konfirmimi i këtij konkluzioni do të bëhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

## **D. MASA DISIPLINORE**

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 - Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe Kontratës kolektive për punonjësit e FSHZH, kërkojmë nga Drejtori Ekzekutiv fillimin e procedurave për dhënie masë disiplinore për punonjësit të cilët janë konstatuar me shkelje nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Pranueshmëria e rekomandimit: I papranuar

Për sa më sipër është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 702/27 prot., datë 13.11.2023 nga ana e FSHZH nga ana e të cilëve pretendohet si më poshtë trajtuar.

**Pretendimi i subjektit:**

"... Referuar komenteve dhe shpjegimeve tona lidhur me gjetjet e auditimit, të pretenduara në Projekt Raport, dërguar pranë jush komunikimit zyrtar (kopje bashkëngjitur), më poshtë evidentojmë ato rekomandime për të cilat, bazuar në argumentet e referuara kërkojmë të rishikohen edhe një herë dhe të trajtohen me objektivitet dhe në përputhje me parashikimet ligjore dhe rregullatorë të aplikueshme, si dhe të ndryshohet statusi i zbatimit në tabelën V Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit duke i klasifikuar sipas zbatimit respektiv si më poshtë:

Në lidhje me rekomandimin 6.1 të Masave Organizative

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH-së:**

Pretendimet Tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë pasi materialet e sjella nuk janë të sigluara nga hartuesit e këtyre dokumenteve (inxhinierët që kanë kryer këtë azhornim).

Në lidhje me rekomandimin 1.1 të Masave Për Shpërblim Dëmi

---

<sup>10</sup> Ky rekomandim është vendosur nisur nga pretendimet e subjektit të audituar se gjatë verifikimit në terren GA realizoi sondazhe jo për çdo km por në disa pika të rastësishme.

### ***Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH-së:***

Pretendimet Tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga ana e Grupit të Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara e të trajtuara nga Aktin e konstatimit si dhe Projektraportin e Auditimit.

*Në lidhje me rekomandimin 1.1 të Masave Për Eliminimin e Efekteve Negative të Konstatuara në Administrimin e Fondeve Publike dhe Për Menaxhimin me Ekonomicitet, Eficiencë dhe Efektivitet të Fondeve Publike.*

### ***Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH-së:***

Në lidhje me këtë rekomandim sqarojmë se në lidhje me sa citoni se është thënë nga ana e Audituesve të KLSH, përveç asaj është përmendur edhe fakti se konfirmimi i këtij konkluzioni do të bëhet në auditimin e radhës në këtë institucion për shkak edhe të natyrë së rekomandimit.

## **IV KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

Në përfundim të procesit të auditimit, nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën nr. 6/11 port., datë 22.11.2022 (*administruar në subjekt me nr. 241/9 prot., datë 23.11.2022*), konstatohet se 40 % e rekomandimeve të pranuar janë zbatuar pjesërisht dhe janë në proces zbatimi 50 % e rekomandimeve të cilat lidhen kryesisht me masat organizative dhe ato në lidhje me përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet. Duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve si më poshtë:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga Auditimi:** (*Gjetja nr. 6 e Masave Organizative të Raportit Përfundimtar të Auditimit*) Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për objektin “*Loti II - Ura e Gjormit, Brataj – Ura Laskos*” rezulton se me datë 17.04.2019 është lidhur kontrata mes Titullarit të AK z. D.A dhe përfaqësuesve të S. AG z. M.M dhe z. I.T me vlerë 4,236,665,117 lekë me TVSH. Sipas shkresës me nr. 828/3 prot., datë 21.04.2020 është miratuar nga ana e Titullarit, kërkesa e kontraktorit S. AG për nën kontraktimin e një pjese të punimeve tek operatori E në masën 45 % dhe përmes shkresës nr. 828/2 prot., datë 21.04.2020 është miratuar kontraktimi i punimeve tek OE RRUGA URA ASFALTIM NR. 2 në masën 45 %.

- Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e punimeve, konkretisht: “*Projektin e Zbatimit (Vizatimet sipas faktit, As-Built); Pagesave pjesore IPC; Fletëve të Matjes (Measurement Sheets)*”; Etj. si dhe nga verifikimi i kryer në terren rezultoi se:

- Gjendja e skarpateve në një pjesë të tyre ishte problematike pasi në shumë raste realizimi i tyre nuk është kryer sipas skicës së librezës së masave dhe projektit, pra nuk është kryer në plan të rrafshët por është kryer me diferenca të dukshme duke lënë në shumë raste edhe gjurmët e gërmimit me ekskavator apo me mjete të tjera. Në rastet kur janë hasur materiale shkëmbore, gërmimi nuk është kryer sipas seksionit tërthor të pasqyruar në vizatimet sipas faktit.

Për rrjedhojë nuk është arritur të sigurohet qëndrueshmëria e skarpateve duke bërë që në shumë raste kanalet të jenë me material të rrëzuar nga këto skarpate. Përveç sa më sipër rezulton se nga ana e firmës sipërmarrëse punimet në skarpate janë kryer jo në përputhje me specifikimet teknike të kontratës pasi në pjesën më të madhe të tyre, skarpatat rezultuan të shembura dhe/ose jo të qëndrueshme, me material të shkrifët në rrugë, kanalet rezultuan të mbushur me materialin e rrëzuar nga skarpatat dhe në shumë raste masivet e gurëve me dimensione të konsiderueshme ishin në rrugë duke u bërë kështu një shkak i mundshëm për ndodhjen e aksidenteve.



Nga verifikimi i Grupi i Auditimit të gjithë aksit për të dy segmentet dhe rezultoi se situata e skarpateve dhe pjesërisht ajo e kanaleve ishin tejet problematike.

Konkretisht, referuar specifikimeve teknike Seksioni 4, pika 4.01, nga verifikimi në terren u konstatua se në shumë raste këto pjerrësi nuk përputheshin me projektin e zbatimit. Kjo mos përputhje qëndronte në ndryshimin e këndeve të pjerrësisë mes vizatimit dhe faktit, apo masive të pa gërmuara në skarpatë të cilat nuk krijonin një plan të rrafshët ashtu siç edhe është paraqitur detaji i projektit mbi të cilin janë kryer edhe volumet e punës për pagesat e kryera ndaj kontraktorit të punimeve S. AG. Për rrjedhojë rezultoi se nuk është treguar kujdes i veçantë në dhënien e formës ekzakte të pjerrësive dhe përveç kësaj, këto pjerrësi nuk janë kryer në përshtatje me karakteristika fiziko – mekanike të formacioneve.

Gjithashtu në dosje nuk disponohen testet e nevojshme që janë kryer në laboratorin e kantierit në lidhje me natyrën e formacioneve, shkallën e tyre të kompaktësisë dhe përmbajtjen e lagështisë.

Për sa i takon kanaleve të betonit në shumë raste u konstatua mos respektim i detajeve të projektit, kryesisht për sa i përket formës lineare, estetike në dimensione në disa raste dhe pa respektuar as trashësinë dhe vendosjen e hekurit sipas kërkesave të projektit.

Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, pika 8.1, Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Kontrata e shërbimit të konsulencës e lidhur me datë 18.01.2018 mes FSHZH dhe konsulentit Artikulli 3 *Obligimet e Kontraktorit* tek Kushtet e përgjithshme të Kontratës, pika 3.1.1 dhe 3.1.2.

**1.1 Rekomandimi:** Nga ana e FSHZH, në rolin e investitorit dhe njëkohësisht e Klientit në kontratën e lidhur me datë 18.01.2018 mes FSHZH dhe BOE P. & E. G, nisur nga problematikat e konstatuara në drejtim të skarpateve gjatë inspektimit në terren në prezencë të Audituesve, përfaqësuesve të FSHZH dhe konsulentit, për kryerjen e një azhurnimi topografik, me qëllim saktësimin e volumeve të punimeve të kryera dhe korrigjimin (në rast të konstatimit të ndryshimeve) të volumeve të situacionit përfundimtar të zërave që preken nga këto ndryshime.

*Menjëherë*

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga Auditimi:** (Gjetja nr. 1 e Masave Për Shpërblim Dëmi të Raportit Përfundimtar të Auditimit) Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratave për punime civile, konkretisht:

Projektit të Zbatimit (Vizatimet sipas faktit, As-Built);

Pagesave pjesore;

Fletëve të Matjes (Measurement Sheets);

Praktikave të Urdhër Ndryshimeve (Variation Order) nga VO nr. 1 deri tek VO nr. 3;

Korrespondencave mes Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), Konsulentit dhe Kontraktorit të punimeve;

Etj.,

si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave (Measurement Sheets) dhe në situacionin përfundimtar volume pune të pakryera në fakt. Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:

Nr.	Kodi i Preventivit	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)
1	E/1.2	Gërmim dhe me ekskavator zinxhir 1.0 m3, në kanale me gjerësi > 2 ml, tokë e zakonshme, kat. IV me shkarkim në mjet	695,700
2	E/1.8	F.V Tub PVC φ - 90 mm	611,414
<b>SHUMA</b>			<b>1,307,114</b>

Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, pika 8.1, Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafët 3.2 dhe 3.3, Kontrata e shërbimit të konsulentës e lidhur me datë 18.01.2018 mes FSHZH dhe konsulentit:

Artikulli 3 *Obligimet e Kontraktorit* tek Kushtet e përgjithshme të Kontratës, pika 3.1.1 dhe 3.1.2; Shtesa A – Përshkrimi i Shërbimeve, Pika II Përshkrimi i Projektit, qëllimi i shërbimeve, detyrat dhe objektivat e pritshëm Qëllimi i Shërbimeve;

Shtesa A – Përshkrimi i Shërbimeve, Pika III. 3 Kontrata e Shërbimit, Aktivitete gjatë fazës së Ndërtimit;

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 31 – 41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Nga ana e FSHZH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **1,307,114 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit OE A. M. – T. M. për punime të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me kërkesat e projektit por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur me datë 24.02.2017 me nr. CWC/ICB/2016/1 me objekt ‘Rindërtimi i rrugës Vlora bypass – Peshkepi – Ura Gjorm Lot 1’.

*Menjëherë*

*Në lidhje me masat e konstatuara në proces zbatimi, nga ana e subjektit të audituar Fondi Shqiptar i Zhvillimit të vijojnë përpjekjet duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore deri në zbatimin e plotë të tyre.*

### **3.16. FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT Projekti Rikonstruksioni i rrugës Ujë i Ftohtë – Orikum dhe ndërtimi i dy By – Pass-eve**

#### **PËRMBLEDHJE**

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), ushtroi auditim në Fondin Shqiptar të Zhvillimit mbi “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022” për auditimin e kryer në vitin 2022 për Projektin “Rikonstruksioni i rrugës Ujë i Ftohtë – Orikum dhe ndërtimi i dy By – Pass-eve”, për periudhën nga fillimi i Projektit deri me datë 28.02.2022 paraqitur me shkresën e administruar në KLSH me nr. 265/8 prot., datë 07.06.2022, administruar në FSHZH me nr. 789/11 prot., datë 09.06.2022, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH<sup>së</sup> të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2022, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;

c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, efizienz dhe ekonomicitet të fondeve;

ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në subjekt u mbajt Akt Verifikimi nr. 1, datë 08.09.2023, administruar në Zyrën e FSHZH me nr. 2751/3 prot, datë 04.09.2023, për të cilin nuk është paraqitur observacion nga ana e subjektit. Pas dërgimit të Projektraportit të Auditimit, nga ana e subjektit janë paraqitur observacione të cilat gjejnë trajtim përgjatë materialit.

**Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:**

**I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.**

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, FSHZH ka respektuar këtë afat duke kthyer përgjigje sipas shkresës së administruar në FSHZH me nr. 789/12 prot., datë 21.06.2022.

**II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.**

-Nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas parashikimeve në Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

**III. Rekomandimet e KLSH**

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 265/8 prot., datë 07.06.2022, administruar në FSHZH me nr. 789/11 prot., datë 09.06.2022, janë rekomanduar gjithsej:

a. Janë rekomanduar 6 masa organizative.

**IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH**

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 265/8 prot., datë 07.06.2022, administruar në FSHZH me nr. 789/11 prot., datë 09.06.2022, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Organizative	6 masa	5	1

**V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit**

Në mënyrë të përmblodhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	5 masa	1	-	4	-

## I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 702/1, prot., datë 04.08.2023, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. A.L, (Përgjegjës grupi)
2. J.H.

## I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 6/11 port., datë 22.11.2022 dhe në FSHZH me nr. 241/19 prot., datë 23.11.2022, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

## I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

## I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

## I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH për Projektin “Ndërtimi i Rrugës së Lumit të Vlorës” me shkresën nr. 6/11 port., datë 22.11.2022 dhe në FSHZH me nr. 241/19 prot., datë 23.11.2022, rezulton se nga **6** masa të rekomanduara (*organizative*), janë pranuar nga subjekti **5** masa ose **83.3 %**. **Nga të pranuarat (5)**: është zbatuar plotësisht **1**, ose **20 %** e tyre si dhe janë në proces zbatimi **4** masa ose 90 %.

Nga sa shikohet niveli i realizimit është në masën 20 %, gjë e cila tregon se FSHZH nuk e ka vlerësuar procesin e zbatimit të rekomandimeve dhe duhet të vijojë përpjekjet për zbatimin e plotë të rekomandimeve të tjera në proces zbatimi.

Nr.	Lloji rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	5 masa	1	-	4	-
<b>SHUMA</b>		<b>5</b>	<b>1</b>	<b>-</b>	<b>4</b>	<b>-</b>

## II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 20 % kurse ai i atyre në proces është 80 %, nivele këto të cila tregojnë mos vlerësimin e këtij procesi në lidhje me ndjekjen e procedurave të

duhura për zbatimin e rekomandimeve por edhe domosdoshmërinë e përpjekjeve për të përfunduar zbatimin e plotë të rekomandimeve të tjera në proces.

### **III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM**

III/1-Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.  
-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, FSHZH ka respektuar këtë afat duke kthyer përgjigje sipas shkresës së administruar në FSHZH me nr. 789/20 prot., datë 21.06.2022.

III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, sipas parashikimeve në Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”,

III/3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion në lidhje me dëgjesa publike rezulton një listë me pjesëmarrës për takimin e zhvilluar në Bashkinë Vlorë datë 16.07.2020 me 14 pjesëmarrës dhe takimi është institucional pasi ka vetë pjesëmarrës nga institucionet Bashkia Vlorë dhe FSHZH dhe vetëm 2 pjesëmarrës nga fusha e biznesit. Nga FSHZH në lidhje me dëgjesat publike konstatohet se nuk janë kryer publikimet në regjistrin elektronik për konsultimet si dhe publikimi në programin e transparencës. Nuk ka një bazë të dhënash mbi procesin e konsultimit publik. Pas kërkesave të kryera nga grupi i auditimit nuk u vendos në dispozicion një informacion i qartë dhe i detajuar mbi procesin e njoftimit dhe konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projekt-aktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar. Për takimet e zhvilluara, që gjithsesi nuk mund të klasifikohen si dëgjesa publike, nuk ka procesverbale për dokumentimin e diskutimeve dhe pretendimeve të ngritura nga palët në kundërshtim me pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr. 146/2014, datë 30.10.2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet nr. 17-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** FSHZH në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë të marrin masa të organizojnë konsultimet publike për “Rikonstrukcioni i rrugës Ujë i Ftohtë – Orikum dhe ndërtimi i dy By –

Pass<sup>-eve</sup>”, pjesë e projektit “Konektiviteti i rrugëve rajonale dhe lokale” me të gjitha etapat e parashikuara nga kuadri ligjor.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**1.2 Rekomandimi:** FSHZH në bashkëpunim me institucionet përfituese të projekteve të marrin masa që të kryejnë konsultimet publike me të gjitha etapat e parashikuara në kuadrin ligjor me qëllim që projektet të jenë të pranuar nga komuniteti si dhe mos të ketë vonesa gjatë implementimit të tyre.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e FSHZH janë realizuar të gjitha dëgjuesat e grupeve të interesit në përputhje me *Kërkesat e përcaktuara të performancës (Performancë requirements 1-8 % 10)*

**Komenti i audituesve:** Nga ana e subjektit të audituar nuk u vu në dispozicion një dokumentacion shtesë në lidhje me mbledhje të tjera të zhvilluara përveç atyre të realizuara më parë të cilat kane qenë në dispozicion të Grupit të Auditimit të mëparshëm. Nisur nga sa më sipër si dhe natyrës së tij, këto dy rekomandime konsiderohen si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**2. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi konstatohet se FSHZH nuk ka caktuar një koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik për bashkërendimin dhe administrimin e punës. Nuk u vendos në dispozicion asnjë provë dokumentare mbi publikimin e njoftimit të konsultimit publik, marrjen e komenteve dhe rekomandimeve në asnjë formë. Nuk dokumentohet si janë njoftuar palët e interesit mbi arsyet dhe ndikimin që ka projekti, afati, vendi dhe mënyra se si mund të dërgohen rekomandimet, adresa e kontaktit të koordinatorsit për njoftimin dhe konsultimin publik në kundërshtime nenet 10, 11, 13 të ligjit nr. 146/2014, datë 30.10.2014 “*Për njoftimin dhe konsultimin publik*.”

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet nr. 17-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1 Rekomandimi:** FSHZH në bashkëpunim me institucionet përfituese të projekteve të marrin masa që të ngrenë strukturat përkatëse për zhvillimin e konsultimeve publike duke mirë informuar palët e interesit dhe duke reflektuar dhe zgjidhur problematikat e komunitetit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** Nga ana e FSHZH është emëruar me Urdhër nr. 116, datë 13.05.2022 Koordinatorin për të drejtën e informimit dhe si person kontakti z. A.I.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *I zbatuar*.

**3. Gjetje nga Auditimi:** Deri në fund të periudhës objekt auditimi (datë 29.04.2022) nuk ka një projekt përfundimtar të pranuar dhe miratuar nga FSHZH (zhvillues i projektit) dhe Bashkia Vlorë (përfitues) por ka një projekt që është në proces ndryshimi ku është evidentuar një gjurmë dhe një listë me prona që preken nga projekti. Në raportin e hartuar nga vlerësuesja e pasurive të paluajtshme zj. M. F. janë evidentuar pronat dhe vlera korresponduese për shpronësim. Implementimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugës Ujë i Ftohtë – Orikum dhe ndërtimi i dy By – Pass<sup>-eve</sup>” prek pronat e Bashkisë Vlorë në zonat Kadastrale 8602 (Vlorë) dhe 3140 (Radhimë), Njësia Administrative Orikum. Për të minimizuar efektet e shpronësimit, ndërtimi i rrugës, që do të mundësohet nga zbatimi i projektit, ka bërë të mundur shmangien e pronave private të zëna nga

ndërtesa banimi dhe/ose objekte biznesi aty ku ka qenë tekniku e mundur. Kuadri ligjor në fuqi për zbatimin e projektit parashikon që personat e prekur nga projekti do të kompensohen për çdo humbje të aseteve fizike, të ardhurave dhe fitimeve që rrjedhin nga realizimi i këtij investimi, nëse këto humbje janë të përkohshme ose të përhershme. Megjithatë, dëshmitë e mbledhura nga vizitat në terren kanë treguar se ndërtimi i rrugëve prek kryesisht parcelat në pronësi publike, tokat bujqësore, vegjetacionin dhe prodhimin në këto toka. Zbatimi i projektit do të ndikojë drejtpërdrejt tek personat që preken nga projekti sepse do të shpronësohen për një sipërfaqe të caktuar të pronës së tyre. Shpronësimi kryhet për interes publik dhe toka bujqësore e marrë do të përdoret për ndërtimin dhe vënien në funksion të objektit “Rikonstruksioni i rrugës ekzistuese Vlorë-Orikum dhe i dy By-pass<sup>eve</sup>”. Në sipërfaqen 47 311.14 m<sup>2</sup> janë marrë në konsideratë sipërfaqja 15 695.44 m<sup>2</sup> - By Pass 1 dhe 31 615.70 m<sup>2</sup> By Pass2. Nga vlerësimi i kryer deri në këtë pikë të projektit rezulton se në total nga ndërtimi i dy By-Pass<sup>eve</sup> preken 50 prona, specifikuisht 22 prona nga By – pass 1 dhe 28 prona nga By – pass 2.

Aneksi nr. 3.2 “Lista e pronave që preken nga projekti dhe që do të shpronësohen”

**Kosto totale e shpronësimit është 567,733,680 lekë ku përveç vlerës së tokës futen edhe kosto e produkteve bujqësore, si dhe zhvlerësimi i pronës nga shpronësimi i një pjese të saj.**

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet nr. 31-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:** FSHZH në bashkëpunim me të gjithë institucionet e përfshira në procesin e shpronësimeve të marrin masa që të evidentohen lista e plotë e pronarëve, vlera përkatëse dhe të nisin menjëherë hapat ligjor për përfundimin e procesit të shpronësimeve dhe kompensimin e pronarëve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Pranueshmëria e rekomandimit: *Ipapranuar*

**4. Gjetje nga Auditimi:** Për zbatimin e punimeve civile në këtë segment është lidhur kontrata e punimeve me referencë DTM50123/Ŵ/2020/1 datë 07.12.2020 me OE “A.-M.” me vlerë 8,674,246.62 USD me TVSH me afat 12 muaj ndërsa për mbikëqyrjen e punimeve është lidhur kontrata me B “P.&E.-G” sipas kontratës me referencë DTM50123/Ŵ/2020/4 datë 28.12.2020 me vlerë 986,160 USD me TVSH. Aktualisht, pas ndryshimit të projektit fillestar të dorëzuar nga ana e projektuesit B I. & A. 4 & S. C., projekti i ri nuk disponon akoma leje ndërtimi; nuk është dorëzuar sheshi i ndërtimit; punimet në terren nuk kanë filluar dhe janë ende në proces procedurat për shpronësimet. Në lidhje me ndryshimet e projektit nga ana e subjektit të audituar u vu në dispozicion dokumentacioni si më poshtë: Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Vlorë me nr. 9879 prot., datë 15.11.2018 dhe në FSHZH me nr. 1518 prot., 20.11.2018, Bashkia Vlorë i është drejtuar FSHZH dhe projektuesit me një shkresë ku i ka përcjellë projekt – propozimet në lidhje me ndërtimin e dy Bypass<sup>eve</sup> në rrugën Radhimë – Orikum. Sipas këtij projekt propozimi është rishikuar gjurma e propozimit fillestar duke marrë parasysh parcelat ekzistuese, gjurmët e rrugëve ekzistuese, njësitë strukturore referuar PPV si dhe relacioneve shpjeguese. Sipas kësaj shkresë është cituar fakti se Bashkia Vlorë e ka bërë këtë projekt propozim në bashkëpunim me grupet e interesit, bizneset që operojnë në atë zonë, si palë të interesuara; Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Vlorë me nr. 6131 prot., datë 22.07.2020 dhe në FSHZH me nr. 1635 prot., 24.07.2020 Bashkia Vlorë i ka kërkuar FSHZH rishikimin e projektit me qëllim reflektimin e projekt-propozimeve të bëra nga kjo NJV e cila sipas Bashkisë është kryer në bashkëpunim me grupet e interesit, bizneset që operojnë në atë zonë, si palë të interesuara; Me shkresën e administruar në FSHZH me nr. 2171 prot., datë 22.09.2020 i është bërë me dije Bashkisë Vlorë fakti mbi vonesat në drejtim të Planit të Veprimt të Risistemimit për rrugën Uji i Ftohtë – Orikum

dhe ndërtimi i dy Bypass<sup>-eve</sup>. Edhe pas një takimi të kryer në datë 16.07.2020 të kryer në Bashkinë Vlorë me përfaqësues të Bashkisë dhe komunitetit nuk ka asnjë rezultat mbi marrjen e titujve të pronësisë nga ASHK për këtë arsye është kërkuar një angazhim shtesë nga ana e Njësisë Vendore; Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Vlorë me nr. 602/1 prot., datë 19.01.2021 dhe në FSHZH me nr. 342 prot., 22.01.2021, Bashkia Vlorë i ka kërkuar FSHZH rishikimin e projektit me qëllim reflektimin e projekt-propozimeve të bëra nga kjo NJV e cila sipas Bashkisë është kryer në bashkëpunim me grupet e interesit, bizneset që operojnë në atë zonë, si palë të interesuara duke kërkuar spostimin e gjurmës së Bypass – it si dhe spostimin e rreth-rrotullimit i cili sipas Bashkisë Vlorë është jo funksional. Kësaj shkresë i është bashkëlidhur edhe ankesa e bërë nga ana e një banori, prona e të cilit preket nga kalimi i gjurmës së projektit. Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Vlorë me nr. 1899/1 prot., datë 19.02.2021 dhe në FSHZH me nr. 342/1 prot., 01.03.2021, Bashkia Vlorë i ka kërkuar FSHZH rishikimin e projektit me qëllim reflektimin e projekt-propozimeve të bëra nga kjo NJV e cila sipas Bashkisë është kryer në bashkëpunim me grupet e interesit si dhe pronarëve legjitimë në atë zonë duke kërkuar spostimin e gjurmës së projektit pasi ajo e miratuar aktualisht në momentin e shkresës ka qenë e tillë që sipas Bashkisë ndan në mes parcelat dhe sjell një kosto të madhe edhe për shpronësimin e tyre. Gjithashtu është përmendur fakti se rreth-rrotullimi i parashikuar është jo funksional dhe nuk zgjidh trafikun e mjeteve. Kësaj shkresë i është bashkëlidhur edhe ankesa e bërë nga ana e një grupi banorësh të Radhimës, prona e të cilëve preket nga kalimi i gjurmës së projektit; Me shkresën e administruar në FSHZH me nr. 342/2 prot., datë 04.03.2021 është dorëzuar projekti nga ana e Projektuesit sipas kërkesave të bëra nga ana e Bashkisë Vlorë. Sipas të gjithë dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe pretendimeve të subjektit të audituar rezulton se është aplikuar për leje ndërtimi por kjo leje nuk është miratuar akoma për shkak të problemeve me pronat dhe aktualisht disponohet vetëm një Draft i miratimit të lejes. (*Shiko Aneksin nr. 2.1*). Për rrjedhojë rezulton se prej mungesës së ndjekjes në mënyrën e duhur të hapave për realizimin e projektit nga ana e FSHZH, konkretisht të atyre në drejtim të bashkëpunimit me Bashkinë Vlorë për identifikimin e saktë dhe në kohë të gjurmës së projektit janë shkaktuar vonesa në realizimin e projektit sipas marrëveshjes së financimit të ratifikuar me ligj. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 44/2020 datë 23.04.2020 “*Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale në Shqipëri*”, neni III Ekzekutimi i Projektit.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 35-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1 Rekomandimi:** Nga ana e FSHZH, në zbatim të Nenit III Ligji nr. 44/2020 datë 23.04.2020 dhe në cilësinë e *Entit Zbatues të Projektit* të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme kryesisht ato në drejtim të bashkëpunimit me Bashkinë Vlorë, sipas Marrëveshjes së lidhur me këtë qëllim mes FSHZH dhe Bashkisë Vlorë në datë 30.04.2020.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** FSHZH vazhdon rregullisht zbatimin e detyrimit të tij ligjor për realizimin e Projektit, sigurisht për sa është e mundur dhe në kompetencën e kësaj organizate.

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi*.

**5. Gjetje nga Auditimi:** Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se aktualisht, pas lidhjes së kontratës nga ana e kontraktorit është paraqitur për pagesë vetëm një situacion pjesor i gushtit të vitit 2021 i cili i takon pagesës paradhënie *Advance Payment* në shumën prej



1,445,707.77 USD pa TVSH, ose 1,734,849.324 USD me TVSH. Nga kjo i është paguar OE vetëm pagesa e vlerës së TVSH në masën 30,258,663 lekë, ose vlera korresponduese e shumës prej 289,141.55 USD. Pas ndryshimit të projektit fillestar të dorëzuar nga ana e projektuesit BOE I. & A. 4 & S. C., rezulton se objekti nuk disponon akoma leje ndërtimi, nuk është dorëzuar sheshi i ndërtimit, punimet në terren nuk kanë filluar dhe janë ende në proces procedurat për shpronësimet. Aktualisht kontraktorit nuk i është paguar shuma prej 1,445,707.774, situatë kjo e cila e ekspozon ndjeshëm FSHZH ndaj riskut të paraqitjes së ankesave nga ana e Kontraktorit për vonesa në kryerjen e pagesës sipas kushteve të kontratës. Për rrjedhojë rezulton se prej mungesës së ndjekjes në mënyrën e duhur të hapave për realizimin e projektit nga ana e FSHZH, konkretisht të atyre në drejtim të bashkëpunimit me Bashkinë Vlorë për identifikimin e saktë dhe në kohë të gjurmës së projektit është rritur ekspozimi i FSHZH ndaj riskut të paraqitjes për ankesave për vonesa në kryerjen e pagesave nga ana e kontraktorit duke rritur kështu mundësitë e krijimit të situatave jo të favorshme për financat e Projektit dhe të vet FSHZH.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 35-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1 Rekomandimi:** Nga ana e FSHZH, në zbatim të Nenit III Ligji nr. 44/2020 datë 23.04.2020 dhe në cilësinë e *Entit Zbatues të Projektit* të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar një menaxhim të konsoliduar financiar me qëllim përmbushjen e dispozitave të kësaj marrëveshjeje.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

Pranueshmëria e rekomandimit: *I pranuar*

**Komenti i subjektit:** *FSHZH ka bërë përpjekje për të rritur bashkëpunimin me të gjithë aktorët të cilët kanë detyrim realizimin e lirit të sheshit të ndërtimit, pajisjen me leje ndërtimi, me leje mjedisore, zgjidhjen e konflikteve sociale, përfundimin e procedurës së shpronësimit dhe procese të tjera të nevojshme dhe të domosdoshme për të realizuar projektin. Pavarësisht punës së kryer deri më tani, për të arritur këtë objektiv, Fondi Shqiptar i Zhvillimit do të vazhdojë të ndërmarrë hapat dhe procedurat e nevojshme procedurale për këtë projekt dhe për çdo projekt tjetër, për të siguruar një menaxhim me ekonomikitet, eficiencë dhe efikasitet, me qëllim përmbushjen e dispozitave të kësaj marrëveshjeje dhe le çdo marrëveshje tjetër me donatorët përkatës.*

**Komenti i audituesve:** Nisur nga sa më sipër si dhe natyra e tij, ky rekomandim konsiderohet si *I pranuar* dhe *Në proces zbatimi* megjithatë konfirmimi i këtij konkluzioni do të bëhet në auditimin e radhës në këtë institucion.

Për sa më sipër është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 702/26 prot., datë 13.11.2023 nga ana e FSHZH nga ana e të cilëve pretendohet si më poshtë trajtuar.

***Pretendimi i subjektit:***

*“... Ky qëndrim për zbatimin e rekomandimeve përkatëse, për aq sa mund të zbatohet nga kjo organizatë në rolin e agjencisë zbatuese të projektit sipas marrëveshjes së huasë me BERZH, është i njëjtë me ato të sqaruara nëpërmjet komunikimeve si vijon ..”*

***Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH<sup>-së</sup>:***

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe atij të paraqitur me observacion sqarojmë se këto informacione nuk sjellin fakte shtesë ndaj dhe rekomandimet do të jenë njësojë me ato të aktit të konstatimit dhe Projektraportit të Auditimit.

#### **IV KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

Në përfundim të procesit të auditimit, nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën nr. 265/8 prot., datë 07.06.2022 (*administruar në subjekt me nr. 789/11 prot., datë 09.06.2022*), konstatohet se 20 % e rekomandimeve të pranuar janë zbatuar plotësisht dhe janë në proces zbatimi 80 % e rekomandimeve të cilat lidhen me masat organizative. Duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **rikërkojmë** vijimin e përpjekjeve duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore deri në zbatimin e plotë të rekomandimeve në proces.

### **3.17. PERFORMANCA E SHOQËRIVE PUBLIKE TË SEKTORIT ENERGETIK NË ADMINISTRIMIN E REZERVËS HIDRIKE NË KASKADËN E LUMIT DRIN, PRODHIMIT, TRANSMETIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2021-2022.**

#### **A. PËRMBLEDHJE**

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 702/1 Prot, datë 04.08.2023, me objekt: “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2022”.

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të lartë të shtetit ” dhe të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH, Nr. 1, datë 04.11.2016, “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacion që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit rekomandimeve të KLSH ”, Duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- a. Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së, të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2022, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjektet e audituara, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- b. Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike, të akteve administrative të nevojshme, si vendime e urdhra për zbatimin e masave organizative;
- c. Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Objekti i këtij Raporti është zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në “shoqëritë publike KESH, OSHEE, në auditimin e performancës “Performanca e shoqërive publike të sektorit energjetik në administrimin e rezervës hidrike në kaskadën e lumit Drin, prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2021-2022” për periudhën nga data 01.01.2021 deri më datën 30.06.2022, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

#### **Në përfundim të procesit të auditimit rezulton se:**

#### **I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.**

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Shoqëria publike Korporata Elektroenergjetike Shqiptare dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja e njoftimit të Raportit Përfundimtar të auditimit duke mos respektuar afatin e njoftimit të KLSH për masat e marra nga këto dy shoqëri

## II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Në vijim e në zbatim të nenit 30, pika 2, të ligjit nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Shoqëria publike Korporata Elektroenergjitike Shqiptare dhe Operatori të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike nuk kanë raportuar (me shkrim) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të Raportit Përfundimtar të auditimit dhe rekomandimeve, duke mos njoftuar mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

## III. Rekomandimet e KLSH

Sipas, Raportit Përfundimtar të Auditimit nr.342/13 Port., datë 23.01.2023, KLSH ka rekomanduar:

a. 10 (dhjetë) masa organizative;

b. 1 (një) masë për moszbatim të kontratës së furnizimit të KESH për FSHU në vlerën **6,188,316,173.0 lekë**

c. 1 (një) masë për moszbatim të kontratës së shkëmbimit midis KESH dhe NOA Energy të sasisë së energjisë elektrike prej 17,515 MËh

## IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH

Sipas shkresës së OSHEE Group të administruar në KLSH me nr. 342/15 prot., datë 11.09.2023, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si me poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Organizative	10 masa	10 masa	0
2	Mos zbatim te kushteve te kontratës se shitblerjes të KESH për FSHU	1 masë 6,188,316,173.0 lekë	1 masa 6,188,316,173.0 lekë	0
3	Moszbatim të kontratës së shkëmbimit midis KESH dhe NOA Energy të sasisë së energjisë elektrike	1 masë 17,515 MËh	1 masë 17,515 MËh	0
4	Masa Disiplinore	0	0	-

## V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	10 masa	1	0	2	7
2	Mos zbatim te kushteve te kontratës se shitblerjes të KESH për FSHU	1 masë 6,188,316,173.0 lekë	0	0	0	1
3	Moszbatim të kontratës së shkëmbimit midis KESH dhe NOA Energy të sasisë së energjisë elektrike	1 masë 17,515 MËh	0	0	0	1
4	Masa Disiplinore	0	0	-	-	-

## I/1 Hyrja

Auditimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të

rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 702/1, Prot., datë 04.08.2023, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë nga:

1. A.L, (Përgjegjës grupi)
2. K.H.

### I/2. Objekti auditimit

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr.342/13 Port., datë 23.01.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

### I/3. Qëllimi auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

### I/4. Metodologjia e auditimit

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

### I/5. Konkluzioni:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti OSHEE Group dhe KESH, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr.342/13 Port., datë 23.01.2023, rezulton se nga 12 masa të rekomanduara (*organizative, moszbatim te kushteve te kontratave të shitblerjes, moszbatim te kushteve te kontratave te shkëmbimit te energjisë elektrike, Disiplinore*), janë pranuar nga subjekti 12 masa ose 100 %. Nga të pranuarat (12): Janë zbatuar plotësisht 1 masë, ose 8.3 % e tyre, janë zbatuar pjesërisht 0 masa ose 0 %, janë në proces zbatimi 2 masa ose 17 % dhe 9 masa janë të pa zbatuara.

Nga sa shikohet niveli i realizimit është në masën 8.3 %, gjë e cila tregon se shoqëritë OSHEE group dhe KESH nuk e kanë vlerësuar procesin e zbatimit të rekomandimeve.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	10 masa	1	0	2	7
2	Mos zbatim te kushteve te kontratës se shitblerjes të KESH për FSHU	1 masë 6,188,316,173.0 lekë	0	0	0	1
3	Moszbatim të kontratës së shkëmbimit midis KESH dhe NOA Energy të sasisë së energjisë elektrike	1 masë 17,515 MËh	0	0	0	1
4	Masa Disiplinore	0	0	-	-	-
<b>Shuma</b>		12	1	0	2	9

## **II. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve**

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është në masën 48.1 % kurse ai i atyre në proces ose të zbatuara pjesërisht është 51.9 %, nivele këto të cila tregojnë vlerësimin pjesërisht të këtij procesi në lidhje me ndjekjen e procedurave të duhura për zbatimin e rekomandimeve.

## **III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm**

**III/1-**Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.  
*-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Shoqëria publike Korporata Elektroenergjitike Shqiptare dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja e njoftimit të Raportit Përfundimtar të auditimit duke mos respektuar afatin e njoftimit të KLSH për masat e marra nga këto dy shoqëri.*

**III/2-**Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”).

Shoqëria publike Korporata Elektroenergjitike Shqiptare dhe Operatori të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike nuk kanë raportuar (me shkrim) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të Raportit Përfundimtar të auditimit dhe rekomandimeve, duke mos njoftuar mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

-Nga ana e subjektit të audituar nuk janë marrë masa për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, veprim ky i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH – së dhe ecuria e zbatimit të tyre, paragrafi 2, ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”,

**III/3.** Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, rezulton si më poshtë:

### **MASA ORGANIZATIVE**

#### **4.1. A ka qënë efciente veprimtaria e KESH në lidhje me administrimin e rezervës hidrike në kaskadën e lumit Drin?**

##### **Gjetje nga auditimi:**

-Në fund të muajit Maj 2021 liqeni i Fierzës kishte një kuote maksimale prej 296.65 m.m.n.d..

Niveli i liqenit në këtë periudhë ishte brenda vlerave të lejuara maksimale dhe mbi mesataren disa vjeçare. Niveli i lartë i arritur në 6 mujorin e parë të 2021 përbënte një siguri për të menaxhuar dhe shfrytëzuar sipas kushteve optimale kaskadën e lumit Drin edhe për 6 mujorin e dytë të vitit 2021.

-Niveli i rezervës hidroenergjetike në Liqenin e Fierzës në Tetor 2021 zbriti me 29 m krahasuar me atë të muajt Maj. Në Tetor niveli zbriti në kuotën 267.74 m.m.n.d.

-Rënia e nivelit të Fierzës ka vijuar edhe përgjatë vitit 2022 duke arritur minimumin historik në fund të muajit Mars 2022 në kuotën 260.67 m.m.n.d.

-KESH në periudhën Qershor deri Gusht 2021, që i përket periudhës së thatë me prurje të pakta, rriti prodhimin e HEC-ve të kaskadës së Drinit duke prodhuar në total në këtë periudhë 1,192,661 MËh ose 30% të kërkesës së FSHU për furnizimin e konsumatorëve fundor.

-KESH nuk ka respektuar kushtet e kontratës për furnizimin e FSHU me sasinë e energjisë elektrike të planifikuar për muajt Gusht, Shtator, Tetor dhe Nëntor 2021.

-KESH përveç operacioneve të tjera, si ato të shitjeve nga prurjet e larta, optimizimit, etj., në periudhën Qershor-Tetor 2021, ka dhënë 149,442 MWh energji elektrike shoqërisë tregtare N. E. në formën e shkëmbimit. Periudhë kjo që korrespondon me rënien e nivelit të liqenit të Fierzës. (Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 24-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

### **Konkluzione:**

Rënia e nivelit të liqenit në muajin Tetor 2021, ka ardhur si rezultat i mosrespektimit të kushteve të shfrytëzimit dhe administrimit të kaskadës së Drinit, për ruajtjen e kuotave të prodhimit dhe nivelit minimal të lejuar.

Në periudhën e thatë, në kushtet e mungesës së prurjeve; KESH rriti nivelin e shfrytëzimit të HEC-ve në periudhën Qershor-Gusht 2021, duke prodhuar gati 30% të kërkesës së kontraktuar me FSHU.

Një faktor tjetër që ka ndikuar në rënien e rezervës hidroenergjetike është sasia e energjisë elektrike të prodhuar për shkëmbim me N. E. në periudhën Qershor-Tetor 2021.

Administrimi i rezervës hidrike ngelet një nga problematikat kryesore si në drejtim të rezervimit të sasisë hidrike në rezervuarët e kaskadës në kushtet e prurjeve të mëdha, ashtu edhe në ruajtjen e vlerave të mesatares shumëvjeçare në kushtet e mungesës së reshjeve siç ka qënë rasti gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2021.

### **Rekomandim:**

Këshilli Mbikëqyrës i KESH të analizojë problematikat e shfaqura në lidhje me shfrytëzimin dhe menaxhimin e rezervës hidroenergjetike në kaskadën e lumit Drin, kryesisht atë të 6 mujorit të dytë të vitit 2021 dhe të tre mujorit të parë 2022.

*Në vijimësi*

**Statusi i pranimi:** Pranuar

### **Përgjigje nga subjekti:**

Referuar Akt verifikimit nr. 4026/2 Prot., datë 04.09.2023 nga shoqëria KESH.SH.A nuk na u vendos në administrim asnjë dokument në lidhje me evidencën dokumentare të hartuar nga subjekti për zbatimin e këtij rekomandimi

**Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.**

KESH të rrisë projektet e investimeve në lidhje me rritjen e parametrave të sigurisë së digave për të minimizuar rrezikun e katastrofës. Investimet vjetore për sigurinë e digave të shoqërohen me investime në teknologji për monitorimin, mirëmbajtjen dhe parashikim.

*Në vijimësi*

**Statusi i pranimit:** Pranuar

**Përgjigje nga subjekti:**

Referuar Akt verifikimit nr. 4026/2 Prot., datë 04.09.2023 nga shoqëria KESH.SH.A nuk na u vendos në administrim asnjë dokument në lidhje me evidencën dokumentare të hartuar nga subjekti për zbatimin e këtij rekomandimi

**Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.**

**Cilat janë hapat e ndërmarra nga KESH për implementimin e sistemit SCADA në rezervën hidrike të kaskadës në lumin Drin?**

Sistemi SCADA<sup>11</sup> shërben për të monitoruar, kontrolluar në kohë reale dhe për të ruajtur të dhëna dhe parametra që janë tregues të ecurisë së procesit teknologjik.

Në rastin e HEC-ve të kaskadës së Drinit, sistemet SCADA shërbejnë për të monitoruar dhe kontrolluar kryesisht të gjithë proceset elektro-mekanike që kryhen turbina (gjeneratori) deri në injektimin e energjisë elektrike në sistemin e transmetimit.

Hidrocentrali në vetvete është një vepër komplekse, ku ndërthuren shumë element, duke filluar nga veprat hidroteknike të cilat bëjnë akumulimin, marrjen dhe shkarkimin e rezervës hidrike dhe nga agregatet, të cilat përbëhen nga:

*a. Pjesa mekanike, turbina e cila bënë të mundur shndërrimin e energjisë potenciale të masës ujore të akumuluar, në energji kinetike të lëvizjes rrotulluese.*

*b. Gjeneratori elektrik, i cili shndërron energjisë kinetike të lëvizjes rrotulluese në energji elektrike.*

*c. Pajisjet elektrike transformuese dhe elementet e traktit të Nënstacionit që bëjnë të mundur transmetimin e energjisë elektrike.*

**Gjetje nga auditimi:**

KESH ende nuk ka implementuar sistemin qendror SCADA<sup>12</sup> për të bashkërenduar në mënyrë informatike dhe kohë reale me SCADA-t lokale të HEC-ve të kaskadës së lumit Drin.

*(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 30-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Konkluzione:**

Mungesa apo vonesa e implementimit të SCADA qendrore në KESH, e cila do të shërbejë si një dispeçeri qendrore për monitorim dhe kontroll në kohe reale me burimet e gjenerimit të KESH ka bërë që marrja e informacioneve në KESH të bëhet manualisht apo pjesërisht për disa parametra në kohë reale.

**Rekomandim:**

KESH të marrë masat e nevojshme për përfundimin dhe implementimin e sistemit SCADA për të patur kontroll në kohë reale të aseteve gjeneruese.

**Menjëherë**

**Statusi i pranimit:** Pranuar

---

<sup>11</sup> Supervision Control and Data Acquisition

<sup>12</sup> Ligj nr. 87/2015 për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet këshillit të ministrave të republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së republikës federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2009, për projektin “energji ujore dhe siguria e digave në kaskadën e Drinit”

### **Përgjigje nga subjekti:**

Referuar Akt verifikimit nr. 4026/2 Prot., datë 04.09.2023 nga shoqëria KESH.SH.A nuk na u vendos në administrim asnjë dokument në lidhje me evidencën dokumentare të hartuar nga subjekti për zbatimin e këtij rekomandimi

**Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.**

### **A ka qënë efektive veprimtaria e KESH në lidhje me menaxhimin e tepricës së energjisë elektrike dhe optimizimit të kostove të blerjes së saj?**

#### **Gjetje nga auditimi:**

Departamenti i Operimit të Tregut nuk ka mundur të realizoj me sukses optimizimin e portofolit financiar nëpërmjet shitjeve/blerjeve për vitin 2021.

Operacionet tregtare të shitje/blerjes të realizuara nga KESH për vitin 2021, për optimizim në pamje të parë perceptohet që janë realizuar me sukses, pasi çmimi i shitjes është më i lartë se ai i blerjes, por ajo që ka ndikuar në mos realizimin e procesit të optimizimit është se sasi të blera nga KESH kanë qënë më të larta se ato të shitjes dhe për pasoj kanë ndikuar që efekti financiar i të ardhurave të rezultojë me humbje në shumën (5,840,019) euro për vitin 2021.

Në muajin Dhjetor 2021 KESH ka kryer procedura për optimizimin e portofolit financiar, nga ku rezulton se, KESH ka shitur 240 MWh me një çmim mesatar 450 euro/MWh por ndërkohë ka blerë një sasi të madhe prej 29,364 MWh me çmim mesatar 236 euro/MWh.

Kjo ka sjell që ky operacion për optimizim të rezultojë me një tregues negativ në portofolin financiar të KESH me 6,835,026 euro.

Nga auditimi i disa procedurave me zgjedhje rastësore për vitin 2022 të zhvilluara nga KESH për optimizim të portofoli financiar, grupi i KLSH përzgjedhi procedurën e muajit Shtator 2022., nga ku rezulton se përsëri shoqëria ka kryer operacione që nuk kanë rezultuar në rritjen e të ardhurave të shoqërisë po me humbje në shumën (49,612) euro. Në këtë procedurë KESH ka shitur 600 MWh me çmimin 601 euro/MWh në shumën 360,547.80 euro dhe ka blerë një sasi prej 780 MWh ose 180 MWh më shumë se shitja me çmim prej 525 euro/MWh, duke shpenzuar shumën prej 410,160 euro.

Për sa më lart, DOT dhe komisioni i shitblerjeve ka vepruar në mospërputhje me nenin 4 pika 4.2 të rregullores së përgjithshme të organizimit të aktivitetit tregtar nga KESH<sup>13</sup> dhe pika IV.4 e manualit të tregtimit<sup>14</sup>, ku parashikohet se:

*AK nëpërmjet procesit të tregtimit së energjisë elektrike, synon përfitimin financiar nëpërmjet shitjes dhe/ose optimizimin e portofolit financiar/energjitik nëpërmjet shitblerjes, kjo në varësi të vlerësimit që i bëhet situatës rast pas rasti.*

Nga auditimi i evidencës së administruar nga grupi i auditimit të KLSH, rezulton se:

Këshilli mbikëqyrës i KESH nëpërmjet vendimit nr.15 datë 01.07.2021 me objekt “Për miratimin e disa ndryshimeve në programin ekonomik financiar të shoqërisë KESH sh.a për vitin 2021”, ka rishikuar totalin e prodhimit neto nga 3,977,367 MWh në 5,322,813 MWh, nga ku rezulton që KESH për vitin 2021 ka prodhuar 5,901,697 MWh duke realizuar dhe tejkuluar parashikimin e planit ekonomik financiar.

<sup>13</sup> Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerit nr. 5233/1 date 12.06.2019

<sup>14</sup> Urdhëri nr.121, datë 06.12.2019



KESH ka përmbushur detyrimin kundrejt FSHU, nga ku sasia e energjisë elektrike e shitur FSHU është 4,145 GWh, kundrejt sasisë së kontraktuar prej 3,950 GWh.

Diferenca e sasisë së energjisë elektrike të shitur kundrejt të asaj të kontraktuar prej 194,704 MWh nga KESH për FSHU është shitur me çmimin 1.5 lekë/KWh, pra me të njëjtin çmim si ajo e sasisë së kontraktuar. Për sa më lart KESH ka vepruar në mospërputhje me neni 2 pika 3 të Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 10841 /1prot, datë 27.12.2019 ku parashikohet se:

*Shitësi në varësi të përmirësimit të kushteve hidrike, të gjithë sasinë e prodhimit të energjisë elektrike mbi atë të parashikuar në piken 1, por në çdo rast jo më shumë se sasia e nevojshme për furnizimin e klientëve fundor që përfitojnë nga shërbimi universal i furnizimit, është i detyruar t'ia ofrojë (propozojë) fillimisht Blerësit me çmimin e HUPX për atë moment.*

Nga auditimi i faturave tatimore rezulton se e gjithë sasia e lëvruar nga KESH për vitin 2021 për FSHU është shitur me 1.5 lekë (Pa TVSH)

Sasinë e kontraktuar si detyrim për të furnizuar FSHU për vitin 2021, KESH e ka realizuar brenda datës 20.12.2021.

Sasia e lëvruar (shitur) nga KESH për FSHU pas datës 20.12.2021 deri më 31.12.2021 është 194,704 MWh.

Në referim të pikës 3 nenit 2 të kontratës së sipërcituar, KESH-i sasinë 194,704 MWh duhej ta faturonte me çmimin e HUPX për FSHU.

Në referim të çmimeve të publikuara nga HUPX për periudhën (20 – 31.12.2021) çmimi mesatar ka qënë 231.75 dhe me kursin ditor të këmbimit ku 1 euro këmbëj me 120.76 lekë, KESH duhej të faturonte për vitin 2021 FSHU **13, 166,910,773 lekë** për gjithë sasinë e shituar.

Nga përlllogaritjet e grupit të KLSH për sasinë shtesë, FSHU i detyrohet KESH-it në shumën **6,188,316,173 lekë (me TVSH).**

Pasi  $194,704 \text{ MWh} * [(231.75 * 120.76) - 1,500] * 1.2 = 6,188,316,173 \text{ leke}$

*(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 31-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

### **Konkluzione:**

Për sa më lart, KESH ka plotësuar dhe tejkalluar sasinë e kontraktura për shitje për FSHU, por nuk ka bërë diferencim në çmimin e shitjes për sasinë shtesë dhe për pasoj kjo ka ndikuar tek të ardhurat e KESH.

### **Rekomandim:**

KESH në bashkëpunim me MIE, në cilësinë e pronarit të përbashkët për shoqëritë KESH dhe OSHEE grup, të kërkoj që shuma **6,188,316,173.0 lekë** (me TVSH) t'i faturohet shoqërisë FSHU sh.a., si një detyrim i lindur nga kontrata e shitblerjes të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të KESH

*Deri më datë 30.06.2024*

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 702/13 Prot., datë 27.09.2023, është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 342/15 prot., datë 11.09.2023 si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** Në lidhje me rekomandimin 3.1, nga ana e shoqërisë FSHU SH.A./ OSHEE GROUP SH.A. është dërguar observacion më date 21 dhjetor 2022 me anë të të cilit kundërshtohet rekomandimi duke argumentuar:

... Në kushtet kur në raportin përfundimtar të KLSH nuk është marrë parasysh observacioni i shoqërisë FSHU sh.a dhe i është lënë detyrë shoqërisë “KESH në bashkëpunim me MIE, në cilësinë e pronarit të përbashkët për shoqëritë KESH dhe OSHEE grup, të kërkojë që shuma **6,188,316,173.0 lekë** (me TVSh) ti faturohet shoqërisë FSHU sh.a si një detyrim i lindur nga kontrata e shitblerjes të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve të KESH”, shoqëria FSHU sh.a është në pritje të veprimeve juridike dhe financiare që do të kryhen nga ana e KESH sh.a, në vazhdim të të cilave do të ndërmarre hapat e mëtejshme ligjore dhe administrative për mos cenimin e situatës së saj financiare.

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Qëndrimi zyrtar i KLSH është shprehur ne Raportin Përfundimtar te Auditimit, në kushtet e këtij auditimi duhej te dokumentohej vetëm hapat e marre ne lidhje me zbatimin e këtij rekomandimi, prandaj ky observacion nuk merret në konsideratë do të konsiderohet si një rekomandim i pazbatuar

**Statusi i pranimit:** Pranuar

**Përgjigje nga subjekti:**

Për sa më lart, referuar observacionit të OSHEE Grup nr. 342/15 prot., datë 11.09.2023, rekomandimi i KLSH për këtë pikë konsiderohet i pa zbatuar

**Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.**

**4.Gjetje nga auditimi:**

Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë KESH në vendimin nr.15 datë 01.07.2021, pika 1 “Treguesit kryesor” për vitin 2021 (i miratuar) dhe 2022 (i rishikuar) ka përcaktuar se sasia për prodhim për furnizim e OSHEE-Klient Tarifor për 2021 të jetë 2,851,843 MWh dhe për vitin 2022 të jetë 2,833,887 MWh.

Ndërkohë në relacionin bashkëlidhur Tabela 3 - Treguesit e Pritshëm të prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike 2021 (MWh) është përcaktuar respektivisht për vitin 2021 sasia e energjisë elektrike të jetë 3,950,000 MWh dhe në atë të rishikuar me 4,157,672 MWh.

Për sa më lart, në referim edhe të sqarimeve të përfaqësuesit të KESH, rezulton që Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr.15, datë 01.07.2021, tek treguesit kryesor nuk ka përputhshmëri me relacionin bashkëlidhur duke paraqitur të dhëna të tjera me ato të pasqyruara në relacionin mbështetës, por sipas tyre është lapsus.

*(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 36-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandim:**

Këshilli Mbikëqyrës i KESH-it të bëj ndryshim në Vendimit nr.15, date 01.07.2021 duke saktësuar dhe unifikuar vendimin me të dhënat e relacionit bashkëlidhur tij.

**Menjëherë**

**Statusi i pranimit:** Pranuar

**Përgjigje nga subjekti:**

Referuar Akt verifikimit nr. 4026/2 Prot., datë 04.09.2023 nga shoqëria KESH.SH.A nuk na u vendos në administrim asnjë dokument në lidhje me evidencën dokumentare të hartuar nga subjekti për zbatimin e këtij rekomandimi

**Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.**

### **5.Gjetje nga auditimi:**

Subjekti tregtar N. E. deri në fund të muajt shtator 2022 është debitor për sasinë 17,515 MWh. Në bazë të kësaj marrëveshje kompania ka një fitim të munguar prej 9,367,730 euro në portofolin e vet financiar, pasi nëse sasia totale e shkëmbyer do të ishte shituar/blerë për optimizim në bazë të çmimeve referente në HUPX do të kishte një fitim prej 9,367,730 euro.  
(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 37-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

### **Konkluzion:**

Për sa më lart, në zbatim të VKM 244 datë 30.03.2016 “Për kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licesuareve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” KESH duhet të garantojë përmbushjen e detyrimit për shërbimit publik për furnizim të qëndrueshëm të FSHU sh.a ofrimin e shërbimeve ndihmese për operimin e sistemit elektroenergjitik Shqiptar si dhe të respektojë parimet e leverdishmërisë ekonomike dhe energjitike në kushtet kur e kërkon situata hidrologjike në vend në përputhje me kriteret e shfrytëzimit të kaskadës.

### **Rekomandim:**

Administratori i shoqërisë KESH Sh.A. të kërkoj nga subjekti tregtar N. E. kthimin e menjëhershëm të sasisë së energjisë elektrike prej 17,515 MWh si detyrim i mbetur i kësaj shoqërie kundrejt KESH-it.

*Deri më datë 30.06.2023*

**Statusi i pranimit:** Pranuar

### **Përgjigje nga subjekti:**

Referuar Akt verifikimit nr. 4026/2 Prot., datë 04.09.2023 nga shoqëria KESH.SH.A nuk na u vendos në administrim asnjë dokument në lidhje me evidencën dokumentare të hartuar nga subjekti për zbatimin e këtij rekomandimi.

**Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.**

### **Rekomandim:**

**5.2.**Administratori i shoqërisë KESH Sh.A. në bashkëpunim me Këshillin Mbikëqyrës të nxjerrin dhe të miratojnë udhëzime apo akte administrative ku të mirë përcaktohet procedura e shkëmbimit të energjisë elektrike me subjekte tregtare duke ndjekur të njëjtin parim të optimizimit “*shit shtrenjtë dhe bli lirë*”

*Në vijimësi*

**Statusi i pranimit:** Pranuar

### **Përgjigje nga subjekti:**

Referuar Akt verifikimit nr. 4026/2 Prot., datë 04.09.2023 nga shoqëria KESH.SH.A nuk na u vendos në administrim asnjë dokument në lidhje me evidencën dokumentare të hartuar nga subjekti për zbatimin e këtij rekomandimi

**Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.**

### **6.Gjetje nga auditimi:**

Shoqëria N. për periudhën 24 -30.04.2021 ka kryer pagesë pjesore në shumën 470,000 euro, e cila është kryer në disa pagesa përgjatë muajve Maj, Qershor dhe Shtator.

Ndërkohë për tre faturat e tjera të emetuara nga KESH, shoqëria N. nuk ka kryer asnjë pagesë megjithëse KESH-i ka lëvruar sasinë 27,090 MWh energji elektrike shoqërisë tregtare N..

Përpos kësaj KESH ka lejuar shoqërinë N. të vazhonte normalisht blerjet edhe për tre procedura të tjera pasardhëse duke mos likuiduar asnjë faturë shitje.

Gjithë struktura përgjegjëse pranë KESH që përgjigjej për kryerjen e pagesës nga N. duke filluar nga sektori i administrimit të kontratave pranë DOT, DOT dhe sektor të tjerë pranë DOT, të cilët kanë përpiluar faturat me parapagim dhe kanë akses në llogarinë bankare të shitjeve kanë lejuar që N. të blejë energji pa asnjë penalitet dhe pa ndërprerje në kushtet kur nuk ka likuiduar si në rastin e likuidimit pjesërisht por akoma më keq në rastin që nuk ka likuiduar tërësisht faturat e njëpasnjëshme për muajt Maj dhe Qershor 2021 duke i krijuar KESH-it një disbalancë negative në llogarinë e të ardhurave, e përlllogaritur vetëm në pricipal pa kamatë vonesat në shumën 2,288,399 euro

*(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 40-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

### **Konkluzion:**

Auditimi i procedurave të shitjes për prurje të larta dhe veçanërisht ato të realizuara me shoqërinë tregtare N., megjithëse e trajtuar hollësisht në raportin përfundimtar të KLSH nr.889/34 Prot. Date 07.06.2022, rimerret përsëri në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit për të evidentuar problematikën serioze që ka funksionimi i MFK-së në drejtim të sigurimit të kontrollit të brendshëm, si një nga pilastrat kryesore të funksionimit të saj, pasi mos likuidimi i faturave pasardhëse për shitje të njëpasnjëshme për një periudhe gati një mujore, rezulton se gjithë hierarkia e parashikuar në rregullore për gjurmimin dhe zbatimin e të gjitha hallkave të kontrollit të brendshëm në këtë rast nuk ka funksionuar, duke e bërë sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit jo efektiv.

### **Rekomandim:**

**6.1.**Administratori i shoqërisë KESH, nëpërmjet nxjerrjes së akteve administrative të përcaktojë procedura të qarta në lidhje me gjurmën e auditit për Departamentin e Operimit të Tregut, për të mos lejuar përsëritjen e këtij fenomeni që përbën një ngjarje me risk të lartë.

*Menjëherë*

**Statusi i pranimit:** Pranuar

### **Përgjigje nga subjekti:**

Referuar Akt verifikimit nr. 4026/2 Prot., datë 04.09.2023 nga shoqëria KESH.SH.A nuk na u vendos në administrim asnjë dokument në lidhje me evidencën dokumentare të hartuar nga subjekti për zbatimin e këtij rekomandimi. **Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.**

### **A ka qënë efektive veprimtaria e KESH për diversifikimin e portofolit të asetëve gjeneruese?**

Vizioni<sup>15</sup> i KESH-it është që të bëhet një aktor i rëndësishëm në tregun rajonal të energjisë duke diversifikuar kombinimin e burimeve tona të energjisë së rinovueshme dhe duke ofruar produkte dhe shërbime të reja. Bazuar në analizën e risqeve ponteciale të jashtme e të brendshme të shoqërisë KESH, strategjia e sipërcituar parashikon si zgjidhje ponteciale ndër të tjera, ndërtimin e asetëve të reja gjeneruese për të rritur kapacitetet.

---

<sup>15</sup> Vendimi 06. datë 24.04.2019 i Këshillit mbikëqyrës për miratimin e strategjisë së shoqërisë KESH sh.a

KESH në zbatim edhe të strategjisë së sektorit elektroenergjetik ka planifikuar në programet ekonomiko financiare fonde për ndërtimin e aseteve të reja gjeneruese.

Fokusi i shoqërisë në asetet e reja gjeneruese kanë qënë në teknologjitë e gjenerimit të cilat janë plotësuese dhe të përputhshme me asetet ekzistuese në administrim.

### **7.Gjetje nga auditimi**

Objektivi i rritjes se kapaciteteve gjeneruese nëpërmjet diversifikimit të aseteve gjeneruese është sigurimi i gjithë sasisë së energjisë së nevojshme për përmbushjen e Detyrimit të Furnizimit Publik duke synuar të mbajë kostot e gjenerimit më të ulëta se çmimet e tregjeve ndërkombëtare të energjisë elektrike, duke optimizuar prodhimin e energjisë nga kombinimi i burimeve hidrike dhe termike dhe duke përmbushur Detyrimin e Furnizimit Publik gjatë gjithë vitit, edhe në periudhën e thatë kur çmimet e energjisë elektrike rriten.

Kombinimi i prodhimit të energjisë elektrike nga dy burime të rinovueshme të saj, siç janë dielli edhe uji është një mundësi shumë e mirë për të garantuar rritjen e efikasitetit në prodhim dhe për të rritur sigurinë e furnizimit të vendit me energji elektrike.

*(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 41-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

### **Rekomandim:**

**7.1.KESH në bashkëpunim MIE të vendos në funksion TEC-in e Vlorës, si një aset i kapitalizuar dhe shumë efektiv në situatën aktuale të krizës së energjisë elektrike, dhe në ekuilibër me ruajtjen e mjedisit e të gjenerimit të sigurt të energjisë elektrike.**

*Në vijimësi*

**Statusi i pranimit:** Pranuar

### **Përgjigje nga subjekti:**

Referuar Akt verifikimit nr. 4026/2 Prot., datë 04.09.2023 nga shoqëria KESH.SH.A nuk na u vendos në administrim asnjë dokument në lidhje me evidencën dokumentare të hartuar nga subjekti për zbatimin e këtij rekomandimi

**Në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.**

### **4.3.1 A janë optimizuar shpenzimet për blerjen e energjisë elektrike në tregun e parregulluar përgjatë vitit 2021 dhe 6 mujorit të parë të vitit 2022 nga shoqëritë OSHEE, OST dhe KESH?**

### **8.Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi rezulton se planifikimi apo zgjedhja e ditës dhe fashës orare për blerjen e energjisë elektrike ngelet një problematikë e trashëguara dhe si e tillë këto shoqëri duhet të rrisin nivelin e kapaciteteve të burimeve njerëzore që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre zgjedhjen optimale të fashës orare të blerjes apo shitjes, pasi zgjedhja e duhur ka ndikim në optimizimin e shpenzimeve të këtyre shoqërive pasi përcaktimi sipas një modeli statistikor të studiuar mund të rezultojë në blerjen e energjisë elektrike me çmim më të ulët në krahasim me fashat e përzgjedhura.

*(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 54-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

### **Konkluzion:**

Për sa më lart, analizimi i opsionit të lotit 2 gjatë planifikimit nga ana e FTL është demonstrativ pasi nga auditimi i kësaj procedure loti 2 është anuluar dhe gjithë arsyetimi shërben vetëm që sektori përkatës pranë FTL të bëjë një studim me të hollësishëm me variante dhe skenar të ndryshëm për të optimizuar blerjen e energjisë elektrike. Nëse FTL nuk do të kishte planifikuar për lotin 2, profilin 07-23, por do të zgjidhte profilin 06-16 (loti 2-opsional) & 22-23 (loti 3-opsional)

diferenca midis hipotezës së planifikimit të një jave më pare “*ex ante*” me atë ndodhur “*post factum*” do të ishte 18,157 euro (321,600-303,443). Kjo tregon qe hipoteza e hedhur nga grupi i KLSH duke patur një shmangie prej 0.59% ose 0.0060 nga vendosja e fashave hipotetike te përzgjedhura, tregon qe do ishte ngjarje e sigurt me një probabilitet të lartë që të ndodhte.

### **Rekomandim:**

**8.1.** Administratorët e OSHEE dhe KESH-it duhet të ngrënë pranë shoqërive të tyre një sektor të analizës së tregut për planifikimin, përcaktimin dhe zgjedhjen e profilit dhe fashave orare sipas modeleve statistikore për të optimizuar shpenzimet për blerjen e energjisë elektrike nëpërmjet procedurave të shitblerjes.

*Në vijimësi*

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 702/13 Prot., datë 27.09.2023, është paraqitur observacion i administruar në KLSH me nr. 342/15 prot., datë 11.09.2023 nga OSHEE group si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** Në mënyrë të përmbledhur pretendimet e OSHEE grup, konsistojnë, e citoj: ... Aktualisht, shoqëria “F.T.L” SH.A., në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore realizon procedura blerjeje energjie elektrike vetëm për mbulimin e nevojave të klientëve në treg të lirë në nivel tensioni 35 kV. Në funksion të këtij aktiviteti, Departamenti i Furnizimit në shoqërinë “F.T.L” SH.A. ka një Sektor të Analizës dhe Çmimit. Referuar rekomandimit 8.1 të raportin përfundimtar të auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, shoqëria “F.T.L” SH.A. me Urdhrin e Brendshëm Nr. 3043/3 Prot., datë 20.07.2023 ka marrë masa për zbatimin e tij duke ngarkuar, deri në miratimin e ndryshimeve të strukturës organizative të shoqërisë, Sektorin e Analizës dhe Çmimit pranë Departamentit të Furnizimit për të kryer detyrat për planifikimin, përcaktimin dhe zgjedhjen e profilit dhe fashave orare për blerjen e energjisë elektrike në procedurat e shitblerjes së energjisë, edhe në funksion të nevojave të Departamentit të Tregtimit të Energjisë. (Bashkëlidhur Urdhri i Brendshëm Nr. 3043/3 Prot., datë 20.07.2023.)

### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Ndryshimet në strukture te sektorit te analizës dhe çmimeve sipas rekomandimeve te lëna nga KLSH, si dhe evidenca dokumentare si dhe reflektimi i zbatimit te këtij rekomandimi ne optimizimin e blerjeve te energjisë elektrike do të konsiderohen nga KLSH si një rekomandim i zbatuar

**Statusi i pranimit:** Pranuar

**Rekomandimi është zbatuar.**

**4.3.2. A janë ndërmarrë masa dhe procedura efektive për shlyerjen e detyrimeve të ndërsjella në shoqëritë publike të sistemit energjetik?**

### **9.Gjetje nga auditimi:**

Shoqëritë publike të sektorit energjetik e kanë detyrim ligjor respektimin e marrëveshjeve mbi të drejtat dhe detyrimet që lindin gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre. Lindja dhe akumulimi i detyrimeve financiare të ndërsjella KESH-OSHEE-OST, ka ardhur si rezultat i moszbatimit të procedurave ligjore, të cilat janë materializuar nëpërmjet marrëveshjeve të pranuar nga këto

shoqëri. Marrëdhëniet ndërmjet shoqërive KESH, OST dhe OSHEE janë rregulluar nga marrëveshjet e nënshkruara ndërmjet këtyre subjekteve dhe konkretisht:

Operatori i Shpërndarjes nuk i ka respektuar këto marrëveshje të miratuara nga ERE kundrejt KESH dhe OST, duke iu krijuar këtyre të fundit vështirësi për ushtrimin normal të aktivitetit të tyre. Këto marrëveshje, janë shkëlur konkretisht: për fatura furnizimi energjie elektrike të leshura nga KESH që nuk njihen/pranohen nga OSHEE; fatura për kamatë vonesa në pagesa të lëshuara nga KESH që nuk njihen/pranohen nga OSHEE; mos shlyerje e detyrimeve të OSHEE ndaj KESH për huat afatgjata; mos shlyerjen e detyrimit të OSHEE ndaj OST për transmetim energjie, etj.

*(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 56-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

### **Konkluzion:**

Për sa më lart, mosrespektimi i marrëveshjeve dhe procedurave ligjore nga ana e kompanive, ka sjellë akumulimin dhe rritjen e detyrimeve të ndërsjella, të cilat i kanë venë në vështirësi këto shoqëri të operojnë në kushte normale për realizimin e misionit të tyre.

Në lidhje me reduktimin e detyrimeve të ndërsjella Ministria e Financave dhe ekonomisë së bashku me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë kane nxjerrë urdhrin përbashkët nr.304 date 17.12.2020 për miratimin e planit të masave të reduktimit të detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike.

Trajtimi i detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë ka qenë një proces sfidues për shkak të nivelit të lartë të detyrimeve të trashëguara dhe akumulimit të detyrimeve të reja. Procesi i konsolidimit të detyrimeve të mbartura është menaxhuar përmes një marrëveshje ristrukturimi afatgjatë mes kompanive. Si rezultat i zbatimit të reformës në sektor, janë akumuluar dhe disa detyrime të reja mes kompanive. Detyrimet e prapambetura nga njësitë e tjera publike, veçanërisht ndërmarrjet e ujësjellësve, mbeten problem për shkak të mekanizmit të dobët të ekzekutimit të pagesave.

Marrja e masave për të ndaluar akumulimin e borxheve të reja është një parakusht i rëndësishëm për reduktimin e përgjithshëm të detyrimeve prapambetura në sektor. Plani i përbashkët i veprimeve ka për qëllim parandalimin e lindjes së borxheve të reja ndërmjet kompanive të energjisë elektrike dhe për të forcuar disiplinën e pagesave nga palët e treta.

### **Rekomandim:**

**9.1.** Shoqëritë publike të sektorit të energjisë elektrike në bashkëpunim me MFE dhe MIE të rrisin përpjekjet për disiplinimin e pagesave korrente, ku procesi i reduktimit të detyrimeve të prapambetura të sigurohet nëpërmjet marrëveshjeve të ristrukturimit të borxheve mes kompanive, dhe kur është e mundur të aplikohet instrumenti i net-imit të detyrimeve të ndërsjella për të përshpejtuar procesin e konsolidimit financiar.

*Në vijimësi*

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 702/13 Prot., datë 27.09.2023, është paraqitur observacion i administruar në KLSH me nr. 342/15 prot., datë 11.09.2023 nga OSHEE group si më poshtë:

### **Pretendimet e subjektit:**

... Pavarësisht vështirësive financiare të likuiditetit që u rritën si rrjedhojë e rritjes së çmimit të energjisë në tregun e lirë sidomos gjatë vitit 2021, OSHEE GROUP SH.A. në zbatim të Urdhrit të Përbashkët Nr. 379 datë 30.09.2021 të MFE dhe MIE “Mbi zbatimin e planit të masave të reduktimit të detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike” gjatë 8-mujorit të parë 2023 ka shlyer nga detyrimet e prapambetura përkatësisht:

Kundrejt KESH shumë prej 1,000,000,000 Lekë

Kundrejt OST shumë prej 180,000,000 Lekë

OSHEE GROUP SH.A. ka saktësuar vlerën fillestare të detyrimeve të trashëguara të institucioneve publike për energjinë e furnizuar dhe është në proces të plotësimit dhe saktësimit të dokumentacionit për shuarjen e detyrimeve ta prapambetura ndërmjet OSHEE GROUP SH.A. - KESH SH.A. & OST SH.A.

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit :**

KLSH gjatë auditimit të detyrimeve të prapambetura ka konstatuar se në marrëdhëniet tregtare të operatoreve të energjisë ka premisa të krijimit të detyrimeve të reja të cilat kanë rritur vlerën e stokut financiar të këtyre detyrimeve, por meqenëse dhe disa prej këtyre detyrimeve janë zvogëluar, ky rekomandim do të konsiderohet i zbatuar

**Statusi i pranimit:** Pranuar

**Në kushte të tilla ky rekomandim është në proces zbatimi.**

#### **4.4.2. A janë përmbushur detyrimet ligjore të sigurisë kibernetike nga shoqëritë publike të sektorit të energjisë elektrike?**

##### **10.Gjetje nga auditimi:**

Referuar përgjigjeve zyrtare rezulton se, Shoqëria OSHEE dhe OST kanë përmbushur detyrimin ligjor për caktimin e personit përgjegjës për sigurinë kibernetike, ndërkohë që shoqëria KESH, nuk ka caktuar ende personin përgjegjës për sigurinë kibernetike. Në referim të shkresës nr. 1165/3 datë 02.03.2021 të KESH drejtuar AKCESK, personi kontaktit i paraqitur nga KESH rezulton që është larguar dhe nuk është pjesë e strukturës së KESH-it.

Në lidhje me pyetjen:

*A keni strategji apo sisteme të menaxhimit të sigurisë kibernetike (ISMS) ku përfshihen politika, procedura apo rregullore të cilat kanë në objektin e tyre rritjen e sigurisë kibernetike?*

Nga auditimi rezulton se vetëm OST ka rritur infrastrukturën e sigurisë kibernetike por dhe të hartimit të dokumenteve strategjik.

Në mënyrë parciale dhe jo të plotë rezultojnë shoqëritë KESH dhe OSHEE grup.

*Për pyetjen audituese:*

*A ka kryer institucioni një vetëvlerësim për nivelin e sigurisë kibernetike?*

Bazuar në ligjin 2/2017 për sigurinë kibernetike dhe Vendimit nr.126 të ERE datë 30.07.2020, ku parashikohet se: OIKI-Operatori i Infrastrukturës Kritike të Informacionit do të paraqesë vetëvlerësimin e tij në ERE bazuar në “Rregulloren mbi përmbajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave të sigurisë (Miratuar me urdhër nr.22, datë 26.04.2018 të AKCESK).

Ky vetëvlerësim do të përmbajë një informacion të detajuar dhe të plotë (duke përfshirë metodologjinë që ka përdorur për të realizuar vetëvlerësimin, mënyrën se si e ka aplikuar këtë metodologji rezultatet e vetëvlerësimit të cilat duhet të përfshijnë identifikimin e riskut si dhe procesin e zvogëlimit të riskut) të çdo rreziku domethënës të identifikuar dhe çdo propozim fillestar për trajtimin e rrezikut përfshirë deklaram për rezultatin e nxjerrë duke identifikuar atë si ‘Jo e arritur "ose" Pjesërisht e arritur " dhe “E Arritur”. Me pas ai duhet të shikojë planin e masave për të ulur rreziqet e identifikuar si dhe të rishikojë planet e investimit për këtë pjesë.

Shoqëritë publike të sektorit elektroenergjitik në zbatim të rregullores së sigurisë kibernetike të infrastrukturës kibernetike në sektorin e energjisë elektrike kanë paraqitur raporte periodike pranë ERE për sigurinë kibernetike.



Vetëm shoqëria OST ka realizuar vetëvlerësim për nivelin e sigurisë kibernetike. Pra përsëri shoqëria KESH dhe OSHEE grup përveç iniciativave të brendshme të tyre nuk kanë realizuar një proces të plotë me ekspert të jashtëm për vetëvlerësimin e sigurisë kibernetike

Në lidhje me pyetjen:

*A janë pajisur me Certifikatë ISO 27001 shoqëritë e sektorit të energjisë elektrike ?*

Bazuar në ligjin 2/2017 për sigurinë kibernetike, Operatorët e Infrastrukturave Kritike në sektorin e energjisë elektrike të pajisen me certifikimin me standardin e sigurisë ISO 27001 brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje. Afati i fundit Mars 2022.

Nga auditimi rezulton se vetëm shoqëria OST është e pajisur me certifikatën e sigurisë ISO 27001, ndërkohë që dy shoqëritë e tjera nuk janë pajisur me këtë certifikatë duke vepruar në mospërputhje me ligjin mbi sigurinë kibernetike dhe “Rregulloren mbi përmbajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave të sigurisë Miratuar me urdhër nr.22, datë 26.04.2018 të AKCESK , ku është parashikuar që: *Operatorët e Infrastrukturave Kritike në sektorin e energjisë elektrike të pajisen me certifikimin me standardin e sigurisë ISO 27001 brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje. Afati i fundit Mars 2022*

OST sh.a., operatori i sistemit të transmetimit të energjisë, në përmbushje të detyrimeve rregullatore bazuar në Nenin 10 të “Rregullores për Sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në Sektorin e Energjisë Elektrike ,Miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 126, datë 30.07.2020”, ka marrë certifikimin ISO 27001:2013 për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMS), duke treguar kështu angazhimin e saj për zbatimin e standardeve më të lartë për sigurinë e informacionit.

*(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 67-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

### **Konkluzione:**

Certifikimi me standardin e sigurisë ISO 27001 i shoqërive të sistemit të energjisë elektrike të klasifikuara si infrastruktura kritike i jep përparësi mbrojtjes së të dhënave të klientit përmes kontrolleve të zbatuara duke përfshirë zhvillimin e produktit sipas sigurisë, kriptimin e të dhënave, menaxhimin e cenueshmërisë, vazhdimësinë e biznesit, planet e rimëkëmbjes nga fatkeqësitë dhe shumë më tepër. Konsumatorët mund të presin një menaxhim sistematik dhe të vazhdueshëm të rreziqeve të sigurisë së informacionit që mund të ndikojnë në konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e informacionit korporativ dhe personal në të gjithë sistemet e TI, Siguria Fizike dhe Teknologjia Operative (OT).

### **Rekomandim:**

**10.1.** Shoqëritë KESH, OSHEE dhe OST duhet të rrisin investimet në lidhje me sigurinë kibernetike për të ngritur një infrastrukturë të sigurt të teknologjive të informacionit dhe komunikimit me protokolle të qarta raportimi, sigurie dhe kontrolli.

*Në vijimësi*

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 702/13 Prot., datë 27.09.2023, është paraqitur observacion i administruar në KLSH me nr. 342/15 prot., datë 11.09.2023 nga OSHEE group si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** *Lidhur me rëndësinë e veçantë të investimeve për sigurinë kibernetike fillimisht i kemi relatuar Këshillit Mbikëqyrës së Shoqërisë me shkresën nr. 650/1 prot, datë 25.01.2023 ku ndër të tjera i kërkojmë miratimit sa më parë për lejimin e fillimit të kësaj procedure pasi me vendimin nr. 2, datë 24.01.2023, pika 2, Këshilli Mbikëqyrës ka urdhëruar OSHEE Group sh.a. të ndërpresë të gjitha procedurat e prokurimit të nisura apo të planifikuara për tu nisur, të cilat janë kompetencë e OSSH sh.a. si edhe miratimin e këtij zëri buxhetor në planin e konsoliduar*

*financiar për vitin 2023. Pas miratimit të zërit buxhetor të miratuar në planin financiar OSHEE Group sh.a. ka filluar përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për këtë procedurë prokurimi. Bashkëlidhur gjeni Vendimin nr. 2 i Këshillit Mbikëqyrës i Oshee Group sh.a. dhe shkresa nr.650/1 dt.25.01.2023.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit :**

*Për sa më sipër, rekomandimi 10.1 në raportin përfundimtar të auditimit përcjellë me shkresën Nr. 342/13 Prot, datë 23.01.2023 të Kontrollit të Lartë të Shtetit, është në proces zbatimi.*

**Statusi i pranimit: Pranuor\_Në kushte të tilla ky rekomandim është në proces zbatimi.**

*Në lidhje me masat e konstatuara në proces zbatimi apo të zbatuara pjesërisht, nga ana e subjektit të audituar OSHEE Group dhe KESH të vijojnë përpjekjet duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore deri në zbatimin e plotë të tyre.*

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

## Anekse

### ANEKSE UJËSJELLËS KANALIZIME FIER

#### Aneksi 1

#### Përmbledhëse e masave sipas llojit. *Në 000/lekë*

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve te pranuar											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr. %	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa organizative	40	-	40	-	-	-	100	-	14	-	-	-	23	-	-	-	3	-	-	-
2	Masa shpërblim dëmi	3	21,140	3	21,140	-	-	100	21,140	-	-	-	-	3	21,140	-	-	-	-	-	-
3	Mos efekt/efic/ekon (3-E)	7	287,548	7	287,548	-	-	100	287,548	2	2,189	1	1,350	2	2,227	-	-	1	281,782	-	-
	Nga të cilat pa kontabilizuar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
4	Masa Disiplinore	6	-	6	-	-	-	100	-	6	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
5	Masa Administrative	3	-	3	-	-	-	100	-	3	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>TOTALI</b>		<b>59</b>	<b>-</b>	<b>59</b>	<b>308,688</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>100</b>	<b>308,688</b>	<b>25</b>	<b>2,189</b>	<b>1</b>	<b>1350</b>	<b>28</b>	<b>23,367</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>4</b>	<b>281,782</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

#### Aneksi 2

#### Pasqyra e Masave Organizative

Nr	Rekomanduar		Pa pranuar		Pranuar		Nga të pranuarat							
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
							Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
1	40	-	-	-	40	-	14	-	-	-	23	-	3	-

#### Aneksi 3

#### Pasqyra e Masave Shpërblim Dëmi *Në 000/lekë*

Nr. Rekomandimesh	Emri shkelësit	Vlera Rekomanduar lekë	Pranuar	Nuk pranohen nga subjekti	Nga të pranuarat							
					Zbatuar		Në proces		Mbetja	Pa zbatuar	Në proces gjyqësor	
					Nr/datë	Vlerë	Nr/Datë	Vlera				Vlera
3	-	21,140	21,140	-	-	-	-	-	-	-	3	21,140

**ANEKSE: UJESJELLES KANALIZIME ELBASAN**

**Aneksi 1**

**Përmbledhëse e masave sipas llojit Në 000/lekë**

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Pa pranuar nga subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi I rekomandimeve te pranuar											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa organizative	26								4		2		3				17			
2	Masa shpërblim dëmi	1	40,771,612															1			
3	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..																				
4	Për eliminimin e efekteve negative....																				
5	Masa disiplinore	1								1											
6	Masa Administrative																				
	<b>TOTALI</b>																				

**ANEKSE AKMC**

**Aneksi 1**

**Përmbledhëse e masave sipas llojit. Në lekë**

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Pa pranuar nga subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi I rekomandimeve te pranuar											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa organizative	19		19		-		100		0		2		17				0			
2	Masa shpërblim dëmi	1	4,669,650	1	4,669,650			100	4,669,650	0		0		1	4,669,650	0		0			
3	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ...	-		-				-													
4	Për eliminimin e efekteve negative....	1	78,044	1	78,044			100	78,044	0		0		1	78,044			0			
5	Masa disiplinore	5		5				100		0		0		0				5			
6	Masa Administrative	-		-				-													
	<b>TOTALI</b>	<b>26</b>	<b>4,747,694</b>	<b>26</b>	<b>4,747,694</b>	<b>-</b>		<b>100</b>	<b>4,747,694</b>	<b>0</b>		<b>2</b>		<b>19</b>	<b>4,747,694</b>			<b>5</b>			

**ANEKSE ALB GAZI**

**Aneksi 1**

**Përmbledhëse e masave sipas llojit. Në 000/lekë**

Nr	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Pa pranuar nga subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi I rekomandimeve te pranuar											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa organizative	20		20		-		100		2		1		10				7			
2	Masa shpërblim dëmi	-		-		-		-		-		-		-				-			
3	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..	-		-		-		-		-		-		-				-			
4	Për eliminimin e efekteve negative....	4	18,451,812	4	18,451,812	-		100	18,451,812	0		0		2	10,217,568			2	423,818,244		

5	Masa disiplinore	5		5		-		100		-	-		4				1		
6	Masa Administrative	-		-		-		-		-	-		-				-		
<b>TOTALI</b>		<b>29</b>	<b>18,451,812</b>	<b>29</b>	<b>18,451,812</b>	<b>-</b>		<b>100</b>	<b>18,451,812</b>	<b>2</b>	<b>1</b>		<b>16</b>	<b>10,217,568</b>			<b>10</b>	<b>423,818,244</b>	

## ANEKSE UJËSJELLËS KANALIZIME VLORE

### Aneksi 1

#### Përmbledhëse e masave sipas llojit. Në 000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve te pranuar											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr. %	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa organizative	19	-	19	-	-	-	100	-	3	-	4	-	12	-	-	-	-	-	-	-
2	Masa shpërblim dëmi	8	15,136	7	14,827	1	309	87.5	14,827	-	-	-	-	7	14,827	-	-	-	-	-	-
3	Mos efekt/efic/ekon (3-E)	6	1,840,234	6	1,840,234	-	-	100	1,840,234	1	1,697	1	1,262,457	4	576,084	-	-	-	-	-	-
-	Nga të cilat pa kontabilizuar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
4	Masa Disiplinore	22	-	22	-	-	-	100	-	22	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>TOTALI</b>		<b>55</b>	<b>-</b>	<b>19</b>	<b>110,744</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>100</b>	<b>-</b>	<b>3</b>	<b>-</b>	<b>1</b>	<b>-</b>	<b>11</b>	<b>106,804</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>4</b>	<b>2,068</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

### Aneksi 2

#### Pasqyra e Masave Organizative

Nr.	Rekomanduar		Pa pranuar		Pranuar		Nga të pranuarat							
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
							Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
1	19	-	-	-	19	-	3	-	4	-	12	-	-	-

### Aneksi 3

#### Pasqyra e Masave Shpërblim Dëmi

Në 000/lekë

Nr. Rekomandimesh	Emri shkelësit	Vlera Rekomanduar lekë	Pranuar	Nuk pranohen nga subjekti	Nga të pranuarat							
					Zbatuar		Në proces		Mbetja	Pa zbatuar	Në proces gjyqësor	
					Nr/datë	Vlerë	Nr/Datë	Vlera				Vlera
8	-	15,136	14,827	309	-	-	-	-	-	-	468	7 14,827

## ANEKSE UJËSJELLES KANALIZIME GJIROKASTER

### Aneksi 1

#### Përmbledhëse e masave sipas llojit. Në 000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve te pranuar											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr. %	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa organizative	40	-	40	-	-	-	100	-	14	-	-	-	23	-	-	-	3	-	-	-
2	Masa shpërblim dëmi	3	21,140	3	21,140	-	-	100	21,140	-	-	-	-	3	21,140	-	-	-	-	-	-
3	Mos efekt/efic/ekon (3-E)	7	287,548	7	287,548	-	-	100	287,548	2	2,189	1	1,350	2	2,227	-	-	1	281,782	-	-
	Nga të cilat pa kontabilizuar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
4	Masa Disiplinore	6	-	6	-	-	-	100	-	6	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
5	Masa Administrative	3	-	3	-	-	-	100	-	3	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>TOTALI</b>		<b>59</b>	<b>-</b>	<b>59</b>	<b>308,688</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>100</b>	<b>308,688</b>	<b>25</b>	<b>2,189</b>	<b>1</b>	<b>1350</b>	<b>28</b>	<b>23,367</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>4</b>	<b>281,782</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

## Aneksi 2 Pasqyra e Masave Organizative

Nr	Rekomanduar		Pa pranuar		Pranuar		Nga të pranuarat							
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
							Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
1	40	-	-	-	40	-	14	-	-	-	23	-	3	-

## Aneksi 3 Pasqyra e Masave Shpërblim Dëmi Në 000/lekë

Nr. Rekomandimesh	Emri shkelësit	Vlera Rekomanduar lekë	Pranuar	Nuk pranohen nga subjekti	Nga të pranuarat							
					Zbatuar		Në proces		Mbetja	Pa zbatuar	Në proces gjyqësor	
					Nr/datë	Vlerë	Nr/Datë	Vlera				Vlera
3	-	21,140	21,140	-	-	-	-	-	-	-	-	3 21,140

## ANEKSE AKUM

### Aneksi 1 Përmbledhëse e masave sipas llojit. Në 000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve te pranuar											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr. %	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa organizative	20	-	20	-	-	-	100	-	10	-	1	-	9	-	-	-	-	-	-	-
2	Masa shpërblim dëmi	3	22,966	3	22,966	-	-	100	22,966	2	12,085	-	-	1	10,880	-	-	-	-	-	-
3	Mos efekt/efic/ekon (3-E)	4	155,060	4	155,060	-	-	100	155,060	2	26,745	-	-	2	128,314	-	-	-	-	-	-

	Nga të cilat pa kontabilizuar		-		-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
4	Masa Administrative	3	-	3	-	-	-	100	-	-	-	-	-	-	-	-	-	3	-	-
5	Masa Disiplinore	12	-	12	-	-	-	100	-	-	-	-	-	11	-	-	-	1	-	-
<b>TOTALI</b>		<b>42</b>	<b>-</b>	<b>59</b>	<b>178,025</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>100</b>	<b>178,026</b>	<b>14</b>	<b>38,831</b>	<b>1</b>	<b>-</b>	<b>23</b>	<b>139,195</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>4</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

**Aneksi 2**  
**Pasqyra e Masave Organizative**

Nr.	Rekomanduar		Pa pranuar		Pranuar		Nga të pranuarat							
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
							Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
1	20	-	-	-	40	-	10	-	1	-	9	-	-	-

**Aneksi 3**  
**Pasqyra e Masave Shpërblim Dëmi**  
*Në 000/lekë*

Nr. Rekomandimesh	Emri shkelësit	Vlera Rekomanduar lekë	Pranuar	Nuk pranohen nga subjekti	Nga të pranuarat						
					Zbatuar		Në proces		Mbetja	Pa zbatuar	Në proces -
					Nr/datë	Vlerë	Nr/Datë	Vlera	Vlera	Vlera	
3	-	22,966	22,966	-	3	12,085	1	10,880	-	-	-

**ANEKSE AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR PROJEKTI NDËRTIMI I BY-PASS-EVE FIER & VLORË**

**Aneksi 1**  
**Përmbledhëse e masave sipas llojit.**

*Në 000/lekë*

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve te pranuar											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr. %	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa organizative	16	-	15	-	1	-	93.7	-	6	-	1	-	7	-	-	-	1	-	-	-
2	Masa shpërblim dëmi	2	68	2	68	-	-	100	68	1	54	-	-	1	14	-	-	-	-	-	-
3	Mos efekt/efic/ekon (3-E)	3	4,614	3	4,614	-	-	100	4,614	-	-	-	-	3	4,614	-	-	-	-	-	-
	Nga të cilat pa kontabilizuar		-		-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>TOTALI</b>		<b>21</b>	<b>4,682</b>	<b>20</b>	<b>4,682</b>	<b>1</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>4,682</b>	<b>7</b>	<b>54</b>	<b>1</b>	<b>-</b>	<b>11</b>	<b>4,628</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>1</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

**Aneksi 2**  
**Pasqyra e Masave Organizative**

Nr.	Rekomanduar		Pa pranuar		Pranuar		Nga të pranuarat							
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
							Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
1	16	-	1	-	15	-	6	-	1	-	7	-	1	-

**Aneksi 3**  
**Pasqyra e Masave Shpërblim Dëmi**

*Në 000/lekë*

Nr. Rekomandimesh	Emri shkelësit	Vlera Rekomanduar lekë	Pranuar	Nuk pranohen nga subjekti	Nga të pranuarat						
					Zbatuar		Në proces		Mbetja	Pa zbatuar	Në proces gjyqësor
					Nr/datë	Vlerë	Nr/Datë	Vlera			
2	-	4,682	2	4,682	1	54	1	14	-	-	-



**ANEKSE AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR PROJEKTI NDËRTIMI I RRUGËS QUKËS-QAFË PLOÇË**

**Aneksi 1**  
**Përmbledhëse e masave sipas llojit.**  
*Në 000/lekë*

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve te pranuarat											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr. %	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa organizative	19	-	19	-	-	-	100	-	10	-	-	-	9	-	-	-	-	-	-	-
2	Masa shpërblim dëmi	2	43	1	10	1	33	23.2	10	1	10	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
3	Mos efekt/efic/ekon (3-E)	3	669	2	577	1	92	86.2	577	-	-	-	-	2	577	-	-	-	-	-	
	Nga të cilat pa kontabilizuar		-		-		-	-	-		-		-		-		-		-		
<b>TOTALI</b>		<b>24</b>	<b>-</b>	<b>22</b>	<b>587</b>	<b>2</b>	<b>125</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>11</b>	<b>10</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>11</b>	<b>577</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	

**Aneksi 2**  
**Pasqyra e Masave Organizative**

Nr.	Rekomanduar		Pa pranuar		Pranuar		Nga të pranuarat							
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
							Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
1	19	-	-	-	19	-	10	-	-	9	-	-	-	-

**Aneksi 3**  
**Pasqyra e Masave Shpërblim Dëmi**  
*Në 000/lekë*

Nr. Rekomandimesh	Emri shkelësit	Vlera Rekomanduar lekë	Pranuar	Nuk pranohen nga subjekti	Nga të pranuarat						
					Zbatuar		Në proces		Mbetja	Pa zbatuar	Në proces gjyqësor
					Nr/datë	Vlerë	Nr/Datë	Vlera			
2	-	43	10	33	1	10	-	-	-	-	-

**ANEKSE FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT PROJEKTI NDËRTIMI I RRUGËS SË LUMIT TË VLORËS**

**Aneksi 1  
Përmbledhëse e masave sipas llojit.**

*Në 000/lekë*

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve te pranuar											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr. %	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa organizative	9	-	7	-	2	-	77.8	-	3	-	-	-	3	-	-	-	1	-	-	-
2	Masa shpërblim dëmi	1	1,307	1	696	1	611	53.2	696	-	-	1	696	-	-	-	-	-	-	-	-
3	Mos efekt/efic/ekon (3-E)	2	140,760	2	140,760	-	-	100	140,760	1	129,293	-	-	1	11,468	-	-	-	-	-	-
	Nga të cilat pa kontabilizuar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
4	Masa Disiplinore	1	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>TOTALI</b>		<b>13</b>	<b>142,067</b>	<b>10</b>	<b>141,456</b>	<b>4</b>	<b>611</b>		<b>141,456</b>	<b>4</b>	<b>129,293</b>	<b>1</b>	<b>696</b>	<b>4</b>	<b>11,468</b>	-	-	<b>1</b>	-	-	-

**Aneksi 2  
Pasqyra e Masave Organizative**

Nr.	Rekomanduar		Pa pranuar		Pranuar		Nga të pranuarat							
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
							Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
1	9	-	2	-	7	-	3	-	-	-	3	-	1	-

**Aneksi 3  
Pasqyra e Masave Shpërblim Dëmi**

*Në 000/lekë*

Nr. Rekomandimesh	Emri shkelësit	Vlera Rekomanduar lekë	Pranuar	Nuk pranohen nga subjekti	Nga të pranuarat						
					Zbatuar		Në proces		Mbetja	Pa zbatuar	Në proces gjyqësor
					Nr./datë	Vlerë	Nr./Datë	Vlera			
1	-	1,307	696	611	1	696	-	-	-	-	-

ANEKSE FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT PROJEKTI RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS UJË I FTOHTË – ORIKUM DHE NDËRTIMI I DY BY – PASS-EVE

**Aneksi 1**  
**Përmbledhëse e masave sipas llojit.**

*Në 000/lekë*

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve te pranuar											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr. %	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa organizative	6	-	5	-	1	-	83.3	-	1	-	-	-	4	-	-	-	1	-	-	-
	<b>TOTALI</b>	<b>13</b>	<b>142,067</b>	<b>10</b>	<b>141,456</b>	<b>4</b>	<b>611</b>		<b>141,456</b>	<b>4</b>	<b>129,293</b>	<b>1</b>	<b>696</b>	<b>4</b>	<b>11,468</b>	-	-	<b>1</b>	-	-	-

**Aneksi 2**  
**Pasqyra e Masave Organizative**

Nr.	Rekomanduar		Pa pranuar		Pranuar		Nga të pranuarat							
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
							Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
1	6	-	1	-	5	-	1	-	-	-	4	-	-	-